Misteret e Klarës

LIVING
ALBANIA

Libra nga Ellen Marie Wiseman

PEMA E KUMBULLËS
MISTERET E KLARËS

Botuar nga *Kensington Publishing Corporation*

MISTERET E KLARËS

ELLEN MARIE WISEMAN

PËRKTHEU: MANJOLA ÇRAGA

LIVING
ALBANIA

Titulli i origjinalit:
What she left behind
Titulli i botimit në gjuhën shqipe:
MISTERET E KLARËS

Copyright 2016 Botimet Living
Tiranë, 2016
Shtypur në Shqipëri
ISBN: 978-9928-216-01-4

Botuese: Ridvana Dulaku

Përktheu: Manjola Çraga
Redaktoi: Pranvera Palushi, Edvina Sojati
Kryeredaktore: Etleva Çepele
Design & Layout: Dritan Lleshi

Të gjitha të drejtat e këtij libri janë të rezervuara.
Ndalohet kopjimi apo riprodhimi i pjesshëm apo i plotë me çdolloj mjeti e forme.



Kompleksi "Don Bosko"
Kulla 7, kati II,
Tiranë, Shqipëri
Tel: +35544800008
Fax: +35544800001
email: info@living.al

Living online:
www.living.al
facebook/Living
instagram/Living_Albania
youtube/TringDigital
twitter.com/TringDigital

Kushtuar bashkëshortit tim, Billit,
i cili ka pasur gjithnjë besim tek unë

Falënderime

Me shumë kënaqësi dua të falënderoj edhe një herë të gjithë ata që më ndihmuan, më mbështetën dhe besuan tek unë, përgjatë këtij rrugëtimi të jashtëzakonshëm.

Pikësëpari, ky roman nuk do të ishte përfunduar, po të mos isha bazuar në veprën "Jetët që lanë pas: Valixhet e një papafingoje spitali" të shkrimtarëve *Darby Penney* dhe *Peter Stastny*. Libri i tyre më frymëzoi dhe më hapi sytë për botën që rrethonte spitalet dhe të sëmurët mendorë në të shkuarën. I detyrohem shumë *Darby Penney*-t që pati kohë t'u përgjigjej pyetjeve të mia lidhur me spitalin "Uillard" dhe gjendjen e pacienteve femra në vitet 1930. Shpresoj të më falni për ndonjë pasaktësi historike dhe për mënyrën krijuese që mund të kem përdorur.

Dua të falënderoj *Deborah Jiang Stein*-in, shkrimtaren dhe bashkëthemeluesen e projektit "unPrison" që iu përgjigj të gjitha pyetjeve të mia lidhur me gjendjen e femrave nëpër burgje. Gjithashtu, një falënderim shkon edhe për *Andrew Thompson*-in, që më përcolli të gjitha njohuritë dhe informacionet që kishte për oficerët e burgjeve.

Dua të falënderoj të afërmit dhe miqtë e mi, të cilët më kanë mirëkuptuar përgjatë kohës që isha e zënë, që më kanë falur sa herë kam qenë e detyruar t'u thosha "jo" dhe që më lejuan të kisha kohën dhe hapësirën e nevojshme për të respektuar afatet kohore. Do t'ju jem ngaherë mirënjohëse që nuk e humbët kurrë besimin tek unë, për durimin dhe mirëkuptimin gjatë këtij rrugëtimi me shumë të përpjeta e të tatëpjeta dhe, mbi të gjitha, për dashurinë tuaj.

Do ta nënvlerësoja, nëse nuk do të shprehja mirënjohjen time për grupin e leximit në BP. Nuk mund ta imagjinoja përjetimin e këtij rrugëtimi të shfrenuar dhe gjallërues pa miqësinë dhe këshillat tuaja të vyera. Ne po e pushtojmë botën së bashku, duke i nxjerrë librat me radhë!

Me shumë kënaqësi dua të shpreh dashurinë dhe mirënjohjen time të madhe për shoqen time, që e kam si motër, *Barbara Titterington*-in. Faleminderit që ishe një nga përkrahëset e mia më të mëdha dhe që lexove kopjen e parë të dorëshkrimit tim. Mendimi yt se unë shkëlqej përherë, më jep forcë për të ecur përpara.

I jam përjetësisht mirënjohëse redaktorit tim të mrekullueshëm, *John Scognamiglio*-s, për besimin që pati tek unë dhe agjentit tim të duruar e mendjehollë, *Michael Carr*. Nuk mund t'ju falënderoj dot kurrë mjaftueshëm për mbështetjen tuaj të palëkundur, për këshillat e vlefshme dhe ndihmën tuaj për ta bërë këtë histori edhe më të veçantë. Dua të falënderoj gjithashtu edhe publicisten time, *Vida Engstrand*-in, që bëri reklamimin e romaneve të mia dhe *Meryl Earl*-in, drejtoren e të Drejtave, që arriti të siguronte të drejtat e librave të mi edhe jashtë vendit. Një falënderim shkon edhe për *Kristine Mills-Noble*-n, e cila realizoi skicat e mrekullueshme të kopertinës. Sërish, dua të falënderoj pa masë ekipin e Kensingtonit për punën e palodhshme që ka bërë në prapaskenë.

Nuk mund të rri pa shprehur dhe përmendur mirënjohjen time për njerëzit që jetojnë në dhe pranë komunitetit tim. Dua të theksoj se inkurajimi dhe mendimet e bibliotekares që më ftoi të bëja një prezantim, të gazetarit që shkroi një artikull për mua, të anëtarit të klubit të librit që më ftoi në shtëpinë e tij, të përkrahësit të internetit apo të dikujt tjetër që e lexoi veprën time dhe më tha se i pëlqeu shumë, ishin shumë të rëndësishme për mua. Duke parë buzëqeshjen dhe fytyrat tuaja të emocionuara, m'u mbushën sytë me lot dhe zemra plot krenari. Këto kanë qenë gjërat më interesante të kësaj përvoje, që nuk kam për t'i harruar kurrë.

Dua të falënderoj nga thellësia e zemrës nënën time të dashur, Sigridin, që ishte pikëmbështetja ime më e madhe, dhe nuk mund të mos falënderoj bashkëshortin tim, Billin, që më mirëkuptoi gjatë gjithë kësaj periudhe. Dhe në fund, por jo për nga rëndësia, dua të shpreh dashurinë dhe mirënjohjen time të madhe për fëmijët e mi, Benin, Xhesikën dhe Shanen, si dhe për nipërit e mi, Rajlin, Harperin dhe Linkolnin. Ju jeni arritja ime më e madhe dhe ju dua me gjithë shpirt. Vetëm ju i jepni kuptim jetës sime.

KAPITULLI 1



IZABELA

Spitali i sëmundjeve mendore "Uillard"
1995

S'kishin kaluar veçse pak minuta që kur vuri këmbë në mjediset e spitalit "Uillard", kur shtatëmbëdhjetëvjeçarja Izabela Stoun, e kuptoi se po gabonte. Kushdo që mund ta shihte duke qëndruar në rrugën kryesore, të prishur dhe plot puseta të kësaj prone të madhe të rrethuar me pemë, nuk do ta imagjinonte se ç'tmerr po përjetonte ajo në vetvete.

Atë të shtunë me mjegull fundgushti, puhiza e ngrohtë sillte me vete aromën e kallamave dhe leshterikëve, dhe shkulmat e herëpashershëm të erës bënin që gjethet e korijeve me pisha, që gjendeshin në anën e majtë të oborrit të hapur, të fëshfërinin. Prej tokës së zhuritur nga dielli, ngrihej një afsh me avuj të nxehtë dhe në barin pranë pyllit gjinkallat zukatnin duke lëshuar tinguj që sa vinin e shtoheshin bashkë me temperaturën e lartë, që dukej se nuk kishte ndër mend të ndalej. Lëndinat e zbukuruara të Uillardit linin pas godinat kryesore, duke zbritur tatëpjetën drejt bregut shkëmbor të liqenit Seneka. Barkat me vela lundronin nëpër dallgë dhe një mol i gjatë përvijohej si për t'i ftuar të gjithë të hynin në ujin vezullues.

Izabela, të cilën i ati e thërriste Izi, duhej të ishte duke shijuar rrezet e ngrohta të diellit dhe peizazhin e mrekullueshëm, por

në fakt, po skërmiste dhëmbët duke u përpjekur të fshinte nga kujtesa imazhin e një vrime në kafkën e të atit nga ku gjaku rridhte çurg. Ndihej si e zënë në kurthin e purgatorit. A do të gjente ndonjëherë paqe apo do të mbetej gjithnjë ajo shtatëvjeçarja që përjetonte pambarimisht natën e tmerrshme të vrasjes së të atit?

Izi doli nga hija e *Chapin Hall*-it, godina kryesore e institucionit, dhe u gjend nën diellin e nxehtë, ku po qëndronte symbyllur dhe po përpiqej të ndrydhte të gjitha mendimet. Por kur u kthye dhe ngriti sytë nga godina trekatëshe me tulla e stilit viktorian, me dritare si të katedraleve, e zaptoi sërish makthi. Një kube gjigante dykatëshe me frëngji ngrihej mbi një mansardë të zezë mbi të cilën dukeshin ca dritare papafingoje, kullëza dhe oxhaqe. Porta gjigante e hyrjes kryesore mbrohej nga një portik i gurtë me kolona të krisura. Kangjellat e hekurta mbulonin dritaret e gjata me shumë panele, shumica e të cilave kishin edhe nga një shtresë kompensate brenda, përveç dritareve të papafingos dhe frëngjive të rrumbullakëta të kubesë. Kjo godinë dukej më tepër si një vend i përndjekur nga fantazmat, sesa si një vend që kishte për qëllim të ndihmonte njerëzit.

Izi vriste mendjen se çfarë tmerresh mund të kishte parë kjo ndërtesë kaba. Çfarë kujtimesh të lemerishme mund të lidheshin me tullat, suvanë dhe xhamat e mjegullt, që kishin qenë përherë pjesë e kësaj strukture të ngritur e të vulosur me gjak dhe lot? Ashtu si dhembja dhe ankthi që do të ishin gjithmonë pjesë e saj, edhe kujtimet e mijëra shpirtrave të torturuar do të vazhdonin të jetonin në *Chapin Hall* dhe në godinat përreth të spitalit "Uillard". Si ka mundësi që ky vend mund të ishte gjithçka, përveçse një kujtim i trishtuar i jetëve dhe i personave të dashur të humbur?

Ajo u kapërdi e u kthye për nga liqeni dhe njërën dorë e vuri mbi sy, për t'u mbrojtur nga dielli. Vriste mendjen nëse lundërtarët i hidhnin ndonjëherë sytë nga spitali dhe mendonin se grumbulli i godinave me tulla dhe lëndinat i përkisnin ndonjë klubi apo kolegji, sepse, po t'i shikoje nga larg, gjithçka dukej e rregullt dhe elegante. Por ajo e dinte shumë mirë. Filloi të imagjinonte pacientët e dikurshëm në oborr, të ulur në karrige me rrota ose duke tërhequr këmbët zvarrë mbi barin e rritur, rrobat e spitalit

që vareshin në parmakët e hollë dhe sy që zgurdulloheshin. Teksa sodiste liqenin blu, imagjinonte sikur ishte një prej tyre. A arrinin ta kuptonin këta pacientë se njerëzit që jetonin përtej gjirit, shëtisnin me barka, gatuanin, dashuroheshin dhe bënin fëmijë? A e pyesnin ndonjëherë veten ata nëse do të largoheshin nga spitali, nëse do t'i bashkoheshin botës "normale"? Apo ndoshta nuk e kishin aspak idenë për jetën që po humbnin?

Izi ndjeu një boshllëk në stomak teksa një kujtim tjetër i regëtiu në mendje: e ëma, Xhoisi, duke u dergjur në një shtrat në spitalin psikiatrik "Elmira", me flokë të shkalafitur e shikim të përhumbur, me një vështrim të zbrazët ngulur në tavan. Ajo qe një ditë mbytëse, njësoj si kjo e sotmja dhe Izi e mbante mend mirë rimelin dhe penelin e së ëmës, që rridhte mbi mollëzat e zbehta, si një kloun që shiu po e bënte qull. Kujtoi se si kish strukur kokën në fundin e gjyshes dhe i ishte lutur të ktheheshin në shtëpi. Nuk do t'i fshinte kurrë nga mendja korridoret e pafund e të bardha të pavijonit të psikiatrisë, erën e urinës dhe të klorit, dhomat e errëta, pacientët në karroca me rrota dhe shtretërit e rrethuar nga mure gome. Pas asaj vizite, për vite të tëra nuk iu ndanë kurrë makthet. I ish lutur gjyshes të mos e detyronte të kthehej më atje dhe për fat të mirë, ajo kish pranuar.

Izi mbështolli krahët rreth vetes dhe nisi të ecte përgjatë trotuarit të prishur në rrugën kryesore të Uillardit, duke vrarë mendjen se si përfundoi aty, teksa eksploronte një kopje gjigante të atij pavijoni të ndyrë të spitalit. Mund të shtirej sikur i dhembte koka apo kishte të përziera, mund të kishte sajuar gjithçka vetëm për të mos shkuar aty. Në vend të saj mund të kishin ardhur shumë punonjës të tjerë të muzeut, por nuk kishte dashur ta linte në baltë nënën kujdestare, Pegin, kuratoren e muzeut. Për herë të parë që kur ishte dhjetë vjeçe, pas vdekjes së gjyshes, Izi kishte prindër kujdestarë që kujdeseshin vërtet për të.

Në më pak se një vit, do të mbushte tetëmbëdhjetë vjeç. Ishte aq e rritur, sa e dinte se për tetëmbëdhjetëvjetor nuk bëheshin festa të mëdha. Ajo do të ishte e pavarur kur të mos merrte më çeqe. Të mos ishe më nën kujdesin e institucioneve shtetërore, do të thoshte të ishe i pastrehë. Kish dëgjuar shumë histori për fëmijë që kishin përfunduar në burg apo në urgjencat e spitaleve, që shisnin

drogë, jetonin me ndihmë sociale apo me kupona ushqimorë, për të marrë ushqime me ulje çmimi. Sa i pashpresë duhej të ishte një person para se të shkelte ligjin e mbijetesës? Tani për tani, gjërat po shkonin mirë dhe ajo nuk donte të nxirrte probleme.

Më parë, Pegi i kish kërkuar të shkonte në spitalin e vjetër që ta ndihmonte për të ruajtur gjithçka që ia vlente, para se godinat të shpalleshin në gjendje të mjerueshme për t'u përdorur. Pa thënë asnjë fjalë, edhe pse nuk e kishte me qejf, Izi kish pranuar ta ndihmonte. Ajo u lehtësua kur Pegi e la të eksploronte fillimisht mjedisin e jashtëm, në vend që ta merrte brenda bashkë me të tjerët, duke u ngjitur këmbadoras nëpër bodrume, duke u endur përmes morgut dhe duke vizituar pavijonet e braktisura të pacientëve. Pyeste veten se çfarë do të mendonte Pegi, po ta merrte vesh se thjesht ideja e të qenit pranë Uillardit ia sillte zorrët në gojë.

Kaloi një urë druri mbi shtratin e një përroi të tharë e më pas ndoqi rrugën me një korsi, drejt korijes me pisha. Në të majtë të saj, një tufë patash po ushqeheshin në një fushë plot me bar, me kokat e përkulura mbi lulet shufërarta. Disa metra larg rrugës, tri biba në ngjyrë gri në të verdhë ishin shtrirë në një fole me lule bishtminjsh dhe yllëza dhe qafat u vareshin deri poshtë. Izi ndaloi dhe po i shihte pa lëvizur. Bibat i kishin sytë hapur, por nuk lëviznin fare. U afrua më shumë, duke ndjekur me bisht të syrit patat e rritura në fushë. Pavarësisht se po afrohej gjithnjë e më shumë, bibat nuk lëvizën fare nga vendi, por qëndronin të ngrira si gurë lumi. Izi u kapërdi, fyti i digjte. Bibat ose kishin ngordhur, ose po ngordhnin.

U ul në gjunjë dhe mori një prej tyre ndër duar, duke ia kthyer trupin e butë e të squllur nga ana tjetër, për ta kontrolluar për ndonjë plagë të mundshme poshtë krahëve apo në bark. Ia lëvizi këmbët dhe qafën dhe e kontrolloi mos kish ndonjë kockë të thyer. Nuk kishte asnjë shenjë traume dhe biba ishte ende e ngrohtë. Më pas, kapsalliti sytë. Ishte ende gjallë. Ndoshta ishin të sëmura ose ishin helmuar nga lëndët kimike apo mjekimet psikiatrike që ishin hedhur pa fund nga Uillardi. Mori në dorë edhe dy bibat e tjera, por nuk vuri re asnjë dëmtim dhe i vendosi sërish në vend.

Ato çaste pyeste veten nëse Pegi do ta lejonte t'i merrte me vete në shtëpi, që të kujdesej për to derisa të merrnin veten. Më pas, iu kujtua se kafshët e egra ndiheshin më mirë kur jetonin vetëm. Ndoshta nëna e tyre do të kthehej dhe do ta zgjidhte ajo problemin. Izi hodhi vështrimin pas me shpresën se prindërit e bibave do të shfaqeshin nga çasti në çast, drejtoi trupin dhe vazhdoi sërish rrugën, me sytë e mbushur me lot. Fatmirësisht, atyre s'u kishte ndodhur asgjë. Befas, bibat brofën në këmbë dhe nisën të vraponin drejt fushës, ku nëna e tyre po gagariste dhe ishte turrur përmes barit. Izi qeshi dhe fshiu sytë, e habitur që patat mund të shtireshin sikur kishin ngordhur.

Psherëtiu e çliruar dhe vijoi drejt korijes me pisha. Në njërën anë të rrugës, në mes të një lëndine, ngrihej një ndërtesë e pjerrët katërkatëshe, me dritare të shkatërruara e të veshura me hekura. Çatia ishte shembur thuajse e gjitha dhe tjegullat në ngjyrë jeshile dhe druri i thyer ishin mbuluar nga myku. Dukej sikur kishte rënë nga qielli, si një anije e nxjerrë nga deti dhe e hedhur mijëra kilometra larg bregut. Në anën tjetër të rrugës, disa rreshta me koka varresh prej hekuri, të anuara majtas e djathtas si dhëmbë të shtrembër në ngjyrë gri, përcaktonin kufijtë e një livadhi. Izi ndjeu një shije të hidhur në fyt. Ishin varrezat e Uillardit. U kthye menjëherë pas dhe filloi të nxitonte hapat drejt godinës kryesore, drejt radhëve me tulla dhe godinave në madhësinë e fabrikave, të cilat lidheshin me *Chapin Hall*-in - pavijonet e pacientëve.

Shkallët e emergjencës së pavijoneve gjendeshin brenda kafazeve prej hekuri. Dritaret e ndotura ishin veshur me hekura të trashë dhe nga parvazet e dëmtuara, një llum i zi rridhte përgjatë mureve me tulla. Shumica e dyerve dhe dritareve ishin veshur nga brenda me kompensatë, sikur gjithçka që kish ndodhur atje nuk duhej të dilte kurrë në dritën e diellit. Izi u rrëqeth. Sa pacientë kishin vuajtur dhe kishin vdekur në këtë vend të tmerrshëm?

Atë çast, dikush e thirri në emër dhe e shkëputi nga mendimet. Kur u kthye, pa Pegin që me një buzëqeshje vesh më vesh e me hapa të shpejtë, po përshkonte rrugën drejt saj. Që kur e pa për herë të parë nënën e saj kujdestare, Pegin, ishte sikur t'i

shfaqej përpara syve imazhi i një hipie të viteve '60. Edhe sot e kësaj dite, ajo ishte po e njëjta. Kish veshur kominoshe xhinsi, një kanotierë me lule, si ndonjë cigane, dhe kaçurrelat i kishte të lëshuar e të shpupuritur.

- Nuk të duket i mrekullueshëm ky vend? - e pyeti Pegi. - Nuk e dija që ishte kaq i madh!

- Është që ç'ke me të, - tha Izi, duke u përpjekur të dukej sa më bindëse.

- E pe hangarin dhe molin? - e pyeti ajo. - Atje, në vitin 1869, zbriti nga një vapor pacientja e parë e spitalit "Uillard". Quhej Meri Rouzi. Ishte një grua e shfytyruar dhe e çmendur, e cila, për dhjetë vjet me radhë, u mbajt në një strehë vorfënore në kontenë Kolumbia, e lidhur me zinxhir brenda një qelie, pa shtrat dhe pa veshje. Atë ditë, në mol mbërritën edhe tre pacientë të tjerë meshkuj, të gjithë të lidhur me pranga. Njërin prej tyre e kishin futur brenda diçkaje, që dukej si një arkë ku çelin zogjtë e pulës.

Izi hodhi vështrimin drejt molit. Në krahun e djathtë të tij ngrihej një hangar dykatësh për barkat, me dritare të thyera dhe dërrasa të shkulura, që dukej si një fytyrë e mavijosur me qepalla të varura.

- Sa barbare duket! - tha ajo.

- Ashtu ka qenë, - iu përgjigj Pegi. - Kjo është edhe arsyeja pse u ndërtua Uillardi. Qëllimi ishte të ngrihej një vend për të çmendurit që po zaptonin gjithnjë e më shumë hapësirat e strehëve vorfënore dhe burgjeve. Brenda disa ditëve nga mbërritja e tyre në spital, pacientët e rinj i lanë, i veshën, i ushqyen dhe zakonisht i mbanin nëpër pavijone.

- Pra, njerëzit trajtoheshin mirë këtu?

Pegi mori një pamje të zymtë.

- Në fillim mendoj se po, por me kalimin e viteve, Uillardi u mbipopullua dhe kushtet u përkeqësuan. Fatkeqësisht, thuajse gjysma e pesëdhjetë mijë pacientëve të Uillardit vdiqën këtu.

Izi kafshoi faqen nga brenda, duke vrarë mendjen se çfarë justifikimi mund të nxirrte që t'i kërkonte ta priste në makinë. Pastaj Pegi vuri buzën në gaz dhe i rroku dorën.

- Eja, - i tha ajo me sytë që i shndrisnin. - Një nga ish-

punonjëset do të na tregojë punishten e mbyllur. Besoj se do t'ia vlejë dhe nuk dua që ta humbasësh për asgjë në botë.

Izi rënkoi në shpirt dhe ndoqi nënën e saj kujdestare përgjatë rrugës kryesore që të çonte te punishtja, duke u munduar të gjente ndonjë arsye për të mos hyrë brenda. Mirëpo nuk po i vinte asgjë ndër mend. Asgjë që të mos tingëllonte budallallëk apo marrëzi. Nuk donte që Pegi të mendonte se ajo ishte e çmendur. Verën e shkuar, kur shkoi për herë të parë në shtëpinë e saj dhe të Herrit, ishte e sigurt se edhe ata do të ishin si prindërit e tjerë kujdestarë, që i merrnin fëmijët për para apo për ndonjë punë. Herri ishte drejtor arti në muzeun shtetëror dhe Izi mendonte se ata të dy nuk fitonin shumë para. Por fatmirësisht, këtë herë kishte gabuar në gjykimin e saj. Prindërit e saj të rinj ishin njerëz të mirë, të gatshëm për t'i dhënë hapësirën e duhur, si fizike, ashtu edhe emocionale, për të cilën kishte nevojë një vajzë e re. Në shtëpinë trekatëshe të Pegit dhe Herrit në *Interlaken*, ajo kishte dhomën e saj me pamje nga liqeni, kishte një televizor, DVD dhe një kompjuter të vetin. Ata i kishin thënë se e kishte ajo në dorë të fitonte besimin e tyre. Ishte hera e parë që dikush e linte të vendoste vetë, pa e gjykuar fillimisht. Më në fund, Izi ndjeu se ishte pjesë e diçkaje "normale".

Gjithsesi, ndonjëherë kjo situatë i dukej shumë e bukur për të qenë e vërtetë. Ajo mendonte se, nga çasti në çast, do të shfaqej dikush apo diçka që do të përmbyste gjithçka. Kështu kishte ecur deri më tani jeta e saj. Pastaj, u kujtua se pas dy ditësh do të shkonte në shkollën e re dhe stomaku iu pështjellua. Ishte gjithmonë e vështirë të ishe nxënësja e re në një shkollë të re.

Sa më shumë i afroheshin punishtes, aq më shumë zjarrmi ndiente në qafë dhe gjoks. Ashtu si e ëma, ajo kishte sy blu të shkruar, flokë të zinj dhe lëkurë të bardhë. Kur nervozohej, qafa dhe kraharori i mbusheshin me njolla të kuqe. Ndiente se lëkura i ishte bërë pulla-pulla. Qëndrimi jashtë, në lëndinat përreth spitalit, ishte tjetër gjë, por tani po hynte në një nga godinat e tij. Dëshira e fortë për t'ia mbathur me të katra i rrihte si çekan në kokë, duke bërë që zemra t'i buçiste fort. *Është pjesë e punës sime,* mendoi. *S'ka lidhje me mua apo nënën time. Ka ardhur koha të mos kapem më pas frikave fëmijërore.*

Ajo mblodhi flokët e gjatë topuz në majë të kokës, duke e lënë puhizën t'i përkëdhelte qafën.

- S'ke vapë me atë bluzë me mëngë të gjata? - e pyeti Pegi.

- Jo, - u përgjigj Izi, duke ulur mëngët dhe duke i shtrënguar fort brenda grushteve. - Është shumë e hollë.

- Kur lava rrobat, vura re se nuk kishe asnjë bluzë me mëngë të shkurtra, - vazhdoi ajo. - Ndoshta duhet të dalim, që të blesh rroba të reja.

Izi u mundua të qeshte me zor.

- Faleminderit, - i tha, - por më pëlqejnë bluzat me mëngë të gjata. S'është nevoja t'i lash rrobat e mia.

- Nuk e kam problem, - ia ktheu Pegi buzagaz. - Thjesht nuk arrij ta kuptoj se si mund të vishesh me mëngë të gjata në një mot të tillë.

Izi mblodhi supet.

- Ngaqë e di mirë se si i kam krahët, - ia ktheu ajo. - Janë shumë të hollë e të bardhë.

- Shumica e vajzave vdesin t'i kenë krahët dhe këmbët të gjata e të holla si të tuat, - ia ktheu Pegi duke qeshur.

Jo, nëse ato do të shikonin vragat, mendoi Izi.

Ajo hodhi vështrimin nga liqeni dhe pranë bregut pa grupe njerëzish që ishin ulur në tavolinat e piknikut, që ecnin ose luanin softboll dhe badminton. Shumë prej tyre kishin veshur rroba të vjetra e të shpëlara dhe i hiqnin këmbët zvarrë, si të ishin trullosur nga mjekimet. Papritur ndaloi.

- Cilët janë ata? - pyeti Pegin.

Ajo vendosi dorën mbi sy për t'u mbrojtur nga dielli dhe hodhi shikimin drejt bregut.

- Ndoshta janë pacientët e qendrës psikiatrike "Elmira", që ndodhet këtu pranë, - tha Pegi. - Përtej liqenit është një kamp. Ndonjëherë, stafi i sjell pacientët këtu për shëtitje.

Izit iu mbushën sytë me lot dhe vazhdoi rrugën, me vështrimin përdhe. Pegi e ndoqi pas.

- Si e ke hallin? - e pyeti ajo.

- Atje ka qenë edhe nëna ime, - tha Izi. - Tek "Elmira".

Pegi e rroku nga supet.

- Më fal! Nuk e dija.

Izi ngriti kokën dhe u mundua të buzëqeshte.

- S'ka problem. Ka ndodhur shumë kohë më parë.

- Dua ta dish se mua më ke gjithnjë pranë, nëse ke nevojë të flasësh.

- E di, - u përgjigj Izi. - Faleminderit!

Jo faleminderit, tha me vete. Asnjë bisedë në botë nuk mund ta ndryshonte faktin se njerëzit ishin mallra me defekt. Para se gjyshja të ndërronte jetë para shtatë vjetësh, Izi ishte vizituar në tre mjekë të ndryshëm, në përpjekje për të gjetur paqe nga makthet që nuk e linin të qetë. Asgjë nuk bëri punë. Përveç kësaj, mjekët nuk dinin asgjë. Shumë prej tyre ngulnin këmbë se e ëma gëzonte një mendje dhe trup të shëndoshë dhe mund ta përballonte më së miri procesin gjyqësor. Por Izi e dinte se e vetmja arsye pse e ëma e qëlloi të atin e saj në gjumë, ishte çmenduria.

Sapo mbërritën te punishtja e mbyllur, ish-punonjësja hapi derën dhe futi brenda Izin, Pegin dhe dy punonjësit e tjerë të muzeut.

- Këtu pacientët paketonin stilolapsa dhe ngjisnin qese letre, - shpjegoi gjithë hare, sikur t'u tregonte ca jorganë të ekspozuar në një panair vendas.

Në brendësi të ndërtesës, në dhomat e shkretuara, gjendeshin tavolinat e zbrazura të punishtes. Kalendarët dhe pajisjet e vjetra kundër zjarrit ishin varur në muret e krisura, ku kish rënë suvaja. Ashensori i vjetër i mallrave kishte vite që nuk vihej në punë, ndaj Izi dhe të tjerët duhej të merrnin shkallët e ngushta e të pjerrëta për të ngjitur tri katet që të çonin në papafingo. U duhej të shkelnin mbi shkallët e prishura, mbi copat e rëna të suvasë dhe të pastronin me dorë rrjetat e merimangave. Kur mbërritën, ish-punonjësja hapi drynin e derës së papafingos dhe i mëshoi fort që ta hapte. Dera nuk lëvizi vendit. Pegi u ngjit për ta ndihmuar, duke e shtyrë me të dyja duart. Më në fund, dera u hap dhe u dëgjua kërcitja e menteshave. Ajri i rëndë dhe pluhuri brenda shkallëve u ngrit lart, sikur papafingoja të ishte një gjigant që gulçonte. Punonjësja i shoqëroi brenda.

Në papafingo mbyteshe nga nxehtësia dhe mungesa e ajrit dhe vendi qelbej erë druri të vjetër, pluhuri dhe glasa zogjsh. Gjethet e rëna përdhe, që era ndër vite i kish futur brenda përmes xhamit

të thyer të njërës prej dritareve, ishin hapërdarë sa andej-këtej dhe dukeshin si një qilim dosido i shtruar mbi dyshemenë e drunjtë. Një përparëse e pistë qëndronte varur në një gozhdë dhe objektet e disa valixheve të prishura ishin shpërndarë nëpër dërrasat e dyshemesë. Çelësa shtëpish dhe fotografi, vëthë dhe rripa, bluza dhe këpucë lëkure ishin përzier me pisllëkun dhe gjethet e rëna përdhe, si sende të nxjerra nga varri pas një gërmimi. Në mes të dhomës së madhe, syri të zinte çantën e një mjeku dhe diçka që dukej si një hartë e grisur, që të dyja mbuluar nga një shtresë e trashë glasash të thara pëllumbash.

Nën trarët e papafingos, një rresht me rafte druri kishte zënë thuajse të gjithë katin. Të emërtuara "Burra" dhe "Gra", si dhe të shënuara me shkronja nga "A"-ja te "Z"-ja në secilën anë, raftet gjigante ishin montuar pingul me muret e larta, përgjatë korridorit që të çonte në mes të dhomës, si korridori kryesor brenda një supermarketi apo biblioteke. Por në vend të konservave apo librave, raftet kishin me qindra valixhe të mbuluara me pluhur, arka, rroba dhe sëndukë.

- Çfarë janë këto? - pyeti Pegi, në zërin e së cilës ndihej një lloj frike.

- Këtu mbaheshin valixhet, - u përgjigj ish-punonjësja. - Të gjitha valixhet dhe sëndukët janë lënë nga pacientët që u mbyllën në këtë institucion, por nuk u larguan kurrë prej tij. Nuk janë prekur që nga koha kur pronarët e tyre i kanë paketuar para shumë dekadash, para se të futeshin në spital.

Izi kafshoi buzën dhe përpëliti sytë e përlotur. Imagjinoi valixhen e së ëmës, të hapur mbi një tryezë në fund të shtratit të saj të spitalit: mbathje, reçipeta dhe këmishë nate të hedhura rrëmujë. Nuk do ta fshinte kurrë nga kujtesa herën e parë kur hyri në dhomën e gjumit të prindërve, pas vrasjes së të atit. Gjyshja kish nevojë për ndihmë, që të gjente e të paketonte plaçkat e së ëmës. Izi kish hapur ngadalë sirtarët e komosë, ku aroma e njohur e parfumit të së ëmës ndihej në jelekët dhe veshjet e brendshme e përhapej kudo, duke i kujtuar gjithçka që kish humbur. Asokohe, Izi ende ndiente erën e gjakut të të atit dhe të barutit. Iu kujtua kur kish parë shtratin e prindërve, kokën dhe këmbët prej hekuri, shufrat anësore të çmontuara e të mbështetura në muret

e dhomës së gjumit, sikur do të transferoheshin në shtëpinë e madhe që e ëma e kish ëndërruar gjithmonë. Tani, thjesht duhej të përmbahej që të mos ia mbathte me të katra nga papafingoja e spitalit e të merrte vrapin nëpër shkallë për të dalë në ajër të pastër, larg kujtimeve të jetëve të humbura e të shkatërruara.

- Është një thesar i vërtetë, - tha Pegi dhe filloi të ecte përgjatë korridoreve, ndërsa me gishtat elegantë prekte dorezat prej lëkure të sëndukëve *Saratoga* dhe dollapëve, duke picërruar sytë për të lexuar etiketat me emra dhe monogramet e venitura. Pastaj u kthye dhe ia nguli sytë ish-punonjëses.

- Ç'do të bëhet me këto objekte?

Punonjësja mblodhi supet.

- Besoj se do t'i hedhin në mbeturina, - u përgjigj ajo.

- Mos! - ia priti Pegi. - S'mund ta lejojmë këtë. Duhet t'i çojmë të gjitha në magazinën e muzeut.

- Të gjitha? - pyeti një nga punonjësit e muzeut.

- Po, - ia ktheu Pegi. - Nuk e shikoni? Këto valixhe janë po aq të rëndësishme, sa edhe një gërmim arkeologjik apo një koleksion me piktura të vjetra. Këtyre njerëzve nuk u është dhënë kurrë mundësia të rrëfejnë historitë e tyre jashtë mureve të një psikiatrie. Ne mund të përpiqemi të kuptojmë se ç'u ka ndodhur thjesht duke parë sendet e tyre personale. Po na jepet mundësia e rrallë të rikrijojmë jetët e tyre para se ata të vinin në Uillard, - tha dhe hodhi vështrimin nga Izi. - Nuk të duket emocionuese?

Izi u përpoq të buzëqeshte, por një peshë e madhe dhe e ftohtë i dukej sikur i peshonte mbi kraharor.

KAPITULLI 2



KLARA

Upper West Side, Nju Jork
Tetor 1929

Tetëmbëdhjetëvjeçarja Klara Elizabet Kartrajt qëndronte mbi tapetin e trashë persian jashtë zyrës së të atit, duke mbajtur frymën, e përkulur përpara, për të dëgjuar bisedën e prindërve përmes derës së gdhendur të lisit. Kur kish qenë më e vogël, dekori luksoz i vilës së madhe të prindërve të saj - salloni me panele, dyshemeja e shndritshme prej druri, portretet, pasqyrat vezulluese, kompleti i argjendtë i çajit mbi sëndukun prej druri qershie, - e bënte të ndihej si një princeshë brenda një kështjelle. Ndërsa tani, punimi i trashë i drurit dhe perdet e rënda prej damasku e bënin të ndihej si një e burgosur brenda një qelie dhe jo vetëm se nuk e kishin lejuar të dilte për tri javë rresht. Shtëpia i dukej si një muze me orendi të vjetra, me dekorime të dala mode, plot me ide të vjetruara dhe dogma arkaike. Kjo i kujtonte mauzoleun, vendin e fundit ku preheshin të vdekurit. Ajo nuk kish ndër mend të ish as njëra e as tjetra.

Psherëtiu dhe u mundua të qetësohej. E kish provuar edhe më parë të arratisej, por pa sukses. Aroma e drurit të kalbur e puros së të atit hynte që poshtë derës dhe përzihej me aromën prej limoni të lustrës së orendive. Kjo i kujtonte orët që kalonte në këtë vend me vëllanë e madh, Uilliamin, në pritje të "takimit"

me babanë, Henri Ërl Kartrajtin. Me aq sa i kujtohej, çdo të premte pas shkolle, pasi kishin bërë detyrat e shtëpisë dhe pas një shëtitjeje në park, prisnin jashtë zyrës së tij derisa vinte darka, pa bërë zhurmë, duke luajtur në heshtje me njëri-tjetrin që të mos e shqetësonin. Kur lirohej, i ati i fuste brenda për të mësuar se ç'kishin bërë në shkollë, për të ndrequr problemet e tyre të sjelljes sa nuk qe vonë dhe për t'u thënë se ç'priste prej tyre në këtë moshë. Ajo dhe Uilliami qëndronin në anën tjetër të tryezës së tij të stërmadhe të punës, me kokën lart dhe sytë drejt dhe dëgjonin pa lëvizur derisa babai ua bënte me kokë e ndizte puron. Kjo tregonte se ata mund të largoheshin.

Nëna e tyre, Ruthi, ua kish bërë të qartë se bisedat për disiplinën dhe ecurinë në shkollë ishin tejet të lodhshme për natyrën e saj delikate. Pasdite ajo merrte një sy gjumë, çdo ditë në të njëjtën orë, ndërsa i shoqi merrej me punën e mërzitshme të edukimit të fëmijëve. Kjo shpërfillje vazhdoi deri kur Klara filloi të bëhej zonjushë e të binte pre e mashtrimeve dhe e dëshirave të djemve të rinj, prandaj Henri këmbënguli që Ruthi të tregonte më tepër vëmendje ndaj saj. Ruthi, pa ndonjë dëshirë të madhe, ishte munduar, por, para tri javësh, kish vendosur ta merrte më seriozisht detyrën e saj si nënë. Klara pyeste veten se ç'do të thoshte Uilliami për faktin se prindërit e mbanin të izoluar si një kriminele të rëndomtë.

Teksa mendonte për vëllanë më të madh, sytë iu mbushën me lot dhe zemra iu çua peshë. Para një viti e gjysmë, trupi i Uilliamit ishte nxjerrë i pajetë nga ujërat e lumit Hadson. I kujtohej fytyra e të atit kur kishte marrë vesh lajmin, se si kërcëllinte nofullën dhe mollëzat e faqeve i ishin skuqur teksa mundohej të pranonte se djali i tij kishte vdekur. Megjithatë, nuk kishte nxjerrë asnjë pikë lot. Klarës i kujtohej se ishte munduar ta shtypte dëshirën e saj për t'i dhënë një grusht në kraharor dhe për t'ia përplasur në fytyrë që kishte qenë i gjithë faji i tij. Por ai s'do ta kishte besuar kurrë. Mendja e tij ishte një libër i mbyllur dhe i kyçur, brenda të cilit kish shkruar vetëm versionin e vet "se si duhej të funksiononte bota". Klara nuk i përqafoi nënën apo babanë, por vuajti në heshtje teksa ata shtireshin si prindër të hidhëruar. Tashmë, kishte vendosur të mos ishte ajo viktima e radhës e grushtit të hekurt të Henri Kartrajtit.

Po të mos i kalonte mbrëmjet e së shtunave në klubin "Koton", ku mund të ishte vetvetja, të qeshte e të kërcente me shokët e shoqet, me siguri që do të kish luajtur mendsh muaj më parë. Hera e fundit që kish dalë me shoqërinë, ishte para tri javësh. I dukej sikur kish kaluar një shekull.

E vogël, kish bërë të pamundurën për t'i kënaqur prindërit: në shkollë merrte veç nota të mira, dhomën e mbante të rregullt, nuk fuste asnjëherë hundët aty ku s'duhej dhe - më e rëndësishmja - nuk fliste kurrë mbrapa krahëve. Por, teksa rritej, kuptoi se prindërit e konsideronin atë dhe të vëllanë thjesht dy persona më shumë dhe askush nuk ua vinte veshin. Të rriturit e shtëpisë siguronin ushqim dhe strehë për fëmijët e tyre, asgjë më shumë. Gjatë dy viteve të fundit, që pas vdekjes së Uilliamit, Klara e kishte përherë e më të lehtë të gënjente, të thoshte se po shkonte në bibliotekë, kur në të vërtetë shkonte me shoqet për të parë shfaqjet e pasdites, filmat e Çarli Çaplinit ose në Parkun Qendror për të parë djemtë teksa luanin *Skee-Ball*[1] ose lojërat me qitje. Herën e parë që u kthye vonë në shtëpi, u habit kur nuk e gjeti të ëmën pranë derës, me duart të vendosura mbi kofshë, gati për të lajmëruar Henrin që t'i jepte dënimin e merituar. Në kokë i buçisnin zëri i trashë i Henrit dhe fjalët që ai lëshonte me tërbim: "Ti e ke vendin këtu, në shtëpi, të mësosh të gatuash dhe të kujdesesh për fëmijët e tu, jo t'i biesh kryq e tërthor qytetit! Ç'të thotë mendja, vallë? Ti je një Kartrajt, dreqi ta hajë! Bën mirë të sillesh si e tillë, ndryshe do të përfundosh rrugëve!" Por, pastaj e kuptoi që prindërit nuk e kishin marrë vesh fare që ajo kish dalë nga shtëpia. Në fillim, mendoi se ishin tepër të shqetësuar për Uilliamin, se mos i kish ndodhur gjë ose mos ai kish vendosur t'i shkëpuste një herë e mirë lidhjet me familjen pas zënkës me Henrin. Pyeste veten, a kish zemër e ëma apo ishte vërtet shumë e ndjeshme dhe për të ish e tepërt të kujdesej për dy fëmijë? Më pas, kuptoi se ndërkohë që i biri ishte zhdukur dhe e bija bënte ç't'i donte qejfi, Ruthi ftonte në shtëpi për çaj disa zonja, fliste me furnizuesit e ushqimeve dhe shitësit e luleve për festën e radhës, shfletonte revistat, pinte uiski që shitej kontrabandë dhe porosiste fustane të reja, bizhuteri dhe peliçe.

[1] Një lojë e ngjashme me bulingun.

Pasi u gjet trupi i Uilliamit, Ruthi nuk planifikoi më festa. Nisi të pinte aq shumë, sa çdo natë humbte ndjenjat. Thoshte se alkooli e qetësonte dhe Henri, që i kalonte ditët duke punuar dhe dilte nga studioja vetëm për të ngrënë apo për të fjetur, sigurohej që gruas së tij të brengosur të mos i mungonte asgjë. Klara e kishte të qartë se për prindërit e saj ishte një çlirim i madh të mos e kishin nëpër këmbë, për aq kohë sa ajo kthehej në shtëpi për drekë, në orën 17:30 fiks. Po të vonohej, do të mendonin se ose kish vdekur, ose ishte në prag të saj.

Çdo javë, për shtatë muaj rresht, u kish thurur prindërve të njëjtën gënjeshtër - do të shkonte në teatër me Xhulian, Marinë dhe Lilianën. Më pas, do ta kalonin natën në shtëpinë e Lilianës. Ruthi nuk e njihte thuajse fare Lilianën, por pranonte që Klara të shoqërohej me të dhe vajzat e tjera, duke u bazuar thjesht në faktin se nënat e tyre ishin pjesëtare të shoqatës së grave dhe frekuentonin kishën ku shkonte edhe Ruthi. Ajo mendonte se nëse prindërit i lejonin Xhulian dhe Marinë ta kalonin natën në shtëpinë e Lilianës, atëherë, nuk kishte asnjë problem.

Porse, në vend që të shkonin në kinema, vajzat mblidheshin në shtëpinë e Lilianës, i bënin flokët rrica-rrica dhe ndërronin me radhë fustanet e zbukuruara me rruaza e thekë. I përveshnin çorapet deri në gju për të treguar se nuk mbanin korse, vishnin këpucë me taka të larta e lidhëse dhe vinin gjerdanë të gjatë me perla, që u binin deri te gjoksi. Në orën 22:00, i dashuri i Lilianës vinte dhe i merrte me makinën e tij të tipit *Bentley*, e i çonte në qendër të qytetit, ndërsa prapa i ndiqte *Rolls Royce* i vëllait të saj, të cilin e mbushte me shokë.

Vendi i tyre i preferuar, klubi "Koton", në qoshe të rrugës 142 dhe shëtitores "Lenoks", ishte një vendtakim i famshëm në Harlemin Qendror[2], i cili njihej ndryshe edhe si sheshi i argëtimit të të pasurve. Në mjedisin e errët dhe plot tym të klubit, Klara dhe shoqet e saj pinin xhin kontrabandë, hanin qershi të mbuluara me çokollatë, pinin cigare, kërcenin çarleston dhe tango. Ato dëgjonin muzikë xhaz nga Luis Armstrong dhe dendeshin aq shumë me alkool, sa më pas mezi mbaheshin në këmbë.

Por, më e rëndësishmja, ishte se klubi "Koton" ishte vendi ku

[2] Lagje në Nju Jork.

Klara u njoh me Brunon. Ai kish lindur në Itali, ishte i biri i një këpucari dhe kish ardhur vetëm në Amerikë. Nuk ishte mësuar me shkëlqimin dhe salltanetet e klubeve të Nju Jorkut. Megjithatë, herën e parë kur ajo e pa, duke çarë rrugën mes turmës, i veshur me jelek të bardhë dhe kravatë, një pallto të zezë dhe frak, mendoi se ishte djali i duhur për të. Ai nuk ua vuri fare veshin vajzave që i kërkonin të kërcenin me të, nuk tregoi asnjë lloj interesi për havjarin apo tabakatë e mbushura me martini, por vazhdonte të ecte përmes sallës, me sytë që i ndrinin, të ngulitur te Klara. Në atë kohë, ajo po kërcente me vëllanë e Lilianës, Xhoin, i cili nuk reshtte së treguari për punën e tij në bursën e Nju Jorkut dhe mburrej se nuk i dridhej dora që t'ia plotësonte të gjitha qejfet një femre.

Kur pa Brunon që po vinte drejt tyre, Klarës nisi t'i rrihte zemra fort. Ai po vështronte gjithë inat, sikur dikush po i vinte vërdallë së dashurës së tij. E habitur se mos e kishte ngatërruar me dikë tjetër, ajo mblodhi të gjitha forcat, e gatshme për të mbrojtur Xhoin e gjorë e të dehur. Më pas, Xhoi u përkul për ta puthur, por ajo u kthye në anën tjetër, duke i shpëtuar duarve të tij të lagështa. Sa hap e mbyll sytë, Brunoja ndërhyri, e mori atë pa u ndier, duke e lënë Xhoin të shushatur dhe duke iu marrë këmbët në mes të sallës.

Brunoja e vështronte ngultas dhe serioz teksa kërcenin, dhe dora e tij e rëndë shtrëngonte shpinën e saj të vogël. Po ta shihje nga afër, ai dukej si Adonisi[3]: me flokë të zinj të lëpirë e të hedhur pas, lëkurë të butë e të bronztë. Ajo uli kokën e sikletosur nga vështrimi i tij.

- Shpresoj që ai të mos jetë i dashuri yt, - theu heshtjen Brunoja me një zë të trashë dhe dialektin që i bënte fjalët të tingëllonin të pasura dhe ekzotike.

Klara mohoi me kokë, duke vështruar njerëzit përreth. Liliana dhe Xhulia qëndronin te bari me gotat e xhinit në duar. Liliana vërtiste perlat mes gishtave, ndërsa Xhulia guduliste një djalë të pashëm me puplën e kamelies.

- Më fal që të mora në atë mënyrë nga partneri yt, - tha ai. - Kisha frikë se do të më refuzoje, po të të kërkoja të kërceje me mua. Mund të më falësh?

---

[3] Figurë e mitologjisë greke.

Ajo ngriti shikimin, pa sytë e tij të zinj dhe u përhumb e tëra. U kapërdi, pa mundur ta shkëpuste vështrimin prej tij. Papritur, buzëqeshi, duke dashur të dukej e kënaqur dhe moskokëçarëse.

- Besoj se po, - ia ktheu.

- Mendon se po tregohem shumë i drejtpërdrejtë? - e pyeti ai dhe buzëqeshi lehtë me buzët e trasha.

- Jo, - u përgjigj ajo. - Por unë...

Pikërisht atë çast, u shfaq Xhoi duke e rrokur Brunon nga supet. Ai u kthye dhe Xhoi, flakë i kuq e i shfytyruar, mblodhi grushtin.

- Ndal! - bërtiti Klara duke ngritur dorën.

Xhoi ngriu në vend dhe grushti i mbeti pezull në ajër.

- Nga e di që ky djalë nuk është një bandit? - e pyeti ai, duke spërkatur gjithandej me pështymë. - Më duket si një zhapik lëngaraq.

- Gjithçka është në rregull, - ia ktheu Klara. - Thjesht po kërcejmë.

- Je e sigurt? - e pyeti Xhoi.

- Sigurisht, - iu përgjigj ajo. - Flasim më vonë, kur të hamë darkë. Mirë?

Xhoi i hodhi edhe një shikim Brunos me sytë e tij të vegjël e të skuqur dhe më pas, uli grushtin. Brunoja buzëqeshi, zgjati dorën dhe u prezantua.

- Të premtoj se do ta sjell... - tha ai dhe e preku Klarën te kyçi i dorës me gishtat e ngrohtë. - Më fal, nuk ta di as emrin.

- Klara, - i tha ajo, duke ndier mollëzat t'i përvëloheshin.

- Premtoj se do t'ua kthej Klarën shokëve të saj si kokrra e mollës, - i tha ai Xhoit.

- Bën mirë të mos më bësh numra, - ia ktheu Xhoi. - Përndryshe, unë dhe shokët e mi do të të nxjerrim me shkelma në rrugë sa hap e mbyll sytë.

- Të betohem, - ia ktheu Brunoja. - Jam njeri i fjalës.

Më në fund, Xhoi shtrëngoi kravatën, i rroku dorën dhe u largua. Më pas, Brunoja iu afrua Klarës.

- Mund ta kem nderin e këtij vallëzimi, *bella* Klara? - e pyeti ai.

Ajo tundi kokën në shenjë pohimi dhe ai e tërhoqi pas vetes.

Rruazat mbi fustanin e saj u ngjeshën pas muskujve të fortë të kraharorit të tij, ndërsa palat e pantallonave të tij cekën gjunjët e saj të zbuluar. Kënga "Someone to watch me over" ishte drejt fundit, por befas Klara ndjeu nevojën të ulej. Gjunjët mezi e mbanin dhe ndiente një pështjellim. Kishte kërcyer me shumë meshkuj në klubin "Koton", disa i njihnin edhe të atin dhe shpresonin të shtinin në dorë pasurinë e saj, disa të tjerë kishin shfaqur interes për ta njohur më mirë, por asnjë prej tyre nuk e kishte bërë të ndihej në këtë mënyrë. Shtrëngoi fort dorën e tij, duke vrarë mendjen nëse ishte xhini apo aroma e kolonjës së tij që e kish trullosur.

- Je mirë? - e pyeti ai. - Do të marrësh pak ajër të pastër?

Ajo tundi kokën.

- Jam mirë, - u përgjigj. - Më duket se alkooli më ka trullosur pak, vetëm kaq.

- Nuk të lë të rrëzohesh, - i tha ai dhe zhyti kokën mes flokëve të saj. Fryma e tij e ngrohtë bëri që trupi t'i rrëqethej i tëri. Atë çast, kënga mbaroi dhe ai ndaloi së vallëzuari, e megjithatë, dukej se s'kish ndër mend ta lëshonte.

- Ke qejf të vish me mua dhe miqtë e mi për darkë? - e pyeti ajo, me një zë miklues. - Ne shkojmë gjithnjë për kafe pas...

- Me shumë kënaqësi, - ia ktheu ai ndërsa e kapi për mjekre dhe ia ngriti kokën lart. - Por si fillim duhet të bëj diçka, - tha dhe i ngjeshi buzët e tij te të sajat, duke e puthur aq fort, sa thuajse e kafshoi. Në fillim, ajo nuk donte, por më pas, ia ktheu puthjen, duke u shkrirë e tëra në krahët e tij. Zhurma e të qeshurave dhe e gotave që trokisnin, u shua dhe ajo dëgjonte vetëm rrahjet e zemrës së saj, që thuajse po i dilte nga kraharori. Sytë po i lëshonin shkëndija, ndërsa trupi po i digjej nga një dëshirë e zjarrtë. Kur u shkëputën, ai po e vështronte, pa frymë.

- E shikon? - i tha. - Ndonjëherë, më mirë të mos pyesësh.

Ajo pohoi me kokë, pa mundur të nxirrte asnjë fjalë.

Më vonë, në darkë, ata u ulën më vete, duke pirë kafe dhe duke ngrënë së bashku një copë kek me mollë. Liliana, Xhulia dhe pjesa tjetër e grupit, që ishin ulur në anën tjetër, bisedonin dhe qeshnin, por Klara dhe Brunoja dukej sikur nuk ishin fare me ta. Ai i tregoi për familjen në Itali dhe ëndrrat e tij për një jetë të suksesshme në

Amerikë. Edhe ajo i foli për veten dhe u habit që u shpreh me të më shumë se me askënd tjetër, përveç Uilliamit. I rrëfeu sa ishte zhgënjyer nga prindërit e saj, duke iu mbushur sytë me lot teksa fliste për vëllanë e saj të dashur e të ndjerë. Brunoja u zgjat te tavolina, i shtrëngoi dorën dhe i tha se i kuptonte shumë mirë problemet e vështira familjare. Mbi të gjitha, ai dëshironte të kishte një familje të tijën, një familje ku të gjithë pjesëtarët shkonin mirë me njëri-tjetrin, pavarësisht gjithçkaje. Edhe ajo donte të njëjtën gjë.

Në fund të mbrëmjes, ata nuk i shkëpusnin dot duart nga njëri-tjetri, ndërsa në fund të javës, e lanë të takoheshin në apartamentin e tij. Në fund të muajit, Brunoja ishte bërë pjesë e grupit. Madje, edhe vëllai i Lilianës, Xhoi, mendonte se ai ishte djalë për kokë të djalit.

Tani, jashtë zyrës së të atit, matanë derës së gdhendur prej dru lisi, Klara dëgjonte zërin e tij bariton, i cili gjëmonte si një tren që ecën ngadalë, nënën e saj që ankohej dhe rrufiste hundët, si dhe shkëmbimin e fjalëve plot mllef. Ata nuk po debatonin me njëri-tjetrin, por po flisnin për Klarën, për herë të parë të xhindosur, që ajo nuk po u bindej dhe s'po ndiqte planet e tyre.

Mbështeti dorën si për të mbrojtur pjesën e poshtme të barkut, duke përpëlitur sytë nga lotët që i rridhnin faqeve. Festa e fejesës do të bëhej të nesërmen mbrëma. Në të, s'do të mungonin fotografi, furnizuesi i ushqimeve dhe të gjithë miqtë e rëndësishëm të prindërve. Ortaku i biznesit të të atit, Riçard Gallageri, kish ftuar dymbëdhjetë mysafirë dhe po priste me padurim të prezantonte nusen e ardhshme të të birit. Ftesat ishin shpërndarë para dhjetë ditësh dhe vetëm disa persona kishin kthyer përgjigje negative. Xhejms Gallageri, njeriu me të cilin Klara duhej të martohej, kishte çuar për të pastruar dhe për të shkëlqyer tek argjendari unazën dykaratëshe të së ëmës. Kishte lënë porosi që t'i shtonin edhe katër diamante të tjera, për ta bërë më të çmuar. Ruthi kish zgjedhur fustanin e Klarës dhe kish pajtuar një parukier për ta rregulluar para festës. Gjithçka po shkonte ashtu siç e kishin planifikuar prindërit e saj. Të ftuarit do të vinin me idenë se do të festonin përvjetorin e Henrit dhe Ruthit. Para fillimit të mbrëmjes, ata do të mbeteshin të mahnitur kur të merrnin vesh për fejesën e Xhejmsit me Klarën.

Befas, era e keqe si vezë e prishur e ujit të ndenjur, ia bllokoi hundët Klarës, së cilës i erdhën zorrët në fyt. Kundërmimi vinte nga vazoja e luleve mbi tavolinën prej dru qershie. Ajo u largua nga dera, mbuloi me dorë hundën dhe gojën e po mundohej të qetësonte stomakun e trazuar. Po të qëndronte më gjatë në korridor, duke praktikuar fjalimin e saj, ose do t'i binte të fikët, ose do të villte. O tani, o kurrë!

Trokiti në derën e studios.

- Çfarë ka? - u dëgjua ulërima e të atit.

- Jam unë, - u përgjigj Klara dhe fjalët i ngecën në fyt. U kollit lehtë dhe më pas, vazhdoi: - Jam unë, Klara. Mund të hyj?

- Hyr! - dëgjoi zërin e tij nga brenda.

Kapi dorezën e derës, e uli dhe më pas, kuptoi se dorën tjetër po e mbante ende poshtë barkut. Ndjeu se mollëzat po i përflakeshin dhe duart i mblodhi grusht. E dinte se e ëma kishte kohë që nuk ia ndante sytë, madje, e kish vënë re se ishte zgjeruar te beli, e shikonte që kishte shumë oreks mëngjeseve dhe përveç këtyre, kish nisur të numëronte pecetat higjienike poshtë lavamanit të tualetit. Nëse Klara do të futej në studion e të atit me dorën mbi bark, e ëma do ta kuptonte menjëherë se frika e saj më e madhe ishte bërë realitet.

Klara mori frymë thellë dhe hapi derën.

E ëma, e ulur në një divan me trëndafila shumëngjyrësh pranë oxhakut me tulla, po bënte fresk me një erashkë me lule, kurse këmbët i kish rehatuar mbi një stol me jastëk. Si zakonisht, flokët e kuqërremtë i kish mbledhur sipas modës së fundit të shekullit XIX dhe fillimit të shekullit XX, topuz në majë të kokës. Për habinë e Klarës, e kish ngritur fundin e gjatë, që i shkonte gjer në tokë, duke nxjerrë në pah kyçet e zbehta të këmbëve, që dukeshin mbi çizmet me majë dhe me lidhëse. Ruthi mendonte se, pavarësisht gjithçkaje, një grua për së mbari duhej t'i mbante ngaherë të mbuluar krahët dhe këmbët. *Duhet të jetë shumë e mërzitur,* mendoi Klara.

Klara nuk ishte e sigurt se çfarë kish ndodhur, por kish filluar t'i urrente veshjet e stilit viktorian të së ëmës, modelet e saj demode të flokëve, karficat me gurë të latuar dhe unazat. Çdo stil tradicional dhe thënie e vjetër i sillte ndër mend sjelljen

e saj tepër të matur. Fëshfërima e palave të fundeve të Ruthit nëpër korridore dhe këpucët e rënda që kërcisnin në dysheme, mjaftonin për ta bërë Klarën të strukej.

Atë çast, Ruthi qëndronte në këmbë duke prekur fustanin, me korsenë që i nxirrte në pah belin e saj të hollë. Në mënyrë instinktive, Klara drejtoi shpatullat dhe futi barkun brenda, me shpresën se e ëma nuk do ta vinte re që nuk kishte vënë korse.

Klarën e kishin detyruar ta vishte korsenë e parë që në moshën gjashtëvjeçare, pasi e ëma i mati belin dhe vuri re se nuk e kishte shumë të hollë. Ruthi kish thënë se, po të mos merreshin menjëherë masa parandaluese, forma e trupit dhe shëndeti i Klarës ishin në rrezik dhe asnjë burrë me mend në kokë nuk do të martohej me një vajzë të rëndomtë, me belin sa një fuçi. Atë mbrëmje, e ëma i veshi një korse, të cilën mund ta hiqte vetëm nëse sëmurej apo kur bënte banjë. S'kish kaluar as një javë kur Klara i zgjidhi rripat në mes të natës, që të merrte një sy gjumë. Të nesërmen në mëngjes, kur Ruthi e gjeti korsenë përdhe, pranë shtratit të saj, e shkundi fort dhe e zgjoi nga gjumi i rëndë që po bënte për t'i dhënë një shuplakë të mirë fytyrës. Pas kësaj, çdo mbrëmje për dy javët në vijim, ajo ia lidhi kyçet e duarve me një shami mëndafshi, që të mos e lejonte të bënte prapësi të tjera. Teksa Klara rritej, një shërbyese me krahë të fuqishëm dhe muskulorë ia shtrëngonte gjithnjë e më shumë korsenë. Kur mbushi tetëmbëdhjetë vjeç, e kishte belin dyzet e tre centimetra, por gjithsesi, e ëma e qortonte duke i kujtuar vazhdimisht se në moshën e saj ajo e kishte dyzet centimetra, por harronte se Klara ishte pesë centimetra më e gjatë.

Tani, në studion e të atit, Klara po shihte ngultas nga e ëma. Ruthi do të tërbohej sikur të gjente byzylykët, fustanet me pupla dhe thekë, të fshehura në fund të dollapit të Klarës, të palosura brenda valixhes që ndodhej poshtë një kostumi të vjetër të leshtë. Si t'ia kish lexuar mendjen Klarës, ajo rrufiti hundët dhe hodhi vështrimin nga dritarja, duke mbledhur buzët. I ati ngriti vetullat, trokiti lehtë mbi tryezën e punës çakmakun e argjendtë dhe vendosi puron në gojë. Si zakonisht, kish veshur një kostum me vija dhe mustaqet i ishin përdredhur mbi buzën e sipërme.

- Çfarë ka? - e pyeti ai.

Klara lëshoi grushtet dhe i mblodhi duart përpara, duke bërë të pamundurën që të mos i dridheshin.

- Mund të flas me ty për diçka? - i tha, duke u sforcuar që zëri të mos i dridhej.

E ëma mërmëriti diçka nëpër dhëmbë dhe u afrua te dritarja, me fundin që i fëshfërinte. Hapi perden dhe bëri sikur sodiste përjashta.

Henri hoqi puron nga goja dhe tha:

- Nëse bëhet fjalë për mbrëmjen e nesërme, biseda mbaron këtu. Festa do të bëhet siç është planifikuar.

Klara me zor u kapërdi dhe iu bë një lëmsh në stomak.

- Sigurisht! - u përgjigj ajo. - Për çfarë duhet të jetë tjetër! U bënë vite që ti dhe nëna s'keni organizuar një festë për përvjetorin tuaj të martesës.

Pasi dëgjoi këtë, e ëma u largua menjëherë nga dritarja.

- Ti e di shumë mirë që do të organizojmë një festë, - i tha ajo. - E bëjmë për ty! Dhe Xhejmsin! Është hera e parë pas kaq muajsh që kam dëshirë të festoj!

Klara skërmiti dhëmbët duke i shtrembëruar buzët me shpresën që ajo të dukej si një buzëqeshje.

- E di, nënë, - i tha. - I vlerësoj shumë të gjitha mundimet e tua. I vlerësoj vërtet, por thjesht...

- E ke idenë sa me fat je që ke gjetur një burrë si Xhejmsi, i gatshëm të martohet me ty? - e pyeti Ruthi.

I gatshëm, mendoi Klara. *Sepse unë kam shumë të meta dhe asnjë burrë me mend në kokë nuk do të martohej me mua. Gjithsesi, ndoshta ke të drejtë, nënë. Xhejmsi nuk ka mend në kokë. Ai është një feminist i ndyrë dhe abuziv. Po ç'rëndësi ka kjo për ty, për aq kohë sa s'do të jem më nën përgjegjësinë tënde? Për aq kohë sa ai do të më ndajë nga Brunoja?*

Me mollëza dhe sy të përflakur, Klara bëri drejt tryezës së punës së të atit.

- Baba, - i tha, - nuk ndihem ende gati për t'u martuar. Veçanërisht me Xhejmsin.

Henri brofi në këmbë duke e shtypur puron pas tavllës së duhanit dhe gishtat e trashë u skuqën, teksa po e shtypte gjithnjë e më fort.

- Klara, - i tha. - E kemi diskutuar edhe më parë këtë temë. Unë dhe nëna jote ta kemi bërë të qartë si ndihemi...

- Po ndjenjat e mia s'kanë rëndësi? - e pyeti ajo, me zemrën që gati sa s'po i dilte nga kraharori. - Po ajo që dua unë, s'ka rëndësi?

- Ti je shumë e re për të ditur se çfarë do, - ia ktheu i ati.

- Jo, - u përgjigj Klara, duke e parë drejt e në sy. - Nuk jam e vogël. Jua kam thënë edhe më parë. Dua të vazhdoj universitetin. - Ishte justifikimi i vetëm që i erdhi ndër mend, për t'i bindur ta shtynin fejesën. Të paktën, tani për tani. Ajo donte të vazhdonte universitetin për t'u larguar nga prindërit, për të studiuar për sekretari ose ndoshta edhe për infermieri. Dëshironte të ecte vetë në jetë. Por tani, ëndrrat e saj po merrnin një rrjedhë tjetër. Për herë të parë në jetë, kuptoi se ç'do të thoshte të ndieje dashuri dhe përkujdesje. Nuk dëshironte gjë tjetër, veçse ta ndante jetën me Brunon dhe të krijonte familje me të. - Liliana do të shkojë në universitet, - u tha, e vetëdijshme se ky nuk ishte një argument shumë i fortë.

- Nuk më intereson aspak se ç'bëjnë shoqet e tua, - ia ktheu i ati, i skuqur në fytyrë.

- Nuk kemi ndër mend të paguajmë një mal me para, të cilat na ka rënë bretku për t'i fituar, për ta çuar vajzën tonë gjoja për të ndjekur arsimin e lartë, që ajo të fillojë duhanin, alkoolin dhe të mos lërë festë pa shkuar! - tha e ëma.

Klara përpëliti sytë dhe i shpëtoi një nënqeshje e dyshimtë. E dinte që e ëma i referohej këngës më të fundit që qarkullonte asokohe: "Ajo nuk pi, nuk lajkatohet, sepse nuk ka nisur ende të shkollohet". Pa dyshim që e ëma mendonte kështu.

- Nënë, vajzat nuk shkojnë në universitet për këto gjëra, - i tha.

- Gjithçka po e bën për atë djalin, Brunon, apo jo? - e pyeti ajo. - Ai emigranti që solle për darkë në shtëpi para disa javësh?

Klara ndjeu t'i ndizej fytyra.

- Nuk e di, nënë, - iu përgjigj. - Të jetë kjo arsyeja? Ndaj do që të martohem me Xhejmsin? Që të më ndash nga Brunoja?

Kujtimi i asaj nate të llahtarshme, kur solli Brunon në shtëpi për t'u njohur me prindërit, vërtitej në mendjen e Klarës dhe skenat ia linin vendin njëra-tjetrës, si fotot në makinerinë me monedha. Brunoja qëndronte te dera, i buzëqeshur, me flokët e

errët të lëpirë pas, duke nxjerrë në dritë fytyrën me nofullat katrore dhe duart i mbante në xhepat e xhaketës që kish marrë hua. Klara e falënderoi që kish ardhur dhe e puthi në faqe, duke nuhatur aromën e pastër të lëkurës së tij të butë, një përzierje e këndshme e kremit të rrojës "Barbasol" dhe sapunit "Lifebuoy". Ai kishte ardhur dhjetë minuta më herët, meqë e kishin paralajmëruar se Ruthi i kishte zët vonesat.

Klara, me zemrën që i fërgëllonte, ia nxori duart nga xhepat dhe i rregulloi kravatën. Duke u munduar të ruante qetësinë që ai të mos nervozohej, i tha të merrte frymë thellë. E kujtoi që t'i rrokte dorën të atit, pastaj e shoqëroi përmes hollit, në fund të korridorit, deri te dhoma e ndenjjes. Llambadarët në formë zambaku dhe pikturat e lanë gojëhapur dhe u habit pa masë që ajo jetonte në një shtëpi aq ekstravagante. I kish thënë se i ati punonte në bankë, pasi druhej se e vërteta do ta trembte. Henri Kartrajti ishte bashkëpronar i bankës "Swift", banka më e madhe në Manhatan, me degë në të gjitha qytezat e Nju Jorkut dhe në disa komunitete të largëta. Nëna e saj, Ruthi, ishte trashëgimtarja e vetme e dyqanit të madh të veshjeve "Brixh Bros".

Klara hapi dyert e fildishta që të çonin në dhomën e ndenjjes dhe e shoqëroi Brunon brenda. Prindërit po pinin çaj para darkës. E ëma ishte ulur pranë oxhakut, ndërsa i ati kish mbështetur njërin krah te buhari i mermertë i tij. Kur Brunoja dhe Klara hynë në dhomë, Henri ngriti shikimin, më pas mërmëriti diçka nëpër dhëmbë dhe i hodhi një sy orës së xhepit. Fillimisht, Ruthi u ngrit dhe në fytyrë iu lexua një buzëqeshje, por, kur pa xhaketën e Brunos që i binte e madhe dhe këpucët e ngrëna, u ul sërish.

Klara shtrëngoi nofullat dhe e shoqëroi Brunon tek i ati, me shpresën se ai do të mahnitej nga historia e tij, që kish ardhur vetëm në Amerikë, për të ndërtuar një jetë të re në tokën e lirisë. Në fund të fundit, i ati i Henrit kish bërë të njëjtën gjë në vitin 1871, duke marrë me vete nusen e tij të re nga Anglia në Amerikë. Në vend që të rrokte dorën e zgjatur të Brunos, ai i hodhi sërish një sy orës së xhepit, duke thënë se kish ardhur ora e darkës. Ruthi u ngrit në këmbë, gishtat delikatë i mbante në ajër, si për ta lejuar Brunon që t'ia prekte dorën. Ai ia shtrëngoi dorën dhe tundi kokën.

- Është kënaqësi që ju njoh, zonja Kartrajt, - tha.

Ruthi i dhuroi një buzëqeshje të thatë, më pas, kapi për krahu të shoqin dhe u nisën drejt dhomës së ngrënies. Klara i futi krahun Brunos dhe duke ia bërë me sy drejt tyre, u shkuan pas. Brunoja ngrysi vetullat dhe rrudhi ballin i pakënaqur. Më pas mori frymë thellë dhe e nxori ngadalë, ndërsa ajo i pëshpëriti në vesh "Të dua" dhe e puthi në faqe. Pa thënë asnjë fjalë, ata zunë vend në tavolinë: prindërit e saj në krye, ndërsa ajo dhe Brunoja larg njëri-tjetrit. Për të parë Brunon, asaj i duhej të shmangte një nga vazot qesharake të luleve, që e ëma këmbëngulte të ekspozonte nëpër shtëpi.

Klara pyeste veten nëse Ruthi e kish vendosur vazon në tavolinën e ngrënies për të mos e parë Henrin gjatë darkës. Ajo nuk e duronte dot kur ai rrufiste supën apo përtypej shumë shpejt. Henri hante me shije dhe babëzi, fuste ushqim pa pushim, pa mbaruar atë që kishte në gojë, fliste me gojën plot dhe merrte racionin e fundit të peshkut apo të mishit të pulës kur të tjerët nuk kishin filluar ende të hanin. Ai mbaronte gjithmonë i pari dhe kjo e mërziste pa masë Ruthin. Sjellja e keqe e të atit Klarës i dukej e ngjashme me mënyrën se si ai jetonte, merrte çfarë donte pa llogaritur personat që e rrethonin, çante gjithmonë përpara si të kishte të gjitha të drejtat për ta bërë këtë. Klara u çua në këmbë, hoqi lulet nga tavolina, i çoi në anën tjetër të dhomës dhe i vendosi mbi bufe. Ruthi e shikonte gojëhapur e pa thënë asnjë fjalë.

Teksa shërbyesja mbushte pjatat me supë, Ruthi nuk ia ndante sytë pjatës që kish përpara. Henri, ballërrudhur, ia kishte ngulur vështrimin Brunos dhe Klarës, teksa mundohej të mbante nën kontroll situatën. Klara u ul sërish në vendin e saj, në pritje që ai të niste bisedën. Kur shikimi iu kryqëzua me atë të të atit, ky i fundit, befas, i interesuar për të rregulluar pecetën në prehrin e tij, të cilën Ruthi e kujtonte gjithmonë që ta përdorte, uli sytë poshtë.

Klara kapi mbulesën e tavolinës dhe drejtoi trupin.

- Baba, - tha ajo, duke u munduar të dukej sa më e qeshur. - Brunoja s'ka mbushur as gjashtë muaj që ka filluar punë në kantierin detar dhe është ngritur në detyrë, në pozicionin e përgjegjësit.

Henri mërmëriti, kapi lugën, e mbushi dhe e futi në gojë.

- Faleminderit që më ftuat në shtëpinë tuaj! - u tha Brunoja. - U treguat shumë të sjellshëm që ia hapët dyert shokut të vajzës suaj.

Klara ia nguli sytë së ëmës, në pritje të një përgjigjeje. Teksa rritej, Ruthi ia kish përsëritur me mijëra herë se ajo i gjykonte njerëzit në radhë të parë nga mënyra se si silleshin. Ruthi ngaherë thoshte se mund të kuptoje shumë për jetën e një njeriu nga mënyra se si ai i përdorte fjalët "Të lutem" dhe "Faleminderit". Me sa dukej, sjellja kish rëndësi vetëm atëherë kur i shkonte për shtat Ruthit. Në fund të tryezës, ajo zhyti lugën në supë dhe ia nguli sytë pjatës, sikur të ngrënët të ishte gjëja më interesante që kish bërë ndonjëherë. Zakonisht, kur kishin mysafirë për darkë, Ruthit s'i mbyllej goja, jepte mendim për gjithçka, për veprat e artit, teatrin, për pajisjet më moderne elektrike e bënte pyetje deri në atë pikë sa bëhej e bezdisshme. Edhe pas vdekjes së Uilliamit, mundohej të mos e jepte veten para të ftuarve. Në fund të fundit, kjo gjë pritej prej saj.

- Nënë! - thirri Klara. - Gjithnjë ke thënë se nuk është e hijshme të shpërfillen të ftuarit.

- Oh, - ia priti Ruthi. - Më fal! - tha teksa uli lugën, fshiu buzët me pecetë dhe lëvizi në karrige. - Nuk e kuptova që mysafiri po më fliste mua, - tha dhe me vetullat përpjetë, e përqendroi vëmendjen te Brunoja. - Çfarë po thoshe, djalosh?

- Doja t'ju falënderoja që më ftuat në shtëpinë tuaj të bukur, - u përgjigj ai.

- Të lutem! - ia ktheu ajo. Më pas, pa thënë asnjë fjalë, mori sërish lugën dhe filloi të hante, ndërsa vëthët me perla i tundeshin rrëzë qafës së zbehtë.

Venat në qafën e Klarës u frynë gati në të shpërthyer. Pra, kështu na qenkësh puna! Ata do t'i hidhnin një sy Brunos dhe më pas, do të vendosnin. Mos ndoshta për shkak të veshjes së tij, punës, theksit dhe ngjyrës së errët të lëkurës? Ajo bashkoi duart mbi prehër, duke rrëmuar pëllëmbët me thonj.

Klara i kish thënë Brunos se babai i saj do të habitej kur të mësonte se sa shpejt i kish ngjitur shkallët e karrierës, edhe pse bëhej fjalë vetëm për portin e vendit. Ajo mendoi se i ati do

të habitej kur të mësonte se Brunoja kish kursyer mjaftueshëm para, sa për të marrë një apartament me qira. Ai po kursente gjithashtu për të bërë edhe ndonjë investim, me shpresën se do të hynte në tregun e bursës. I kish thënë se Henri do ta këshillonte me kënaqësi, do t'i jepte mendime dhe emrin e një investitori të besuar për ta orientuar në drejtimin e duhur. Tani, i vinte të hante veten me dhëmbë që ishte treguar aq budallaqe dhe e verbër. Ç'i tha mendja vallë, që e solli në shtëpi?

Mendimet e saj fluturonin sa andej-këtej, duke u munduar të gjente një mënyrë shpëtimi, për t'i dhënë fund sa më parë të ishte e mundur kësaj mbrëmjeje të tmerrshme. Bënte sikur po hante, por në stomak ndiente një pështjellim. Pyeste veten se çfarë ish duke menduar Brunoja. A e kuptonte ai shqetësimin e saj? A e dinte ai se nuk do ta kish ftuar kurrë në shtëpi, po ta dinte se prindërit do të reagonin ashtu? Apo ndoshta mendonte se gjithçka ishte e kurdisur? Ndiente që kraharori e qafa i ishin nxehur dhe faqet po i merrnin flakë. Befas, i ati filloi të fliste.

- Po mundohem të kuptoj diçka, - tha duke e parë Brunon për herë të parë në sy. Ndaloi së ngrëni, mbështeti njërin krah mbi tavolinë dhe me gishtin drejtuar nga ai vazhdoi: - Se mos harroj, si e ke mbiemrin?

- Moreti, zotëri, - iu përgjigj Brunoja. - Bruno Moreti. Më kanë vënë emrin e babait tim të ndjerë.

- Ëhë, - ia bëri Henri, duke ngritur kokën. - Dhe me çfarë merrej yt atë në Itali?

- Ishte këpucar. Shumë i zoti, zotëri.

- E kuptoj, - i tha Henri. - Pra, yt atë ishte këpucar dhe ti punon në kantierin detar? Në portin "Sauth Strit"?

- Po, zotëri, - iu përgjigj Brunoja, me një buzëqeshje të lehtë që dukej sikur luante në buzët e tij.

Klara ndjeu zemrën t'i rrihte pak më ngadalë dhe u mbush thellë me frymë, për herë të parë që kur Brunoja shkeli në pragun e tyre. Babai po fliste me të. Ky ishte hapi i parë.

- Sa fiton me punën që bën në kantier? - e pyeti Henri.

- Baba! - u dëgjua zëri i Klarës. - Ke thënë ngaherë se nuk është e hijshme t'i pyesësh njerëzit për të ardhurat e tyre personale.

Henri e vështroi Klarën dhe ngrysi vetullat.

- Ma do mendja se Brunoja ka ardhur sepse i intereson ime bijë, - ia ktheu ai. - Në këtë rast, kam të drejtë ta pyes për çfarë të dua.

- S'ka problem, - ia ktheu Brunoja Klarës. Ai buzëqeshi dhe e përqendroi gjithë vëmendjen te Henri. - Fitoj mjaftueshëm sa të kem një apartament timin, zoti Kartrajt. Dhe tani jam ngritur në detyrë në postin e përgjegjësit.

- Ku e paske këtë apartament? - e pyeti Henri.

- Në rrugën "Mëllberi", zotëri, - ia ktheu djaloshi.

- Në lagjen italiane?

- Po, zotëri.

Henri mërmëriti diçka nëpër dhëmbë dhe më pas fërkoi me dorë mustaqet.

- Ime bijë është rritur me tërë të mirat, - vazhdoi më pas. - Mendon vërtet se mund të kujdesesh ashtu si duhet për të, me pagën e një dokeri?

- Ndoshta ende jo, zotëri, - ia ktheu Brunoja, - por po punoj shumë për t'u ngritur...

- Po mundohesh të ecësh përpara? Dëshiron të bëhesh këpucar si yt atë? Ime bijë s'mund të jetojë përgjithmonë me lëmoshën time. Shpresoj të mos e kesh fjetur mendjen nga kjo anë.

Klara e shihte Brunon me habi, ndërsa zemra i rrihte si kudhër në kraharor. Brunoja uli kokën dhe ia nguli sytë tavolinës, ndërsa tëmthat i rrihnin pa pushim. Për një çast e hoqi shikimin dhe pa e humbur besimin, ngriti kokën, e pa drejt e në sy babanë e saj dhe i tha:

- Me gjithë respektin që kam për ju, zotëri, vajza juaj më ka thënë se, para se të futeshit në biznesin bankar, keni shitur këpucë për të siguruar bukën e gojës. Ka shumë mundësi të keni shitur këpucët, për të cilat im atë është shumë i famshëm. Ju thotë gjë emri Salvatore Moreti?

Për habinë e Klarës, i ati u zverdh i tëri. U mbështet në karrige dhe qëroi fytin.

- S'ma kanë zënë veshët kurrë këtë emër.

- Mos ndoshta sepse atje ku punonit ju, shisnin vetëm këpucë me çmime të lira? - e pyeti Brunoja. - Këpucët e tim eti shiteshin në butikët më të shtrenjtë.

Klara kafshoi buzën dhe po mundohej të mbante të qeshurën. Nuk kish parë askënd që ta acaronte të atin ashtu. Por zbavitja e saj nuk zgjati shumë. Duhej ta dinte mirë se asnjë nuk mund ta vinte në siklet Henri Kartrajtin dhe t'ia hidhte pa u lagur.

- Nëse yt atë paska qenë një stilist i famshëm këpucësh, - ia priti Henri, - atëherë, ç'kërkon ti këtu, në Amerikë, duke punuar në dok për të nxjerrë bukën e gojës?

Brunoja mbodhi buzët dhe u skuq i tëri. Më pas, pastroi zërin dhe ia ktheu:

- Im atë vdiq vitin e shkuar. Xhaxhai dhe vëllai im më i madh, morën në zotërim biznesin. Për fat të keq, shprehja "biznesi dhe familja nuk duhet të përzihen bashkë" është më se e vërtetë. Nuk shkoja mirë me tim vëlla. Për të mos prishur qetësinë e familjes, u largova. Përveç kësaj, ëndrra ime ka qenë gjithmonë të jetoja në Amerikë. Erdha këtu për të provuar veten. E di që mund t'ia dal mbanë edhe i vetëm, sepse jam i fortë dhe i vendosur si im atë.

Henri u mbështet në karrige, me krahët e kryqëzuar mbi kraharorin e tij të gjerë.

- E po, - ia ktheu ai, - mendoj se fillimisht duhet t'ia vërtetosh vetes këtë, para se të vish këtu dhe të ma vërtetosh mua. Deri më tani, s'më ke lënë asnjë lloj mbrese.

Klara lëshoi lugën në pjatë dhe argjendi i rëndë vringëlloi kur u përplas pas porcelanit me buzë floriri. Shtyu karrigen dhe u ngrit në këmbë.

- Më fal, Bruno! - i tha. - Më fal që të bëra të përjetoje këtë përvojë. S'ma merrte mendja që prindërit e mi ishin kaq mendjengushtë. Po ta dija, nuk do të të kisha prezantuar kurrë me ta. Më mirë ta kishim shijuar darkën në apartamentin tënd, siç bëjmë zakonisht të premteve.

Ruthi u mek dhe ngjyra e fytyrës i iku fare. Njërën dorë e mbështeti te fyti, kurse buzët i lëviznin pa pushim, si peshku që jep shpirt.

- S'ka gjë, - ia ktheu Brunoja. - I kuptoj. Yt atë është i shqetësuar...

- Jo, - ia preu fjalën Klara. - Më beso, është tepër vonë për mirëkuptime. Eja të ikim, të lutem!

Brunoja u ngrit në këmbë dhe Klara i ra rrotull tavolinës

për ta kapur për dore. Pa e hedhur vështrimin pas, ajo u largua bashkë me të nga dhoma e ngrënies. Prapa tyre, Henri bërtiste dhe mallkonte, i thoshte të kthehej në çast, por Klara nuk ia vuri veshin.

Kjo kish ndodhur thuajse para një muaji. Tri ditë më pas, prindërit i thanë për martesën e ujdisur me mblesëri me Xhejmsin. Që prej asaj dite, atë s'e kishin lejuar të dilte më nga shtëpia. S'e dinte nëse Brunoja kishte ardhur ta kërkonte, sepse nuk e kishin lejuar ta hapte derën apo të përgjigjej në telefon. Madje, edhe shërbyesen e kishin udhëzuar të mos i tregonte se kush vinte për vizitë. Tani, në studio, e ëma e vështronte ngultas.

- Të lutem, tregohu më e respektuar ndaj meje, - i tha Ruthi. - Ti e di që s'dua gjë tjetër, veçse më të mirën për ty. Dua të martohesh me Xhejmsin, sepse është njeri i mirë.

- Nuk është ashtu. Ai është...

- Ai do të kujdeset për ty, do të të sigurojë ushqim dhe veshje. Do të jetoni në një shtëpi të bukur, - i tha Ruthi. - Do të të ofrojë jetën që je mësuar të bësh.

- Nënë, ti mund të mos e besosh, - i tha Klara, pa e fshehur dot neverinë, - por jo të gjithë njerëzit martohen për para. Disa martohen edhe për dashuri.

- Mos i fol nënës me atë gjuhë! - i tha Henri, me nofullën që i dridhej nga nervat.

Por tashmë ishte tepër vonë. Diçka kish marrë të tatëpjetën në kokën e Klarës. Kur fillonte të shfrynte gjithë ç'kish grumbulluar, ajo nuk dinte të ndalej. Dukej se vitet e zhgënjimit dhe të zemërimit po bënin punën e tyre.

- Vetëm kjo të intereson, apo jo? - i tha së ëmës. - Preferon të kesh ca bizhuteri dhe një shtëpi të bukur, para një familjeje të bashkuar e të lumtur.

- S'është e vërtetë! - ia ktheu Ruthi e lënduar. - Si mund të tregohesh kaq e keqe dhe të më lëndosh kështu, kur e di se çfarë kam kaluar? Yt vëlla s'do të më kish folur kurrë në këtë mënyrë! S'është çudi që na la. Ndoshta kish frikë ta ndante biznesin me ty.

- Ai nuk na la për fajin tim, - i tha Klara. - Na la sepse babai

e pushoi nga puna dhe ti nuk e mbështete. Më vjen keq, por ndonjëherë mendoj se je gati të shkelësh mbi trupin e tët biri vetëm për të marrë një dollar në rrugë.

Henri po i vinte rrotull tryezës, me duart e mbledhura grusht.

- Kërko falje, vajzë e mbarë! - i tha ai me buzët që i dridheshin. - Në shtator do të martohesh me Xhejmsin dhe pikë!

Fjalët e tij i ranë si një goditje e fortë në kokë, si një gjëmim i fuqishëm, si përplasja e një dere. Për vite të tëra, kishte bërë sehir, i kish lejuar t'i drejtonin jetën, t'i tregonin çfarë të vishte e çfarë kursesh të ndiqte në shkollë. E ëma e kish urdhëruar shërbyesen t'i kontrollonte dhomën çdo javë, për t'u siguruar që nuk mbante cigare apo pije alkoolike. Henri kish hequr nga biblioteka librat "e papërshtatshëm" dhe nuk e kish lejuar të vazhdonte kursin e pianos, sepse e konsideronte të pahijshëm. Ai i diktonte si t'i shpenzonte paratë e xhepit dhe ia kthente mbrapsht të gjitha veshjet që nuk i pëlqenin. Klara nuk ishte e sigurt nëse po i lindte instinkti atëror apo diçka tjetër, por i kishte ardhur në majë të hundës.

- Pse? - bërtiti ajo. - Pse doni të më martoni me zor? Apo se familja e Xhejmsit është e pasur dhe kështu s'do t'ju duhet të më mbani më me para? Apo doni të siguroni biznesin, të siguroheni që i ati i Xhejmsit do të mbetet partneri juaj?

Henri e kapi fort te supet dhe e shkundi, aq sa gishtat e tij të trashë iu ngulën në mish.

- S'mund të më flasësh me këtë gjuhë! - i tha me sytë që i regëtinin gjithë egërsi. Klara e kuptoi se ai po luftonte me veten, që të mos e flakte të bijën në qoshen tjetër të dhomës.

Atë çast, hodhi vështrimin nga e ëma.

- Si mund të rrish aty, të bësh sehir dhe ta lejosh këtë njeri të sillet kështu me mua? - i tha ajo. - Si mund të zgjedhësh tët shoq para fëmijëve të tu? E di që edhe me Uilliamin kështu u soll. E di që e zhdëpi në dru të birin dhe ti nuk lëvize as gishtin!

- Mos guxo ta përziesh Uilliamin me këtë punë! - i tha e ëma.

- Pse jo? - ia ktheu Klara. - Lejove që babai ta shkatërronte atë, pse jo edhe mua?

Me kyçin e hollë të dorës, Ruthi preku ballin dhe u plandos në divan. Henri e lëshoi Klarën dhe vrapoi me të katra tek e shoqja, duke u gjunjëzuar pranë saj.

- Shiko ç'bëre! - tha ai, duke i hedhur Klarës një vështrim qortues. - E bërë nënën të qajë!

Klara ua kish ngulur sytë prindërve, teksa vitet e zemërimit të ndrydhur po i gëlonin në kraharor.

- Uilliami bëri gjithçka për ty, - tha Klara. - Punoi ditë e natë përkrah teje, për vite të tëra. Hoqi dorë nga gjithçka vetëm për të vërtetuar se kush ishte. Por nuk mjaftoi, apo jo? Nuk ia dhe kurrë miratimin tënd, sepse kjo do të thoshte t'i jepje atë që meritonte!

Pas këtyre fjalëve, i ati u ngrit në këmbë, i ra dhomës përqark dhe e fshikulloi Klarën me një shuplakë fytyrës. Ajo gati sa nuk humbi ekuilibrin, por gjeti një vend ku të mbështetej dhe mes lotëve që i shkonin çurg, vendosi dorën mbi faqen që i përcëllonte.

- Çfarë bëri ai? - iu hakërrye ajo, duke mos ia ndarë sytë të atit. - Çfarë gjëje të tmerrshme bëri ai, që ti të mos e doje më?

- Po të paralajmëroj, - i tha ai. - Edhe një fjalë tjetër dhe unë...

- Po, tamam! - ia ktheu ajo, me lotët e nxehtë që i rridhnin faqeve.

- Mendoje se ishte prona jote, pasi punonte për ty. E trajtoje si skllav, ndërsa ti krimbeshe në para. Ai nuk duroi dot më dhe vendosi të mbrohej. Por ti s'mund ta lejoje një gjë të tillë, ndaj e flake në rrugë! - dhe më pas iu kthye së ëmës: - Dhe ti e lejove që ta bënte këtë! Nuk kërkove kurrë të dëgjoje versionin e Uilliamit. Nuk e vure ujin në zjarr të mësoje nëse ai kishte ndonjë vend ku të fuste kokën, nëse kishte për të ngrënë apo jo!

- Mos fol më! - ulëriti Henri. - Para se të pendohesh!

- Nuk pendohem për asgjë, - ia ktheu Klara. - E vetmja gjë për të cilën pendohem, është që nuk e kam kuptuar më parë të vërtetën.

Henri nxitoi drejt tryezës, kapi receptorin e telefonit dhe formoi një numër. Me sytë ngulur tek e shoqja që qante, flakë i kuq në fytyrë dhe me nofullën që i dridhej, priste që nga ana tjetër e telefonit

dikush të përgjigjej. Drita e llambadarit ndriçonte bulëzat e djersës mbi ballin e tij. Klara bëri të largohej. Po të dilte nga ajo derë, do të mbetej pa asnjë kacidhe. Po të qëndronte, do të ndihej si e zënë në kurth. Nuk u tha asnjë fjalë më shumë dhe rroku dorezën e derës.

- Po, toger, - tha i ati në telefon. - Jam Henri Kartrajti. Dua që të dërgosh këtu dikë, urgjent. Druaj se po përballemi me një situatë të vështirë, - tha ndërsa Klara ndaloi në derë dhe po priste të dëgjonte se ç'do të thoshte i ati më tej. - Bëhet fjalë për time bijë, Klarën. Mendojmë se është futur në telashe.

Klara e hapi me forcë derën dhe doli me vrap nga dhoma.

KAPITULLI 3



Izi

Gjimnazi "Lejkshor"

Izi e kish hedhur çantën e shpinës mbi njërën shpatull, gishtin e madh të dorës e kish përdredhur pas rripit të trashë dhe po përpiqej të gjente klasën e vitit të katërt. Korridoret e shkollës së re ishin plot me nxënës, disa prej të cilëve me kufje në vesh nxitonin drejt rafteve të tyre duke qeshur e biseduar me shokët e shoqet. Si në të gjitha shkollat, në korridore ndihej një erë e çuditshme, një përzierje djerse, çamçakëzi dhe ashkla lapsash. Gjimnazi "Lejkshor" ishte një nga shkollat më të vogla ku ajo kish studiuar, me vetëm 765 nxënës nga viti i parë deri në të katërtin. Vriste mendjen nëse në këtë shkollë të vogël do ta kishte më të lehtë apo më të vështirë të përshtatej.

Atë mëngjes, kish veshur një bluzë të zezë me mëngë të gjata, xhinse të shkurtra dhe atlete të zeza. Vuri re se thuajse të gjitha vajzat kishin veshur xhinse të grisura, taka, minifunde apo çizme të markës "Doc Marten". U hodhi një sy formularëve që mbante në dorë dhe në stomak iu mblodh një lëmsh. Dokumentet me emrin dhe të dhënat e saj duhej t'ia dorëzonte mësueses kujdestare apo infermieres së shkollës? Apo mos ndoshta formulari me emrat dhe numrat e prindërve kujdestarë duhej të dorëzohej tek infermieria e shkollës? Duhej

t'ia dorëzonte formularin bashkë me orarin e klasës mësueses apo duhej ta mbante vetë? E kish harruar se ç'duhej të bënte.

Më në fund, në një derë pa të shkruar "Zoti Hadson" dhe vazhdoi drejt, duke u përpjekur të mos përplasej me askënd. Atë çast, dikush bërtiti dhe dy djem vrapuan mes turmës, njëri me një bluzë me stampën e grupit muzikor "The Doors", e tjetri flokëkuq e me tela në dhëmbë. Flokëkuqi u përplas me të e thuajse e ngjeshi pas rafteve. Nga goditja, u rrotullua rreth vetes dhe formularët e të dhënave i ranë nga duart, flokët i mbuluan fytyrën dhe çanta e shpinës i rrëshqiti nga supet. Flokëkuqi qeshi, i kërkoi falje dhe u largua me nxitim. Ajo rregulloi flokët dhe filloi të kërkonte në dyshemenë me pllaka formularët që ishin hapërdarë, grisur dhe zhubravitur poshtë atleteve, sandaleve dhe takave.

Më në fund, mes turmës i zuri syri një hapësirë boshe. Shkoi drejt një grupi dhe u ul në gjunjë për të kapur dokumentet mes këmbëve që lëviznin me nxitim, duke u përpjekur të mos e shkelnin. Zgjati dorën të kapte formularin e fundit, por dikush ia rrëmbeu nga duart. Ajo u ngrit, gati për ta ndjekur.

- Ej! - thirri.

- Po mundohesha të të ndihmoja, - ia ktheu një djalë, i cili i zgjati letrën. Sytë e tij bojë qielli kishin një nuancë thuajse të argjendtë dhe flokët i kishte të zinj si korbi.

- Faleminderit! - i tha, teksa ndiente faqet t'i përflakeshin.

- S'ka gjë, - ia ktheu ai duke buzëqeshur dhe nuk po e lëshonte dorën e së dashurës, edhe pse ajo vazhdonte të ecte përpara. Në çast, ajo ndaloi dhe hodhi një vështrim pas, për të parë se ç'po bënte ai. Flokët i kishte të gjatë e të verdhë dhe këmbët të bukura e të nxira nga dielli. Dukej seksi, e bukur dhe plot vetbesim, tipi i vajzës që Izi nuk do të ishte kurrë. E dashura e Korbit i hodhi Izit një vështrim shpërfillës dhe më pas, ia tërhoqi atij dorën fort, duke e nxitur të ecte përpara. Ai mblodhi supet dhe u zhduk mes turmës.

Izi nisi t'i shtronte dokumentet e zhubrosura me gishta, duke u përpjekur të mos ndotej me bojën e tyre. Gjeti atë që i duhej, ndërsa të tjerat i futi në çantën e shpinës dhe ndoqi nxënësit e tjerë për në klasë. Nëpër muret e klasës ishin vendosur kafshë të

balsamosura: kastorë, lepuj, një dhelpër, mi uji, një sorrë dhe një fazan. Kavanozat e mbushur me embrione derrash qëndronin rreshtuar në raftet mbi dritare, dhe një erë e lehtë metanali kishte mbushur ajrin. Zoti Hadson ishte ulur në tryezën e tij dhe po lexonte një libër, ndërsa nxënësit flisnin e qeshnin, të ulur në tavolina, kurse karriget i kishin kthyer mbrapsht. Një grup fëmijësh me flokë të zinj, rroba të errëta, tatuazhe dhe pirsing qëndronin në fund të klasës. Djemtë që pak më parë u përplasën me Izin, po hidhnin nga dritarja tullumbace me ujë. Një grup atletësh dhe nxitëse tifozësh ishin ulur pranë dritareve, të kapur për krahu.

Izi kërcëlliu dhëmbët dhe iu afrua tryezës së zotit Hadson, ndërsa stomakun e ndiente të trazuar. Nuk po e kuptonte pse ndihej aq nervoze. Edhe më parë i kish rastisur të ishte një nxënëse e re. Katër herë, në fakt. Pas burgosjes të së ëmës, u shpërngul në një qytet tjetër për të jetuar me gjyshen, ku u detyrua të niste gjithçka nga e para, në një shkollë të re. Tre vjet më vonë, pasi gjyshja vdiq, Izin e dërguan në familje të ndryshme kujdestare dhe për pasojë, u detyrua të ndryshonte shkollat që në klasë të pestë. Dy vjet pas kësaj, babai i saj kujdestar, pas një zënke të fortë, e shtroi të shoqen në spital. Atë mbrëmje, Izin e çuan në një familje tjetër kujdestare. Të nesërmen, u detyrua ta fillonte klasën e shtatë në një shkollë të re. Kur prindërit e dytë kujdestarë u transferuan në një shtet tjetër, edhe ajo u detyrua të shpërngulej. Po fillonte vitin e parë të gjimnazit, por këtë herë gjendej në një familje me një nënë të alkoolizuar. Për tre vjet radhazi, Izi gatuante dhe kujdesej që fëmijët e tjerë të shkonin të pastër e të rregullt në shkollë. Një ditë para se ajo të përfundonte vitin e parë të gjimnazit, nëna kujdestare, e cila po ngiste minifurgonin e familjes, mori drejt liqenit dhe u mbyt. Një javë më pas, Izin e çuan në familjen e Pegit dhe Herrit. Tashmë, ishte mësuar me të qenët e sapoardhur në një mjedis të ri.

Por këtë vit, për një sërë arsyesh, gjërat ishin ndryshe. Përshtatja do të ishte më e vështirë se zakonisht, sepse shumica e nxënësve të vitit të katërt kishin qenë bashkë që në vit të parë. Të paktën ditën e parë të shkollës që do të vazhdonte më pas,

do të ishte fillestare si gjithë të tjerët. Të ishe nxënëse e re në vit të katërt, ishte si të shkoje pa ftuar në një festë.

Ajo dorëzoi formularin, në pritje që zoti Hadson ta shikonte dhe ta merrte. Ndjeu se nxënësit e tjerë po e shikonin gjithë kërshëri, i binin lehtë me bërryl njëri-tjetrit, tregonin me gisht drejt saj dhe e vështronin të habitur. Mësuesi kish ulur kokën dhe po lexonte librin. Pak nga pak, të qeshurat dhe bisedat filluan të shuheshin.

- Ej, çantë e lezetshme, - u dëgjua një zë djali. - Do të shkosh në ekskursion?

Të gjithë ia plasën së qeshurës. Izi ndjeu fytyrën t'i përskuqej. Ç'të keqe kishte çanta e saj e shpinës? Ndërkaq, qëroi fytin që të tërhiqte vëmendjen e zotit Hadson. Befas, dikush e goditi me një prezervativ në kokë, që më pas ra përtokë. Ajo hodhi sytë nga shokët e rinj të klasës. Një grup vajzash po qeshnin nën zë dhe kthyen kokat nga ana tjetër. Njëra prej tyre ishte e dashura e Korbit. Ky i fundit po e shihte me vëmendje dhe nuk po ia ndante sytë. Çfarë kishte në sytë e tij, mospërfillje apo keqardhje? Zor se mund ta dalloje. Izi la mbi tryezë të dhënat, ngriti prezervativin nga toka dhe ia dha mësuesit. Më në fund, ai ngriti sytë.

- Më duket se kjo është për ju, - i tha Izi dhe të gjithë qeshën.

- Po tallesh? - e pyeti zoti Hadson duke rrudhur ballin.

- Jo, - ia ktheu Izi. - Unë po qëndroja këtu për t'ju dorëzuar dokumentet dhe dikush e hodhi këtë drejt jush, por gabimisht, më goditi mua.

Mësuesi ia rrëmbeu prezervativin, e hodhi në koshin e mbeturinave dhe u ngrit në këmbë.

- Më dëgjoni të gjithë me kujdes! - iu drejtua nxënësve. - Uluni nëpër vendet tuaja, - tha dhe i mori dokumentin Izit, e lexoi e më pas iu drejtua klasës: - Kjo është Izabela Stoun. Urojini mirëseardhjen, ju lutem! - dhe i ktheu sytë nga Izi. - Ulu ku të duash, - i tha.

Izi i hodhi një vështrim të shpejtë klasës për të gjetur një vend të lirë. E vetmja bankë e lirë ishte në qoshe, në fund të klasës. E hoqi çantën e shpinës nga supet dhe u nis drejt dritareve, me qëllim që të ecte anash bankave dhe jo në mes. Më pas, kuptoi se për të shkuar te banka bosh, duhej të kalonte pranë Korbit dhe

së dashurës së tij. Për një çast, mendoi të kthehej dhe të kalonte nga ana tjetër, por do të binte shumë në sy, ndaj vazhdoi aty ku ishte. Kur arriti në gjysmë të hapësirës mes bankave, kaloi pranë tyre. Ndërkohë, një nga djemtë i bllokoi rrugën duke mbështetur këmbën në parvazin e dritares.

- Më fal! - i tha ajo dhe buzëqeshi me zor.

- Si quheshe ti? - e pyeti djaloshi. Ai ishte i pashëm dhe lëkurën e kishte të pastër e të trashë, ndërsa balluket bionde i kish hedhur mënjanë, mbi sytë blu.

- Izabela, - ia ktheu ajo, duke u munduar të dukej sa më miqësore. - Por të gjithë më thërrasin Izi.

- Izi? - ia ktheu djaloshi. - Si Izi Popi?

- Jo, - i tha Izi. - Ai është Igi Pop.

- Anderson! - u dëgjua zëri i mësuesit nga fillimi i klasës. - Kështu ke ndër mend ta fillosh këtë vit shkollor?

- Thjesht po prezantohesha, - ia ktheu djaloshi. - Po i uroja mirëseardhjen Izi Popit, siç na thatë ju.

Të gjithë ia plasën gazit. Izi ndjeu qafën dhe kraharorin t'i ndizeshin flakë.

- Mos u sill si idiot, Luk, - tha dikush pas kurrizit të saj.

Izi u kthye të shihte se kush foli. Ishte Korbi.

- Lëre të kalojë, - i tha Lukës, ndërsa e dashura e goditi në krah duke e parë vëngër, por ai e shpërfilli.

Luka uli këmbën dhe i shkeli syrin Izit.

- Nëse ke nevojë për dikë që të të njohë me vendin, - i tha ai duke u ngërdheshur, - mua më ke në dispozicion.

- Faleminderit! - iu përgjigj Izi që po shkonte drejt bankës së saj.

Fillimi më duket i mbarë, mendoi ajo, teksa ulej. *Dhe s'kam as pesë minuta që kam hyrë.*

Gjatë apelit, Izi mësoi se Korbi e kishte emrin Etan Blek dhe e dashura e tij quhej Shenon Mekenzi. Izi i studioi me vëmendje nxënësit e tjerë, ndërsa zoti Hadsën fliste për mbledhësit e fondeve, komitetet e ballos së fundvitit dhe zgjedhjet nëpër klasa. Njëra nga vajzat që ishte ulur pranë Shenonit, Kristali, i hodhi Izit një shikim, më pas, u zgjat dhe i pëshpëriti Shenonit diçka në vesh. Ato kthyen kokat pas dhe nisën të qeshnin. Kur një vajzë tjetër, Nikola - nëse Izi ia mbante mend mirë emrin - e pa Shenonin

gjithë kureshtje, kjo e fundit i pëshpëriti diçka në vesh. Të tria i hodhën sërish sytë nga Izi dhe u zgërdhinë sikur po kënaqeshin duke treguar anekdota.

Izi nguli thonjtë në pëllëmbët e duarve, për të mposhtur dëshirën që t'i shante mbarë e prapë. Në çdo shkollë kishte gjithmonë një grup, një klikë vajzash të liga, që ua bënin jetën ferr vajzave të tjera. Nuk donte shumë mend për të kuptuar se kush ishin vajzat e liga në këtë shkollë. Ajo e dinte se gjëja më e mirë që mund të bënte, ishte t'i shpërfillte. Shpresonte që ato të mos e merrnin vesh se nëna e saj qëndronte në një burg të sigurisë së lartë, për vrasjen e të shoqit. Nuk do ta kishte të lehtë në atë klasë të vogël. Sakaq, një kujtim i regëtiu në mendje: dy vajza në shkollën e saj të fundit, e thërrisnin "psikopate" nëpër korridore dhe e pyesnin nëse e kishte ajo armën e së ëmës. Duke u përmbajtur që të mos ua nxirrte sytë vendit, kish kafshuar buzën fort dhe thuajse kish ndier shijen e gjakut t'i rridhte në gojë.

Ndërkaq, tërhoqi mëngët, për t'u siguruar që të arrinin deri te kyçi i dorës. Vragat në parakrah po i zbeheshin dhe ishte betuar të mos e priste më veten, çfarëdo që të ndodhte. Para një muaji, i kish flakur të gjitha brisqet. S'do të lejonte kurrsesi që këto vajza idiote ta detyronin të shkelte premtimin që i kish bërë vetes.

Herën e parë që preu veten, mbrëmjen pasi i kish vdekur gjyshja, hyri në tualetin e shtëpisë së vjetër në fermë dhe nxori nga dollapi i ilaçeve enën e qelqit plot me brisqe të gjyshit të saj të ndjerë. Mori prej andej një brisk - ena kish formën e një njeriu me flokë të zinj dhe këmishë blu - më pas, u ul mbi tualet dhe bëri një prerje nja dy centimetra në parakrah. Pastaj, humbi ndjenjat. Disa minuta më pas, kur u përmend, e gjeti veten në dyshemenë e tualetit, me dorën që shtrëngonte parakrahun, plagën e të cilit nuk guxonte ta shihte. Aty kuptoi se dhembja fizike e zhdukte për disa minuta dhembjen emocionale. Kish humbur ndjenjat sepse e zinte gjaku. Gjatë shtatë viteve në vijim, vazhdoi ta lëndonte veten për të shuar zemërimin, zhgënjimet dhe dhembjen, por plagët i bënte pa i parë.

Kur u shpërngul të jetonte me Pegin dhe Herrin, filloi të kuptonte se, të priste veten, ishte një budallallëk. Për më tepër nuk donte t'i ngjante së ëmës. Frika e saj më e madhe ishte se mos sëmurej

mendërisht. Po të arrinte t'i kontrollonte emocionet, veçanërisht zemërimin, ndoshta nuk do të binte në të njëjtën grackë.

Atë çast, nga fillimi i klasës, një vajzë me flokë të zinj dhe të shndritshëm që i binin mbi shpatulla si një pelerinë mëndafshi, shkarraviste në bllokun e shënimeve pa i kushtuar vëmendje rrëmujës përreth, duke u hedhur veçse një shikim rastësor dhe të ftohtë nxënësve të tjerë. Izi kish njohur edhe më parë vajza si ajo. Ndoshta ajo ishte lidhur me ndonjë student universiteti dhe nuk kish kohë të merrej me palaçollëqet e shokëve të klasës. Ose ishte udhëheqësja e grupit të vajzave të këqija.

Më në fund ra zilja dhe nxënësit u ngritën me potere nga bankat, për të bërë pushimin e parë mes orëve. Asnjë nxënës tjetër nuk kishte çantë shpine. Izi i mblodhi me nge gjërat e saj, duke pritur qëllimisht që të tjerët të largoheshin më parë. Kur u bë gati të dilte, e thirri zoti Hadson dhe ajo u kthye mbrapsht.

- Urdhëroni, zoti Hadson!

- Më ke dhënë formularin e gabuar, - i tha ai. - Ky formular është për infermieren.

- Oh! - psherëtiu Izi dhe iu afrua tryezës së tij, mori dokumentin e filloi të rrëmonte në çantën e shpinës për të gjetur të duhurin. - Më falni për gabimin!

- Dëgjo, - i tha profesori. - Shkolla është e vogël dhe këta nxënës kanë qenë bashkë që në vit të parë. Kanë kaluar dy vjet që kur kanë pasur mes tyre një nxënëse të re.

Izi ngriti supet.

- Mirë, - i tha.

- Nëse dikush të tall, gjëja më e mirë që mund të bësh, është t'i shpërfillësh.

Për ty është e lehtë, mendoi ajo.

- Mirë, - iu përgjigj sërish. - Faleminderit!

Pas mësimit, vajza me flokë të zinj iu afrua Izit te rafti.

- Ç'kemi? - e përshëndeti. - Mirë se erdhe në ferr!

- Faleminderit! - ia ktheu Izi, duke futur çantën e shpinës në raft.

- Këtu asnjë nuk mban çantë shpine, - vazhdoi vajza. - Shkolla është aq e vogël, sa në pushimin midis orëve të gjithë vijnë te raftet e tyre.

- E vura re, - tha Izi. Vajza ishte pak si thuthuqe, por nga ana tjetër, dukej se përshtatej më së miri me grupin e vajzave të liga - trup i përsosur, makijazh ideal, veshje të papara. Çne që po i fliste Izit?

- Quhem Aleksandra, - i tha ajo. - Shkurt më thërrasin Aleksa.

Izi mbylli raftin, ndërsa në kraharor shtrëngonte librin e matematikës.

- Izi, shkurt për Izabela.

- Më pëlqyeka, - tha Aleksa duke buzëqeshur. - Të shkon. Dëgjo, Shenoni dhe shoqet e saj të hapin veç telashe. Gjëja më e mirë është t'i shpërfillësh dhe t'u qëndrosh sa më larg.

- Je personi i dytë që ma thua këtë.

- Sepse është e vërtetë, - ia ktheu Aleksa.

Izi mblodhi supet.

- Ato s'më ngacmojnë, - tha ajo, ndërsa Aleksa qeshi.

- Si të duash. Mos më thuaj që nuk të paralajmërova. Nuk besoj se ke hasur më parë ndonjë si Shenoni.

- Çfarë mund të ketë kundër meje? - e pyeti Izi. - Unë jam e re këtu.

Aleksa ngrysi vetullat.

- Së pari, i dashuri i saj të mbrojti, - i tha ajo. - Kjo është luftë e hapur.

- Nuk ishte faji im, - tha Izi.

- E di, - ia ktheu ajo. - Por vajza e fundit, që Shenoni e konsideronte si rrezik për lidhjen e saj me Etanin, u detyrua të transferohej në një shkollë tjetër.

- Ju nuk jeni shoqe?

Aleksa i hodhi sytë gjetkë për një çast. Ajo lëvizje e befasishme, ajo vonesë e vogël teksa Aleksa shmangte shikimin e bëri Izin të vriste mendjen nëse po i thoshte të vërtetën. Ndoshta Aleksa ishte spiune e vajzave të këqija, ndoshta e kishin dërguar që të bëhej shoqe dhe t'u tregonte më pas gjithçka.

- Kemi qenë shoqe shumë të ngushta, - i tha Aleksa. - Por jemi prishur para ca kohësh.

- Çfarë ndodhi? - e pyeti Izi, edhe pse e dinte se pyetja e saj ishte e pavend, por punë e madhe. S'do të lejonte kurrsesi të binte në grackën e tyre.

- Si thua, takohemi më vonë? - e pyeti Aleksa. - Mund të të shoqëroj në shtëpi, nëse do. Kam një makinë të tipit *BMW* të vitit '76. Është karakatinë, por e kam blerë vetë dhe e bën mirë punën e saj.

Izi nisi të gërvishte me thonj kapakun e librit të matematikës dhe ndiente një pasiguri që po e gërryente përbrenda.

- Duhet të kthehem në shtëpi me autobus, - i tha. - Prindërit e mi kujdestarë më kanë thënë të mos udhëtoj me askënd që ata nuk e njohin.

- Po mirë, të kaloj më vonë nga shtëpia jote? - e pyeti Aleksa. - Kështu do të prezantohem me prindërit e tu kujdestarë dhe ndoshta mund të shoqërohemi bashkë.

Izi ishte gati të pranonte kur Aleksa i nguli sytë në fund të korridorit, pas shpinës së saj, dhe u pre në fytyrë. Shenoni dhe shoqet e saj po qëndronin pranë tyre, të ndjekura nga një re e dendur llaku flokësh dhe parfumi. Ajo po i buzëqeshte Aleksës vesh më vesh, sytë po i shndrinin dhe me zor po e mbante lajmin interesant që kishte.

- Do të vish sonte, apo jo? - i tha ajo. - Prindërit e Dejvit u nisën për në Florida dhe ai e ka frigoriferin dëng me birra.

Aleksa u ngrys dhe rrudhi ballin si fizarmonikë. Nisi të përgjigjej, por Shenoni ia kish ngulur sytë Izit, sikur po e shihte për herë të parë.

- Oh, - tha Shenoni teksa u hodhi një vështrim vajzave të tjera dhe më pas i buzëqeshi Izit. - Mund të vish edhe ti, nëse ke qejf. Do të të prezantoj me të gjithë.

- Unë... - belbëzoi Izi.

- Mos harro, - vazhdoi Shenoni t'i thoshte Aleksës. - Na premtove se do të sillje tekila.

Aleksa nuk mundi të kthente përgjigje, pasi Shenoni, duke qeshur nxitoi drejt korridorit me vajzat e tjera. Izi ia kish ngulur sytë Aleksës, në pritje të një shpjegimi.

- Ajo e di që unë po të them se nuk e honeps dot, - i tha. - Gjithë këtë e bëri që të dilja si gënjeshtare.

- Meqë e thua ti, - ia ktheu Izi. - Duhet të kthehem në klasë tani, - tha dhe e la Aleksën pas, teksa mori përgjatë korridorit, duke menduar se ky do të ishte një vit shumë i gjatë. - Do të shihemi!

KAPITULLI 4



KLARA

Qendra "Long Ajlënd" për të sëmurët mendorë
Dita e Vitit të Ri, 1930

Dy muaj e gjysmë pas zënkës me prindërit, Klara ishte ulur pranë dritares me gjashtë panele të ngushta të dhomës së saj në katin e tretë të vilës "Norton", duke soditur mjediset kryesore të qendrës "Long Ajlënd" për të sëmurët mendorë. Ishte mëngjes herët, dita e Vitit të Ri: retë gri qëndronin ulët si një shenjë ogurzezë në qiellin dimëror. Stuhia e borës nuk kish pushuar gjithë natën dhe kish veshur gjithçka me mantelin e bardhë. Pemët në korijen me kedra, ishin përkulur nën peshën e dëborës dhe uji që rridhte pranë përroit, kish ngjyrën e gurëve të varrit. Kopshtari, me shpinën kërrusur, po pastronte me lopatë trotuaret dhe kapela e kuqe i vërtitej lart e poshtë teksa ai grumbullonte dëborën në pirgje gjithnjë e më të mëdha. Një kamion i zi, me tehet që ngriheshin e uleshin si krahët e një grerëze gjigante, po pastronte rrugën e ngushtë me pemë, ndërsa uturima e motorit dhe kërcitja e plugut bënin që xhamat e hollë të dritareve të dridheshin. Më në fund era pushoi, por, herë pas here, qielli lëshonte një stuhi të ngadaltë flokësh të trashë dëbore.

Me lotët që i shkëlqenin në sy, Klara vriste mendjen se ku do të ishte vitin e ardhshëm, ditën e Vitit të Ri. E imagjinonte veten duke jetuar me Brunon, duke rritur fëmijën e tyre dhe e çliruar

nga tutela e prindërve. Fillimisht, duhej të largohej sa më parë nga qendra "Long Ajlënd". Duhej ta bindte doktor Thornin se më kot e mbanin të izoluar. Deri më tani, asgjë nuk kishte nxjerrë në dritë. Ai merrte për bazë fjalët e të atit dhe jo të sajat.

Megjithatë, u lehtësua që e kishin anuluar shëtitjen e mëngjesit. U gëzua jo vetëm se nuk do të dilte jashtë në atë mot të ftohtë dhe me borë, por kishte gjithë mëngjesin që rrinte në tualet nga të përzierat, ndihej e dobët dhe po dridhej e tëra. Rrëshqiti dorën ngadalë mbi bark dhe ndjeu instinktin mbrojtës ndaj foshnjës që rritej brenda saj. Fatmirësisht, askush nuk e dallonte që ishte shtatzënë, por ajo e ndiente se dalëngadalë barku po i rritej. Fëmija që priste, ishte vajzë dhe për këtë ishte e sigurt. Çdo mbrëmje, për më tepër se një javë, kish parë në ëndërr një foshnjë me fustan rozë me fjongo, me kaçurrela të errët si të Brunos dhe sy ngjyrë çokollatë që e shikonin ngultas. Klara kapërdiu lëmshin e madh që i ishte mbledhur në fyt, e habitur nga dashuria e pafundme që ndiente për foshnjën, ende pa e lindur.

Kjo e bëri të mendonte për nënën e saj, Ruthin. A e kish përkëdhelur ajo ndonjëherë barkun që i rritej kur ishte shtatzënë, duke i premtuar vetes se do ta donte dhe do ta mbronte foshnjën e saj gjithë jetën, pavarësisht nga gjithçka? Apo mos ndoshta embrioni që rritej brenda saj, ishte thjesht një barrë që ia bënte të vështirë të vishej sipas modës? A e kish pritur me padurim ditën kur ta pushtonte në kraharor foshnjën e sapolindur dhe t'i puthte ballin e vogël aromëmirë, apo ndoshta mezi kish pritur t'i shkonte në fund shtatzënisë, që më pas për foshnjën të kujdesej një dado dhe ajo të vazhdonte jetën e saj? Klara besonte se duhej të kish qenë patjetër kjo e fundit. Në të kundërt, si mund të shndërrohej një nënë e dashur dhe e kujdesshme në një grua egoiste, e cila nuk e vinte ujin në zjarr se çfarë u ndodhte fëmijëve të saj?

E fshiu nga mendja imazhin e së ëmës dhe po mundohej t'i mbushte mendjen vetes se duke menduar për gruan që e solli në jetë, nuk do të ndryshonte asgjë. U ul në shtratin e ngushtë, hodhi pulovrin krahëve dhe ia nguli sytë letrës së pahapur mbi tryezë. Ia kish dërguar i ati. Ishte letra e dytë që i dërgonte që kur e kishin shtruar në qendrën "Long Ajlënd" para dy muajsh, pavarësisht se ajo i shkruante përditë dhe i përgjërohej ta nxirrte

prej andej. Zarfi me ngjyrë të fildishtë qëndronte aty prej një ore, që kur ajo ishte kthyer pasi kishte ngrënë mëngjes. E kish marrë në dorë mbi njëzet herë, me gishtin e madh përqendruar te cepi i kapakut, dhe e kish ulur sërish, të pahapur.

Në letrën e parë që kish marrë një javë pas mbërritjes, Henri i shkruante se qëndrimi në qendrën "Long Ajlënd" ishte për të mirën e saj dhe thjesht diçka e përkohshme, derisa ajo të merrte ndihmën e duhur mjekësore. Por ndërsa javët kalonin pa marrë asnjë lajm, Klara filloi të shqetësohej se mos i ati kish ndryshuar mendje dhe se ajo do të qëndronte aty më shumë nga sa kish menduar. Tani, e ardhmja e saj varej nga ajo që i ati kish shkruar në letrën e fundit dhe, për sa kohë që të ishte e mundur, donte të besonte se prindërit do ta lejonin të kthehej në shtëpi. Kur Xhejmsi ta merrte vesh se ajo mbante në bark fëmijën e dikujt tjetër, do ta anulonte martesën. Prindërit do ta bënin hasha dhe do ta hidhnin në rrugë. Gjithsesi, gjithçka ishte më mirë se ajo që po përjetonte. Gjithçka ishte shumë më mirë sesa të rrinte e mbyllur në atë çmendinë, edhe pse ajo ishte më e mira që mund të blihej me para.

Dhomat në qendrën "Long Ajlënd" ishin të ngrohta, të pastra dhe mjediset të mirëmbajtura. Dhe më e rëndësishmja, stafi ishte i mirë. Gjatë vakteve, pacientët përdornin takëme të argjendta dhe porcelan luksoz, rehatoheshin nëpër sallone, në divane të periudhës së Luigjit XV. Trajtimi përqendrohej kryesisht te pushimi, qetësia, ushqimi i mirë, ajri i pastër dhe aktivitete si çiklizmi dhe tenisi. Sigurisht, edhe te seancat terapeutike. Në rastin e Klarës, ishte e qartë: ajo po mbahej kundër dëshirës së saj. Gjatë seancës së parë të terapisë, një ditë pasi kishte mbërritur aty, pyeti doktor Thornin se çfarë mund të ndodhte nëse përpiqej të arratisej prej andej.

- Pse do të arratisesh? - e pyeti ai, duke e vështruar përmes syzeve të rrumbullakëta. Ai ishte i gjatë dhe i dobët si skelet, me një arrëz gjigante në fyt, që i lëvizte lart e poshtë në gurmazin kockë e lëkurë, si peshku në sqepin e një pelikani.

- Sepse unë nuk e kam vendin këtu, - iu përgjigj Klara. - Jam shëndoshë si molla.

- E shoh, - ia ktheu doktor Thorni, duke shkarravitur në

bllokun e shënimeve. - Atëherë, si ka mundësi që përfundove në qendrën "Long Ajlënd"?

Klara, e ulur në një karrige druri, me kyçet e këmbëve kryqëzuar pas karriges dhe duart e mbledhura në prehër, ia kish ngulur thonjtë pëllëmbëve të duarve dhe përpiqej të dukej sa më e qetë.

- Im atë nuk është mësuar që unë t'ia bëj fjalën dysh. Ai mendon se femrat janë thjesht objekt soditjeje dhe zëri i tyre s'duhet të dëgjohet. Kjo është mënyra e tij për të më bërë të hesht, për të më vërtetuar se ka kontroll mbi mua. Po mundohet të më detyrojë të bëj diçka që unë nuk dua.

- A nuk është detyra e prindit të bëjë më të mirën për fëmijët e tij?

- Po, - tha ajo. - Është e vërtetë, por ai s'po bën më të mirën për mua! Ai po më detyron të martohem me një njeri të ndyrë, që nuk vlen një grosh... - tha dhe ndaloi. Në stomak i ishte mbledhur një lëmsh nga meraku se mos po fliste më shumë se ç'duhej. - Çfarë ju ka thënë im atë? Pse më ka mbyllur këtu?

- Tha se kishe pësuar një krizë nervore. Është i shqetësuar se nuk i ke mendimet e qarta.

- Kjo është absurde, - tha ajo. - Ai thjesht nuk përballet dot me të vërtetën.

- Cila është kjo e vërtetë, Klara?

- E vërteta është se prindërve të mi u interesojnë më tepër paratë dhe pushteti, sesa fëmijët e tyre.

- Paske shumë mllef ndaj tyre, që të kanë mbyllur këtu.

Klara drejtoi trupin.

- Sigurisht që kam mllef, - ia ktheu duke ngritur zërin. - E kush nuk do të ndihej kështu?

Doktor Thorni tundi kokën dhe shkroi diçka në bllokun e shënimeve. Pastaj bëri pyetjen tjetër pa i ngritur sytë.

- Mendon se yt atë po komploton kundër teje, Klara?

Ajo ngriu në vend.

- Jo, - u përgjigj, duke mohuar me kokë. - Komploti është një fjalë shumë e rëndë. Im atë mendon se do të më japë një mësim të mirë duke më mbyllur këtu. Atij nuk i pëlqen njeriu që unë dashuroj. Mendon se, kur të kthehem në shtëpi, nuk do t'i kundërshtoj më planet e tij.

Doktor Thorni uli stilolapsin, hoqi syzet dhe fërkoi sytë. Më pas, gërshetoi gishtat mbi tryezë dhe ia nguli sytë Klarës, duke e parë me shumë vëmendje.

- Ndonjëherë, - foli ai me zë të qetë, - kur shqetësohemi apo mërzitemi, fillojmë të imagjinojmë gjëra. Babai yt thotë se e ke akuzuar për vrasjen e tët vëllai.

- Nuk është e vërtetë, - ia ktheu ajo. - Im vëlla vrau veten, pasi mendonte se nuk kishte më asnjë arsye për të jetuar. Im atë e shkatërroi atë dhe nëna ime nuk lëvizi as gishtin për ta ndaluar.

- Mendon se prindërit e tu janë përgjegjës për vdekjen e tët vëllai?

- Mund t'i kishin zgjidhur gjërat ndryshe, - tha ajo, - por kaluan në ekstreme, siç bëjnë ngaherë. Në vend që t'i zgjidhnin problemet si prindër normalë, e hoqën qafe!

- Dhe tani mendon se po përpiqen të të heqin qafe edhe ty.

- Nuk doja të... - Klara pushoi së foluri dhe u mundua të qetësohej, pasi zemra po i rrihte pa pushim. Befas, kuptoi se fjalët e saj mund të keqinterpretoheshin dhe të përdoreshin kundër saj.

- Ka ndonjë problem? - e pyeti doktor Thorni dhe ngriti vetullat.

Ajo mohoi me kokë.

- Pse nuk e përfundon atë që po thoshe? - e pyeti ai.

Ajo e përqendroi shikimin te duart dhe ndjeu se sytë po i përloteshin.

- Ju nuk po më dëgjoni, - i tha. - Dëgjoni vetëm ato që ju interesojnë. Po i keqinterpretoni fjalët e mia, duke më nxjerrë si një njeri të paqëndrueshëm.

- Duket se nuk paske fort besim te njerëzit, - tha mjeku. - Te prindërit e tu, te njeriu me të cilin ata duan të të martojnë. Madje, as tek unë.

- Si do të ndiheshit ju, doktor, nëse situata do t'ju ishte kthyer kundër? A nuk do të përpiqeshit të shpjegoheshit dhe a nuk do të kërkonit t'ju linin të lirë, po të ishit mendërisht i shëndoshë?

Doktor Thorni mbylli bllokun e shënimeve dhe vuri sërish syzet.

- Pacientët e qendrës "Long Ajlënd" dalin që këtu vetëm me autorizimin tim ose me kërkesë të palës që i ka shtruar këtu, në këtë rast, të babait tënd.

- Çfarë do të ndodhte nëse do të bëja gati valixhen dhe do të largohesha? Nëse do të dilja nga porta e madhe?

Ai buzëqeshi dhe u shtrembërua, sikur po mundohej të mbante të qeshurën.

- Mund ta provosh, - ia ktheu. - Por sipërfaqja e "Long Ajlëndit" është katër hektarë dhe duhet të bësh goxha rrugë për të mbërritur te porta kryesore. Do të të ndalonim para se të shkoje shumë larg. Përveç kësaj, porta është e mbyllur me dry dhe unë e kam parë sa të madhe e ke valixhen. S'besoj se do ta kesh të lehtë ta nxjerrësh nga dhoma, aq më tepër, ta zbresësh nga shkallët dhe ta tërheqësh përgjatë lëndinës.

Ditën kur u grind me të atin, gabimi i saj më i madh qe përgatitja e valixhes. Duhej të ishte larguar nga studioja, të rrëmbente pallton dhe të ikte nga shtëpia sa hap e mbyll sytë. Duhej të ishte larguar që kur i ati i tha togerit të vinte i shoqëruar me një mjek. Por ajo nxitoi për në dhomën e saj, nisi të bënte gati rrobat dhe harroi se duhej ta zbriste vetë nga shkallët atë valixhe kaba dhe se askush nuk do ta lajmëronte shërbëtorin dhe shoferin që ta ndihmonin për t'i ngarkuar bagazhet e saj në makinë. Në fund të fundit, po ia mbathte nga shtëpia, nuk po nisej për ndonjë udhëtim përtej detit. Nuk i kish bërë llogaritë me mend në kokë dhe, e pushtuar nga paniku, s'kish qenë në gjendje të lidhte logjikisht dy mendime të ndryshme. Dinte vetëm se duhej të merrte sa më shumë gjëra të mundej, sepse, pasi të dilte nga ajo derë, veshjet në valixhe dhe rrobat që kishte në trup, do të ishin gjithçka që zotëronte në këtë botë.

Tani që e mendonte, kuptoi se ishte treguar pa mend. E dinte se policia do të mbërrinte në shtëpinë e saj brenda disa minutash, sepse Ruthi i kish njoftuar me qindra herë - kur nuk gjente dot varësen me perla, kur i kish humbur shandani në sallon, kur nuk gjendej kompleti i preferuar anglez i çajit. Sa herë që mbërrinte, policia mundohej ta qetësonte Ruthin teksa ecte tutje-tëhu dhe vajtonte, e bindur se ia kish vjedhur shërbyesja. Më pas, të gjithë: shërbyeset, shërbyesit dhe shoferët e limuzinës rreshtoheshin dhe merreshin në pyetje si të ishin kriminelë. Me kalimin e kohës, e vërteta dilte në dritë. Varësja e Ruthit kish rrëshqitur prapa komodinës së tualetit, shandanët ishin vendosur në depon e

ushqimeve në pritje për t'u pastruar e shkëlqyer, ndërsa kompleti i çajit ishte zhvendosur në një raft tjetër. Kur kuptonte se sendet e çmuara nuk kishin humbur, Ruthi falënderonte policinë për ndërhyrjen e shpejtë. Ndërkaq, Klara mundohej t'i kërkonte të falur shërbyeses.

Po t'i kish shkuar ndër mend se sa shpejt mbërrinte policia në shtëpinë e saj, në vend që të shqetësohej si Ruthi për "sendet" personale, mund t'ia kish mbathur prej andej. Kur i ati shoqëroi në dhomën e saj togerin, dy policë dhe një mjek, ajo e kish mbushur valixhen dëng dhe nuk kishte mundësi t'ia mbathte. Henri i urdhëroi burrat ta mbyllnin valixhen dhe ta zbrisnin poshtë bashkë me vajzën e tij të vetme. Asaj i ishte ngulitur në mendje fytyra flakë e kuqe e të atit dhe sytë e tij të tërbuar, si dhe gjestet që bënte me dorë, sikur po urdhëronte dëbimin e një krimineli nga shtëpia e tij.

- Ku qëndron problemi? - pyeti togeri.

- Ajo ka shpifur lloj-lloj akuzash të tmerrshme, - i tha Henri duke tundur kokën. - Druaj se imagjinata ka filluar t'i punojë shumë.

- S'është e vërtetë, - u tha Klara. - Unë thjesht...

Henri po e shihte mjekun me ca sy përgjërues.

- Mund ta ndihmoni?

Klara u drejtua për nga dera, por një polic e kapi nga kyçi i dorës. U mundua të shpëtonte, por më kot.

- Më lësho, - ulëriti ajo. - S'mund ta bëni këtë! Nuk kam bërë asgjë!

- Ka përjetuar ndonjë traumë emocionale Klara kohët e fundit? - pyeti mjeku Henrin.

- Ka humbur të vëllanë, - ia ktheu ai. - I është ngulitur në mendje që unë... - tha dhe uli kokën me grushtet e mbledhura te tëmthat, sikur e gjitha kjo të ishte një barrë e tepërt për të.

- Nuk është kjo arsyeja pse unë... - bërtiti Klara, ndërkohë që polici e shtrëngoi edhe më shumë te krahu. - Jo, më lësho!

Togeri me sytë nga mjeku, e la atë të merrte vendimin përfundimtar. Ai tundi kokën dhe, para se Klara të protestonte më tej, policët e mbërthyen për krahësh, e nxorën nga dhoma, zbritën shkallët, dolën jashtë dhe e futën në pjesën e pasme të makinës së zezë tip *Buick* të doktorit. Xhaketën dhe çizmet e

dimrit i hodhën pranë saj, në ndenjësen e pasme, ndërsa valixhen e futën në bagazh. Ajo vështroi nga dritarja hyrjen e gurtë të shtëpisë së prindërve, parmakët prej graniti dhe zambakët e gdhendur mbi hapësirën e derës. Nuk e dinte se përse po i vështronte, por brenda vetes kishte një fije shprese dhe priste që e ëma të dilte duke qarë te shkallët, e mërzitur që po i merrnin vajzën e vetme. Por e vetmja gjë që mban mend të ketë parë, ishte cepi i xhaketës së të atit teksa u zhduk në hyrje të shtëpisë dhe doreza prej tunxhi e derës që u hodh përpjetë nga përplasja e saj.

Ndërsa tani, Klara kafshonte faqen nga brenda, duke u munduar të gjente një mënyrë për ta bindur doktor Thornin që ta linte të ikte.

- Më vjen shumë keq! - i tha mjeku. - Druaj se koha jonë mbaroi.

- Por unë... - i tha Klara.

Mjeku u ngrit më këmbë, iu afrua tryezës dhe i tha:

- Mbaruam për sot, Klara.

- Kaq ishte? - e pyeti ajo, duke u dorëzuar. - Do t'i merrni vendimet duke u bazuar në një bisedë njëzetminutëshe?

- Do të flasim më tepër në takimin tonë të ardhshëm, - i tha ai, duke i hapur derën.

- Kur? - e pyeti ajo. - Nesër?

Doktor Thorni vuri buzën në gaz dhe mohoi me kokë.

- Druaj se nesër duhet të vizitoj disa pacientë të tjerë. Do të takohemi sërish javën tjetër.

Klarës iu bë një gropë në stomak. *Javën tjetër?* Gati sa nuk ia dha ulërimës kur mendoi se do të qëndronte aty edhe një javë tjetër. Me siguri që i ati nuk kish ndër mend ta linte aty aq gjatë.

Në korridor, e priste një infermiere e re për ta shoqëruar në dhomën e saj. Klara ecte me krahët e kryqëzuar dhe mundohej të mos e jepte veten. Nuk do të ishte e favorshme për të nëse dukej emocionalisht e paqëndrueshme në sy të infermieres. Edhe pse ajo i buzëqeshi Klarës kur doli nga zyra e mjekut, sytë e ëmbël blu shfaqnin keqardhje.

Atë çast u pushtua nga një frikë e papërshkrueshme, sa edhe lëkura i sëmboi nga të rrëqethurat. Korridoret dukeshin pa fund

dhe tapetet e kuqe e të gjelbra, si dhe shandanët prej kristali i kujtuan brendinë e një këndi lojërash në ishullin Konei, ku klientët përndiqeshin nga një kloun me një shkop "magjik" nëpër labirintet dhe korridoret e errëta, me dysheme të pjerrëta dhe mure të lëvizshme. Gjithnjë e kish urryer këndin e lojërave, pasi i kujtonte panikun që kish përjetuar kur një avion i ishte djegur mes këmbëve. Ishte kthyer mbrapsht dhe kishte çarë rrugën mes turmës së njerëzve për të dalë jashtë, duke u betuar se s'do të hynte më kurrë aty brenda, pavarësisht se shokët do ta tallnin. Qendra "Long Ajlënd" ishte një mijë herë më e keqe. Nuk kishte asnjë rrugë shpëtimi, asnjë dalje ose qoshe nga të shihte dritën e diellit, as hot-dogë apo shoqe që e vinin në lojë.

Sapo mbërriti në dhomën e saj, ndaloi te dera duke pritur infermieren që ta fuste brenda. Ia nguli sytë dyshemesë për rreth një minutë, para se të kuptonte se infermierja kish ndaluar disa hapa pas saj dhe po e vështronte vetullngrysur, sikur po përpiqej të merrte një vendim.

- S'ke dalë asnjëherë shëtitje në mjediset përreth? - e pyeti ajo.

Klara mohoi me kokë.

- S'kam shumë që kam ardhur këtu.

- E di kur ke ardhur, - iu përgjigj ajo. - Isha me infermieren MekKarn kur të shoqëroi mbrëmë për në dhomë. E ndihmova të shpaketonte rrobat e tua.

- Më fal! - tha Klara. - Nuk mbaj mend asgjë. Unë...

- S'ka problem, - ia ktheu ajo. - Ke dëshirë të bësh një shëtitje? Kemi pak kohë derisa të shtrohet dreka dhe kjo mund të jetë një nga ditët e fundit të ngrohta para se të vijë dimri. Lëndinat janë shumë të bukura. - Me të thënë këto fjalë, infermierja hodhi një sy përreth, e shqetësuar se mos i dëgjonte njeri.

Klara tundi kokën.

- Dua të rri pak vetëm.

- Je e sigurt? - e pyeti ajo. - Dielli po ndriçon dhe është aq ngrohtë, sa nuk ke nevojë as për pulovër. Nesër thonë se koha do të ftohet...

Klara psherëtiu dhe vari supet. Por ndoshta mund të mësonte rrugën përreth qendrës dhe të gjente një mënyrë shpëtimi, ndaj pohoi me kokë. Ecën përgjatë korridorit, morën një kthesë dhe

u futën në kafazin e shkallëve. Infermierja zbriti e para, por te shkalla e katërt, ndaloi. Infermiere MekKarni po ngjiste shkallët.

- Oh, - psherëtiu ajo. - Ndoshta e lëmë për një herë tjetër, - tha dhe u kthye të ngjiste me vrap shkallët, ndërsa Klara e ndoqi pas.

- Infermiere Joti! - u dëgjua pas tyre zëri i MekKarnit, që shpejtoi hapat nëpër shkallë. Asaj iu prenë gjunjët dhe ndaloi ta priste vetullngrysur. Infermiere MekKarni i arriti, vendosi njërën dorë mbi ijë, rrudhi ballin dhe tha:

- Ku po shkonit? Ti kishe urdhër ta çoje pacienten në dhomën e saj.

- Po e shoqëroja Klarën jashtë, - ia ktheu infermiere Joti, - për të marrë pak ajër të pastër.

MekKarni ia nguli sytë Jotit dhe nofulla po i dridhej nga nervozizmi.

- S'të takon ty të marrësh vendime se ç'është më e mira për një paciente! - i bërtiti ajo. - Shoqëroje menjëherë në dhomën e saj!

Infermiere Joti uli sytë përdhe.

- Si urdhëron, zonjë!

- Mos harro, ti nuk je mjeke, - shtoi MekKarni më pas. - Bën mirë të ndjekësh shembullin tim. Kam më shumë se njëzet vjet që punoj në këtë qendër dhe gjithmonë i zbatoj pikë për pikë udhëzimet e mjekëve!

- Më fal! - ia ktheu Joti, duke u bërë flakë e kuqe në fytyrë.

Infermiere MekKarni tundi kokën dhe filloi sërish:

- Është hera e dytë që më detyron të të tërheq vëmendjen. Bën mirë të jesh më e kujdesshme.

Klara u kapërdi, bëri një hap përpara dhe ndërhyri:

- Doktor Thorni e udhëzoi të më shoqëronte jashtë, - i tha ajo. - I thashë se ndihesha si e mbyllur në kafaz dhe ai mendoi se do të më bënte mirë nëse dilja disa minuta.

Infermiere MekKarni, me buzët mbledhur, ia kish ngulur shikimin Klarës, por dhe ajo nuk po ia hiqte sytë. Më në fund, i hodhi një vështrim infermiere Jotit dhe e pyeti:

- E vërtetë është kjo?

Joti pohoi me kokë.

MekKarni mblodhi sërish buzët dhe po përpiqej të mos e

humbiste toruan, ndërsa një damar blu i kish kërcyer në ballë.

- Luajini këmbët! - u tha, duke ua bërë me dorë drejt shkallëve. - Keni dhjetë minuta kohë para se të shtrohet dreka. Sigurohu që pacientja të vijë në mensë në kohë. Nëse vonohet, ti do të mbash përgjegjësi, - tha, tundi kokën gjithë inat dhe mori rrugën përmes korridorit.

Infermierja i buzëqeshi Klarës dhe i tha:

- Faleminderit! Të betohem se do të ma kishte nxirë jetën.

Kjo kish ndodhur para dhjetë javësh, por dukej sikur kishin kaluar dhjetë vjet.

Klara zgjati dorën për të marrë letrën mbi tryezë. Kur e pa në mëngjes, zemra thuajse i doli nga vendi, duke menduar se ia kish dërguar Brunoja. Më në fund po u kthente përgjigje letrave të saj. Por kur mbi zarf pa shkrimin e Henrit, u lëshua sërish mbi krevat, duke e mbuluar fytyrën me duar. Nuk arrinte ta kuptonte pse Brunoja nuk i kishte shkruar asnjë letër. Në fillim, u shqetësua se mos letrat e saj i kishin mbajtur diku, por kjo i dukej e pamundur. Ajo i kish çuar vetë te recepsioni, i kish hedhur me dorën e saj në kutinë e mbyllur postare. Muaji i parë kaloi pa asnjë lajm. Më pas, filloi të zgjohej e mbuluar e tëra në djersë të ftohta, e alarmuar dhe e frikësuar se diçka e keqe mund të kish ndodhur. Babai i saj ishte një tiran i etur për pushtet dhe këtë s'e luante as topi. Por s'mund të shkonte deri atje sa ta hiqte qafe Brunon, apo jo? Për pak kohë, mendoi se ndoshta Brunoja e kish harruar. Ndoshta lidhja e tyre nuk kish qenë e rëndësishme për të. Ndoshta ajo ishte një prej femrave dosido në listën e gjatë të atyre që linin kokën pas tij. Por jo, s'ishte ashtu. Ishte më keq se aq. Shumë më keq. Ajo ishte e sigurt për këtë. Gjithsesi, preferonte më shumë ta imagjinonte Brunon në krahët e një femre tjetër, sesa t'i jepte jetë imazhit që nuk e linte të qetë çdo natë: Brunoja që pluskonte me shpinë pranë vëllait të saj, Uilliamit, në lumin Hadson.

U largua një hap nga tryeza dhe vendosi dorën mbi buzë. Befas, iu përzje sërish, edhe pse buka e thekur që hante çdo mëngjes, ia kish lehtësuar shumë të përzierat. Pas tre muajsh heshtjeje, i ati nuk duhej t'i kish shkruar vetëm për ta përshëndetur. Krishtlindjet dhe Viti i Ri kishin ardhur dhe ikur, por ajo kishte marrë vetëm një kartolinë. Mos ndoshta, më në fund, do të largohej prej atij

vendi, apo do ta detyronin të qëndronte më gjatë?

U mbush thellë me frymë dhe e mori sërish letrën, duke u betuar se këtë herë do ta hapte. Kafshoi buzën dhe gishtin e madh të dorës e rrëshqiti te pjesa e pasme e zarfit. Pastaj, e hapi. Gishtat i dridheshin teksa shpaloste letrën ngjyrë fildishi të të atit. Zarfi ra përtokë, ndërkohë që letrën e shtrëngonte fort me duart që i dridheshin.

E dashur Klara,

Unë dhe nëna jote shpresojmë të jesh mirë dhe se po merr ndihmën e nevojshme. Fatkeqësisht, jeta jote mori këtë rrjedhë. Doktor Thorni më siguroi se ndonjëherë, sado që bëjnë të pamundurën, prindërit nuk mund ta përcaktojnë dot rritjen e fëmijëve të tyre. Asnjëra palë nuk e ka gabim. Ajo që është bërë, nuk zhbëhet më. Unë dhe nëna kemi bërë të pamundurën dhe s'mund të kërkojmë më shumë nga vetja. Po të shkruaj për të të thënë se gjërat kanë ndryshuar që nga kriza që përfshiu bursën në muajin shtator. Për shkak të humbjeve të mëdha, për të ruajtur shtëpinë dhe mënyrën e jetesës me të cilën jemi mësuar, mua dhe nënës na vjen shumë keq të të themi se nuk na e mban më xhepi të paguajmë mjekimin në qendrën "Long Ajlënd". Unë dhe doktor Thorni kemi folur gjerë e gjatë për gjendjen tënde dhe ramë dakord të ndërmarrin hapin e nevojshëm të radhës. Ai do të të shpjegojë gjithçka për çfarë kemi rënë dakord. Mos harro, unë dhe nëna jote duam më të mirën për ty.

Me dashuri,

babai.

Klara nuk ia hiqte dot sytë letrës, fjalët iu mjegulluan dhe një lëmsh i madh iu mblodh në fyt. Ç'kuptim kishte e gjithë kjo? Cili ishte hapi i nevojshëm i radhës? Mos ndoshta do ta nxirrnin nga qendra? Mos do ta linin të lirë, të ishte e pavarur? Letra i ra përdhe, ndërsa ajo nisi të ecte nëpër dhomë me hapa të vegjël e duke u dridhur e tëra. Takimin e radhës me doktor Thornin e kishte në orën 11:00. Ora shënonte 09:30. Ndaloi dhe mori disa herë frymë thellë, duke u munduar të qetësonte të rrahurat e forta të zemrës. Shqetësimi emocional nuk i bënte mirë fëmijës. Duhej

të qetësohej. Pas një minute, u shtri në shtrat, hodhi batanijen e hollë shpatullave që i dridheshin dhe mbylli sytë.

Befas, brofi në këmbë, duke menduar se duhej të bënte patjetër diçka. Duhej t'i shkruante Brunos. Ai duhej të ishte në dijeni nëse gjërat do të ndryshonin, nëse do ta nxirrnin nga qendra apo do ta çonin në shtëpi. Edhe pse nuk e dinte në i kishte marrë letrat e saj, duhej të mundohej ta informonte për gjithçka që po ndodhte. U ngrit, hapi sirtarin e tryezës dhe nxori letrat që i kishin dhënë përfaqësuesit e qendrës. Tërhoqi karrigen, u ul dhe e pozicionoi stilolapsin mbi letër, por kuptoi se nuk dinte ç'të shkruante. Si mund t'i shpjegonte Brunos se çfarë po ndodhte, kur as ajo vetë nuk e dinte? Letrën do ta shkruante pasi të përfundonte takimin me doktor Thornin. Ndoshta ai do ta takonte më shpejt. Mund të pyeste edhe infermiere MekKarnin nëse kish ndryshuar orari i takimeve. U ngrit dhe iu afrua derës. Në korridor dëgjoi zëra meshkujsh.

Nxitoi sërish te tryeza, futi në sirtar të gjitha sendet dhe, më pas, hodhi vështrimin përqark dhomës për të gjetur diçka që të dukej sikur ishte e zënë me punë. Infermiere MekKarni kish thënë se duart që rrinin kot, ishin këndi i lojërave të djallit dhe, nëse një pacient nuk kishte asgjë për të bërë, kishte gjithmonë dysheme për t'u larë dhe tualete për t'u pastruar. Klara mori nga rafti mbi shtratin e saj Biblën që i kish dhënë institucioni, u ul mbi krevat dhe e hapi në një faqe çfarëdo. Ndjeu një lloj trullosjeje dhe të dridhura, si të kishte ditë pa futur gjë në gojë.

Atë çast, kërciti dera. Doktor Thorni dhe një burrë që ajo nuk e njihte, hynë në dhomën e vogël. Menjëherë pas tyre, u duk edhe infermiere MekKarni. Një shtresë dëbore kish zënë vend mbi supet e palltos së leshtë të të huajit dhe kishte mbushur palët e pantallonave të tij, ndërkohë që përdhe, rreth gallosheve të tij, formoheshin pellgje nga dëbora e shkrirë.

- Mirëmëngjesi, Klara! - e përshëndeti doktor Thorni. - Si ndihesh sot?

Ajo u sforcua të buzëqeshte dhe mbylli Biblën që kishte në prehër.

- Shumë mirë, faleminderit! Po ju?

Doktor Thorni hodhi vështrimin nga personin tjetër.

- Siç ju thashë, - iu drejtua ai, - ajo është ngaherë e këndshme.

Nuk do t'ju hapë asnjë telash.

Burri kapi me dorë kapelën e republikës, pa e hequr dorezën, dhe më pas e ngriti duke iu drejtuar Klarës. Ajo e përshëndeti me një gjysmëtundje koke, ndërsa buzët i dridheshin teksa mundohej të buzëqeshte. Doktor Thornit i kapën sytë letrën mbi tryezën e Klarës.

- Shoh që e paske lexuar letrën që të ka dërguar babai.

- Po, - u përgjigj, duke u përpjekur që zëri t'i dukej sa më i qëndrueshëm. - Më shkruante se ju do të më shpjegonit çfarë po ndodh.

- E vërtetë, - i tha ai. - Ndaj kam ardhur këtu, - dhe ia bëri me shenjë nga burri me kapelë të leshtë. - Ai është zoti Glen. Është nga Ovidi, një qytet i vogël pranë liqenit Seneka.

Infermiere MekKarni bëri një hap para për të qëndruar pranë doktorit, duke e fshehur njërën dorë prapa fundit të saj të bardhë. Klarës i zunë sytë diçka të gjatë dhe të argjendtë në dorën e saj. Dukej si shiringë. Një lëmsh iu formua në fyt dhe mezi po merrte frymë. Befas u ngrit në këmbë. Bibla i rrëshqiti nga prehri dhe ra në dysheme duke bërë një zhurmë të madhe. Pa se dy roja dhe një infermiere me përparëse ngjyrë blu ishin duke pritur në holl.

Doktor Thorni ngriti njërën dorë, si ta ndalonte Klarën t'ia mbathte. Infermiere MekKarni, me sytë e zmadhuar dhe të shndritshëm, u afrua edhe më shumë, si të ishte në gatishmëri.

- Zoti Glen dhe një infermiere kanë ardhur të të marrin dhe të të çojnë në Uillard.

- Uillard? - pëshpëriti Klara. Me zor u kapërdi dhe ndjeu se gjuha iu trash.

- Është një spital shtetëror për të sëmurët mendorë, - tha doktori. - Babai yt do që të sigurohet se ti do të marrësh ndihmën e nevojshme. Për fat të keq, ai nuk është më në gjendje të paguajë qëndrimin tënd këtu.

Klara bëri disa hapa prapa, duke shtrënguar fort pulovrin me duar.

- Nuk e kuptoj, - tha dhe balli iu mbush me bulëza të ftohta djerse. - Babai tha se qëndrimi im këtu do të ishte i përkohshëm. S'kam nevojë për ndihmë. Dua vetëm të shkoj në shtëpi!

Infermiere MekKarni bëri përpara dhe nxori shiringën nga

vendi ku e kishte fshehur. Doktori ngriti njërën dorë për ta ndalur.

- Të kuptoj, Klara, - tha ai. - Por fillimisht duhet të shërohesh. Fillo të paketosh gjërat e tua. Makina e zotit Glen po të pret jashtë.

- Por moti... - ia ktheu Klara, duke kërkuar një arsye për t'u vonuar sa më shumë.

- Po hapet, - i tha zoti Glen. - Nuk do të kemi asnjë problem, nëse nisemi brenda disa orësh. Do të mbërrijmë në Uillard kur të bjerë muzgu.

- Nuk ke pse trembesh, - i tha Thorni. - Në Uillard do të kujdesen shumë mirë për ty.

Klara u plandos mbi shtrat dhe ndjeu se këmbët nuk e mbanin më, e krahët i kishte të pafuqishëm. Mblodhi forcat që të mos binte si kërcu përdhe. Kërkoi t'u thoshte diçka që ata të kuptonin se ishte mendërisht e shëndoshë, se krimi i saj i vetëm ishte zënka me prindërit. Po ndëshkohej sepse ua kish bërë fjalën dysh, sepse kish mbështetur me forcë atë që ishte e drejtë dhe e vërtetë, por nuk po gjente fjalët e duhura.

- Infermiere MekKarni, - iu kthye doktor Thorni. - Thirr një nga infermieret e tua të ndihmojë Klarën të bëjë gati plaçkat, ndërsa ti shoqëroje zotin Glen dhe infermieren e tij në mensë. Me siguri duan të shijojnë një vakt të ngrohtë para se të nisin rrugën e gjatë për në Uillard. Silli edhe Klarës një çaj të ngrohtë dhe diçka për të ngrënë para se të niset.

Infermierja dhe zoti Glen dolën nga dhoma, ndërsa Thorni qëndroi në derë, me njërën dorë mbështetur te doreza.

- Do të jesh shumë mirë, - i tha Klarës. - Ti je një vajzë inteligjente e me një të ardhme të ndritur përpara. Thjesht ke nevojë për pak ndihmë, për të kuptuar drejtimin e duhur në jetë. Nëse tregohesh bashkëpunuese, nuk ke pse të frikësohesh për transferimin në Uillard. - Më pas, mbylli derën dhe u largua, duke e lënë Klarën të shtangur e të mbërthyer nga frika, me sytë ngulur mbi dyshemenë e drunjtë.

Me lëvizje të ngadalta, u ngrit dhe mori ditarin që kish poshtë krevatit. U ul në tryezë dhe e hapi në faqen e fundit ku kish shkruar, por fjalët i mjegulloheshin para syve. Kish shkruar çdo ditë që pas mbërritjes aty, por nuk e kishte përmendur kurrë

foshnjën, për disa arsye: kish frikë se mund të ndillte ters për shtatzëninë e saj ose mjekët mund t'ia gjenin ditarin dhe t'i tregonin të atit. Nuk arrinte ta imagjinonte se çfarë mund të bënte Henri po të merrte vesh se ajo priste fëmijën e Brunos. Ndoshta mund ta bënte hasha përgjithmonë.

Ajo fshiu sytë, mori një stilolaps e po mundohej të hidhte diçka në letër për faktin se po e hidhnin tutje si të ishte një mbeturinë, se po e mbyllnin si të ishte kriminele. Kish dëgjuar shumë histori për prindërit që nuk i nxirrnin kurrë jashtë fëmijët e tyre; fëmijë me gjymtyrë të deformuara, me temperamente të pakontrollueshme, zhvillim të vonuar mendor, me buzë të ndara më dysh, që mbaheshin të fshehur, izoloheshin në një dhomë në katin më të lartë të shtëpisë ose mbaheshin në një papafingo të errët. Të njëjtën gjë po bënte edhe i ati i saj me të? Kaq shumë turp i vinte nga e bija? Donte ta izolonte sepse ajo dashuronte një djalë që atij nuk i pëlqente? Vërtet besonte se mjeku do ta bënte të kuptonte sjelljen e gabuar, se mund ta detyronin të martohej me dikë që s'e donte? Apo mendonte vërtet se ajo ishte e sëmurë? Sakaq, mori stilolapsin dhe nisi të shkruante në ditar.

> *Im atë po më heq qafe, po më dëbon. S'jam shumë e sigurt se ç'kërkon të arrijë me këtë. Kjo më bën edhe më të vendosur që, kur të më lënë të lirë, ta jetoj jetën si të dua dhe sa më larg tij. Im atë po më dërgon në spitalin "Uillard". Pyes veten nëse duhet të kem frikë.*

Disa minuta më vonë, në dhomë hyri infermiere Joti, e cila i buzëqeshi dhe e pa drejt e në sy, ndryshe nga mjekët dhe infermieret e tjera që dukej se gjithnjë i shmangeshin. Klara mendoi t'i tregonte se do ta largonin nga qendra, por e dinte se ishte e kotë. Infermierja e re nuk mund të bënte asgjë. Ajo e ndoqi me sy kur infermierja nxori nga dollapi valixhen dhe e vendosi përdhe. Peshoi mbi gishtat e këmbëve teksa u ul të hapte kapakun e saj, ndërsa këmbët me çorape të bardha dhe duart e zbehta lëviznin ngadalë, si një balerinë që realizon një numër koreografik. Klara besonte se ajo dhe infermiere Joti kishin thuajse të njëjtën moshë. Maksimumi, infermierja mund të ishte

dy ose tre vjet më e madhe. Teksa po imagjinonte prindërit e infermieres, të buzëqeshur dhe krenarë për diplomimin e saj për infermieri, sytë iu mbushën me lot. Po kërkonte me sy nëpër gishtërinjtë e saj të kuptonte nëse ishte e martuar. Në dorën e majtë kishte një unazë fejese.

Befas, Klara ndjeu një barrë mbi supe, si të kish ngecur poshtë një shkëmbi gjigant. Kraharori iu ngushtua, agonia e hidhërimit e vuri përfund. Ishte e sigurt se dëgjoi zemrën t'i copëtohej. Në çast, ndjeu se po i përzihej. U ngrit menjëherë, nxitoi për te koshi i mbeturinave dhe ra në gjunjë. Pasi nxori gjithë ç'kish ngrënë pak më parë, fyti i digjte dhe nuk i kish mbetur më asgjë, veç dhimbjes dhe shijes së hidhur. Pështyu në kosh disa herë e më pas u ngrit teksa këmbët i dridheshin. Infermiere Joti iu afrua, i vuri dorën mbi supe, ndërsa fytyrën ia kish mbuluar një hije shqetësimi.

- Je mirë? - e pyeti ajo.

Klara fshiu buzët me kurrizin e dorës dhe iu përgjigj:

- Jo, nuk jam mirë.

- Je sëmurë? Të njoftoj mjekun?

Ajo tërhoqi pulovrin poshtë belit dhe u ul mbi krevat.

- Nuk jam sëmurë, - i tha me zë të ngjirur. - Jam shtatzënë.

Infermierja shtangu. Klara mbuloi fytyrën me duar, u zgjat përpara dhe mbështeti bërrylat mbi gjunjë. Supet po i dridheshin, ndërsa dihatjet i kish të shkurtra dhe të shpeshta.

Infermierja u ul në gjunjë pranë saj dhe me njërën dorë i fërkonte shpinën.

- Qetësohu, qetësohu, - i tha ajo. - Gjithçka do të shkojë mirë.

- Jo, - ia ktheu Klara. - Asgjë nuk do të shkojë mirë. Mjekët këtu duhet të më ndihmojnë, por si mund ta bëjnë kur s'ma vënë veshin? - tha dhe u shtri në krevat e u mbështoll me batanije. Infermiere Joti tërhoqi karrigen nga tryeza dhe u ul përballë saj.

- Më vjen shumë keq, - tha ajo. - Si mund të të ndihmoj?

- Vetëm po të më largosh nga ky vend para se të më çojnë në Uillard, përndryshe, nuk mund të bësh asgjë për mua.

- Më fal që po të pyes, - i tha infermierja, - po i ati i fëmijës ku është? E di ai? Jeni të lidhur?

Klara u ngrit dhe pa dashje, nga thellësia e shpirtit, i doli një

gjysmëbuzëqeshje e gjysmërënkim.

- Po, - i tha mes stërkalave të pështymës që i fluturuan nga goja. E dinte që infermierja nuk kishte faj, por s'e kontrollonte dot zemërimin. - Jemi të lidhur. Nuk e pe që erdhi mbrëmë për të më takuar? Ai është i gjatë, zeshkan dhe i pashëm. Kishte veshur kostumin e tij më të mirë. S'ka mundësi të mos e kesh parë, - tha teksa fliste me zë të lartë dhe këmbëngulës. Për një çast, shtangu dhe pyeti veten nëse po luante mendsh.

Infermierja e re kryqëzoi duart në prehër dhe uli sytë para se të fliste. Kur ngriti sërish vështrimin, sytë i qenë përlotur.

- Më dëgjo, - i tha me zë të butë. - Kam vetëm gjashtë muaj që punoj këtu. S'është puna ime ideale, por është puna e vetme që arrita të gjeja. Unë dhe i fejuari duam të martohemi sa më shpejt të jetë e mundur, por ai ka qenë pa punë dhe... - tha dhe ndaloi duke kafshuar buzën e sipërme, e luhatur nëse duhej të vazhdonte më tej. - Që kur të pashë për herë të parë, e kuptova se nuk ishe e çmendur. S'e di si, por thjesht e kuptova. Të lutem, mos i trego askujt, por kam përgjuar disa nga seancat që ke zhvilluar me doktor Thornin për t'u bindur mirë. Të dëgjova kur the se babai të kishte futur këtu, sepse nuk doje të martoheshe me njeriun që të kishte gjetur ai. Unë e di se si ndihesh në një situatë të tillë. Edhe im atë nuk e pëlqen të fejuarin tim, ndaj kam shumë nevojë për këtë punë. Po mundohem të kursej sa më shumë para për t'u martuar dhe për t'u larguar nga ajo shtëpi, sa më shpejt të mundem. Yt atë të mbylli këtu sepse je e dashuruar me dikë tjetër, apo jo? Me Bruno Moretin?

Klara u ngrit dhe i lëshoi këmbët në anë të shtratit.

- Nga e di emrin e tij? - e pyeti ajo. - S'ia kam treguar kurrë doktor Thornit.

Frymëmarrja e infermieres nisi të shpeshtohej, kraharori po ulej e po ngrihej gjithnjë e më shpejt.

- Duhet të më premtosh se nuk do t'i tregosh askujt, asnjë fjalë për këtë, - pëshpëriti ajo. - Po e mori vesh kush, do të humbas punën.

- Të premtoj, - i tha Klara e shushatur. - Thjesht më thuaj nga e di emrin e tij! Ka ardhur këtu? Ka ardhur të më kërkojë?

Infermierja hodhi vështrimin nga dera dhe më pas, u zgjat

përpara.

- Kam parë letrat, - mërmëriti ajo. - Letrat që i ke shkruar Brunos.

Klara tundi kokën e pështjelluar.

- Çfarë po thua? Si mund t'i kesh parë? Pasi i kam shkruar, i kam futur menjëherë në kutinë postare, përballë recepsionit.

Infermiere Joti mblodhi buzët, u ngrit më këmbë dhe filloi të ecte nëpër dhomë. Më pas, rroku pjesën e pasme të karriges dhe ia nguli sytë Klarës, fytyra e së cilës ishte bërë borë e bardhë.

- Letrat nuk janë postuar kurrë, - pëshpëriti ajo. - Infermiere MekKarni më detyroi të kontrolloja postën dalëse për t'i hequr ato. Më tha se kështu kishte urdhëruar mjeku. Dyshoj se kanë qenë urdhrat e babait tënd.

Krejt papritur, Klara nuk po merrte dot frymë. Qafa dhe fytyra dukej se po i merrnin flakë dhe një lëmsh në fyt e pengonte t'i nxirrte fjalët. S'ishte çudi që Brunoja nuk i ishte përgjigjur kurrë letrave të saj! U ngrit dhe tërhoqi karrigen nga tryeza, me gjunjët që i dridheshin. U ul në të, nxori kancelaritë nga sirtari, rrëmbeu një stilolaps dhe filloi të shkruante. Me gishtat që i dridheshin, mundohej të lidhte fjali logjike.

- Postoje këtë letër për mua, - i tha, duke folur dhe shkruar sa më shpejt që mundej. - Brunoja nuk e di ku jam apo ku po shkoj. Më premto se do të ma postosh këtë letër, - tha teksa përfundoi së shkruari letrën e shkurtër, të cilën e palosi dhe e futi në një zarf. Më pas, ia nguli sytë infermiere Jotit duke pritur miratimin e saj.

Infermierja shtrëngoi duart, shpatullat e imta i kish kërrusur dhe sytë i ishin përlotur.

- Nuk di ç'të të them, - tha ajo. - Po sikur të më kapin?

- Fshihe letrën, - i tha Klara. - Te reçipetat apo në të mbathura, s'ka rëndësi se ku. Fute në një vend ku askush të mos e shohë. Postoje kur të ikësh për në shtëpi. - Ajo e mbylli zarfin, shkarraviti adresën e Brunos në pjesën e përparme dhe ia dha infermieres.

Kjo e fundit ia nguli sytë letrës, duke kafshuar cepin e buzës. Papritmas, në korridor u dëgjuan zëra. Klara u ngrit dhe ia la letrën në duar. Ajo zbërtheu pjesën e sipërme të uniformës dhe e futi në reçipeta. Atë çast, dera e dhomës u hap dhe brenda hyri infermiere MekKarni me një tabaka me ushqim. Ajo ndaloi dhe

hodhi vështrimin nga valixhja e hapur mbi dysheme.

- Çfarë po ndodh këtu? - pyeti. - Pse s'e ke ndihmuar Klarën t'i bëjë gati rrobat?

Infermiere Joti u kthye nga ajo dhe buzëqeshi.

- Klara ishte e mërzitur dhe unë po mundohesha ta qetësoja, duke i thënë se mjekët dhe infermieret në Uillard janë shumë të mirë. Besoj se tani ndihet më mirë. Apo jo, Klara?

Infermieret e hodhën vështrimin nga Klara dhe po prisnin derisa ajo pohoi me kokë.

- Po, faleminderit! - tha dhe shkoi te komoja ku filloi të nxirrte rrobat e t'i paloste me kujdes duke i vendosur brenda valixhes. Papritmas, iu duk se këmbët po e lëshonin, si copa akulli që thuajse po shkriheshin e po formonin një pellg në dysheme. U ul në gjunjë, vendosi bluzat në valixhe dhe po mundohej të kontrollonte dridhjen e duarve.

Infermiere MekKarni lëshoi një psherëtimë të thellë.

- Infermiere Joti, - tha ajo, - kishe për detyrë të ndihmoje pacienten të bënte gati valixhen. Ti nuk je mjeke, mos e harro këtë. Përmbaju detyrës sate, përndryshe do të më detyrosh të të raportoj për mosbindje ndaj urdhrave.

- Si urdhëron, zonjë! - iu përgjigj Joti, duke marrë tabakanë me ushqim, të cilën e vendosi mbi tavolinë, dhe u kthye nga infermiere MekKarni. - Do të kujdesem që pacientja të mbarojë së paketuari plaçkat dhe të hajë para se të largohet.

Infermiere MekKarni e pa Klarën të ulej në gjunjë pranë valixhes, me buzë të rrudhura dhe sy të fikur. Klara ngriti shikimin dhe i dha një buzëqeshje të vakët. Më në fund, MekKarni bëri të largohej.

- Mos u vononi shumë, - tha ajo. - Zoti Glen dhe infermiere Mei po e mbarojnë drekën. Më pas, zotëria do të dalë të ndezë makinën, ndaj keni më pak se gjysmë ore për t'u bërë gati.

- Shumë mirë, - ia ktheu infermiere Joti. - Do të kujdesem që Klara të zbresë shumë shpejt te hyrja kryesore.

Sapo infermiere MekKarni u largua, Joti nxitoi për te dera.

- Do të kthehem shpejt, - i tha Klarës.

- Ku po shkon? - e pyeti Klara që u ngjeth e tëra nga frika. Po sikur t'ia jepte letrën doktor Thornit? Po sikur e gjitha kjo të

ishte një grackë?

- Ti nxito dhe mundohu të mbarosh me plaçkat, - i tha ajo. - Në fund, vish pallton dhe çizmet, por mos e mbyll valixhen. Do ta mbyllim kur të kthehem unë, - dhe doli duke e lënë Klarën vetëm në dhomë.

Pasi i futi edhe gjërat e fundit në valixhe, Klara veshi çizmet dhe pallton. U afrua te dritarja dhe zgjati kokën për të parë hyrjen kryesore. Nuk binte më dëborë dhe te rrugina pa zotin Glen duke pirë cigare. Tymi i saj dhe tymi i marmitës së makinës formonin një siluetë të errët, që i kujtonte skenën e një filmi. Por ky nuk ishte film dhe zoti Glen nuk ishte një hero që po mundohej të gjente një zgjidhje.

Klara u hodh përpjetë kur infermiere Joti hyri me vrull në dhomë, duke mbajtur në duar një batanije.

- Merre, - i tha dhe nxitoi drejt valixhes. - I thashë MekKarnit se të duhej një batanije e ngrohtë për rrugës. - U ul më gjunjë dhe e shpalosi. Letrat që Klara i kish shkruar Brunos, u hapërdanë brenda valixhes. - Mendova se do t'i doje me vete.

E shtangur, Klara mori njërën prej tyre. Joti ia rrëmbeu dhe e vuri bashkë me të tjerat, nën rrobat e saj.

- S'kemi kohë për këtë, - i tha duke dihatur. Uli kapakun e valixhes, e mbylli me çelës dhe e ngriti. - Ndoshta dikush në Uillard mund të t'i postojë.

Klara e përqafoi.

- Shumë faleminderit! - i tha ajo dhe nuk i mbajti dot lotët. Infermierja e nxori Klarën prej aty dhe e shoqëroi deri te dera, ku vajza e re pikasi sytë e saj të përlotur.

KAPITULLI 5



Izi

E shtuna e javës së parë të shkollës kish qenë e ngrohtë dhe e lagësht, ndërsa flladi i lehtë lëvizte vetëm degët më të larta të pemëve. Më poshtë, ajri nuk lëvizte fare. Teksa shkonte në punë, Izi ecte përgjatë një trotuari me hije dhe prekte me gishta gjethet e mështeknës mbi kokën e saj. Ishte mëngjes herët dhe një shtresë vese mbulonte ende gjethet e pemëve, që i bënte të dukeshin të freskëta e të njoma. Pegi dhe Herri kishin dalë nga shtëpia më herët se zakonisht, pasi ajo mezi priste të hapte valixhet e Uillardit. Izi u kish kërkuar ta bënte më këmbë rrugën për në magazinën e muzeut, në vend që të shkonte me ta me makinë. Ajo ish e lumtur që kish ecur dhe kish pasur ca minuta për vete. Java kish fluturuar dhe ditët kishin qenë të zëna me angazhimet e shkollës, detyrat e shtëpisë dhe orët e kaluara me prindërit kujdestarë. Në fakt, kish qenë një javë e vështirë.

Ditët e para, teksa orvatej të mësonte rrugën për në shkollë, kish shkuar me vonesë thuajse në të gjitha orët e mësimit. Në disa raste, kish kërkuar edhe ndihmë për të gjetur klasat dhe disa nga nxënësit shpeshherë e kishin orientuar gabim. Dukej se e kishin bërë qëllimisht dhe ajo nuk e kuptonte pse. Nuk u kishte bërë asgjë. Mundohej të shpërfillte mënyrën se si e trajtonin, duke pyetur veten nëse i trajtonin kështu të gjithë nxënësit e rinj apo nëse kishin diçka personale. Gjithsesi, kjo sjellje e lëndonte.

Orën e parë të fizkulturës, pasi më në fund kish mësuar se palestra ndodhej në një ndërtesë tjetër, që lidhej me mensën përmes një korridori të gjatë, në dhomën e zhveshjes së vajzave ishte varur një tabelë ku shkruhej se palestra ishte mbyllur përkohësisht për shkak të një problemi në sistemin hidraulik. Befas, kur dëgjoi të bërtiturat që vinin së largu dhe kërcitjen e atleteve mbi dyshemenë e drunjtë, që jehonte diku gjetkë në ndërtesë, iu mblodh një lëmsh në stomak. Ishte me vonesë. Psherëtiu dhe e mori kthesën me vrap, sa thuajse u përplas me një shoqen e Shenonit, e cila ishte ulur për të lidhur atletet jashtë dhomës së zhveshjes së djemve.

- Kujdes ku hedh këmbët! - i tha vajza, duke u mbajtur me njërën dorë.

- Më fal! Nuk të pashë, - i tha Izi dhe zgjati dorën ta ndihmonte të ngrihej, por kjo e fundit e shpërfilli dhe mbaroi së lidhuri atletet. *Si e ka emrin?* mendoi Izi. *Kristal? Nikola? Tina?*

Ndërkohë vajza u ngrit.

- Pse kaq me vrap? - e pyeti ajo, ndërkohë që pastronte gjunjët dhe pantallonat, e më pas, kaloi gishtat mes ballukeve me fije. Ashtu si modeli i Shenonit dhe i shumë vajzave të tjera në këtë shkollë, modeli i saj i flokëve ishte i këndshëm: flokë të shkallëzuar e të derdhur nga fundi - si modeli i personazhit të Rejçëllit në serialin televiziv "Friends". Pantallonat e shkurtra të bardha të fizkulturës i rrinin ngjitur pas trupit dhe shkronja "K" shkëlqente në bluzën e shkurtër dhe të gjerë. *Kristal, kështu quhej.*

- Doja të ndërrohesha për orën e fizkulturës, por... - i tha Izi.

- Duhet të përdorim dhomën e zhveshjes së djemve derisa ta rregullojnë sistemin hidraulik në dhomën tonë, - ia ktheu Kristali. - Bën mirë të nxitosh. Mësuese Suathardi na detyron të vrapojmë për çdo minutë që vonohemi.

- Po kur... - belbëzoi Izi.

Kristali tundi dorën në ajër.

- Mos u shqetëso, - i tha ajo. - Sistemi hidraulik prishet gjatë gjithë kohës, të paktën një herë në muaj. Djemtë nuk kanë palestër në dispozicion deri pas dreke.

Izi qëndronte si e ngrirë, duke u munduar të kuptonte se çfarë duhej të bënte.

- A do të më hapin telashe, nëse vesh pantofla me gisht dhe xhinse në palestër? - pyeti ajo.

Kristali qeshi dhe përpëliti sytë.

- Më beso, është më keq se të shkosh me vonesë, - tha dhe mbërtheu Izin për krahu dhe e tërhoqi drejt dhomës së zhveshjes. - Eja, është dhoma e vajzave. Do të të orientoj unë.

Izi pranoi që Kristali ta shoqëronte te dhoma e zhveshjes së djemve, por një çast, ndaloi e pasigurt në hyrje. Kristali hapi derën dhe u mbështet pas saj. Po e mbante hapur dhe po buzëqeshte, por Izi nuk lëvizi vendit.

- O Zot i madh! - tha. - Mos u bëj frikacake! Do të vij edhe unë me ty!

Izi mori frymë thellë. Nëse Kristali ish e gatshme të futej brenda, ndoshta nuk kishte ndonjë problem. Ajo e ndoqi në një korridor me tavan të lartë, që të çonte në një derë të dytë. Izit i shpoi hundët era e keqe e djersës dhe e urinës së ndenjur, ndërsa zhurma e dollapëve që përplaseshin, e dusheve dhe bisedat e njerëzve jehonin në mjediset e shtruara me çimento. Dëgjoheshin vetëm zëra meshkujsh. Izi ndali e habitur. Para se të kthehej dhe t'ia fuste vrapit, Kristali e mbërtheu nga dora dhe hapi me vrull derën e dytë. Shenoni dhe Nikola po i prisnin në anën tjetër. Të tria vajzat e mbërthyen Izin dhe e tërhoqën me zor në dhomën e zhveshjes së djemve, duke i zhvatur rrobat, shkulur flokët dhe me thonjtë e lyer me manikyr e gërvishtën nëpër krahë. Dhoma me avull ishte plot me djem lakuriq dhe gjysmë të zhveshur. Kur panë vajzat, nisën të qeshnin e të fishkëllenin, duke i fluturuar në ajër peshqirët e njomë e duke kërcyer sipër stolave. Izi e mbante kokën ulur dhe mundohej të shmangej, por më kot. Në këtë betejë, humbi një nga pantoflat dhe çanta me rrobat e fizkulturës i ra përdhe.

Vajzat e tërhoqën me zor përmes dhomës së zhveshjes dhe e çuan te dushet. Pasi shkuan aty, e shtynë përpara dhe ia mbathën me vrap. Izi, ashtu këmbëzbathur siç ishte, rrëshqiti në dyshemenë e njomë dhe gati sa nuk ra. Një dorë e lagur e mbërtheu në krah që të mos binte. Kur ngriti sytë, pa Etanin që qëndronte pranë saj, me flokët ngjeshur pas ballit, që i kullonin pikë-pikë, me kraharorin e zhveshur e të mbuluar me shkumë. Ajo i hodhi një

vështrim, e shtangur si një dre nga dritat verbuese të makinës, e më pas u largua nga dhoma e dusheve duke u penguar.

Me faqet e përflakura mori rrugën drejt dhomës së zhveshjes, kapi pantoflën dhe rrobat e fizkulturës, duke mos ia ndarë sytë dyshemesë. Djemtë thërrisnin dhe fishkëllenin, duke e pyetur nëse i kish pëlqyer ndonjë gjë nga ato që kish parë. Kur një rrip i njomë e goditi paksa në mes të kraharorit, ajo ndaloi dhe ua nguli sytë djemve.

- Fëmijët për të cilët jam kujdesur, e kanë pasur bibilushin më të madh se tuajin, - u tha me zë të ashpër. Djemtë qeshën dhe ia bënë me dorë.

Kur doli nga dhoma e zhveshjes, me njërën këmbë të xhinseve të lagur dhe këmishën të grisur në mëngë, Shenoni dhe shoqet e saj po e prisnin në korridor.

E tërbuar, Izi mblodhi grushtet, gati për t'u dhënë një mësim të mirë, por e dinte se nuk ia vlente.

- Mos u zemëro, - i thirri Shenoni nga pas. - Ishte thjesht shaka. Ua bëjmë të gjitha nxënëseve të reja.

Duke i mallkuar të gjitha nën zë dhe duke sharë veten që i zuri besë Kristalit, vazhdoi rrugën derisa mbërriti te zyra e drejtorit. Drejtori i tha se do t'i kërkonte mësueses së lëndës së edukatës që për mbledhjen e ardhshme të përgatiste një material për ngacmimet në shkollë dhe, nëse Izi do të ndihej sërish e kërcënuar, mund t'i drejtohej psikologes së shkollës. Kur ai e pyeti për emrat e personave që e ngacmuan, ajo nuk pranoi t'ia tregonte. Nëse drejtori merrte në pyetje Shenonin dhe shoqet e saj, atëherë jeta do t'i kthehej në ferr. Donte që ta informonte për atë çka ndodhte në shkollën e tij, por nuk ndihej ende gati që, për të bërë ai detyrën, atë ta tregonin me gisht si spiune. Atë mbrëmje, vonë, mezi e përmbajti veten që të mos hynte në tualetin e Herrit dhe Pegit për të kërkuar një brisk.

Si të mos mjaftonte incidenti me djemtë, një ditë tjetër, ajo kapi Shenonin dhe Kristalin duke i ndotur derën e raftit me salcë domatesh. Kur vajzat panë Izin të vinte, u sulën turravrap në drejtim të kundërt, por në fund të korridorit i priste Etani, vetullvrenjtur e me buzë të mbledhura. Kur pa Izin, ndjeu fytyrën t'i skuqej nga turpi. Por sapo Shenoni dhe Kristali iu afruan, ai

u kthye dhe ia krisi vrapit, me një shishe keçapi bosh në dorë. Me sa dukej, edhe ai ishte po aq i keq sa të tjerët. Nuk e kish dëgjuar të nxirrte ndonjë fjalë nga goja, por e qeshura e tij dhe fakti që e kish ndihmuar të mos rrëzohej në dush, e kishin bërë të mendonte se ishte ndryshe. Për arsye që nuk i shpjegonte dot, u zemërua me veten dhe u trishtua, pasi kuptoi se ishte gabuar.

Tani që e mendonte, zemra i rrihte fort dhe ndiente se në grykë i ishte mbledhur një lëmsh mllefi. Duhej të bënte patjetër diçka për t'i dhënë fund ngacmimeve të Shenonit, por çfarë? Dhe si? Dukej sheshit se në shkollë ajo bënte ligjin dhe askush nuk guxonte të përballej me të. Izi kish parë se nëpër korridore vajzat e tjera rrinin gjithmonë pas grupit të Shenonit, ecnin sa më larg, edhe pse ishin vonë për në mësim. Nëse korridoret ishin plot dhe nuk kish asnjë mënyrë për ta shmangur Shenonin, disa nga vajzat ktheheshin mbrapsht dhe ecnin në drejtimin tjetër. Ata që nuk qeshnin dhe nuk brohoritnin kur Shenoni dhe shoqet e saj i punonin rrengje ndonjë nxënësi, shmangnin shikimet ose vështronin gjithë siklet, në vend që të mbështesnin viktimat. Izi nuk mund ta kuptonte se si një person mund të kishte kaq shumë pushtet mbi të tjerët. Kjo ia sillte zorrët në gojë.

Të shkonte e t'u tregonte prindërve kujdestarë se çfarë i kish ndodhur, nuk ishte zgjidhja e duhur. Shumë herë, i kish parë ata të përfshiheshin keq në problemet e bullizmit. Prindërit, të xhindosur që dikush s'e linte rehat fëmijën e tyre, u drejtoheshin mësuesve dhe këshillit të shkollës, duke kërcënuar këdo që u dilte përpara. Nga frika se mos i hidhnin në gjyq, meqë një nxënës akuzohej për ngacmim, mësuesit dhe këshilli i shkollës nuk bënin asgjë. Pastaj, fëmija i ngacmuar do të paguante ngaqë u kishte treguar të rriturve. Ngacamanët, pavarësisht gjithçkaje, gjejnë gjithnjë një mënyrë për të piketuar viktimat e tyre. Atë do ta ngacmonin më keq, nëse u tregonte prindërve kujdestarë dhe këta të fundit do të bisedonin me drejtorin e shkollës. Duhej ta gjente vetë një mënyrë se si të shpëtonte prej Shenonit. Përveç kësaj, ajo kish mësuar t'i dilte për zot vetes qysh në moshën dhjetëvjeçare dhe as që i shkonte ndër mend të mbështetej te dikush tjetër.

Izi ngadalësoi hapat në trotuar. Teksa mendonte për Shenonin, ndjeu një shtrëngim të fortë dhe të keq në brinjë, sikur një bishë

t'ia kish mbërthyer kraharorin me kthetra. E urrente lëmshin që i mblidhej në stomak, dhimbjen e fortë dhe të pareshtur në nofulla. Befas, pamja iu turbullua e gjitha. Ndaloi së ecuri dhe po i jepte kurajë vetes që të mbushej me frymë. Duhej të çlirohej nga mllefi dhe mërzia para se të humbiste kontrollin, siç kish ndodhur me nënën e saj. Mori frymë thellë dhe hodhi sytë përreth për t'u siguruar se nuk e kish parë askush të ndalonte në mes të trotuarit pa asnjë arsye. Ishte e sigurt që mund të dukej si një e çmendur.

Matanë rrugës i zunë sytë një dyqan. Mblodhi duart grusht, duke u munduar të mposhtte tundimin për të vrapuar drejt tij e për të blerë një pako me brisqe. Vazhdoi të ecte përpara, hapi pëllëmbët dhe numëroi deri në dhjetë. I zhduku mendimet e këqija nga mendja, e vendosur që të mos lejonte askënd ta kthente pas, drejt atij vendi të errët e të shkretë, ku çlirimi i vetëm ishte dhembja e saj më e madhe.

Më në fund, Izi mbërriti në magazinë. Pegi po e priste, me sy të zgurdulluar dhe po fliste me një shpejtësi marramendëse. Flokët kaçurrelë në ngjyrë kafe i kish mbledhur në një lëmsh të vërtetë në majë të kokës, kish veshur sandale, një fund të gjatë me lule dhe një bluzë pa mëngë të Herrit. Në anën tjetër të magazinës, Herri fliste dhe qeshte, me duar e këmbë, me një grup burrash dhe grash.

Pegi i tregoi Izit, të rreshtuara nëpër tavolina, 427 valixhet dhe sëndukët e Uillardit, që prisnin të hapeshin dhe të nxirrnin në shesh gjithë ç'kishin brenda. Thuajse pa frymë nga emocionet, ajo i dha Izit një bllok të trashë lëkure.

- Këtu dua të shkruash emrat e pronarëve të valixheve, - i tha. - Më pas, unë do t'i hap dhe do të të them se çfarë kanë brenda. Duhet të regjistrojmë gjithçka, madje, edhe detajet më të vogla.

- Mirë, - iu përgjigj Izi. - Duket shumë e thjeshtë.

- Ne do të regjistrojmë gjysmat, ndërkohë që gjysmën tjetër do ta bëjë Herri me ekipin e tij.

Atë çast, Herri po vinte drejt tyre me dy persona të tjerë. Njëri ishte i gjatë, i dobët, me flokë të verdhë e të rrallë dhe syze me skelet argjendi. Si zakonisht, ishte veshur në mënyrë të përsosur, me një këmishë me vija dhe pantallona të zeza. Pranë tij, qëndronte një burrë trupmadh, me mjekër gri, para të cilit

Herri dukej si fëmijë. Izin e lanë gojëhapur përmasat e gjigantit që po ecte drejt saj, me fytyrë të gjerë e të kuqe, e këmbët si trung peme. Kurrë nuk kish parë njeri më të madh. Aparati fotografik që ai mbante në dorë, dukej si lodër. Më pas, vuri re personin që ecte përkrah gjigantit. Në duar po mbante ca çanta, një këmbalec me tri këmbë dhe kish flokë të zinj si korb. Izi ndjeu gjakun t'i ndizte flakë mollëzat.

Ishte Etani.

- Ky është miku ynë Piteri dhe djali i tij, Etani, - i tha Herri Izit. - Kanë ardhur për të bërë fotografi.

- Kjo është asistentja ime, Izabela, - u tha Pegi. Ne e quajmë Izi.

Piteri buzëqeshi dhe i rrëmbeu dorën Izit, ndërsa gishtat e saj të hollë u zhdukën brenda dorashkave të mëdha. Etani i rroku dorën Pegit, pastaj i buzëqeshi dhe përshëndeti Izin. Kjo e fundit e përshëndeti me kokë dhe uli sytë përdhe, tek atletet e saj të vjetra dhe xhinset e gjera. Pegi i kish thënë të vishte rroba pune, veshje të vjetra që, edhe nëse dëmtoheshin, nuk kish problem. Tani, po vuante përbrenda, po ziente nga inati që s'kish veshur një këmishë shumëngjyrëshe, në vend të bluzës me mëngë të gjata me figurën e grupit muzikor "New kids on the block", në të cilën shkruhej "Unë e dua Xhordanin". Këtë bluzë e kishte që në vit të dytë dhe zakonisht e vishte për të fjetur. Jo vetëm që kish veshur rroba të shëmtuara e të dala mode, por kish menduar të mos bënte as dush para se të nisej për në punë. Flokët i kish kapur bisht dhe disa fije të yndyrosura i vareshin mbi sytë pa makijazh. Sakaq, filloi të imagjinonte se si do ta tallnin në shkollë.

Piteri dhe Etani po ecnin pranë Pegit dhe Izit, drejt njërës anë të magazinës, ndërkohë që Herri u nis nga ana tjetër. Fatmirësisht, trupi gjigant i Piterit ngrihej si digë mes Izit dhe Etanit, aq sa mund të pretendonte se Etani nuk ishte aty. Gjatë atyre çasteve të shkurtra, pati mundësinë të merrte frymë thellë, duke u lutur që qafa dhe fytyra, të bëra flakë, të merrnin ngjyrën e tyre normale.

Kur mbërritën pranë valixhes së parë - me lëkurë të prishur, me një dorezë kafe dhe tokëz metalike - Etani montoi këmbalecin dhe nxori nga çanta e shpinës një elektrik dore. Pegi dhe Izi qëndruan pas, teksa Piteri shkrepi disa foto. Izi qortonte veten në

heshtje, e paaftë për t'i hequr sytë nga trupi muskulor i Etanit. Ai kish veshur një palë këpucë serioze të zeza dhe xhinse të ngushta, ndërsa bicepsët e gjerë kishin tendosur mëngët e përveshura të këmishës së bardhë me kopsa. Në mendje iu shfaq një imazh: trupi i tij i nxirë e muskulor, lakuriq, i lagur, me ujin që i rridhte gjithandej në dhomën e dusheve të djemve. *Pse duhet të vijë këtu?,* mendoi ajo. *Pse duhet të jetë kaq simpatik?* Më pas, i erdhi ndër mend imazhi i tij me një shishe keçapi në dorë, duke ia mbathur bashkë me të dashurën, si një djalë kopshti që e kapin me presh në duar duke futur macen në tualet. Sado i bukur të ishte nga jashtë, ai ishte i shëmtuar nga brenda. Këtë nuk mund ta ndryshonin dot as gjithë muskujt e botës.

Më në fund, Pegi iu afrua valixhes dhe lexoi me zë të lartë etiketën mbi të, duke shqiptuar emrin dhe mbiemrin që Izi ta mbante shënim - *Madalena Smoll*. Pastaj, mori frymë thellë, veshi një palë doreza plastike dhe ngadalë e me kujdes hapi tokëzën e më pas valixhen. Piteri u afrua të bënte fotografi para se përmbajtja e valixhes të trazohej, duke i lënë Izin dhe Etanin përkrah njëri-tjetrit. Izi, me bisht të syrit, vuri re se Etani po e shikonte, ndërsa ajo i mbante sytë drejt.

Me shumë kujdes, Pegi nisi të nxirrte nga valixhja një nga një sendet delikate, kurse Izi shënonte se çfarë ishin.

> *Një Bibël me tri fotografi bardhë e zi të futura brenda saj; fotoja e një djali të vogël me këmishë të bardhë dhe pantallona të errëta, prapa së cilës ishte shkruar me laps: "Çarlsi - 1919"; fotoja e një vajze të vogël me fustan me rrudha dhe kapelë me lule, prapa së cilës ishte shkruar me laps: "Ester - 1921"; fotoja e një gruaje të moshuar me përparëse, që qëndronte në verandë, prapa së cilës ishte shkruar: "Mamaja - Shtëpiza e verimit, 1927". Katër enë të argjendta kuzhine. Dy kapuça fëmijësh të punuar me shtiza, njëri me fjongo ngjyrë rozë dhe tjetri me fjongo blu. Gjendja: të zverdhur dhe me njolla. Një palë papuçe fëmijësh të qëndisura me ngjyrë të bardhë. Gjendja: e mirë.*

Izi priste që Pegi të vazhdonte, por brenda valixhes nuk kishte më asgjë, asnjë veshje apo këmishë nate, asnjë letër apo sende të tjera personale.

- Kaq ishin, - tha Pegi, me sytë që i ndriçonin. Ajo mblodhi supet dhe i hodhi një vështrim Izit, Piterit dhe Etanit.

- Për ç'arsye mund të marrë dikush me vete veshje fëmijësh në një çmendinë? - pyeti Izi.

- Nuk e di, - u përgjigj Pegi. - Ndoshta kanë qenë të fëmijëve të saj. Ndoshta kanë qenë e vetmja gjë e rëndësishme për të. E kupton? Për këtë po përpiqemi. Të mësojmë diçka për personat që kanë lënë valixhet këtu.

- Por sa? - pyeti Etani. - Sa mund të zbulosh duke parë se çfarë kanë ato brenda?

- Shpresojmë që të na lënë të studiojmë edhe disa nga kartelat mjekësore, - u përgjigj Pegi. - Tani për tani, ato janë të mbyllura, por ne do të zgjedhim rastet më interesante dhe do t'i kërkojmë leje Zyrës së Shëndetit Mendor që të na lejojë të zbulojmë diçka më shumë.

- Dëshiron t'i fotografoj sendet veç e veç apo në grup? - e pyeti Piteri.

Pegi po qëndronte me duart në prehër dhe po mendohej.

- Besoj se varet nga numri i sendeve që ndodhen në valixheve. Për shembull, sendet e kësaj mund t'i fotografojmë të gjitha bashkë.

Etani nxori një copë të zezë nga çanta dhe e shtroi përpara valixhes. Pastaj, montoi edhe një këmbalec për të përdorur një dritë tjetër, kurse Pegi i dha Izit një palë doreza plastike dhe i kërkoi ta ndihmonte që të sistemonte mbi copën e zezë kapuçat, fotot dhe enët prej argjendi. Izi e falënderoi për dorezat dhe filloi të kapte me kujdes sendet delikate. Dëshironte të kishte një maskë, si ajo që Pegi përdorte ngaherë kur restauronte pikturat apo pastronte ndonjë artefakt të vjetër. Ndoshta mund të ishte budallallëk, por nuk donte të thithte pluhurin që ishte mbledhur aty për dekada të tëra, apo të ndiente erën e kalbësirës që dilte nga valixhja dhe rrobat e zverdhura të fëmijëve. Era e rëndë dhe e fortë, si dhe aroma e vdekjes, i kujtoi varret e vjetra dhe dhomën e mbyllur të prindërve.

Në muze, sendet antike ekspozoheshin në piedestalë apo vitrina xhami dhe nuk duhej t'i prekje. Por këtu ndryshonte puna. Si një arkeologe që i përkushtohet gërmimit, ajo mbante në dorë

sende që nuk i kish prekur njeri tjetër për dekada të tëra. Po jepte ndihmën e saj në zbulimin e sekreteve të groposura, duke i prekur vetë ato që dikur u përkisnin disa njerëzve, prej të cilëve nuk kish mbetur asgjë, veç disa eshtrave të kalbura nën tokë. Për të mos përmendur që pronari i këtyre sendeve ishte i çmendur. E dinte që ishte një marrëzi, por filloi të imagjinonte grimca mikroskopike të kapuçave dhe enëve të argjendta të kuzhinës, që pluskonin në ajër dhe i hynin në mushkëri e në sistemin e qarkullimit të gjakut, duke nisur kështu një reaksion zinxhir psikotik dhe, kur molekulat e dëmtuara të arrinin në tru, do të vulosnin fatin e saj të ngjashëm me atë të së ëmës. Filloi të ndihej e trullosur dhe po mundohej të mos merrte frymë thellë, me shpresën se dita do të fluturonte shpejt dhe do të kthehej në shtëpi e do të bënte një dush.

Ndërkaq, Pegi dhe Izi përfunduan së sistemuari sendet. Më pas, Piteri dhe Etani nisën të bënin foto. Ato qëndruan mënjanë, duke pritur që Piteri t'u thoshte nëse duhej t'ua ndryshonin vendin sendeve. Të katërt punonin në heshtje dhe qëndronin mbi kapuçat e fëmijëve, mbi sendet e argjendit, mbi fotografitë dhe Biblën, si një ekip kirurgësh dhe infermieresh mbi tryezën e operacionit. Meqë Pegi mbeti e kënaqur me fotot e Piterit, ajo dhe Izi i futën sërish me kujdes sendet brenda valixhes, mbyllën kapakun dhe vazhduan me valixhen tjetër.

Pasi kjo gjë u përsërit edhe për katër valixhet e tjera, Izi u bë më e vetëdijshme për çdo lëvizje dhe frymëmarrje, çdo pozicion duarsh dhe këmbësh. Ndiente shikimet e Etanit dhe mund të nuhaste kolonjën mashkullore, aromën e fortë të drurit që i kujtonte se ata ishin të rinj dhe kishin një rrugë të gjatë përpara, para se të ndaheshin nga jeta. Dëshironte të qëndronte pranë tij, donte të nuhaste aromën e tij dhe jo erën e rëndë që vinte nga valixhet. Ndonjëherë, i cekte krahun pa dashje ose i zinte rrugën dhe ai i buzëqeshte vesh më vesh. Ajo e shpërfillte dhe hidhte vështrimin diku tjetër, e xhindosur që fytyra i ndizej flakë. Çfarë kishte ai që e bënte të ndihej aq e dobët, e luhatur dhe e pambrojtur?

Fluturat në stomak i kujtonin mënyrën se si ndihej kur fliste me punonjësin social. Por këtë herë, ndryshonte puna. Etani nuk dinte asgjë për të. Nuk dinte asgjë për të shkuarën e saj, të tashmen, proceset gjyqësore dhe udhëtimet, për shpresat dhe

ëndrrat e saj. Dhe nuk kishte për ta marrë vesh kurrë. Ai ishte një provokues i keq, si e dashura e tij. Izi nuk donte të kishte asnjë lidhje me të. Duhej ta mblidhte veten, veçanërisht pse kishin edhe dyqind valixhe të tjera për të kontrolluar. Të qenët pranë Etanit dhe sikleti që ndiente se po merrej me sendet personale të personave të çmendur dhe të vdekur, e bënë t'i vinte fre çdo mendimi. Vëmendja iu përqendrua në çdo lëvizje përreth.

Brenda valixheve kishte letra, fotografi, artikuj prej argjendi, Bibla, tiranda, orë me zile, kopsa, këpucë, shami të qëndisura, bardhakë rroje, një statujë qeni, një filxhan porcelani dhe një jorgan të bërë vetë. Izi s'linte send pa shënuar, duke kapsallitur herë pas here sytë nga lagështia që i mjegullonte shikimin. Nuk mund të mos imagjinonte dot prindërit, bashkëshortët dhe fëmijët e pronarëve të valixheve, që vajtonin të dëshpëruar mungesën e njerëzve të dashur, edhe pse ekzistonin ende fizikisht në këtë botë. Sa e vështirë mund të ketë qenë të gjendej se ku qëndronte problemi, të qëndronin zgjuar për net të tëra duke vrarë mendjen nëse mund të bënin vërtet diçka. Pyeste veten nëse njerëzit e dashur të të shtruarve në Uillard ishin shokuar nga sëmundja e pjesëtarëve të tyre të familjes apo e kishin kuptuar që në fillim. Në çdo rast, mendimi i jetëve të humbura - i festave familjare, Krishtlindjeve, ditëlindjeve, dashurive, përrallave para gjumit, martesave dhe diplomimeve - për shkak të një dështimi apo kaosi të pashpjeguar brenda trurit të një personi, bëri që në kraharor të ndiente ca shtrëngime. Nuk ishte e drejtë.

Erdhi mesdita dhe ata kishin kontrolluar vetëm pesëmbëdhjetë valixhe. Izi po fillonte të kuptonte se projekti do të zgjaste më shumë nga ç'e kishte parashikuar. Me këto ritme, do të punonte përkrah Etanit për gjashtë apo shtatë ditë. Mos ndoshta do të binte më shumë në sy, po të kërkonte që të ndihmonte Herrin? Vetëm mendimi se do të kalonte më shumë kohë me Etanin, e bëri që të pushtohej nga emocione që e rrëqethën të tërën. Duke qenë kaq pranë tij, ndihej sikur nuk kish futur gjë në gojë apo nuk kish vënë gjumë në sy për ditë të tëra. Këmbët nuk i mbanin dhe kokën e ndiente të trullosur. Ishte rraskapitëse, e mërzitshme dhe e mrekullueshme në të njëjtën kohë. *Ç'po më ndodh kështu?* mendoi ajo.

Fatmirësisht, kur erdhi ora e pushimit, Pegi pyeti Izin nëse

donte të ulej jashtë për të ngrënë drekë. Ajo kish mbushur një shportë me sanduiçë dhe ata mund të hanin nën hijen e pemëve të lisit, në barin e kositur pranë parkingut. Piteri, Etani dhe pjesa tjetër do të shkonin te "fast-food"-i më i afërt për të ngrënë hamburger e për të pirë lëng frutash me qumësht. Edhe Izi dëshironte të shkonte me ta, sepse në shtëpinë e prindërve kujdestarë, të haje jashtë ishte një ngjarje e rrallë, madje, edhe kur bëhej fjalë për "fast-food"-e. Por këtë herë, ndihej e çliruar që nuk kishte shkuar, pasi kështu do të gjente pak paqe dhe qetësi, pak hapësirë dhe kohë larg Etanit. Më pas, dëgjoi Pegin tek fliste me të tjerët dhe befas ndjeu një shtrëngim.

- Oh, jo! - tha Pegi. - Kam marrë me vete ushqim të mjaftueshëm për të gjithë. Kam marrë sanduiçë me proshutë dhe djathë, sallatë me makarona, humus, pite, patate të skuqura, shalqi, çaj të ftohtë dhe limonadë. Në bagazhin e makinës kam batanije të tjera dhe karrige portative. Ejani, se do të kënaqemi!

- Më falni, o njerëz, - tha Herri duke qeshur. - Sime shoqeje i pëlqen të përgatitë ushqim për të tjerët.

Të gjithë qeshën dhe pranuan të qëndronin. U drejtuan nga makina e Pegit për të shkarkuar karriget, ndërsa ajo u kthye aty ku qëndronte Izi.

- Mund të më ndihmosh me ushqimet? - e pyeti.

- Sigurisht, - i tha Izi që po vuante përbrenda.

Lëre Pegin të kujdeset për të gjithë, mendoi. *Mirë që duhej të punonte me Etanin, por tani duhej edhe të hante drekë me të?* Disa minuta para se të nisnin pushimin, e kish marrë uria aq shumë, saqë të gjithë mund ta dëgjonin zhurmën që po i bënte stomaku. Por tani e ndiente të turbulluar nga një përzierje e çuditshme ngazëllimi dhe frike.

Të gjithë u mblodhën poshtë ca lisave me trungje të trasha. Burrat po sistemonin karriget portative, kurse Pegi dhe Izi po shtronin një batanije dhe po sistemonin ushqimin në një tavolinë. Burrat u rreshtuan teksa Pegi u mbushte gotat dhe shpërndante sallatën me makarona nëpër pjata plastike, ndërkohë që Izi nxirrte sanduiçët nga shporta dhe ndante patatet e skuqura. Kur pa Etanin në rresht, bëri sikur ishte e përqendruar te puna e saj, me shpresën se ai do të ulej më tutje. I dha sanduiçin dhe u shtir

sikur po kërkonte në çantën e ushqimeve një qese patatinash, por ndjeu se gishtat e tij cekën të sajët. Fillimisht e shpërfilli, por më pas i zgjati edhe atij një qese. Ai kapi qesen dhe dorën e saj njëkohësisht, duke i thërrmuar patatinat mes gishtave të tyre. Izi ngriti sytë.

- Oh, më fal! - i tha ai duke qeshur. - Është e vështirë të shikosh, kur nuk e ke mendjen. - Teksa ajo u mundua të largohej, ai nuk e lëshoi. - Faleminderit për sanduiçin dhe patatinat.

Ajo zgurdulloi sytë dhe ia ktheu:

- Mund të ma lëshosh dorën?

- Faleminderit që më shërbeve duke buzëqeshur!

- Po më vonon për të shpërndarë ushqimin.

- Mund të thuash "Të lutem, largohu!" - i tha ai.

Ajo e pickoi mbi kurrizin e dorës.

- Të lutem, largohu, - i tha gjithë sarkazëm. Ai e lëshoi dhe kapi patatinat.

- Mund të thuash "S'ka përse!" - shtoi ai.

Izi e shpërfilli dhe i buzëqeshi personit tjetër në radhë.

- Pse atij i buzëqeshe, ndërsa mua jo? - e pyeti Etani dhe ajo i dha një buzëqeshje të vakët, që ai ta linte të qetë. - Kështu po, - tha. - Tani do të më shijojë dreka.

Sapo Etani u largua, Izi psherëtiu dhe u mundua të përqendrohej te të tjerët që qëndronin në rresht, por zemra i rrihte fort në kraharor. Nuk kish njohur njeri më arrogant se ai. I dukej e pabesueshme që e kish nervozuar aq shumë.

Më vonë, kur të gjithë kishin mbaruar së ngrëni, Izi u ul këmbëkryq mbi batanije, poshtë një lisi, duke cimbisur një pite, ndërsa Pegi s'po linte njeri pa i mbushur gotat. Etani ishte ulur në një karrige portative, disa metra më larg, duke folur e qeshur me Piterin dhe Herrin. Herë pas here, hidhte sytë drejt saj dhe e kapte duke e vështruar. Sa herë që ajo betohej se nuk do ta shihte më, tërhiqej nga tingulli i zërit të trashë dhe e qeshura e tij. Do të donte të kish marrë me vete një revistë apo libër për të lexuar, çfarëdo që të ishte, vetëm që të dukej se po bënte diçka dhe nuk po shkonte kohën kot. Pasi shpërndau ushqimin, qëndroi për një kohë të gjatë në tualet, duke larë duart e duke rregulluar flokët, me shpresën se të tjerët do të kishin përfunduar së ngrëni kur

të dilte prej andej. Përkundrazi, Pegi po u ofronte sërish për të ngrënë, duke qeshur dhe duke iu lutur që të hanin më shumë, sepse nuk donte ta çonte dëm gjithë atë ushqim.

Teksa ajo po përfundonte së shpërndari çajin e ftohtë dhe limonadën, Izi u ul në gjunjë mbi batanije dhe filloi të mblidhte tasat dhe pecetat e mbetura. Po merrej me çfarë të mundej, që ky piknik i mërzitshëm të mbaronte sa më shpejt. Pegi u kthye dhe u ul pranë saj. U mbështet te lëvorja me gunga e lisit, psherëtiu dhe fshiu ballin me dorë.

- Kaluam shumë mirë, - tha. - Më pëlqejnë shumë piknikët, po ty?

- Ëhë, - ia ktheu Izi.

- O Zot, sa i lezetshëm është ai djalë! - tha Pegi. - Nuk të duket edhe ty?

Izi u zgjat të kapte kanat bosh prej kauçuku dhe e pyeti:

- Kush?

Pegi qeshi.

- E di mirë se për kë e kam fjalën. Etani.

Izi mblodhi supet dhe i vendosi kanat në shportë.

- Besoj se po.

- Kemi vite që i njohim prindërit e tij, - tha Pegi. - Janë njerëz të mrekullueshëm.

- Sa keq që kanë një fëmijë idiot, - u përgjigj Izi, duke mbledhur qeset bosh të patatinave, të cilat bëri t'i hidhte në koshin e mbeturinave.

- Kush është idiot? - u dëgjua një zë i trashë nga pas. Izi u kthye dhe pa Etanin që qëndronte pranë tyre. Me njërën dorë kish kapur një degë mbi kokën e tij dhe tjetrën e kish futur në xhepin e xhinseve. Ai i shkeli syrin, ndërsa Izi donte të ngrihej dhe t'ia zhdukte nga fytyra atë buzëqeshje vetëkënaqësie.

Pegi i bëri Etanit pak vend në batanije dhe i tha:

- Ulu këtu, - duke i treguar me dorë vendin bosh mes saj dhe Izit. - Ulu. Kemi edhe ca minuta kohë para se t'i përvishemi sërish punës.

Teksa Izi hodhi një dorë plot me peceta të pista në qesen e mbeturinave, mendonte: *Ç'dreqin bën kështu? Meqë ty të pëlqejnë prindërit e tij, s'është e thënë se unë duhet të miqësohem me të.*

- S'ka problem, zonja Berrous, - i tha Etani. - Nuk doja t'ju ndërprisja.

Zonja Berrous? Uf, çfarë idioti!

- Jo, nuk na ndërpreve, - ia ktheu Pegi. - Thjesht po i thosha Izit se prindërit e tu janë njerëz fantastikë. I thashë që i kemi miq të ngushtë.

- Atëherë, i bie që unë jam idioti, - tha Etani duke qeshur.

- Oh, jo! - psherëtiu Pegi që u ngrit me sy të zgurdulluar e duke tundur dorën, si ta fshinte komentin e saj në ajër. - Nuk është...

- Mos u shqetëso, - i tha Izi Pegit. - S'ke pse më mbron, - dhe rrëmbeu pirunët e pisët e thikën e shalqirit, i mbështolli me një pecetë letre dhe i futi në shportën e piknikut, mes tasave dhe kanave prej kauçuku. Ndjeu dhimbje, si një pickim i fortë, kur tehu i thikës së shalqirit i preku gishtin. E nxori dorën rrëmbimthi nga shporta, pa prerjen dhe gjunjët iu prenë. E vuri gishtin mes buzëve, ndërsa shija e gjakut i mbushi gojën. Më pas, u ul mbi batanije, mbylli sytë, duke pritur që t'i merreshin mendtë e të trullosej, derisa të binte përdhe.

- Çfarë ke? - e pyeti Pegi. - U preve?

Izi pohoi me kokë dhe mbërtheu me dorën tjetër një cep të batanijes, duke u munduar të mbahej pas diçkaje, teksa bota i vinte vërdallë. Më pas, ndjeu një prekje në kyçin e dorës dhe hapi sytë. Etani, i ulur në gjunjë pranë saj, po i hiqte me kujdes gishtin nga goja.

- Më lër t'i hedh një sy, - i tha ai. Tepër e dobët për ta kundërshtuar, Izi e lejoi që ta shikonte. Gishtërinjtë dhe pëllëmba e tij ishin të ngrohta dhe të buta si mëndafshi, tamam si pushi i butë i një këlyshi që fle. Ndjesia e marramendjes nisi të venitej dhe zemra t'i rrihte normalisht. - Është e thellë, por s'është asgjë serioze, - tha ai dhe pa nga Pegi. - Ke ndonjë ankeplast ose fashë?

- Po marr kutinë e ndihmës së shpejtë, - tha Pegi, duke u ngritur më këmbë.

- Jam shumë mirë, - u tha Izi, duke tërhequr dorën. - Vërtet. - Por tashmë ishte tepër vonë. Pegi kish vajtur në gjysmë të rrugës dhe, teksa vraponte, fundi i saj me lule formonte dallgë nga pas.

- Nuk dukesh fare mirë, - tha Etani dhe mori një pecetë të pastër nga bobina. - Je zbardhur krejt në fytyrë.

- Kështu e kam ngjyrën e lëkurës, - tha ajo, me grushtin e mbledhur mbi stomak.

- Më paske mashtruar, - i tha Etani. - Mendoja se lëkura jote ishte e kuqe, - dhe u mundua t'ia kapte sërish dorën, por ajo e hoqi me vrull.

- Ha-ha, - ia bëri ajo. - Më shkrive së qeshuri.

- Vëre këtë rreth gishtit për të ndaluar rrjedhjen e gjakut, - i tha Etani, duke i dhënë pecetën e letrës. E mori dhe bëri si i tha ai, me shpresën se do të largohej. E kishte shumë pranë dhe vinte erë pastërti, ishte shumë i ngrohtë dhe jashtëzakonisht simpatik. Izi bëri pas mbi batanije dhe brofi në këmbë, kurse ai qeshi dhe po e shihte në sy. - Nuk të kafshoj, ti e di.

- Jo, - tha ajo. - Nuk e di, - dhe mori shportën e piknikut e u nis drejt makinës së Pegit.

Etani u ngrit dhe i shkoi pas.

- Pra, mendon se unë jam idiot, hë? - tha dhe në zërin e tij vuri re njëfarë zbavitjeje. Kjo ia pështjelloi stomakun.

- Nuk mendoj asgjë. Unë nuk të njoh, - tha dhe nxitoi hapat, por ai e arriti.

- E vërtetë, ti nuk më njeh, ndaj nuk duhet të më vësh nofka.

- Oh, - ia ktheu Izi, me sytë e zgurdulluar. - E kuptova se ku e ke fjalën. Mund të thuash ç'të duash, por s'ke për të fituar gjë.

- Çfarë?

Ajo ndaloi dhe kthye drejt tij.

- Unë të quaj idiot dhe ti mërzitesh, por nga ana tjetër, ti dhe e dashura jote s'e keni për gjë t'u punoni rrengje të shëmtuara njerëzve. Kështu?

Befas, buzëqeshja e tij u shua dhe po e shihte ngultas, vetullngrysur.

- Nuk e dija që ishte dollapi yt.

- Nuk ka rëndësi i kujt ishte! Ishte diçka e tmerrshme dhe shumë e ulët!

- Ke të drejtë. Ashtu ishte, - ia ktheu. - Por Shenoni...

- Shenoni të thotë ty dhe gjithë të tjerëve se çfarë duhet të bëni dhe ju i shkoni pas, si një tufë konesh të bindura!

- Jo, s'është ashtu. Është... ajo...

Atë çast, Izi pa Pegin që nxitonte drejt tyre përmes parkingut, dhe në dorë mbante kutinë bardhë e blu të ndihmës së shpejtë. Përkrah saj ishte dhe Herri, me ballin e rrudhur nga shqetësimi.

Izi tundi kokën dhe vazhdoi:

- Kështu është, por nuk dua të flas për këtë tani. Unë dhe ti do të punojmë bashkë derisa të përfundojnë të gjitha valixhet. Le ta pranojmë se ne të dy nuk jemi në një mendje, në rregull?

Etani po e ndiqte me sy ndërkohë që Pegi dhe Herri po afroheshin.

- Mund të flasim një herë tjetër për këtë? - e pyeti ai. - Diku tjetër?

Izi rrëmbeu shportën me të dyja duart, duke e ngjeshur të prerën pas dorezës së drunjtë. Dhembja i depërtoi në zemër dhe mendje, ndërsa emocionet kontradiktore luftonin për të pasur epërsi ndaj njëra-tjetrës. Instinkti i thoshte t'i qëndronte sa më larg Etanit, se ai do t'i shkaktonte veç telashe. Në të njëjtën kohë, nuk e mohonte se ai e tërhiqte. Teksa stomaku iu mblodh lëmsh, ndjeu një zemërim të brendshëm.

- Pse? - e pyeti ajo.

Në atë çast, mbërritën Pegi dhe Herri.

Etani kapi kutinë e ndihmës së shpejtë dhe tha:

- E mora. Merrem unë me të.

- Je i sigurt? - e pyeti Pegi. - S'ka nevojë për qepje ose diçka tjetër?

Ai qeshi mbyturazi dhe u përgjigj:

- Nuk ka nevojë për qepje. Është një prerje e vogël.

- Në rregull. Meqë e thua ti! Në fund të fundit, ti je mjeku i ardhshëm. Ne po pastrojmë rrëmujën e piknikut, kurse ti kujdesu për Izin.

Para se ajo të kundërshtonte, Pegi dhe Herri i lanë vetëm dhe u kthyen sërish poshtë pemëve për të mbledhur karriget dhe ftohësit. Etani hapi derën e pasagjerit të makinës së Pegit dhe e urdhëroi Izin të ulej. Ajo u bind dhe u ul në ndenjësen e ngrohtë të lëkurës, ndërsa këmbët e gjata i vareshin jashtë derës së hapur. Etani u ul në gjunjë përpara saj dhe lëshoi përtokë kutinë e ndihmës së shpejtë. Më pas, i kapi dorën dhe nisi t'i hiqte me

kujdes nga gishti pecetën prej letre të mbushur me gjak. Izi u mblodh sa një grusht dhe e hodhi vështrimin diku gjetkë.

- Mos u bëj si fëmijë, - i tha ai. - Është njësoj si ta kesh prerë me letër. Nuk po del më gjak.

- Po ti sikur the se ishte prerje e thellë?

- Po, por është e vogël. Nuk të gjen gjë nga kjo, të premtoj.

Ajo ndjeu gishtat e tij të ngrohtë dhe të mëndafshtë t'i rrëshqisnin mbi dorë, teksa Etani e tërhiqte drejt vetes që t'i fashonte plagën. Ndërkohë, Izi pyeste veten se çfarë mund të mendonte ai po ta merrte vesh se dikur ajo e priste veten qëllimisht. *Me siguri do të mendojë se jam e çmendur*, mendoi. *Dhe ndoshta ka të drejtë*.

- Fjalë me vend - i tha Izi, duke u përpjekur të shpërqendrohej që të mos fliste me vete. - Je vërtet doktor i ardhshëm.

- Prindërit e mi duan që unë të bëhem mjek, - shtoi Etani, hapi kutinë e parë të ndihmës së shpejtë dhe rrëmoi brenda saj. - Mua më pëlqen të bëhem mjek urgjence.

- Unë s'do ta bëja kurrë këtë, - ia ktheu ajo.

Duke u munduar të mos e mbante mendjen te gishti, shikonte Pegin dhe Herrin përmes xhamit të përparmë të makinës së mbuluar nga pluhuri. Nën hijen e pemëve, Herri e puthi Pegin nxitimthi në buzë para se t'ia merrte ftohësin nga dora. Ajo buzëqeshi dhe i shpupuriti flokët. Kjo skenë i kujtoi Izit kohën kur shkonte në plazh me prindërit; nëna dhe babai qeshnin dhe ndiqnin njëri-tjetrin në rërë, i ati e mbërthente të ëmën për beli, e puthte dhe e ngrinte peshë për ta hedhur mes dallgëve. Izi buzëqeshte teksa i shikonte dhe ndihej e sigurt dhe e gëzuar. Bota e saj ideale ishte e mbushur me njerëz të lumtur që e donin njëri-tjetrin, ashtu siç duhej të ishte vërtet. Më pas, u turbullua nga imazhi i çarçafëve të mbuluar me gjak dhe trupi i të atit, i shtrirë barkas në krevatin e prindërve, në kokën e të cilit dukej një vrimë e zezë. Ajo pa të ëmën të mbledhur kruspull në një qoshe të dhomës së gjumit, me sytë e ngulur në një vend dhe armën e gjuetisë pranë këmbëve të mbuluara me gjak. Stomaku iu turbullua sërish. Në fund, të gjitha të qeshurat në plazh, të gjitha mëngjeset e gëzuara të Krishtlindjeve, puthjet, të gjitha shakatë në tavolinën e ngrënies nuk ishin gjë tjetër veç

një iluzion. Ajo pyeste veten se çfarë sekretesh të tmerrshme i fshihnin njëri-tjetrit Pegi dhe Herri.

- Me sa shoh, - tha Etani duke buzëqeshur, - nuk i ke punët mirë, nëse të zë gjaku.

- Çfarë the? - e pyeti ajo, e tronditur nga mendimet.

- Je mirë? - i tha Etani dhe i nguli sytë ballërrudhur.

- Po, - ia ktheu Izi. - Më fal! E kisha mendjen diku gjetkë.

Ajo guxoi ta shikonte teksa ai i lyente gishtin me jod, në pritje të një djegieje që nuk e përjetoi kurrë.

- Po mendoja se do të ishe një mjeke e tmerrshme në sallën e urgjencës, - tha ai.

- Po, - u përgjigj Izi, duke i kthyer sytë nga Pegi dhe Herri. - Kur isha e vogël, kam dashur të bëhesha veterinere, por nuk i shoh dot kafshët duke vuajtur. Nuk do të isha e zonja t'i operoja, edhe nëse kjo mund t'u shpëtonte jetën.

Ajo dëgjoi veten të fliste hapur si kurrë më parë dhe u step. Si zakonisht, goja i punonte më shpejt se mendja. Ndoshta ishte ende e trullosur nga prerja e gishtit.

- As unë, - tha Etani. - Vjet, një makinë më shtypi labradorin e verdhë dhe qava për ditë të tëra. Nuk shkova as në shkollë. Ishte shumë prekëse.

- Por nuk e ke problem të bëhesh mjek urgjence? T'i shohësh njerëzit teksa vuajnë?

- Kjo është diçka tjetër.

- Si qenka diçka tjetër? - e pyeti.

Ai mblodhi supet.

- Nuk e di. Ndryshon puna. Kafshët janë të pafajshme, njerëzit janë... E po, ata nuk janë të pafajshëm. Kafshët janë shumë herë më të mira se njerëzit.

Ajo uli vështrimin dhe pa flokët e tij të zinj sterrë, shpatullat e gjera, qafën e nxirë nga dielli dhe e harroi fare gishtin. Rreth gishtit mbante fort një copë fashë të trashë dhe me dorën tjetër po hapte rrotën e ankeplastit; çdo lëvizje e bënte ngadalë dhe me kujdes. A mund të kishte zemër të butë dhe zgjuarsi pas sjelljes gjithë fodullëk dhe muskujve të tij? Apo ndoshta edhe kjo ishte një nga rrengjet e tij? Mendonte edhe mënyrën e sjellshme me të cilën i kish folur Pegit - "Zonja Berrous" - duke u kujtuar se të

gjithë djemtë adoleshentë që kish njohur dhe që silleshin aq mirë me të rriturit, zakonisht ishin dinakë. Sjellja e tij e mirë nuk i dukej e besueshme. Gjithsesi, në njëfarë mënyre, mendoi se tani, për herë të parë, po shikonte Etanin e vërtetë.

- Si e kishte emrin qeni yt? - e pyeti ajo.

- Lusi, - i tha. - Ishte femër.

- Më vjen shumë keq për Lusin, - ia ktheu Izi.

- Faleminderit! Vjet prindërit më blenë një qen tjetër, një labrador tjetër të verdhë. Edhe atij ia vumë emrin Lusi.

Ai vuri dy shirita ngjitës rreth fashës dhe më pas i buzëqeshi, me sytë blu si oqeani e të thellë si deti. Kur kuptoi se ia kish ngulur sytë, ajo brofi menjëherë në këmbë dhe gati e goditi. Etani mezi u mbajt te dera.

Atë çast, Herri dhe Piteri u afruan te makina, me karriget dhe ftohësit nëpër duar.

- Shoh se ajo t'i paska marrë mendtë, - i tha Herri duke qeshur.

Etani mbylli kutinë e ndihmës së shpejtë dhe u ngrit më këmbë.

- Humba ekuilibrin, - u përgjigj ai, i bërë flakë në fytyrë.

- S'e vë në dyshim, - i tha Piteri duke qeshur. - Hape bagazhin.

Ndërkohë që Etani ndihmonte burrat të ngarkonin pajisjet e piknikut, Izi mori kutinë e ndihmës së shpejtë dhe u nis drejt magazinës. Ajo vështroi pas dhe pa djaloshin që duke futur karriget në bagazhin makinës, shihte drejt saj teksa largohej.

Në magazinë, valixhja tjetër që Pegi hapi i përkiste një burri të quajtur Lorenc Lorenci. Teksa ajo përmendte sendet e rralla që ndodheshin brenda çantës së prishur prej lëkure - *një palë këpucë meshkujsh me lëkurë të zezë, një palë tiranda llastiku me kopsa të bardha, një bardhak blu dhe të bardhë rroje, një furçë rroje me qime të buta dhe të verdha* - Izi gjeti një justifikim për t'i mbajtur sytë te blloku i shënimeve. U përqendrua që të mos i shpëtonte asgjë pa shkruar dhe të mos e mbante mendjen tek Etani. Kur erdhi koha që sendet e valixhes të sistemoheshin për t'u fotografuar, Etani mori dorezën plastike të Izit, e bëri gati dhe u ofrua ta ndihmonte që ajo ta vishte pa iu lënduar gishti.

Izi ndjeu se po skuqej në fytyrë dhe, teksa mori dorezën, i tha:

- Faleminderit, por e vesh vetë!

Pasi ndihmoi Pegin të sistemonte sendet e valixhes, hoqi dorezat dhe i la sërish përtokë. Etani i ngriti dhe i futi në xhep. Herën tjetër kur t'i duheshin, ajo do të detyrohej t'ia kërkonte. Kur e pa që ai i mori për herë të dytë, ajo kërkoi ndjesë dhe shkoi të kërkonte një palë të tjera.

Gjatë tri orëve të ardhshme, ata kontrolluan edhe dhjetë valixhe të tjera. Në njërën prej tyre kishte copëza të prera nga një gazetë filipinase, fotografia e një klase në akademinë parapërgatitore "Brajant" në Sollt Lejk Siti, një bllok i vogël që i përkiste Roberto Torres ku shkruhej: "Kujtimet e mia shkollore në Amerikë" dhe një uniformë e vjetër marinari, me një kapelë të leshtë marine. Izi shfletoi bllokun dhe lexoi një shënim: *Në shkollën publike "Uollbash" studiova lëndët: gjuhë angleze, gramatikë, aritmetikë, gjeografi, higjienë, muzikë, drejtshkrim dhe karpenteri. Këtu mora njohuri për veprat e Henri Longfellout. Në këtë shkollë, ka pesë studentë nga Lindja, përfshirë dhe mua.* Faqja e fundit përfundonte me një fjali të lënë në mes. *Nuk e kam idenë se kur do ta fitoj sërish lirinë. Do të doja të shkruaja...*

- Vras mendjen nëse ky ka qenë babai i tij, - tha Pegi, me një copëz gazete në dorë, ku kish dalë një aziatik me shikim të vrazhdë. - Ai duhet të ketë qenë patjetër bankier, politikan ose ka pasur ndonjë profesion të ngjashëm.

Izi po shikonte një nga fotot e shumta në valixhe. Në të, kish dalë një djalë i ri aziatik me një libër në duar, simpatik dhe me një pamje të qetë e studioze. Pas saj, ishte shkruar me laps një emër: *Roberto Torres*. Ajo s'e imagjinonte dot udhëtimin e gjatë dhe të ndërlikuar që mund të kish bërë Robertoja nga Filipinet për të përfunduar në një spital të çmendurish në Nju Jork.

Një valixhe tjetër kishte një Bibël, kartolina, libra me himne fetare, një libër lutjesh dhe një letër, që një murgeshë ia dërgonte një peshkopi. Në një çantë të vjetër prej lëkure të rreme aligatori, gjendej një diplomë dhe një koleksion filxhanësh çaji me gjithë pjata, të mbështjellë me shumë kujdes. Në një valixhe të madhe kishte ca tenxhere e tiganë, një llambë, një komplet mbajtësesh erëzash me xham të gjelbër, të prodhuara në periudhën e Depresionit të Madh dhe një palë patina.

Valixhja e fundit për atë ditë ishte një sënduk gjigant i mbuluar me afishe udhëtimi të venitura. Në njërën prej tyre, dukej një anije e zezë oqeanike me fjalët "Kunard - Boston për në Evropë" të shkruara në ngjyrë të kuqe. Në një tjetër, mespërmes kullës Eifel në ngjyrë rozë, me shkronja të zeza shkruhej "Francë". Kishte afishe të tjera nga Zyrihu, Italia, Maini, Kajro, Londra dhe Bremerhaveni. Pegi, Izi, Etani dhe Piteri u mblodhën rreth sëndukut, secili i humbur në mendimet e veta teksa analizonin zbukurimet me dru, dorezat prej tunxhi dhe pullat e zbërdhulëta të valixheve. Kjo ishte valixhja më e madhe, një bllok guri mes një deti valixhesh me përmasa të zakonshme.

Izi u mundua të imagjinonte pronarin e sëndukut: një burrë i moshuar, ndoshta shkrimtar ose profesor, që udhëtonte nëpër botë në kërkim të njohurive të kulturave vendase dhe zakoneve tradicionale. Ndoshta ishte shkencëtar ose arkeolog, që pasi kish kaluar kohë duke eksploruar varret egjiptiane dhe rrënojat e lashta, ishte plakur dhe kish filluar të çmendej apo të vuante nga alzhajmeri. Në njëfarë mënyre, e kishin mbyllur në Uillard dhe asnjë i afërm nuk kish ardhur ta merrte më.

Pasi Piteri e fotografoi sëndukun nga të gjitha këndet, ai dhe Etani e vendosën drejt. Izi u befasua kur Pegi lexoi emrin e shkruar në etiketën e ngjitur te doreza. Pronarja e sëndukut kishte qenë femër - *Klara Elizabet Kartrajt*. Izi mbajti shënim emrin, ndërsa Pegi hapi drynin e tunxhtë dhe shulat dhe pasi mori frymë thellë, ngriti kapakun. Kur panë çfarë kishte brenda, Pegi dhe Izi mbetën gojëhapur. Piteri filloi të shkrepte aparatin.

Në sirtarët prej kashmiri me doreza lëkure dukeshin puplat, fjongot e mëndafshta, perlat, këmishët e natës, partiturat dhe anët e zbukuruara të fotografive të vjetra. Në një varëse rrobash ishin varur ca bluza me fruda, funde me pala, fustane të zbukuruara me rruaza, çorape mëndafshi, një triko e madhe me fjongo sateni dhe një fustan mbrëmjeje bust, me pëlhurë në ngjyrë të artë. Në cep të sëndukut, dukeshin dy kapela të shpëlara e të palosura - kapela republike grash - një çantë dore me rruaza, disa libra dhe një palë këpucë me taka të larta. Në mes të sëndukut, binin në sy një pirg letrash të pahapura e të shpërndara kuturu.

- Do të na duhet më tepër vend për të hapur gjithë këto

sende, - tha e emocionuar Pegi. - Etan, mund t'i thuash Herrit të na sjellë një nga tavolinat bosh?

Etani bëri si i thanë. Brenda disa minutash, ai dhe Herri vendosën një tavolinë të madhe pranë sëndukut.

- Kam një pëlhurë tjetër të zezë në bagazhin e makinës, - tha Etani dhe doli.

- Merr edhe një film tjetër, meqë po shkon te makina, - i thirri Piteri.

Ndërkohë që ai shkonte te makina, Piteri përfitoi për të shkuar në tualet. Sakaq, Pegi nisi të hapte sirtarët, ndërsa Izi ishte gati të mbante gjithçka shënim. *Një kopje e librit "Getsbi i madh" nga F. Skot Fitzgerald - gjendja: e shkëlqyer. Një kopje e librit "Dashnori i Ledi Çaterleit", nga D.H. Lorenc - gjendja: e shkëlqyer. Një partiturë. Kartolina nga Gjermania, Spanja dhe Franca - gjendja: e mirë. Një shall me pupla rozë. Tri varëse perlash. Katër byzylykë argjendi me gurë të çmuar. Një fotografi bardhë e zi e një vajze të re me një fustan me thekë, e ulur në një tavolinë të rrumbullakët dhe katër vajza mbi njëzet vjeçe që buzëqeshnin prapa karriges së saj - pas ishte shkruar: "Ditëlindja e tetëmbëdhjetë - klubi "Koton". Një fotografi e së njëjtës vajzë me një djalë të ri me smoking dhe jakë të ngritur - prapa së cilës ishte shkruar: "Unë dhe Brunoja - korrik 1929." Një fotografi e së njëjtës vajzë me një burrë të moshuar me kapelë dhe pallto të leshtë dhe me një grua të moshuar me shall gëzofi dhe kapelë me pupla, prapa së cilës ishte shkruar: "Nëna dhe babai - Krishtlindje 1928". Një ditar me kapak lëkure të gjelbër, gjendja: e mirë.*

Në çdo fotografi, vajza e re, Klara, rrezatonte me flokët e valëzuar deri te supet apo të mbledhur poshtë kapelës. Ishte aq e bukur, sa dukej si një aktore kinemaje, me sy të mëdhenj e qerpikë të gjatë, mollëza të ngritura, buzë të plota dhe lëkurë të zeshkët. Në foton ku Klara kish dalë me prindërit, i ati kish dalë me gojë hapur. Nëna e Klarës ishte një grua trupvogël, e hequr në fytyrë, dhe kish dalë me sytë drejtuar nga ana e djathtë e fotos, si të planifikonte të arratisej sapo fotografi të shkrepte aparatin. Ata dukeshin të trishtuar.

Ndërkohë që Pegi filloi të sistemonte sendet e sëndukut, Izi mori në dorë foton e Klarës dhe Brunos për ta parë më nga afër.

Brunoja kish flokë të errët, nofulla të gjera në formë katrore dhe lëkurë të përsosur. Ia kish hedhur krahun Klarës dhe ishte kthyer pak nga ajo, sikur donte ta puthte në faqe. Klara po vështronte nga aparati me sytë e saj të ëmbël dhe një buzëqeshje të kënaqur. Izi shikonte foton dhe pyeste veten nëse ndonjëri prej tyre e kish imagjinuar ndonjëherë që gjërat nuk do të rridhnin ashtu siç kishin shpresuar. Nëse ndokush do ta kish gjetur këtë foto diku tjetër, me përjashtim të papafingos së një çmendine, do ta kish imagjinuar shumë lehtë se ata të dy ishin martuar me një ceremoni luksoze, ishin shoqëruar me një limuzinë të zezë për të jetuar në një shtëpi të madhe e me një tufë fëmijësh të bukur. Ishte e lehtë të imagjinoje se ishin plakur krah njëri-tjetrit dhe kishin vdekur të lumtur, pasi kishin bërë një jetë modeste.

Kur vështroi fytyrën e lumtur të Klarës, Izin e pushtoi një valë trishtimi. A e kishte imagjinuar ndonjëherë Klara se do të çmendej? A e kishte imagjinuar ndonjëherë se jeta e saj do të merrte një kthesë aq të tmerrshme? Ia nguli sytë Brunos dhe ndjeu se u rrëqeth e tëra. Po me të çfarë kish ndodhur? E dinte ai se kish rënë në dashuri me një të çmendur? Uronte që ai të kish shpëtuar pa u lënduar nga ajo marrëdhënie.

Kur Pegi mblodhi letrat dhe po rrëmonte mes tyre kokulur, Izi ndjeu se diçka e keqe iu mblodh përbrenda. Kur pranoi t'i ndihmonte, nuk e kishte imagjinuar se do të përjetonte diçka të tillë. Kudo ku hidhte sytë, shikonte shenja që i kujtonin kthesën e papritur që i kish marrë jeta. Tani, pirgu i letrave të pahapura i sillte ndër mend dosjen e fshehur në pjesën e pasme të komosë së saj, anët e së cilës gati sa nuk po shpërthenin nga letrat, kartolinat e ditëlindjeve dhe Krishtlindjeve - korrespondenca e nënës së saj, që edhe sot e kësaj dite Izi nuk pranonte ta lexonte.

Punonjëses sociale i kish thënë se nuk pranonte t'i lexonte letrat, pasi e urrente të ëmën. Por kjo ishte thjesht një gënjeshtër. Edhe pse ishte e zemëruar me të ëmën, edhe pse i vinte keq për të, edhe pse kishte frikë se mund të përfundonte si ajo, Izi në të vërtetë, nuk e urrente. Po të tregohej e sinqertë, atë e kishte marrë malli shumë për të, ndoshta jo më shumë se për të atin. I vinte në mendje imazhi i saj teksa piqte biskota në kuzhinën e ndriçuar nga dielli, teksa mbillte manushaqe dhe teksa ia kapte

flokët gërshet me një fjongo rozë. Gruaja që Izi e donte aq shumë dhe që e kishte marrë malli, nuk ishte e njëjta që i kishte vrarë të atin. Diçka kishte ndryshuar në mendjen e saj dhe e kishte shndërruar në një person tjetër. Mendimi se e ëma ishte çmendur, ishte i llahtarshëm, por kjo nuk e mbushte Izin me urrejtje, por me trishtim dhe frikë. Preferonte të besonte se e ëma nuk kish pasur mundësi tjetër.

Punonjësja sociale do të mendonte se Izi ishte çmendur po t'i tregonte të vërtetën: që ajo nuk i lexonte letrat, sepse druhej se mos përmbanin gjëra që nuk mund t'i përballonte. Po sikur letrat të ishin mbushur me hallakatjet e marra të një gruaje të çmendur? Po sikur fjalët e së ëmës të ndikonin tek ajo, duke e shtyrë drejt rrëpirës së çmendurisë? Gjëja më e lehtë për të bërë, mënyra më e lehtë për të ecur përpara ishte të shtirej se ato letra nuk ekzistonin. Sigurisht që ajo e kishte marrë me vete dosjen me letra, nga një shtëpi në tjetrën, ndërkohë që i shtonte edhe letrat e tjera që mbërrinin. Por tashmë, ishte e zonja të reagonte ashtu si në rastet kur shikonte fotografinë e të atit, që e mbante në xhepin e jashtëm me zinxhir të valixhes së saj. Letrat dhe fotografia ishin ato pak gjëra që zotëronte, prona e saj, ndërsa të tjerat, si veshmbathjet apo ndonjë palë xhinse, nuk ia vlen t'i përmendësh.

Por kishte një ndryshim të madh mes letrave të Klarës dhe të Izit. Zarfet e gjetura në sëndukun e Klarës nuk kishin as pulla e as vula postare, sepse nuk qenë postuar kurrë.

- Të gjitha i janë drejtuar një personi të vetëm, - tha Pegi, duke parë zarfin e fundit.

- Brunos? - pyeti Izi, kurse Pegi ngriti vetullat.

- Po! Bruno Moretit! Po ti nga e dije?

Ajo i tregoi foton e Klarës dhe Brunos, që Pegi e pa duke picërruar sytë.

- O Zot i madh! - tha më pas. - Sa çift i bukur!

- Pyes veten se çfarë mund të ketë ndodhur, - tha Izi, duke e parë sërish foton. - Ajo duket shumë normale dhe e lumtur.

Pegi mblodhi supet dhe ia ktheu:

- Shpresojmë që ta marrim vesh.

- Ndoshta këtu do të gjejmë diçka, - tha Izi, duke u zgjatur për të marrë ditarin. Në kapakun me lëkurë të gjelbër, ishte stampuar

një zambak. Ajo hapi bllokun e vogël dhe nisi të lexonte me zë të lartë. *Janar 1925. I dashur Ditar, tani ndodhem në Zvicër. Mamaja ma bleu këtë bllok në një dyqan të bukur dhuratash në Engleberg. Sa do të doja të jetoja këtu! Unë dhe Uilliami u kënaqëm shumë duke shëtitur nëpër qytet. Më pëlqejnë shumë malet dhe shtëpitë e Zvicrës. Edhe nëna me babanë duken të lumtur këtu. Por nesër duhet të kthehemi sërish në shtëpinë tonë.*

Izi e ndërpreu leximin dhe kaloi te faqja e fundit. Ajo i kapërceu paragrafët e gjatë dhe lexoi shënimin e shkruar. *Babai po më çon në Uillard. Pyes veten nëse duhet të kem frikë*. Izi ia nguli sytë Pegit, duke u munduar të kapërdinte lëmshin e madh që i ishte mbledhur në fyt. Çfarë mund t'i kish ndodhur kësaj vajze të re, që kish përfunduar në një vend të tillë si Uillardi? Nëse nuk bëhej fjalë për një rastësi të tmerrshme, atëherë, ç'gjendje e pashpjegueshme mund të kish qenë shkaku i sëmundjes së saj? Pse i ati e kish mbyllur në çmendinë? Mos ndoshta për një minutë sillej normalisht dhe sakaq e humbte toruan dhe sillej si e çmendur? I kish ndodhur gjë asaj apo Brunos? Mos ndoshta Klara kish shtënë mbi dashurinë e jetës së saj gjatë një shpërthimi çmendurie apo xhelozie?

Atë çast, u kthyen Etani dhe Piteri dhe në duar mbanin një copë pëlhurë të zezë dhe një film të ri. Izi uli ditarin dhe nisi të sistemonte fotografitë e kartolinat teksa mundohej të fshihte sytë e përlotur. Ajo nëpërdhëmbi diçka ndërsa fshinte hundët që i shkonin çurg, me shpresën se askush nuk do ta vinte re. Kur hodhi vështrimin nga Etani, ai ia kish ngulur sytë e po e shihte me vëmendje.

KAPITULLI 6



KLARA

Në ndenjësen e pasme të makinës së markës *DeSoto* që uturinte, e mbështetur te dera, Klara sodiste nga dritarja, kurse këmbët i kish mbuluar me batanijen që i kish dhënë infermiere Joti. Perëndimi i diellit ndriçonte retë e holla, duke e mbushur qiellin me hije të lehta ngjyrë karafili dhe livande. Ndërtesat dhe pemët që bëheshin gjithnjë e më të largëta, dukeshin më të errëta, duke u shndërruar në silueta përkundrejt qiellit ngjyrë pasteli. Në këtë orë të ditës, Klara mendonte se mund të shihej varianti tokësor i parajsës dhe ferrit, i dritës dhe territ, i së mirës dhe së keqes.

Minutat e fundit para se dielli të perëndonte, toka dhe gjithçka mbi të dukej e zezë pisë, sikur për atë periudhë të shkurtër kohe e keqja sundonte botën, para se yjet dhe hëna të dilnin e të ndriçonin qiellin e natës, për t'u kujtuar të gjithëve se në univers ekzistonte vërtet drita dhe mirësia, shpresa dhe parajsa. Tani, në prag të errësirës së plotë, Klara imagjinonte sikur zoti Glen do ta ngiste makinën pa fund, derisa të përpiheshin nga errësira. Ajo ngriti sytë nga qielli, në kërkim të yllit të parë të mbrëmjes dhe mori frymë e çliruar kur pa një dritë sa maja e gjilpërës që xixëllonte mbi degët e zhveshura të një peme të errët.

Pas gjashtë orë heshtjeje të plotë në makinë, më në fund, zoti

Glen lajmëroi se po mbërrinin në mjediset e spitalit "Uillard". Infermiere Mei, ulur pranë Klarës, qëndronte si e ngrirë, me duar në prehër, fytyrë të shtrembëruar dhe shikimin drejt. Para tri orësh, pasi kishin lënë qendrën "Long Ajlënd", Klara i ishte përgjëruar zotit Glen të ndalonte në një pikë karburanti ose në një restorant buzë rrugës, që të shkonte pak në tualet. Ajo shpresonte të gjente një mundësi sado të vogël për t'ia mbathur, ndoshta nga dera e pasme e restorantit ose dritarja e tualetit të femrave. Por infermierja nuk ia kish ndarë sytë për asnjë çast, madje kish shkuar deri aty, sa e kishte ndjekur pas edhe në tualetin e karburantit, ku kish qëndruar e heshtur dhe si e ngrirë teksa Klara mbaronte punë.

Ndërkohë që lante duart, kërkonte në mënyrë të dëshpëruar një send të fortë për të goditur infermieren në kokë, por e vetmja gjë që i zinte syri, ishte një kosh mbeturinash prej kashte. Ishte shumë i lehtë për të përmbushur qëllimin e saj. Përveç kësaj, nuk ishte e sigurt nëse do të kish zemër ta lëndonte atë grua, qoftë edhe për të shpëtuar veten.

Kur hodhi vështrimin në pasqyrën e tualetit, iu duk se ia kishte ngulur sytë një e huaj. Deri në çastin kur pa veten aq të lodhur e me flokë të shpupuritur, ishte ndier sikur e gjithë kjo nuk po i ndodhte asaj. Ishte ndier si e shkëputur, e sigurt që gjithçka do të përfundonte si një makth apo rreng që po e përjetonte dikush tjetër. Ndihej e sigurt se dikush ose diçka do ta shpëtonte. Në fund të fundit, ajo ishte Klara Elizabet Kartrajti, e bija e trashëgimtares së vetme të "Brixh Bros", qendrës së madhe të veshjeve, dhe e pronarit të bankës "Swift". Asaj i pëlqente shumë çamçakëzi me shije manaferre, qentë dalmatë, buzëkuqi me aromë qershie dhe kërcimi çarleston. Gjëra të tilla nuk u ndodhnin njerëzve si ajo.

Më pas, vërejti sytë e përhumbur, lëkurën e zbehtë dhe kuptoi se po i ndodhte pikërisht asaj; atë po e çonin në një spital dhe jeta po i merrte një rrjedhë të çuditshme. Tani ishte e vështirë të imagjinoje se Brunoja kishte puthur pikërisht ato buzë dhe kish përkëdhelur me shumë dashuri pikërisht ato faqe. Pyeste veten se çfarë vinin re mjekët dhe infermieret kur e shihnin.

Pasi kaluan pikën e karburantit, udhëtuan në qetësi, me përjashtim të rasteve kur zoti Glen fërshëllente ndonjë melodi të

Brouduejit apo të muzikës xhaz. Shiu godiste pa pushim tabanin metalik të makinës dhe era uturinte përmes xhamave, si shpirtrat e inatosur të luginave të zbrazëta, që donin me dëshpërim të hynin brenda.

Tashmë shiu kish pushuar dhe kish mjaftueshëm dritë sa Klara të dallonte disa hangarë dhe ato që dukeshin si kopshte frutore e ara të mbjella me drithë. Këtu, toka ishte e zhveshur dhe ajo mund të shihte rreshtat plot kallinj bojë kafe të misrit dhe grurin e florinjtë si qëndismë mbi tokë. Jashtë hangarëve, derrat dhe lopët po ushqeheshin, ndërsa ca kuaj vinin vërdallë në një kullotë të rrethuar me gardh. Pak më tej rrugës, dukeshin ca kotece pulash, një punishte farkëtari dhe disa ndërtesa të stilit industrial. Ajo u hodh përpjetë kur zoti Glen nisi të fliste papritur.

- Spitali "Uillard" është hapur në vitin 1869 dhe tani ka marrë përmasat e një fshati të madh, - tha ai. - Pacientët punojnë në fermë, hekurudhë. Pjesën më të madhe të ushqimit për pacientët dhe stafin e sigurojmë nga furra e bukës dhe kuzhina jonë. Kemi kopshte frutore dhe kultivojmë drithëra. Në punishtet tona, prodhojmë veshje, këpucë, madje edhe qivure me dru pishe, që i përdorim për të varrosur pacientët në varrezat e Uillardit.

Klarës iu ngritën qimet e kokës përpjetë. Kurrë nuk i kish shkuar ndër mend se njerëzit *edhe mund të vdisnin* në Uillard. Mendonte se thjesht merrnin ndihmë dhe dërgoheshin sërish në shtëpi. Pse duhej të kishte një varrezë në një spital të çmendurish?

- Nga se kanë vdekur pacientët? - pyeti me zë të mekur.

- Nga gjithfarë arsyesh, - u përgjigj zoti Glen. - Tuberkulozi, ethet e tifos, kolera, pleqëria.

- Pleqëria? - pyeti Klara.

- Sigurisht, - tha ai. - Disa pacientë kanë qëndruar për dekada të tëra në Uillard.

- S'është nevoja të diskutoni për këto gjëra, zoti Glen, - foli vrazhdë infermiere Mei.

Klara u mundua të kapërdinte lëmshin e krijuar në fyt dhe hodhi batanijen shpatullave.

Pasi kaluan një kantier hekurudhe të ndriçuar me fenerë vajguri, ku nja dymbëdhjetë burra shtynin karrocat e dorës plot me qymyr drejt një centrali elektrik, ajo pa në largësi siluetat

e errëta të ndërtesave me përmasat e fabrikave, të ngjitura me një strukturë gjigante qendrore, që dukej si një shtëpi vigane me katër kate. Teksa po u afroheshin ndërtesave, vuri re dritat që shkëlqenin pas dritareve të gjata e pa perde, hijet që lëviznin, ecnin, përkuleshin dhe qëndronin pa lëvizur pranë xhamave. Kur pa dritaret me hekura, i erdhën zorrët në gojë.

Atë çast, zoti Glen filloi të fërshëllente melodinë e këngës "Someone to watch over me", ndërsa Klarës iu mblodh zemra në kraharor dhe fyti iu ndez flakë. Por kur infermiere Mei filloi të këndonte nën zë, atëherë i erdhi të ulërinte. *Qëllimisht e kishin zgjedhur atë këngë? Mos ndoshta ky ishte hapi i parë i planit të tyre për ta çmendur?* Nguli thonjtë në pëllëmbët e duarve, e sigurt se ishte në gjumë, me shpresën se dhembja do ta zgjonte. Por ky nuk ishte një makth, kjo ishte jeta e saj e vërtetë. Shumë shpejt do të gjendej pas atyre dritareve, duke parë përjashta dhe askush nuk do të kujdesej më për të. Papritur, e pushtoi një valë e fortë malli për shtëpinë, aq e fortë, sa ishte gati të ulërinte.

Jashtë, ndërtesat trekatëshe nuk kishin të sosur, si krahë gjigantë të lidhur pas qosheve të largëta, si shkallë anësore që të çojnë drejt shtëpisë së madhe. U mundua të imagjinonte se sa shpirtra të shkreta po vuanin pas mureve me tulla të Uillardit. Nëse do të merrej për bazë numri i ndërtesave dhe i dritareve, ai ishte vërtet i madh. Ndjesia e frikës që e kishte shtrënguar pak më parë në fyt, u shndërrua në një vorbull të madhe në stomakun e saj.

Makina *DeSoto* ecte me zhurmë përgjatë rrugëve të shkatërruara e më pas mori kthesën në të majtë, përballë strukturës vigane. Në të djathtë të saj, jashtë makinës, toka vinte paksa e pjerrët, por ishte thuajse errësirë dhe ishte e vështirë të shikoje. Në largësi, ajo që dukej si një grumbull resh, qëndronte e fshehur në një luginë të thellë, por më pas, toka ngrihej sërish. Pastaj vuri re ca drita që pasqyroheshin në luginë dhe kuptoi se po shikonte një pellg me ujë.

Zoti Glen ndaloi makinën përpara një ndërtese gjigante të stilit viktorian. Ajo ishte ndërtesa kryesore, por rreth saj ndodheshin edhe dymbëdhjetë godina të tjera. Një palë shkallë dyshe gjarpëronin në hyrjen kryesore dhe pas dritareve vezullonin

ca drita të forta. Një nga dyert u hap dhe në portikun e gurtë u shfaq një burrë me kostum të errët. Zoti Glen fiku makinën dhe zbriti.

- Më prit këtu, se vij e të marr unë, - i tha infermiere Mei Klarës.

Klara ndjeu t'i thahej fyti nga frika, krahët dhe këmbët nisën t'i dridheshin, ndërsa buza e sipërme iu mbush me bulëza djerse. Edhe pse kishte vapë, i mbërtheu të gjitha kopsat e palltos, duke përforcuar kështu shtresën e vetme të mbrojtjes. Zoti Glen nxori valixhen e saj nga bagazhi, doli anash makinës dhe hapi derën e pasme të pasagjerit. Atë çast, erdhi infermiere Mei dhe Klara zbriti nga makina duke mos ia ndarë sytë ndërtesës që kishte përpara. Në një pllakë mermeri të gdhendur mbi portikun prej guri shkruhej "*Chapin Hall*". Ajo ndjeu t'i thahej goja kur ngriti sytë lart dhe pa dritaret si të katedraleve, dritaret e papafingos, oxhakët e mëdhenj dhe kupolën me tri kate. Gjithçka ngjante me një kështjellë, kala, një burg pa shpëtim. Dhe atë po e rrasnin brenda.

Burri që qëndronte në portik, ndoqi parmakun që gjarpëronte poshtë shkallëve të gurta dhe u takua me ta në fund të trotuarit.

- Si shkoi udhëtimi? - pyeti ai zotin Glen. Më pas përshëndeti me kokë infermiere Mein dhe ndërkohë që duart i mbante pas shpine, i hodhi Klarës një shikim nga koka te këmbët. Ishte një burrë trupvogël, i dobët, me mjekër të gjatë dhe vetulla të rëna. Flokët e errët i kish lëpirë anash dhe kish nxjerrë në pah fytyrën e nxirë nga dielli. Kostumi që kish veshur, i rrinte si ta kish bërë me porosi: jakën e bardhë e kish ngritur lart dhe këpucët prej lëkure shkëlqenin aq shumë, sa pasqyroheshin llambat me vajguri të hyrjes.

- Fillimisht, e patëm të vështirë, - tha zoti Glen. - Por gjithsesi, ia dolëm të mbërrinim.

- Mirë, shumë mirë, - tha burri. - Ndërsa kjo duhet të jetë Klara, apo jo?

- Doktor Roaç, kjo është Klara Elizabet Kartrajti, - tha infermierja. - Është tetëmbëdhjetë vjeçe dhe është në gjendje shumë të mirë fizike.

- Nuk është nevoja të izolohet?

- Doktor Thorni na siguroi se nuk ka qenë sëmurë, - tha infermiere Mei që nuk ia shqiste sytë mjekut, sikur priste ndonjë miratim prej tij.

- Ju hapi telashe rrugës? - iu kthye doktor Roaçi zotit Glen, duke e shpërfillur vështrimin e infermieres.

- Jo, zotëri, - u përgjigj ai. - Nuk iu dëgjua zëri fare.

- Mirë, mirë, - tha doktori. - Futeni brenda që ta sistemojmë.

Klara shtrëngoi nofullën, ndërsa një dhembje therëse sa vinte e i shtohej në kokë. Ata po flisnin për të sikur ajo të mos ishte aty, si të ishte një qenie e vockël njerëzore që nuk dëgjonte, ndiente apo fliste. Sakaq, i zgjati dorën, me shpresën se mjeku do të arsyetonte që ajo s'e kishte vendin aty.

- Është kënaqësi që ju njoh, doktor Roaç, - i tha me një buzëqeshje të sforcuar.

Ai ngriu në vend kur pa dorën e zgjatur, ndërsa të vetat vazhdonte t'i mbante të lidhura pas shpine. Infermierja ia uli dorën dhe mblodhi buzët gjithë neveri.

- Mbaje për vete, - i tha ajo.

Mjeku ktheu kurrizin dhe u fut brenda, ndërsa zoti Glen ua bëri me dorë grave që ta ndiqnin pas. Klara qëndronte si hu, duke pyetur veten nëse duhej t'ia jepte vrapit. Ajo mund ta linte pas infermiere Mein, por ishte e sigurt se zoti Glen do ta kapte shpejt. Infermierja e shpoi, duke e nxitur të lëvizte vendit. Klara e pa me inat e më pas filloi të ecte në vendkalimin e këmbësorëve drejt *Chapin Hall*-it.

Doktor Roaçi, që qëndronte vetullngrysur dhe i frikur se mos ajo përpiqej ta prekte sërish, mbante hapur njërën nga dy dyert dhe priste që ato të futeshin brenda. Sapo hynë, zoti Glen dhe infermierja hoqën palltot dhe i varën në një varëse rrobash prej hekuri. Klara nuk u zhvesh.

- Për momentin mund ta mbajë pallton, - tha mjeku pa iu drejtuar ndonjërit në veçanti. Zëri i tij jehoi në hollin e gurtë. - Do ta çojmë në pavijonin B të grave. Zoti Glen, të lutem, merri bagazhet e saj!

Mjeku nisi të ecte lart e poshtë hollit, me duart e mbledhura pas shpine dhe këpucët e forta që kërcisnin përgjatë dyshemesë së bardhë prej mermeri. Sakaq, një infermiere që ishte ulur në

një tryezë, ngriti sytë dhe fytyra e saj e zbehtë u ndriçua nga drita e abazhurit të tavolinës, që binte mbi dhomën e errët si një fener. Tavanet ishin minimumi gjashtë metra të larta, me një kube me xhama të ngjyrosur në mes, të rrethuar nga llambadarë të pandezur, me gjethe tunxhi dhe poçe të gdhendura. Një rresht me karrige mermeri shtrihej në të gjithë sallën dhe imazhet e fermave dhe Alpeve të mbuluara nga dëbora mbushnin muret në ngjyrë ulliri. Në njërën anë të hyrjes kryesore ishin vendosur divane dhe kolltukë të rehatshëm, që formonin një sallon pritjeje pranë dritareve që ngriheshin nga dyshemeja e deri në tavan, kurse në pjesën e pasme të hollit, një shkallë e madhe prej druri të shpinte në katin e dytë. Dekori i kujtoi Klarës shtëpinë e madhe të prindërve, por kjo ishte shumë më e madhe. Gjunjët iu drodhën dhe nisi të fërgëllonte e tëra, kurse këmbët dukej se do ta lëshonin përtokë nga çasti në çast.

Doktor Roaçi i shoqëroi përmes hollit, drejt një korridori të shkurtër me shumë dyer dhe ndali përballë derës së parë djathtas.

- Infermiere Mei, - tha ai, duke mos ia ndarë sytë Klarës, - të lutem, shoqëroje Klarën brenda dhe ndihmoje të marrë nga sënduku i saj një palë këpucë, ndërresa dhe tri fustane për t'u ndërruar çdo ditë, por jo çorape. Ndërresat e natës do t'ia japim ne dhe pjesën tjetër të sendeve të saj personale do t'i fusim në magazinë. Mos harro t'i lësh jashtë pallton dhe çizmet për veprimtaritë në natyrë.

- Si urdhëron, doktor Roaç, - tha prerë infermiere Mei. Pastaj hapi derën dhe e shoqëroi Klarën në dhomën e zhveshjes, duke mërmëritur diçka nëpër dhëmbë. Zoti Glen i ndoqi, ngriti sëndukun mbi një tavolinë të lartë duke rënkuar dhe më pas, i la të dyja femrat vetëm.

- E dëgjove mjekun? - i tha infermierja që, pasi mbylli derën, u ul në një karrige, kryqëzoi krahët dhe vazhdoi: - Nxito!

Klara mori frymë thellë dhe hapi shulat e sëndukut, me shpresën se letrat që i kishte shkruar Brunos, nuk do të përhapeshin andej-këtej. Qëndroi pranë tavolinës, duke u munduar t'ia zinte pamjen infermieres dhe hapi kapakun. Nuk ishte e sigurt nëse duhej të merrte disa prej tyre dhe t'i fshihte në xhep apo të shpresonte se mund ta hapte sërish sëndukun, në rast se ia mbushte mendjen

dikujt që t'ia postonte. Po sikur infermiere Mei ta diktonte dhe t'ia merrte? Nuk e kuptonte pse infermierja rrinte fytyrëngrysur dhe nuk ishte në humor që kur ishin kthyer në spital. Po sikur t'ia nxirrte Klarës gjithë inatin që kish përbrenda? Kështu, Klara vendosi të mos rrezikonte. Hëpërhë, do t'i linte letrat në sënduk.

Brenda tij, mbi këmishën e natës prej mëndafshi, qëndronte një zarf me emrin e Brunos sipër. Ajo e mbuloi me dorë, palosi këmishën dhe e futi nga fundi, në mes të malit me rroba. Nxori këpucët kafe nga një sirtar dhe i vendosi mbi tavolinë. Më pas, kërkoi me kujdes ndërresat dhe tri fustane, duke u munduar të mos e kthente përmbys të gjithë sëndukun. Kur sytë i zunë fustanin me thekë në ngjyrë pjeshke, që kish veshur mbrëmjen që kish takuar Brunon, ndjeu një shtrëngim në fyt. A do të mund të kërcente sërish me të?

Më në fund gjeti ato që po kërkonte: një fustan pambuku blu, me jakë të rrumbullakët e të qëndisur, një fund të drejtë bojëkafe, një bluzë rozë me lidhëse në qafë dhe një fustan shtëpie të verdhë të çelur. I nxori nga valixhja dhe i vuri mbi tavolinë. Atë çast, infermiere Mei u ngrit në këmbë. Klara mbylli valixhen, kyçi tokëzat prej tunxhi, mori rrobat në dorë dhe u kthye.

- Mirë janë këto? - e pyeti ajo.

Infermierja u hodhi një sy të shpejtë fustaneve dhe ia rrëmbeu nga dora.

- Shumë mirë i ke, - i tha, duke shtrembëruar buzët gjithë inat.

I hodhi rrobat mbi tavolinë, hapi derën dhe e shoqëroi sërish Klarën në holl, ku po i prisnin zoti Glen dhe doktor Roaçi, që kishte veshur një përparëse të bardhë. Pranë tyre, qëndronte një infermiere tjetër, një grua e gjatë, truplidhur, me shpatulla të gjera dhe flokë të kuq kaçurrelë. Qafën e kishte të trashë dhe mollëzat e fryra i zgjateshin deri te goja, si tullumbace që po plasnin. Sytë e vegjël mezi i dukeshin në fytyrën buçkane dhe buzëkuqi bënte kontrast me lëkurën e saj të zbehtë, si gjaku mbi dëborë. Edhe pse nga fytyra të linte përshtypjen e një njeriu obez, nuk ishte e shëndoshë, por krahët dhe këmbët i kishte gjithë muskuj. Infermierja trupmadhe mbante një pëlhurë të bardhë nën sqetull.

- Zoti Glen, - tha doktor Roaçi teksa mbante duart në xhepat

e përparëses së bardhë, - të lutem, çoje sëndukun e Klarës në holl. Nesër në mëngjes do ta sistemojmë.

- Si urdhëron, zotëri, - ia ktheu ai dhe u nis menjëherë në dhomën e zhveshjes për të marrë sëndukun.

- Infermiere Mei, mund të kthehesh në ndërtesën e infermiereve, - i tha mjeku, i cili për herë të parë që kur kishin mbërritur, e pa drejt e në sy. Ajo i buzëqeshi, por ai e hoqi sakaq vështrimin, duke kërcitur nofullën. - Infermiere Trençi do ta marrë situatën në dorë.

- Të kthehem në dhomën time, doktor Roaç? - e pyeti ajo dhe sytë po i shndrisnin teksa priste.

- Mund të shkosh në cilën dhomë të duash, - iu përgjigj mjeku. Më në fund ai buzëqeshi i vetëkënaqur dhe u mundua ta fshihte me delikatesë këtë gjë.

Infermiere Mei pohoi me kokë dhe mollëzat iu ndezën flakë. I buzëqeshi mjekut më shumë se ç'duhej dhe dukej si një marrëveshje e heshtur mes tyre. Infermierja trupmadhe u kollit për të qëruar fytin, ndërsa Mei uli shikimin dhe ndoqi zotin Glen në korridor.

- Tani të sistemojmë Klarën diku për të kaluar natën, - i tha mjeku infermiere Trençit. - Nesër merru me shkresurinat. Është koha të fikim dritat dhe nuk duam të shkelim programin.

- Si urdhëron, doktor, - ia ktheu infermierja.

Doktor Roaçi ia bëri me shenjë Klarës dhe u nis përgjatë korridorit.

- Eja këtej, - i tha.

Klara kafshoi faqen nga brenda dhe i shkoi mjekut pas. Çdo nerv i dridhej sikur përcillte rrymë elektrike. Krahët dhe këmbët i dridheshin si ta kishte futur gishtin në prizë dhe ta mbante atje pa lëvizur. Ku po e çonin? Do të rrinte në dhomë me një paciente tjetër apo do të kishte dhomën e saj? Nuk mjaftonte që e kishin degdisur aty, pa e ditur se çfarë do të ndodhte më pas apo sa gjatë do të qëndronte, por tani i duhej edhe ta ndante dhomën me një të huaj, që mund të ishte e dhunshme ose e çmendur. Ky mendim ishte tepër i rëndë për të.

Nxitoi hapat duke u munduar të arrinte mjekun dhe infermieren, me duart e mbledhura grusht brenda xhepave të

palltos. Kur arritën në fund të korridorit, u kthyen majtas. Më pas, ndaluan para një dere hekuri, me një çarë të vogël me shufra metalike në mes. Mjeku bëri vend dhe infermierja hapi kyçin e më pas derën, menteshat e së cilës kërcitën aq shumë, sa të shponin daullen e veshit. Doktor Roaçi i bëri Klarës shenjë të hynte dhe më pas e ndoqi në korridorin e ftohtë.

Era e fortë e urinës dhe e klorit i shpoi hundën dhe zuri gojën me dorë. Shkonte pas mjekut dhe infermieres, duke qortuar veten që s'ia kishte mbathur kur iu dha mundësia. Dyshonte se mund t'i shpëtonte zotit Glen, por të paktën, duhej ta kish provuar. Gjithçka do të ishte shumë më mirë, sesa t'i lejonte ta mbyllnin në këtë vend të llahtarshëm.

Korridori i gjatë ishte aq i gjerë, sa mund të nxinte dy trena dhe muret e larta kishin dyer pa fund. Të gjitha ndërtesat e Uillardit ishin projektuar për të strehuar gjigantë dhe Klara nuk e kuptonte arsyen. Kur mbërritën në gjysmë të korridorit, papritur u hap një derë, prej nga dolën dy roja që po tërhiqnin një grua. Flokët e shpupuritur i kishin mbuluar fytyrën e shtrembëruar dhe pjesa e poshtme e lagur e këmishës së natës i ishte ngjitur pas këmbëve lakuriqe. Një infermiere doli nxitimthi nga dhoma dhe u shkoi pas. Gruaja ulërinte dhe nuk arrinte t'i ngulte dot këmbët e zbathura në dysheme. Klara ndali dhe zemra po i buçiste në kraharor. Pa u vonuar, infermiere Trençi u kthye, e mbërtheu për krahu me dorën gjigante dhe e shtyu përpara.

- Ec përpara, - i tha ajo prerë.

Klara u mundua të lirohej nga mbërthimi i saj, por më kot. Ajo çau përpara me një qetësi të çuditshme, sikur po nxirrte shëtitje një qen dhe nuk i bënë aspak përshtypje përpjekjet e Klarës. Përmes një dere të hapur në krahun e majtë, dëgjoheshin paciente që bërtisnin nga ca shtretër të mëdhenj me kapakë të mbyllur. Befas, Klara ndjeu të përziera.

Në fund të korridorit u kthyen sërish majtas dhe u futën në një tjetër derë hekuri të mbyllur me dry dhe kaluan nëpër një korridor të dytë të njëjtë me të parin. Kur ndaluan përpara derës së katërt djathtas, infermierja ia lëshoi krahun Klarës.

- Ma jep pallton, - i tha. Me gishtat që i dridheshin, Klara zbërtheu pallton dhe e hoqi. Fatmirësisht, para se të largohej nga

qendra "Long Ajlënd" kish veshur një pulovër, pa e ditur se në Uillard bënte kaq ftohtë. - Edhe çizmet.

Klara bëri ç'i thanë, hoqi çizmet dhe ndjeu dyshemenë e ftohtë akull nën këmbë.

- Nesër në mëngjes sille në zyrën time për një kontroll, - i tha doktor Roaçi.

- Si urdhëron, doktor, - iu përgjigj infermierja. - Nesër do ta kesh në zyrë.

- Shumë mirë, - tha ai, vështroi Klarën dhe vazhdoi: - Ne jemi këtu vetëm për të të ndihmuar, mos e harro këtë. S'ke pse të kesh frikë.

Më pas, e përshëndeti me kokë dhe nxitoi drejt fundit të korridorit.

Duke e parë teksa largohej, infermiere Trençi bëri një zhurmë të çuditshme me gjuhë. Mblodhi buzët, tundi kokën dhe u duk sikur një dhembje e befasishme iu pasqyrua në fytyrën buçkane. Pastaj hapi derën dhe hyri në dhomë. Klara ndjeu një shtrëngim në kraharor. Infermiere Trençi e mbante derën hapur dhe priste. Klara u fut brenda ngadalë, me duart e mbledhura grusht mbi kraharor, dhe ndiente se zemra po i dilte vendit.

Era e jashtëqitjes dhe e urinës ishte po aq e fortë, sa edhe ngjyra e gjelbër e mureve të lyera me vernik. Klara tërhoqi mëngën e pulovrit dhe mbuloi gojën. Në dhomën akull të ftohtë ndodheshin pesëdhjetë krevate metalike të mbërthyera me bulona në dysheme, të gjithë me jastëkë e çarçafë të pistë dhe dyshekë me lesh. Pacientet qëndronin ulur mbi shtretërit e tyre ose vinin përqark dhomës, të veshura me këmisha nate të holla, pa asnjë ndërresë poshtë dhe format e lakuara të gjoksit të tyre dukeshin sheshit. Disa kishin veshur pulovra dhe çorape, por shumica ishin këmbëzbathur, ndërsa disa të tjera kishin veshur këmisha force. Njëra prej tyre rrinte ulur në një qoshe me një kukull prej lecke në krahë, të cilën e tundte dhe i këndonte një ninullë. Dy gra qëndronin pranë dritareve të larta me hekura. Njëra prej tyre sodiste natën, tjetra përplaste kokën te rrjeta e telit që mbronte xhamin, i cili ishte veshur nga një shtresë e hollë akulli.

- Fikini dritat! - thirri infermiere Trençi.

Gratë morën duke u zvarritur drejt shtretërve të tyre. Gruaja

me kukullën në krahë e me këmbë të holla e të shtrembra u struk në krevatin më të afërt, ndërsa kukullën e kish futur brenda rrobave të grisura. Infermiere Trençi i vështronte dhe priste në heshtje. Kur të gjitha gratë u ulën apo u shtrinë në krevatet e tyre, shtrati pranë gruas me kukull kishte mbetur bosh. Dukej se dikush kish fjetur aty, pasi çarçafët dhe jastëku ishin rrëmujë dhe të zhubrosur. Infermiere Trençi rrëmbeu cohën e palosur që mbante nën krah dhe ia zgjati Klarës. Ishte një këmishë nate.

- Vishe këtë, - i tha.

Klarës iu ngushtua kraharori dhe mezi po mbushej me frymë.

- Këtu?

- Rregulli i parë i Uillardit është "Bëj si të thonë", - ia ktheu infermierja. - Bindu dhe s'do të kemi probleme.

- Ka ndonjë banjë këtu pranë? - e pyeti Klara. - Diku ku mund të ndërrohem pa pasur njeri rrotull?

Infermierja buzëqeshi dhe njëri cep i buzëve të saj të lyera me të kuq u ngrit pak më lart se tjetri.

- Rregulli i dytë i Uillardit është "Mos bëj pyetje".

Klara uli sytë dhe u kthye nga pacientet e tjera, me këmbët dhe krahët që i dridheshin si zogth. Hoqi çorapet dhe pulovrin, pastaj fustanin që e la të binte lirshëm përdhe dhe u kthye nga infermiere Trençi për t'i marrë këmishën e natës.

- Hiqi të gjitha! - i tha. - Bën mirë të mos më ngresh nervat, vajzë!

Klara hoqi këmishën e brendshme dhe reçipetat, duke mbuluar me krah gjoksin e zhveshur, e më pas, zgjati dorën për të marrë këmishën e natës. Këtë herë infermierja ia zgjati vetë. Klara e veshi me shpejtësi rrobën dhe më pas, hoqi të mbathurat. U përkul për të kapur pulovrin, por në çast ndaloi. Duke u dridhur, i hodhi sytë nga infermierja.

- Mund ta marr? - e pyeti, duke i treguar me gisht pulovrin.

- Nuk jam e pashpirt, - ia ktheu ajo.

Klara e ngriti dhe e veshi, e gëzuar që leshi ishte ende i ngrohtë.

- Mos harro ato që të tha doktor Roaçi, - i tha infermierja. - Jemi këtu për të të ndihmuar, - dhe i bëri me shenjë drejt

krevatit bosh. - Është e vështirë të ndihmosh dikë, nëse personi nuk i respekton rregullat.

Klara u nis drejt shtratit me stomak të pështjelluar. U kapërdi disa herë, duke u munduar të mos villte. Gruaja në shtratin përballë lëvizte sa para-mbrapa dhe lëshonte ca tinguj të lehtë që tingëllonin pak a shumë si "Uh-oh, uh-oh, uh-oh". Një tjetër shkulte flokët e gjatë e të pistë dhe qeshte ndërsa shkulte disa qime njëherësh. Klara arriti te shtrati, u ul dhe mbuloi hundën me cepin e pulovrit.

- Fikini dritat! - thirri sërish infermierja. Gratë u shtrinë dhe tërhoqën batanijet. Edhe Klara bëri të njëjtën gjë: u mblodh sa një grusht kur preku teshat e ndotura. U shtri me shpinë, duke ndier krupë nga mendimi se do ta mbështeste faqen në atë jastëk të pistë. - Mos lëviz sonte nga krevati, Sharlotë, - i ulëriti infermiere Trençi.

Në çast dhomën e mbuloi terri.

Infermierja hapi derën dhe doli, teksa një dritë e dobët drejtkëndore nxori në pah trupin e saj vigan. Dera u përplas me zhurmë dhe dhomën e pushtoi sërish terri. Më pas, u dëgjua dhe zhurma e shulit që u mbyll. Sakaq, përqark Klarës gratë nisën të bënin zhurmë - rënkonin, kolliteshin, këndonin nën zë, mërmërisnin dhe qanin me dënesë. Klara dëgjoi kërcitjen e sustave të një krevati dhe ndjeu dikë që e preku në krah. Dikush qëndronte pranë shtratit të saj dhe dihaste. Ajo mbuloi kokën me batanije dhe mori pozicionin e fetusit. Vuri duart që i dridheshin mbi fytyrën e njomë dhe qau me dënesë, duke u lutur që të gdhihej sa më shpejt.

KAPITULLI 7



Izi

Një natë pasi kish hapur grumbullin e parë me valixhe të Uillardit, Izi rrinte shtrirë në shtrat me bluzë dhe të mbathura. Donte të fshinte çdo mendim nga koka, duke parë video muzikore në kanalin televiziv MTV, por pa dobi. Të gjitha çiftet e reja që putheshin, i sillnin ndër mend Klarën dhe Brunon, Etanin dhe prindërit e saj. Gishti i rrihte pa pushim nën fashë dhe i kujtonte Etanin të ulur në gjunjë, te këmbët e saj. Iu kujtua prekja e tij e ëmbël dhe flokët e zinj, si dhe buzëqeshja që rrezatonte kur e shihte në sy. *Ai ka të dashur,* mundohej t'i mbushte mendjen vetes. *Edhe sikur të mos kishte, do të ishte më mirë me dikë tjetër. Përveç kësaj, ai është një idiot arrogant, mos harro. Ndihmon të dashurën që të tallë të tjerët. Pse e mban mendjen tek ai?*

Ishte mesnatë, ndaj fiku televizorin dhe u shtri barkas, me shpresën se do ta zinte gjumi. Edhe pse ishte e rraskapitur, fytyra e Etanit qëndronte prapa qepallave të mbyllura: flokët e zinj pisë, sytë në ngjyrë argjendi. Papritmas, fytyra e tij u shndërrua në atë të të atit, sytë e tij pa jetë të ngulur diku dhe koka e gjakosur. Sakaq, u ngrit nga shtrati dhe hapi dritaret të ajroste pak dhomën. *Kështu fillon?* pyeti veten. *Kështu çmendet njeriu? Të njëjtat imazhe dhe mendime vërtiten pa pushim në trurin e tyre dhe ata nuk mund t'i ndalojnë? Çfarë problemi kam, xhanëm?*

Shkoi në tualet, lau për herë të dytë dhëmbët, piu një gotë ujë dhe u pa në pasqyrë. Sytë i kishte të mbufatur e të skuqur, pa dyshim, sepse kish qarë pak më parë. Uillardi, valixhet, Klara. Gjithçka e çonte shumë pranë shtëpisë. Po ta dinte se projekti i valixheve do t'i sillte ndër mend gjithë këto gjëra të tmerrshme që po mundohej t'i harronte, do të ishte munduar më shumë për ta shmangur. Gjithsesi, nuk donte të zhgënjente Pegin dhe Herrin, pavarësisht atyre që do të hiqte.

Ajo u habit që, edhe pse kish kaluar një kohë e gjatë, kujtimi i prindërve dhe imazhet e tmerrshme të ngjarjes së asaj mbrëmjeje ishin ende shumë të forta. Shumë shpejt do të mbushte tetëmbëdhjetë vjeç. Tashmë duhej ta kishte harruar atë ngjarje, duhej ta kish lënë pas të shkuarën dhe të ecte përpara. Por sa herë që mendonte për prindërit, i dukej se kthehej sërish shtatë vjeçe - një vogëlushe e tmerruar, e hutuar dhe e braktisur.

E kishte pushtuar frika se mund të përfundonte si e ëma dhe ta kalonte jetën e vetmuar dhe e mbyllur në një çmendinë apo burg. Sipas saj, kjo ishte arsyeja përse qante.

Si mund të bënte një jetë normale me gjithë këtë ankth që pluskonte në trurin e saj, gati për të shpërthyer? Si mund të shpresonte të kishte një marrëdhënie apo të martohej, duke qenë e vetëdijshme se mund të vinte në rrezik edhe dikë tjetër? Si mund të bëhej nënë, duke e ditur se mund t'i braktiste fëmijët papritur?

Kaloi gishtat mbi vragat që kishte në parakrah, duke u munduar të mposhtte dëshirën për ta gërricur lëkurën me thonj. *Jo,* mendoi, duke mbajtur me zor lotët. *Kam ecur shumë përpara për t'u kthyer sërish pas.* U kap fort pas cepit të lavamanit, derisa duart iu zbardhën. *S'do të dorëzohem kurrë. S'do të lejoj që e shkuara të më vulosë të ardhmen. Unë s'jam si nëna ime.*

Mori frymë thellë dhe i hodhi një grusht ujë fytyrës. Pastaj, shkoi sërish në shtrat, ndërsa flladi i freskët i mbrëmjes i ledhatonte këmbët e zbathura dhe flokët e hedhur mbi pjesën e sipërme të jastëkut. Fiku dritën, mbylli sytë dhe nisi të numëronte mbrapsht, e vetëdijshme se ishte e kotë, por mundohej të provonte gjithçka që mund të frenonte mendimet dhe imazhet që i vërtiteshin në kokë.

Papritur, dëgjoi një goditje në xhamin e dritares dhe hapi sytë.

Dukeshin si thonj që trokisnin lehtë dhe gërvishtnin xhamin. E dëgjoi sërish dhe u ngrit. Diçka rrëshqiti në murin anësor. Ajo u ngrit mbi krevat dhe mbajti frymën për të dëgjuar më mirë. Edhe dy trokitje të tjera të lehta - *tak-tak* - u dëgjuan në xhamin e sipërm. U ngrit dhe ndezi dritën.

- Izi? - u dëgjua nga jashtë një zë mashkulli.

E fiku sërish dritën dhe qëndroi në këmbë. Hodhi batanijen supeve dhe iu afrua dritares. Një *përplasje* tjetër e fortë e bëri të hidhej përpjetë.

- Izi! - tha sërish zëri i mashkullit, akoma dhe më këmbëngulës.

Ajo zgjati kokën në parvazin e dritares dhe u mundua të shquante ndonjë figurë në lëndinën e errët. Hëna e plotë formonte hije të gjata mbi bar, si të ishin pesë forma njerëzish të rreshtuara pranë telit të rrobave, këmishët dhe pantallonat e të cilëve dallgëzoheshin nga flladi i lehtë dhe flokët e gjatë e të shkatërruar valëviteshin si një varg flamujsh të zinj. Për një çast i ndali zemra. Fillimisht iu duk sikur ia kishin ngulur sytë një grup piratësh zombi, nga filmi i Xhon Karpenterit "Mjegulla". Pastaj kuptoi se nuk ishin gjë tjetër veçse siluetat e errëta të degëve dhe gjetheve, që dridheshin dhe fluturonin jashtë dhomës së saj. Mori frymë e lehtësuar dhe u mbështoll më shumë me batanije.

- Këtu poshtë! - thirri zëri.

Izi iu afrua më shumë dritares dhe kontrolloi pjesën e rruginës me zhavorr. Etani e shikonte nga qoshja e garazhit dhe fytyra e tij dukej si një maskë e bardhë në terrin e plotë. Kur arriti të shquante figurën e saj, ai hodhi guriçkat që kishte në dorë, mori një elektrik dhe e vendosi poshtë mjekrës.

- Surprizë! - tha ai me një pëshpëritje të fortë dhe zbardhi dhëmbët. Hijet e syve dhe të hundës që krijonte drita nën mjekrën e tij, dukeshin si maska bardhë e zi e një vampiri Hallouini.

Izi u zgjat jashtë dritares.

- Çfarë bën këtu? - e pyeti ajo, duke u munduar t'i shpërfillte rrahjet e zemrës.

- Të kam sjellë një dhuratë, - ia ktheu ai. Në dorë mbante diçka të sheshtë dhe katrore, në madhësinë e një libri xhepi.

- Është mesi i natës, - pëshpëriti Izi. - Mos të ka lënë gjë mendja?

Jo, prit, mendoi ajo, *s'ka problem.*

- Zbrit poshtë, - i tha Etani.

- Jo! - ia ktheu Izi. - Do të më hapësh probleme!

Atë çast, një makinë mori kthesën në rrugë dhe dritat e saj ndriçuan lëndinën dhe rruginën. Etani u struk prapa garazhit dhe, sapo makina iku, doli sërish nga vendi ku ishte fshehur.

- Mos bëj kështu, - vazhdoi. - S'do të të vonoj më shumë se një minutë. Të premtoj.

Izi kafshoi buzën. Çfarë donte ai këtu? Çfarë mund t'i kishte sjellë? Ishte e shtunë mbrëma. Pse nuk ishte me Shenonin? Zemra nisi t'i rrihte fort. Po sikur të ishte ndonjë rreng? Po sikur aty poshtë të ishte edhe Shenoni, në pritje për t'i punuar një rreng tjetër?

- Nuk zbres poshtë, - i tha. - Duhet të largohesh.

- Seriozisht e ke? - e pyeti ai mosbesues. - Erdha poshtë dritares sate në mes të natës për të të bërë një surprizë dhe ti më thua të largohem? Mendoja se ishim shokë, - tha dhe Izit mezi ia mbajti goja t'i thoshte se mund t'ia bënte surprizën të nesërmen në shkollë, kur ai shtoi: - Nëse nuk zbret poshtë, do t'i bie ziles së derës dhe do të të kërkoj.

Ajo psherëtiu.

- Prit pak, - i tha dhe mbylli perdet, hodhi batanijen mbi krevat dhe veshi një palë pantallona. Mori për nga dera, por pastaj u kthye mbrapsht dhe shkoi në tualet për t'u parë në pasqyrë. Flokët i ishin ngatërruar, rimeli i ishte përhapur gjithandej. Bëri gishtin me pështymë dhe u mundua të hiqte makijazhin e mbetur, u shkoi një krehër flokëve dhe i lidhi bisht. Hoqi bluzën dhe nxitoi te komoja për të marrë një tjetër.

Rrëmbeu sandalet në kuzhinë dhe doli në majë të gishtave nga dera e pasme. Sapo vuri këmbën në bar, veshi sandalet dhe nxitoi drejt garazhit e kërrusur. Fatmirësisht, dhoma e gjumit e Pegit dhe Herrit ishte në anën tjetër të shtëpisë, ndaj ata ndoshta nuk kishin dëgjuar asgjë. Etani e priste në anën tjetër të garazhit me dru kedre, duke ndriçuar me elektrik librin e vogël që mbante në dorë. Kur e pa Izin, e fiku menjëherë dhe drejtoi trupin.

- Çfarë bën këtu? - e pyeti ajo.

- Uroj që edhe ti të jesh mirë, - ia ktheu ai buzagaz.

- Çfarë do?

- Si e ke gishtin?

Ajo zgjati gishtin e lënduar dhe fasha e bardhë u duk si një fantazmë e vogël mes territ.

- Shumë mirë, - u përgjigj dhe kryqëzoi krahët. - Ja ku zbrita. Ta plotësova dëshirën. Atëherë, ç'na qenka kjo surprizë kaq e madhe?

Ai ngriti librin, duke e ndriçuar me elektrikun e dorës. Drita reflektoi mbi kapakun e gjelbër, ku ishin stampuar zambakët, dhe në pjesën anësore prej lëkure të zezë. Ishte ditari i Klarës.

Izi ia rrëmbeu nga duart dhe e pyeti:

- Çne ti me këtë? Nuk duhej ta kishe marrë!

- Qetësohu, - i tha ai. - E kam marrë hua.

- Nuk është yti, - iu hakërrye ajo.

Etani u ngrys dhe vazhdoi:

- Ti po e lexoje. Përveç kësaj, ajo e çmendura ka vdekur me kohë...

- Nuk ka rëndësi! Nuk duhej ta kishe marrë.

- E pashë që nuk po ia shqisje sytë dhe mendova se doje ta lexoje.

- E di se në ç'telashe mund të futesh që e ke marrë këtë ditar? - e pyeti ajo, e çuditur që fliste gjithë mllef. - Është pronë shtetërore!

- O Zot! - tha Etani dhe zgurdulloi sytë. - Mund të qetësohesh? Mund ta kthejmë pasi ta kesh lexuar. Do ta fusim sërish në valixhe të shtunën tjetër, kur të shkojmë në magazinë. Nuk prish punë. Askush nuk do ta marrë vesh që nuk është aty.

Ajo i zgjati ditarin.

- Ktheje atje ku e more.

- Si të duash, - i tha duke mbledhur supet. - Po e marr. Më fal që të shqetësova, - tha, mori ditarin dhe bëri të largohej. - Do të shihemi.

Ajo shtrëngoi dhëmbët dhe mendoi se ai kishte të drejtë. Kishte shumë dëshirë ta lexonte ditarin e Klarës, por jo në këtë mënyrë. Kishte frikë se mund të futej në telashe, nëse e merrte pa leje. Por, nga ana tjetër, po sikur të mos i binte më në dorë?

- Prit, - i thirri, ndërsa ai u kthye buzagaz.

- Ndërrove mendje?

- Ndoshta, - ia ktheu ajo.

Etani u mbështet pas murit të garazhit dhe i zgjati ditarin.

- Thuhet se përndiqet nga fantazmat, e di? - e pyeti ai.

Ajo u vrenjt dhe e hutuar e pyeti:

- Kush përndiqet nga fantazmat?

- Spitali "Uillard".

Izi ia hodhi sytë ditarit.

- Ou! - ia bëri me shpresën se ai nuk do ta vinte re ngurrimin.

- Para nja dy javësh, disa nga miqtë e mi hynë tinëz atje dhe u llahtarisën. Në pavijonin e grave, njërin e gërvishtën në qafë dhe në spital dëgjuan një lloj rënkimi.

Izi u drodh e tëra.

- Sa e tmerrshme! - tha ajo.

- Unë mendoj se është fantastike, - tha Etani duke qeshur.

- E po, ti je paksa i çuditshëm.

- Ditari nuk është e vetmja arsye pse erdha deri këtu, - tha me seriozitet. - Doja të të kërkoja falje që ndihmova Shenonin të vendoste ato... ato gjëra në dollapin tënd. Ke të drejtë. Bëra diçka të tmerrshme dhe të ulët. Kur po e lexoje ditarin në magazinë, vura re se po qaje dhe...

Izi shtangu.

- Dëgjo, - i tha ajo. - Tani gjërat po më shkojnë shumë mirë dhe nuk dua t'u vë shkelmin. Nëse Pegi dhe Herri marrin vesh se ditarin e kam unë, me gjasë do të më kërkojnë të largohem.

- Lexoje në fundjavë dhe ma sill në shkollë të hënën. Do ta çoj sërish në vend. Askush s'do ta marrë vesh se e ke pasur ti. Të jap fjalën për këtë.

Izi psherëtiu dhe fërkoi me gishta kapakun e gjelbër. Gjithë këto vite nuk kish dashur gjë tjetër veç të depërtonte në mendjen e së ëmës, për të mësuar se pse, krejt papritur, një person i shëndoshë mendërisht mund të luante mendsh. S'mund të pyeste mjekët për këtë, pasi ata e kishin deklaruar plotësisht të shëndetshme. Ama, Izi e dinte shumë mirë. Tani, kishte në duar përgjigjet që kërkonte prej kohësh. Sapo deshi ta pyeste Etanin nëse mund t'ia jepte ditarin në klasë, befas, diçka tjetër i kaloi nëpër mend.

- Po Shenoni? - e pyeti. - S'besoj se asaj do t'i vinte mirë po ta

merrte vesh se ke qenë këtu, - i tha dhe, si për habinë e saj, Etani heshti. Po kruante zverkun me sytë përdhe, pastaj, pa Izin dhe u ngrys.

- Nuk është aq e keqe sa mendon ti, - i tha.

- Po, është, - ia ktheu ajo. - Fillimisht, u hoq sikur donte të ishte shoqe me mua, pastaj, filloi të më punonte rrengje. Është e tmerrshme.

- Ndoshta sillet ashtu kur është e rrethuar nga njerëz të tjerë, por kur jemi vetëm...

- Oh! - psherëtiu Izi, duke kryqëzuar krahët. - Pra, s'e vret shumë mendjen se si sillet me të tjerët, për aq kohë sa me ty sillet mirë?

- Jo, - ia ktheu ai. - S'është ashtu. Ne jemi lidhur që në klasë të tetë dhe vetëm vitin e fundit nisi të sillej... Nuk e di... ndryshe. Sa për dijeni, ajo ka kaluar shumë vështirësi.

Izi rrotulloi sytë dhe iu përgjigj:

- Ky nuk është justifikim. Mund të kapërcente gjithçka në jetë, pa qenë nevoja të sillej në atë mënyrë. E kam zët kur njerëzit fajësojnë këdo për sjelljen e tyre, përveç vetes.

- I ati e ka braktisur dhe e ëma është e alkoolizuar.

- Kjo nuk i jep të drejtë të jetë aq e poshtër! - tha dhe sapo nxori ato fjalë nga goja, një lëmsh iu mblodh në stomak nga pendimi.

Etani psherëtiu dhe vazhdoi:

- I ati ushtronte vazhdimisht dhunë mbi të dhe të ëmën. Kur Shenoni ishte dymbëdhjetë vjeçe, ndërhyri mes tyre dhe përfundoi në spital me trauma dhe një krah të thyer. E ëma nuk mund t'u tregonte të vërtetën mjekëve. Ajo i gënjeu dhe u tha se Shenoni ishte hedhur nga çatia e verandës, pasi mendonte se mund të fluturonte.

Izi u kapërdi. Nuk e imagjinonte dot që një baba mund t'i bënte keq fëmijës së tij apo një nënë të mos e mbronte fëmijën. Vërtet mamaja e saj ia kishte vrarë të atin, por ajo ishte çmendur dhe Izi donte të besonte se nuk kishte menduar kurrë për pasojat e atij veprimi. Duhej të kishte qenë medoemos e çmendur, ndryshe do ta dinte se Izi do të rrënohej nga humbja e të atit dhe kur policia të zbulonte se ç'kishte bërë, do t'i humbiste të

dy prindërit. Vetëm një njeri i sëmurë mendërisht nuk do ta mendonte këtë gjë. Por ishte për t'u çuditur, sepse para gjëmës së madhe, nëna e Izit kishte qenë tepër e kujdesshme. Nuk e lejonte të shkonte vetëm me shoqet në shkollë, edhe pse ndodhej dy lagje më tej, e detyronte të vishte jelek kamerdare në plazh, kur të gjithë fëmijët përplaseshin të lirë me dallgët dhe luanin në rërë, pa u penguar nga një jelek i trashë ngjyrë portokalli. Ajo gjithnjë e kish ditur se i ati e adhuronte, i blinte fustane të bukura dhe e shoqëronte në kursin e vallëzimit, madje, i kish premtuar se do t'i blinte edhe një poni kur të mbushte dhjetë vjeç. Edhe tani, pas gjithë asaj që kish ndodhur, Izi nuk e imagjinonte dot se prindërit mund ta lëndonin qëllimisht.

- Pas kësaj, - vazhdoi Etani, - babai i Shenonit e boshatisi llogarinë e tyre bankare dhe i la me gisht në gojë. Që prej asaj kohe, nuk morën më asnjë lajm prej tij. - Etani vështroi përdhe, dhe më pas i hodhi Izit një shikim lutës. - Të lutem, mos i trego askujt që t'i thashë këto gjëra. Kam folur më shumë se ç'duhet. Të gjithë e dinë këtë, por ajo do të më vrasë po ta marrë vesh se të kam treguar ty. Thjesht, doja që të kuptoje se si ndihet ajo.

Izi psherëtiu.

- Dëgjo, - i tha. - Më vjen shumë keq për të. Vërtet. Por do ta dish se çfarë mendoj unë? Me gjithë këto që mora vesh, jam edhe më e turbullt. Nuk e kuptoj dëshirën e saj për të lënduar njerëzit, kur e di shumë mirë se si mund të ndihen.

- Mendoj se ka aq shumë frikë të lëndohet, saqë bën të pamundurën që askush të mos përzihet me të. Ajo mendon se ka një hierarki, apo diçka të tillë, dhe duhet të qëndrojë gjithmonë në majë për të mbrojtur veten.

- Ti e beson vërtet këtë?

- Po, - iu përgjigj Etani. - Jam përpjekur të flas me të, jam munduar ta bëj të kuptojë se nuk ka pse... - tha dhe hodhi vështrimin diku gjetkë, ndërsa në fytyrë i lexohej dhembja. - Mendoj se tani për tani ajo më ka vetëm mua. Jam i vetmi që e kupton pse sillet në atë mënyrë. E ëma nuk e vë ujin në zjarr për asgjë dhe gjithë të tjerët i vijnë pas qejfit, sepse kanë frikë prej saj.

Oh, Zot! mendoi Izi. *Ai e dashka vërtet.* Dhe mendja i shkoi tek i ati, i cili nuk e kishte ditur se po martohej me një grua që një

ditë do të çmendej. Donte ta këshillonte Etanin të bënte kujdes, por, në vend të kësaj, mori frymë thellë dhe ndërroi temë.

- Si mund të ta kthej ditarin pa e marrë vesh Shenoni? Ajo u zemërua shumë kur më mbrojte dje.

- Po, - i tha ai. - Është shumë xheloze, ndaj duhet të tregohemi të kujdesshëm.

Izi hapi gojën për t'i thënë se Shenoni i dukej tip i ndërlikuar, e vështirë dhe egoiste, por ndërroi mendje.

- Lëre ditarin te dollapi yt, - tha Etani. - Do ta marr në mes të orëve të mësimit.

- Mirë. Numri i dollapit tim është... Oh, po ti e di shumë mirë se ç'numër ka, - tha më pas duke u zgërdhirë.

- Jam fajtor dhe nuk e mohoj, - tha Etani dhe ngriti duart lart.

KAPITULLI 8



KLARA

Uillard - një ditë pas shtrimit

Rrezet e diellit, bashkuar me thërrmijat e pluhurit, depërtonin përmes dritareve të larta me hekura, duke ndriçuar disi dhomën e errët, por pa e mposhtur dot të ftohtin. Pas një muri ishte instaluar një rresht me vaska njëqind e tetëdhjetë centimetra të gjata, secila e mbuluar me mushama dhe e rrethuar me tuba metalikë. Gjithë tubacionet ishin shtruar në dysheme dhe myku i përhapur gjithandej kish errësuar pllakat e dëmtuara. Infermieret jepnin urdhra dhe pacientet ziheshin, ulërinin e luftonin duke u munduar të rezistonin, që të mos i fusnin në vaskat me ujë akull të ftohtë.

Klara qëndronte lakuriq para njërës prej vaskave, me njërin krah mbështetur në kraharor dhe tjetrin që mundohej të mbulonte organin gjenital. Dyshemeja me pllaka bardhezi, dukej sikur ishte shtruar me akull. U drodh e tëra kur pa njërën nga infermieret ta mbushte vaskën me kubikë akulli. Infermiere Trençi dhe një paciente muskulore me njërin sy të mbyllur, qëndronin në pritje pranë rubineteve. Në vaskën tjetër, nga një e çarë në mbulesën e saj, shfaqej herë pas here fytyra e zbehtë e një gruaje, buzët e së cilës ishin mavijosur. Në anën tjetër të dhomës, dy ndihmësinfermierë po nxirrnin nga uji një grua pa ndjenja dhe po e çonin në tryezën e vizitave që ndodhej pak më larg.

- Hyr brenda, - i tha infermiere Trençi Klarës.

- Por unë... - nisi të thoshte Klara.

- Bëj si të thonë, apo e harrove? - iu hakërrye infermierja. - Është për të mirën tënde.

- Por unë... - tha sërish Klara me zë të dobët.

Infermiere Trençi eci përpara dhe e kapi nga krahu me dorën e saj gjigante.

- Ne jemi këtu për të të ndihmuar, - i tha e vendosur. - Kjo ka për të të qetësuar. Të kthjellon mendjen.

Para se Klara ta merrte vesh se ç'po ndodhte, infermierja e ngriti peshë dhe e zhyti në vaskë, duke e fundosur në ujin e akullt. Një dhembje i përshkoi kraharorin dhe iu duk se nuk kishte më ajër në mushkëri. Pa dashje, mori frymë, duke kapërdirë një sasi të mirë uji. U kap në anë të vaskës dhe doli në sipërfaqe me duart që i rrëshqisnin në porcelanin e lagësht. Duke u kollitur dhe duke u munduar të merrte frymë, përpiqej të qëndronte në këmbë. Për një sekondë, gjithçka iu errësua dhe e kuptoi se do të humbiste ndjenjat. Më pas, pacientja me një sy të mbyllur e kapi nga shpatullat dhe nisi t'i pastronte fytyrën dhe qafën, duke ia çjerrë lëkurën me një copë të ashpër. Më në fund, Klara arriti të mbushej me frymë. Pacientja e fërkonte poshtë krahëve dhe mes këmbëve me më shumë fuqi nga ç'ishte e nevojshme, duke i vrarë gjymtyrët.

Nga uji i ftohtë, Klarës i dukej sikur po e godisnin me një breshëri thikash. U përpoq të mos ngrihej për të dalë nga vaska dhe e la pacienten ta fërkonte, ndërsa trupi po i dridhej dhe po shpresonte se, sa më shpejt të mbaronte, aq më shpejt do të dilte prej saj. Infermiere Trençi rrinte e vështronte dhe krahët viganë i mbante të kryqëzuar mbi gjoksin e madh, ndërsa buzëqeshja e neveritshme i shtrembëronte gjysmën e fytyrës buçkane.

- Të lutem! - i tha Klara, duke e parë në sy. - Unë jam...

- Pusho, - iu hakërrye ajo duke tundur gishtin e trashë. - Jeta aristokrate në qendrën "Long Ajlënd" të ka bërë të dobët, kjo është e gjitha.

Klara mbylli sytë, duke pritur që pacientja të mbaronte sa më shpejt së lari flokët me finjë. Kur i derdhën mbi kokë kovat me ujë të ftohtë, mblodhi gjunjët në kraharor, i mbështolli këmbët me krahë, thuajse pa marrë frymë fare, dhe po dridhej aq shumë,

sa zemra dukej se do t'i shpërthente nga çasti në çast. Më në fund, pastrimi mbaroi dhe pacientja me një sy të mbyllur u tërhoq pas duke gulçuar.

- Dil, - i tha infermiere Trençi.

Duke u kollitur, pështyrë e duke u zvarritur Klara doli nga vaska. Pacientja me një sy të mbyllur i dha dhe një dorë të fundit duke e fshirë me një peshqir të ashpër.

- Do të të kishim lënë më gjatë në ujë të ftohtë, - i tha infermierja, - por sot ke takimin tënd të parë me doktor Roaçin. Bëj si të thonë dhe gjithçka do të shkojë vaj.

Pacientja me një sy të mbyllur i dha Klarës fustanin e verdhë dhe ndërresat. Dhëmbët po i kërcisnin në mënyrë të pakontrolluar dhe këmbët i ndiente aq të dobëta, sa mezi po e mbanin. Megjithatë, ia doli të vishte rrobat dhe të lidhte këpucët. Teksa u drejtua për nga dera, infermiere Trençi e urdhëroi ta ndiqte pas. Me flokët që i pikonin në fytyrë dhe në pjesën e pasme të qafës, ajo bëri si i thanë, fshiu ballin me pulovër dhe shkoi pas saj. Teksa ecnin në korridor, mbështeti dorën në bark. *A mund t'i mbijetonte një foshnjë e vockël, ende e palindur, një trajtimi të tillë?* Sytë iu mbushën me lot, zemra thuajse i pushoi dhe ndjeu një barrë të rëndë mbi supe. Nuk ishte e sigurt nëse do të mbijetonte, po t'i ndodhte gjë foshnjës së Brunos.

Klara e ndoqi infermiere Trençin përgjatë korridorit të gjerë të *Chapin Hall*-it, mes një dere të dyfishtë dhe një korridori me kthesa, derisa mbërritën në anën tjetër të ndërtesës. Lanë pas zyrën e telegrafit dhe farmacinë, për të mbërritur në një korridor të shkurtër, në fund të të cilit gjendej një derë. Në një nga tri karriget jashtë zyrës së doktor Roaçit, qëndronte kokulur një grua e zbehtë, trupvogël, me një pallto të kuqe, e cila mbante në prehër një kuletë lëkure. Ajo ngriti sytë dhe buzëqeshi.

- Mirëmëngjesi, infermiere Trençi! - përshëndeti gruaja. Dukej e re, thuajse në një moshë me Klarën, me mollëza të ngritura, flokë ngjyrë platini dhe lëkurën si porcelan. E gjithë fytyra i ndriti kur buzëqeshi, por në sy i lexohej një hije trishtimi. Klarës i ra në sy barku i saj i fryrë dhe nuk mund ta imagjinonte se ç'bënte këtu një vajzë shtatzënë, që priste të takohej me doktor Roaçin.

- Mirëmëngjesi, zonja Roaç! Sa kohë keni që prisni këtu? - e

përshëndeti infermierja, ndërsa Klara uli sytë dhe u mundua të fshihte tronditjen. Çne një grua kaq e bukur dhe e re të ishte martuar me një burrë njëzet vjet më të madh, veçanërisht me një mjek që punonte në një çmendinë?

- Oh, nuk e di, - u përgjigj zonja Roaç. - Jo shumë.

- E di ai që keni ardhur? - e pyeti infermierja, që qëndronte me njërën dorë mbështetur në derën e zyrës.

Zonja Roaç pohoi me kokë.

- E mora në telefon para se të vija, si gjithmonë. Më tha se do të dilte të bisedonte me mua kur të kishte kohë.

- Prit këtu, - ia ktheu infermierja duke vënë buzën në gaz. - Të shoh se si është puna.

Infermiere Trençi hapi derën dhe futi brenda Klarën. Në mes të dhomës, gjendej një tryezë e gdhendur me shije. Në mur, pas tryezës ishte varur një kornizë ari me portretin e një burri të moshuar dhe tullac, me monokël. Rreth e rrotull portretit, kishte korniza me diploma mjekësore dhe foto bardhezi burrash me kapela dhe grash me fustane të gjata. Të gjithë kishin dalë në hyrje të *Chapin Hall*-it. Në muret e tjera ishin varur foto të hekurudhave, fabrikave, kopshteve dhe rafteve të ndonjë farmacie të mbushura me mijëra shishe qelqi.

Doktor Roaçi rrinte ulur pranë tryezës dhe i buzëqeshte me çibuk në gojë infermiere Meit, e cila ishte ulur në një karrige të vogël, me këmbët e kryqëzuara dhe njërën anë të fundit të ngritur deri në mes të shalëve. Kur u hap dera, ajo u hodh përpjetë dhe u skuq e tëra, kurse doktor Roaçi ngriti sytë i trembur. Infermiere Trençi e shoqëroi Klarën drejt tryezës së tij.

- Sa herë të kam thënë të trokasësh para se të hysh në zyrën time? - iu drejtua ai.

- Të kërkoj ndjesë, doktor, - i tha infermierja me sytë e skuqur. - Nuk jam mësuar ende me rregullat e reja. Ndoshta do t'i mbaja mend po të mos ndryshonin çdo javë.

- Thjesht lëre pacienten, - i tha ai prerë. - Je e lirë të largohesh. Infermiere Mei do ta shoqërojë në mensë pasi të mbarojmë punë këtu.

- Po ju pret gruaja në korridor, doktor, - i tha infermiere Trençi. - Ta fus brenda?

Befas ai u ngrit në këmbë.

- Jo, - u përgjigj. - Do të dal unë jashtë ta takoj.

- Shumë mirë, - i tha Trençi që turfulloi dhe doli duke përplasur derën. Infermiere Mei ia kish ngulur sytë doktor Roaçit dhe një buzëqeshje nervoze i luante mbi buzë. Ballëngrysur, mjeku u drejtua për nga një derë xhami në të djathtë të tryezës.

- Çoje pacienten në dhomën e vizitave, - tha ai. - Unë do të vij pas pak.

Infermiere Mei mori një kartelë në dorë dhe hapi derën e xhamit.

- Këtej, Klara, - i tha ajo duke ngritur zërin pa qenë e nevojshme.

Klara e ndoqi për në dhomën e vizitave, duke u përpjekur të mos dridhej. Poshtë një dritareje tetëkëndëshe, dëgjohej zhurma e një radiatori prej gize, që e kish ngrohur njëtrajtësisht dhomën. Për një çast, Klara deshi të mbështetej atje.

- Hip te shkallët, - i tha infermierja, që vazhdonte të fliste me zë të lartë, sikur Klara të ishte e trashë e të mos dëgjonte mirë nga veshët apo sikur të mos kuptonte.

Infermierja shënoi gjatësinë dhe peshën e saj në kartelë e i mati temperaturën dhe tensionin. Më në fund, doktori hyri në dhomë dhe mbylli derën. Infermiere Mei tërhoqi një stol të vogël drejt tryezës së vizitave.

- Hiqe fustanin dhe ulu mbi tryezë, Klara, - i tha ajo.

- E di që po flet me mua, - ia ktheu Klara. - E di emrin tim.

- Si the? - e pyeti infermierja, duke ngritur vetullat përpjetë.

- S'është nevoja të bërtasësh dhe ta përmendësh gjithmonë emrin tim, - i tha Klara duke zbërthyer fustanin. Hoqi pulovrin, i zhveshi rrobat nga koka dhe ndërkohë që i mbante në krahë, vazhdoi: - Unë kuptoj dhe i kam veshët top. Nuk jam idiote, - tha dhe u ul në tryezën e vizitave të mbuluar me letër.

Me vetulla të ngrysura, infermiere Mei ia rrëmbeu veshjet dhe ia hodhi mbi karrige. Shikonte me sy të zgurdulluar nga doktori, si të priste që ai ta mbronte. Duke e shpërfillur bisedën, ai u drejtua nga lavamani për të larë duart, vuri një palë doreza plastike, mori stetoskopin nga një varëse në mur dhe e vendosi në vesh. E mbështeti mbi gjoksin e majtë të Klarës, mbajti vesh dhe

rrudhi vetullat. Era e llastikut dhe e kremit i shpoi hundët dhe mend nuk volli. Tani që trupi po i ngrohej, ndjeu pështjellim në stomak nga uria dhe të përzierat.

- S'e kuptoj pse është e nevojshme e gjitha kjo, doktor, - iu drejtua Klara. - Mund t'ju siguroj se jam plotësisht e shëndetshme.

- Është thjesht pjesë e procesit të shtrimit, - u përgjigj ai dhe vuri buzën në gaz. - Mos u shqetëso.

- S'është nevoja të më shtroni, - vazhdoi ajo. - Unë s'kam asnjë problem.

- Ëhë, - ia bëri ai dhe i mori kartelën infermiere Meit, që t'i hidhte një sy. Infermierja ia nguli sytë, si një qen kur pret të shpërblehet për sjelljen e mirë.

- Çfarë tha ajo? - e pyeti infermierja, ndërsa mjeku i hodhi një vështrim tërë inat.

- E diskutojmë më vonë, - ia ktheu ai, duke e parë vëngër.

- Ju lutem, - i tha Klara. - Më dëgjoni. Unë s'e kam vendin këtu. Im atë thjesht...

- Është thjesht një kontroll fizik, - e ndërpreu mjeku. - Do të flasim herë tjetër pse je shtruar këtu. Tani për tani, mundohu të bashkëpunosh, në rregull?

- Kur? - e pyeti Klara.

- Kur të vijë koha, do t'i them infermieres të të sjellë.

Klara psherëtiu, duke shtrënguar nofullat e zhgënjyer. Mjeku ia dha sërish kartelën infermieres, e cila e kapi me të dyja duart dhe gishtat e saj mbetën për disa sekonda mbi duart e tij. Më në fund, ai i buzëqeshi dhe e pa ëmbël. Infermiere Mei u çlirua.

Doktor Roaçi i kontrolloi Klarës reflekset me një çekiç gome dhe më pas i kontrolloi edhe veshët me një lente zmadhuese. Ai i kërkoi të zbriste nga tryeza e të përkulej, që t'i kontrollonte shtyllën kurrizore. Ajo bëri siç i thanë dhe ai kaloi gishtat përgjatë shpinës së saj, i tërhoqi krahët nga pas dhe e mbërtheu nga kyçet.

- Ndien ndonjë dhimbje në shpinë apo shpatulla? - e pyeti duke ngjeshur legenin në prapanicat e saj.

- Jo, - i tha Klara që po dridhej. Mjeku e lëshoi dhe ajo u drejtua, duke fërkuar kyçet e duarve. Ai vazhdoi duke ia vendosur duart mbi shpatulla e duke i tërhequr pas. Preku vertebrat e qafës dhe i ngjeshi gishtat pas skalpit të kokës, duke ndjekur formën

e saj. Zgjati duart dhe preku klavikulat e më pas, ia ngriti krahët lart, ia zgjati përpara duke e udhëzuar t'i mbante ashtu, ndërkohë që i bënte një kontroll poshtë sqetullave.

- Infermiere Mei, - foli ai, - do të qëndroni sërish në godinën e infermiereve sonte?

- Po, doktor, - u përgjigj Mei, me një zë që sa vinte e ëmbëlsohej.

- Si të duken dhomat? Ti e di që ne mundohemi shumë që punonjësit të ndihen sa më rehat këtu në Uillard.

- Dhomat e Uillardit janë më të mirat që kam parë ndonjëherë, - ia ktheu infermierja.

Para se të kuptonte se ç'po ndodhte, Klara ndjeu duart e doktorit mbi gjoksin e saj. Ai e shtrëngoi një herë, dy herë, i cimbisi thithat dhe më pas e lëshoi. Mbaroi aq shpejt, sa ishte e vështirë të përcaktoje nëse ishte pjesë e kontrollit apo diçka tjetër. Ajo uli krahët dhe mbuloi gjoksin. Kur u gjend përballë me të, u skuq e tëra, por mjeku e shpërfilli dhe hoqi dorezat. Shkoi sërish te lavamani dhe lau duart, duke i sapunisur e shpëlarë dy herë me ujë aq të nxehtë, sa lëshonte avull. I fshiu me një peshqir të pastër, vuri sërish dorezat dhe tërhoqi një spatul të drunjtë nga një kavanoz në raftin e barnave.

- Hip mbi tryezë, Klara, - i tha ai dhe ajo hipi sërish mbi tryezën e vizitave, ndërsa krahët i mbante ende mbi gjoks. - Të pëlqen Uillardi, infermiere Mei?

- Po, - u përgjigj ajo dhe u afrua sikur donte të shikonte fytin e Klarës. - Më pëlqen shumë.

Doktor Roaçi buzëqeshi i vetëkënaqur dhe ngriti spatulën.

- Hape gojën, - i tha Klarës. - Bëj "aaa".

Ajo bëri ç'i thanë, ndërsa mjeku ia ngjeshi gjuhën poshtë me shkopin prej druri. Kjo ishte e tepërt. Klarës iu përzje dhe volli mbi dorën e mjekut dhe përparësen e tij. Ai u tërhoq i neveritur dhe pa rrobat, kurse krahët i kish zgjatur përpara dhe buzët i kish shtrembëruar. Infermiere Mei shtangu në vend dhe kartela që mbante në dorë, i ra përmbys mbi një pellg të vjellash. Për një sekondë, po shihnin njëri-tjetrin me sy të zgurdulluar.

Më në fund, Mei erdhi në vete. Hapi kanatat poshtë raftit të barnave dhe nxori një mullar me peshqirë, më pas kapërceu të

vjellat përtokë dhe nisi të pastronte katrahurën nga përparësja e mjekut, që rrinte si hu, me buzët e mbledhura nga nervat. Ajo i zbërtheu përparësen dhe ia hoqi me shumë kujdes që të mos i ndoteshin rrobat. Më pas, i hoqi dorezat, i hodhi në kosh dhe lau me vrap duart. Doktor Roaçi u kthye mbrapsht, me shumë kujdes që të mos shkelte mbi të vjellat. Shkoi te lavamani dhe nisi të lante duart me një furçë të fortë, duke i fërkuar aq shumë, sa lëkura iu bë flakë e kuqe. Infermierja tërhoqi nga krahu Klarën, e cila po rrëmonte me thonj lëkurën.

- Si guxon ti! - iu hakërrye ajo. - Mos do të përfundosh në dhomën e izolimit? Këtë do?

- S'ka problem, - i tha doktori duke fshirë duart. - S'besoj se e bëri qëllimisht. Pastro rrëmujën që ta mbyllim sa më parë kontrollin.

Infermiere Mei ngrysi vetullat teksa merrte peshqirë të tjerë poshtë raftit.

- Të thërras infermiere Trençin të merret me këtë? - e pyeti ajo.

- Jo, - iu përgjigj mjeku. - Jepi Klarës një peshqir që të pastrohet dhe ta mbyllim këtë punë.

- Më fal! - i tha Klara teksa fshinte krahët dhe këmbët. - Nuk e bëra qëllimisht, thjesht...

- Nuk ndihesh mirë? - e pyeti ai. - Ke qenë sëmurë?

- Jo, - u përgjigj Klara që u mbush me frymë dhe e mbajti përbrenda, e pasigurt nëse duhej t'i tregonte të vërtetën. Ndoshta do ta trajtonin më mirë, po ta merrnin vesh se priste një fëmijë. Ndoshta do ta linin të lirë. Çmendina nuk ishte vendi i duhur për të sjellë në jetë një fëmijë. Me siguri edhe doktori do të ishte në një mendje me të. Ajo kafshoi faqen nga brenda, duke u munduar ta hiqte mendjen nga të përzierat. - Nuk jam sëmurë. Jam shtatzënë.

Mjeku shfryu dhe rrudhi vetullat.

- Ndoshta je nervoze ose ke ngrënë diçka që stomaku s'ta ka pranuar, - i tha ai.

Klara mohoi duke tundur kokën.

- Jo, - ia priti ajo. - Kam një të dashur dhe fëmija që pres është i tiji.

Doktori ngriti kokën dhe e tundi sikur do të miratonte diçka.

- Do të më tregosh për këtë më vonë, - i tha mjeku. - Unë jam këtu për të të ndihmuar, mos e harro. Tani duhet të shkosh në mensë të hash mëngjesin.

- Por ju jeni mjek, - i tha Klara. - Mund ta dalloni nëse jam shtatzënë apo jo. Me siguri edhe ju jeni dakord që spitali nuk është vendi i duhur për një grua shtatzënë.

- Kemi një gjinekologe që mund të bëjë kontrollet e nevojshme, - u përgjigj doktori. - Por druaj se sot nuk është këtu.

Klara po mendonte se përse duhej t'ia bënte pikërisht ai kontrollin e gjoksit, kur kishin një mjeke femër për këto gjëra, por e dinte që kjo ishte një humbje kohe. Më e rëndësishmja, ishte t'ia mbushte mendjen që ajo do të bëhej me fëmijë dhe mbështeti dorën mbi bark.

- Shikojeni barkun tim, - i tha. - E kam të fryrë.

Doktori bëri me shenjë nga rrobat e Klarës mbi karrige.

- Vishu, - i tha ai. - Po të jesh vërtet shtatzënë, do ta marrim vesh shumë shpejt, apo jo? Infermiere, të lutem, shoqëroje Klarën poshtë në mensë.

Infermierja që po pastronte dyshemenë me këmbë e me duar dhe kish mbledhur buzët gjithë inat, u ngrit dhe priti te dera derisa Klara u vesh.

- T'i them infermiere Trençit të vijë ta mbarojë pastrimin? - pyeti sërish ajo.

Doktori mohoi me kokë.

- Jo, ajo duhet të kujdeset për pacientë të tjerë këtë mëngjes. Merr ndonjë nga ndihmësit.

Mei u skuq në fytyrë dhe shtrëngoi nofullat nga nervat. Klara mbërtheu bluzën, duke menduar se, tani për tani duhej të bënte çfarë t'i thoshin. Doktor Roaçi i kishte thënë se do të bisedonin një herë tjetër. I kish mbetur edhe një mundësi që ta bënte të kuptonte se nuk ishte nevoja ta mbanin të shtruar aty. Ndoqi infermiere Mein përmes korridorit të *Chapin Hall*-it dhe dolën në fund të ndërtesës së parë. Një rojë hapi dyert e hekurta dhe i lejoi të kalonin, ndërsa nëpër korridore jehoi kërcitja dhe përplasja e metalit. Infermiere Mei e shoqëroi Klarën poshtë një

shkalle të ngushtë për në bodrum, ku u futën në një korridor të vogël prej guri për të shkuar në mensë.

Muret lara-lara prej betoni të mensës kishin një ngjyrë të zbehtë gri, ndërsa në qoshet e sipërme dukej lyerja e vjetër me bojë të bardhë. Dyshemeja, që dikur duhej të kish qenë ngjyrë blu, ishte e ngrënë dhe tërë gropa e në disa vende mungonin pjesë rrethore, sikur dikush ta kish gërryer gurin me lugë. Mensa mbante erë qumësht të prishur, lakër dhe graso. Me dhjetëra paciente qëndronin ulur në tavolinat e gjata, kurse rojat vinin vërdallë nëpër mensë dhe i mbikëqyrnin kur hanin. Infermiere Trençi dhe dy të tjera lëviznin poshtë e lart në fund të mensës, për të mbajtur në rresht disa paciente. Këto të fundit mbanin në dorë ca tabaka, ku vendosnin ushqimin që merrnin nga punëtoret e kuzhinës, të cilat ndodheshin në anën tjetër të një banaku të gjatë. Mes grave në rresht, ishin edhe gruaja me kukull dhe ajo që përpëlitej në shtrat. Kudo ku hidhte sytë, nuk shihte gjë tjetër veç vështrime të zbrazëta, sy të mbufatur dhe buzë të shtrembëruara.

- Duhet të shkojmë në dhomën me diell! - u thirri pacienteve të ulura në tavolina një nga rojat. - Pastroni rrëmujën që keni bërë!

Ato u ngritën dhe morën pjatat, por disa prej tyre nuk lëvizën vendit dhe vazhdonin të përtypnin të shushatura ushqimin e mëngjesit. Rojat i ngritën me zor nga stolat, duke ua rrëmbyer enët nga duart. Një paciente u orvat të hipte mbi tavolinë dhe e futi këmbën e zbathur brenda një pjate. Një prej rojave e mbërtheu prej krahu, duke e mallkuar teksa po e zbriste. Më në fund, arritën t'i bindnin të gjitha gratë që të hiqnin enët e tyre të kuzhinës dhe t'i nxirrnin nga mensa. Katër punëtore të mensës ngritën takëmet dhe pjatat e mbetura, ndërsa gratë e pavijonit të Klarës po mblidhnin ato të tavolinës së tyre. Infermiere Mei e shoqëroi Klarën përgjatë mensës për t'ia dorëzuar infermiere Trençit.

- Kjo paciente bëri një katrahurë në dhomën e vizitave të doktor Roaçit, - i tha Trençit. - Mjeku kërkon që, pas mëngjesit, t'i çosh një sanitare në zyrë për të pastruar rrëmujën.

- S'kam kohë të merrem me këto gjëra, - ia ktheu ajo vetullngrysur. - Ti je kryeinfermierja e tij dhe është detyra jote të kujdesesh për gjithçka që ndodh atje lart.

- Unë thjesht po zbatoj urdhrat, - i tha infermiere Mei, me kokën lart. - Ai më tha që të shkoje ti, - tha dhe ktheu kurrizin për t'u larguar, por ndërroi mendje. - Edhe diçka tjetër, - u kthye duke treguar me gisht nga Klara. - Ajo mendon se është shtatzënë. - Këtë të fundit e tha me zë të lartë, sikur po bënte ndonjë shpallje.

Infermiere Trençi zgurdulloi sytë dhe u nis drejt Klarës, por ishte tepër vonë. Nja dymbëdhjetë paciente kishin flakur tabakatë e i ishin turrur duke e kapur nga barku, një tjetër i prekte flokët, ndërsa njëra vajtonte dhe e kapte nga fytyra. Klara ishte ulur në bisht dhe krahët i kish mbledhur rreth kokës për t'u mbrojtur. Një tufë gishtërinjsh të pistë e preknin në gojë dhe e gërvishtnin nëpër faqe. Infermiere Trençi dhe rojat larguan gratë, duke u bërtitur që ta linin Klarën të qetë. Infermiere Mei u avit disa hapa për të parë ç'bëhej, me një buzëqeshje vetëkënaqësie në fytyrë.

- Lëreni të qetë! - u bërtiti Trençi pacienteve. - Merrni tabakatë dhe shkoni te tavolina! Urgjent, përndryshe do t'ju fusim në izolim!

Shumica e grave u bindën, ndërsa njëra u rrëzua dhe ulërinte e mbulonte kokën me duar. Dy roja e ngritën peshë dhe e tërhoqën zvarrë duke e nxjerrë nga mensa. Infermiere Trençi po e shihte Mein si e tërbuar kur kjo e fundit i tha:

- Do të raportoj me shkrim për këtë, - dhe ngriti supet përpjetë. - Edhe diçka tjetër, - vazhdoi. - E di doktor Roaçi që ti nuk i ke fare në kontroll pacientet e tua?

- Kam mbi pesëmbëdhjetë vjet që punoj me doktorin, - ia ktheu Trençi duke shtrënguar dhëmbët, - dhe do të vazhdoj të punoj edhe pasi të ikësh ti.

Infermiere Mei përpëliti sytë dhe u largua nga mensa. Trençi e mbërtheu Klarën për krahu dhe e çoi pranë banakut që të merrte mëngjesin.

- Qoftë e vërtetë apo sajesë ajo që tha, - i tha duke dihatur, - bën mirë të mos bësh zë. S'do të nxjerrësh gjë në dritë po ua tregove të gjithëve. Mjekëve s'u intereson fare dhe pacientet do të të shqyejnë.

Pas këtyre fjalëve e la Klarën në rresht dhe u largua. Një grup tjetër grash nisën të ecnin njëra pas tjetrës drejt dyerve në fund

të mensës. Klara mori një tabaka nga banaku dhe u mundua të qetësonte frymëmarrjen, ndërsa zemra po i buçiste në kraharor. Tabakaja kishte një gotë me çaj, ujë fare, një pjatë me katër kumbulla dhe një copë bukë shumë të fortë. Me tabakanë në dorë gjeti një vend bosh në një tavolinë. Sapo u ul, gruaja përkrah i rrëmbeu bukën nga pjata. Klara e mbuloi ushqimin me trup dhe zgjati dorën që i dridhej, të merrte gotën me çaj. Nuk kishte uri, por e dinte se duhej të hante dhe të pinte për foshnjën e saj. Rrufiti një gllënjkë çaj. Nuk ishte aspak i ngrohtë dhe kishte shijen e urinës, megjithatë, e kapërdiu. Kumbullat ishin të forta dhe të thata, por u mundua t'i përtypte edhe ato.

Ndihmësit vinin lart e poshtë mensës, duke u thënë grave të nxitonin, që të ulej grupi tjetër i pacienteve. Në fund të tavolinës, qëndronte gruaja me kukull. Ajo filloi të ulërinte dhe të kapte për flokësh një paciente tjetër, e cila e gjuante në krah dhe orvatej t'i shpëtonte, ndërsa ndihmësit vrapuan drejt tyre për t'i ndarë.

- Po më vdes vajza urie, - klithi gruaja, duke mbërthyer me duart si kthetra copën e bukës që kishte tjetra. - Nuk e dëgjon si qan? Ajo do të hajë!

Një nga ndihmësit e mbërtheu nga krahët gruan që ulërinte dhe e ngriti pupthi nga tavolina. Tjetri e goditi në fytyrë, ia rrëmbeu kukullën dhe ia hodhi në cepin tjetër të mensës. Gruaja thirri me sa kishte në kokë dhe vrapoi pas saj, me fytyrën e shtrembëruar nga dhembja. Ra në gjunjë dhe e ngriti kukullën, duke e përkundur në krahë dhe duke qarë me dënesë. Rojat e ngritën në këmbë dhe e çuan sërish te tavolina, me një shikim të zbrazët dhe pa asnjë emocion në fytyrë. Gruaja u ul dhe nisi të këndonte një ninullë, duke përkundur kukullën me fytyrën e mbuluar nga flokët. Të gjithë nisën të hanin sërish.

Klara ia nguli sytë kumbullës së fundit, ndërsa stomaku po i përzihej gjithnjë e më shumë. Mendoi t'ia jepte kumbullën gruas që mbante kukullën, por e mori nga pjata dhe e futi në gojë, duke u munduar të mos e nxirrte teksa e përtypte dhe më pas e kapërdiu.

KAPITULLI 9



Izi

Të hënën pasdite, ditari i Klarës ishte ende në raftin e sipërm të Izit, mes librit të matematikës dhe të anglishtes. Për fat të keq, në ditar nuk kish gjetur asnjë nga përgjigjet që kërkonte, përkundrazi, ndihej edhe më e turbullt. Jeta në vitet '20 kish qenë magjepsëse dhe në ditar, si çdo vajzë e re, Klara kish shkruar se i duhej të përballej me pështjellimin dhe zhgënjimet e të qenit në prag të moshës madhore. Nuk gjeti asgjë që t'i linte të kuptonte se ajo nuk ishte mirë mendërisht. Gjë prej gjëje. Përveç edukimit me rregulla tepër të rrepta dhe hidhërimit për humbjen e të vëllait, dukej se Klarën e priste një e ardhme e ndritur, derisa u njoh me Brunon. Pikërisht atë çast, gjithçka mori një rrjedhë tjetër.

Mund të ishte shndërruar frika e Klarës për të mos qëndruar dot pranë njeriut të zemrës, në një sëmundje mendore? Mund të ishte edukimi i rreptë shkaku i nervozizmit, paranojës dhe iluzioneve të saj? Jo, nuk mund të ishte e vërtetë. Ditari i Klarës dukej si ai i një vajze të re me këmbë në tokë dhe e vetëdijshme për realitetin. Izi e dinte se, asokohe, mjekët nuk e kuptonin ç'ishte depresioni apo gratë që silleshin në mënyrë impulsive, por nuk arrinte ta imagjinonte se i ati e kish dëbuar vetëm sepse kish rënë në dashuri me një njeri të shtresës së ulët, siç e konsideronte

ai Brunon. Akoma dhe më e pabesueshme ishte se e ëma e Klarës nuk kishte bërë asgjë për të kundërshtuar vendimin e të shoqit. E gjithë kjo ishte e paimagjinueshme. Tani, Izin nuk e linte të qetë historia e Klarës. Më shumë se kurrë, donte të mësonte se ç'kishte ndodhur me të pasi kishte përfunduar në Uillard.

Gjatë pushimit të shkurtër mes orëve të fundit, po qëndronte pranë dollapit të saj, duke kafshuar buzën dhe duke vrarë mendjen se pse Etani nuk e kishte marrë ende ditarin. Ai kish qenë në shkollë atë ditë. E kishte parë bashkë me Shenonin nëpër korridore. E kish injoruar Izin kur i kish kaluar pranë, teksa qeshte dhe fliste me miqtë, sikur ajo të ishte e padukshme. Mezi ishte përmbajtur për të mos i shkuar pranë që ta pyeste nëse mendonte se ajo ishte një idiote. E kuptonte shumë mirë kur e vinin në lojë. Nxori librin e psikologjisë nga çanta e rrobave të fizkulturës dhe përplasi derën e dollapit. Ç'dreqin po kurdiste ai? Kishte pasur kohë të mjaftueshme për ta marrë ditarin.

Teksa ra zilja dhe po nxitonte nëpër korridor, po mendonte se ndoshta duhej ta kthente vetë ditarin në muze. Pyeste veten se si do të reagonte Pegi, nëse e kapte me presh në duar. Kishte bërë gjysmën e rrugës për në klasë kur u kujtua se esenë me temën"Të kuptojmë mendjen kriminale" e kish lënë te fletorja tjetër. U kthye dhe ia dha vrapit nëpër korridoret e zbrazëta, duke sharë veten që ishte hutuar, sepse tani do të vonohej për në mësim. Kur arriti te dollapi, pa Etanin që po mundohej të merrte ditarin. Ai u hodh përpjetë kur e pa.

- Më në fund! - i tha ajo. - Po filloja të dyshoja nëse të gjitha ato që më the atë natë, ishin fjalë boshe.

- Më fal! - i tha ai, i skuqur në fytyrë dhe mezi merrte frymë. - Shenoni është sjellë shumë çuditshëm sot. Më detyroi ta shoqëroja në të gjitha orët e mësimit, edhe pse unë isha vonë për të miat.

- A nuk je në orën e psikologjisë me të tani?

- Po, - ia ktheu ai dhe hodhi një vështrim në korridor. - I thashë të më ruante një vend sa të shkoja në tualet.

- Pse ke kaq frikë?

- Mendoj se ajo e ka kuptuar që diçka po ndodh.

- Çfarë do të thuash me këtë?

- Ajo e di që po punoj në muze me ty, - i tha Etani. - Dhe nuk u gëzua fare kur e mori vesh.

Izi kapsalliti sytë.

- Po pastaj? Kjo s'do të thotë se domosdoshmërisht po ndodh diçka.

- Ti nuk e njeh Shenonin.

Ajo turfulloi.

- Besoj se e njoh shumë mirë. Si e mori vesh që ne punojmë bashkë në muze?

Atë çast, Etani hodhi shikimin përtej Izit dhe u pre në fytyrë, ndërsa ajo u kthye për të parë ç'po ndodhte. Shenoni qëndronte në fund të korridorit dhe po i shihte me duart e kryqëzuara.

- Oh, dreqi ta hajë! - mërmëriti Etani. Ia la ditarin në dorë Izit dhe nxitoi drejt saj. - Ç'kemi, zemër? - i tha duke u munduar të mos binte në sy. - Izit i ishte bllokuar dollapi dhe më kërkoi ndihmë për ta hapur.

Shenoni nuk ia ndau sytë derisa ai shkoi pranë, pastaj, ia nguli sytë Izit. Ajo e vendosi sërish ditarin aty ku ishte, mbylli dollapin dhe nisi të ecte drejt tyre, me librat ngjeshur pas kraharorit si një mburojë antiplumb. Shenoni po e shihte vëngër dhe nuk ia ndau sytë për asnjë çast, derisa Etani e kapi për dore dhe e shoqëroi në klasën e psikologjisë. Izi po i ndiqte pas dhe shpresonte të gjente një vend bosh, sa më larg tyre. Shenonit i mbeti koka pas, i pëshpëriste diçka Etanit në vesh dhe qeshte; lëshonte një kakarisje të fortë, sikur po i tregonte ndonjë anekdotë. Kur mbërritën në klasën e psikologjisë, ndalën para derës së mbyllur. Shenoni ia hodhi duart në qafë Etanit dhe e puthi në buzë. Edhe ai ia ktheu puthjen dhe pastaj u tërhoq.

- Mjaft me kaq, - i tha. - Jemi shumë vonë.

Shenoni i hodhi një vështrim gjithë neveri Izit dhe tha:

- Punë e madhe. Do t'ia hedhim fajin Izi Popit.

Etani hapi derën dhe e tërhoqi Shenonin në klasë. Izi i ndoqi pas, duke u munduar të mposhtte dëshirën për t'i treguar Shenonit arsyen e vërtetë pse e kish gjetur Etanin pranë dollapit të saj. Përpara klasës, mësues Defoja po shkarraviste në dërrasën e zezë. Ca njolla djerse i ishin formuar në sqetullat e këmishës blu dhe xhinset e shpëlara i kish futur brenda këpucëve. Pavarësisht

stinës, ai kish veshur këpucë marshimi. Thoshin se ai jetonte në një apartament mbi stacionin e trenit dhe se pjesën më të madhe të parave që fitonte, i jepte për bamirësi. Sapo ata hynë, ua nguli sytë nëpërmjet syzeve me xhama të trashë.

- Faleminderit që na nderuat me praninë tuaj, - u tha ai. - Luani këmbët dhe zini vend.

Izi u çlirua kur pa se në fund të klasës ishte një bankë bosh. Ajo nxitoi drejt saj, ndërsa Etani dhe Shenoni u ulën në bankat e para.

Kur mbaroi së shkruari në tabelën e zezë, u ul në tryezën e tij dhe u kërkoi nxënësve të dorëzonin esetë. Pasi i mblodhi të gjitha, u ngrit në këmbë të shpjegonte mësimin e ri.

- Sot do të flasim për arsyet që e çojnë një njeri normal të kryejë papandehur një krim të tmerrshëm, - tha ai. - Si për shembull, të vrasin bashkëshorten apo bashkëshortin apo të vijnë të armatosur në shkollë për të vrarë shokët dhe shoqet e klasës. - Fliste dhe ecte lart e poshtë nëpër klasë, duke hequr këmbët zvarrë në dysheme. - Herë pas here, në lajme dëgjojmë histori të njerëzve normalë dhe të zakonshëm, që, pa shfaqur asnjë lloj shenje, bëjnë gjëra të tmerrshme. Kryejnë krime që tronditin personat që i rrethojnë, madje edhe ata që i njohin shumë mirë. Të gjithë mbeten të shushatur dhe orvaten të kuptojnë se çfarë ka ndodhur. Kur pjesa më e madhe e njerëzve marrin vesh ç'ka ndodhur, mendimi i parë që u vjen ndër mend, është se nuk ka mundësi që personi që njohin të jetë kriminel...

Izi u struk në bankë, duke u munduar të mos i dëgjonte fjalët e mësuesit. Mori stilolapsin, vizatoi një katror në fletore dhe i ra figurës sipër me qindra herë, duke i mështuar stilolapsit gjithnjë e më fort, derisa maja u thye.

- Pyetja që ngrihet, - vazhdoi ai, - është nëse këta njerëz dalin jashtë karakterit të tyre apo gjithmonë kanë qenë të prirë të veprojnë kështu? Çfarë mendon ti, Stoun?

Izi ngriti sytë. Disa nga nxënësit u kthyen për ta parë, me vetullat e ngritura përpjetë.

- Më falni! Mund të ma përsërisni edhe një herë pyetjen?

Të gjithë ia plasën gazit.

- Do ta vlerësoja shumë nëse nuk do të merresh me shkarravina dhe të tregosh më tepër vëmendje në mësim, - i tha mësuesi.

Shenoni ngriti dorën dhe mësues Defoja ia bëri me shenjë.

- Po, MekKenzi?

- Kam një ide, - tha Shenoni. - Ndoshta mund të ftojmë nënën e Izit të vijë në klasë dhe të na e shpjegojë më mirë se si funksionon mendja e një krimineli.

Izi ndjeu gjakun t'i hipte në tru. Askush nuk e kishte mësuar të fshehtën e së ëmës kaq shpejt. Ajo ia nguli sytë Shenonit.

- Çfarë do të thuash? - e pyeti Nikola, duke u shtirur si e shqetësuar, me një buzëqeshje false në fytyrë. - Çfarë ka bërë nëna e Izit?

- Oh, më fal! - tha Shenoni, duke u shtirur si e habitur. - Kujtova se e kishin marrë vesh të gjithë, - tha dhe, pa i hequr sytë nga Izi, vazhdoi: - Nëna e saj i ka vrarë babanë teksa ishte në gjumë. Tani e kanë mbyllur në Bedford.

Klasa psherëtiu në kor dhe një mori kokash u kthyen drejt Izit. Sy të zgurdulluar dhe të tronditur u drejtuan nga ajo. Vajzat mbuluan gojën me dorë, ndërsa djemtë bënë qepalla me njëritjetrin dhe qeshën. Të gjithë nisën të flisnin njëherësh.

- Është dënuar me vdekje? - pyeti njëri nga djemtë.

- Mund ta sjellësh këtu të na tregojë si ka ndodhur? - pyeti Luka.

- Cila është ngjyra e saj e preferuar, portokallia? - pyeti Nikola.

Mësues Defoja bëri disa hapa para dhe ndërhyri:

- Qetësohuni tani, - tha dhe ngriti duart. - Rrini urtë!

Asnjë s'ia vuri veshin. Vajza që ishte ulur pranë Izit, u ngrit dhe shkoi në një bankë tjetër. Luka hipi mbi karrige dhe zgjati duart si të gjuante me armë, ndërsa me gishtin tregues imitonte tytën e revoles.

- Bam! Bam! - bëri duke u shtirur sikur gjuante drejt Izit dhe pastaj, u kthye edhe nga shokët e klasës. Disa prej tyre u rrëzuan nga karriget dhe ranë përdhe, duke rënkuar dhe duke u shtirur si të vdekur.

Izi u ngrit vetëtimthi, mblodhi librat dhe u drejtua për nga dera. Etani u çua dhe e kapi për krahu për ta ndaluar.

- Prit, - i tha dhe më pas bërtiti me sa kishte në kokë. - Pushoni të gjithë! Bëni mirë t'i thërrisni mendjes dhe të mos silleni më si budallenj!

Të gjithë e mbyllën gojën duke e parë me sy të zgurdulluar.

- Ç'dreqin bën kështu, Etan? - i tha Luka. - Të paska rënë në kokë për Izi Popin?

- Po, Etan, - u hodh një djalë kokëkuq me quka. - E di *e dashura* jote që nxënësja e re t'i ka marrë mendtë? - Ai kishte zë të hollë, si femër, në kontrast me pamjen dhe përmasat e tij shtazarake. Nuk ishte i shëndoshë, thjesht trupmadh dhe muskulor. Nëse Izi e mbante mend mirë, ai quhej Xhosh.

Shenoni brofi në këmbë dhe ia largoi dorën Etanit nga Izi.

- Çfarë bën kështu? - iu hakërrye me fytyrë të shtrembëruar nga inati.

Klasa ra në heshtje të plotë, ndërkohë që të gjithë prisnin se ç'do të bënte Shenoni më pas.

- Të gjithë nëpër vende! - ndërhyri mësuesi, duke marrë situatën në kontroll. - Po dëgjova qoftë edhe një fjalë tjetër, do t'ju dënoj!

Shenoni e tërhoqi Etanin për ta larguar nga Izi dhe u ul, buzëvarur. Ajo e pa ngultas me sytë që i shkreptinin dhe më pas, u drejtua nga dera.

- Të lutem, kthehu në vendin tënd, Stoun, - iu drejtua mësuesi. - Mos lejo që një tufë rrugaçësh të përfitojnë prej teje.

Izi ndaloi aty ku ishte, përballë derës, ndërsa zemra i rrihte fort në kraharor. S'dinte ç'të bënte, të qëndronte apo të largohej, sepse nuk e dinte nëse do të futej në telashe po të ikte nga mësimi. Më pas, mësuesi tha:

- MekKenzi, je e dënuar për një javë.

- Çfarë? - tha ajo duke u ankuar. - Çfarë bëra unë?

- Çfarë bëra unë? - u dëgjua një zë tallës nga fundi i klasës. - Si zakonisht, unë thjesht po argëtohem në kurriz të dikujt tjetër. - Izi u kthye të shihte se kush foli dhe pa Aleksën. Ajo ishte mbështetur në parvazin e dritares, rrinte e ngrysur dhe fliste gjithë sarkazëm. - Të gjithë e dinë se nëna ime është e alkoolizuar dhe babai na ka braktisur. Mund t'ia hedh paq për gjithçka, sepse unë jam një vajzë e gjorë dhe e turbulluar.

- Mbylle gojën! - i bërtiti Shenoni dhe u ngrit nga banka e saj e u turr drejt Aleksës, por Etani e frenoi.

- MekKenzi! - bërtiti mësuesi. - Mos ke qejf të pezullohesh nga shkolla?

- Ajo është gënjeshtare! - tha Shenoni, duke u munduar të çlirohej nga mbërthimi i Etanit.

Disa nga nxënësit panë njëri-tjetrin në sy, duke tundur kokat dhe rrotulluar sytë. Të tjerët ulën shikimin, sikur ndiheshin në siklet që po e shihnin Shenonin ashtu, të rrënuar.

- Qetësohu! - i tha Etani asaj.

- Ti je kuçkë! - iu kthye Shenoni Aleksës duke bërtitur. - Ashtu si jot ëmë!

- Mjaft! - thirri mësuesi. - Etan dhe Shenon, shkoni në drejtori, menjëherë! Dilni nga klasa!

Etani e mbërtheu Shenonin nga kyçi i dorës dhe e tërhoqi jashtë, teksa ajo shante gjatë gjithë kohës. Nxënësit shpërthyen në fjalë, kurse Izi vazhdonte të qëndronte para klasës, me librat ngjeshur pas kraharorit e me një lëmsh të nxehtë të mbledhur në fyt. Nuk dinte ç'të bënte, të kthehej sërish në vendin e vet apo të kërkonte leje për të shkuar në tualetin e vajzave, që të mblidhte veten. Mësuesi u mundua të vendoste qetësi në klasë, por askush nuk po e dëgjonte. Izi fshiu sytë dhe u kthye sërish në vend. Pas shumë përpjekjesh, klasa ra në qetësi dhe mësues Defoja mbaroi së shpjeguari mësimin, fjalët e të cilit Izit nga njëri vesh i hynë e nga tjetri i dolën.

Pas mësimit, ajo nxitoi për te dollapi, futi fletoret dhe ditarin e Klarës në çantën e shpinës dhe u nis drejt tualetit të vajzave. Mezi priste që asaj dite t'i vinte fundi. Sapo të shkonte në shtëpi, do t'i tregonte Pegit se ditarin e kishte ajo. Shpresonte që ta falte dhe të mos e dërgonte në një familje tjetër kujdestare. Në mendime e sipër hapi derën e tualetit dhe mori kthesën për nga rreshti i banjave, por ndaloi në çast. Shenoni ishte mbështetur pas kaloriferit, me fytyrën e kuqe dhe sytë e mbufatur. Kristali dhe Nikola i qëndronin pranë me peceta në duar dhe i fërkonin shpatullat.

- Zhduku që këtej! - i ulëriti Shenoni dhe Izi bëri të largohej, por ndërroi mendje dhe u kthye të përballej me të.

- Dëgjo, - i tha ajo, duke qëndruar pranë derës. - S'e kam idenë pse më urren kaq shumë, por e kuptoj se çfarë po përjeton. Është e vështirë të kesh prindër që nuk shkojnë me njëri-tjetrin.

Shenoni rrufiti hundët dhe drejtoi trupin.

- Më dëgjo mirë, dështake! - iu hakërrye, duke hedhur drejt saj një pecetë të përdorur. - Ti s'di asgjë për mua dhe s'ke për të mësuar kurrë gjë!

Izi kafshoi faqen nga brenda, si për të mposhtur dëshirën që ndiente për t'ia përplasur të vërtetën në fytyrë. Më shumë se gjithçka, donte t'i thoshte të logjikonte dhe të mos ua nxirrte inatin të tjerëve, por kishte frikë se, po të niste, nuk mund ta ndalonte më njeri. Përveç kësaj, s'do të fitonte asgjë. Ndoshta ajo dhe Shenoni mund të bënin një marrëveshje. Të paktën, mund të silleshin në mënyrë të qytetëruar me njëra-tjetrën derisa të diplomoheshin. Ia vlente barra qiranë ta provonin. Siç thoshte ngaherë gjyshja e saj, *armikut mund t'ia hash kokën me të mirë.*

- E po, - vazhdoi, - ndoshta edhe mund të flasim ndonjëherë. Kur erdha për herë të parë këtu, m'u duk se doje që të bëheshim shoqe. Ndoshta mund ta nisim gjithçka nga e para.

- Nga e para do të fillosh një punë tjetër. Nuk dua të punosh më me të dashurin tim.

Izi mblodhi supet dhe tundi kokën.

- Më vjen keq, por kjo gjë s'ka për të ndodhur kurrë.

Shenoni lëvizi drejt saj, ndërsa Kristali dhe Nikola e ndoqën pas, me krahët e kryqëzuar në gjoks.

- Po ta dije ç'është më e mira për ty, do të bëje si të them unë, - i tha Shenoni.

Para se Izi të kthente përgjigje, vajzat e mbërthyen dhe e ngjeshën pas murit.

Izi luftonte dhe orvatej të shpëtonte, duke i lëvizur shpatullat sa para-mbrapa. Shenoni i doli përballë, duke i shuar kështu çdo fije shprese për t'ia mbathur. Vajzat e mbanin Izin nga krahët, ndërsa Shenoni me gishtin mbi buzë, mendohej.

- Hëm, - ia bëri ajo. - Çfarë duhet të bëj, që të të jap një mësim të mirë?

Atë çast, dikush shkelmoi derën e njërës prej banjave dhe një zhurmë e fortë jehoi si bubullimë në tualetin me tavan të lartë.

Një zë vajze u dëgjua të thërriste:

- Lëshojeni!

Ato e lëshuan dhe Izi eci ca hapa para. Aleksa qëndronte pranë lavamanëve, flakë e kuqe në fytyrë dhe mezi merrte frymë.

- Seriozisht e ke? - i bërtiti ajo Shenonit. - Po e sulmoni në grup nxënësen e re? Nuk mendon se duhet të ndryshosh?

- Po e tepron më shumë se ç'duhet sot, - i tha Shenoni dhe e shtyu Aleksën, e cila humbi ekuilibrin dhe u mundua të kapej pas cepit të lavamanit për t'u mbajtur. Shenoni nisi të ecte drejt saj, por Izi i doli përpara.

- Lëre të qetë atë! - i tha ajo ndërsa Shenoni iu afrua ballë për ballë.

- Përndryshe, çfarë do të bësh? - iu hakërrye Shenoni. - Do të marrësh armën e mamit dhe do të më qëllosh?

- Jo, - i tha Izi. - Do të të marr të dashurin. Dukej se linte kokën pas meje kur erdhi në shtëpinë time një natë.

Shenoni zgurdulloi sytë dhe u bë flakë e kuqe në fytyrë. Bërtiti dhe deshi ta kapte për fyti me gishtat e saj të lyer me manikyr. Aleksa e tërhoqi Izin dhe të dyja dolën me vrap nga tualeti nëpër korridore e derisa dolën jashtë, ku u drejtuan për nga autobusët.

- Faleminderit! - i tha Izi, duke u munduar të qetësonte frymëmarrjen.

- S'ka përse, - ia ktheu Aleksa. - Të thashë të ruheshe prej saj, - tha dhe hodhi një vështrim pas. - Dreqi ta hajë!

Izi u kthye dhe pa Shenonin, Kristalin dhe Nikolën që po kalonin trotuarin dhe po vinin drejt tyre.

- Nxito! - i tha Aleksa dhe e tërhoqi drejt parkingut. Ato çanë rrugën mes tre rreshtave me automobila, duke iu shmangur dyerve të hapura dhe duke nxituar përmes nxënësve. Më në fund, arritën te makina e Aleksës. Ajo hapi dyert dhe hynë brenda. Futi çelësin në kuadër dhe ndezi makinën. - Vëre rripin e sigurimit.

- Por duhet të marr autobusin për t'u kthyer në shtëpi, - i tha Izi. - Nuk duhet të udhëtoj me askënd që Pegi dhe Herri nuk e njohin, apo harrove?

- Forca! - tha Aleksa, rroku levën e marsheve dhe ia bëri me shenjë nga autobusët. - Të shohim nëse arrin atje para tyre.

Izi pa nga xhami i përparmë i makinës. Autobusët ndodheshin në anën tjetër të parkingut, përtej trotuarit dhe një rripi të gjerë bari. Shenoni dhe shoqet e saj po çanin përmes dy makinave, vetëm tri vende parkimi larg.

- Më premto se do të më vish për vizitë në shtëpi dhe do të prezantohesh, - i tha Aleksës.

- Patjetër, - iu përgjigj ajo, duke i futur marshin makinës. Doli nga parkingu, mori kthesën majtas dhe u largua me shpejtësi, ndërsa puplat e palloit që kishte varur në pasqyrën e pasme lëkundeshin sa andej-këtej. Teksa po largoheshin, Izi u kthye pas dhe pa Shenonin, Kristalin dhe Nikolën në trotuar, me fytyrat e skuqura dhe flokët e shpupuritur nga era. Shenoni i shau duke u nxjerrë gishtin e mesit.

Aleksa e pa nga pasqyra.

- O Zot! - tha ajo. - Tani jemi përgjithmonë në listën e saj të zezë.

- Për ç'arsye të kishte në listën e saj të zezë? - e pyeti Izi. Aleksa kapi çantën dhe nxori një paketë cigaresh, duke i ofruar edhe Izit një.

- Jo, faleminderit, - ia ktheu ajo.

Aleksa tërhoqi një cigare me dhëmbë dhe rrëmoi në çantë për të gjetur çakmakun.

- Dikur kemi qenë shoqe të ngushta, - filloi ajo me cigare në gojë. Pasi e ndezi, e futi sërish çakmakun në çantë dhe e thithi cigaren gjatë. Uli xhamin nga ana e saj dhe e shfryu tymin jashtë. - Derisa ime më i tregoi së sajës se ç'bënte i ati i Shenonit.

- Mendova se e ëma e dinte që ai e rrihte.

Aleksa ia nguli sytë vëngër.

- Po ti nga e di që atë e rrihte i ati?

- Ma tha Etani.

- Ka ardhur vërtet në shtëpinë tënde?

- Po.

Aleksa lëshoi një fërshëllimë të gjatë.

- Mendova se e the vetëm për të xhindosur Shenonin. Si ndodhi? Doja të thosha, çfarë donte ai te ty?

- Punojmë bashkë në muze, - u përgjigj Izi. - Donte të më kërkonte falje që më punoi një rreng. Më tha se donte që të ishim shokë.

- Ua! - u habit Aleksa. - Ti je pa dyshim në krye të listës së zezë të Shenonit! - qeshi dhe e thithi edhe një herë cigaren. - Të paktën s'do të jem më në qendër të vëmendjes së saj.

- Pse të urren aq shumë?

Ajo ndali në semafor dhe ia nguli sytë Izit, sikur po i analizonte besnikërinë nëpërmjet ngjyrës së syve.

- Po ta tregova, - i tha, - më jep fjalën që s'do t'ia thuash askujt? Kurrën e kurrës!

- Të premtoj, - i tha Izi.

- Nuk po mbroj Shenonin e as po tregohem besnike ndaj saj. Ajo është sjellë aq keq me mua, saqë nuk i detyrohem për asgjë. Dua ta përfundoj këtë vit me sa më pak telashe që të jetë e mundur dhe të mos ia shoh më bojën këtij qyteti pas diplomimit. Do të largohem dhe nuk do ta kthej më kokën pas.

- Nuk do t'i tregoj askujt, - i tha Izi. - Të jap fjalën.

Semafori u hap dhe Aleksa nisi sërish ta ngiste makinën duke e thithur edhe një herë cigaren. Izi priste, duke mbajtur frymën.

- Nuk e kam fjalën për faktin se i ati e rrihte, - i tha Aleksa, prerë. - E kam fjalën për diçka më të keqe.

Izi ngriu në vend. Iu desh pak kohë që të formulonte pyetjen e radhës. Ajo u kapërdi para se të fliste.

- Çfarë i ka bërë tjetër?

Aleksa fiku cigaren në tavllën e duhanit dhe mbylli dritaren.

- Siç të thashë, - iu drejtua ajo, - unë dhe Shenoni kemi qenë shoqe të ngushta. Asaj i pëlqente shumë t'i kalonte fundjavat në shtëpinë time, por nuk donte kurrë që unë të rrija në të sajën. Nuk më bënte shumë përshtypje kjo gjë dhe, në njëfarë mënyre, ndihesha e çliruar, sepse i ati më ngjethte mishtë. Më dukej se më shikonte me ca sy që nuk më pëlqenin. Kur ishim rreth dymbëdhjetë vjeçe, e gjeta Shenonin duke qarë në shtëpinë e saj mbi pemë. E kuptova menjëherë se duhej të kish ndodhur diçka. Më tha se babai i futej natën në shtrat dhe besoj e kupton...

Izit iu pështiros dhe presioni i zemërimit që ndiente, u zëvendësua nga diçka e zbrazët dhe e ftohtë.

- O Zot i madh! - tha ajo. Mllefi i papërmbajtur që kish grumbulluar, si një balonë me ajër të nxehtë, u shfry, duke ia lënë vendin ca emocioneve të forta.

- Shenoni më detyroi t'i premtoja se nuk do t'ia tregoja askujt, - tha Aleksa. - Kurrën e kurrës. Ditët e para nuk dija ç'të bëja. Nuk shkova më në shtëpinë e saj, nuk i flisja as në

shkollë, s'bëja gjë prej gjëje. Isha e tronditur dhe nuk po arrija ta mblidhja veten nga ajo që sapo kisha mësuar. Më kupton? Më në fund, e kuptova se s'mund ta mbaja të fshehtë. Duhej ta ndihmoja Shenonin. Ishte shoqja ime e ngushtë. I tregova nënës dhe ajo i tregoi asaj të Shenonit, e cila e kishte ditur me kohë këtë gjë.

Izi u zmbraps dhe i erdhën zorrët në gojë.

- E ëma e Shenonit e dinte dhe nuk kish bërë asgjë? E pranonte atë veprim?

- Po dhe jo. Kur ime më u ballafaqua me të, më në fund ajo i tha diçka të shoqit. Një zënkë e madhe shpërtheu mes tyre, që përfundoi në dhunë fizike, siç ndodhte ngaherë. Por këtë herë, Shenoni u përpoq ta ndalonte të atin që të mos e vriste nënën dhe përfundoi në spital. Kur i shkova Shenonit për vizitë, ishte bërë si e xhindosur. Tha se kishte ndërhyrë mes prindërve të saj, sepse ishte hera e parë që e ëma ishte përpjekur ta mbronte. Tha se ajo i kish ditur të gjitha dhe goja ime e madhe, që nuk kish ndenjur rehat, thjesht i kish përkeqësuar gjërat. Më tha se nuk donte të më shikonte më kurrë me sy. U ktheva në shtëpi duke qarë me dënesë dhe ime më njoftoi policinë.

- E arrestuan?

- Jo. Policisë nuk iu dha kurrë mundësia që të përfshihej në këtë çështje. Po atë mbrëmje, ai u largua dhe nuk u kthye më kurrë. Vetëm unë, Shenoni dhe nënat tona e dimë se çfarë përbindëshi ishte ai.

- Dreqi ta hajë! - tha Izi. - Pra, ai ia paska hedhur paq.

- Pak a shumë.

- Por unë ende nuk arrij të kuptoj një gjë. Pse të urren Shenoni?

- Sepse nuk e mbajta fjalën e dhënë. I tregova sime mëje çfarë po ndodhte me të.

- Ti po përpiqeshe ta ndihmoje.

Aleksa hodhi vështrimin nga Izi, me sy të përlotur.

- Po ti do të doje që dikush ta merrte vesh se babai yt ka abuzuar me ty?

- Pikësëpari, nuk besoj se do ta lejoja një gjë të tillë.

- Nuk ke nga ta dish këtë. Ai nisi të abuzonte kur ajo ishte e vogël, shumë e vogël për ta kuptuar mirë.

Izi uli vështrimin, ua nguli sytë atleteve ndërkohë që ndiente ca të përziera.

- Kjo është e tmerrshme!

- Më keq s'ka ku të shkojë.

- Por edhe pas kaq vitesh, Shenoni nuk arrin ta kuptojë që ti fole sepse e kishe për zemër?

- Ti ndoshta mendon se ajo duhet të ndihet e gëzuar që ai u largua nga sytë këmbët dhe e vërteta nuk doli kurrë në shesh. Në fakt, mendoj se shqetësohej më tepër se mos merrej vesh. Por asnjë nuk di gjë për këtë. Unë dhe ime më nuk i thamë kurrë njeriu. Ndoshta duhej ta kishim bërë. Ndoshta Shenoni do të ndihej më mirë po të shpëtonte edhe nga e ëma. Ti beson se ajo mund të linte gjithçka pas krahëve dhe të më falte? Unë ia theva besimin, njësoj si prindërit e saj, dhe nuk mendoj se do të jetë ndonjëherë në gjendje t'i kuptojë personat që ia duan vërtet të mirën. Nuk do ta kuptojë ndonjëherë se si ndihesh kur do dikë me gjithë zemër dhe kur jep dashuri. Ajo nuk e di se ç'do të thotë të të duan dhe të ndihesh e mbrojtur. Nuk e ka përjetuar kurrë këtë ndjesi, as nga prindërit e saj. Si mund ta presë një gjë të tillë prej meje?

- Po Etani?

- Etani nuk është gjë tjetër veçse një trofe në duart e Shenonit, sportisti i pashëm që të gjitha vajzat duan ta kenë. Ajo është tmerrësisht xheloze, por nuk i bëhet vonë për të. Ajo shkon në shtrat me gjysmën e skuadrës së futbollit dhe i ka hedhur hi syve atij djali.

- E di ai se ç'i ka bërë i ati?

- Nuk e besoj. Nuk e imagjinoj dot se mund t'ia thotë atij.

Izi gërmonte me thonj qoshet e ndenjëses prej lëkure dhe vështronte jashtë xhamit të përparmë të makinës. Nga njëra anë, i vinte shumë keq për Shenonin, por, nga ana tjetër, nuk e kuptonte pse i lëndonte të tjerët për t'u ndier më mirë. E kuptonte edhe që ishte e mbushur me mllef, por pse të mbrohej duke sulmuar dikë tjetër? Ajo vetë kish zgjedhur të lëndonte veten dhe jo ata që e rrethonin. Meqë i ati i Shenonit kish qenë përbindësh, nuk ishte e thënë që edhe ajo të ishte ashtu.

Kjo e bëri të kridhej në mendime dhe të mendonte për Klarën.

I ati i saj ishte një lloj tjetër përbindëshi. Edhe e ëma nuk kish mundur ta mbronte dot të bijën. Si Klara, edhe Shenoni ishin tradhtuar nga prindërit e tyre. Izi nuk po kuptonte dot asgjë dhe mendja i shkoi tek i ati. Ai kish qenë një njeri i mirë, babai më i mirë që mund të dëshironte një vajzë. Të paktën kish pasur një gjë të mirë në jetë, por ai nuk jetonte më. E ëma e kish larguar përgjithmonë nga jeta e saj. *Pse marrin mundimin njerëzit të sjellin në jetë fëmijë kur u shkaktojnë atyre vuajtje?*

- Dua të të them diçka, - i tha Aleksa, duke e shkëputur Izin nga mendimet e saj. - Unë dhe ti kemi diçka të përbashkët. Edhe im atë nuk jeton më.

- Më vjen shumë keq, - i tha Izi. - Pse vdiq?

- U aksidentua me makinë kur isha nëntë vjeçe, - i tha Aleksa.

- Pra, jeton vetëm me nënën tënde?

Aleksa ngriti supet.

- Po. Ajo është një nënë fantastike dhe i bie bretku në punë. Edhe kur nuk punon, shkon gjithmonë nëpër mediume. Edhe mua më pëlqejnë, por ajo është e fiksuar pas këtyre gjërave që të lidhet me tim atë.

- Të paktën e di që ata duheshin, - i tha Izi.

- Besoj se po, - ia ktheu Aleksa. - Ej, mund të të pyes për diçka?

- Patjetër, - i tha Izi.

- Nëse nuk ke dëshirë të flasësh, thjesht ma thuaj.

- Çfarë? - e pyeti Izi.

- Pse e vrau nëna jote babanë?

Izi ngriti supet.

- Nuk e di, - u përgjigj me sytë e mbushur me lot.

- Oh, kjo është e tmerrshme, - ia ktheu Aleksa.

- Po, - i tha Izi. - Ashtu është.

Pasi Aleksa e la pranë shtëpisë së Pegit dhe të Herrit, Izi bëri detyrat e shtëpisë, një dush dhe la ditarin e Klarës mbi tavolinën e kuzhinës. Pastaj, me zemër të ngrirë, priti që Pegi dhe Herri të ktheheshin në shtëpi.

KAPITULLI 10



KLARA

Në Uillard, Klara kaloi dimrin e parë më të gjatë të jetës së saj. Thuajse çdo javë, stuhi të furishme tundnin dritaret me shkulma të fuqishëm ere, duke i veshur xhamat me perde të trasha akulli. Ata mbuloheshin nga dëbora e njomë dhe retë e përhimëta në qiellin e zymtë ishin e vetmja gjë që Klara mund të shikonte mes hapësirave boshe. Ndihej e izoluar brenda një fortese të akullt gjigante. Imagjinonte sikur ajo dhe pacientet e tjera ishin prej akulli dhe, nga çasti në çast, do të thyheshin. Akulli përbëhej nga lotët, i përzier me baltë dhe gjak, dhe ajo mund ta shijonte këtë përzierje të kripur me buzët e plasaritura.

Ashtu si të gjitha pacientet gjatë javëve të para në Uillard, atë e kishin detyruar të ulej në dhomën me diell, tetë orë në ditë, shtatë ditë në javë. Pacientet lejoheshin të largoheshin prej atje vetëm për të ngrënë dhe gjatë pushimeve të planifikuara për të shkuar në tualet. Gjatë pjesës tjetër të ditës, deri pas darke, detyroheshin të uleshin në stola të fortë gur, të vendosur përgjatë mureve, ndërsa rojat i kontrollonin vazhdimisht për t'u siguruar që të mos shpërthenin në veprime të pakontrolluara apo të ngriheshin në këmbë. Klara mundohej ta kalonte peshën nga njëra ijë në tjetrën, por, në fund të javës së parë, lëkura e të ndenjurave dukej se i ishte acaruar dhe kish filluar t'i gjakosej.

Një mëngjes të shtune u ngrit në këmbë për herë të parë pa marrë leje dhe me lotët e dhembjes në sy, pyeti nëse mund të shkonte në tualet. Rojat që ishin me shërbim atë ditë, Deni dhe Riçardi, ishin ulur në karrige portative në mes të dhomës e po luanin poker. Pacientet e tjera qëndronin ulur, kishin varur kokat, të mbështetura pas murit, flinin, qanin, jargaviteshin, këndonin apo zgurdullonin sytë përreth dhomës, si të shikonin njerëz të padukshëm.

- Po më përzihet, - tha Klara, me njërën dorë në stomak.

Riçardi vendosi letrat mbi tavolinë, u ngrit dhe u kthye fytyrëngrysur nga ajo.

- Ulu! - e urdhëroi ai, duke ia bërë me shenjë drejt stolit. - Pas një ore ke pushimin për të shkuar në tualet.

- Por duhet të shkoj tani, - i tha. - Të lutem!

Riçardi me kokën lart e shpatullat drejt, iu afrua dhe ndaloi disa hapa larg saj.

- Të thashë të ulesh!

- Nuk mund të silleni kështu me njerëzit, - ia preu ajo duke tundur kokën. - S'është e drejtë!

Riçardi puliti sytë dhe nxori gjuhën jashtë, duke e përqeshur. Për një çast iu duk se para saj qëndronte një djalë gjashtëvjeçar, që po zihej në oborrin e shkollës. Më pas, ai u afrua edhe një hap.

- Kam urdhër që ju të rrini ulur, - i tha ai, ndërsa buza e sipërme i dridhej.

Klara u orvat t'i shkonte pranë, duke e mbajtur njërën dorë para gojës, por ai e mbërtheu me duart si kthetra. Ajo e goditi në krah, teksa roja po e tërhiqte zvarrë në mes të dhomës. Përdrodhi kyçin duke u përpjekur t'u shpëtonte kthetrave të tij, por ishte e kotë. Riçardi e kish mbërthyer si ganxhë.

- Më lësho! - bërtiti ajo. - Detyra juaj është t'i ndihmoni njerëzit dhe jo t'i torturoni! Më pas, pa mundur të përmbahej, u përkul dhe volli në dysheme e për pak ia llangosi atij këpucët.

Ndërkaq u ngrit edhe roja tjetër. Një nga pacientet nisi të ulërinte dhe të qante, ndërsa një tjetër u sul me vrap për nga dera. Një e tretë u ngrit në këmbë, duke u tundur sa andej-këtej, ndërsa njëra prej këtyre ecte tutje-tëhu, tundte kokën dhe shtrëngonte duart. Infermiere Trençi u sul turravrap në dhomë dhe i urdhëroi pacientet të uleshin.

- Çojeni në dhomën C! - bërtiti ajo.

Riçardi e tërhoqi Klarën zvarrë jashtë dhomës e nëpër korridor, si të ishte fëmijë. Hapi një derë dhe, duke mërmëritur i zemëruar e i neveritur, e shtyu brenda një dhome me një shtrat e pa dritare. Mandej, e ndoqi pas, duke mbyllur derën pas tij. Ajo u pengua, por arriti të gjente një pikëmbështetjeje. Teksa ai avitej drejt saj, ajo sprapsej, me këmbët dhe krahët që i dridheshin si zog. E gjeti veten të mbështetur pas murit dhe, pa e kuptuar, Riçardi kish ngritur dorën duke i dhënë një goditje të fortë në fytyrë, sa koka i fluturoi anash dhe flokët i mbuluan fytyrën. Ajo mbështeti dorën mbi faqen e nxehtë që i rrihte nga goditja dhe ia nguli sytë, ndërsa lotët i shkonin çurg.

Roja e rroku nga krahët dhe e shtyu mbi shtratin që gjendej në mes të dhomës, e ngriti lart dhe e rrasi me sa fuqi kishte mbi dyshekun e pistë. Në dhomë erdhi edhe një rojë tjetër që e mbante, dhe duart e tij të forta po ia dërrmonin krahët.

Ashtu, e shtrirë siç ishte në shtrat, përpiqej t'i godiste me këmbë, me sa fuqi kishte, për të shpëtuar prej tyre, por ishte e kotë. Teksa roja tjetër e mbante fort që të mos lëvizte, Riçardi ia lidhi kyçet e duarve dhe të këmbëve me rripa lëkure pas krevatit.

- Pse po ma bëni këtë? - ulëriti ajo. - Thjesht doja të shkoja në tualet!

Dera u hap sërish dhe në dhomë hyri rrëmbimthi një infermiere me një shiringë që i shkëlqente në duar. Ajo kaloi përkrah Riçardit në anë të krevatit, kapi krahun e Klarës dhe i nguli agen.

- Jo! - klithi Klara. - Më lëshoni!

- Është për të mirën tënde, - i tha infermierja.

Riçardi dhe roja tjetër u sprapsën dhe po vështronin Klarën. Në vetulla u shndrisnin ca bulëza djerse dhe gjoksin e kishin fryrë si këndesa.

- Me sa duket, asnjëra prej këtyre nuk dashka të mësojë me të mira, por veç me të këqija, - tha Riçardi, duke fshirë ballin me duar.

- Ju lutem, - u tha Klara, - më lini të lirë.

Infermierja dhe rojat e shpërfillën dhe u larguan nga dhoma, duke përplasur derën e hekurt pas tyre, ndërsa rrapëllima e çelësave

dhe e drynit që u mbyll, jehoi gjithandej. Disa minuta më vonë, kërcëllima çjerrëse e metalit që rrëshqiste, e bëri atë të mblidhej kruspull, ndërsa dikush hapi dritaren e vogël katrore në pjesën e sipërme të derës. Ajo ngriti kokën dhe u orvat të shikonte, por pa vetëm një pjesë balli dhe dy sy që përpëliteshin. Më pas, dritarja e vogël u mbyll dhe në korridor u dëgjuan ca zëra të mbytur. Klara mbështeti sërish kokën mbi dyshek. Tavani iu turbullua dhe pamja iu errësua. Ua nguli sytë mureve. Qoshet e dhomës dukeshin sikur mblidheshin nga brenda dhe anët me allçi sikur dridheshin në çdo rrahje zemre. Krejt papritur, ndjeu se do të villte sërish. Ktheu kokën anash dhe volli, duke u kollitur e duke u përlyer me të vjella. Më pas, ndjeu se qepallat po i rëndoheshin, puliti nja dy herë sytë dhe bota u zhduk.

Gjëja e parë që ndjeu kur u përmend, ishte një dhembje në stomak dhe djegia përreth kyçeve të duarve dhe këmbëve. I dukej sikur ishte përleshur dhe çdo muskul i dridhej e i dhembte. U mundua të kthehej anash, por vazhdonte të ishte e lidhur pas shtratit. Çarçafi i poshtëm ishte i ftohtë dhe i lagur, ajri i rëndë dhe kundërmonte erë të vjellash e urine. Dalëngadalë po i kujtohej gjithçka. E kishin futur në izolim.

Ngriti kokën e rënduar dhe hodhi një vështrim përqark dhomës, duke kapsallitur sytë dhe duke u munduar të qartësonte shikimin. Drita e verdhë në tavan e mbushte dhomën me një shkëlqim të mjegullt. Muret nisën t'i rrotulloheshin sërish, ndaj e uli kokën e po priste që marramendja t'i kalonte. Kur u ndje e sigurt se mund t'i hapte sytë, hodhi shikimin në fund të krevatit, për nga dera. Kur pa infermiere Trençin të ulur në një qoshe, e cila po lexonte një libër, filloi të fliste e të kërkonte ndihmë.

- Mund të më zgjidhësh, të lutem? - foli Klara, me zë të dobët e të ngjirur.

Teksa ngriti kokën, infermiere Trençi lëshoi një zë të ulët dhe befasues. Për habinë e Klarës, sytë i kishte të skuqur e të përlotur. Fshiu mollëzat, u ngrit duke vendosur librin mbi karrige dhe ballëngrysur iu afrua krevatit me sytë ngulur mbi Klarën.

- Nuk e di, - i tha ajo. - Po ti, do të vësh mend e të sillesh mirë?

- Të lutem, - i tha Klara, - po thaj së ftohti dhe po vdes urie.

- Ndoshta duhej ta kishe menduar këtë para se të shkaktoje gjithë atë potere në dhomën me diell.

- Ata s'më lejuan të shkoja në tualet dhe unë...

Infermiere Trençi tundi kokën.

- Rregullat nuk janë vendosur kot, - i tha. - Si mund të të ndihmojmë, nëse ti nuk i respekton ato?

- Por unë e kuptova se do të villja dhe...

- Roja tha se u ngrite pa marrë leje.

- Po, por...

- A nuk të kanë thënë se, para se të ngrihesh, duhet të marrësh leje?

Klara pohoi me kokë.

- Në rregull, - ia ktheu infermierja. - Para se të të lejoj që të ngrihesh, do të më thuash se ke për ta mbajtur vëth në vesh këtë që ndodhi.

- Nuk do ta harroj kurrë, - tha Klara.

- Dhe që tani e tutje, duhet të bësh ashtu si të thonë.

- Mirë.

- Përsërite atë që sapo të thashë, Klara.

- Që tani e tutje, duhet të bëj ashtu si më thonë.

- Të lumtë! - i tha Trençi buzagaz. - Mund të flesh në pavijon për aq kohë sa nuk orvatesh të bësh gjë. Në të kundërt, do ta gjesh veten sërish këtu. Më kuptove?

Klara pohoi me kokë.

- Kuptova, - ia ktheu ajo.

Infermiere Trençi uli dorezat e krevatit, zgjidhi rripat prej lëkure dhe u spraps. Klara u ngrit, fërkoi kyçet e duarve, ndërsa koka vazhdonte t'i buçiste. I kaloi këmbët anash dyshekut dhe hoqi flokët nga fytyra. Vinte erë të vjellë dhe dhoma iu rrotullua. Mbylli sytë dhe mori frymë thellë që të ruante ekuilibrin. Më në fund, dhoma nuk po i vinte më vërdallë. Zbriti ngadalë nga dysheku, ndërsa ndërresat e lagura të natës i ishin ngjitur pas këmbëve. Mbështolli krahët rreth vetes, duke u munduar të mos dridhej.

- Mund të bëj një dush dhe të marr ndërresa të pastra? - pyeti, ndërsa dhëmbët i kërcisnin.

- Është tepër vonë për këtë, - iu përgjigj infermiere Trençi,

duke u drejtuar për nga dera. - Është koha që të fiken dritat. Duhet të presësh deri nesër.

- Por unë s'kam futur gjë në gojë që në mëngjes, - i tha ajo.

- Që dje në mëngjes, - ia ktheu infermierja dhe mori librin nga karrigia e u kthye nga Klara, duke e shtrënguar romanin pranë kraharorit të gjerë. - Ke dy ditë që fle.

Klara vuri dorën mbi bark.

- Do të më lini pa ngrënë deri në mëngjes?

Deshi të thoshte diçka lidhur me shtatzëninë, por u step. Infermiere Trençi i kish thënë të mos e përmendte kurrë foshnjën.

- Më vjen keq, - i tha ajo dhe u drejtua për nga dera. - Kur shkel rregullat, ndëshkohesh.

Klara kafshoi buzën. Donte ta ndalonte atë grua dhe ta bënte të kuptonte se nuk ishte si pacientet e tjera. Infermiere Trençi duhej të kishte patjetër një zemër diku brenda asaj pamjeje të egër dhe burrërore. Klara i hodhi një sy romanit që infermierja kishte në dorë. Në kopertinë ishte figura e një gruaje të kërrusur poshtë një peme, kokulur dhe symbyllur. Libri titullohej "Dhe lind dielli" i shkrimtarit Ernest Heminguej. Klarës iu kujtua dita kur ajo dhe infermiere Trençi kapën mat doktor Roaçin dhe infermiere Mein. Trençi ishte inatosur dhe neveritur që mjeku e kishte lënë të shoqen të priste në korridor, dhe bënte gili-vili me dashnoren. Por, atë ditë, në sytë e infermieres Klara lexoi edhe diçka tjetër; diçka që dukej si dhembja e një zemre të thyer.

Ajo u kapërdi, duke u munduar të mos e mbante mendjen te stomaku bosh dhe koka që i vinte vërdallë.

- Më ka ardhur shumë keq për personazhin kryesor të këtij libri, - i tha ajo, duke i treguar me kokë romanin. - Po ty të erdhi keq?

Infermiere Trençi ngrysi vetullat dhe rrudhi ballin. Dukej sikur do të thoshte diçka, do të shprehte ndjenjat e saj për librin, por më pas, ndërroi mendje. Mblodhi veten, hapi derën dhe ia bëri me shenjë drejt korridorit.

- Shkojmë, - i tha prerë.

Klara doli nga dera me këmbët që mezi i mbanin.

- Më copëtohet zemra që jam larg njeriut që dua, - i tha, duke u munduar të dukej sa më miqësore. - Ai quhet Bruno.

Infermiere Trençi nuk po ia vinte veshin, por ecte me mundim në korridor, ndërsa mbante romanin në duart gjigante. Klara e ndiqte nga pas. - Nuk ta shpjegoj dot sa e madhe është vuajtja kur do dikë, por ai nuk ta kthen këtë dashuri.

- Mjaft dërdëllite, - i tha infermierja.

- Veçanërisht nëse ai është i dashuruar me dikë tjetër, - i tha Klara. - Dhe unë e kam ditur shumë mirë që s'do të ishte kurrë imi. Që do të ishte një torturë e vërtetë.

Infermiere Trençi ndaloi dhe u kthye me fytyrë nga Klara, zgjati krahët dhe tregoi me gisht fundin e korridorit.

- Nëse do, mund të të kthej sërish në atë dhomë, - i tha ajo, e bërë flakë e kuqe në fytyrë.

Klara tundi kokën dhe uli sytë përdhe. Infermiere Trençi mërmëriti diçka nëpër dhëmbë dhe nisi të ecte sërish, me shpatulla kërrusur e buzëvarur nga zhgënjimi.

Që atë ditë e në vazhdim, Klara ulej në stolat e dhomës me diell pa nxjerrë asnjë fjalë nga goja, duke imagjinuar flokët e zinj të Brunos dhe sytë e shndritshëm ose këndonte nën zë fjalët e këngës së saj të preferuar. Bënte gjithçka që mund t'ia hiqte mendjen nga të ndenjurat që i ishin bërë copë dhe këmbët e mpira. Mundohej t'i fshinte sa më parë lotët, para se t'i shkonin çurg faqeve, e të mos tërhiqte vëmendjen e askujt. Fatmirësisht, nga fundi i javës së dytë, vërtetoi se mund të kishin besim tek ajo dhe mund t'i ngarkohej ndonjë punë. Ditën kur e çuan në kuzhinë për të qëruar patate, me zemër të copëtuar tha një lutje falënderimi për të gjitha ato gra fatkeqe, të cilave nuk do t'u jepej kurrë një mundësi e tillë.

Kuzhina kryesore ndodhej në një grup godinash të mëdha prapa *Chapin Hall*-it, në afërsi të sheshit gjigant në formë "U"-je, që formohej nga pavijonet e lidhura me njëri-tjetrin. Në ndërtesat e mëdha që ngjanin si fabrika, ndodhej kuzhina kryesore, furra e bukës, lavanteria, salla e kaldajave dhe magazina. Nga kuzhina, ushqimi shpërndahej në pavijone përmes një sërë tunelesh nëntokësore dhe ashensorëve të kuzhinës.

Përgjatë ditëve të gjata të dimrit, Klara ulej në një stol druri dhe qëronte patate në kuzhinën e nxehtë. Ndenjësja e stolit ishte e fortë dhe e çarë. Ai lëkundej sa para-mbrapa mbi një nga

këmbët e tij të shkurtra, por të paktën mund të ulej aty kur donte të ndërronte vend. Nuk e imagjinonte dot se si nuk i lejonin pacientet të punonin, por i detyronin t'i kalonin ditët të ulura në stolat e dhomës me diell. Nëse nuk kishin qenë të çmendura kur kishin mbërritur në Uillard, tani me siguri që ishin shndërruar në të tilla. Klara nuk arrinte ta kuptonte pse mjekët mendonin se ajo lloj torture u bënte mirë.

Pavarësisht nga moti, ajo e priste me padurim radhën për të derdhur mbeturinat e patateve në pirgun e plehrave që ndodhej pas derës së pasme të kuzhinës. Më pas, këto mbeturina u jepeshin për ushqim pulave dhe derrave të Uillardit. Edhe gjatë dimrit, kur fytyra i ngrinte nga ajri i akullt dhe sytë i lotonin nga era e fortë, ajo qëndronte jashtë sa më shumë të mundej, pasi e dinte se kjo mund të ishte arratia e saj e vetme nga ditët e zymta. Mëngjeseve, kur ajri ishte i pastër dhe i qetë, arrinte të dëgjonte uturimat dhe çaf-çufet e lokomotivave që kalonin aty pranë, si dhe kërcitjet e forta të akullit të liqenit, si gulçimi i një kanali gjigant kur zbrazet. Edhe pse nga mjediset e pasme të *Chapin Hall*-it nuk mund ta shihte sipërfaqen e ujit, ajo ndiente një afri me të, që të dy kishin ngrirë në kohë dhe prisnin.

Në fund të muajit shkurt, kur pa krahët dhe këmbët e saj si skelet, kuptoi se nuk kish qenë kurrë më parë kaq e dobët. Ishte tretur e tëra, me përjashtim të barkut si një topth i vogël që rritej çdo ditë dhe që, fatmirësisht, askush nuk e kish kuptuar se ishte shtatzënë. Pjesën më të madhe të kohës, ndihej e dobët dhe e trullosur, sikur fëmija që po rritej brenda saj, po ia shteronte të gjitha fuqitë. Mundohej të hante gjithçka që i jepnin, edhe nëse ishte një tas me supë si lëtyrë apo një vezë e zier pak, që ia sillte zorrët në gojë kur mundohej ta kapërdinte. Gjatë kohës kur punonte në kuzhinë, fshihte mes pirgut të mbeturinave një kokërr patate për ta ngrënë kur askush nuk e kishte mendjen. Patatet e pabëra kishin shije dheu dhe niseshteje, por ajo i hante, gjithsesi.

Në një ditë të zymtë e me shi, në fund të muajit mars, në oborrin e pasmë të kuzhinës, një mi topolak e i lagur nga shiu doli nga pirgu i mbeturinave dhe vrapoi përmes një vrime të vogël në fund të gardhit të lartë prej druri. Klara iu afrua rrethimit, uli

poshtë shportën me lëkurat e patates dhe u ul në gjunjë mbi baltë. Vrima ishte sa një top bejsbolli dhe gardhi rrethues ishte i lagur dhe i dhëmbëzuar. U ngrit dhe filloi të godiste me këmbë dërrasat e tjera rreth vrimës, duke u përpjekur t'i shkatërronte. Më pas, u ul sërish në gjunjë dhe nisi t'i thyente copat e drurit me dorë. Ashklat iu ngulën nëpër duar, por ajo vazhdoi, duke thyer copa sa pëllëmba e dorës. Pa përmes vrimës dhe syri i zuri veç baltë dhe disa metra më tutje themelet e një godine tjetër. I hodhi copat e thyera të drurit përtej vrimës dhe atë e mbuloi me një pirg me lëkura patatesh dhe perimesh. Të nesërmen shkuli edhe ca copëra nga gardhi dhe në fund të javës, pëllëmbët dhe gishtat i ishin copëtuar, por ama, ia kish dalë të hapte një vrimë aq të madhe, sa mund të zvarritej në të.

Një pasdite, shkoi sërish te pirgu i mbeturinave, hoqi lëkurat dhe theu një copë druri tjetër. U shtri me shpinë në tokën e lagur pranë gardhit, që të mos lëndonte foshnjën, dhe më pas, lëvizi sa andej-këtej derisa koka dhe shpatullat hynë nën vrimë, por barkun e kishte shumë të madh.

Foshnja e pengonte. Sa u bë gati ta hapte vrimën pak më tepër, dikush e mbërtheu te kyçet e këmbës dhe e tërhoqi zvarrë, nëpër baltë.

- Je mirë? - e pyeti një burrë, duke dihatur në këmbë pranë saj. Kishte veshur një xhaketë të leshtë dhe kominoshe të pista, ndërsa çizmet i kish të mbuluara me llucë. - Ishe rrëzuar?

Klara u ngrit.

- Unë... - tha ajo, me zemrën që i buçiste në kraharor.

- Po mundoheshe t'ia mbathje? - e pyeti teksa e shihte me njërin sy, pasi tjetrin e kishte të ënjtur dhe të mbyllur.

Klara tundi kokën dhe u mundua të ngrihej në këmbë. Burri u përkul për ta ndihmuar dhe duke bërë me dorë drejt gardhit vazhdoi:

- Nuk ke për të fituar gjë po kalove matanë atij gardhi, - i tha ai. - Atje është dhoma e kaldajës. Nuk ka asnjë rrugë përreth saj.

- Po ti si hyre këtu? - e pyeti ajo, duke fshirë duart pas fustanit. Flokët e ndotur dhe të ftohtë i binin mbi qafë, ndërsa krahët dhe këmbët i kishte të lagura e me baltë.

Burri pështyu në tokë dhe një tjetër rrëke pështyme i varej

nga cepi i gojës. Tregoi me gisht gardhin pranë murit të pasmë të kuzhinës dhe tha:

- Atje është një derë. Kemi një tufë të re me derra dhe shefi më dërgoi të marr ca mbeturina të tjera. Të pashë ty të shtrirë përdhe dhe...

Klara i hodhi një sy gardhit të drunjtë për të parë derën. E vetmja mundësi për ta hapur, ishte një hapësirë pak më e gjerë mes dy dërrasave, e cila mezi dukej. Eci me mundim mespërmes baltës deri te dera, futi gishtat te hapësira dhe u orvat ta hapte, por ajo ishte tepër e ngushtë. Gishtat nuk i futeshin aq sa duhej që ta mbërthente mirë.

- Si e hap ti këtë derë? - e pyeti burrin.

Ai eci rëndë-rëndë drejt saj dhe ndaloi para derës.

- Shefi më dha një çelës për të hyrë, - ia ktheu ai. - Më tregoi edhe një marifet për të dalë, - tha teksa goditi me grusht fundin e dërrasës dhe dera u hap. E kapi në cep dhe e mbylli sërish. - E pe?

- Ta provoj edhe unë? - e pyeti Klara.

Ai mblodhi supet dhe bëri disa hapa pas. Klara goditi me grusht në të njëjtin vend. Druri u lëkund dhe kërceu përpjetë, por dera nuk u hap.

- Të thashë që do marifet, - tha burri duke qeshur.

Klara mori frymë thellë dhe e goditi sërish, me sa fuqi kishte. Këtë herë, cepi i derës kërciti dhe doli nga gardhi. Ajo e tërhoqi dhe dera u hap. Në anën tjetër, u shfaq një rruginë e shkatërruar që gjarpëronte përgjatë ndërtesës, por pastaj merrte kthesën në një qoshe të gurtë dhe nuk dukej më. Klara doli me nxitim nga tharku, duke vrapuar sa i hanin këmbët, teksa në vesh dëgjonte gjëmimin e pulsit të saj. Disa metra larg qoshes, burri e kapi nga prapa dhe e ngriti peshë, duke e shtrënguar aq fort me duart mbërthyer rreth belit të saj, saqë mezi po merrte frymë. Ai e futi sërish brenda gardhit, e uli përdhe dhe përplasi derën duke gulçuar.

- Ma punove bukur, - i tha, i skuqur dhe i shfytyruar. - Shefi më tha të mos lejoja askënd të kalonte përtej kësaj dere. Kurrë.

- Më fal, - u përgjigj Klara që po përpiqej të qetësonte frymëmarrjen. - Vetëm se... unë nuk duhej të isha këtu.

- Nuk mund të largohesh, - i tha burri duke tundur kokën.

- Kështu shkel rregullat dhe po i shkele ato, hyn në telashe të mëdha.

- E di, - i tha ajo. - Thjesht... - për një çast ngurroi dhe po përpiqej të gjente fjalët e duhura. - Meqë jemi, si të quajnë?

- Stenli, - i tha ai. - Im atë më quajti Stenfor, por ime më më thërriste Stenli.

- Je pacient, Stenli? - e pyeti ajo, me shpresën se ai do ta kuptonte se ishin njësoj.

- Kam njëzet vjet këtu, - ia ktheu ai duke tundur kokën. - Që kur isha shtatëmbëdhjetë vjeç.

Klara ndjeu një shtrëngim përbrenda.

- Pse të sollën këtu?

- Më vdiqën prindërit, - tha. - Nuk bëja gjë tjetër asokohe, veçse futesha në telashe dhe isha i madh për të qëndruar në jetimore.

- S'dua të të hap telashe të tjera, Stenli, - ia ktheu Klara që kafshoi cepin e buzës, duke u munduar të gjente diçka tjetër për t'i prishur mendjen. - Unë jam rritur në fermë. I dua shumë kafshët. Mund të m'i tregosh ndonjëherë derrat e rinj?

- Jo, - ia ktheu ai. - Shefit s'do t'i pëlqente kjo gjë. Ai thotë se në fermën e derrave nuk duhet të futet asnjë i huaj.

- Po sikur të më lësh të futem nga ajo derë? Si thua? - e pyeti. - Asnjë s'do ta marrë vesh.

Stenli tundi kokën sa para-prapa, si të marshonte në vend, pa i shkëputur gishtat e mëdhenj të këmbës nga toka. Në atë çast, nga ana tjetër e gardhit, u dëgjua uturima e një motori.

- Duhet të kthehem në punë, - tha duke kapsallitur njërin sy. - Po vjen shefi, - tha dhe nxitoi për te karroca e dorës, e shtyu më afër pirgut të mbeturinave dhe nisi ta mbushte me mbetjet e perimeve.

Klara i shkoi pas.

- Kur vjen t'i marrësh plehrat? - e pyeti. - Dua të them, në ç'orë vjen zakonisht?

Stenli ngjeshi fort sfurkun në mbeturinat e kuzhinës dhe ngarkoi në karrocë një pirg me lëkura perimesh.

- Para se të lindë dielli, - tha duke vështruar poshtë. - Kur të gjithë janë ende në gjumë, kështu s'më bezdis askush.

Jashtë gardhit, ndaloi një makinë, motori i së cilës uturinte. U dëgjua zhurma e metalit që përplasej pas një tjetri: u hap një derë e rëndë dhe pastaj u mbyll. Më pas, u hap dera e gardhit dhe hyri një burrë me kominoshe të ndotura e gjithë baltë.

- Pse dreqin po vonohesh kaq shumë, Stenli? - pyeti. - Duhej të takoheshim në rrugë para dhjetë minutash.

Stenli, me shpatullat e kërrusura, vazhdonte të punonte.

- Më fal, shef! - tha. - Kjo zonjushë kishte ngecur te gardhi dhe m'u desh ta ndihmoja, - tha ai ndërsa i hodhi një sy vrimës, e më pas, vetullngrysur, hetoi Klarën.

- Çfarë po ndodh këtu? - pyeti.

- Asgjë, - tha Klara dhe mori shportën e u nis drejt kuzhinës. - Thjesht po bisedonim.

Burri e ndoqi dhe u fut në kuzhinë pas saj.

- Lëre Stenlin rehat! - tha. - Më dëgjove? Ai është njeri punëtor dhe nuk përzihet kurrë në telashe. Mbaje vath në vesh këtë.

Klara vazhdoi të ecte, kurse shefi i Stenlit mori drejtimin e kundërt. Ajo ktheu kokën dhe e pa atë tek çante rrugën mes pjatalarëseve dhe bufeve. Pastaj, u kthye majtas e u zhduk. Klara u kthye në vendin e vet e iu përvesh punës, duke u orvatur të mposhtte panikun që po i zinte frymën. Me siguri që shefi i Stenlit do ta kallëzonte. Gratë e tjera po e vështronin ngultas dhe pa dyshim që pyesnin veten se pse krahët dhe këmbët i kishte të mbuluara me baltë të tharë.

Pas disa minutash, u shfaq shefi i Stenlit së bashku me përgjegjësen trashaluqe të kuzhinës. Përgjegjësja e kërrusur, me mjekrën e shtrembër, eci rëndë drejt Klarës. Duhej të ishte rreth të gjashtëdhjetave, megjithatë, krahët e shëndoshë e të zbehtë, i kishte gjithë muskuj.

- Dëgjova se kishe ngecur te gardhi jashtë? - e pyeti.

- Rashë në baltë, - tha Klara. - Më ngeci këmba te vrima. Ishte një aksident.

Përgjegjësja e kapi për krahu dhe e tërhoqi jashtë. Stenli priste pranë gardhit me karrocën mbushur deri në majë. Uli sytë përdhe dhe po luante me cepin e xhaketës.

- Ti e ke hapur atë vrimë? - e pyeti përgjegjësja Klarën.

- Jo, - tha ajo. - Ju thashë që rashë dhe...

- Mbylle menjëherë! - i tha përgjegjësja shefit të Stenlit. Ajo e tërhoqi sërish Klarën brenda, ama nuk e la në kuzhinë, por e çoi drejt e në zyrën e doktor Roaçit.

- Ku do të kishe shkuar, po t'ia kishe mbathur? - e pyeti doktor Roaçi. - Uilliardi shtrihet në qindra hektarë, përfshirë edhe pyjet e dendura. Qyteti më i afërt është kilometra larg.

- Nuk e di, - iu përgjigj, ndërsa grushtet i mbante mbledhur në prehër. - Di vetëm se duhet të largohem prej këtej!

- Po sikur të të ndodhte gjë? Si do t'i dilja para tët eti?

- Nuk dua t'ia di fare për tim atë! - tha. - Mund t'i thoni ç'të doni. Ju të dy e dini shumë mirë që unë s'e kam vendin këtu.

Doktor Roaçi, i kapur mat, u ngrys.

- Nuk e di se për çfarë po flet, - tha. - Ti nuk ndodhesh rastësisht këtu, Klara. Unë dëshiroj të të ndihmoj të bëhesh më mirë.

- Siç ju thashë edhe më parë, - vazhdoi ajo, - ndodhem këtu, sepse u zura me tim atë. S'kam nevojë për ndihmë!

- Nuk e kupton? - i tha doktor Roaçi. - Orvatja për t'ia mbathur më bind edhe më shumë se mendja jote nuk është e kthjellët. Një femër në gjendjen tënde dhe me një fizik të brishtë nuk duhet të sillet e vetme vërdallë. Nuk je e sigurt!

- Nuk jam aq e pazonja sa mendoni ju.

- Besoj se e di se ç'lloj spitali është Uillardi, apo jo?

- Sigurisht që po, - ia ktheu. - Është një institucion për njerëzit e çmendur. Por unë nuk dëgjoj zëra. Nuk kam halucinacione. E di që im atë ju ka thënë se jam e çmendur, por ai ka gënjyer!

- Ka gënjyer? - pyeti doktor Roaçi dhe buzëqeshi i trishtuar. - E dashur Klara, po pse do ta bënte një gjë të tillë?

- Për të më mbyllur këtu.

- E beson vërtet këtë?

- Sigurisht! Në fillim, mendova se thjesht donte të më jepte një mësim dhe pastaj, do të pranonte që të kthehesha në shtëpi. Tani, mendoj se ndihet i kënaqur që më ka hequr qafe.

Doktor Roaçi tundi kokën, vetullngrysur.

- Po më shqetëson vërtet, Klara, - tha. - Ti vazhdon të besosh se yt atë po komploton kundër teje, se ne po të mbajmë të mbyllur këtu për të të lënduar disi.

- Ju lutem, - tha ajo, - më lini të iki! Mund t'i thoni babait se jam ende këtu. I thoni që më ka ikur mendja fare, prandaj u detyruat të më izolonit përgjithmonë. S'më intereson se ç'i thoni. Thjesht më lini të iki! Ai s'ka pse ta marrë vesh!

- Je shumë e turbullt, Klara, - tha ai. - Unë jam mjek. Jam betuar për t'i ndihmuar njerëzit dhe këtë po përpiqem të bëj.

- S'kam qenë kurrë me e kthjellët se kaq, - ia ktheu Klara. - Po më mbani të mbyllur në një çmendinë kundër dëshirës sime. Mendja është e vetmja gjë që më ka mbetur, dhe ju siguroj se është shumë e kthjellët. S'jam si pacientet e tjera këtu, të cilat besojnë verbërisht gjithçka që u thoni dhe ju lejojnë t'i mbani mbyllur si kafshë. Nuk është kjo detyra e mjekut. Ky është një veprim kriminal.

Doktor Roaçi u ngrys dhe picërroi sytë.

- Ndoshta ke nevojë për pak pushim, - i tha. - Ndoshta do të të bëjë mirë të mendohesh për pak kohë. Orvatja për t'u arratisur është një vepër e rëndë, që zakonisht kërkon një trajtim të ashpër, por jam i gatshëm të marr masa të buta, sepse jam i bindur se ti je aq e zgjuar, sa të mësosh nga gabimet e tua...

Ajo u zgjat në tavolinë dhe i kapi duart. Balta e tharë që kishte mbetur në bërryla, njollosi letërthithësen e pastër. Ai u spraps dhe u përpoq të shkëputej; një tingull i dobët dhe gjithë frikë i doli nga buzët. Klara e shtrëngoi edhe më shumë.

- Si do të ndiheshit nëse s'do të pranoja t'ju lëshoja? - e pyeti. - E di që s'ju pëlqen t'ju prekin. Nuk e di pse, por di që kjo gjë ju tremb. Dhe, në rast se nuk e dini, burrat e ndershëm nuk i tradhtojnë gratë. Ndoshta ju keni nevojë për ndihmë, doktor. Ndoshta duhet t'ju mbyllin në çmendinë! Do t'ju pëlqente kjo?

Doktor Roaçi, i bërë flakë i kuq në fytyrë dhe me flegrat e hundës të zgjeruara sa më s'ka, u ngrit në këmbë dhe u çlirua nga shtrëngimi i saj.

- S'e di se ç'lojëra po mundohesh të luash, - tha, - por me mua s'të pinë ujë, - dhe mbylli dosjen. - Do të flasim sërish për këtë temë takimin e ardhshëm. Ndërkohë, unë s'jam armiku yt, Klara. Ndoshta deri në takimin e radhës do të kesh ndryshuar qëndrim.

Në gjashtë ditët që vijuan, Klarën e mbyllën në një dhomë të pistë, me mure çimentoje, në pavijonin e izolimit, ku si orendi

kishte vetëm një tualet dhe një krevat metalik të mbërthyer përdhe. Dy herë në ditë, poshtë derës së siguruar mirë, përmes një dritareje të vogël, i fusnin një tabaka me bukë të tharë dhe një tas supe si lëtyrë. E vetmja gjë që e ndihmonte të kuptonte nëse ishte ditë apo natë, ishte një llambë e thjeshtë e varur në tavan, e cila ndizej dhe fikej kur duhej. Në korridor, dëgjohej jehona e zinxhirëve vringëllues dhe përplasja e dyerve metalike, e përforcuar më shumë nga ulërimat dhe rënkimet. Në ditën e gjashtë, infermiere Trençi, duke nxjerrë gjuhën në shenjë pakënaqësie, hapi derën për ta nxjerrë jashtë. E pafuqishme për të thënë ndonjë fjalë, ajo e ndoqi infermieren në pavijon në heshtje.

Nga mesi i muajit prill, thuajse dy muaj para periudhës kur Klara mendonte se duhej të lindte, i kishte dalë aq shumë barku, saqë fustanet i rrinin ngjitur pas trupit. Ama, të njëjtën formë barku e kishte vënë re edhe te pacientet e tjera femra - ndoshta ato kishin qenë të shëndosha para se të vdisnin urie këtu në Uillard, ose ndoshta e vinin të gjithë shëndetin në bark - ndaj e dinte se nuk ishte asgjë e re nëse një gruaje i kishte dalë barku. Askujt nuk i kishte rënë në sy që Klara po shëndoshej nga dita në ditë. Askush nuk e besonte apo nuk i interesonte që ajo do të sillte në jetë një fëmijë dhe askush nuk e merrte mundimin të shikonte nëse thoshte apo jo të vërtetën.

Ditën e fundit të muajit maj, gjatë takimit të dytë me doktor Roaçin, Klara u ul në karrigen përballë tavolinës së tij; ndenjësja e fortë i shtypte kockat e legenit. S'kishte pjesë të trupit që të mos i dhembte, si të ishte nëntëdhjetë vjeçe dhe jo nëntëmbëdhjetë. S'po e kuptonte nëse trupin e ndiente të tendosur e të ngrirë ngaqë ishte shtatzënë dhe e kequshqyer, apo këto dhimbje i vinin nga dyshekët e hollë gjithë gunga, në të cilët kishte fjetur gjatë këtyre pesë muajve të fundit.

Çdo natë, bënte gjumë me hope dhe plot makthe, sikur po lindte në pavijon dhe s'e ndihmonte askush, përveç pacienteve të tjera. Në ëndërr, bërtiste e ulërinte me sa kishte në kokë në shtratin e ndyrë. Gratë e tjera i mblidheshin përqark, duke u tundur lart e poshtë, duke u jargëzuar dhe duke u qaravitur. Duke shtrënguar fort cepat e dyshekut, ajo çohej: ishte gollomesh dhe e shfytyruar. Gruaja me kukullën prej lecke ia rrëmbente foshnjën

e sapolindur dhe vraponte jashtë pavijonit, me kordonin gjithë gjak që e tërhiqte zvarrë.

Edhe në atë çast, siç bënte gjithmonë, Klara u ngrit me njërën dorë te barku, duke pritur të ndiente fëmijën të lëvizte. Frika e saj më e madhe ishte se mos fetusi kishte vdekur dhe ajo nuk do ta merrte vesh derisa t'i vinte koha për të lindur. Si zakonisht, nuk ndjeu asgjë. Hera e fundit kur e kishte ndier të lëvizte, kishte qenë në mbrëmje. Edhe atëherë, ishte merakosur se mos e kishte imagjinuar, aq e lehtë kishte qenë rrahja poshtë dorës së saj. Për të një miliontën herë mendoi se, ose foshnja ishte jashtëzakonisht e vogël, ose diçka e tmerrshme mund të kishte ndodhur. U drodh e tëra dhe iu duk sikur po mbytej.

Në anën tjetër të tavolinës, doktor Roaçi vriste mendjen për rastin e saj, me stilolapsin gati për të shkruar në kartelë. Ajo ia kishte ngulur sytë stilolapsit të hijshëm e të gdhendur që ai mbante në dorë. Sa budallaqe ishte treguar që kishte menduar se mund të mbante bojë dhe letra për t'i shkruar Brunos dhe se ndoshta do të gjente dikë që mund t'ia postonte. Në Uillard, s'i interesonte askujt se pse e kishin mbyllur aty, e jo më t'u interesonte jeta e saj e mëparshme. Nisi të mendonte për infermiere Jotin. Ajo e kishte vënë re menjëherë që Klara gëzonte shëndet të plotë mendor. Pse në Uillard askush nuk e vinte re këtë? Ajo besonte se infermiere Joti ose kishte ndërruar mendje për postimin e letrave, ose e kishin kapur gafil, sepse, në të kundërt, Brunoja do të kishte ardhur me kohë për ta shpëtuar. Ndjeu një dhembje të lehtë poshtë kafazit të kraharorit.

- Ç'po mendon, Klara? - e pyeti doktor Roaçi me zë kumbues e të qetë.

- Po pyesja veten se si i ndihmoni pacientët kur nuk i shikoni kurrë, - iu përgjigj.

Ai ngrysi vetullat.

- Nuk po e kuptoj se ku do të dalësh, - tha.

- U bënë pesë muaj këtu dhe ky është takimi i dytë. Herën e fundit që ju takova, ishte atëherë kur hyra në telashe.

Ai u rehatua në karrige dhe po fërkonte me gishta mjekrën e rregulluar me shumë kujdes.

- Këtu në Uillard, janë më tepër se tre mijë pacientë, - tha

mjeku. - Meshkuj dhe femra. S'mund të presësh ndonjë trajtim të veçantë, tani për tani. Nuk je në qendrën "Long Ajlënd".

- Nuk po kërkoj trajtim të veçantë, - ia ktheu Klara. - Ju pretendoni se doni të më ndihmoni. Si mund të më ndihmoni kur nuk më takoni kurrë? Kam filluar të mendoj se Uillardi shërben vetëm për të izoluar njerëzit.

- Ky institucion u krijua me mendimin se çmenduria mund të kurohet me ndihmën e njerëzve sa të vendosur, aq edhe humanë, duke ofruar siguri nga streset e jetës, pushim dhe punë të vazhdueshme. Ty t'i kemi dhënë të gjitha këto, apo e kam gabim, Klara?

Klara, së cilës i therte shpina, lëvizi në karrige.

- Së pari, unë nuk jam e çmendur. Së dyti, kjo s'është një strehë e sigurt nga streset e jetës. Ju po më mbani këtu me pahir. Mos vallë kështu ndihem e qetë dhe e lumtur?

- Çfarë mund të bëj për ty që të ndihesh më pak e stresuar?

- Më lini të largohem. Kam qëndruar më gjatë se ç'duhet. Me siguri që edhe im atë do të jetë dakord.

Doktor Roaçi tundi kokën.

- Druaj se gabohesh, - tha. - Babai yt i ka varur të gjitha shpresat tek unë që të të shëroj. Fatkeqësisht, s'më ke thënë asgjë që mund të tregojë se je përmirësuar.

- Çfarë doni që t'ju them? Ma thoni dhe do t'jua them.

- Beson ende se yt atë të ka mbyllur këtu për të shpëtuar prej teje?

Ajo uli supet.

- Është hera e dhjetë që po ma bëni këtë pyetje.

- E kam për detyrë të të pyes.

- Ama, i shtrembëroni gjithmonë përgjigjet e mia, për t'i përshtatur me idenë që keni krijuar paraprakisht për mua. Jeni i bindur se, meqë ndodhem këtu, duhet të kem patjetër një problem!

- Thjesht përgjigjju pyetjes që të bëra.

Klara mori frymë thellë dhe psherëtiu me zë të lartë:

- Në këtë institucion, më futi im atë, kaq di t'ju them. Nëse më lejoni të kthehem në shtëpi, do të bëj gjithçka që dëshiron ai.

- Pra, po thua se, më në fund, e ke kuptuar që yt atë dëshiron vetëm të mirën tënde?

Ajo kafshoi faqen nga brenda dhe pohoi me kokë. Kishte pranuar gjithçka, vetëm për të rifituar sërish lirinë. Çfarëdo që të ndodhte kur të kthehej në shtëpi, nuk do të ishte aq e tmerrshme sa kjo që po përjetonte këtu, në këtë vend të izoluar. Doktor Roaçi shkarraviti diçka në kartelë, me ballin të rrudhur nga përqendrimi. Më pas, ngriti kokën.

- Klara, të ka shkuar ndonjëherë ndër mend të vrasësh veten?

Ajo mohoi me kokë.

- Pse ma bëni këtë pyetje? Nuk ju kam dhënë asnjë arsye për të menduar...

- Nuk e di nëse je e informuar, por vetëvrasja mund të jetë e trashëgueshme. Thjesht dua të sigurohem që...

- Jo, - iu përgjigj. - Siç ju thashë edhe më parë, dua të më jepet edhe një herë mundësia për të bërë një jetë normale me njeriun që dashuroj dhe për të rritur së bashku fëmijën tonë. Ama, s'mund të bëj asnjërën nga këto, nëse vazhdoni të më mbani këtu.

- E ke fjalën për Brunon, apo jo?

Klarës iu mblodh një lëmsh në kraharor.

- Nga e dini emrin e tij? Jua ka treguar babi?

Doktor Roaçi, i ngrysur në fytyrë, i hodhi një shikim të shpejtë kartelës, ndërkohë që vërtiste stilolapsin mes gishtit të madh dhe gishtave të tjerë. Mandej, ngriti shikimin, për ta parë në sy.

- Besoj se ka ardhur koha të të them të vërtetën, Klara.

Ajo u struk edhe më shumë në karrige dhe zemra sa s'po i dilte nga kraharori.

- Të vërtetën për çfarë? - pyeti.

- Ke të drejtë për diçka, - tha doktor Roaçi. - Yt atë më ka treguar për Bruno Moretin.

- Vërtet? - u habit dhe s'po mbushej dot me frymë. - Çfarë ju ka thënë?

Doktor Roaçi lëshoi stilolapsin dhe mblodhi duart mbi tavolinë.

- Klara, - tha me keqardhje, - Bruno Moreti nuk ekziston.

Me ardhjen e qershorit, shirat e pranverës më në fund pushuan. Meqë mjediset e Uillardit ishin të thata, pacientët lejoheshin

të bënin shëtitje të mbikëqyrur nga rojat. Çdo pavijon ruante grupin e vet. Pacientët viheshin në rresht për katër si një bandë e çorientuar marshimi. Disa prej tyre merrnin kthesën majtas, ndërkohë që grupi kthehej djathtas, kurse të tjerë mbeteshin prapa, të paaftë për të ndjekur ritmin. Femrat dërgoheshin në një drejtim, kurse meshkujt në tjetrin. Duke picërruar sytë nën rrezet e flakëruese të diellit, Klara ndiqte pas gratë e pavijonit të saj dhe sodiste ujërat vezulluese të liqenit Seneka.

Një grua e gjatë dhe e dobët, me fytyrë të kthyer nga dielli, duke përveshur mëngët, këndonte nën zë pranë Klarës. Esteri kishte gjashtë javë që kishte ardhur në Uillard. E kishte mbyllur i shoqi kur e kishte kapur në flagrancë duke u puthur me një burrë tjetër. Edhe pse pa makijazh dhe me një fustan të thjeshtë blu, ajo, me flokët e dendur biondë dhe lëkurën e lëmuar, dukej si yll kinemaje. Kur e pa për herë të parë në mensë, teksa shikonte me sy të zgurdulluar dhe plot frikë pacientet e tjera, Klara e kuptoi menjëherë se edhe ajo nuk e kishte vendin në Uillard. Më vonë, në pavijon, e paralajmëroi për dhomën me diell dhe i tha se mënyra e vetme për të shpëtuar, ishte të sillej mirë. Që prej asaj kohe, mes tyre lindi një miqësi e ngushtë dhe Klara u gëzua shumë që kishte dikë me të cilën të shkëmbente ndonjë fjalë.

Në krahun tjetër të Esterit, ishte Madalena, një grua imcake, mes të njëzetave, e shtruar në Uillard para një viti, pasi kishte humbur dy fëmijë dhe ishte ndarë nga burri që abuzonte me të. Ishin bërë shoqe ndërkohë që punonin në kuzhinë, ku Madalena lante pjatat.

- Kur mbërrita në Uillard, dielli shkëlqente si sot, - tha Madalena dhe ngriti kokën drejt qiellit. - Atë ditë, ndërtesat dhe liqeni kishin një pamje mahnitëse. Mendova se, më në fund, dikush do të kujdesej për mua.

- Këtu nuk mund të kujdeset askush për ne, - tha Esteri. - Kur të dal prej këtej, do të gjej një plak pasanik, që të mos shqetësohem më kurrë për veten.

- Ndoshta këtë duhej ta kisha bërë kohë më parë, - tha Madalena duke buzëqeshur. - Duhej të kisha gjetur një plak pasanik, që të më paguante qiranë e asaj pronares së fëlliqur.

- Prapëseprapë, ajo do ta kishte njoftuar policinë, - tha Esteri.

- Ndoshta do të kishte nxjerrë pretekstin se je prostitutë ose do të kishte gjetur diçka tjetër.

- Kujtova se kishe qenë në shtrat, e sëmurë, kur erdhi policia, - tha Klara. - A nuk ishte kjo arsyeja pse nuk punoje dhe nuk e paguaje dot qiranë?

- Nuk isha e sëmurë, - ia ktheu Madalena. - S'kisha shumë që isha kthyer nga burri im i neveritshëm, të cilit i kërkova të më jepte ca para që të blija diçka për të ngrënë. Më zhdëpi në dru. M'u desh plot një javë që të ngrihesha nga shtrati. Mirë që shkoja deri në tualet. Pasi policia më futi brenda, mjeku tha se nuk isha mirë dhe se duhej të shtrohesha në spital, por ajo pronarja e mallkuar u tha se unë përdorja fjalë të pista dhe flisja me vete, kështu që më futën në çmendinë.

Klara tundi kokën. Vështroi gratë e tjera para saj, të cilat i tërhiqnin këmbët zvarrë, kurse kokat i mbanin poshtë dhe supet i kishin të kërrusura, gra, që, ashtu si ajo, Esteri dhe Madalena, kishin menduar se do të kishin një jetë normale e do të ishin të lumtura. Sigurisht, disa prej tyre ishin vërtet të sëmura, me probleme mendore që i pengonin të ishin njerëz normalë e të suksesshëm. Po sa prej tyre ishin viktima të rrethanave, gra të lëna pa asnjë kacidhe nga burrat, të cilët i kishin braktisur ose kishin vdekur; gra që kishin humbur fëmijët dhe kishin nevojë për ndihmë për t'i bërë ballë dhimbjes së papërballueshme; gra që ishin syrgjynosur nga prindërit, ngaqë nuk i pranonin vendimet e tyre? Sa prej tyre kishin përfunduar në Uillard për shkak të një shpërthimi zemërimi, ngaqë ishin flakur dhe ishin braktisur nga fëmijët ose ngaqë kishin humbur prindërit në moshë të vogël e ishin rritur në jetimore? Sa prej atyre që gëzonin shëndet të plotë mendor kur i sollën këtu, do të ishin në gjendje të arsyetonin pas disa muajsh abuzimi apo keqtrajtimi me banja të akullta dhe qetësues?

Pak më parë, Madalena i kishte treguar Klarës historinë e Rubit, një emigrante italiane që kishte ardhur në Amerikë para dymbëdhjetë vjetësh bashkë me të shoqin. Pas dy vjetësh, burri i ishte vrarë në një aksident kur punonte në ndërtim. E uritur dhe e pastrehë, Rubi nisi të prostituonte rrugëve të Nju Jorkut dhe dinte vetëm disa fjalë anglisht. Pas disa kohësh, u arrestua dhe u

soll në Uillard. Kjo ngjarje kishte ndodhur para dhjetë vjetësh. Tani, ajo ulej çdo ditë në dhomën me diell, kokulur, dhe rripte në heshtje lëkurën e krahëve.

Të jetoje e izoluar, ishte vërtet e padurueshme, por Klara as që mund ta imagjinonte se sa torturuese ishte të mos flisje dot, të mos kishe të drejtë të shpjegoje si përfundove në rrugë apo të thoshe që gëzoje shëndet të plotë mendor. Pse mjekët nuk kishin sjellë dikë që fliste gjuhën e Rubit? Po sikur të kishte të afërm në Itali, të merakosur se ku kishte përfunduar apo çfarë kishte ndodhur me të? Po sikur t'i duhej thjesht një letër për t'u larguar njëherë e përgjithmonë nga ky ferr? Duke menduar për gjithë këto padrejtësi, ndjeu një dhembje therëse që po i çante kraharorin.

- Si ndihesh sot? - e pyeti Esteri. - Pas pak kohësh, do të vijë në jetë vajza jote.

Klara vuri dorën mbi bark dhe ndjenja dashurie e frike njëkohësisht, i pushtuan zemrën. Esterit dhe Madalenës u kishte treguar gjithçka: për Brunon, për babanë dhe se ishte e sigurt që foshnja ishte vajzë.

- Jam mirë, - tha. - Ndihem pak e pafuqishme, por përveç kësaj...

- Ç'do të ndodhë pasi të lindë foshnja? - pyeti Esteri Madalenën. - Mendon se do ta lënë Klarën të largohet?

Madalena ngriti supet.

- Nuk e di, - tha. - S'kam dëgjuar kurrë për ndonjë që mund të ketë lindur këtu, - dhe hodhi sytë nga liqeni, për t'iu shmangur shikimit të Klarës.

Klara mori frymë thellë dhe u mundua të mos i kushtonte rëndësi ndjesisë se Madalena nuk po tregohej plotësisht e sinqertë. S'mund ta fajësonte për këtë. Nëse Madalena dinte diçka dhe nuk po ia tregonte, thjesht po përpiqej të tregohej sa më optimiste. Madalena e kuptonte se, nëse Klara do të mendonte për të ardhmen, për kohën pasi foshnja të vinte në jetë, ajo ndoshta nuk do ta gjente më fuqinë për të ecur përpara. Tani për tani, ajo duhej të besonte se gjërat do të ndryshonin për mirë. Nuk kishte rrugëdalje tjetër.

- Uroj të më lënë të largohem, - tha. - Ky nuk është vendi i duhur për të rritur një fëmijë.

- Mendoj se ke të drejtë, - tha Esteri buzagaz. - Do të të lënë të largohesh.

Grupi i femrave vazhdonte të ndiqte rrugën kryesore të Uillardit drejt një korijeje të dendur me pisha në krahun tjetër të përroit Mirs, i cili rridhte sa gjatë gjerë derisa derdhej në liqenin Seneka. Për javë të tëra, era kishte fryrë me tërbim dhe shiu kishte rënë me gjyma. Përroi, bregu i të cilit ishte mbuluar nga gjethet, vërshonte drejt perëndimit si një lumë i harbuar, a thua se do të dilte nga shtrati. Degët dhe gjethet e pemëve shtilleshin dhe vërtiteshin në ujin e rrëmbyeshëm ngjyrë gri. Gratë kaluan mbi një urë të drunjtë. Dallgët e rrëmbyeshme të përroit ua mbysnin zërat. Klara mendoi të kërcente nga hekurat dhe rryma e fortë ta merrte me vete e ta çonte në liqen, ku ndonjë varkëtar që kalonte aty pranë, mund ta gjente e ta merrte me vete, ose të çante rrymën e të kalonte në bregun tjetër, por përroi ishte shumë i thellë e i furishëm. Uji i rrëmbyeshëm thyente degët e trasha të pemëve nëpër gurë dhe shkëmbinj. Përveç kësaj, ajo nuk dinte të notonte; dikur, vetëm sa ishte pllaquritur e llapashitur në plazhin e ishullit Konei. Edhe pse nuk ishte shtatzënë, rreziku për t'u mbytur kishte qenë i madh. Ç'i duhej liria, nëse nuk do të jetonte më?

Në fund të urës, gratë morën djathtas, duke ndjekur një rrugë të baltosur drejt liqenit. Në të djathtën e tyre, mes rrugës dhe korijes me pisha, një fushë e gjerë ishte mbushur me piketa prej hekuri, të vendosura njëra pas tjetrës, secila shtatëdhjetë centimetra e lartë dhe tridhjetë centimetra e gjerë. Në rreshtin e fundit, një burrë me çizme llastiku dhe kominoshe po hapte një gropë. Kur pa gratë, ndaloi dhe e hodhi lopatën në një pirg dheu, hoqi kapelën e i përshëndeti me dorë.

- Ai është varrmihësi, Lorenc Lorenci, - tha Madalena. - Ka më tepër se tridhjetë vjet këtu në Uillard dhe mund të bëjë pak a shumë ç't'i dojë qejfi. Kam dëgjuar se gjatë një vere, nisi të flinte te ajo kasollja atje tej, pranë korijes me kedra, - dhe tregoi me gisht drejt një shtëpize njëkatëshe, të strukur buzë pyllit, çatia e së cilës ishte mbushur plot me boçe dhe hala pishe. Klara nuk e imagjinonte dot se prej sa kohësh në atë strehë nuk banonte njeri, por iu duk e rrënuar, gati për t'u shembur e për t'u bërë pluhur.

Druri i tharë përgjatë viteve dhe ajri i ndenjur i papafingos ngriheshin në një re të stuhishme tallashi dhe ashklash. S'arrinte ta imagjinonte se si mund të ishte nga brenda. - Lorenci i kishte pyetur mjekët nëse mund të largohej nga pavijoni i meshkujve e të qëndronte në këtë kasolle, - vazhdoi Madalena. - U kishte thënë edhe të mos shqetësoheshin, sepse nuk kishte ndër mend të largohej, pasi s'kishte ku të shkonte.

- Nuk është orvatur kurrë t'ia mbathë? - pyeti Esteri me sy të zgurdulluar.

- Thotë se ndihet i lumtur këtu.

- Duhet të jetë i çmendur, - tha ajo. - Askush s'mund të jetë i lumtur këtu.

Në të majtë të rrugës, ngrihej një godinë katërkatëshe, me çati me tjegulla jeshile, që kishte bërë bark në mes, si të mbante një barrë të padukshme. Me sa duket, dikur, godina me tulla kishte qenë e lyer me bojë të bardhë. Tani, gurët e ekspozuar ishin të palatuar dhe kishin marrë një ngjyrë trëndafili, kurse fashat e zbehta të bojës së rrjepur ishin ngjitur nën strehën e çatisë dhe rreth kornizave të dritareve. Shufrat e hekurta i vinin kryq e tërthor dritareve të ndotura, si filli i zi në një çorape të arnuar. Pranë godinës, një pemë e gjatë dhe e tharë, me degë të përdredhura e të përkulura, arrinte deri në qiell.

Në oborrin anësor, dy grupe pacientësh ecnin me mundim përgjatë anës së oborrit të mbuluar nga barërat e këqija; disa prej tyre me duar të mbledhura, disa me këmishën e forcës ose me dorashka lëkure me zinxhirë, por të gjithë të lidhur bashkë me litarë në mes. Njëri grup kishte meshkuj, ndërsa tjetri femra. Këmishët e bardha të spitalit ishin të shqyera dhe kishin zënë kore nga pisllëku; jashtëqitja, të vjellat dhe urina u ishin tharë në këmbë, krahë e flokë. Një grua binte vazhdimisht dhe tërhiqej zvarrë nga të tjerët, derisa rojat e ndalnin grupin që ajo të ngrihej përsëri, por gruaja rrëzohej sërish pas dhjetë hapash. Shumë prej pacientëve ecnin duke u lëkundur apo çalonin, ndërsa të tjerë bërtisnin për ndihmë. Njëra prej tyre mundohej të godiste ato që kishte përqark, ndërsa një tjetër kthehej për të ecur në drejtimin e kundërt. Një pacient mashkull me këmishë force shtynte me shpatulla përpara në çdo hap që hidhte, në fillim majtas, pastaj

djathtas, si një futbollist që praktikon lëvizjet e tij. Një nga burrat kishte maskë në gojë. Disa prej tyre mallkonin me sa kishin në kokë.

Klara u mundua të mos mendonte më për ta, por nuk mundi.

- Cilët janë ata? - pyeti Esterin.

- Ata janë shumë të dhunshëm dhe mbahen të izoluar, veçan të tjerëve, - tha. - Mjekët i mbajnë të mbyllur atje tej, në shtëpinë "Ruki Pest". Kam dëgjuar se nuk ka ngrohje dhe se pacientët lidhen me zinxhir pas shtretërve.

Klara u drodh e tëra, edhe pse nuk kishte ftohtë, dhe hodhi vështrimin nga liqeni. Një varkë me dru tiku formonte një vijë të bardhë mes dallgëve. Një spango me flamuj shumëngjyrësh, e lidhur nga direku te kiçi i anijes, përkundej nga era. Ajo picërroi sytë për të parë njerëzit që ishin ulur në hapësirën pas kasolles dhe pyeste veten se ç'mendonin ata kur shikonin Uillardin. Vallë, e dinin se ç'ishte ky vend? I shihnin pacientët si njerëz të vërtetë apo si qenie jonjerëzore, që nuk mund të bënin një jetë normale? Kënaqeshin që pacientët ishin izoluar dhe ndiheshin të lehtësuar që mund ta shijonin jetën pa u shqetësuar nga dikush me probleme mendore? A e kuptonin se pjesa dërrmuese e pacientëve kishin pasur dikur shpresa dhe ëndrra? Që disa prej tyre po mbaheshin të izoluar kundër vullnetit?

Në atë çast, dikush ulëriti dhe e shkëputi Klarën nga mendimet. Një burrë lakuriq, me sy të çapëlyer dhe mjekër të çrregullt, doli nga qendra "Ruki Pest"duke vrapuar. Vraponte drejt liqenit me aq shpejtësi sa mund të ecnin këmbët e tij thatanike, kurse dy roja i shkonin pas. Burri lakuriq u pengua te një trung peme dhe u rrëzua, mandej, duke u kacavjerrë, u ngrit sërish më këmbë. Rojat e kapën dhe e zunë përfund. Më pas, e ngritën dhe e tërhoqën zvarrë drejt godinës me tulla. Kur ata e drejtuan grupin në anën tjetër, drejt hangarit të barkave dhe dokut, larg qendrës "Ruki Pest", Klara, e çliruar, hodhi vështrimin tej.

Më vonë, kur ishte në kuzhinë, nuk reshtte së menduari për pacientin e qendrës "Ruki Pest" dhe vriste mendjen se nga çfarë tmerresh kërkonte të shpëtonte. Si mund të ekzistojë një vend si Uillardi, ku njerëzit trajtohen si kafshë, ndërsa të tjerët vazhdojnë qetësisht jetën? Ajo vriste mendjen nëse e dinte babai sa i tmerrshëm ishte Uillardi apo as që i bëhej vonë fare? Aty

ku ulej për të qëruar patate, arrinte të shikonte Madalenën tek lante pjatat në lavaman dhe djersa i shkonte çurg. Përgjegjësja e kuzhinës nuk i lejonte punëtoret të flisnin me njëra-tjetrën, por Klara ndihej e gëzuar vetëm që e kishte Madalenën aty pranë, për të shkëmbyer ndonjë buzëqeshje apo përshëndetje me dorë, për t'i thënë vetes se ajo dhe të tjera në Uillard ishin ende në rregull nga mendtë. Gruaja e ulur në një stol në të majtë të Klarës nuk nxirrte kurrë asnjë fjalë nga goja. Kokulur, qëronte patate dhe murmuriste me vete.

Sikur t'ia kishte lexuar mendimet, Madalena u kthye nga Klara dhe e përshëndeti me dorën gjithë sapun. Sytë i kishte të lodhur, por të qeshur. Në atë çast, përgjegjësja eci përmes kuzhinës, duke kaluar mes Klarës dhe Madalenës, buzëvarur. Madalena u kthye, vuri gishtin e madh te hunda dhe nxori gjuhën, duke e përqeshur nga prapa përgjegjësen. Një pjatë e njomë i rrëshqiti nga dora tjetër, u përplas përdhe e u thye në qindra copëza të bardha në dyshemenë me pllaka.

Përgjegjësja e kuzhinës ndali hapin dhe u rrotullua vetëtimthi për të parë se çfarë kishte ndodhur. Pa humbur kohë, vrapoi drejt Madalenës. Kjo e fundit bëri prapa, derisa mbeti e zënë në grackë te qoshja mes murit dhe lavamanit metalik. Përgjegjësja ia nguli thonjtë në krah, e tërhoqi përpara e mandej e shtyu te banaku. Pjesa e pasme e kokës iu përplas pas rafteve dhe nga përplasja u dëgjua një zhurmë e fortë, e mbytur, kurse argjendurinat u tundën në kullesë. Përgjegjësja ngriti dorën për ta goditur, duke ulëritur diçka për vlerën e pajisjeve. Atë çast, Klara lëshoi qëruesen e patateve dhe shkoi drejt tyre.

- Lëre të qetë! - i bërtiti. Ia mbërtheu dorën përgjegjëses duke u përpjekur ta largonte nga Madalena. Ajo, e bërë flakë në fytyrë dhe duke gulçuar, u kthye dhe e shtyu Klarën me të dyja duart. Edhe pse dukej si një shtytje e lehtë, Klara fluturoi mbrapsht, me krahët që i valëviteshin dhe me sy të zgurdulluar. U orvat të ruante ekuilibrin, por rrëshqiti në dyshemenë e lagur, u rrëzua dhe koka goditi pllakat me një zhurmë të mbytur; një dhembje e fortë i përshkoi kafkën. Vështroi tavanin dhe kapsalliti sytë. Gjithçka iu err dhe gati sa s'po i binte të fikët. Ndjeu njëfarë ngrohtësie dhe ujërat i shpërthyen mes këmbëve; më pas, humbi ndjenjat.

Klara përpëliti sytë me mundim dhe, më në fund, i hapi, duke u orvatur të përqendrohej tek objektet sferike që i ndriçonin mbi kokë. Po e çonin diku. Rryma ajri me erë mbytëse i përplaseshin në fytyrë e në krahë. Nuk e kishte idenë se ku mund të ishte, por, më pas, kuptoi se dritat e turbullta që ndriçonin sipër, ishin drita tavanesh. Ktheu kokën dhe pa salla me drita të zbehta dhe shtretër spitali; pa infermieret që përkuleshin mbi pacientët duke u bërë gjilpëra, duke u kontrolluar pulset dhe duke shkruar nëpër kartela. E kishin vënë mbi barelë dhe po e transportonin me nxitim nëpër korridoret e infermierisë. Befas, ndjeu muskujt e barkut t'i përdridheshin e t'i tendoseshin, sikur t'i kishin ngulur një thikë në pjesën e poshtme të tij. Deshi të çohej, të ngrinte gjunjët e të mblidhej kruspull, por një dorë e fuqishme e shtriu sërish. Ngriti sytë për të parë kush po e shtynte barelën. Ishte një infermiere që nuk e njihte.

Ajo mori kthesën dhe e drejtoi barelën brenda dhomës së vizitave, ku po e priste një mjek, i cili dukej si thithëlopë. Ishte i shkurtër dhe i fryrë si tullumbace; faqet bullafiqe i vareshin poshtë e i formonin një mjekër tjetër.

- Çfarë i ka ndodhur? - pyeti mjeku infermieren.

- Është rrëzuar dhe ka përplasur kokën, - tha ajo dhe kaloi nga ana tjetër për të qëndruar pranë barelës. - Tani u përmend.

- Sa kohë ka pa ndjenja? - pyeti ai dhe u përkul mbi të e i hapi qepallat, duke i kontrolluar bebet e syrit me një dritë të vogël.

- Ndoshta pesëmbëdhjetë minuta, - u përgjigj infermierja.

- Si ndihesh? - e pyeti Klarën me zë të lartë. - Të merren mendtë?

Klara mohoi me kokë. Ndjeu një kontraktim tjetër dhe mblodhi gjunjët, me qëllim që të ndalonte dhembjen therëse dhe përvëluese në pjesën e poshtme të barkut. I dukej sikur po e copëtonin. Kafshoi buzën, duke rënkuar ngadalë.

- Të dhemb koka? - pyeti mjeku.

- Jo, - iu përgjigj Klara. - Po lind.

Mjeku rrudhi vetullat, vështroi infermieren me një shikim pyetës, por ajo mblodhi supet.

- Mund të ngrihesh dhe të shkosh te tavolina e vizitave? - i tha Klarës.

Ajo u ngrit me krahët që i dridheshin, zemrën që i rrihte fuqishëm, dhe kokën që i buçiste njësoj. Me dorën mbi bark, uli këmbët nga dysheku dhe zbriti nga barela. Mes këmbëve po i rridhte një lëng i ngrohtë që i njomi këpucët e lëkurës. Mjeku shkoi te lavamani për të larë duart.

- Duhet t'i heqë mbathjet, - i tha infermieres.

Klara i hoqi këpucët pa i zgjidhur, sepse dhembja therëse e barkut nuk e lejonte ta drejtonte trupin. Infermierja iu afrua dhe nisi t'i ngrinte fustanin, që t'i hiqte mbathjet. Ajo ia shtyu dorën dhe i hoqi vetë, duke u orvatur t'i ulte poshtë pa u rrëzuar. Hipi në tavolinën e vizitave dhe po mundohej të merrte frymë ngadalë dhe thellë.

Mjeku tërhoqi mbajtëset metalike të këmbëve dhe ia bëri me shenjë Klarës që të shtrihej. Ajo u bind dhe mbështeti kokën në një jastëk të vogël me gunga. Mjeku i kapi këmbët për t'ia lidhur dhe ajo mbylli sytë, teksa përpiqej të imagjinonte fytyrën e Brunos, flokët e tij të zinj dhe buzëqeshjen rrëzëlluese. Kur mjeku e preku me duar, ajo kërceu përpjetë, ktheu kokën nga ana tjetër dhe pa veten në xhamin e bardhë të dollapit të mbushur me spatula laringale, topa pambuku dhe instrumente të tjera të mprehta e të shndritshme. Pas kontrollit, mjeku i preku gjunjët dhe i tha të ngrihej.

- Kjo vajzë e gjorë është gati për të lindur, - tha. - Ta çojmë në një dhomë.

Infermierja mblodhi buzët, ia nguli sytë Klarës dhe, më pas, mori një kartelë e ia zgjati mjekut.

- Cili mjek kujdeset për të? - pyeti doktori, duke shkruar diçka në kartelë.

- Doktor Roaçi, - ia ktheu ajo. - Të marr një karrige me rrota?

- Po, - tha mjeku. - Sille sa më shpejt. - Infermierja u largua nga salla dhe mjeku iu drejtua Klarës. - E di cili është babai i fëmijës?

Klara pohoi me kokë, e pasigurt nëse mund të përgjigjej. Kontraktimet po shtoheshin gjithnjë e më shumë.

- I dashuri im, Brunoja, - tha duke gulçuar.

- E ku është Brunoja tani?

- Nuk e di, - arriti të thoshte Klara.

- Është pacient i këtij spitali? - pyeti mjeku.

Klara mohoi me kokë, ndërkohë, bulëza djerse i mbuluan ballin dhe buzën e sipërme. Infermierja u kthye me një karrige me rrota dhe mori nga dollapi një fustan spitali. Klara zbriti nga tavolina dhe u ul në karrigen me rrota, duke u mbështetur mirë. I dukej sikur zorrët po i dilnin jashtë dhe brenda një kohe të shkurtër do të formonin një pirg të gjakosur në prehrin e saj. Befas, instinktivisht, deshi të ngrihej e të zbriste nga karrigia.

- Ulu! - tha infermierja dhe e shtyu sërish në karrige. Para se Klara të kundërshtonte, ajo nisi ta shtynte karrocën përmes sallës.

- Po del foshnja! - ulëriti Klara.

Mjeku hapi derën dhe infermierja e nxori Klarën në korridor. U kthye djathtas dhe vrapoi përgjatë korridorit, duke u bërtitur infermiereve dhe pacientëve të tjerë që të hapnin rrugën. Një punëtor po shtynte një karrige me rrota drejt tyre, ndërkohë që me një dorë mundohej të mbante në karrige burrin pa ndjenja. Nuk mundi të kthehej shpejt dhe gati sa s'u përplasën. Më në fund, infermierja hyri në një korridor të shkurtër dhe e futi Klarën në një dhomë me një krevat.

- Çohu, - tha.

Një infermiere tjetër e ndihmoi Klarën të ngrihej nga karrigia dhe filloi ta zhvishte.

- Vish këtë fustan, - i tha duke i zbërthyer reçipetat. - Je gati për të lindur. E kupton këtë?

- Po, - u përgjigj Klara që mezi mbushej me frymë. - I thashë doktor Roaçit që jam shtatzënë, por nuk ma vuri veshin. - Veshi fustanin, hipi mbi dyshek dhe u shtri. Një tjetër vazhdë dhembjesh i përshkoi mesin dhe ndjeu sërish instinktin për të shtyrë.

Infermierja e parë e mbuloi me një çarçaf të hollë, ndërsa e dyta e kishte mbërthyer te kyçet e këmbëve dhe ia mbante të bashkuara, duke i thënë që të mos shtynte derisa të vinte mjeku. Klara përpëlitej në shtrat, në përpjekje për të mos u shtrënguar. I dukej sikur trupin po ia ndanin më dysh; pejza dhe muskuli i përdridheshin në drejtimin e kundërt, kurse venat iu tendosën aq shumë, sa gati po shpërthenin. Më në fund, doktori erdhi me nxitim dhe i urdhëroi infermieret të merrnin batanije, peshqirë dhe një legen me ujë të ngrohtë.

- Na duhet morfinë dhe skopolaminë, - tha i alarmuar. Infermieret dolën me vrap nga dhoma dhe ai e kontrolloi sërish Klarën. Ajo u ngrit mbi bërryla dhe hetoi fytyrën e mjekut, me shpresën se mos kuptonte diçka lidhur me gjendjen e foshnjës. Zemra që i rrihte fort, gati sa s'po i dilte vendit.

Nëse llogaritjet kishin qenë të sakta, foshnja po lindte dy javë para kohe. U ndje e tmerruar, sepse, pavarësisht nga gjithçka, vajza po vinte në jetë më herët dhe mund të mos mbijetonte. Mandej, po aq befas sa nisën, aq edhe u lehtësuan. Klara u lëshua sërish mbi jastëkë, duke gulçuar.

- Ka ndonjë problem? - pyeti.

- Rri shtrirë dhe mundohu të jesh sa më qetë, - ia ktheu mjeku. - Tani je nën kujdesin tim.

Infermieret u kthyen nxitimthi në dhomë. Në krahë, mbanin peshqirë, një legen, çantën e mjekut dhe një kanë me ujë të nxehtë. Klarës iu mblodh sërish një lëmsh në stomak dhe ndjeu një tjetër kontraktim. I dukej sikur çdo muskul po ia shtrëngonin me një morsetë gjigante. Mori frymë thellë, vuri duart mbi gjunjë dhe shtyu. Foshnja po dilte; ndiente kokën e gjerë e të njomë që po mundohej të shkëputej nga trupi i saj e të vinte në këtë botë.

Nisi të merrte frymë shpejt. Në çdo frymëmarrje, dëgjoheshin gulçime të shpeshta e të dobëta. Një rrëke i rrodhi mes këmbëve. Pickimi i një gjilpëre në lëkurë e bëri të hidhej përpjetë. Ktheu kokën dhe pa një infermiere që kishte shtrënguar buzët fort dhe i kishte ngulur një gjilpërë në pjesën e sipërme të krahut. U mundua të ngrihej sërish, por fuqia e kishte lënë. Vështroi mjekun. Çehrja e tij e ngrysur ishte gjëja e fundit që pa, para se gjithçka t'i errësohej.

KAPITULLI 11



Izi

Uillard

Në ndenjësen e pasme të makinës *Mitsubishi* të Pegit dhe të Herrit, Izi ngacmonte pjesët anësore të thonjve, teksa shikonte godinat e Uillardit që i vërtiteshin para dritareve të makinës. Ishte shtator. Dielli shkëlqente në qiellin blu, kurse në largësi dalloheshin shkreptima që paralajmëronin një stuhi të mundshme. Në të majtë të makinës, shtrihej liqeni Seneka që vezullonte në largësi, kurse dallgët e cekëta valëzonin në bregun e anës tjetër. Majat e pemëve lëkundeshin nga puhiza e lehtë dhe pulëbardhat ishin mbledhur në çatinë me dërrasa të hangarit të varkave të Uillardit, që ishte përkulur nga brenda.

Godinat dhe mjediset e Uillardit dukeshin të heshtura dhe pa jetë. Asnjë fije bari nuk tundej, asnjë degë apo gjethe dredhke nuk lëvizte, asnjë zog nuk fluturonte pranë çative apo të ulej nëpër oxhaqe. Në kontrast me muret me tulla të kuqe, dritaret e pavijoneve dukeshin të shkrumbuara e të zeza, si të kishin marrë flakë nga brenda ose dielli ta kishte të pamundur të depërtonte në errësirën që mbizotëronte brenda tyre.

Izi nuk po u besonte syve që ishte rikthyer në spitalin e vjetër, që do të futej brenda kësaj godine të braktisur e do të kontrollonte regjistrat e vjetër mjekësorë. U përpoq me sa fuqi kishte të

merrte frymë thellë e ta largonte frikën, duke u përqendruar tek emocionet për të zbuluar diçka më shumë për Klarën.

Para tri netësh, pas darkës dhe pasi kishte mbaruar detyrat e shtëpisë, Izi, më në fund, i kishte rrëfyer Pegit se kishte marrë ditarin e Klarës. Pegi ishte zhgënjyer, por nuk ishte zemëruar, sepse e kuptonte magjepsjen e saj dhe besonte se nuk kishte ndër mend ta mbante atë. Pasi e kishte falënderuar që i tregoi të vërtetën dhe i kishte mbajtur një leksion për virtytet e ndershmërisë e të sinqeritetit, Pegi shfaqi interes për gjithçka që Izi kishte gjetur.

- Faleminderit që nuk u zemërove, - tha Izi.

- Do të më bësh një nder? - pyeti Pegi. - Herën tjetër, më merr leje.

Izi pohoi me kokë.

- Patjetër, - tha.

- Meqë të intereson kaq shumë ky projekt, a dëshiron të vish me ne në Uillard të shtunën? Ende s'arrij ta besoj, por autoritetet shtetërore na kanë lejuar të kontrollojmë regjistrat mjekësorë.

- Do të analizoni edhe dosjen e Klarës? - pyeti Izi.

- Më vjen keq! - iu përgjigj Pegi duke tundur kokën. - Nga sendet që gjetëm në valixhe, e patëm shumë të thjeshtë të kuptonim gjithë jetën e saj. Nuk është ndër pacientet për të cilat duam të rrëmojmë më tepër. Ashtu si the edhe ti, në ditar kemi gjetur shumë shpjegime, por, nëse ke dëshirë të vish me ne, mund ta kërkosh vetë atë dosje. Na kanë lejuar të rrimë në spital vetëm disa orë, ndaj duhet të kontrollojmë shpejt.

Sa më shumë i afroheshin godinës së braktisur, aq më shpejt i rrihte zemra Izit. Herri hapi krahun në një rrugicë të ngushtë dhe parkoi pranë një godine katërkatëshe me tulla. Fiku makinën dhe zbriti. Izi zbriti nga dera e pasme dhe pa se pranë tyre po hapnin krahun dhe po parkonin edhe dy makina të tjera. Pegi dhe Herri dolën prapa *Mitsubishi*-t dhe hapën bagazhin. Nga makina e parë zbritën dy punëtorë të muzeut, ndërsa makina e dytë parkoi në anën tjetër. Izi nuk arrinte të dallonte se kush ishte ulur në ndenjësen e përparme, por e dinte që makina e dytë ishte e babait të Etanit, sepse Pegi i kishte thënë që do të vinte edhe fotografi. U hap dera dhe u shfaq Piteri, ndërkohë, çatia e makinës u ngrit lart dhe struktura metalike nisi të kërciste. Izi mbajti frymën,

duke pritur të shikonte nëse Etani ishte me të. Piteri doli prapa makinës dhe hapi bagazhin. Nuk zbriti asnjë tjetër.

Në njëfarë mënyre, Izi u ndje e lehtësuar. Tani s'do të shqetësohej më që t'i shmangej Etanit dhe ishte e lirë të përqendrohej për të gjetur dosjen e Klarës. Kishin kaluar katër ditë që nga skena e sikletshme që ishte krijuar në orën e psikologjisë dhe ajo nuk kishte marrë më asnjë lajm prej tij. Kur e kishte hasur atë dhe Shenonin nëpër korridore, ata e kishin shpërfillur. Asnjë nga nxënësit e tjerë nuk e kishte përmendur nënën e Izit apo të talleshin me të dhe befas, dukej sikur Izi nuk ekzistonte. Vetëm Aleksa i fliste. Për arsye që Izi nuk mund t'i përcaktonte, indiferenca e Shenonit ishte si qetësia para një stuhie, madje, edhe Aleksa mendonte se ishte vërtet e çuditshme.

Shkoi te bagazhi i makinës dhe u habit kur pa Pegin dhe Herrin që kishin veshur uniforma spitali mbi rrobat e tyre. Pegi i dha një elektrik dore dhe një uniformë jeshile.

- Pse do t'i veshim këto? - pyeti Izi.

- Ky spital i vjetër është i ndotur me asbest dhe plumb, - tha Herri. - Duhet të përdorim pajisje mbrojtëse.

Izi hodhi vështrimin nga makinat e tjera dhe pa që edhe punëtorët e muzeut po vishnin pajisje mbrojtëse. Piteri iu afrua makinës së Pegit dhe Herrit duke buzëqeshur vesh më vesh. Mbi njërën shpatull, mbante pajisjet e fotografisë, kurse në tjetrën kishte hedhur rripin e gjerë të një projektori. Pegi dhe Herri vunë rreth qafës maska letre dhe u nisën drejt ndërtesës. Herri kishte me vete një projektor dhe një çantë shpine, ndërsa Pegi kishte varur një çantë pëlhure në njërën shpatull. Izi dhe të tjerët i ndiqnin nga pas. Me të mbërritur te porta e mbyllur me zinxhirë dhe dryna, e bllokuar nga brenda me kompensatë, Pegi u dha të gjithëve nga një palë çizme mbrojtëse prej letre, që t'i vishnin sipër këpucëve.

- S'ke marrë asgjë për të veshur sipër rrobave? - e pyeti Herri Piterin.

Ai tundi dorën në shenjë mohimi.

- S'më gjen gjë, - tha.

- Të paktën merri këto, - tha Pegi dhe i zgjati një maskë e një palë çizme. Piteri mori maskën dhe e vuri. U mundua të vishte

çizmet mbi këpucët gjigante, por nuk i bënin. Buzëqeshi dhe me to mbuloi veshët. Të gjithë ia plasën gazit.

- Nuk paska ardhur Etani sot? - pyeti Pegi.

Ai mohoi me kokë.

- Kishte stërvitje, - u përgjigj dhe më pas, i buzëqeshi Izit. - Më tha të të bëja të fala dhe se i vjen shumë keq që po e humbet këtë mundësi.

Izi ndjeu gjakun t'i ngjitej deri te mollëzat. U përkul dhe veshi çizmet prej letre mbi atlete, duke vrarë mendjen se pse Etani i kishte dërguar të fala. Nëse nuk ishte aq burrë sa ta përshëndeste vetë në publik, ç'kuptim kishte e gjitha kjo? Mos ndoshta i vinte zor të pranonte se ata ishin shokë? Apo mos ndoshta kishte frikë nga e dashura? Shtrëngoi nofullat dhe drejtoi trupin, me shpresën se nuk ishte skuqur në fytyrë.

Herri nxori një palë çelësa nga xhepi, hapi drynin dhe hoqi zinxhirin nga dorezat prej tunxhi të derës.

- Ky është spitali i ri, - tha Pegi. - Në fillim, në *Chapin Hall* ndodheshin pavijonet, salla e operacionit dhe morgu. Më pas, pacientët me sëmundje ngjitëse u zhvendosën në një shtëpi të vjetër ferme dhe ndërtuan këtë, spitalin kryesor.

Herri hapi derën dhe një shkulm i vrullshëm ajri i ndenjur bëri që një tufë letrash të grisura të fluturonin te pragu i plasaritur. Një rreze drite në formë drejtkëndëshi u përhap në dyshemenë e errët, duke nxjerrë në pah shtresat e pisllëkut dhe të mykut të tharë. Të gjithë vunë maskat e u futën brenda. Drita e dobët e diellit depërtoi përmes dyerve të hapura të korridorit e u kryqëzua në kalimet e gjata e të errëta. Herri ndezi elektrikun dhe hodhi një sy përqark. Letra të zverdhura, copa gjipsi, copëza suvaje të rënë, shishe plastike dhe mbeturina kishin mbuluar pllakat e dyshemesë. Pranë një muri të plasaritur, ishte një karrige me rrota, ndërsa në mes të korridorit ishte hedhur përmbys një karrocë e thyer me rrota. Shtëllunga pluhuri valëviteshin në ajër, si miliona larva të vogla që pluskojnë në sipërfaqen e detit.

- Mendoni se kemi ndriçim mjaftueshëm për atë që duam të bëjmë? - pyeti Pegi dhe zëri i doli i mbytur, për shkak të maskës së letrës.

- Po, - tha Herri. - Piteri ka marrë me vete një projektor me

bateri. Pastaj, hyn edhe dritë nga dritaret. Them se na mjafton. Salla e regjistrave ndodhet në fund të korridorit në të majtë.

Izi ecte pas grupit në korridor dhe drejtonte elektrikun mes dyerve të hapura, suvasë dhe bojës së tharë që i kërciste nën këmbë. Në një dhomë në të djathtën e saj, një rresht me lavamanë ishin montuar në mur, i cili ishte mbuluar nga myku; porcelani i tyre ishte plot gjipse të thyera dhe pluhur; rrëke ndryshku zgjateshin nga rubinetet. Nja dymbëdhjetë koka dushi ishin varur në një tub të gjatë të instaluar përgjatë tavanit. Bashkuesit metalikë kishin zënë çmërs dhe kishin marrë ngjyrë të gjelbër. Dhoma tjetër ishte plot e përplot me karrige me rrota, por, përveç pëlhurës apo plastmasit, ndenjëset e tyre ishin në formën e ndenjëseve të tualetit, por pa kapakë. Një dhomë ishte bosh, me përjashtim të një dysheku të pistë dhe një cope plastike që varej nga tavani. Diku, në fund të korridorit, jehonin tingujt e piklave të ujit.

Më në fund, mbërritën pranë një dere të mbyllur, me një tabelë ku shkruhej "Regjistrat". Herri provoi tre çelësa para se të gjente të duhurin. Hapi derën dhe të gjithë e ndoqën pas. Përmes dy dritareve të mëdha në mur, hynte mjaftueshëm dritë që të mund të shikonin. Pluhuri fluturonte në ajrin e amullt, i ndriçuar nga rrezet e dobëta të diellit.

Pegi vuri dorën mbi kraharor dhe shikonte përqark, syzgurdulluar. Salla ishte mbushur me tavolina të përmasave të ndryshme, me rafte me dosje, dollapë rrobash dhe rafte të tjera, gjithçka e mbushur dhe e stivuar deri lart me dosje, dokumente dhe kuti. Formularë me anë të ngrëna ishin shpërndarë nëpër dysheme, ndërsa të tjerë ishin vënë kapicë pesëmbëdhjetë centimetra nga toka, të siguruar me një shirit llastiku. Dyshemeja me pllaka ishte mbuluar nga radioskopitë dhe dosjet, të shpërndara kuturu, si t'i kishte flakur dikush në sallë dhe të kishte mbyllur derën.

- Si do t'ia gjejmë anën gjithë këtyre? - tha Pegi.

- Nuk e di, - ia ktheu Herri. - Duhet të punojmë shpejt.

Në një qoshe, Piteri montoi projektorin, i cili ndriçonte mesin e sallës, hoqi disa kuti nga një tavolinë e vogël, të cilën e vendosi në mes të sallës dhe nisi të nxirrte pajisjet. Pegi shkoi në qoshen më të largët dhe ngriti një dosje të trashë. I hodhi një sy për disa

sekonda, pastaj e uli poshtë dhe mori një tjetër disa centimetra më larg. Pasi pa nja dymbëdhjetë dosje, tha:

- Me sa duket, janë munduar t'i sistemojnë sipas rendit alfabetik.

- Si thoni sikur të zgjedhim emrin e një pacienti dhe të kërkojmë dosjen e tij? - pyeti Herri.

- Ide gjeniale, - tha Pegi dhe nxori një letër nga çanta, u caktoi nga një emër të gjithëve, përveç Izit dhe Piterit, dhe më pas u shpërndau kartelat. - Shënoni emrin e pacientit dhe të gjitha informacionet që mendoni se janë të dobishme. Lëreni Piterin t'u bëjë sa më shumë foto dosjeve të rëndësishme. Kjo është mundësia e vetme që kemi, ndaj luajini duart. Izi, ti mund të më ndihmosh mua.

Të gjithë u shpërndanë në drejtime të ndryshme dhe iu përveshën punës. Izi ndoqi Pegin në anën tjetër të dhomës.

- Çfarë do të bëj? - pyeti ajo.

- Mbiemri i pacientit që po kërkoj, fillon me K, si Klara, - tha. - Ndoshta këtu mund të gjesh edhe atë që po kërkon.

Pegi tërhoqi një dosje dhjetë centimetra të trashë dhe të dyja panë faqen e parë. Në kapak ishin ngjitur dy foto bardhë e zi; njëra i përkiste një gruaje të moshës së mesme me një bluzë me jakë me lidhëse, me flokë të qethur, me një buzëqeshje të druajtur dhe sy dashamirës. Në murin pas kokës, ishin pesë shifra: numra të zinj në një shirit të bardhë. Në foton e dytë, kishte dalë e njëjta grua me lëkurë të rrudhur në ngjyrë gri dhe me rrathë të dallueshëm poshtë syve. Ishte e ngrysur në fytyrë dhe buzët i ishin futur përbrenda në gojën pa dhëmbë. Ishte fytyra më e trishtuar që Izi kishte parë ndonjëherë.

- Ester Bolduin, - tha Pegi, e mbylli kartelën dhe e vuri sërish atje ku e gjeti. - Qenkemi te shkronja "B", - dhe eci pak përgjatë murit, mori një dosje tjetër sipër një rafti dhe e hapi. Izi s'ia shqiste sytë Pegit, sepse nuk donte të shikonte foton e një fytyre tjetër të rrënuar nga vitet e kaluara brenda këtij institucioni.

- Dimitri Kabell, - tha Pegi. - Jemi te shkronja "K". E vuri në vend dosjen dhe foli me zë të ulët. - Vazhdo të kontrollosh se mos gjen dosjen e Klarës.

Izi eci përgjatë murit dhe mori një kartelë nga raftet. I përkiste

dikujt me mbiemrin Kahill. E vuri në vend dhe mori një dosje tjetër, dy rafte më poshtë. Kjo grua e kishte mbiemrin Kallahan. Mori sërish një tjetër dosje, më pas një tjetër, duke shtrënguar nofullat në çdo shikim të dërrmuar dhe në çdo fytyrë pa dhëmbë që i dilte para. Ishte e paimagjinueshme që aty ishin izoluar aq shumë njerëz dhe disa, për gjithë jetën. Pyeste veten se sa prej tyre mund të ishin si Klara, që kishin një jetë normale dhe, sa hap e mbyll sytë, e kishin gjetur veten të mbyllura këtu. Çfarë do të kishte ndodhur nëse pacientët do të ishin pyetur se ç'u kishte ndodhur dhe jo se çfarë problemi kishin? Pjesa më e madhe e dosjeve ishin disa centimetra të trasha, ku pasqyroheshin vite të tëra të kaluara në këtë institucion. Izit iu mblodh një lëmsh në stomak.

Nisi të pyeste veten pse ishte përfshirë në këtë aventurë dhe pse kishte dashur të zbulonte diçka më shumë për një grua që kishte vdekur me kohë, për një grua së cilës nuk iu dha kurrë mundësia të bënte një jetë normale, siç e meritonte. Izi kishte problemet e veta. Pse të gërmonte në andrallat e dikujt tjetër?

Një nga punëtorët e muzeut çoi një dosje në mesin e sallës, ku Piteri po fotografonte kartelat, radioskopitë dhe dokumentet mjekësore. Izi vështroi për një sekondë, mandej, mori një dosje të trashë poshtë një të holle. Hapi kapakun dhe thuajse e lëshoi nga duart. Klara e shikonte me sy të frikësuar, me buzë të mbledhura fort, sikur mundohej të mos qante. Poshtë emrit ishte shkruar me fjalë të pjerrëta dhe të zeza ***Iluzione paranojake të shoqëruara me halucinacione***.

Izi u kapërdi, kurse sytë iu përlotën. U ul në një stol pranë rafteve dhe nxori elektrikun, me shpresën se askush nuk e kishte mendjen tek ajo. Vendosi dosjen e trashë mbi prehër, shfletoi faqen e parë dhe nisi të lexonte.

> *1 janar 1930: Pacientja duket në gjendje të mirë fizike. Është e pastër dhe është përshtatur me qetësi në pavijon. Është e tërhequr dhe duket se nuk e ka idenë pse e kanë sjellë këtu. Doktor Thorni na paralajmëroi se ajo mendon se nuk ka probleme mendore. Mund të ketë halucinacione dhe iluzione. Është shumë bashkëpunuese, ushqehet mirë dhe bën gjumë të rehatshëm.*

2 janar 1930: Pas kontrollit, s'u gjend asnjë shkak fizik se pse pacientja ndihet aq e dobët. Temperatura dhe pulsi janë normale. Gjatë kontrollit të kraharorit dhe të kockave nuk rezultoi asgjë e pazakontë. Ajo ka iluzione sikur pret një fëmijë, por nuk u vu re asnjë shenjë shtatzënie. Është fort e dobët. Ky iluzion i pacientes mund të vijë edhe për shkak të shtimit të halucinacioneve, karakteristikë e sëmundjes së saj.

Izi psherëtiu. Klara mendonte se ishte shtatzënë? Pse nuk e kishte përmendur këtë gjë në ditar? Mos vallë kishte qenë aq e dëshpëruar për t'u larguar, saqë kishte filluar të imagjinonte gjëra? Mos ndoshta ndarja nga Brunoja e kishte lënduar më shumë nga ç'mund të përballonte? Shfletoi faqet e tjera duke lexuar sa më shpejt që mundej.

5 mars 1930: Pacientja u përpoq t'ia mbathte. Është paranojake dhe vazhdon të ketë iluzione për arsyen pse e mbajnë këtu. U tregua shumë e ftohtë dhe armiqësore gjatë intervistës. U dënua me izolim për gjashtë ditë për t'i hequr paranojën.

31 maj 1930: Pacientja vazhdon të ketë paranoja dhe iluzione. Ashtu siç ishte shprehur edhe i ati, Henri Kartrajt, në letër, ajo vazhdon të besojë se është e dashuruar me një djalë të quajtur Bruno. Babai i saj më ka siguruar se ky njeri nuk ekziston. Çdo përpjekje e bërë që pacientja të përballet me realitetin, ka qenë e pasuksesshme.

1 qershor 1930: Teksa po punonte në kuzhinë, pacientja shkaktoi rrëmujë. Ra pa ndjenja në tokë dhe, më vonë, u përmend me dhimbje të forta në bark. Trauma që pësoi në kokë, nuk përbënte rrezik për jetën. Disa orë më vonë, pacientja solli në jetë një foshnjë femër, të shëndetshme, megjithëse nën peshë. Babai nuk njihet.

Izit gati sa s'po i shpërthente zemra në kraharor. Nuk arrinte t'i besonte ato që po lexonte. Klara dhe Brunoja kishin pasur një vajzë! I ati i Klarës i kishte thënë mjekut se Brunoja nuk ekzistonte! Izi s'mund ta imagjinonte një baba që e mbyll vajzën në çmendinë vetëm se ajo dashuron dikë që s'i pëlqen atij. Pyeste

veten se ç'kishte ndodhur me foshnjën. Ku s'i shkonte mendja. A ishte e porsalindura aq e fortë sa të mbijetonte? A lejohej të mbaheshin fëmijët në Uillard? Imagjinoi dy gurë varri në varrezat e Uillardit, nënë e bijë përkrah njëra-tjetrës në përjetësi, pa iu dhënë kurrë mundësia për një jetë normale. Sytë iu mbushën me lot. Filloi të mendonte një mundësi tjetër, por asgjë nuk po i vinte ndër mend.

Vazhdonte të shfletonte faqet, duke kërkuar ndonjë të dhënë për të marrë vesh më shumë. Kishte shënime të tjera për iluzionet, paranojën dhe halucinacionet. Nga fundi, shënimet ishin gjithnjë e më të rralla, më tepër në formë kronike. Shkruhej për gjendjen fizike të Klarës dhe marrëdhëniet e saj me pacientet e tjera. Kishte të dhëna kartelash në dorëshkrime të ndryshme, dokumente mjekësore dhe lista e dozave të qetësuesve që kishin filluar t'i jepeshin. Izi kaloi te faqet e fundit, për të kërkuar një raport pas vdekjes apo certifikatën e vdekjes. Nuk kishte asgjë.

Pyeste veten nëse Brunoja e dinte se ku kishte përfunduar Klara për gjithë ato vjet. A e kishte marrë vesh që kishte një vajzë, apo e kishte harruar fare Klarën dhe kishte vazhduar jetën? Më pas, Izit iu kujtuan zarfet në valixhen e Klarës, me dhjetëra letra shkruar Brunos, por që s'u postuan kurrë. Mbylli kartelën dhe pa foton sipër saj.

Do ta zbuloj se çfarë ndodhi me vajzën tënde, mendoi. Nëse, dashtë Zoti, është gjallë, do t'i dhuroj asaj ditarin dhe foton ku ti ke dalë me Brunon. Do t'i tregoj sa shumë e ke dashur dhe se ajo s'duhet të ketë frikë. Do t'i them të vërtetën për ty.

KAPITULLI 12



KLARA

Infermieria në Chapin Hall
Shtator 1930

Jashtë dritares së dhomës së infermierisë, dielli shkëlqente mbi liqenin Seneka si mijëra copëza pasqyrash dhe gjethet e pemëve kishin filluar të lulëzonin. Nëse Klara i kishte bërë mirë llogaritë, ajo kishte qëndruar katër muaj në dhomën e *Chapin Hall*-it, duke soditur velin gri të shiut të majit që ia kishte lënë vendin zagushisë së verës, ndërsa lëndinat e mëdha të Uillardit kishin marrë ngjyrë kafe për shkak të valës së gjatë të nxehtësisë së gushtit. Asaj i shërbenin ushqim tri herë në ditë, i zbraznin koshin e dhomës dy herë në ditë dhe, një herë në javë, një infermiere e shoqëronte te dushet që të lahej. Përveç kësaj, e mbanin si të burgosur, por këtu ndihej shumë më mirë sesa në pavijon.

Një rreze drite hynte përmes dritareve të pista. E ulur në një karrige metalike me jastëk, Klara hamendësonte se po afrohej java e dytë e shtatorit dhe vriste mendjen se për sa kohë do t'ia lejonin këtë trajtim të denjë. Sipas infermiereve, ishte shumë shpejt për të ndezur ngrohësit, edhe pse dhoma me tavan të lartë bëhej akull gjatë natës dhe nuk ngrohej kurrë si duhej gjatë ditës, prandaj ajo flinte me çorape dhe pulovër.

Atë ditë, jashtë, buzë liqenit, dukej se ishte më ngrohtë sesa brenda në dhomë. Po digjej nga dëshira për të hapur dritaret,

me qëllim që ajri i freskët të hynte brenda. E dinte fort mirë se çfarë ndjesie të krijonte bota e jashtme. Puhiza e lehtë e vjeshtës ishte e këndshme dhe ajri i freskët, një ndërthurje e pazakontë e tokës së mykur dhe e gjetheve të thara. Do të jepte gjithçka për të shijuar ajrin përjashta, sepse infermieria kutërbonte nga era e neveritshme e suvasë së mykur, bojës së rënë, urinës dhe dezinfektuesve. Klara ishte e sigurt se mund të nuhaste aromën e ngrohtë të gjakut dhe erën e hidhur të vdekjes. I dukej sikur hunda dhe mushkëritë i ishin bllokuar nga pluhuri dhe myku i zi, indet i luftonin sa mundeshin për të marrë frymë, ndërsa rrugët e frymëmarrjes ishin bllokuar nga infeksioni dhe sëmundja.

Lotët i shkuan çurg dhe vështroi të bijën, Beatris Elizabet Moretin, që flinte në krahët e saj. Zemrën ia pushtoi një ndjenjë e pazakontë dashurie dhe dëshire për të mbrojtur të bijën. Vallë, do t'i nxirrnin nga Uillardi? A do të jetonin të lira, të shijonin dritën e diellit dhe ajrin e pastër? Ky institucion i izoluar dhe me erë mbytëse nuk ishte vendi i duhur për të rritur një fëmijë. Ajri gjithë myk i spitalit, i mbushur me mikrobe, barna dhe sëmundje nuk i bënte mirë mushkërive të vogla të Beatrisës. Sërish, siç i ndodhte zakonisht disa herë në ditë, e pushtoi një valë frike që dukej sikur po e mbyste dhe gati sa nuk filloi të qante me dënesë.

- Më fal që përfundove këtu, - pëshpëriti. - Është faji im. Duhej të isha martuar me Xhejmsin. Mund të thosha se ishe vajza e tij dhe tani s'do të të mungonte gjë. Por nga ta dija? Nga ta dija që im atë do të ma bënte këtë? Nga ta dija që do të më urrente?

Doktor Roaçi i kishte thënë Klarës se kishte njoftuar prindërit e saj për foshnjën, por nuk kishte marrë ende përgjigje. Klara imagjinoi se lajmi që ajo do të lindte një fëmijë bastard, do ta kishte xhindosur edhe më shumë Henrin. Kishte ndjesinë se, që tani e tutje, ishte e vetme në këtë botë, me Beatrisën, nëse do të mbijetonin.

Gjatë shëtitjes javore për në dhomën e dusheve, me Beatrisën të mbështjellë me batanije e të shtrënguar pas kraharorit, Klara, pa dashje, dëgjoi mjekët dhe infermieret teksa flisnin për tuberkulozin, tifon, kolerën dhe difterinë. Me sa kuptoi, pacientët në gjendje të rëndë mbaheshin në një kat tjetër, të izoluar nga pjesa tjetër e infermierisë, ama, njerëzit po vdisnin

çdo ditë dhe shqetësimi për të kontrolluar sëmundjet ngjitëse po bëhej gjithnjë e më i madh. Ç'do të ndodhte me të dhe foshnjën nëse sëmureshin? Infermieret donin që, ndërkohë që ajo lahej, ta mbanin ato Beatrisën, por Klara nuk pranonte. Që prej ditës kur lindi, nuk kishte lejuar asnjë ta prekte foshnjën, nga frika se mund të mbartnin mikrobe. Nëse vajzës i ndodhte diçka, nuk kishte më arsye për t'u larguar nga Uillardi, sepse do të luante mendsh vërtet, njëherë e përgjithmonë.

Klara luftonte që të mposhtte frikën, sepse histeria dhe paniku nuk i bënin punë dhe duhej të ishte e kthjellët, nëse donte të mbijetonte. Në vend të frikës, në stomak iu mblodh një shkulm i fortë zemërimi, i cili, pas çdo frymëmarrjeje, bëhej gjithnjë më i madh e më i ftohtë. Si mund të silleshin kështu prindërit? Si mund ta braktisnin e ta linin në mëshirë të mjekëve dhe infermiereve që nuk dinin asgjë për gjendjen e vërtetë të saj? Mos ndoshta të gjithë do ta braktisnin atë dhe vajzën në këtë dhomë, të luanin mendsh, të sëmureshin, të kalbeshin përgjithmonë aty? Mendoi për të ëmën dhe pyeste veten se si ishte e mundur që disa gra kishin lindur pa instinktin mëmësor? Ç'nënë mund të jetë ajo që nuk e shikon apo nuk i flet kurrë fëmijës?

Mendoi për ditën kur Beatrisa erdhi në jetë, kur u përmend, kapsalliti sytë dhe nisi të bëhej e vetëdijshme për dritën që ndriçonte dhe për dy figurat e turbullta që qëndronin mbi të. Kur iu qartësua shikimi, pa doktor Roaçin dhe një infermiere që ia kishin ngulur sytë.

- Ku është foshnja? - pyeti e tmerruar. Paniku e kishte pushtuar të gjithën, zemra i rrihte fort dhe nuk mbushej dot me frymë. U mundua të çohej, por ndjeu një dhembje të mprehtë në bark. Nuk i kushtoi rëndësi, sepse donte të mësonte nëse vajza ishte ende gjallë.

- Mos lëviz, tani për tani, - i tha doktor Roaçi.

- Foshnjën e ke këtu, - tha infermierja dhe vendosi dorën në një krevat të drunjtë fëmijësh. - Është vajzë dhe gëzon shëndet të plotë.

Klara u çlirua nga paniku dhe mori frymë e lehtësuar, kurse zemra që buçiste, kishte filluar t'i ngadalësonte rrahjet. U orvat të mbështetej mbi krahët që i dridheshin, dhe hodhi vështrimin

nga vajza e sapolindur, e cila ishte mbështjellë me një batanije të bardhë dhe po flinte si qengj. Kur u mbështet te jastëkët, Klara u drodh. Iu duk sikur i kishin ngulur një thikë në pjesën e poshtme të barkut.

- Nuk duhet të lëvizësh, - tha doktor Roaçi. - Ke pësuar një goditje të fortë në kokë. Mendojmë se do të bëhesh më mirë, por duhet të qëndrosh disa ditë në shtrat.

- Çfarë kam? - pyeti ajo duke vendosur duart mbi bark.

- Doktor Slejdi të operoi, - tha doktor Roaçi me zë të qetë. - Nuk ka asgjë për t'u shqetësuar. Shumë shpejt do të jesh njësoj si më parë.

- Çfarë operacioni? - pyeti. - Çfarë më ka bërë?

Doktor Roaçi shkoi në fund të shtratit dhe ngriti kartelën e varur.

- Meqë jam mjek, - tha dhe nxori një stilolaps nga përparësja, - është detyra ime të kujdesem për shoqërinë në përgjithësi. Nëse shoqëria do të lulëzojë, ne duhet të inkurajojmë personat me plazma embrionale të shëndetshme të shtohen dhe të mos i lejojmë ata me plazma embrionale jo të shëndetshme që të kenë pasardhës. Sterilizimi është një procedurë e zakonshme në spitalet shtetërore. Detyra jonë është të mos i lejojmë personat me probleme ta trashëgojnë gjenin e çmendurisë te pasardhësit e tyre.

Klarës iu mblodh një lëmsh i madh në fyt. Mendoi për Brunon, se si i kishin shndritur sytë kur kishin folur për martesën dhe për fëmijët. Ai dëshironte të kishte dy djem dhe dy vajza.

- Si guxoni ta bëni këtë! - bërtiti.

Doktor Roaçi shkroi diçka në kartelë, pastaj, e vari sërish në fund të shtratit.

- Do të flasim më vonë, - tha. - Pasi ta kesh marrë veten.

- Nuk kishit asnjë të drejtë të merrnit këtë vendim për mua, - tha duke u përpjekur të mposhtte dëshirën për t'u ngritur e për ta kapur për fyti. - Unë jam në rregull dhe ju e dini fort mirë këtë.

Ai ktheu shpinën dhe u nis drejt derës; këpucët e lustruara kërcisnin në dyshemenë me pllaka. Klara thirri me zë të ngjirur nga pas:

- Ky është fëmija i Brunos. Brunoja ekziston, pavarësisht se ç'thotë im atë.

Para se të dilte, doktor Roaçi u kthye e tha:

- Siç të thashë, do të flasim pas disa ditësh. Të paktën, nuk do të futesh më në telashe. Tani për tani, duhet të pushosh.

Në atë çast, foshnja nisi të lëvizte e të grindej, gati për t'ia plasur të qarit. Doktor Roaçi doli nga dhoma dhe mbylli derën.

- Pushoje tani, - i tha infermierja Klarës, iu afrua krevatit dhe mori foshnjën e porsalindur në krahë. Vogëlushja, fytyra e së cilës ishte në ngjyrë rozë, po qante. - Duhet të mendosh për tët bijë, - shtoi teksa ia uli batanijen deri te mesi, i vuri në krahë vogëlushen qaramane, i hapi fustanin me gishtat e ashpër dhe i nxori gjoksin e fryrë. Klara vuri njërën dorë mbi kraharor, me mollëzat që i ishin skuqur nga tërbimi dhe poshtërimi. Për herë të parë që kur kishte ardhur në vete, kuptoi se thithat i dhembnin. Kur ishte pa ndjenja, dikush ia kishte vendosur foshnjën në gjoks. - Është llupëse, - vazhdoi infermierja.

Klara kapsalliti sytë dhe pa foshnjën e sapolindur. Mes lotëve, fytyra e vockël dukej si një njollë dhe ajo harroi gjithçka, madje edhe infermieren që e kishte aty pranë. Faqet e vajzës ishin ngjyrë rozë e të buta, ndërsa qerpikët, të gjatë e të errët, si të Brunos. Ledhatoi dorën e vogël të së bijës, e cila i shtrëngoi gishtat e veckël rreth të sajve. Foshnja qante dhe dridhej, goja e butë dhe në ngjyrë rozë kërkonte thithën e gjoksit dhe sapo e gjeti, e futi në gojë, u qetësua dhe mbylli sytë e vegjël. Klarës po i hapej koka dhe i kalonin të therura të forta në bark, dallgë-dallgë, si batica dhe zbatica, me një ritëm të përsosur me thithjen dhe gllënjkat e vajzës. E puthi të bijën në ballë dhe vari kokën; supet i dridheshin dhe i dukej sikur dashuria e hidhërimi do t'ia copëtonin zemrën.

E ulur nën rrezen e ngrohtë të diellit që hynte përmes dritares së dhomës së infermierisë, Klara preku me gisht vijën e hollë në pjesën e poshtme të barkut dhe një hidhërim i thellë e pushtoi të tërën. Penjtë ia kishin hequr para disa muajsh, por plaga ishte ende e butë. Ndiente një zemërim të madh e të papërmbajtur për atë që mjekët kishin bërë pa miratimin e saj. Ledhatoi me mollëzat e gishtave faqet e buta të Beatrisës, duke dashur të shpërfillte hijet e shufrave të hekurit që i binin mbi lëkurën e zbehtë. Klara mendoi për nënën e saj. Vallë a kishte ndier Ruthi të njëjtën dashuri të pashoqe për vogëlushen e saj? Si është e mundur që një grua

të lindë një fëmijë dhe të mos interesohet më për të? Si është e mundur që një nënë të mos interesohet për vajzën e saj të izoluar, të dendur me ilaçe dhe të sterilizuar? Si është e mundur që një nënë të mos interesohet nëse fëmija ka ftohtë, uri apo frikë? Nuk arrinte ta kuptonte dot.

Klara dashurohej çdo ditë e më shumë me Beatrisën. Ndiente një dhembshuri të pamasë, që ia shtrëngonte zemrën. S'e imagjinonte dot veten ndryshe. Gjatë muajve të gjatë e të vetmuar brenda dhomës së errët të spitalit, Beatrisa kishte qëndruar pranë Klarës, në shtratin e saj, duke e parë me sy kureshtarë teksa ajo i tregonte për trumcakët dhe gushëkuqët, të ulur në degët e pemëve jashtë. Vogëlushja e dëgjonte me vëmendje, duke gugatur apo duke ndenjur urtë, sipas rastit, teksa ajo sajonte përralla me kështjella dhe princër e i tregonte për liqenin, për barin, për pemët. Sytë ngjyrë çokollatë të Beatrisës zmadhoheshin, si të kuptonte çdo fjalë kur Klara përshkruante Brunon, herën e parë kur ishin takuar dhe se ç'baba i mrekullueshëm do të kishte qenë, nëse ato do të liheshin të lira.

Për habinë e saj dhe për arsye që nuk i kuptonte, doktor Roaçi tregohej më i kujdesshëm se kurrë. I vinte në dhomë çdo javë për të bërë seancat dhe pas çdo vizite, e pyeste se si ishte foshnja dhe nëse dukej e shëndetshme dhe e fortë. Në seancën e fundit, Klara ngriu në vend kur doktor Roaçi iu afrua krevatit të vogëlushes, tërhoqi cepin e batanijes, si të donte ta shikonte më mirë. Klara mori të bijën dhe shkoi drejt dritares.

- Ju lutem, mos iu afroni, - tha. - S'dua ta prekë asnjë.

- Por unë jam mjeku i saj, - tha doktor Roaçi. - S'ke pse shqetësohesh. Dua më të mirën për të dyja ju.

- Ajo s'ka nevojë për mjek! - tha. - Nëse na doni vërtet të mirën, na lejoni të largohemi nga ky vend!

- Me ndërgjegje të plotë, s'mund të lë të lirë asnjërën prej jush, - tha ai. - Ti nuk je mirë, Klara. Derisa të vërtetoj të kundërtën...

- Çfarë do të bëni? - e ndërpreu ajo. - Do të na mbyllni përgjithmonë në këtë dhomë?

- Jo, - iu përgjigj. - Po pres lajme nga yt atë dhe pastaj do të...

Klara mbeti pa frymë.

- Babai im? - tha. - Kujtoja se s'kishit marrë lajme prej tij që

kur i treguat për vajzën. I thatë që s'më interesojnë paratë e tij dhe se dua vetëm të jem e lirë?

Doktor Roaçi mohoi me kokë, duke mbledhur buzët fort.

- Jo, jo, - tha duke tundur dorën. - Nuk kam marrë vesh asgjë prej tij.

- Ju po më fshihni diçka, - ia ktheu ajo. - Për çfarë bëhet fjalë?

- Ndoshta babait tënd i duhet më tepër kohë për të pranuar se ka një mbesë. Me siguri, ky lajm e ka tronditur, veçanërisht duke pasur parasysh që nuk e dimë se kush është i ati.

- Babai i Beatrisës është Brunoja, - tha Klara me sytë që i digjnin. - Pyetni tim atë.

- E pyeta, - tha doktor Roaçi, duke u drejtuar nga dera. - Përgjigjja e tij do të vendosë atë që do të ndodhë më pas. Nëse kthen përgjigje, kuptohet.

Që prej asaj nate, Klara lutej që i ati t'i tregonte të vërtetën doktor Roaçit. Ç'arsye tjetër mund të kishte që ajo të vazhdonte të qëndronte në Uillard? Tani, as që bëhej fjalë të martohej me Xhejms Gallagerin. Mjaftonte që babai t'i tregonte doktor Roaçit se Brunoja ekzistonte vërtet dhe ajo do të ishte e lirë. Mos vallë po kërkonte shumë?

Zhyti kokën në flokët e dendur të Beatrisës, të njëjtat onde ngjyrë gështenjë si të Brunos, dhe nuhati aromën e pafajësisë së saj, me shpresën se të dyja duhej të ishin të forta. Çuditërisht, gjatë ditëve të fundit, Beatrisa ishte grindur shumë. Klara mendoi se ndoshta duhej të fillonte t'i ndryshonte ushqimin. Gjatë fëmijërisë së vet, nuk kishte kaluar shumë kohë me fëmijë të tjerë dhe, pa dyshim, Ruthi nuk i kishte mësuar asgjë për mëmësinë. Klara e dinte se do të vinte një çast kur qumështi i gjirit nuk do të ishte i mjaftueshëm. Kërkoi mendimin e infermiereve, por ato mblodhën supet ose i thanë se do të mundoheshin të gjenin diçka të përshtatshme.

Për habinë e saj, vaktet në infermieri mund të krahasoheshin me ushqimet në qendrën "Long Ajlënd"; për mëngjes, vezë dhe bukë të thekur; për drekë, sanduiçe me proshutë dhe djathë, të shoqëruar me fruta, ose mish pule apo mish derri me simite, si dhe një pjatë me bathë, misër apo bizele për darkë. Kur pyeti njërën prej infermiereve se pse po i jepnin ushqim të shëndetshëm, u

habit edhe më shumë kur mori vesh se ishte doktor Roaçi ai që kishte urdhëruar që vaktet të ishin sa më të bollshme, me qëllim që të kishte qumësht të mjaftueshëm për të ushqyer foshnjën. Pavarësisht nga dieta, qumështi i gjirit po i hollohej dhe nuk mjaftonte për të ushqyer një foshnjë që rritej dita-ditës.

Pasi kishte lindur, infermieret i kishin sjellë Klarës pelena dhe tri trupore për foshnjën. Ato ishin të arnuara dhe gati në të grisur te bërrylat, por ishin më të mira sesa fustanet e spitalit që Klara kishte përdorur për ta mbështjellë. Nisur nga kjo dashamirësi, ajo kishte shpresuar se infermieret do t'i sillnin ushqime të përshtatshme për foshnjën: drithëra me oriz, fruta të shtrydhura ose, të paktën, qumësht lope.

Në atë çast, dëgjoi çelësin të rrotullohej në derën e dhomës së infermierisë. U ngrit në këmbë dhe u kthye, duke e mbajtur Beatrisën në krahë dhe duke pyetur veten se kush mund t'i vinte në dhomë në atë orë. Ishte tepër herët për drekën dhe takimin tjetër me doktor Roaçin e kishte në fund të javës. Mos ndoshta i ati i ishte përgjigjur më në fund letrës së doktor Roaçit? Klara mbajti frymën, duke parë derën tek hapej.

Hyri një infermiere dhe bëri mënjanë duke e mbajtur derën hapur. Ajo vuri re se ishte një nga infermieret që i kishte sjellë truporet dhe pelenat për vajzën, i kishte buzëqeshur dhe e kishte përkëdhelur Beatrisën, duke i thënë se kishte një vajzë shumë të bukur. Atë çast, infermierja i mbante sytë përdhe, si të donte ta shmangte vështrimin e saj. Doktor Slejdi dhe një grua e veshur me rroba civile, fytyrat e të cilëve ishin si të ngrira, hynë në dhomë. Gruaja kishte veshur një pallto të gjatë leshi dhe kishte vënë një kapelë të gjelbër, poshtë së cilës i dilnin flokët gështenjë. Mbi buzën e sipërme, i dalloheshin rrudhat, si vizat ndarëse të vizores, kurse në krahë kishte një batanije rozë. Hodhi sytë përqark pa thënë asnjë fjalë. Dy ndihmës ndoqën brenda doktor Slejdin dhe gruan, më pas, mbyllën derën. Klara s'po kuptonte se ç'donte aty doktor Slejdi. Kishin kaluar shumë javë që nga hera e fundit kur i kishte bërë një kontroll.

- Çfarë po ndodh? - pyeti.

- Kjo është zonjusha Meson, - tha doktor Slejdi ftohtë dhe pa asnjë emocion. Ai dhe gruaja nisën të ecnin në dhomë drejt

Klarës. - Është përfaqësuese e Shoqatës në Ndihmë të Fëmijëve.

Zonjusha Meson e përshëndeti me kokë Klarën dhe, më pas, ia nguli sytë Beatrisës. Rojat qëndronin vigjilentë pranë hyrjes. Infermierja s'e kishte ngritur ende kokën, vazhdonte të shikonte përdhe, kurse duart i mbante në bel. Diçka nuk shkonte. Klara bëri mbrapsht, me Beatrisën që e shtrëngonte në kraharor dhe zemrën që gati sa s'po i dilte vendit.

- Çfarë doni? - pyeti.

- Ky s'është vend i përshtatshëm për fëmijë, - tha zonjusha Meson. - Të premtoj se do t'i gjej një familje shumë të mirë.

Ndjeu një therje në kraharor, sikur t'i ishte futur një dorë gjigante në të dhe po i shkulte zemrën. Merrte frymë me gulçime të shkurtra e të dobëta; stomaku iu mblodh i tëri dhe një prerje e fortë e detyroi të përkulej e të bëhej si pikëpyetje.

- Jo! Ajo është imja! S'mund të ma merrni! - ulëriti dhe eci mbrapsht derisa u përplas me murin e dritares; këmbët nuk po i ndjente më, ndërsa krahët iu bënë akull. Mbuloi gojën me duar, e sigurt që do të villte.

Doktor Slejdi dhe zonjusha Meson po i vinin rrotull shtratit, duke u afruar gjithnjë e më shumë. Ai u mundua ta kapte Klarën për krahu, kurse zonjusha Meson vuri batanijen në fund të shtratit dhe u turr të merrte Beatrisën.

- Jo! - bërtiti Klara, u lëshua si shigjetë për t'u shpëtuar dhe vrapoi drejt qoshes së dhomës. Rojat lëvizën nga vendi dhe u nisën drejt saj, pa thënë asnjë fjalë. Doktor Slejdi dhe zonjusha Meson, me krahë të zgjatur përpara, si të ishin duke iu afruar një kafshe të egër, i shkuan pas dhe e ngjeshën në një qoshe.

- Na jep foshnjën, - i tha zonjusha Meson. - Nuk do që të të bjerë nga duart, apo jo?

- Largohuni prej nesh! - ulëriti Klara. - S'do t'ju lejoj të ma merrni!

Doktor Slejdi kërceu përpara, e mbërtheu prej krahu me të dyja duart dhe filloi të hungërinte nga sforcimi, ndërsa zonjusha Meson u zgjat të kapte Beatrisën me duart e ashpra që orvateshin ta shkëputnin foshnjën nga shtrëngimi i nënës. Klara e shtyu tutje dhe zonjusha Meson bëri mbrapsht e u pengua. Sytë iu zgurdulluan, kurse krahët i valëviteshin në ajër. Beatrisa u zgjua

dhe nisi të qante, fytyra iu mblodh e tëra dhe u bë flakë e kuqe. Zonjusha Meson arriti ta mbante veten pa u rrëzuar dhe u turr përpara, me duart e zgjatura. Klara u rrotullua dhe u kthye nga ana tjetër, në përpjekje për t'i shpëtuar shtrëngimit të fortë të doktor Slejdit. Ajo e goditi në kërci, ndërsa ai e mallkoi dhe e shtrëngoi edhe më shumë, duke ia ngulur gishtat e trashë në krahë. Para se Klara të kuptonte se ç'po ndodhte, rojat e kishin zënë përfund: njëri i mbante krahët, tjetri qëndronte përpara që të mos binte foshnja, kurse zonjusha Meson ia hapi duart me forcë, që të lëshonte Beatrisën.

Klara e çliroi njërin krah dhe e goditi zonjushën Meson në gojë, e cila preku buzën e sipërme, hoqi dorën dhe me sy të zgurdulluar pa gjakun që i kishte mbuluar majat e gishtave. Rojat ia mbërthyen krahun Klarës dhe ia mbanin me forcë nga pas. Zonjusha Meson ia nguli sytë dhe fshiu buzën, duke u bërë gjithë gjak në nofull. Klara vazhdonte të shtrëngonte Beatrisën në kraharor me njërën dorë, duke goditur, duke u tundur e duke u përpjekur të çlirohej, por ishte e kotë. Rojat ishin më të fortë.

- Jo! - ulëriti dhe fyti gati sa s'i doli vendit. - Ju lutem! S'mund të ma merrni foshnjën!

- Mundemi dhe do ta marrim, - tha zonjusha Meson. Me ndihmën e doktor Slejdit, ia rrëmbeu Beatrisën Klarës dhe qeshi e vetëkënaqur. Me atë pak fuqi që i kishte mbetur, Klara bëri përpara, u shpëtoi rojave nga duart dhe ia nguli thonjtë zonjushës Meson në faqe e u zgjat për të marrë të bijën. Zonjusha Meson ulëriti, duke mbuluar fytyrën me duar. Klara e shtrëngoi Beatrisën në kraharor dhe u kthye t'ia mbathte, por rojat e mbërthyen nga shpatullat. Doktor Slejdi ia rrëmbeu Beatrisën nga krahët me vendosmëri.

- Jo, - tha Klara, duke qarë me dënesë. - Ju përgjërohem! Mos ma merrni!

- Më vjen keq, - tha doktor Slejdi. - Një ditë, do ta kuptosh se është për të mirën e saj.

Infermierja, me sytë e përlotur, mori një peshqir për t'i fshirë faqen zonjushës Meson, por ajo ia rrëmbeu nga dora dhe fshiu fytyrën, pastaj, mori batanijen dhe e hapi mbi shtrat. Doktor Slejdi ia dha Beatrisën zonjushës Meson, e cila e shtriu mbi shtrat,

e mbështolli me batanije rreth këmbëve të vogla që shqelmonin, më pas, e mori në duar dhe filloi ta përkundte sepse po qante.

- Keni marrë vendimin e duhur, - iu drejtua doktor Slejdit. - Kjo grua nuk është e aftë për të qenë nënë. - Doktori pohoi me kokë dhe filloi të merrte frymë thellë, që të kapte ritmin e frymëmarrjes.

- Jooooo! - ulëriti Klara dhe ndjeu shijen e gjakut në fyt. Godiste dhe shkelmonte me sa fuqi kishte, duke luftuar t'u shpëtonte rojave. Zonjusha Meson u drejtua për nga dera, kurse Klara u përkul përdhe: çdo muskul dhe kockë i therte nga dhimbja e hidhërimi. Rojat e tërhoqën zvarrë gjithë rrugës: faqja i përplasej në pllakat e ftohta të dyshemesë me një zhurmë të mbytur. Ndjeu një pickim në krah dhe ktheu kokën nga dalja. Gjëja e fundit që pa, ishte zonjusha Meson që po dilte nga dera me vajzën në krahë, dhe batanija rozë që varej nga njëra anë e palltos së leshtë. Beatrisa po ulërinte.

* * *

Klara ktheu kokën mbi jastëkun e fortë. Drita e zymtë e mëngjesit të hershëm hynte përmes dritares së mbyllur me shufra hekuri. Mund të shikonte një pjesë të pyllit me kedra dhe një burrë me çizme llastiku që ecte përgjatë rrugës me lopatën hedhur mbi supe. Më pas, dëgjoi një ulërimë. U ngrit dhe pa përqark dhomës. Nja gjashtë gra ishin ulur mbi ca shtretër të pistë metalikë, me këmbët e lidhura me zinxhir në fund të shtratit. Klara uli vështrimin. Pa se edhe ajo kishte një zinxhir rreth kyçit. Kishte përfunduar në qendrën "Ruki Pest".

KAPITULLI 13



Izi

E shtunë. Ishte një mbrëmje e freskët dhe e kthjellët fillimtetori. Hëna e plotë kishte dalë në qiellin ngjyrë kobalti: një sferë me pika blu e rrethuar nga një miliard pikëza drite. E veshur me xhinse, atlete dhe një bluzë me kapuç, Izi ishte ulur në ndenjësen prej lëkure të makinës së Aleksës, duke u munduar të largonte ndjenjën e fajit që e kishte gënjyer sërish Pegin dhe Herrin. Në fillim, nuk u kishte treguar se ditarin e kishte marrë Etani dhe, tani, kjo. Ishte thjesht një gënjeshtër e padëmshme. U kishte thënë se do të qëndronte në shtëpinë e Aleksës, kur në të vërtetë do të shkonte për kamping me disa nxënës të vitit të katërt nga "Lejkshori" dhe nga gjimnazi "Romulus". Edhe pse ishte një gënjeshtër e vogël, ndihej si mos më keq, sepse Pegi dhe Herri ishin treguar shumë të mirë me të.

Aleksa i binte timonit me gishta dhe këndonte këngën "You oughta know" të Alanis Morisetit, që buçiste në radio. Kur lanë pas autostradën me dy korsi dhe morën një rrugë të ngushtë e të prishur, Izit iu mblodh një lëmsh në stomak. Nuk ishte e sigurt nëse kjo ishte një ide e mirë. Aleksa ngadalësoi makinën në rrugën gjithë gropa, fiku radion kur hynë në një tunel të errët të formuar nga pemët e shkurtra e të mbuluar nga gjethet, dhe u

struk në ndenjësen e saj, kur papritur, një degë gërvishti mbulesën e makinës. Fenerët kërcyen përpjetë në zhavorrin e prishur, duke ndriçuar pas gëmushës ca sy të vegjël që shkëlqenin.

- Je e sigurt që kjo është rruga e duhur? - pyeti Izi.

- Po, - ia ktheu Aleksa. - Organizojmë gjithmonë festa këtu. Askush nuk vjen ta kontrollojë këtë zonë. Është pronë shtetërore, pjesë e spitalit të vjetër "Uillard".

Izi u kapërdi. Pa dyshim që kishte gabuar.

- S'duhej të kisha ardhur, - tha dhe ia nguli sytë pyllit. - Pas gjithë atyre që ndodhën me Shenonin, nuk dua të futem sërish në telashe.

- Këtu do të ketë aq shumë njerëz, saqë s'do ta marrësh vesh nëse ka ardhur apo jo. Thjesht injoroje.

- Po sikur të mos më lërë rehat?

- Je me mua dhe shokët e mi nga gjimnazi "Romulus". Ata s'i durojnë dot budallallëqet e Shenonit. Gjithçka do të shkojë mirë.

- Nuk di ç'të të them...

- Rehatohu dhe shijoje jetën. Ky është viti i fundit i gjimnazit. Duhet të harbohesh se nuk të vijnë më këto ditë!

Jo, faleminderit, mendoi Izi. *Pikërisht këtë po mundohem të mos bëj.* Në fund të rrugës me baltë, ato u gjendën përballë një lirishte me bar të mbushur plot me makina, furgonë dhe motorë. Izi kafshoi buzën. Përmes pemëve, në anën tjetër të parkingut, dalloi një grup adoleshentësh që po pinin alkool, duhan dhe po kërcenin rreth një zjarri të madh në breg. Shkëndija të kuqe fluturonin në qiellin e mbrëmjes si xixëllonja të dala jashtë kontrollit. Në sfond, liqeni Seneka dukej si një sahan i zi gjigant dhe hëna e plotë pasqyrohej në sipërfaqen e tij në një vijë të gjerë dredhuese. Izi u kujtua se diku kishte lexuar se fjala "i çmendur" e kishte origjinën nga ideja se rrezet e hënës mund të kishin një ndikim negativ në mendjet e njerëzve. Shpresonte që kjo të mos ndodhte sonte.

Aleksa parkoi dhe zbritën nga makina, duke nxjerrë nga ndenjëset e pasme çantat e shpinës, batanijet dhe tendën. Zhurma e muzikës së lartë rrihte brenda kraharorit të Izit si zemra e dikujt tjetër. Një puhizë e freskët sillte me vete aromën e pakëndshme të zjarrit, të drurit që digjej, të peshkut të prishur e të leshterikëve të njomë.

Izi rrëmbeu xhaketën, hodhi mbi supe çantën e shpinës dhe ndoqi Aleksën në anën tjetër të parkingut. Çanë rrugën përgjatë një ure me dërrasa, të ngritur mbi një moçal, pastaj, ndoqën një shteg gjarpërues përmes fidanëve shtrembaluqë dhe grumbujve të vegjël të rërës derisa mbërritën pranë bregut. Dhjetëra adoleshentë ishin mbledhur në plazh. Disa qëndronin më këmbë, të tjerë ishin ulur në stolat e kampingut rreth zjarrit bubulak, disa ngrinin tendat, disa të mbledhur bashkë e të ulur mbi batanije, duke ngrënë pica dhe patatina, duke pirë duhan e birra. Një grup ishte ulur përreth një nargjileje, një tjetër luante volejboll, ndërsa një tjetër kalonte me radhë tek anëtarët e grupit një shishe uiski. Dikush e kishte futur makinën *Pontiac Sunfire* në rërë, kishte hapur bagazhin dhe për shkak të altoparlantëve të magnetofonit, makina dridhej e tëra. Festa kishte nisur në orën tre pasdite, por Izi dhe Aleksa ishin vonuar, pasi kishin pasur punë.

- Le ta ngremë tendën atje tej, - tha Aleksa dhe bëri me shenjë nga një vend pranë një dune të mbuluar me bar. Izi ndiqte Aleksën përmes turmës së njerëzve dhe pyeste veten nëse ndokush do të mendonte se ç'dreqin donte ajo atje. Pa një djalë që po bënte vertikalen, ndërsa Luka dhe Xhoshi e mbanin lart te këmbët dhe zbraznin birrë në një hinkë të vendosur mbi një zorrë që përfundonte në gojën e djalit. Rreth tyre, ishin mbledhur një grup djemsh e vajzash duke bërtitur: "Jepi, jepi! Forca!" ndërsa djali, i kthyer kokëposhtë, bënte të pamundurën që ta kapërcente birrën pa e derdhur.

Izi dalloi disa çifte të ulura pranë zjarrit, të kapur për dore. I hoqi menjëherë sytë kur pa Etanin dhe Shenonin të mbështjellë me një batanije, të cilët po bisedonin dhe po qeshnin me Kristalin e të dashurin e saj, Dejvin.

- Me sa shoh, thashethemet nuk qenkan të vërteta, - tha Aleksa dhe lëshoi çantën në rërë. - Ende jo, gjithsesi.

- Çfarë thashethemesh?

Aleksa bëri me shenjë drejt Etanit dhe Shenonit.

- Të gjithë thonë se Etani do të ndahet me Shenonin, që të lidhet me ty, - tha.

Izi ndjeu faqet t'i ndizeshin.

- Kjo s'ka për të ndodhur kurrë.

- Çfarë? Që s'do të ndahet me të apo që s'do të lidhet me ty?

- Asnjëra prej të dyjave.

- Po thua se s'të intereson fare? - tha Aleksa duke qeshur nën buzë dhe u ul në gjunjë për të hapur tendën.

- Nuk dua t'ia di. Nuk më intereson fare, sepse nuk dua të më përndjekë ajo që bën ligjin në shkollë.

- Pra, po të mos ishte Shenoni, do të ta kishte qejfi, hë?

- Nuk thashë këtë.

- Oh, e kuptova. Ke të dashur në shkollën e mëparshme.

Izi mohoi me kokë.

- Po përpiqem ta kaloj sa më mirë këtë vit, kjo është e gjitha. Duhet të mendoj se çfarë do të bëj pasi të mbush tetëmbëdhjetë vjeçe. Nuk më duhet një lidhje koti që mund të ma ngatërrojë edhe më shumë jetën.

- Ëhë, - tha Aleksa.

Në atë çast, u afrua një grup djemsh dhe vajzash, me batanije, tenda, çanta shpine dhe termos nëpër duar. Djemtë ulën përtokë termosin dhe shkuan të ngrinin tendën, ndërsa vajzat erdhën të përqafonin Aleksën, e cila i prezantoi me Izin.

- Këto janë Kimi dhe Xheki nga gjimnazi "Lejkshor", - tha dhe pastaj bëri me shenjë drejt djemve. - Krisi është nga "Lejkshori", ndërsa Fini dhe Breshka nga "Romulusi".

- Ç'kemi? - i përshëndeti Izi, buzagaz. Xheki mori një verë me lëng frutash nga termosi dhe ia zgjati Izit e Aleksës. Ajo ishte e gjatë dhe elegante, lëkurën e kishte të butë e të nxirë nga dielli, ndërsa flokët e kuqërremtë i mbante gërshet. Dukej sikur sapo kishte dalë nga një kopertinë reviste. Kimi ishte e shkurtër dhe topolake, me flokë gështenjë dhe syze të trasha. Djemtë e lanë punën me tendën, morën nga një shishe birrë dhe u bashkuan me vajzat.

- Ta ka treguar Aleksa pse e thërrasin Breshkën "Breshka"? - pyeti Fini Izin.

Ajo mohoi me kokë dhe Breshka e gjuajti Finin në krah.

- Mbylle atë dreq goje! - tha.

Fini tregoi me gisht mes këmbëve të tij.

- Sepse duket si breshkë e vogël që nxjerr kokën jashtë.

Të gjithë ia dhanë të qeshurës, ndërsa Breshka i kërceu Finit mbi shpinë, duke u përpjekur ta rrëzonte në rërë.

- Mos ua vër veshin atyre, - i tha Xheki Izit. - Janë idiotë.

- Juhu! - ia bëri Aleksa, teksa shikonte pas Izit, drejt zjarrit të madh. Xheki dhe Kimi ndoqën shikimin e saj dhe ngritën vetullat të habitura. Izi ktheu kokën për të parë dhe zemra nisi t'i rrihte fort kur pa Etanin, Shenonin, Xhoshin, Kristalin dhe Dejvin që po vinin drejt tyre. Izi pa nga Aleksa si për ta pyetur se ç'të bënte. Ajo mblodhi supet. Kur Etani dhe të tjerët mbërritën, djemtë që po ziheshin, ndaluan, ngritën shishet e birrës dhe u thanë "Gëzuar!". Izi i mbante sytë përdhe. Shenoni dhe Kristali e përshëndetën grupin me fjalë të ëmbla. Aleksa kapsalliti sytë. Xheki, Kimi dhe djemtë i ftuan të bashkoheshin me ta dhe u ofruan birra e verë me lëng frutash. Djemtë nisën të bisedonin për makinat dhe futbollin, ndërsa vajzat të tregonin se sa jastëkë kishin marrë me vete dhe se si do të merrnin rreze dielli të nesërmen në mëngjes. Izi nuk ia ndante sytë Aleksës, Kimit dhe Xhekit. Befas, dikush e preku te krahu dhe ajo u hodh përpjetë. Ishte Shenoni.

- Mund të bisedojmë? - e pyeti me zë të ëmbël. - Vetëm për vetëm.

Izi rrëkëlleu një gllënjkë verë dhe vështroi Aleksën, e cila ia kishte ngulur sytë dhe ishte ngrysur në fytyrë. Shenoni, buzëvarur, e shikonte Izin me trishtim.

- Për çfarë do të flasësh me të? - pyeti Aleksa me zë të lartë.

Etani i la shakatë me Finin e Dejvin dhe hodhi sytë nga vajzat për të parë se çfarë po ndodhte, pastaj u afrua, me një çehre të shqetësuar.

- Çfarë po ndodh këtu? - pyeti. Shenoni e kapi për dore, kurse Kristali tërhoqi Dejvin nga bluza dhe i tha të mos bënte zë. Njëri pas tjetrit, të gjithë heshtën. Izin e pushtoi një ndjesi e paqartë, sikur ata po bëheshin gati të kryenin një ritual në plazh dhe e flijuara do të ishte ajo.

- Në rregull, - tha Shenoni duke kapsallitur sytë. - Do të ta them këtu, në sy të të gjithëve.

- Duhet të jetë diçka shumë interesante, - mërmëriti Aleksa.

- E di që jam sjellë keq dhe kërkoj falje, - tha. - E kam seriozisht. Ky është viti i fundit i shkollës dhe dua të mbahem mend për mirë, jo për keq. Do ta nisja duke i kërkuar falje Izit, por duhet të të kërkoj falje edhe ty, Aleksa.

Aleksa qeshi.

- Vërtet mendon se është kaq e lehtë? - tha. - Ti je sjellë shumë keq jo vetëm me mua, por edhe me shumë të tjerë.

- Pse nuk e dëgjon deri në fund? - iu hakërrye Kristali.

- Po e dëgjoj, apo jo? - ia ktheu Aleksa.

- S'ka problem, Kristal, - tha Shenoni dhe befas, i kaluan disa të dridhura, fërkoi krahët dhe iu afrua Etanit. Ai hoqi xhaketën e ia hodhi supeve, kurse ajo buzëqeshi dhe e puthi në faqe. Pastaj, me mjekrën që i dridhej, i hodhi një vështrim Aleksës e Izit. Dukej si një teatër i vënë në skenë për të mirën e të gjithëve.

- E kam të vështirë ta pranoj, - tha Shenoni, - por Aleksa ka të drejtë. Jam sjellë shumë keq. Kam qenë e ligë, egoiste, e tmerrshme. I kam trajtuar njerëzit shumë keq, por jam penduar. Nuk mund të justifikohem për mënyrën se si jam sjellë.

- Pra, - tha Aleksa, dyshuese, - pasi na ke terrorizuar për vite me radhë, tani duhet të të besojmë se, krejt papritur, ke kuptuar se je sjellë keq? Ne duhet t'i kapërdijmë gjithë të ligat që na ke bërë dhe të themi: "S'ishin asgjë"?

Shenoni ia nguli sytë, kurse faqet iu bënë flakë të kuqe.

- E di që po ju kërkoj shumë, - tha. - Ama, gjithë këto vite, kam dëgjuar gjithçka që ju të gjithë keni thënë për babanë dhe nënën time, - dhe uli sytë përdhe. - E di që mendoni se në vend të zemrës kam një gur, por s'është e vërtetë. Përkundrazi, lëndohem shumë kur dëgjoj që flasin keq për familjarët e mi. Besoj se thjesht... Nuk di ç'të them. Doja të kundërpërgjigjesha dhe t'i lëndoja të tjerët. E di që kam vepruar gabim.

Izi s'e mbajti dot veten dhe tha:

- Njerëzit do të vazhdojnë të flasin. S'i ndryshon dot. Thjesht shpërfilli.

Shenoni anoi kokën dhe i buzëqeshi Izit, si një vajzë e vogël që kishte parë një qenush në dyqanin e kafshëve.

- E shikon? - tha. - E dija që Izi do të më kuptonte. Të kërkoj falje që thashë para klasës se mamaja jote është në burg. - Izi u drodh dhe ua nguli sytë shokëve dhe shoqeve të Aleksës, duke pritur se si do të reagonin.

- O Zot, fillove sërish! - tha Aleksa me zë të lartë. - Izi s'ka

shumë që është njohur me shoqërinë time dhe ti sërish volle vrer në sy të të gjithëve.

Shenoni vuri dorën mbi buzë.

- Mos! - tha. - Nuk e bëra qëllimisht! Këtë herë jo, e kam seriozisht!

Aleksa tundi kokën.

- Nuk e di, - tha. - Me sa duket, po e shfrytëzon këtë mundësi për ta turpëruar sërish Izin.

- Jo, - tha Shenoni. - Nuk doja ta vija në siklet. E kam seriozisht. Mos bëni kështu! Duhet të më jepni një mundësi. Do të më duhet pak kohë që të ndryshoj. Më vjen vërtet shumë keq, Izi!

Shenoni, e përlotur, ia nguli sytë Izit. Pranë saj, Etani po vërente birrën që kishte në dorë, rërën, Finin dhe Breshkën; gjithçka, përveç Izit. Fjalët e Shenonit, toni i zërit, qëndrimi i saj, mënyra se si i dridheshin buzët kur fliste... gjithçka dukej e vërtetë, por, Izi ishte e sigurt se i kishte parë një shkreptimë zemërimi në sy. Gjithsesi, vetëm për atë natë, vendosi të luante lojën e saj.

- S'mund të flas në emër të të gjithëve, - tha, - por jam e gatshme të të jap një mundësi tjetër. - Në të vërtetë, u ndje e çliruar. Edhe nëse Shenoni i kthehej sërish zakonit të saj të lig, kur të ktheheshin në shkollë të hënën, ndoshta për këtë natë, Izi mund të rrinte e qetë, të argëtohej e të zinte shokë e shoqe të reja.

- Seriozisht e ke? - e pyeti Aleksa Izin. - Do ta falësh kështu, si pa të keq?

- S'ka problem, Aleksa, - tha Shenoni. - E di që ty të kam trajtuar më keq se të tjerët dhe ke gjithë arsyet e kësaj bote për të mos më folur kurrë me gojë. S'je e detyruar të më falësh, nëse nuk e ndien, por, shpresoj të sillemi në mënyrë të qytetëruar me njëra-tjetrën derisa të diplomohemi.

Të gjithë ia ngulën sytë Aleksës dhe po prisnin se si do të reagonte. Izi mblodhi supet, me shpresën se ajo nuk do të ishte mërzitur me të që u dorëzua aq lehtë.

Më në fund, Aleksa kapsalliti sytë.

- Varja, - tha. - Po të jap një mundësi tjetër, sepse më kanë

ardhur në majë të hundës zënkat dhe goditjet pas shpine. Por po të paralajmëroj, mos u mundo të ma hedhësh. Nuk të fal më.

- Të premtoj, - tha Shenoni dhe drejtua për nga Aleksa, me krahët hapur, por ajo u spraps duke ngritur dorën. Shenoni ndali në vend. - S'ka gjë, - tha buzagaz. - Të kuptoj. S'kemi arritur ende në këtë pikë, - dhe zgjati verën që mbante në dorë. - A mund të ngremë një gotë për të nisur gjithçka nga e para?

- Sigurisht, - ia ktheu Aleksa dhe ngriti menjëherë gotën.

Pasi të gjithë e kishin rrëkëllyer nga një pije, Shenoni tha:

- Tenda jonë është atje, pranë korijes me mështekna. Pasi të jeni sistemuar, na bëni një vizitë.

- Me të parë me të bërë, - ia ktheu Aleksa.

Shenoni pa Izin.

- Dëshiron të rrish pak me ne? - e pyeti.

Izi mblodhi supet.

- Mirë, - tha.

- Mrekulli! - tha Shenoni duke buzëqeshur. - Xhoshi ka sjellë fishekzjarrë. Do të të presim ty dhe pastaj do t'i hedhim. - Ajo puthi Etanin dhe e shtyu tutje: re të vogla rëre ngriheshin nga pantoflat me gisht teksa nxitonte drejt zjarrit të madh. Kur ishte në gjysmë të rrugës, ngriti gotën në ajër dhe thirri: - Le të fillojë festa!

Fini dhe djemtë iu përveshën sërish punës për të ngritur tendat, ndërsa Xheki dhe Kimi po rregullonin karriget dhe batanijet. Izi ishte ulur në gjunjë në rërë për të ndihmuar Aleksën me tendën e tyre.

- Ç'dreqin ishte gjithë ajo skenë? - pyeti me zë të ulët, që të tjerët të mos e dëgjonin.

- S'e kam idenë, - tha Aleksa. - Besoj se e di atë fjalën e urtë "Mbaji afër miqtë, por armiqtë edhe më afër".

- Mendon se ajo po bën pikërisht këtë? - pyeti Izi.

- Më shumë gjasa po, - ia ktheu ajo, - prandaj bëji sytë katër.

- Unë? - tha Izi. - Pse?

- Sepse, shoqja ime e padjallëzuar, është hera e parë që Shenoni i kërkon falje dikujt. S'e ka bërë kurrë më parë. Besoj se ndihet e kërcënuar prej teje. Në këto çaste, duhet të jetë duke ngrënë veten me dhëmbë.

Izit iu mblodh një lëmsh në stomak. Kishte shpresuar se pendimi i Shenonit kishte qenë i sinqertë dhe do të niste një jetë të re. Izi duhej ta dinte mirë që asgjë nuk ishte aq e thjeshtë.

Kur ra mesnata, gjysma e nxënësve të vitit të katërt ishin kapitur në rërë, në tendat e tyre ose ishin ulur e po bisedonin për politikën dhe fenë, duke folur me zë të lartë, me fjalët që u dilnin gjysmake. Aleksa, Izi, Xheki dhe nja dymbëdhjetë të tjerë, përfshirë Shenonin dhe Etanin, ishin ulur mbi disa drurë të sjellë nga lumi, rreth zjarrit që gati po shuhej. Izi ngacmonte prushin me fundin e një shkopi të gjatë, duke thyer pjesët e shkrumbuara dhe copat e trungjeve që po digjeshin, ndërsa Aleksa dhe Fini ishin përfshirë në një debat të zjarrtë për ngrohjen globale. Mbrëmja kishte kaluar më mirë nga sa e kishte imagjinuar Izi. Kishte qeshur dhe ishte ndier e qetë; kishte hedhur fishekzjarrë te zjarri i madh dhe kishte parë disa nga djemtë e vajzat që bënin si pula në breg të liqenit. U bë gati t'i thoshte Aleksës se do të shkonte të shtrihej në tendë, kur Xhoshi u ngrit, i erdhi rrotull zjarrit dhe u nis drejt saj. Habitej ende se si një djalë aq trupmadh kishte një zë aq të hollë. Ai ishte mbrojtës i famshëm në një skuadër futbolli dhe, teksa po e imagjinonte duke brohoritur "Forca, skuadër! Në fushë!", s'e mbajti dot veten, por nisi të qeshte nën zë.

- Ke nevojë për shoqëri? - e pyeti ai duke e parë në sy. Ishte këmbëzbathur dhe i zhveshur nga mesi e lart, duke nxjerrë në pah kraharorin e gjerë, të mbuluar nga qime të kuqërremta.

Izi mërmëriti diçka nëpër dhëmbë.

- Në fakt, po bëhesha gati të largohesha, - ia ktheu.

Ai bëri sikur nuk e dëgjoi dhe u ul këmbëkryq si bretkosë, mbi një trung pranë saj. Kofsha e tij preku të sajën dhe ajo bëri më tutje.

- Të pëlqen të jetosh në bregun e bukur të liqenit Seneka? - e pyeti.

Izi nuk ia shqiste sytë thëngjillit që digjej.

- S'është keq.

- Jam i sigurt se, tani që u pajtove me Shenonin, do ta kesh më të lehtë.

Ajo e vështroi. Në sy kishte një shikim të pajetë dhe fytyra i ishte skuqur nga dielli dhe alkooli i tepërt, por nuk dukej i dehur.

Izi imagjinonte se ai mund të pinte një arkë me birra e të mos ndiente asgjë.

- Të shpresojmë, - tha. - Sa kohë ke që e njeh Shenonin?

Xhoshi rrudhi vetullat dhe një pasiguri iu ndeh në fytyrë. Më pas, çoroditja aq e pati dhe buzëqeshi.

- Oh, ne njihemi prej kohësh, - tha. - Kemi qenë shokë të ngushtë që në kopsht. Putheshim pas pianos.

- E di Etani që t'i paske bërë gilivili me të dashurën e tij? - pyeti Izi. Ishte një përpjekje e kotë për të bërë paksa gallatë, por asaj s'po i vinte ndër mend asgjë tjetër. Ndoshta donte të mësonte diçka më shumë lidhur me Etanin dhe Shenonin.

Xhoshi mohoi me dorë.

- Etanin e kam shok. Ai e di që unë dhe Shenoni kemi qenë dikur miq të ngushtë.

- Keni qenë dikur?

Xhoshi shtrembëroi buzët e trasha, sikur po i mendonte edhe një herë ato që sapo kishte thënë.

- Ajo është lidhur me Etanin tani. Ai është shoku i saj më i mirë, megjithatë ne jemi ende miq.

- Oh, - psherëtiu Izi. Befas, ndjeu krahun e rëndë të Xhoshit t'i peshonte mbi supe. Era e rëndë e djersës dhe e birrës i shpoi hundët.

- Ndoshta ne të dy mund të bëhemi miq të ngushtë, - tha.

- Ëm, - tha Izi dhe ia hoqi krahun e u ngrit më këmbë. - Po shkoj të shtrihem.

Xhoshi e kapi nga krahu dhe dora gjigante gjithë djersë e mbërtheu si një darë e butë rreth kyçit të dorës.

- Ulu, - tha duke e tërhequr. - Mund të flasim për disa minuta? Të njihemi pak më mirë?

Ajo u spraps.

- Më fal! -tha. - Jam e lodhur dhe po shkoj të shtrihem.

Në atë çast, Dejvi u ngrit, shkoi drejt makinës dhe fiku magnetofonin.

- Dëgjoni! - thirri dhe u afrua sërish pranë zjarrit që dalëngadalë po shuhej. - Ka rënë mesnata! E dini se ç'do të thotë kjo?

Xhoshi u ngrit në këmbë dhe tundi grushtin në ajër.

- Po! - ulëriti. - Le ta bëjmë! - Nja dymbëdhjetë adoleshentë

të tjerë brofën në këmbë dhe rrëmbyen elektrikët e birrat e nisën të flisnin gjithë entuziazëm. Në anën tjetër të zjarrit që po shuhej, Etani u ngrit në këmbë dhe kontrolloi elektrikun e dorës. Shenoni dhe Kristali veshën pulovrat me kapuç dhe po prisnin buzagaz e të emocionuara. Këmbët nuk po u zinin vend nga padurimi.

- Ç'do të bëjmë? - pyeti Izi.

- Një shëtitje në godinën "Uillard", - tha Xhoshi dhe e rrëkëlleu me fund birrën që i kishte mbetur dhe e hodhi shishen në prush. - Eja! Kam marrë elektrik rezervë.

Izit nisi t'i pështjellohej stomaku. Fini dhe Aleksa, që ndodheshin pranë saj, hoqën batanijen me të cilën ishin mbuluar, dhe u ngritën në këmbë.

- Ti s'do të shkosh, apo jo? - e pyeti Izi Aleksën.

- Që ç'ke me të - ia ktheu ajo me sytë që i shndrisnin. - Më pëlqejnë fantazmat, seancat e spiritizmit dhe gjërat e këtij lloji. Do të jetë fantastike! Dikur, shkonim përgjatë bregdetit për të arritur në Uillard dhe për t'u futur brenda hangarit të vjetër të varkave. Të ngjethej mishi, por ne, gjithsesi, nuk pamë gjë. Tani mund t'i eksplorojmë të gjitha godinat.

- Bëfshi qejf! - tha Izi. - Unë do të qëndroj këtu dhe do të fle.

- Mos bëj kështu, - tha Aleksa. - Mos na e prish! Është vetëm dy kilometra e gjysmë larg më këmbë.

- Nuk kam frikë të eci më këmbë, - tha Izi.

Aleksa mënjanoi kokën.

- Eja! Nëse ndodh ndonjë gjë e pazakontë, do të kthehemi. Të jap fjalën.

- Nëse s'ka qejf të vijë, - tha Xhoshi, - nuk mund ta detyrojmë. Do të qëndroj unë t'i bëj shoqëri, - dhe ia hodhi sërish krahun Izit dhe e afroi pas vetes. Trupi i tij ishte gjithë djersë. Izi ia hoqi gishtat nga krahu dhe arriti të shkëputej prej tij.

- Tani që po e mendoj, - i tha Aleksës, - ndoshta ecja do të më bëjë mirë.

Të gjithë mbathën këpucët dhe veshën bluzat. Nxënësit e vitit të katërt nisën të ecnin përgjatë bregdetit, me elektrikët në dorë, drita e të cilëve ndriçonte shkëmbinjtë, qiellin, rërën dhe pyllin. Hëna pasqyrohej në sipërfaqen e liqenit dhe uji merrte një shkëlqim kaltërosh të botës së përtejme. Luka dhe

Xhoshi udhëhiqnin dhe gjenin rrugët më të lehta, rreth pemëve të përmbysura dhe gurëve në madhësinë e një makine. Në zonat moçalore, mbanin në kurriz disa nga vajzat, që të mos u lageshin këmbët. Kur në sfond u duk doku dhe hangari i barkave të Uillardit, Luka ndaloi dhe u kthye nga të tjerët.

- Le të ndahemi në grupe, - tha. - Kështu, mund të kontrollojmë një sipërfaqe më të madhe. Nëse dikush shikon apo gjen diçka, do të mblidhemi dhe do ta shohim të gjithë bashkë. Disa nga miqtë e mi shkuan te tunelet poshtë *Chapin Hall*-it dhe gjetën morgun. Pranë morgut, panë dikë që dukej si grua.

Kristali dhe një nga shoqet e saj klithën dhe përqafuan njëratjetrën, pastaj filluan të qeshnin nën hundë. Luka ngriti dorën për t'i qetësuar.

- Fytyra e gruas ishte e fryrë dhe e nxirë, - tha. - Sikur të kishte qëndruar për një kohë të gjatë nën ujë apo t'i kishte ndodhur diçka tjetër. Ajo hapi gojën sikur donte të ulërinte dhe, më pas, u zhduk nga faqja e dheut.

- O Zot i madh! - thirri një nga vajzat.

- Mos bëni zhurmë! - u dëgjua zëri i dikujt.

- Në bodrumin e *Chapin Hall*-it mjekët bënin terapi me elektroshok, - tha Luka. - Në vitet '40, vërshoi uji dhe shumë pacientë u mbytën. Më duket se ishin nja pesëdhjetë vetë. Mendojmë se ajo gruaja ishte njëra prej tyre.

- Gjepura! - ia priti një nga djemtë.

- Më thuaj si do të përfundojë kjo histori, - i tha Xheki Aleksës. - Unë po largohem.

- Mos bëj kështu! - tha Aleksa. - E gjitha kjo bëhet vetëm për t'u argëtuar.

Xheki tundi kokën.

- Nuk mund ta përballoj.

- Po vij edhe unë me ty, - tha Izi.

- S'mund të më lini vetëm! - u tha Aleksa. - Mos ik, Izi! Të lutem! Rri me mua.

Izi lëshoi një ofshamë.

- Mirë, - tha. Ndoshta mund të gjente të dhëna të tjera për Klarën dhe vajzën e saj.

- Nëse ndokush dëshiron të kthehet, - tha Xhoshi, - është i lirë të shkojë. Ne të tjerët do të vazhdojmë rrugën. Le ta çojmë deri në fund këtë që kemi nisur. Unë, Brajani, Poli dhe Etani do të jemi drejtuesit e grupeve. Një grup do të shkojë te pavijonet, një te morgu, që ndodhet në pjesën e poshtme të *Chapin Hall*-it dhe tjetri në qendrën "Ruki Pest". Luk dhe Dejv, si thoni, kontrollojmë morgun ne?

- Dakord, - tha Dejvi, i hodhi krahun Kristalit, e cila po qeshte dhe tundi kokën në shenjë pohimi.

- Edhe unë jam dakord, - tha Luka.

- Shkëlqyeshëm! - ia priti Xhoshi dhe vështroi Aleksën e Izin. - Po ju, vajza, keni qejf të vini me grupin tonë?

Aleksa ia nguli sytë Izit.

- Do të jetë fantastike të kontrollojmë morgun, - i tha ajo.

Izi mblodhi supet.

- Për mua, s'ka rëndësi se në cilin grup do të jem, - tha.

- Po, edhe ne do të vijmë me grupin tënd, - i tha Aleksa Xhoshit.

- Grupi im u plotësua, - njoftoi Xhoshi.

Izi shtrëngoi nofullat. Të futeshe në Uillard gjatë ditës, ishte diçka e pakëndshme, por, të futeshe në morg, në pjesën e poshtme të *Chapin Hall*-it gjatë natës, ishte akoma edhe më keq e, mbi të gjitha, me disa nga shokët e shoqet e Shenonit. Kjo ishte një ide e keqe. Por si të vepronte? Nëse kthehej mbrapsht, Xhoshi me siguri do t'i shkonte pas. Nuk donte të pranonte që kishte frikë, sepse, në fund të fundit, ishin shumë vetë. Ndoshta ishte më mirë ta çonte deri në fund këtë që kishte nisur.

- Fikini elektrikët derisa t'u afrohemi godinave, - tha Xhoshi.

Ata nisën të ecnin me mundim përgjatë shpatit me bar drejt godinave të shkatërruara të spitalit "Uillard". Drita e hënës dhe hijet kishin mbuluar anembanë hapësirën e pamasë të tij. Kur mbërritën në *Chapin Hall*, të gjithë ndalën dhe shikonin gjithë habi, duke ndriçuar me elektrikët e dorës dritaret me hekura dhe papafingot e errëta. Natën, godina gjigante e stilit viktorian dukej dhjetëfish më e frikshme. Izit i hyri frika dhe i ngriu zemra. Si dreqin erdhi sërish këtu, për të tretën herë, dhe për më tepër, si kishte ndër mend të futej në morg pas mesnate?

- O Zot i madh! - tha Kristali. - Kjo është godina më e llahtarshme që më kanë zënë sytë.

- Vë bast se morgu do të na kallë datën, - tha Aleksa duke qeshur.

Kristali i shtrëngoi dorën Dejvit.

- Sa e shpifur! - tha duke kërcyer sa mbi njërën këmbë në tjetrën. - Kam shumë frikë. Më duket sikur do t'i mbush pantallonat!

Grupet u shpërndanë në rrugën e shkatërruar dhe plot puseta përballë *Chapin Hall*-it. Grupi i Etanit u nis drejt pavijoneve të pacientëve, grupi i Brajanit u drejtua për nga qendra "Ruki Pest", grupi i Polit shkoi për te *Hadley Hall*, ndërsa grupi i Xhoshit u nis drejt morgut.

Xhoshi e udhëhoqi grupin nëpër pavijonet në pjesën e pasme të *Chapin Hall*-it. Godinat dykatëshe me tulla zgjateshin për blloqe të tëra, me shtesa të pafundme, çatitë e të cilave formonin një mishmash që të jepte përshtypjen se ishin bërë në çastin e fundit. Pirgje gjethesh të rëna kishin mbuluar qoshet e ndërtesës dhe fole të vjetra zogjsh vareshin në strehët e çative të larta.

Prapa *Chapin Hall*-it, Xhoshi ndaloi në fund të një shkalle të ndryshkur sigurimi. Ashtu si shkallët e sigurimit në pavijonet e pacientëve, dalja dhe shkallët e katit të dytë, që të nxirrnin përjashta, ishin brenda një kafazi me tela. Izit nuk i kishte rënë në sy më parë, por në fund të shkallëve ishte një kafaz tjetër i madh, me një derë me tela, që mund të mbante dymbëdhjetë a më shumë persona. Dera e tij ishte e kyçur nga jashtë. Në rast zjarri, njerëzit e mbyllur në të duhej të dilnin që atje dhe të zbrisnin nga shkallët, por kjo nuk mund të ndodhte, sepse dera ishte e kyçur. U drodh e tëra kur kuptoi se kjo ishte një masë parandaluese që ata të mos ia mbathnin.

Xhoshi ia dha elektrikun Izit dhe i tha të ndriçonte kafazin në fund të shkallëve të sigurimit. Gardhi me tela ishte çarë vertikalisht në një vend.

- Këtu u futën shokët e mi, - tha ai.

Futi gishtat e tij të mëdhenj në vrimat në formë rombi të gardhit me tela, i hapi dhe u zvarrit brenda. Të gjithë i shkuan pas, përveç Izit. Luka, Dejvi dhe Kristali ngjitën me vrap shkallët e hekurit për në katin e dytë, ndërsa Aleksa priti Izin. Teksa vraponin, hapat e

tyre kërcisnin mbi metalin e ftohtë. Xhoshi u ul në gjunjë brenda kafazit dhe zgjati dorën për ta ndihmuar Izin të ngjitej, por ajo nuk ia vuri veshin dhe u zvarrit këmbadoras brenda.

Dejvi drejtoi elektrikun nga dalja, në majë të shkallëve të sigurimit. Pjesa e sipërme e derës ishte e mbyllur me kompensatë.

- Si do të futemi brenda? - pyeti.

- Prisni! - tha Xhoshi. - Merrem unë me këtë!

Aleksa dhe Izi po prisnin në fund të shkallëve, ndërsa Xhoshi nxitoi të ngjitej. E mbërtheu fundin e kompensatës dhe e shkuli. Prapa saj, fshihej një dritare pa xhama.

- Këtu nuk e nxë prapanicën tënde të madhe, - tha Dejvi duke qeshur.

- E vëmë me bast? - ia ktheu Xhoshi. U kthye anash dhe futi pjesën e sipërme të trupit mes së çarës, me këmbët që i fluturonin në ajër. Dejvi qeshte, sepse mendonte se Xhoshi kishte ngecur. Pastaj, legeni dhe këmbët u zhdukën dhe u dëgjua një zhurmë e fortë. Më pas, s'pipëtiu asgjë.

Dejvi lëvizi pranë derës dhe ndriçoi me elektrik dritaren.

- Je mirë, trashaluq? - pyeti duke qeshur mbyturazi.

Në atë çast, Xhoshi u ngrit në këmbë, me fytyrën e shtrembëruar, kurse duart i tundte në ajër.

- Më nxirrni prej këtej! - ulëriti. Të gjithë u hodhën përpjetë.

Dejvi u zvarrit këmbadoras drejt së çarës, flakë i kuq në fytyrë dhe me flegrat e hundës që i lëviznin.

- Do të të vras me duart e mia! - tha duke u futur brenda.

Të gjithë u zvarritën një nga një përmes së çarës. Pasi ishin futur të gjithë, Dejvi dhe Xhoshi po i udhëhiqnin përmes një korridori, duke ecur ngadalë, me elektrikët në dorë që ndriçonin muret dhe dyshemenë. Të tjerët u shkonin pas. Leskërat e bojës dhe copat e allçisë u kërcisnin nën këmbë. Tavanet ishin shumë të larta dhe atyre u dukej sikur nuk kishin asgjë mbi kokë, sikur çatia ishte zhdukur dhe kishte një hapësirë të errët e të zymtë. Leskërat e bojës ngjyrë gri në të gjelbër vareshin nga muret, si krustacet që kacavirren pas mbetjeve të anijeve nën ujë. Dyshemeja ishte mbuluar me letra të mykura, ibrikë plastikë dhe copa kartonësh. Tingulli i piklave të ujit jehonte përgjatë korridorit.

Izi ia ngulte sytë të gjitha dyerve të mbyllura, duke shpresuar

të gjente një sallë ku arkivoheshin dosjet apo kartelat, dhe përpiqej ta shpërfillte idenë se dyert hapeshin ngadalë kur ajo i linte pas. Aleksa ecte përkrah saj; me njërën dorë kishte mbërthyer fort, si morsetë, bërrylin e Izit. Përpara, në fund të korridorit, një derë e lartë me një hark përsipër të çonte drejt një humnere të errët.

- O Zot i madh! - thirri Kristali. - Çfarë është ajo?

Të gjithë ndaluan.

- Çfarë? - pyeti Xhoshi dhe ktheu kokën.

- Atje! - tha Kristali dhe bëri me gisht drejt fundit të korridorit.

Xhoshi drejtoi elektrikun. Në anën tjetër të korridorit, një karrige dhe diçka që dukej si pjesë e një rrote, ishin anuar nga njëra anë si një xhuxh i shtrembër.

- Është thjesht një karrige me rrota, - tha Aleksa.

- O Zot! - ia behu Dejvi. - Mos e përsërit më këtë!

Kristali mori frymë lirshëm.

- Më falni! - tha.

Filluan sërish të ecnin. Pastaj, Dejvi dhe Xhoshi ndalën.

- Çfarë ka? - pyeti Luka. - Pse ndaluam?

- Seç dëgjova, - u përgjigj Dejvi.

- Edhe unë, - tha Xhoshi.

- Çfarë ishte? - pyeti Kristali.

- Nuk e di, - ia ktheu Dejvi. - M'u duk se në dhomën tjetër diç lëvizi. Si fëshfërimë a diçka e ngjashme.

- Dhoma tjetër nuk ka derë, - tha Dejvi.

- Po pastaj? - ia ktheu Aleksa.

- Shko ti e para, - tha Xhoshi dhe ndriçoi me elektrik hyrjen e errët e të zbrazët në të majtë të tij.

Aleksa rrëmbeu elektrikun, mori frymë thellë dhe u nis drejt hyrjes, duke ndriçuar binarin e dhomës.

- Sa e shpifur! - tha dhe hyri brenda. Të gjithë i shkuan pas.

Drita e hënës depërtonte përmes dritareve të pista me hekura dhe hije të gjata shtriheshin mbi dyshemenë me pllaka. Copa gjigante të suvasë vareshin nga tavani, në të cilin kishte dalë suvaja e vjetër dhe ishin formuar shtresa të trasha myku të zi. Poshtë dritareve, përmes vrimave të mbuluara nga pluhuri dhe kompensatat, dukeshin tullat e jashtme. Në mes të dhomës, një shtyllë e trashë metalike kishte çarë dyshemenë dhe kishte

dalë lart, kurse një shufër e përdredhur zgjatej nga njëra anë në formën e "S"-së. Në fund të shufrës së përdredhur, një ndenjëse plastike blu dhe një tokëz vareshin në ajër si shilarës. Teksa mendonte për qindra shpirtrat e torturuar, që ishin ulur në atë karrige dhe kushedi ç'kishin hequr nga ato që mund t'u kishin bërë, Izit iu pështjellua stomaku. Në të majtë, në një faqe muri të lyer me vernik, të zinte syri tubacione të ndryshkura dhe nja gjashtë vaska porcelani, të rrethuara me struktura metalike dhe të gjitha, përveç njërës, të mbuluara me një cohë të pistë e të grisur. Coha ishte kapur me perçina te struktura metalike dhe në të ishte krijuar edhe një çarje, e cila ngjante si një gojë e shqyer, ku duhej të dilte koka e pacientit e kthyer në një anë. Izi u rrëqeth. Duhej të kishte ngulur këmbë e të mos kishte ardhur këtu.

- Ç'dreqin është kjo? - tha Luka dhe u ul në ndenjësen plastike ngjitur pas shtyllës. U mëshoi këmbëve në dysheme dhe ndenjësja nisi të rrotullohej.

- S'e kam idenë, - tha Aleksa, - por këto vaska përdoreshin për banjat me ujë akull të ftohtë. Pacientët i zhysnin në ujin e akullt dhe i linin aty derisa humbnin ndjenjat.

- Mjaft me këto, - tha Xhoshi. - Kujtova se erdhëm deri këtu për të gjetur morgun.

- Po, - ia priti Dejvi. - Shkojmë.

Izi ndoqi grupin kur doli nga dera, e çliruar që po e linin pas dhomën e mërzitshme. Në fund të korridorit, morën kthesën djathtas dhe çanë përmes karrigeve me rrota, karrocave që lëkundeshin, arkave prej druri ku ishte shkruar "Spitali Uillard", dyshekëve tërë njolla e të pistë dhe barelave të ndryshkura me rrota. Më në fund, arritën në majë të një shkalle. Izi tërhoqi mëngën e bluzës dhe mbuloi dorën, mbërtheu parmakun dhe ndoqi Aleksën teksa zbriste shkallët. Nuk donte ta prekte parmakun, por më mirë të kapej pas tij, sesa të rrëzohej, të rrokullisej deri në fund të shkallëve e të përplasej kushedi ku.

Në korridoret e katit të parë, ishin hedhur kuturu karrige të shkatërruara me rrota, tavolina të vogla, ndenjëse me rripa dhe me rrota të veshura me vinil. Nëpër dyer, shkruhej: pavijoni i krizave kronike, pavijoni i krizave akute, pavijoni i epilepsisë,

pavijoni i të sëmurëve dhe i paralitikëve. Sa më thellë që hynin në labirintin e korridoreve, aq më shumë dhoma ishin pa dyer. Izi e drejtoi elektrikun për nga hyrjet e errëta, duke ndriçuar shtretërit metalikë, kutitë gjithë myk, kontejnerët plastikë me ndërresa, karrocat mbi të cilat ishin vënë pirg pajisjet e EKG-së dhe tavolinat e vizitave me hekura. Izi u hidhte një sy të shpejtë hapësirave plot mbeturina se mos dallonte ndonjë raft dosjesh, por nuk i zuri syri asgjë. Pyeste veten nëse Klara e kishte sjellë në jetë vajzën në një nga këto dhoma. Duhej të kishte qenë e tmerrshme të lindje një foshnjë të vogël e të pafajshme në këtë vend të llahtarshëm.

Ata gjetën më në fund një tabelë ku shkruhej "Bodrumi", me një shigjetë të drejtuar nga krahu i djathtë. Ecën përgjatë një korridori të shkurtër derisa mbërritën te një ashensor shërbimi dhe para një dere të madhe me një tabelë të gjelbër ku shkruhej "Morgu". Xhoshi hapi dyert. Një rrymë e ftohtë ajri iu përplas në fytyrë dhe më pas u përhap edhe nëpër shkallë. Izi, Luka dhe Aleksa i shkuan pas. Të fundit ishin Dejvi dhe Kristali. Kur mbërritën, ndaluan. Izi u kapërdi.

Në të gjitha drejtimet, majtas, djathtas dhe përpara, kishte një sërë tunelesh të gjata çimentoje. Tuba të madhësive të ndryshme që pikonin, shtriheshin përgjatë gjithë gjatësisë së tavaneve, pranë kanaleve metalike ku dikur kalonin telat elektrikë. Në çdo tridhjetë metra, të gjitha korridoret ishin me një hyrje me hark sipër, prandaj tunelet dukeshin si korridore poshtë një kështjelle mesjetare. Izit iu duk sikur po qëndronte mes dy pasqyrave, sepse pasqyrimi i hyrjes me hark reflektohej mijëra herë në çdo drejtim. Ajo imagjinoi sikur kishte humbur dhe nuk po e gjente dot rrugën për të dalë. Në hyrjen përballë, mbi hark, ishte një tabelë ku shkruhej "Trajtimi me elektroshok". Në hyrjen në të majtë, ishte varur një tabelë tjetër ku shkruhej "Morgu". Në të djathtë të shkallëve, ishte një ashensor shërbimi që rrinte i hapur, kurse skara e ndryshkur prej tunxhi ishte pjesërisht e mbyllur. Një shtrat spitali me një rrotë të thyer dhe një çarçaf të shqyer e të pistë ishte mbështetur pas murit të ashensorit.

- Ndoshta me këtë i sillnin trupat këtu poshtë, - tha Aleksa.

- Ëhë, - ia priti Kristali.

Xhoshi nisi të ecte nëpër korridor drejt morgut. Trupi i madh thuajse e bllokonte fare dritën e elektrikut, që ndriçonte përgjatë korridorit.

- Këtej, - tha. Dejvi dhe Kristali e ndiqnin nga pas.

- Prit! - tha Aleksa. - Ta kontrollojmë një herë sallën ku bënin trajtimet me elektroshok.

Xhoshi ndaloi dhe u kthye pas.

- Nuk ka asgjë aty poshtë, - u përgjigj.

- Ejani tani! - tha Dejvi. - Do të shkojmë në morg. - Dukej i inatosur. Izi pyeste veten se pse e kishte me kaq ngut. Ndoshta sillej si i zemëruar për të fshehur frikën.

- Unë po shkoj të hedh një sy, - tha Aleksa.

Xhoshi mërmëriti nëpër dhëmbë dhe u nis rëndë-rëndë drejt tyre e iu bashkua grupit pa shumë qejf.

- Le të mbarojmë punë shpejt e shpejt, - tha.

Në të majtë të tunelit, pas harkut të katërt, gjetën sallën e trajtimeve me elektroshok. Hapësira me tavanin e ulët ishte e mbushur plot me tavolina vizitash, karroca të ndryshkura dhe kuti metalike që dukeshin si bateri gjigante, me disqe të zeza dhe tela të dalë nga të katër anët. Në fund të sallës, në mur, qëndronin raftet e barnave me sirtarët gjysmë të hapur, ku dukeshin bobinat me tela, protezat mbrojtëse plastike dhe ato që ngjanin si telekomandat e një videoloje. Izi ecte përgjatë mureve, duke kërkuar rafte me dosje apo gjithçka tjetër që mund të kishte dokumente, por nuk pa asgjë.

- Duhet t'u kenë bërë elektroshok shumë personave njëherësh, - tha Dejvi. - Si një kope bagëtie që e damkosin.

- Ashtu duket, - tha Aleksa. - The se këtu vërshoi uji dhe vdiqën njerëz?

- Po, - tha Xhoshi teksa rrëmonte në një sirtar. U kthye për ta parë dhe ia drejtoi dritën e elektrikut në fytyrë.

Aleksa ngriti dorën për të mbuluar sytë.

- Shoku, - tha, - po më verbon!

Drita e elektrikut u shua.

- Më fal! - tha Xhoshi.

- Sa e shpifur! - tha Kristali.

- Pyes veten nëse kanë bërë edhe lobotomi këtu, - tha Aleksa.

- Ju lutem, - tha Dejvi. - Ne duhej të eksploronim morgun dhe jo ta çonim dëm kohën këtu.

- Po, - tha Izi, që i dukej se po i përzihej. - Largohemi prej këtej.

Vijuan rrugën drejt morgut. Ajri bëhej gjithnjë e më i lagësht e i ftohtë. Izi futi duart në xhepat e pulovrit dhe vuri kapuçin. Përkrah saj, Kristali godiste fort me dorë hapësirën boshe mbi kokë, e tmerruar se mos ndonjë rrjetë merimange i ngecte nëpër flokë ose i ngjitej në fytyrë. Xhoshi ndaloi pa lajmëruar dhe ndriçoi me elektrik një derë të hapur në të majtë të tij. Dejvi vazhdoi të ecte, pastaj ndaloi dhe u kthye.

- Eja, - tha. - Thuajse arritëm.

Xhoshi mori për nga dera e hapur.

- Ç'dreqin është kjo? - tha gjithë neveri.

Dejvi iu bashkua atij.

- Dreqi ta hajë! - tha dhe të dy u zhdukën brenda dhomës. Të tjerët i ndoqën.

Në muret e dhomës së gurtë, ishin vendosur kafaze hekuri me metal pesë centimetra të trashë. Shufrat ishin ngjitur kryq, si një thurje e lirë shporte. Brenda kafazeve, krevate metalike ishin ngulur me bulona në dysheme, ndërsa nga muret vareshin zinxhirë dhe pranga.

- Ç'është ky vend? - pyeti Kristali.

- Në këto kafaze mbanin njerëz, - tha Xhoshi dhe qeshi me nervozizëm.

- Ndoshta këtu mbaheshin pacientët e dhunshëm, - tha Aleksa.

- Ose ndoshta mbanin pacientët e sëmurë me tuberkuloz dhe tifo, - tha Izi.

- Sa e frikshme! - tha Aleksa. - S'është çudi që Uillardi përndiqet nga fantazmat.

- Të shkojmë në morg e ta mbarojmë këtë që kemi nisur? - tha Izi duke u munduar të fliste qetë.

- Patjetër, - tha Xhoshi. - Shkojmë. Mund të vijmë këtu një herë tjetër.

Grupi doli nga dhoma dhe mori majtas. Më në fund, panë një derë të madhe, në të cilën ishte varur një tabelë e venitur ku

shkruhej me shkronja të gjelbra "Morgu". Në fund të një tuneli, panë një hyrje tjetër, me dritare të thyera në pjesën e sipërme të dyerve dyshe. Drita e dobët e hënës kaltëronte nëpërmjet xhamit të mbuluar nga pisllëku. Afër dyerve, njëri mbi tjetrin, gjendeshin qivure të bëra vetë që arrinin deri në tavan, si një pirg librash të stërmëdhenj.

- O Zot i madh! - tha Kristali. - Sa e frikshme!

Kaluan derën e madhe dhe hynë në morg, duke ecur ngadalë, si t'i priste diçka nga ana tjetër. Dejvi dhe Xhoshi ndriçuan me elektrikë dhomën. Në fund të saj, ngulur në mur, gjendej një lavaman i thellë, banaku prej porcelani i të cilit ishte mbushur me gota të verdha plastike dhe shishe të holla. Dyshemeja e çimentos ishte mbushur me kosha mbeturinash dhe kuti të mykura; pak më tej, një karrocë me pajisje nekropsie dhe disa karrige portative të thyera. Nga tavani i leskëruar, vareshin mbi tavolinën e çeliktë të autopsisë abazhurët. Në të dyja anët e tavolinës që ndodhej aty nga mesi i morgut, kishte vrima katrore, ndërsa në njërën anë ndodhej një legen i vogël me një zorrë të zezë. Pranë tavolinës, ndodhej një vaskë me rrota dhe një zorrë llastiku. Në pjesën metalike ishte shkruar "lëng balsamimi".

Në qoshen e largët të dhomës, një kube e drunjtë për ruajtjen e trupave, me gjashtë dyer, menteshat dhe dorezat e së cilës ishin ndryshkur dhe nxirë, zinte thuajse çerekun e dhomës. Pranë kubesë, ndodhej një motor i zi i prishur, i cili kish furnizuar me energji dhomën frigoriferike. Në dy dyert e sipërme të kubesë, në dërrasat e së cilës pasqyrohej drita e elektrikëve, nuk kishte njolla. Katër dyert e poshtme ishin tërë njolla e vija me atë që dukej si katran i zi, sikur diçka brenda dyerve të sipërme të ishte prishur, të ishte shkrirë e të kishte rrjedhur poshtë. Ndihej një aromë e lehtë formaldehidi, myku dhe diçkaje tjetër që vinte erë si metal i shkrirë.

Izi mbuloi gojën me dorë dhe e përmbajti veten para se t'ia mbathte me vrap nga dhoma e të dilte përjashta, në ajrin e pastër. Në një qoshe, i zunë sytë një raft me dy sirtarë. Nxitoi drejt tij, hapi sirtarin e sipërm dhe ndriçoi me elektrik. Një grumbull dosjesh u rrëzuan në pjesën e pasme të sirtarit, që kishte zënë një shtresë të trashë pluhuri dhe rrjetash merimange. Aleksa u afrua për të parë se ç'po bënte.

- Çfarë janë këto? - pyeti. - Çfarë gjete?

Izi i dha elektrikun.

- Mbaje këtë, - tha. Aleksa e drejtoi dritën brenda raftit, ndërkohë, Izi po rrëmonte mes dosjeve me zemër të ngrirë. Të gjitha ishin bosh. Hapi sirtarin e fundit dhe gjeti një grumbull letrash të verdha të hedhura kuturu. Mori në dorë njërën prej tyre dhe ia rrëmbeu elektrikun Aleksës. Ishte një certifikatë vdekjeje e paplotësuar e shtetit të Nju Jorkut.

- Çfarë po kërkon? - pyeti Aleksa.

- Në muze po punojmë për projektin "Uillard", - u përgjigj Izi. - Po shikoj nëse mund të gjej diçka që mund të na hyjë në punë.

- E si do t'ia shpjegosh këtë nënës kujdestare? - tha Aleksa.

- Më vonë do të shqetësohem për këtë, - ia ktheu Izi.

Atë çast, u shfaq Kristali.

- Eja, - tha, e kapi Aleksën për krahu dhe e tërhoqi përpara, drejt tavolinës së autopsisë. - Të shikojmë nëse do të na shfaqet sërish ajo gruaja. Mblidhuni të gjithë në rreth të pyesim nëse është këtu.

Izi kontrolloi edhe letrat e tjera. Në gjithë atë pirg nuk kishte asgjë, veçse certifikata të paplotësuara vdekjeje.

- Nxito! - tha Aleksa.

Izi kapsalliti sytë dhe mbylli raftin.

- Mblidhuni të gjithë këtu, - tha Kristali. - Do të bëjmë një seancë spiritizmi.

- Fantastike! - tha Dejvi dhe zuri vend përkrah Kristalit. - Ide e mirë, vogëlushe!

Luka hoqi një kuti të lagur kartoni nga tavolina e autopsisë dhe tha:

- Ej, Xhosh, eja këtu dhe shtrihu mbi këtë. Do të të bëjmë një masazh që s'ke për ta harruar kurrë.

Xhoshi qeshi dhe shkoi drejt kubesë ku dikur mbaheshin trupat. Hapi një nga dyert e mesit dhe e ndriçoi me elektrik. Pjesa e brendshme e kubesë ishte me gropëza dhe myk.

- Unë do të shtrihem mbi atë, - tha, - nëse ti do të shtrihesh këtu, - dhe nxori një pllakë të madhe të ndryshkur. Në dhomë u dëgjua tringëllima e metalit gërvishtës.

- Sa do të më japësh po u shtriva aty? - e pyeti Luka.

- Pesë dollarë, - i tha Xhoshi.

- Unë do të të jap dhjetë, nëse futesh brenda dhe na lejon ta mbyllim derën, - tha Dejvi.

- Mjaft me këto budallallëqe, ju, - ua priti Kristali. - Mendoj se e bëmë gjithë këtë rrugë për të parë nëse ky vend përndiqej nga fantazmat.

Xhoshi u afrua te tavolina dhe e la derën e kubesë pjesërisht hapur.

- Në rregull, - tha. - Mos u inatos kaq shpejt.

- Mbylle! - i bërtiti Kristali. - E kam seriozisht. - Nga xhepi i xhaketës nxori një qiri të vogël e të trashë, i kërkoi Dejvit çakmakun dhe ndezi fitilin e shkurtër. Pastaj, e vuri qiririn në mes të tavolinës së autopsisë, duke lëvizur ngadalë dhe me kujdes që flaka të mos shuhej dhe gishtat të mos preknin sipërfaqen e ndotur. - Në rregull, mblidhuni, - tha. - Qëndroni rreth tavolinës dhe fikini elektrikët.

Të gjithë i fikën elektrikët dhe u afruan. Izi qëndronte mes Dejvit dhe Xhoshit, me shpinë nga kubeja, me elektrikun poshtë krahut dhe me grushtet e shtrënguara fort brenda xhepave të pulovrit me kapuç. Kristali i mori dorën Dejvit dhe zgjati të merrte edhe të Aleksës. Flaka që dridhej, krijonte hije të errëta poshtë syve të saj.

- Mos bëni zhurmë, - tha Kristali. - Kapuni të gjithë për dore. - Aleksa kafshoi buzën dhe i kapi duart Kristalit e Lukës. Në të njëjtën kohë, Dejvi dhe Xhoshi u zgjatën për të kapur duart e Izit. Në fillim, ajo s'i nxori duart nga xhepat, por, më pas, vendosi që t'i bashkohej kësaj loje. Sa më shpejt ta mbyllnin këtë seancë idiote spiritizmi, aq më shpejt do të largohej prej andej. Dora e Xhoshit dukej si një dorezë bejsbolli e bërë qull. I erdhi për të vjellë. Pak më vonë, Luka dhe Xhoshi kuptuan se ishin pranë njëri-tjetrit.

- Unë s'kam ndër mend të kap një mashkull për dore, - tha Luka.

- As unë, - ia ktheu Xhoshi.

- Kapuni, mos bëni llafe! - tha Kristali duke i parë rreptë. - S'ka për të funksionuar, nëse nuk e marrim të gjithë seriozisht.

- Ajo ka të drejtë, - tha Aleksa. - Duhet të kapemi për dore.

- Pse? - pyeti Izi. - Ç'kuptim ka e gjitha kjo?

- Në rast se shpirtrat që do të sjellim në këtë botë, janë të këqij, - iu përgjigj Aleksa, - shpirti i keq nuk mund të hyjë tek asnjëri prej nesh, nëse jemi të kapur me njëri-tjetrin.

- E shikoni? - tha Kristali duke qeshur. - Ua thashë. Le ta mbarojmë edhe këtë punë.

Xhoshi kapsalliti sytë dhe i zgjati dorën Lukës, i cili i preku majat e gishtave pa dëshirë.

- Nëse dëgjoj ndonjë thashethem për këtë, do të... - tha Luka.

- Ne jemi si gur varri, - tha Dejvi dhe bënte sikur po i dërgonte fluturimthi disa puthje.

Kristali i shkeli këmbën.

- Harrove për çfarë kemi ardhur deri këtu? - tha.

Ai shtrembëroi fytyrën nga dhembja.

- O Zot! - tha. - Në rregull.

- Jeni të gjithë gati? - pyeti Kristali dhe e drejtoi vëmendjen veçanërisht te Xhoshi dhe Luka. Këta të fundit pohuan me kokë dhe u munduan të mos qeshnin. Kristali priti edhe nja dy sekonda, pastaj mbylli sytë.

- A ka ndonjë këtu, mes nesh? - pyeti ajo me zë të qetë e gjithë përkushtim. Një nga djemtë turfulloi, si të mundohej të mbante të qeshurën. - Nuk kemi ardhur këtu për t'ju lënduar, - vazhdoi Kristali.

- Nëse ndodhet ndonjë këtu, mes nesh, - tha Aleksa, - na jepni një shenjë.

Izi hapi sytë për të parë Aleksën, e habitur që ajo po fliste. Sytë i kishte të mbyllur dhe kokën ulur. Pranë saj, Luka qëndronte me supet e kërrusura, fytyrën gjithë ankth, sikur priste ta godisnin apo ta preknin nga çasti në çast. Izi i mbylli sytë sërish. Vriste mendjen se çfarë mund të ndodhte, po të përmendnin emrin e Klarës. Mendoi t'ua rekomandonte emrin e saj, por ndërroi mendje, sepse të gjithë do ta pyesnin se ku e kishte mësuar emrin e asaj pacienteje. Në këto çaste, donte vetëm që e gjitha kjo të merrte fund.

- Dëshirojmë që ju të lëvizni mes nesh, - tha Kristali. - Mund të na prekni flokët, t'u bini mureve, mund të bëni gjithçka që ne të kuptojmë se ndodheni këtu.

- Nëse më prek njeri, unë heq dorë, - tha Luka.

- Shshttt, - ia bëri Kristali dhe mori frymë thellë, gjatë, e pastaj e nxori ngadalë, duke pritur. Më pas, shtoi: - Ju lutem, na jepni një shenjë që ndodheni këtu. Duam të dimë pse gjendeni ende të bllokuar brenda këtij spitali.

- Mund t'ju ndihmojmë që të gjeni paqen, - tha Aleksa. - Të largoheni nga ky vend e të bashkoheni me të dashurit tuaj, të cilët nuk janë më në këtë botë.

Në atë çast, një *tak-tak* i mbytur u dëgjua prapa Izit. Aleksës i shpëtoi një tingull i fortë, edhe pse po përpiqej të mos ulërinte.

- Shshttt... - pëshpëriti Kristali. - S'ka asgjë. Qetësohu. Nëse je vërtet ti, a mund ta bësh sërish atë zhurmë?

Tak-tak.

Xhoshi e shtrëngoi edhe më shumë Izin me dorën e djersitur. Ajo lëvizi gishtat që të lirohej prej tij, por ishte e kotë.

- Të dëgjojmë, - tha Kristali.

- Ke qenë paciente këtu? - e pyeti Aleksa. - Ke qenë e mbyllur në këtë vend të tmerrshëm?

Tak-tak. Tak-tak.

Zemra e Izit nisi të rrihte me shpejtësi. *E vërtetë ishte e gjitha kjo?* Kishte pranuar të vinte në këtë vend të tmerrshëm për të mos i prishur qejfin Aleksës, jo të trembej për vdekje. E ku kishte më keq se të ishe në një çmendinë e të shikoje fantazmat e pacientëve të dikurshëm?

- Vetëm je? - vazhdoi ta pyeste Aleksa. - Ka të tjerë me ty?

- Mund të bësh një zhurmë tjetër? - tha Kristali. - Diçka që ne të kuptojmë se je vërtet ti?

Në atë çast, pas vetes, Izi dëgjoi tri trokitje, sikur dikush po godiste lehtë dorezat brenda kubesë së drunjtë. Iu ngritën qimet përpjetë. Befas, ajri dukej më i rëndë dhe më i nxehtë, sikur dikush të kishte ndezur kaldajën. Pavarësisht nga dyshimet, mblodhi supet si për t'u strukur dhe shtrëngoi me sa fuqi kishte dorën e Dejvit e të Xhoshit.

- Mund të trokasësh sërish? - tha Aleksa.

Tak-tak, tak-tak.

- Ne jemi këtu për të të ndihmuar, - thirri Kristali. - Mund të na e thuash emrin?

Tak-tak, tak-tak, tak-tak, tak-tak.

Aleksa ulëriti. Izi hapi sytë dhe lëshoi duart e Xhoshit e të Dejvit. Elektriku i ra përtokë. Në atë çast, qiriri u fik dhe morgu ra në terr. Aleksa nisi të bërtiste.

- Më lësho! Më lër të qetë! Çfarë po bën? - Pastaj nisi të fliste mbyturazi sikur dikush t'ia kishte zënë gojën.

Izi vrapoi drejt derës, duke u përplasur me Xhoshin. Për habinë e saj, ai e mbërtheu dhe e rrotulloi përqark. Për një çast, mendoi se kishte humbur drejtimin dhe Xhoshi po e ndihmonte t'ia mbathte, por dera ishte në të djathtën e saj, jo në të majtë. Dhoma u mbush me zhurma njerëzisht që hiqnin këmbët zvarrë dhe ziheshin. Pastaj, Xhoshi e kapi Izin rreth kraharorit dhe e ngriti lart. Goja i kundërmonte erë birre dhe fryma e ngrohtë i hynte Izit furishëm në vesh. Mendoi se do ta mbante në krahë derisa ta nxirrte nga dhoma, në një vend të sigurt, por pastaj, dikush e mbërtheu prej kyçesh dhe ia ngriti këmbët nga dyshemeja.

- Çfarë dreqin po bën? - ulëriti duke gjuajtur me shkelma. Me njërën këmbë që mundi ta lironte, goditi dikë në kokë dhe dëgjoi mallkimet e tij. Ishte Dejvi. Ajo dridhej e përdridhej dhe përpiqej të shpëtonte prej Xhoshit, por ishte e kotë. Dejvi e mbërtheu sërish te kyçi dhe e çuan në anën tjetër të dhomës. - Më lëshoni!

Metalet fërkoheshin me njëri-tjetrin duke lëshuar një tingull gërvishtës. Ishte zhurma e pllakës së kubesë që tërhiqej zvarrë. Më pas, Izin e lëshuan mbi bllokun e ftohtë, duke e mbajtur poshtë, ndërkohë, pjesa e pasme e kokës i përplasej me çelikun e fortë. Disa duar të fuqishme e mbanin shtrënguar dhe nuk e linin të ngrihej. Tingulli gërvishtës i metalit u dëgjua sërish dhe ajo bëri përpara, si të rrëshqiste në një shpat horizontal, por, në këtë rast, shpati po lëvizte bashkë me të. E futën në kube. Pllaka u përplas me murin e pasmë me një zhurmë drithëruese. Izi ngriti krahët që të mos lejonte ta mbyllnin derën. Bërrylat dhe kyçet iu çorën pas pjesës së brendshme dhe të ashpër të kubesë. Dera i zuri parakrahun, e gërvishti dhe i dërrmoi muskujt. Ajo ulëriti. Disa duar të fuqishme e shtynë dhe ia futën krahët brenda. Më pas, dera u mbyll, duke e lënë në terr të plotë.

KAPITULLI 14



KLARA

Qendra "Ruki Pest"

Jashtë dritareve të qendrës "Ruki Pest", gjethet e lisave fluturonin rreth kreshtave dhe më pas binin një e nga një përtokë. Klara, e ulur në shtratin e ndotur, shikonte Lorenc Lorencin që shtynte karrocën e dorës përmes shtyllave prej hekuri në varrezën matanë rrugës. Ai punonte në varreza të paktën tri herë në javë dhe bënte çdo ditë të njëjtat gjëra. Në fillim, ndalonte në vendin e caktuar, zbërthente pallton, hiqte kapelën, shtrinte me dorë flokët e thinjur, një herë nga njëra anë dhe një herë nga ana tjetër, pastaj katër herë në mes. Më pas, bënte kryqin dhe ulte kokën. Kapelën e mbante të shtrënguar në zemër. Pas më shumë se një minute, ngrinte sytë dhe vështronte qiellin, vinte sërish kapelën, merrte lopatën nga karroca dhe fillonte të gërmonte. Punonte pa pushim dhe ndalonte vetëm kur hiqte ndonjë gur nga anët e gropës ose kur merrte kazmën. Pa e hapur të gjithë gropën dhe pa e pastruar pirgun e dheut nga rrënjët dhe gurët, nuk bënte pushim. Pasi mbaronte punë, hiqte kapelën, i shtrinte sërish flokët, fshinte ballin dhe e vinte sërish kapelën. Madje, edhe në ditët kur krasiste gjethet apo kosiste barin, punonte pa pushim, derisa ta përfundonte punën.

Javët kalonin. Klara ndihej gjithnjë e më e pafuqishme dhe

i dukej sikur po dorëzohej, ama, njëherazi, habitej me forcën e varrmihësit. Edhe në dimër, kur bora përkulte pemët e kedrës dhe zinte vend mes hekurave jashtë dritareve, varrmihësi hapte me lopatë shtigjet përmes varrezës për të gërmuar vendin e prehjes së dikujt. Një ditë, aty nga fundi i dhjetorit, pak çaste pasi kishte filluar të gërmonte tokën e ngrirë, edhe ai ishte dorëzuar. Disa javë më vonë, kur Klara mundi të shihte se ujërat e përroit Mirs ishin rritur shumë nga shkrirja e akullit, për shkak të motit të ngrohtë, të pazakontë për muajin janar, Lorenc Lorenci u rikthye në punë.

Çdo natë, lutej që të vinte sa më shpejt dita kur varrmihësi të hapte një varr për të. Ditët dhe netët i kalonte e lidhur me zinxhir pas krevatit, duke fjetur ose duke soditur jashtë dritareve të mbuluara nga pisllëku. Zgjidhej nga zinxhirët vetëm kur ishte koha për të ngrënë ose kur shkonte në tualet dy herë në ditë. Ashtu si shumicës së grave të qendrës "Ruki Pest", shpesh i ndodhte të urinonte apo të dilte jashtë edhe kur nuk kishte shkuar ende ora për të përdorur tualetin. Për pasojë, fustani i spitalit kishte zënë kore nga urina, gjaku dhe jashtëqitja e tharë. Çarçafët dhe batanija e hollë ishin lerosur dhe të mbysnin nga era e rëndë. Gjatë ciklit menstrual, i jepnin rrecka për t'i vënë poshtë të brendshmeve dhe mund të shpëlahej vetëm kur përdorte tualetin. Nëse ishte me fat, pas banjës javore me ujë të ftohtë, mund t'i jepnin një këmishë të pastër nate, por, në të shumtën e rasteve, ishte e pamundur të gjeje një të tillë.

Ulërimat dhe britmat shpesh vinin nga diku gjetkë. Përveç tingujve të të qarit, të kollës dhe të grave që flisnin me vete, dhoma e Klarës ishte relativisht e qetë. Punonjësit e qendrës "Ruki Pest" ishin të pakualifikuar. Për shkak të dozës së papërshtatshme me tretësirë opiumi që u jepej përditë pacientëve, shumica e tyre zhyteshin në një gjendje pavetëdijeje dhe trullosjeje, si të ishin në ëndërr.

Klarës kishte filluar t'i pëlqente shija e hidhur e tretësirës së opiumit, e cila kishte shijen e jamballit të zi, të përzier me dhe e sheqer. E dinte se mpirja e gjuhës shumë shpejt do t'ia linte vendin pavetëdijes dhe kështu, nuk do ta ndiente më hidhërimin që i kishte pushtuar kraharorin e po i zinte frymën, sikur të

kishte përsipër një shkëmb gjigant. Pavarësisht nga mjekimet, përjetonte të njëjtin makth çdo natë. Në mes të pavijonit, mes qindra shtretërve të tjerë me foshnja të dobëta dhe qaramane, shikonte krevatin metalik të Beatrisës. Brenda gjendej vajza e vogël që qante, e dobët dhe me një këmishë të pistë nate.

Çdo mëngjes, kur efekti i mjekimit dobësohej dhe Klara hapte sytë, lotët ia mjegullonin shikimin. Kujtimi i Beatrisës që ia rrëmbenin nga duart, bënte që diçka e keqe dhe e ndyrë t'i pështjellonte stomakun. Qëndronte e shtrirë dhe donte të vdiste, pa e mposhtur më pikëllimin, donte që gjaku t'i kthehej në plumb, zemra në gur dhe muskujt në granit. Mbyllte sytë dhe mundohej të hiqte mendjen, por brenga dhe hidhërimi e kthenin gjithmonë në realitet, si për ta ndëshkuar. Agonia thuajse e gllabëronte të tërën.

Gjatë ditëve të para në qendrën "Ruki Pest", ishte munduar t'i bënte punonjësit të arsyetonin. U ishte lutur ta lironin, që të gjente të bijën para se të ishte tepër vonë, para se Beatrisa të shkonte larg e ta humbte përgjithmonë. Të pashpirt ndaj lutjeve të pacientëve, punonjësit e kishin shpërfillur. Me fytyrat e akullta, e kishin shtyrë lehtë përgjatë korridorit, e kishin shtrirë në shtrat, duke ia shtrënguar zinxhirin fort rreth këmbëve. Një herë, pasi e kishin shoqëruar për në tualet, ajo kishte shtyrë dhe kishte hedhur përtokë një nga rojat, pastaj kishte vrapuar nëpër korridor, por e vetmja gjë që kishte gjetur, ishte një derë e mbyllur dhe një grup rojash të tjera që po prisnin ta kthenin sërish në dhomën e saj.

Një javë më vonë, kishte vendosur të mos hante më. Kjo gjë u kishte rënë në sy punonjësve, të cilët kishin nisur ta mbikëqyrnin. Ata e kishin urdhëruar të hante qullin që ishte tharë në tas. Kur kishte refuzuar, e kishin ngritur nga stoli dhe e kishin goditur aq fort me pëllëmbë në fytyrë dhe e kishin paralajmëruar se, nëse nuk u bindej urdhrave, gjërat thjesht do të shkonin më keq nga sa ishin. Me buzën e çarë dhe që i rridhte gjak, kishte futur një lugë dhe thuajse ishte mbytur. Më vonë, kishte mallkuar veten që nuk ishte aq e fortë sa t'i lejonte ta ndëshkonin. Beatrisën s'e kishte më dhe vetë ishte e mbyllur në një spital për të sëmurët mendorë. Nuk kishte më asnjë arsye për të jetuar.

Pastaj, nga fundi i muajit shkurt, kishte parë në ëndërr

Beatrisën, sikur ishte e rritur, me flokë të errët si sateni, të gjatë deri te shpatullat, që i binin sipër fustanit të verdhë. Beatrisa kishte hyrë në atë që dukej si dhomë spitali, pastaj, ishte ulur në gjunjë dhe i kishte buzëqeshur me lotët që i shkëlqenin në sy. Të nesërmen në mëngjes, lëmshi që i ishte mbledhur në kraharor prej shumë kohësh, sikur ishte zvogëluar. Ishte ende aty, i rëndonte dhe e lëndonte, por, gjithsesi, nuk ndihej më sikur po i copëtohej zemra. Ëndrra kishte qenë aq e vërtetë, saqë Klara ndiente ende parfumin e Beatrisës dhe faqet e saj të buta. Kjo ëndërr duhej të kishte patjetër një kuptim, por, nuk do ta merrte vesh kurrë nëse do ta kalonte pjesën tjetër të jetës e mbyllur në qendrën "Ruki Pest".

Po atë mbrëmje, Klara nuk e kapërdiu dozën e opiumit, por e mbajti në gojë. Kur infermierja shkoi te pacientja tjetër, ajo mbuloi buzët me batanije dhe e pështyu te pëlhura e pistë. Në javët e ardhshme, u soll njëlloj si gratë e tjera të droguara, me qëllim që të mos binte në sy. Më një mars, kur doktor Roaçi më në fund shkoi në qendrën "Ruki Pest" për të vizituar pacientet e tij, ajo e pa drejt e në sy dhe pranoi se gjëja më e mirë ishte që Beatrisa të rritej nga prindër të tjerë.

KAPITULLI 15



Izi

Chapin Hall

Duke u orvatur të rregullonte ritmin e frymëmarrjes, Izi po përpiqej të rrotullohej në pllakën metalike brenda kubesë së morgut, por ishte e kotë. Kubeja ishte aq e ngushtë, sa nuk mund t'i përthyente gjunjët e ta shtynte trupin lart, sepse i binte tavanit të ulët dhe mureve.

- Më nxirrni prej këtej! - ulërinte.

Zhurma të mbytura e të qeshura nën zë hynin përmes mureve të drunjta. Dëgjohej zhurma e dyerve të morgut që hapeshin, përplaseshin para e prapa dhe, për pak çaste, u ndje tringëllima e menteshave. Më pas, nuk pipëtinte më asgjë.

- Ndihmë! - thirri.

Zgjati dorën dhe goditi fort derën. Druri i ashpër ia zhvoshku lëkurën te kyçet e duarve. Heshti për disa sekonda, se mos dëgjonte diçka tjetër përveç dihatjes së vet, pastaj mbylli sytë dhe numëroi deri në dhjetë, me qëllim që të mposhtte panikun që kërcënonte ta pushtonte të tërën. *Ata do të kthehen*, mendoi. *Kanë dalë jashtë për të qeshur. S'do të vonohen e do të kthehen*. Befas, era e rëndë dhe e neveritshme e diçkaje të kalbur dhe e formaldehidit ia bllokoi hundët. Mblodhi buzët fort dhe u mundua të mos merrte frymë, por mungesa e oksigjenit e trullosi.

- Mjaft më! Kaq e pati edhe shakaja! - thirri. - Më nxirrni prej këtej! Aleksa? Xhosh?

Ende asgjë. Ndoshta nuk ishte shaka. Më pas, iu kujtuan britmat e mbytura të Aleksës që i ulërinte dikujt dhe i thoshte ta lëshonte. Mos vallë e kishin mbyllur edhe atë në një nga kubetë?

- Aleksa? - thirri. - Këtu je?

Heshtje. Ç'dreqin po ndodhte? Ndoshta Aleksën e kishin tërhequr zvarrë dhe e kishin nxjerrë nga dhoma me zor. Iu kujtua paralajmërimi që i kishte bërë ajo. Duhej të tregohej edhe më e kujdesshme pas faljes që i kishte kërkuar Shenoni. Urrejtja e pushtoi të tërën. Mos vallë Shenoni kishte kurdisur gjithçka me Xhoshin, Kristalin dhe Dejvin? Në mendje i kaloi një tjetër mendim dhe kthetrat e frikës e mbërthyen në fyt e të dridhura i përshkuan trupin. Nëse Aleksën e kishin tërhequr zvarrë përgjatë gjithë bodrumit, shkallëve dhe deri përjashta, ajo do ta kuptonte që Izi kishte humbur, vetëm kur ta lëshonin. Nuk e kishte idenë që atë e kishin mbyllur brenda kubesë.

Mori frymë thellë dhe po përpiqej të kujtonte se si ishin ndarë grupet, se si ishte vendosur që grupi i saj do të kontrollonte morgun. Mos ndoshta ankthi për të mos hyrë në Uillard kishte qenë aq i madh, saqë nuk kishte mundur të vinte re asnjë shenjë të këtij kurthi të mundshëm?

Mblodhi grushtet. Papritmas, nisi të dridhej e të gulçonte, sepse nuk po mbushej dot me frymë. Përpiqej të mposhtte tmerrin që po e mbyste dhe i dukej sikur do të humbte ndjenjat. Nga sytë, nisën t'i shpërthenin lot zemërimi dhe frike.

- Më nxirrni prej këtej! - ulëriti me sa fuqi kishte. Ama, në pjesën e kubesë poshtë saj...

Tak-tak, tak-tak.

Mbylli veshët. Zemra sa s'po i dilte nga kraharori. *Ç'dreqin po ndodh kështu?*

Tak-tak, tak-tak.

- Nëse s'më nxirrni tani, do të pendoheni keq! - thirri, e vetëdijshme që kërcënimet nuk pinin ujë. Çfarë mund të bënte vallë? T'i spiunonte te drejtori i shkollës? U ra mureve me sa fuqi kishte, duke përplasur fort kyçet dhe duke shtrënguar gishtat e këmbës.

- Dejv! Xhosh! E di që ju të dy më futët këtu!

I shkoi ndër mend t'i thoshte atij që po bënte gjithë atë zhurmë, të ndalonte, sepse e dinte tashmë se gjithçka ishte pjesë e rrengut. Duhej të ishte patjetër kështu. Por vendosi të mos i kushtonte rëndësi. Po sikur ai që bënte atë zhurmë poshtë, të mos ishte njeri? Po përfytyronte atë: një skelet të pistë të shtrirë në kube, poshtë saj, me gojën pa buzë që hapej e mbyllej, kyçet e duarve dhe kockat që trokisnin në drurin e njomë. Imagjinoi një skelet me një fustan të leckosur spitali, copëza pëlhure të mykur dhe mishi të kalbur i vareshin nga brinjët. Kryqëzoi krahët dhe e largoi nga mendja këtë imazh. Duke mbajtur sytë mbyllur, përpiqej të shpërfillte zhurmën dhe mendimin që e kishin mbyllur brenda kubesë së një morgu. *Po sikur të mos kthehet asnjë? Po sikur të më lënë këtu? Mund të vdes dhe askush s'do ta marrë vesh se çmë ndodhi. Askush s'do ta marrë vesh ku ndodhem. Jo. Aleksa s'do ta lejojë kurrë këtë gjë. Me t'i shpëtuar Lukës dhe Kristalit dhe me të kuptuar se unë kam humbur, do të pyesë se ku kam përfunduar. Ajo do të kthehet të më gjejë.*

Befas, i erdhi në mendje një kujtim i mjegullt nga fëmijëria ose ndoshta ishte ndonjë makth i harruar, por nuk ishte shumë e sigurt. Ishte në krevat. Abazhuri në formën e ponit ndriçonte dhe përhapte një dritë rozë në njërën qoshe të dhomës së errët. Dera kërciti dhe ajo u zgjua. Kapsalliti sytë dhe bëri të ngrihej. Befas, dikush, një burrë, ishte shtrirë pranë saj. Era e djersës dhe e uiskit përhapej në ajër si mjegull. Në fillim, nuk mundi t'i dallonte tiparet e të panjohurit, por pastaj, ai i buzëqeshi dhe fytyra iu shndërrua në një demon hungërues, me sy të gjakosur, të dalë jashtë zgavrave, aq sa preknin vijën ndarëse të flokëve; dhëmbët e zinj e të kalbur i kishte me majë. Donte të ulërinte, por nuk mundte, sepse demoni e shtrëngonte me sa fuqi kishte.

Izi kafshoi buzën. Duart i shtrëngonte dhe i lironte pa pushim. Tek mundohej të rregullonte ritmin e frymëmarrjes, flegrat e hundës i ishin hapur shumë. Në fyt, ndiente ajrin e nxehtë e të thatë. Iu kujtua makthi që e kishte përndjekur gjatë gjithë fëmijërisë, i cili, pa dyshim, doli në dritë ngaqë e kishin mbyllur në atë kube. Mbante mend se kishte qenë aq e tmerruar, sa ishte mpirë në vend, e pazonja për t'i treguar nënës. Kjo gjendje kishte

zgjatur disa orë dhe vetëm pasi kishte dalë nga kjo përhumbje, sikur të ishte në ekstazë, kishte mundur të fliste. Prindërit do ta kishin lejuar të kridhej në krevat me ta deri të mëngjes. I kujtohej nëna që i përsëriste pa mbarim se nuk kishte arsye të frikësohej, sepse përbindëshat nuk ishin të vërtetë dhe se ajo do ta mbronte gjithmonë. I kujtohej që e ëma i kërkonte falje, por nuk ishte e sigurt se për çfarë.

Në ato çaste, e fshiu disi nga mendja atë imazh të tmerrshëm, por ndjesia e të qenit në kurth, ndjesia sikur po mbytej, i peshonte aq shumë dhe i dukej sikur po i afrohej një tren e do t'i kalonte përsipër. Zbërtheu zinxhirin e pulovrit me kapuç dhe tërhoqi jakën e bluzës. Balli dhe buza e sipërme iu mbuluan nga bulëza djerse. Ngriti mëngët dhe i nguli thonjtë në krah, duke u orvatur të çante lëkurën. Nëse Shenoni kërkonte ta çmendte, plani i saj po funksionononte. J*o*, mendoi. *S'mund të lejoj që ajo të fitojë.* U mundua të qetësohej dhe filloi të imagjinonte se muskujt e gishtave të këmbës, të shputave dhe të kofshëve do t'i çliroheshin. Lehtësimi zgjati vetëm pak sekonda, sepse, më pas, e pushtoi sërish paniku. Mori frymë thellë dhe ia nisi nga e para.

Duhej ta mbante veten e të ishte e qetë. Trokitja poshtë saj kishte ndalur dhe po vriste mendjen nëse keqbërësin e kishte zënë gjumi. Kushdo që të ishte, duhej të merrte fillimisht miratimin e Shenonit. Teksa mendonte për Shenonin, shtrëngoi nofullat. Po sikur të trembej aq shumë sa të pësonte ndonjë infarkt apo krizë nervore? Po sikur t'i mbaronte oksigjeni para se dikush ta gjente? Aq shumë e urrente Shenoni, saqë ishte e gatshme t'i rrezikonte edhe jetën? Po Etani kishte gisht në gjithë këtë rreng të tmerrshëm?

Jo, s'mund të kishte. Mund të ishte aq naiv sa të justifikonte rrengjet e ulëta të Shenonit, por s'do të pranonte kurrsesi t'i shkonte pas fillit në këtë mesele. Duhej ta kishin organizuar Shenoni, Xhoshi, Kristali dhe Dejvi.

Djersa që kishte shkaktuar paniku, filloi të avullonte. Ajri i ftohtë i ngacmonte kyçet e duarve e të këmbëve, sikur gishtat e akullt të fantazmave t'i preknin lëkurën. Mbërtheu zinxhirin e pulovrit dhe hodhi në kokë kapuçin, duke u mbledhur, me qëllim që të rrinte ngrohtë. Dhëmbët i kërcëllinin. Imagjinonte veten të mbyllur në kube, teksa vjeshta ia linte vendin dimrit dhe

ajo që sa vinte e bëhej më e dobët dhe më e pafuqishme, e uritur për vdekje. Ngriti krahët dhe fërkoi fytyrën me duar. Lëkura i dukej si dyllë: e ftohtë dhe e pajetë nga jashtë, regëtitëse dhe e nxehtë nga brenda. Iu kujtua se kishte dëgjuar histori me njerëz që ishin varrosur të gjallë, të cilët kishin çjerrë me thonj dhe kishin gërvishtur kapakët e drunjtë të qivureve, duke u orvatur të dilnin. Imagjinoi gishtërinjtë gjithë gjak, thonjtë që haheshin me shpejtësi, derisa nuk mbetej më asgjë, përveç kockës.

Jo, tha me vete. *Ti nuk je mbyllur në një qivur. Je brenda një kubeje. Mund të dalësh prej këtej. Duhet thjesht të presësh sa të vijë dikush dhe të të hapë derën.* Donte të fshinte imazhin nga mendja e të përqendrohej në diçka tjetër. I kishte shtrënguar dhëmbët aq shumë, saqë nofullat po i dhembnin e po ndiente një dhimbje koke, një sëmbim të mprehtë që po i buçiste në të dyja anët e tëmthave.

Më në fund, dëgjoi disa zëra të mbytur, hapa të rëndë që vraponin nëpër korridor, dhe dyert e mëdha që u hapën.

- Izi? - thirri dikush. - Ku je? - Ishte Aleksa.

- Jam këtu! - u përgjigj dhe goditi fort njërën anë të kubesë.

- Dreqi ta hajë! - u dëgjua zëri i një mashkulli.

- Do të të nxjerrim prej andej! - tha Aleksa. - Duro!

Zërat vinin të largët e të mbytur, sikur t'i ndanin disa dyer radhazi.

- Në cilën kube mund të jetë? - tha zëri i mashkullit. Izit nisi t'i rrihte zemra fort. I ngjau si Etani.

- Nuk e di, - tha Aleksa. - Le t'i hapim dyert!

Goditi me forcë drurin mbi kokë.

- Jam këtu! - tha dhe u dëgjua të hapej kubeja në krahun e majtë. Më pas, u hap edhe ajo që ishte poshtë saj.

- Ç'dreqin bëhet kështu? - tha Etani. - Çfarë bën aty brenda?

U dëgjua kërcitja e metalit, pastaj disa goditje të forta, sikur dikush po luftonte të ngrihej në këmbë apo po kacafytej. Diçka e rëndë gërvishti dyshemenë, pastaj goditi derën mbi kokën e saj. Kubeja u trondit e tëra.

- Ku është Izi? - turfulloi ai. Zëri iu dëgjua jashtë derës dhe Izi e imagjinoi atë duke shtyrë dikë drejt kubesë, me fytyrën e shpërfytyruar nga zemërimi.

- Nuk ishte ideja ime! - u dëgjua një tjetër zë mashkulli. - Më paguan!

- Kush të pagoi? - pyeti Etani dhe e ngjeshi me zhurmë tjetrin sërish te kubeja.

- Mos u merr me të! - i tha Aleksa. - Duhet të gjejmë Izin!

- Me ty do të merrem më vonë, - tha Etani.

Izi përfytyroi dikë tek e tërhiqnin me forcë jashtë kubesë. Një goditje metalike jehoi nëpër dhomë, sikur dikush të ishte rrëzuar mbi vaskën me lëngun e balsamimit. Dera që lëkundej, kërciti.

Më në fund, dera e trashë që ndodhej mbi kokën e saj, u hap dhe rreze drite hynë në hapësirën e errët. Mezi po merrte frymë, prandaj po shtyhej anëve të kubesë dhe po mundohej të dilte. Më pas, dikush hoqi pllakën. Izi përpëliti sytë dhe vuri përpara dorën që i dridhej, sepse dritat e verbuan. Rrezet e dritës u shuan, ndërsa Aleksa, me fytyrë të zbehtë dhe sy të zgurdulluar, qëndronte aty, duke mbajtur në dorë dy elektrikë, dhe po vështronte Izin.

- O Zot! - tha. - Je mirë?

- Them se po, - tha Izi, duke u ngritur mbi bërryla. Hodhi këmbët mbi buzën e pllakës dhe menjëherë kërceu më këmbë. Iu morën mendtë. Mori frymë thellë dhe mbylli sytë, me qëllim që të fitonte sërish ekuilibrin. Një dorë e ngrohtë e rroku nga kurrizi. U kthye dhe pa Etanin, vetullngrysur e me buzë të mbledhura fort, i cili i doli përpara dhe i zgjati dorën për ta ndihmuar të zbriste. Ende duke u dridhur, ajo e kapi për krahu për t'u mbështetur dhe lëvizi deri në buzën e trashë të pllakës metalike. Etani e mbërtheu nga beli, e çoi peshë dhe e uli ngadalë përdhe. Bota iu errësua e iu drodh e gjitha nën këmbë teksa tundej dhe mundohej të mos shembej përdhe. Etani e mbërtheu nga supet dhe e shtrëngoi fort.

- Je e sigurt që je mirë? - e pyeti dhe u përkul për ta parë drejt e në sy.

Izi pohoi me kokë. E çliruar që kishte shpëtuar, pyeste veten se ç'donte ai këtu. Donte ta pyeste ku ishte Shenoni apo nëse e dinte se çfarë kishte planifikuar e dashura e tij, por, më parë, donte të largohej sa më shpejt që të ishte e mundur nga Uillardi.

- Më vjen shumë keq, - tha Aleksa. - Nuk e dija se çfarë po ndodhte. Kur më tërhoqën zvarrë prej këtu, kujtova se po të tërhiqnin edhe ty. Nuk shikoja asgjë dhe doja t'ia mbathja por...

- ajo po qante dhe fjalët i dilnin me dihatje të shkurtra dhe të dobëta. - E kuptova që nuk ishe me ne, vetëm kur dolëm jashtë.

- S'ka gjë, - tha Izi. - Nuk është faji yt. Më nxirrni prej këtej.

- Ata m'i morën elektrikët dhe më lanë jashtë godinës, - tha Aleksa. - M'u desh shumë kohë për të gjetur dikë që të më ndihmonte.

- Eja, - tha Etani dhe i hodhi Izit krahun rreth belit. - Shkojmë.

Ajo ecte drejt daljes duke u mbajtur te krahu i Etanit për të ruajtur ekuilibrin. Dridhej e tëra. Dhëmbët i kërcëllonin ca nga i ftohti, rraskapitja dhe ndjesia e çlirimit, ca nga zemërimi.

- Duhet të ketë patjetër gisht Shenoni, - tha Aleksa gjithë mllef. - Ajo i ka nxitur ta bëjnë këtë!

- Po, - ia ktheu Izi. - Të njëjtën gjë mendova edhe unë.

Etani ndaloi në korridor, zbërtheu pulovrin dhe ia zgjati Izit. Ajo futi krahët dhe u mbështoll e tëra me të: pjesa e brendshme e tij ishte e thatë dhe e ngrohtë, kurse te jaka ndihej aroma e njohur e parfumit të Etanit. Donte të mbulonte fytyrën me pulovër, për të mos ndier erën e lagësht e të keqe të bodrumit, por i rezistoi kësaj dëshire. Nisi të ecte sërish përgjatë korridorit me çimento dhe po i hidhte hapat sa më shpejt të mundej, e etur për ajër të pastër.

- Kush të mbylli brenda? - e pyeti Etani. - E pe?

- Xhoshi dhe Dejvi, - iu përgjigj Izi. - Jam e sigurt për këtë.

- Më vjen shumë keq, - tha. - S'më besohet se do të arrinte deri këtu, sa të ta punonte edhe këtë rreng. Jo vetëm ty, por kujtdo.

- E dashura jote është një kuçkë e ligë, - tha Aleksa. - Hiqet sikur është e merakosur për Izin dhe pyet se çfarë mund t'i ketë ndodhur vallë. Izi duhet ta padisë atë bushtër!

Në fund të korridorit, Izi mbërtheu parmakun dhe u mundua të ngjiste shkallët.

- Nëse merr vesh se ke ardhur të më kërkosh, asaj do t'i ikë truri, - i tha Etanit.

Ai mblodhi supet.

- Ku është tani?

- Të gjithë po presin te hangari i barkave, - tha Aleksa.

- Shkojmë atje, - tha Izi.

Rrezet e elektrikut përthyheshin dhe kryqëzoheshin me njëra-tjetrën. Vijat e verdha të dritës përvijonin luginën e zezë dhe ndriçonin dërrasat e kalbura të hangarit të barkave. Grupe adoleshentësh lëvrinin, ecnin tutje-tëhu dhe hidheshin lart e poshtë për t'u ngrohur, duke pritur të merrnin vesh se çfarë kish ndodhur. Kur pa Izin të zbriste kodrën, Kristali u nis nxitimthi drejt saj, duke vrapuar nëpër bar. Izi ndjeu kraharorin dhe fytyrën t'i merrnin flakë.

- Si je? - e pyeti Kristali, duke u shtirur sikur i vinte keq. Zgjati duart për ta përqafuar, por Izi kaloi pa ia hedhur sytë dhe vazhdoi të ecte e të kërkonte Shenonin me sy mes turmës.

Më në fund e pa. Po fliste dhe po qeshte me Xhoshin dhe Lukën, të cilët, në njërën dorë mbanin një shishe birrë, kurse në tjetrën cigare. Izi çau mes turmës, pa e vrarë mendjen se të gjithë ia kishin ngulur sytë. Sa më shumë i afrohej Shenonit, aq më tepër i rritej mllefi brenda vetes, si një tullumbace që fryhet dhe është gati të plasë. Normalisht, në një rrethanë tjetër, do të ishte munduar ta mbyste zemërimin dhe mllefin sapo të nxirrnin kokën, por, këtë herë, mllefi ishte aq i madh, saqë e kishte pushtuar të tërën dhe nuk e linte të mendonte qartë. S'do ta gjuante Shenonin, por nuk do të lejonte t'ia hidhte paq pas kësaj që bëri. Eci drejt saj me hapa të mëdhenj, me trupin drejt dhe duart mbledhur grusht.

Pa Shenonin që ktheu ngadalë kokën drejt saj. Poshtë syve, i ishin formuar qese nga alkooli dhe mungesa e gjumit. Kur pa Izin që po shkonte drejt saj, buzëqeshja i ngriu në fytyrë. Shenoni u mat të fliste, por Xhoshi u fut mes tyre dhe e ndaloi Izin.

- Ç'dreqin ndodhi atje? - pyeti. - Je mirë?

- Ti e di shumë mirë se çfarë ndodhi, - ia ktheu Izi.

I kaloi anash dhe çau rrugën drejt Shenonit, e cila ia kishte ngulur sytë, kurse buzët i lëvizte pa pushim, pa ditur nëse duhej të qeshte apo të ngrysej. Pa dyshim, vriste mendjen edhe nëse e kishin zbuluar për atë që kishte bërë. Por, meqenëse ishte gjendur në të tilla rrethana me mijëra herë, Shenoni e dinte instinktivisht se çfarë duhej të bënte. Buzëqeshi si e lehtësuar.

- O Zot i madh! - tha. - Je mirë?

Për të mijtën e sekondës, Izit i shkoi ndër mend të ndalonte e të kthehej pas, sepse nuk ia vlente të merrej me të. Pikërisht në atë çast, diçka e errët i pushtoi trurin, prandaj nxitoi përpara dhe e mbërtheu Shenonin nga jaka me të dyja duart dhe e tërhoqi nga vetja.

- Nëse ngatërrohesh edhe një herë me mua, - turfulloi, - do të pendohesh keq! - Nga buzët i fluturuan disa stërkala pështyme që përfunduan në mollëzat e nxira nga dielli të Shenonit. Ajo u bë dyllë e verdhë në fytyrë dhe bëri mbrapsht, u mundua t'i hiqte gishtat e Izit e të çlirohej prej saj.

- Më lësho! - thirri.

- Kërko falje! - vijoi Izi gjithë mllef.

- S'kam bërë asgjë! - vazhdoi Shenoni.

- Kërko falje, përndryshe do të të shtyp si morr, - ulëriti Izi.

Para se Izi të kuptonte se çfarë po ndodhte, Xhoshi, me njërën dorë tërhoqi pulovrin e saj dhe me tjetrën kapi Shenonin nga supet, duke u munduar t'i ndante.

- Lëshoje! - tha duke e ndaluar Izin. - Nuk e di se çfarë ndodhi atje brenda, por ajo nuk ka gisht fare në këtë mesele.

Izi i shpëtoi nga duart.

- Gjepura! - ia ktheu dhe i drejtoi gishtin në fytyrë. - Ti e di shumë mirë se çfarë ndodhi! Më mbylle në kube dhe më le atje! Ajo të ka përfshirë edhe ty në gjithë këtë!

- Unë? - tha Xhoshi duke ngritur vetullat përpjetë. - Nuk e di çfarë ke tymosur, por unë s'të kam prekur as majën e gishtit. Aleksa nisi të ulërinte dhe të gjithë vrapuam jashtë. Kujtova se po vije pas nesh!

- Gënjen! - tha Izi.

- Ti nuk ishe me ne, - i tha Aleksa Xhoshit. - Erdhe pas disa minutash, kur Luka dhe Kristali më kishin lëshuar.

Shenoni qëndronte pranë Xhoshit, me krahët e kryqëzuar në kraharor.

- S'arrij ta besoj, - tha. - Unë kërkoj falje për gjithçka, kërkoj një mundësi tjetër dhe ti më falënderon kështu? Nuk e di nëse do të hakmerresh apo çfarë, por të thuash që e kam porositur Xhoshin të të mbyllë në kube, është një akuzë fort e rëndë. Nuk do ta bëja kurrë diçka kaq të tmerrshme.

Izi nisi të ecte sërish drejt Shenonit, por Xhoshi hyri mes tyre

dhe e largoi. Befas, aty erdhi Etani dhe i doli në mbrojtje Izit. Ngriti grushtin dhe e goditi Xhoshin në fytyrë, duke mërmëritur diçka nëpër dhëmbë. Pasi Etani drejtoi trupin para, Xhoshi u lëkund prapa dhe u rrëzua përdhe, me duart lart dhe hundën e gjakosur.

- Mos guxo më t'i afrohesh Izit! - turfulloi.

Në atë çast, u shfaq Dejvi, me sytë e çapëlyer kur pa Xhoshin dhe mandej Etanin.

- Ç'dreqin bën kështu, Etan? - tha. Etani mblodhi sërish grushtin, gati për të dhënë një goditje tjetër, por këtë herë e kishte për Dejvin. Izi e ndaloi duke e kapur për krahu.

- Mos, - tha. - Nuk ia vlen të merresh me ta.

Etani fshiu buzët me krah, duke gulçuar e duke parë si i hutuar dhe rroku Izin nga supet.

- Je mirë? - e pyeti Izi. Dejvi ndihmoi Xhoshin të ngrihej dhe të dy ia ngulën sytë Etanit, duke lëvizur kokat në shenjë qortimi.

- Si e ke hallin, vallë? - pyeti Dejvi.

- Si e kam hallin? - përsëriti Etani. - Kur do të rriteni dhe të filloni të mendoni për pasojat e veprimeve? Çfarë do të kishit bërë, po t'i kishte ndodhur gjë Izit? Po sikur të vritej apo të mos e gjenim dot?

- Ç'dreqin ke kështu, Etan? - tha Shenoni. - Pse e mbron atë? Jam unë e dashura jote, apo e ke harruar?

Etani uli sytë për një minutë, mandej, e pa atë në sy.

- Jo më, - tha dhe u ngrys e shtrembëroi fytyrën sikur të kishte provuar diçka të prishur.

- Si the? - ulëriti Shenoni me sa kishte në kokë. - Çfarë the?

Etani mori frymë thellë, pa ia ndarë sytë Shenonit.

- Po ndahem nga ti. Nuk mund të qëndroj me dikë që kënaqet duke lënduar të tjerët. Nuk e di se çfarë të ka ndodhur këto kohët e fundit, por këtë herë i kalove caqet.

- I paskam kaluar caqet? - tha Shenoni me zë të dobët. - Ti i beson asaj kështu, si pa të keq?

- Në kube gjeta shokun tënd, Brajanin. Më tha se ti e kishe paguar për ta bërë gjithë këtë.

- Nuk është e vërtetë, - u hodh Xhoshi. Ishte i dehur, prandaj zëri i doli i mbytur. Kishte zënë hundën me dorën e trashë e të

mbuluar me gjak, që ishte tharë. - Ajo nuk ka fare gisht në këtë mesele.

- S'ke pse të mundohesh kaq shumë për t'i rënë në sy, Xhosh, - i tha Etani. - Është e gjitha jotja.

Kapi Izin për krahu dhe u ktheu kurrizin e u nisën nga bregu. Aleksa u shkoi pas.

- Do të shkojmë në urgjencë? - pyeti Etani.

- Jo, - ia ktheu Izi. - Do të më kalojë.

- Eja, Aleksa! - tha. - Ta shoqërojmë për në shtëpi.

KAPITULLI 16



KLARA

Mars 1931

Një javë pasi e kishin nxjerrë nga qendra "Ruki Pest", Klarën e lejuan të bashkohej me pacientet e tjera, e sistemuan në një pavijon tjetër dhe i caktuan një punë në lavanteri: të përzgjidhte, të kolliariste dhe të hekuroste rrobat. Asaj i binte bretku në punë, ku temperaturat ishin shumë të larta dhe kushtet si mos më keq, por, gjithsesi, ishte e lehtësuar që, më në fund, ishte larguar nga qendra "Ruki Pest". Ishte e gëzuar për mundësinë që iu dha të ngrihej sërish në këmbë e të punonte, të vinte trupin në lëvizje e të tendoste muskujt dhe mbi të gjitha, ishte e lumtur që nuk e lidhnin më me zinxhir pas krevatit njëzet e katër orë në ditë.

Secila prej grave të lavanterisë shikonte punën e vet, përveç Matildës, një e moshuar me flokë të gjatë të thinjur, që i mbante gërshet, dhe me një theks të trashë evropian, e cila s'linte njeri pa i folur. Ishte më shpatullgjerë dhe më qafëgjatë se pjesa më e madhe e grave që gjendeshin aty. Krahët i kishte të trashë dhe muskulorë, ndërsa gishtat jashtëzakonisht të gjerë. Çarçafët dhe këllëfët e sapolarë Matilda i dorëzonte në dhomat e kollarisjes. Ajo ngrinte dhe mbante mbi kurriz govata plot me tesha të njoma e i transportonte ngadalë përgjatë dhomës. Kur nuk mbante mbi kurriz govatat e rënda, shtynte për te rrobaqepësia, që ndodhej në

anën tjetër të korridorit, karroca me veshje të grisura e të shqyera. Sa herë që ndalonte, përqafonte të gjitha gratë dhe u thoshte të njëjtat fjalë.

"Unë nuk dëgjoj zëra, nuk shikoj vizione. Nuk jam e çmendur, por jam nervoze."

Pacientet nuk lejoheshin ta preknin njëra-tjetrën, por askush nuk mundohej ta ndalonte Matildën të dhuronte përqafimet e përditshme. Klara kuptoi se mezi priste ta shikonte atë çdo ditë dhe të ndiente krahët e fuqishëm e të ngrohtë tek e përqafonin. I dukej sikur kishte kaluar një shekull që kur e kishin përqafuar për herë të fundit, ndaj e rrokte pak më gjatë sa herë që e takonte. Kur e falënderonte, Matilda zbardhte dhëmbët dhe i thoshte se ishte shumë e ëmbël. Ky përqafim u shndërrua në ritual që i ndriçonte ditën Klarës, një shfaqje dashamirësie në një vend të ftohtë e të pashpirt.

Pas dy javësh, Klarën e lejuan të kalonte një orë çdo pasdite në dhomën e argëtimit. Ishte një dhomë e gjatë dhe e ngushtë, e veshur me letër me vija, me perde të qëndisura dhe llambadarë të stilit viktorian. Pacientet uleshin në divane me jastëkë apo karrige të thurura dhe flisnin, sodisnin peizazhin jashtë, luanin me letra dhe lojëra të tjera në tavolinat prej dru lisi. Në një qoshe, një paciente lëvizte dorezën e gramafonit dhe luante pa pushim interpretimin acarues të këngës "America the Beautiful". Kjo dhomë ishte dekoruar në mënyrë të tillë që të dukej e të ishte sa më e rehatshme, me qëllim që pacientet të ndiheshin sa më të qeta, por te Klara kishte efektin e kundërt. Për të, e gjitha dukej si tallje, një orvatje për t'i qetësuar pacientet, që ato të mendonin se nevojat po u plotësoheshin më së miri, teksa muajt dhe vitet fluturonin. Jeta po u fashitej dhe askush nuk bënte as përpjekjen më të vogël për t'i ndihmuar që ta kthenin mbrapsht. Pas perdeve luksoze dhe orendive të rehatshme, dritaret ishin ende të zëna me hekura, dyert ende të kyçura dhe rojat i vëzhgonin ende me sy vigjilentë.

Klara ecte mes karrigeve dhe tavolinave për të gjetur një vend të qetë, ku të rrinte vetëm, larg të gjithëve. Befas, zemra mend i shpërtheu në kraharor. Esteri dhe Madalena ishin ulur bashkë përpara një rafti librash. Madalena ishte përkulur përpara dhe po i lexonte diçka Esterit, e cila ishte ulur në një kolltuk, me

kokën mbështetur dhe sytë e mbyllur. Klara nuk e kishte parë Madalenën që prej ngjarjes në kuzhinë, kur kishte përplasur kokën dhe më pas kishte lindur. Esterin e kishte parë për herë të fundit gjatë shëtitjes së përditshme kur kishin kaluar pranë qendrës "Ruki Pest". Nxitoi drejt tyre dhe u ul në gjunjë pranë karriges së Esterit.

- Jam shumë e lumtur që ju takova të dyjave, - pëshpëriti.

Madalena zgurdulloi sytë nga habia dhe libri i rrëshqiti nga duart e i ra në prehër.

- Klara, - tha, - ku ke qenë gjithë këtë kohë?

Ajo vështroi Esterin për të parë se si do të reagonte, por atë e kishte zënë gjumi. Nga afër, fytyra e saj dukej më e zbehtë nga sa e mbante mend. Rrathët e zinj poshtë syve nxirrnin në pah lëkurën e rrudhur. Dukej sikur ishte nja dhjetë vjet më e madhe. Tiparet si të një ylli kinemaje ishin venitur nga hidhërimi dhe stresi, dhe vetëm se kishte puthur një burrë tjetër. U kapërdi me zor, duke u rrekur të fitonte zërin që thuajse i kishte humbur.

- Atë ditë, pas ngjarjes në kuzhinë, më çuan për të lindur, - tha. - Për disa muaj, qëndrova bashkë me foshnjën në infermieri, por pastaj... - Fjalët i mbetën në grykë. U mundua të fliste, por një lëmsh që po e përvëlonte, i ishte mbledhur në fyt.

- Ku e ke foshnjën? - e pyeti Madalena me zë të ulët, pastaj shtrëngoi cepin e librit dhe kyçet iu zbardhën plotësisht, kurse sytë i dukeshin pa jetë.

- Ma morën, - arriti të thoshte Klara. - Erdhi një grua dhe ma mori. - Ishte hera e parë që i thoshte këto fjalë me zë të lartë. Papritmas, iu morën mendtë dhe iu përzje. U ngrit, tërhoqi karrigen dhe fshiu lotët që i rridhnin faqeve.

- Oh, jo, - ia behu Madalena. - Shpresoja se të kishin lënë të lirë. Pas ngjarjes në kuzhinë, kujtova se të kishin ardhur prindërit dhe të kishin marrë. Këtë gjë i thosha vetes, gjithsesi. Nuk do ta kapërdija dot nëse do të të kishte ndodhur diçka e keqe, sepse gjithçka ndodhi ngaqë më mbrojte mua. Por tani, të paskan marrë foshnjën... - tha dhe uli kokën e rrufiti hundët, ndërsa lotët po i rridhnin çurg.

Klara ia shtrëngoi fort dorën Madalenës.

- S'ka gjë. Do të vijë një ditë që do ta takoj sërish time bijë.

Nuk e di se kur apo si, por do ta takoj. Tani për tani, duhet thjesht të mbahem pas kësaj shprese e të bëj gjithçka që më thonë. Në njëfarë mënyre, duhet ta bind doktor Roaçin se jam shëruar.

Madalena ngriti kokën, kafshoi buzën dhe nisi të rrëmonte lëkurën rreth gishtit të madh të dorës.

- Çfarë ke? - pyeti Klara. - Ke ndonjë hall?

Madalena ia nguli sytë Esterit.

- Bëj kujdes, - tha. - Doktor Roaçi ia bëri atë edhe asaj.

Klara u kthye për të parë Esterin.

- Çfarë i bëri? - pyeti. - Çfarë ka Esteri? Kujtova se po flinte.

- E vërtetë, po fle, - tha Madalena, - sepse tani ajo s'bën gjë tjetër, veçse fle. Para kësaj, doktor Roaçi e pyeste vazhdimisht për detajet e lidhjes së saj. I shoqi kishte thënë se ajo ishte sjellë si një kuçkë e rëndomtë, kurse doktor Roaçi i tha se e vetmja mënyrë për t'u shëruar, ishte t'i tregonte gjithçka. Donte të dinte të gjitha detajet, edhe ato më të voglat. Në fillim, nuk pranoi, por doktor Roaçi i tha se nuk do ta linte kurrë të lirë, nëse nuk bashkëpunonte. Mandej, kur, më në fund, pranoi dhe i tregoi gjithçka, ai i kërkoi që të bënte me të gjithçka që kishte bërë me të dashurin. E detyroi të bënte seks me të.

Klara shtrëngoi nofullat dhe një valë e nxehtë tërbimi i përshkoi pjesën e poshtme të kafazit të kraharorit.

- E lëndoi shumë?

Madalena mohoi me kokë.

- Deshi ta kapte me zor, por Esteri i ra me shkelm, - iu përgjigj dhe bëri me shenjë mes shalëve. - Besoj se e kupton se ku. Një javë më pas, u zhduk. Kur e kthyen sërish në pavijon, infermiere Trençi tha se kishte qenë në koma të simuluar me insulinë. Esteri ishte mirë, por jashtëzakonisht e lodhur. E lanë të qëndronte shtrirë për disa kohë. Por pastaj, ndodhi diçka. Ajo thotë se në pavijon kishte hyrë një burrë. Mendoj se kjo e ka trembur për vdekje.

Klara u vrenjt.

- Një burrë ka hyrë në pavijonin e grave? Si është e mundur? - pyeti ajo.

- Ai kishte ardhur bashkë me marangozët, të cilët po rregullonin një vrimë në tavan apo po vendosnin një derë të re. Nuk jam shumë e sigurt.

- Nuk i bëri keq, apo jo?

- Jo, - iu përgjigj Madalena. - Nuk e besoj. Por, pas kësaj, Esteri nuk reshtte së pyeturi se ku kishe përfunduar ti. Nuk pushonte. Thoshte pa pushim "Ku është Klara? Ku është Klara?".

Klara u ngrit në këmbë, e trembur.

- Unë? - pyeti. - Pse duhej të pyeste për mua?

Madalena tundi kokën.

- Nuk e di, - u përgjigj. - Të dyja pyesnim veten se ku kishe përfunduar, por kjo ishte ndryshe. Ajo ishte e xhindosur. Sikur jeta e saj do të kishte kuptim vetëm po të të gjente ty. I pyeste të gjithë se ku mund të kishe përfunduar. Pas kësaj, doktor Roaçi i nisi një mjekim që e mban gjithë kohën në gjumë. Kur fle, duket si e vdekur. Kur zgjohet plotësisht dhe mund të flasë, nuk më tregon asgjë. Druan se, po të flasë me mua, do t'i harrojë gjërat. Kjo ka ndodhur thuajse para dy muajsh.

Klara ia nguli sytë Esterit.

- Po e zgjuam, do të fillojë të flasë?

- Mbase, - tha Madalena. - Ndonjëherë flet, ndonjëherë rri e heshtur. Varet nga dita.

Klara e preku me butësi Esterin te krahu dhe e tundi ngadalë.

- Ester? - tha. - Ester, më dëgjon?

Ajo lëvizi kokën shumë ngadalë. Madalena ishte ulur përpara në karrige dhe vështronte përqark dhomës për t'u siguruar që s'po i shikonte njeri. Roja përgjegjës për dhomën e argëtimit ishte ulur në një tavolinë dhe po lexonte një revistë. Madalena e kapi nga duart Esterin dhe e tërhoqi me kujdes përpara.

- Ester, zgjohu. Klara ka ardhur këtu dhe do të flasë me ty. - Pjesa e sipërme e trupit të Esterit u përkul përpara, por koka i varej pas dhe sytë i mbante ende mbyllur. Madalena nuk e tërhoqi më dhe e la të fundosej sërish në jastëk. - Më dëgjove, Ester? Ka ardhur Klara. Është këtu, pranë teje.

- Ester, - tha Klara dhe deshi të thërriste, por e mbajti veten. Iu afrua më shumë e u mbështet te krahu i kolltukut, duke u zgjatur t'i fliste në vesh. - Jam unë, Klara. Madalena më tha se doje të flisje me mua. Çfarë kishe? Çfarë doje të më tregoje?

Esteri puliti qepallat dhe ngriti kokën nga jastëku.

- Të lumtë! - tha Madalena. - Zgjohu, Ester. Ka ardhur Klara.

E mban mend Klarën?

Esteri kapsalliti sytë dhe, më në fund, i hapi. Vështroi vëngër Madalenën, mandej, mbuloi fytyrën me duar dhe mori frymë thellë.

- Ester, - tha Klara, - pse e kishe pyetur doktor Roaçin se ku isha unë? Do të më tregosh ndonjë gjë?

Esteri i lëshoi duart në prehër dhe u kthye ngadalë nga Klara, ndërkohë, një rrëke e hollë jarge i varej nga buza e poshtme.

- Ku është Klara? - pyeti duke folur ngadalë dhe duke i shqiptuar keq fjalët.

- Jam këtu, - foli Klara. - Hapi sytë dhe më shiko. Jam pranë teje.

Esteri u rrek t'i hapte qepallat e të përqendrohej te fytyra e saj. E bardha e syve ishte e skuqur dhe iridat i kishte pa jetë.

- Klara, - tha, - në pavijon u fut një burrë.

- E di, - ia ktheu Klara. - Më tha Madalena.

- Unë po flija dhe ai më zgjoi.

- Çfarë ndodhi? - e pyeti. - Të bëri gjë? Të lëndoi?

Esteri mohoi me kokë.

- Më shkundi nga supet dhe më frikësoi, pastaj, më pyeti për ty. Më pyeti nëse të njihja.

Zemra i fërgëlloi. Klara nisi të rrëmonte me thonj pëllëmbët e duarve.

- Si ishte? - pyeti. - Ta tha emrin?

- Flokët i kishte të errët dhe sytë ngjyrë kafe. - Esteri mbylli sytë dhe, për një sekondë, Klara u frikësua se mos ra sërish në gjumë. Pastaj, në buzët e saj u dallua një buzëqeshje e zbehtë. - Ishte shumë simpatik.

Klara mezi mbushej me frymë.

- Ester, çfarë të tha ai njeri?

Ajo u kapërdi dhe kapsalliti sytë.

- Më tha: "Thuaji Klarës që po punoj me grupin e marangozëve dhe që kam ardhur ta marr me vete".

- Kush ishte? - pyeti Klara dhe qimet e krahëve iu ngritën përpjetë. - Kush erdhi të më marrë? Si e kishte emrin, Ester?

- Bruno, - iu përgjigj Esteri. - Ishte Brunoja.

KAPITULLI 17



Izi

Mëngjesin tjetër, pas ditës kur e mbyllën në kube, Izi u tërhoq zvarrë për të dalë nga thesi i gjumit dhe eci me mundim drejt tualetit të Aleksës. Gjymtyrët i kishte si të ngrira dhe muskujt të tendosur, si të ishte zënë keqas me dikë. Lau fytyrën dhe hodhi një sy nga pasqyra e tualetit. Shikimin e kishte të turbullt dhe flokët të shpupuritur. U ul të urinonte dhe, për herë të parë, vuri re se gjunjët i kishte të gërvishtur e të mavijosur. Bërrylat dhe parakrahët i ishin mbuluar nga njolla të errëta blu, kurse lëkura në kyçet e duarve i ishte rrjepur dhe gjakosur. Madje, edhe gishtat e mëdhenj të këmbës i kishte të mavijosur. Papritmas, ndjesia sikur e kishin futur në grackë, iu rikthye. Nuk i kushtoi rëndësi, por u ngrit nga tualeti dhe iu avit dritares. Jashtë, dita ishte e zymtë dhe me shi. Ashtu ndihej edhe ajo: gjithë mllef dhe e dëshpëruar.

Mirë që kishin vendosur të ktheheshin në shtëpinë e Aleksës, në vend që ta kalonin natën pranë liqenit, sepse do të ishin bërë qull nga shiu, për të mos përmendur çka mund të ndodhte kur Shenoni t'i ndiqte e t'u hapte telashe. Pasi e kishin nxjerrë nga kubeja, Izi ishte dridhur gjatë gjithë kohës dhe thesi i hollë i gjumit nuk do të mjaftonte për ta ngrohur. Rrugës kur po ktheheshin në qytet, kishte ndezur kondicionerin e makinës dhe

brenda ishte bërë aq shumë vapë, saqë Aleksa dhe Etani kishin filluar të ankoheshin.

Pas një mëngjesi të shpejtë me lëng portokalli dhe drithëra, Aleksa e la Izin në fund të rruginës së shtëpisë së prindërve kujdestarë dhe i premtoi se do të kthehej më vonë për të parë një film. Edhe pse nuk ishte në humor, Izi i ishte shumë mirënjohëse asaj, që përpiqej t'ia hiqte nga mendja atë që kishte ndodhur në Uillard. Mblodhi shpatullat që ta zinte sa më pak shiu, dhe nxitoi përgjatë rrugës së shtruar, duke shmangur pellgjet e ujit. Nuk i hiqej nga mendja imazhi i Etanit buzë trotuarit, kur e lanë një natë më parë pranë shtëpisë dhe ajo ishte varur në dritaren e hapur të pasagjerit. Në fillim, kishte menduar se ai po përpiqej ta puthte dhe i ishte larguar, por pastaj kishte kuptuar se thjesht po e përshëndeste dhe ishte skuqur nga sikleti. Ai e kishte pyetur për të njëqindtën herë nëse ishte mirë dhe kishte këmbëngulur që ta mbante pulovrin deri të hënën, kur fillonte shkolla, por ajo nuk kishte pranuar. Gjithçka kishte ndodhur shumë shpejt dhe nuk donte që ai të mendonte se, meqë u nda nga Shenoni, do të bëhej e dashura e tij. Nuk ishte ende e sigurt në duhej t'i besonte dikujt që i pranonte pa të keq lojërat dhe rrengjet e liga të Shenonit. Gjithsesi, e mbajti për vete medaljonin me emblemën e grupit "Green Day", që kishte gjetur në xhepin e pulovrit. E fërkoi me gishtin e madh të dorës, pastaj, mori frymë thellë dhe hapi derën që të çonte në kuzhinën e Pegit.

Zakonisht, të dielave në mëngjes, Herri bënte petulla dhe të tre rehatoheshin në shtëpi me pizhame, duke lexuar libra vizatimorë dhe duke plotësuar fjalëkryqe deri në mesditë. Ato pak orë kur qeshnin e bisedonin dhe kur Pegi e Herri e ndihmonin me detyrat e shtëpisë, e bënin të ndihej sikur ishte pjesë e një familjeje të vërtetë. Në ato çaste, tek mendonte për proshutën e thekur, petullat me kos, të mbuluara me shurup panje, ndjeu që po i gërryenin zorrët. Kur hyri në kuzhinë, Pegi dhe Herri ishin veshur dhe ishin ulur në tavolinë, me filxhanët e kafesë në duar dhe gazetën e së dielës të palosur me kujdes mes pecetave të tavolinës së ngrënies. Pegi ngriti kokën, u tremb dhe i ngriu buzëqeshja në fytyrë. Herri ktheu karrigen dhe ia nguli sytë Izit gjithë seriozitet.

Izit i ngriu gjaku. Me sa duket, duhej ta kishin marrë vesh për festën në bregdet. I kishte gënjyer kur u kishte thënë se do ta kalonte natën në shtëpinë e Aleksës, prandaj tani, ata do t'i thoshin se duhej të largohej nga shtëpia. E ndiente. E la çantën e shpinës t'i binte nga supet dhe u ul e po priste zemërngrirë. Teksa priste, sytë ia kishte ngulur fotos së presidentit Klinton dhe Monika Levinskit në faqen e parë të gazetës.

- U kënaqe mbrëmë? - e pyeti Pegi, duke u munduar të buzëqeshte.

- Gjithçka shkoi mirë, - iu përgjigj dhe po vriste mendjen nëse po e provokonin. Vendosi t'ua thoshte troç. - Por unë...

- Duhet të të themi diçka, - e ndërpreu Herri. Uli syzet dhe fshiu duart pas pantallonave. Pegi lëvizi në karrige dhe kyçet e duarve iu bënë borë të bardha teksa shtrëngonte me sa fuqi kishte filxhanin e kafesë.

- Së pari, kemi disa lajme të mira, - tha Pegi. Zëri iu drodh dhe qëroi fytin. Izi ia nguli sytë dhe një lëmsh përvëlues iu mblodh në fyt e nuk po e linte të merrte frymë. Çfarë mund t'i thoshte vallë Pegi që ta zbuste situatën? - Gjeta një infermiere që ka punuar në Uillard. Mendojmë se mund të jetë kujdesur për Klarën. Nëse dëshiron, mund të shkojmë të bisedojmë me të.

Izi pohoi me kokë dhe zemra sa s'po i dilte vendit.

- Mendon se e di çfarë i ndodhi Klarës? - arriti të thoshte. - Apo vajzës së saj?

- Nuk e di, - ia ktheu Pegi. - Por do ta pyesim. Nëse nuk ka ndonjë informacion, të premtoj se do të mundohemi ta zbulojmë bashkë.

Bashkë. Izi u përlot. Pegi i tha se do të mundoheshin ta zbulonin bashkë. Pra, nuk do ta largonin. Mori frymë thellë e lehtësuar. Mandej, Herri vështroi Pegin, për ta mbështetur dhe për të dhënë miratimin e tij.

- Ka dhe diçka tjetër, - tha vetullngrysur. - Ka të bëjë me nënën tënde.

Izi ngriu. Herri dhe Pegi ia zinin shumë rrallë në gojë nënën. Çfarëdo që t'i thoshte Herri, e ndiente se ishte diçka e keqe. E kuptonte nga çehrja e fytyrës.

- Ç'i ka ndodhur? - pyeti dhe një lëmsh iu mblodh në stomak.

Pegi e përkëdheli. Izi ndjeu sikur po i lëvizte diçka në kokë, sikur truri po ndalonte dhe do të pësonte goditje.

- Mbrëmë, kishte pësuar hemorragji cerebrale - tha ai. - Ishte në qeli dhe vetëm sot në mëngjes e morën vesh se kishte probleme.

Izi u kapërdi.

- Më vjen shumë keq! - tha Pegi, e përlotur. - Është në koma. Mjekët thonë se nuk shpëton.

Izi ia nguli sytë Pegit dhe po përpiqej të gjente fjalët e duhura. I dukej sikur në vend të gjuhës kishte çelik, kurse buzët i ndiente të rënda e të padobishme. Ajo i fërkoi dorën dhe gishtat e butë prekën kyçet e rrjepura të Izit, e cila uli vështrimin dhe gulçoi.

- Çfarë të ka ndodhur? - e pyeti Pegi.

Izi largoi dorën dhe e mblodhi grusht në prehër.

- Asgjë. U rrëzova kur po provoja patinat me rrota të Aleksës. Edhe vetë u habit sa shpejt e sajoi këtë gënjeshtër. Çfarë kishte ndryshuar nga dje në sot? Kapi çantën e shpinës dhe u ngrit, duke e shtyrë karrigen nën tavolinë.

- Je mirë? -pyeti Herri. - Nuk do të dish se çfarë thonë mjekët?

- Nesër, pasi të mbarosh mësimin, mund të të shoqërojmë që t'i bësh një vizitë, - tha Pegi. - Gjithmonë, nëse ke dëshirë.

Izi rrëmoi me thonj pjesën e pasme të karriges. *E ç'të mirë do t'i sillte kjo?* mendoi.

- Jam shumë e lodhur. Nëse s'e keni problem, po bëj një dush dhe po shtrihem të fle.

- Të të përgatis diçka për të ngrënë? - e pyeti Pegi.

- Nëse ke uri, mund të të bëj petulla, - tha Herri.

Izi mohoi me kokë dhe u largua nga dhoma. Këmbët dukej sikur po i hiqte zvarrë. Kishte ngjitur gjysmën e shkallëve kur ngadalësoi hapat dhe u kap pas parmakut. Zemra po i rrihte shpejt. Kur arriti në krye të shkallëve, korridori iu turbullua. U mbështet te kolona kryesore sa të fitonte sërish ekuilibrin. Pas një minute të gjatë, shkoi në dhomë, lëshoi çantën përdhe dhe vrapoi për në tualet.

Hapi kapakun dhe i nxori të gjitha drithërat që kishte ngrënë në shtëpinë e Aleksës, por ende i vinte për të vjellë dhe i dukej sikur ezofagu po i dilte vendit e po rrëshqiste si një spirale e gjakosur në fund të sifonit. Më në fund arriti të merrte frymë e

lehtësuar dhe nuk po i vinte më për të vjellë. Pështyu pa pushim, pastaj shpëlau gojën dhe u ngrit më këmbë. Një kanoçe përgjysmë me *Coca-Cola* ndodhej në anë të lavamanit. E piu atë që kishte mbetur, me shpresën se lëngu me aromë karameleje do t'ia hiqte shijen e hidhur që kishte në gojë.

Ende e trullosur, mezi shkoi deri në dhomën e gjumit dhe u plandos në krevat, duke u kthyer në anën e preferuar, dhe shtrëngoi jastëkun në kraharor. I mbylli sytë me zor dhe po përpiqej t'i ndalonte lotët, por ishte e kotë. Për dhjetë vjet radhazi, e kishte tmerruar ideja për ta vizituar të ëmën në burg. Kishte frikë se mos ajo dukej e sillej si e çmendur ose nuk do ta njihte kush ishte. Në këto çaste, nuk dëshironte asgjë tjetër, veçse ta takonte. Thellë-thellë, shpresonte se do të vinte një ditë kur ajo do të shërohej ose do të binin të gjitha akuzat ndaj saj. Ndoshta ndodhte ndonjë mrekulli dhe dilte në dritë se vrasja e të atit kishte qenë e gjitha një keqkuptim. Ndoshta e kishte vrarë ndonjë hajdut dhe nëna e Izit, duke qenë dëshmitare e vdekjes së dhunshme, kishte luajtur përkohësisht nga mendtë. Kur e vërteta të dilte në shesh, nëna do të lirohej dhe do të ishin sërish një familje. Me kalimin e viteve, Izi kishte thurur në mendje qindra skenarë të ndryshëm, por nuk pranonte asnjërin prej tyre, e sigurt se nuk ishin gjë tjetër veçse imagjinata të parealizueshme të një vajze të vogël të humbur. Në atë çast, gjithçka kishte marrë fund. Asnjë nga skenarët nuk do të bëhej realitet. Izi do të mbetej jetime. Mundësia për të pasur sërish një nënë të vërtetë, sado e vogël që ishte, u zhduk njëherë e përgjithmonë.

Iu drodhën supet dhe kafshoi jastëkun, e habitur edhe vetë nga emocionet e fuqishme që e kishin pushtuar. Për një kohë të gjatë, e kishte mbajtur kokën lart dhe nuk ishte dorëzuar, aq sa ia kishte mbushur mendjen vetes se ishte e pathyeshme. Në këto çaste, gjithçka po i shembej para syve. E dinte se një ditë gjërat do të ndryshonin, por ende jo, jo tani, jo kështu. Kapsalliti sytë e përlotur, mandej, ngriti kokën dhe pa nga komoja. Kartolinat dhe letrat e nënës ishin aty, të futura në një zarf, të fshehura pas çorapeve dhe të brendshmeve.

U ngrit dhe fshiu sytë. Zemra i rrihte fort. Leximi i letrave mund t'i përmirësonte gjërat ose mund t'i përkeqësonte. Iu

kujtuan zarfet në valixhen e Klarës. Jeta e saj do të kishte marrë një rrjedhë tjetër, nëse ato letra do të ishin postuar dhe nëse Brunoja do t'i kishte lexuar. Ndoshta do ta kishte nxjerrë Klarën nga qendra "Long Ajlënd" para se të dërgohej në Uillard. Ndoshta do të ishin martuar, do të kishin krijuar një familje dhe do të kishin jetuar të lumtur përgjithmonë.

Në ato çaste, Izi pyeste veten nëse gjërat do të kishin qenë ndryshe, po t'i kishte lexuar letrat e nënës. Ndoshta përgjigjet që i kishte kërkuar aq shumë, kishin qenë aty, gjithë kohës. Stomaku iu pështjellua. Pavarësisht se çfarë shkruhej në letra, tashmë ishte tepër vonë që gjërat të ndryshonin. Gjithsesi, kishte nevojë të mësonte të vërtetën. Në letrat e nënës ose do të ishte përshkruar figura e gruas që kishte qenë dikur, plot dashuri dhe adhurim, ose përmes tyre do të mësonte njëherë e përgjithmonë se ajo ishte vërtet e çmendur.

U ngrit dhe nxori letrat nga sirtari i parë i komosë, pastaj, u ul këmbëkryq mbi krevat, me zarfin e fryrë të vendosur mbi shallin e leshtë përpara saj. Hapi kapësen metalike, pastaj kapakun dhe i la kartolinat dhe letrat të përhapeshin gjithandej. Pirgu i madh i zarfeve të përmasave dhe ngjyrave të ndryshme, i solli ndër mend Shën Valentinin kur ishte në shkollën 9-vjeçare, ku të gjithë merrnin kartolina nga shokët dhe shoqet e klasës. Ngaherë pyeste veten nëse do të merrte aq shumë kartolina sa fëmijët e tjerë dhe priste me padurim të shihte se ç'ishte shkruar nga ana e pasme. Do të ishte vetëm një emër apo vetëm inicialet SHNP, shokë të ngushtë përgjithmonë, apo thjesht SHN, shokë të ngushtë?

I ktheu përmbys një e nga një të gjitha zarfet, duke kontrolluar vulën postare e duke i renditur sipas rendit kronologjik. Do t'i lexonte sipas viteve, duke filluar me muajt e parë pas burgosjes së saj. Në fillim, kishte marrë nga një letër çdo muaj, pastaj, me kalimin e kohës, letrat ishin rralluar, duke shkuar në tri apo katër në vit. Izi mendonte se, bashkë me letrat e zakonshme, mes tyre kishte edhe kartolina ditëlindjesh e Krishtlindjesh. Të gjitha kishin të njëjtën adresë: Burgu Shtetëror i Bedfordit.

Mori frymë thellë dhe kapi letrën e parë, me vulën postare të korrikut 1986, një muaj pasi nëna ishte dënuar. Hapi zarfin. O tani, o kurrë! Vuri gishtat mbi buzët që i dridheshin, dhe filloi të lexonte.

Përshëndetje, vogëlushe!

Si je? Shpresoj të jesh mirë. Më ka marrë shumë malli për ty! Dua të dish se më vjen shumë keq për atë që i ndodhi babait tënd. E di që, tani për tani, s'e kupton se çfarë po ndodh, por një ditë, do ta kuptosh, të premtoj. Më vjen shumë keq që isha e sëmurë për një kohë kaq të gjatë dhe nuk isha në gjendje të të qëndroja pranë. Kur u përmirësova, ishte tepër vonë. E di që je e trishtuar dhe e hutuar, zemër. Më vjen shumë keq për këtë. Të lutem, eja dhe më tako. Më ka marrë malli aq shumë, saqë po më copëtohet zemra. Të lutem, bëhu vajzë e mbarë për gjyshen tënde. Do të shihemi së shpejti.

Të dua sa qielli e toka bashkë.

Mami.

Izit i ndritën sytë. Të dua sa qielli e toka bashkë. Nëna ia përsëriste këtë shprehje çdo natë, kur e shoqëronte në krevat, para se të fikte dritën e të venitej në korridorin e gjatë. Në njëfarë mënyre, Izi e kishte harruar. Grisi zarfin tjetër. Ishte një kartolinë ditëlindjeje.

Në kapakun e saj shkruhej "Gëzuar ditëlindjen, vogëlushja ime!" Brenda, nëna kishte shkruar "Më ka marrë malli shumë dhe të dua sa qielli e toka bashkë." *Ku mund ta ketë blerë këtë kartolinë ditëlindjeje një e burgosur?* pyeste veten Izi. Letra e radhës ishte pak a shumë e ngjashme: një letër drejtuar një tetëvjeçareje, jeta e së cilës tashmë kishte marrë një tjetër rrjedhë; më shumë shfajësime dhe kërkesa për një vizitë. Në letrat e mëvonshme, nëna nuk i kërkonte më që të shkonte ta vizitonte, përkundrazi, filloi t'i shkruante gjithçka që donte t'ia thoshte personalisht, të gjitha këshillat që donte t'i jepte bijës së vetme. Izi ishte rrëmbyer aq shumë nga leximi i letrave dhe nga padurimi për të gjetur ndonjë rresht apo grup fjalësh që konfirmonin sëmundjen mendore të së ëmës, sa shpesh harronte të merrte frymë. Por, deri tani, nuk kishte gjetur asgjë. Gjithashtu, duke lexuar letrat, vuri re se nëna nuk ia përmendte më të atin, sikur ai të mos kishte ekzistuar kurrë.

Një ndjenjë keqardhjeje e pushtoi të tërën dhe filloi të pendohej. Mos ndoshta ishte gabuar gjithë kohës? Mos ndoshta i kishte çuar dëm vitet kur kishte pasur frikë? Nga këto letra,

dukej se nëna gëzonte shëndet të plotë mendor. Sa më shumë lexonte, aq më shumë e ndiente se po e humbiste sërish nga e para, ama, nuk po e kuptonte ende se çfarë kishte ndodhur para dhjetë vjetësh.

Kishte lexuar thuajse dyzet letra deri në orën tre pasdite. Pegi ishte ngjitur në dhomën e saj disa herë, kishte trokitur lehtë dhe e kishte pyetur nëse ishte mirë, nëse donte t'i sillte diçka për të ngrënë apo për të pirë. Sa herë që vinte aty, Izi i thoshte se nuk donte asgjë, vetëm se kishte nevojë të rrinte vetëm, dhe e falënderonte që tregohej aq e kujdesshme. Në të vërtetë, Izi nuk mund të kapërdinte dot asgjë, edhe po të donte. Stomakun e kishte të trazuar dhe i dukej sikur po i ziente.

Pas një ore, fjalët po i ngatërroheshin dhe e kishte gjithnjë e më të vështirë t'i mbante sytë hapur. Letra që kishte në dorë, ishte futur brenda kartolinës së urimit për 13-vjetorin e ditëlindjes. Ishte e zhubrosur, prandaj mezi lexohej. Vendosi të lexonte edhe një letër, pastaj do të bënte një dush dhe do të shtrihej të flinte. Por, në atë çast, frymëmarrja iu bllokua dhe brofi menjëherë në këmbë. I lexoi edhe një herë fjalët.

> *E vrava babanë tënd, sepse e gjeta në dhomën tënde, duke bërë gjëra që një baba nuk duhet t'ia bëjë kurrë vajzës. Më vjen keq që nuk ta kam treguar më parë, por prita derisa të ishe aq e rritur sa të kuptoje se çfarë ndodh zakonisht mes një burri dhe një gruaje. Mos u mërzit, zemër. Unë e ndalova para se të shkonte shumë larg.*

Izi lëshoi letrën dhe vuri duart në gojë. Në pjesën fundore të fytit, ndjeu një shije acidi. Jo, s'mund të jetë e vërtetë. Është thjesht një ëndërr e keqe! Kush mund t'i thotë së bijës trembëdhjetëvjeçare se i ati e ka ngacmuar? Nëna gënjente! Në fund të fundit, ishte e çmendur. Babai i Izit nuk do ta kishte bërë kurrë një gjë kaq të tmerrshme, apo jo? Duke u dridhur e tëra, u mblodh duke marrë pozicionin e fetusit dhe ia nguli sytë trëndafilit të vetëm të letrës së murit. Për shkak të shikimit të turbullt, i dukej sikur petalet e kuqe pulsonin, si një vizatim i animuar i zemrës së saj të copëtuar e të gjakosur.

Mandej, makthi iu kthye sërish me gjithë forcën e tij: dora e djersitur e demonit mes këmbëve të saj, krahu i rëndë që e shtrëngonte fort që të mos ngrihej. Demoni u ngrit dhe u zgërdhi. Përzierja e çuditshme e neverisë dhe ekstazës i gërshetonte tiparet në një maskë të llahtarshme. Pastaj, maska u shndërrua në një fytyrë njerëzore dhe Izi e njohu demonin. Ishte babai i saj.

Kërceu nga krevati, vrapoi për në tualet dhe ra më gjunjë përpara sifonit. Kraharori dhe stomaku i ishin bërë plagë nga dhembjet teksa villte pa pushim. Më në fund, filloi të merrte frymë lirshëm dhe u përkul mbi vaskë, kurse pjesën e sipërme të dorës e vuri te sytë. Valë të nxehta paniku, që i rrihnin rreth zemrës si një ngarkesë elektrike, ia ndezën qafën dhe kraharorin. Ndjeu lëkurën t'i ngjethej e t'i therte në çdo milimetër, ndjeu çdo muskul të krahëve e të këmbëve t'i tendosej. U mundua të merrte frymë thellë dhe ta nxirrte frymën ngadalë, ndërsa kokën e vërtiste sa andej-këtej. Kuptoi se gjithçka që kishte besuar, ishte thjesht një gënjeshtër, një gënjeshtër që e kishte trilluar vetë.

E ëma kishte hequr dorë nga jeta dhe liria vetëm për të mbrojtur atë. Gjithë këto vite, Izi kishte menduar se nëna ishte e çmendur, kurse i ati një njeri i dashur, që pagoi çmimin e çmendurisë të së shoqes. Gjithë këto vite i kishin ikur kot, sepse nuk kishte qenë aq e guximshme sa t'i kërkonte së ëmës t'i tregonte versionin e saj të historisë.

Befas, diçka i regëtiu në tru. Ashtu si pjesëza e fundit e një pazëlli gjigant që, më në fund, u vendos në vendin duhur, edhe në këtë histori befas gjithçka filloi të kishte kuptim. Nëna kishte qenë gjithmonë tepër e dhënë pas saj, prandaj edhe rreziku më i vogël që mund ta kërcënonte Izin, bënte që atë ta kapte paniku. Një herë, kur po psonisnin në dyqanin e ushqimeve, Izit i kishte shpëtuar karroca nga dora, ndërsa nëna po shikonte pjeprat. Kishte ecur disa hapa më tutje, deri në fund të korridorit, për të parë vitrinën e lodrave. Kur e ëma kishte vënë re që e kishte humbur nga sytë, kishte nisur të thërriste pa pushim emrin e saj aq fort, saqë administratori i dyqanit kishte ardhur me vrap. Izi u kthye me nxitim në sektorin e ushqimeve dhe e kapi të ëmën te bërryli, e vështroi në sy gjithë ankth, ngaqë kishte frikë se mos kishte luajtur mendsh. Nëna ra më gjunjë dhe nisi të qante me dënesë, duke i thënë që të mos largohej më kurrë prej saj.

Tek kishte parë të shoqin që donte të përdhunonte vajzën e vogël, nënës së Izit i kishte kërcyer gjaku në kokë dhe e kishte qëlluar. Në këtë mënyrë do të silleshin shumica e nënave, por pa dyshim që pjesa më e madhe e tyre do të njoftonin policinë dhe s'do ta qëllonin të shoqin në kokë me çifte. Por, të paktën, tani Izi e kuptonte se çfarë kishte ndodhur.

Në letër, nëna e pranonte se kishte bërë gabim që e kishte vrarë të shoqin, por e kishte humbur mendjen për pak sekonda. E dinte pse po ndëshkohej. Avokati nuk mund ta bindte gjykatësin të tregohej i butë, sepse nuk zotëronte asnjë provë që babai mund të kishte bërë diçka të keqe. Nëna e saj nuk kishte pranuar që ajo t'i nënshtrohej kontrollit fizik, duke zgjedhur kështu të hiqte dorë nga liria e saj. Besonte se do të vinte një ditë kur do ta lironin me kusht dhe ato do të bashkoheshin sërish.

Izi kafshoi buzën. Gjithë këto vite, e vërteta kishte qenë aty pranë, duke pritur që ajo të hapte një zarf e të lexonte të zezën mbi të bardhë, por ishte treguar shumë kokëfortë për ta vënë re. Tani, nëna ishte në koma! Izi nuk do të kishte më asnjë mundësi t'i thoshte se, më në fund, e kishte kuptuar. Nuk do t'i jepej më kurrë mundësia t'i kërkonte falje që nuk kishte shkuar ta takonte.

Mendoi për Shenonin, nëna e së cilës ishte treguar moskokëçarëse për atë që i shoqi kishte bërë. Si mund të jetonte Shenoni çdo ditë me të kur e dinte se ajo s'kishte lëvizur as gishtin për ta mbrojtur? Duhej të ishte ndjesia më e keqe në botë. Pavarësisht gjërave të tmerrshme që i kishte bërë Shenoni, Izit i dhembte shpirti për të. Ah, sikur nëna e Shenonit të kishte bërë diçka për ta ndalur të shoqin, jeta e asaj do të kishte marrë një tjetër rrjedhë. Si mundej Shenoni të përballej çdo ditë me të ëmën? Si mund ta falte?

Izi mbuloi fytyrën me duar. Ndryshe nga e ëma e Shenonit, nëna e saj i kishte kaluar gjithë këto vite e vetme, duke menduar se nuk e donte asnjë. Pastaj, Izi u kujtua se kishte lexuar diku që njerëzit në koma i dëgjonin ndonjëherë të dashurit e tyre kur u flisnin. Nëna nuk kishte vdekur. Ajo mbahej në jetë përmes pajisjeve. Kishte ende kohë për ta parë, për t'i thënë lamtumirë. Do t'i thoshte Pegit që ta çonte të nesërmen në Bedford. Mbase nëna do ta dëgjonte kur t'i kërkonte të falur.

Kur u bind se mund të qëndronte në këmbë, u ngrit dhe hoqi rrobat. Gjunjët, bërrylat dhe këmbët, me të cilat kishte goditur nga brenda kubenë, i dhembnin ende, por tani, po i buçiste edhe koka. U fut në vaskën e zbrazët. Porcelani i ftohtë dhe i fortë dukej si gur varri teksa prekte lëkurën e saj. Me duart që i dridheshin si të një gruaje njëqindvjeçare, u mundua të mbyllte tapën dhe të hapte ujin e nxehtë. Teksa vaska mbushej, ia nguli sytë piletës përballë, pa menduar asgjë dhe e vetëdijshme vetëm për të ftohtin e të nxehtin, ndërkohë që uji i ngrohtë nisi t'i mbulonte këmbët. Kur niveli i ujit arriti në mes, hodhi shampo trupi mbi sfungjer dhe filloi të shkumëzohej, duke u fërkuar para e prapa me më shumë forcë se ç'duhej, dhe vëzhgonte si në ekstazë flluskat e bardha që i formoheshin në këmbë e krahë. Pa vragat e holla e të zbehta në krahë dhe pyeti veten nëse ishte prerë për të shtypur kujtimet e tmerrshme të asaj që i kishte bërë i ati. Mbylli rubinetin dhe u zhyt në ujin plot me flluska, pa lëvizur, teksa një pikim i ngadaltë e i vazhdueshëm i jehonte në vesh si një orë nënujore.

Pas disa minutash, kaloi duart mbi trup, duke fërkuar me gishta gjinjtë dhe pushin mes këmbëve. Sa herë kishte imagjinuar të bënte seks, sa herë kishte imagjinuar një burrë që i puthte gjinjtë e zhveshur dhe lëkurën e ngrohtë, që e prekte në të gjitha vendet e buta dhe intime? Sa herë kishte imagjinuar Etanin teksa bënte dashuri me të? Me qindra herë. Fatmirësisht, ajo nuk mbante mend që i ati ta kishte përdhunuar. A do të gjendej ndonjëherë dikush që t'i tregonte se çfarë kishte ndodhur në të vërtetë? Këto mendime i pështjelluan stomakun dhe i erdhi për të vjellë. U fërkua edhe një herë mes këmbëve, pastaj u ngrit dhe u shpëla në dush, duke e lënë rrjedhën e ngrohtë të ujit t'i çlironte qafën dhe supet. Më në fund, e mbylli ujin dhe zbrazi vaskën. U fshi me peshqir dhe veshi pizhame të pastra, pastaj shkoi në dhomë e u struk poshtë mbulesës.

S'do të lejoj që e shkuara të më diktojë të ardhmen, mendoi. *Asokohe, isha një njeri tjetër. S'do ta kaloj gjithë jetën duke paguar për mëkatet e tim eti. Nuk do ta bëj dhe nuk mundem ta bëj.*

KAPITULLI 18

Klara

Javët në vijim, pasi kishte folur me Madalenën dhe Esterin, Klara i kaloi duke menduar se ku mund të punonte Brunoja. Natën nuk vinte gjumë në sy dhe ditën ishte e shpërqendruar. Gjatë punës në lavanteri, i përziente çarçafët me peshqirët, këmishët e spitalit me përparëset. Kur përgjegjësja e vuri re gabimin, e transferoi në sektorin e rrobaqepësisë që gjendej në anën tjetër të korridorit, ku riparonte këmishët, pantallonat dhe këmishët e natës. E ulur në një stol, filloi të bënte qepje të vogla e të sakta, ndërkohë që mendonte se si të gjente Brunon. Deri tani, nuk kishte pasur sukses.

Një ditë pasi Esteri i kishte treguar Klarës se çfarë kishte ndodhur, kishte menduar të takonte doktor Roaçin për ta bindur njëherë e përgjithmonë se Brunoja ekzistonte. Në njëfarë mënyre, do të këmbëngulte që ai të sillte brigadën e marangozëve në zyrën e tij, një e nga një. Brunoja do të ishte mes tyre dhe do ta njihte Klarën e kështu do të vërtetohej se ajo kishte thënë të vërtetën gjatë gjithë kësaj kohe. Mandej, iu kujtua Madalena që i kishte thënë se doktor Roaçi kishte nisur t'i bënte qetësues Esterit, ngaqë sillej si e tërbuar, sikur jeta t'i varej nga gjetja e Klarës. Pse duhej t'i jepte qetësues kur mund t'i thoshte që të mos fliste? Mos

ndoshta kishte frikë se Klara mund të merrte vesh që Brunoja ishte në Uillard? Edhe po të ishte kjo arsyeja, pse e bënte këtë? Para se të shkonte te doktor Roaçi, duhej të bënte disa pyetje të tjera. Po atë pasdite, u ul përkrah Esterit në dhomën e argëtimit dhe e tundi me kujdes që ta zgjonte.

- Dua të të pyes për diçka, - tha Klara dhe u përkul përpara e i foli me zë të ulët.

Esteri kapsalliti sytë, ngriti kokën dhe i buzëqeshi me zor.

- E gjete Brunon? - e pyeti, duke i shqiptuar fjalët me vështirësi.

- Shshshttt, - pëshpëriti Klara. - Nuk dua të na dëgjojë njeri.

Esteri psherëtiu.

- Në rregull, - pëshpëriti.

- Thjesht poho me kokë nëse është po apo jo, mirë?

Esteri, me qepallat gjysmë të mbyllura dhe me buzët e lagura e të hapura, pohoi me kokë.

- Ia ke treguar doktor Roaçit emrin e burrit që u fut në pavijon? - pëshpëriti.

Esteri pohoi me kokë.

- I the që Brunoja po më kërkonte?

Esteri pohoi sërish me kokë.

Zemra e Klarës nisi të rrihte fort.

- Çfarë të tha doktor Roaçi?

Esteri shtrembëroi buzët gjithë neveri.

- Më tha se kisha halucinacione.

- Vetëm kaq? Ndaj nisi të të jepte qetësues?

Ajo mohoi me kokë.

- E pyeta për ty. Më tha se ishe shumë e sëmurë, pastaj e pyeta për foshnjën tënde. I thashë që babai ishte Brunoja.

- Edhe? - e pyeti Klara dhe mbajti frymën.

- Ai u habit që unë isha në dijeni për foshnjën.

- Të tha gjë që ma morën?

- Jo, - ia ktheu Esteri me mjekrën që i dridhej. - Më tha se s'duhej të fusja hundët, por të shikoja punën time.

Klarës iu duk se fytyra dhe kraharori po i merrnin zjarr. S'e imagjinonte dot pse doktor Roaçi nuk pranonte ta besonte historinë e Esterit. Esteri nuk fitonte gjë duke thënë se Brunoja ekzistonte vërtet. Pse doktor Roaçi nuk i shkonte deri në fund

kësaj historie e të zbulonte nëse Klara i kishte thënë të vërtetën apo jo? Kaq shumë e kishte tepruar me ato që kishte bërë - e kishte mbyllur atë, i kishte marrë vajzën - saqë nuk i pranonte gabimet? Apo mos ndoshta pas gjithë kësaj fshihej i ati i saj dhe ishte ai që e manovronte si marionetë doktor Roaçin?

Befas, në fytyrën e Esterit shihej veç ankth e dhembje.

- Më fal! - tha dhe shpërtheu në lot. - Ishte faji im.

- Çfarë? - e pyeti Klara dhe një lëmsh iu mblodh në stomak.

- S'duhej t'i kisha treguar doktor Roaçit për Brunon, - tha me zë të mekur.

- S'ka gjë, - ia ktheu Klara. - Ti thjesht po përpiqeshe të më ndihmoje.

- Po sikur doktor Roaçi ta ketë hequr qafe atë? - tha Esteri.

Klarës i hipi gjaku në kokë. Dhoma nisi t'i vinte rrotull. Nuk e kishte menduar kurrë një gjë të tillë. Doktor Roaçi mund ta pushonte me lehtësi nga puna Brunon dhe ta dëbonte nga spitali. Po pastaj?

Disa ditë më vonë, vodhi nga rrobaqepësia një palë pantallona dhe një këmishë burrash. Njomi flokët dhe i lëpiu nga pas. Pastaj, shkoi në lavanteri për t'u përvjedhur bashkë me pacientët meshkuj, duke marrë teshat e lara. Përgjegjësja e kapi dhe e mori mënjanë. E dënuan një javë në izolim, pastaj e lejuan të kthehej sërish në punë. Ajo pyeti pacientet e tjera nëse e kishin parë brigadën e marangozëve dhe nëse po, ku e kishin parë. Të gjitha i thanë jo, duke mohuar me kokë, me sy të çakërdisur. Ato donin thjesht t'i linin të qeta. Mendoi për një çast t'ia tregonte infermiere Trençit historinë e Esterit, me shpresën se asaj do t'i vinte keq për të, por pastaj, kuptoi se kështu do të rrezikonte shumë. Nganjëherë, i dukej e pamundur ta gjente Brunon, por duhej ta provonte. Nuk kishte rrugëzgjidhje tjetër.

Orët e para pas mesnatës ishin më të këqijat. Në atë kohë, fillonte të shqetësohej për Brunon, se mos e kishin pushuar nga puna dhe se mos ai nuk do të gjente dot mënyrën për ta shpëtuar. Shqetësohej se mos ai humbte besimin e hiqte dorë së kërkuari, shqetësohej se mos Esteri kishte parë ëndërr. Në fund të fundit, Klara s'kishte lënë gjë pa i treguar Esterit dhe Madalenës: se ajo dhe Brunoja ishin të dashuruar, se prindërit e saj nuk ishin

dakord, se i ati e kishte dëbuar nga shtëpia dhe se ajo priste një fëmijë. Ndoshta izolimi në Uillard dhe rënia në koma kishin bërë që e gjora të lajthiste. Ndoshta kishte imagjinuar gjithçka! Ky mendim po e mbyste Klarën, sikur në kraharor t'i kishin vendosur një pllakë të ftohtë graniti.

Për net me radhë, nuk kishte vënë gjumë në sy. Një mal dyshimesh dhe pyetjesh i kalonin në mendje e nuk e linin të qetë. Sa herë që ishte gati ta zinte gjumi nga rraskapitja, ideja e tmerrshme se Brunoja nuk ishte në Uillard, e bënte të ngrihej pupthi mbi shtrat, e pafrymë dhe ujë në djersë, me këmbë të ngatërruara në çarçafët e ndotur. Mandej, strukej mes teshave, qante dhe pyeste veten nëse do të ishte ndonjëherë e lirë, derisa e zinte gjumi.

Një ditë, në rrobaqepësi, ulur në një stol të fortë e me kurriz nga dritarja, me një shportë plot këmisha të sapokollarisura mes këmbëve, Klara pa përgjegjësen që hipi mbi një shkallë për të ndërruar një llambë. Ajo ishte një grua trupvogël dhe e moshuar, e cila çalonte dhe vinte vërdallë me mundim nëpër rrobaqepësi. Kishte veshur një fund të gjatë e të gjerë, që fëshfërinte në dyshemenë me dërrasa. Pacientet femra i thërriste "e dashur" dhe sigurohej që ato të mos e ngrinin kokën, por të përqendroheshin vetëm te puna e tyre. Nganjëherë, përdorte një bastun për të ardhur vërdallë, duke u ankuar se kockat i dhembnin fort për shkak të motit dhe, shpeshherë, ndalonte për të fërkuar këmbën e sëmurë. Për shkak të pranverës shumë të lagësht, kishte nisur ta përdorte çdo ditë bastunin.

Kur e pa përgjegjësen mbi shkallët e larta, Klara u struk kur ajo u lëkund dhe mend u rrëzua. Nuk e dinte se përgjegjësja kishte një këmbë të sëmurë, por, gjithsesi, vriste mendjen se pse do të rrezikonte të hipte në ato shkallë për të ndërruar llambën. Në rrobaqepësi, kishte tri llamba të djegura, përfshirë edhe atë mbi kokën e Klarës. Tavanet ishin tre metra e gjysmë të larta, kurse abazhurët gjendeshin thuajse tre metra lart nga dyshemeja. Sigurisht, në Uillard, kishte burra që merreshin me këto punë.

Befas, si një vetëtimë, i lindi një ide.

Nëse nuk mund të shkonte te Brunoja, mbase duhej të gjente një mënyrë që të vinte Brunoja tek ajo. Esteri i kishte thënë se punonte me brigadën e marangozëve, kurse Madalena i kishte

thënë se ata po meremetonin një vrimë në tavan apo ndoshta po montonin një derë të re. Klara hodhi një sy rreth e qark rrobaqepësisë, se mbase gjente diçka që ta thyente. Pasi pa për rreth një minutë dhe nuk gjeti gjë, zemra iu copëtua. Dyert ishin shumë të trasha, po ashtu edhe kasat. Muret ishin mbushur me rafte të hapura, ku vendoseshin veshjet dhe teshat e palosura; kishte me dhjetëra stola druri, tavolina dhe karrige me kurriz të lartë, por thuajse të gjitha orenditë ishin prodhuar me dru të fortë lisi apo panje. Trarët mbështetës të dhomës ishin më të mëdhenj se koka e saj. Kuptoi se ndryshe nga dritaret e pavijoneve, të cilat ishin mbuluar me rrjetë mbrojtëse, dritaret e rrobaqepësisë ishin të ekspozuara. Xhamat ndaheshin nga njëri-tjetri me ristela të holla druri, të cilat mund të thyheshin lehtë.

Me zemrën që i rrihte fort, u ngrit nga stoli dhe iu afrua shkallës nga po zbriste përgjegjësja. Para se të hidhte hapin e fundit, ajo humbi ekuilibrin dhe gati u rrëzua. Klara e mbërtheu prej krahu.

- Mund të të ndihmoj? - e pyeti.

Përgjegjësja, e bërë flakë e kuqe në fytyrë dhe me duart gjithë gunga që i dridheshin ende, shfryu e lehtësuar, pastaj drejtoi fundin.

- Faleminderit, e dashur, - i tha. - E kam zët të ngjis shkallë.

Të dyja bashkë i lëvizën shkallët nëpër dysheme dhe i vendosën poshtë llambës tjetër. Klara u ngjit dhe e ndërroi llambën pa pësuar asnjë incident, pastaj, i tërhoqën shkallët për ta çuar poshtë llambës tjetër, pranë dritareve ku ishte ulur Klara. Ajo mori frymë thellë dhe u ngjit sërish në shkallë, duke u munduar ta mbante veten e të mos i dridheshin këmbët. Nuk kishte zgjidhje tjetër. Duhej të largohej nga Uillardi. Duhej të gjente Brunon dhe Beatrisën. Duhej të bënte patjetër diçka ekstreme tani, para se ta humbte guximin.

Zgjati duart që të arrinte llambën dhe u përkul qëllimisht më shumë se ç'duhej, duke e anuar shkallën drejt dritareve. U shtir sikur humbi ekuilibrin dhe e ktheu përmbys shkallën dhe me majën e saj goditi xhamat e dritares. Dhoma u mbush me copëza xhami dhe ashkla druri që u përhapën gjithandej. Në sekondën e fundit, lëshoi shkallën dhe u rrëzua në dyshemenë prej druri me një zhurmë të mbytur. Shkalla ra mbi një raft dhe një grumbull

me këmisha të bardha e pantallona kafe rrëshqitën ngadalë. Rafti i sipërm u nda më dysh dhe shkalla u rrëzua përtokë duke bërë një zhurmë të fortë.

- O Zot i madh! - ulëriti përgjegjësja. - Je mirë, e dashur?

Dy ndihmësinfermierë hynë nxitimthi në rrobaqepësi duke vrapuar që të ndihmonin Klarën të ngrihej. Disa pacientë shikonin të trembur, kurse të tjerë mblodhën supet dhe po pëshpëritnin. Me fytyra të zverdhura, shumica u ulën të shikonin. Klara, së cilës po i dridheshin këmbët, u ngrit dhe shkundi fustanin.

- Jam mirë, - tha duke fshirë bërrylat. Kofsha i therte nga dhimbja dhe iu duk sikur shpatulla i kishte dalë vendit, por s'kishte ndër mend të qahej e ta çonin në infermieri.

E nervozuar dhe e bërë flakë në fytyrë, përgjegjësja urdhëroi që të gjithë t'i ktheheshin punës. Gratë morën stolat dhe iu përveshën sërish qepjes, disa duke qarë, disa duke mërmëritur, të tjera duke psherëtirë pas duarve që u dridheshin. Duke gulçuar dhe duke u mbështetur mbi bastun, sikur të ishte ajo që sapo ishte rrëzuar, përgjegjësja mori fshesën dhe ia zgjati Klarës.

- Më fal! - tha Klara, duke marrë fshesën. - Po mundohesha të ndihmoja.

- Mos u shqetëso për këtë, e dashur, - tha. - Thjesht pastroje këtë katrahurë, gjej një stol tjetër dhe vazhdo punën. - Shtrëngoi bastunin me të dyja duart dhe hodhi sytë përqark dhomës, duke nxjerrë gjuhën. - Do të bëja mirë të merrja dikë që të riparonte gjithë këtë dëm.

- Kur? - e pyeti Klara.

Përgjegjësja rrudhi vetullat.

- Sa më shpejt të mundem, - tha prerë. - Megjithëse s'e kuptoj se ç'ndryshim ka kjo për ty, e dashur.

Të nesërmen, pas mëngjesit, Klara, zemërngrirë, vrapoi drejt derës së rrobaqepësisë. Sytë i hodhi menjëherë te dritarja e thyer dhe rafti i shqyer, me shpresën se do të shikonte punëtorët duke punuar, por dritaren e kishin mbuluar me kompensatë, ndërsa raftin e kishin hequr. Mblodhi supet. Nëse marangozët kishin ardhur, ajo s'kishte pasur mundësi t'i shikonte. Shkoi në qoshe të dhomës dhe gjeti një stol mes grave të tjera, në këmbët e të cilave

kishte shporta të mbushura me çarçafë dhe këmishë nate. Mezi arriti të shkonte fillin në gjilpërë nga lotët dhe bota iu mjegullua.

Sa budallaqe dhe idiote u tregova, mendoi, duke kafshuar buzën fort. *Edhe po të kishin ardhur marangozët kur unë isha këtu, nuk ishte e sigurt nëse Brunoja do të ishte mes tyre. Ashtu siç i kishte thënë edhe Esteri, doktor Roaçi mund ta ketë hequr qafe ose ndoshta ka më tepër se një brigadë marangozësh.* Buka e thekur dhe e fortë, si dhe kumbullat e thara nga vakti i mëngjesit i kishin rënë si gur në stomak dhe gati sa nuk po villte. Një nga pacientet nisi të këndonte "Bye, bye, blackbird" me zë të lartë e duke stonuar. Një tjetër nisi të këndonte nën zë dhe tundte gishtat e hollë e të bardhë në ajër, si të ishte duke drejtuar një orkestër të padukshme. Klara mezi po e mbante veten që të mos u bërtiste të pushonin. Mandej, përgjegjësja erdhi për të bërë kontrollin dhe Klara u gëzua shumë kur gruaja pushoi së kënduari.

Nxori një këmishë nate të grisur nga shporta, uli kokën dhe iu përvesh punës, por, pa dashje, shpoi gishtin me gjilpërë. Bëri sikur s'kishte ndodhur gjë dhe vazhdoi të qepte një nga supet e këmishës. Përgjegjësja ecte nëpër dhomë duke çaluar dhe përplaste bastunin në dërrasat e dyshemesë. Një njollë e kuqe u duk në këmishën e natës që Klara kishte në duar, pastaj disa njolla të verdha. Klara futi gishtin në gojë, u çua nga stoli dhe e shtyu këmishën në fund të shportës, duke mallkuar nën zë. Gruaja që kishte pranë, mblodhi buzët në shenjë mosmiratimi dhe po e shikonte.

Pikërisht në atë çast, dëgjoi në korridor një zë mashkulli. Ktheu kokën andej nga vinte zëri, ndërkohë zemra po i buçiste në kraharor. Një burrë, me shpatulla të kërrusura, si të transportonte diçka të rëndë, po ecte mbrapsht përmes derës së rrobaqepësisë.

Dritat e tavanit binin mbi kokën e tij pa flokë. Bustin e kishte të shkurtër dhe të trashë, si të ishte xhuxh, por nga ana tjetër, gjymtyrët i kishte të gjata dhe të dobëta. Tallashi ia kishte mbuluar kominoshet me një shtresë të hollë pushi të verdhë. Tullaci tërhiqte këmbët zvarrë nëpër dhomë me njërën anë të kornizës së dritares në njërën dorë, duke u munduar të mos gërvishtte kasën e gjerë të derës. Klara mbajti frymën teksa shikonte kornizën e dritares të hynte në derë, duke menduar se do t'i binte të fikët para se të shikonte kush ishte në anën tjetër.

Pastaj uli supet. Burri që mbante anën tjetër të dritares së riparuar, ishte i zbehtë dhe hollak, me flokë të shkurtër, biond. Klara u lëshua në stol duke kapsitur sytë mes lotëve. Të dy burrat kaluan pranë saj bashkë me dritaren dhe e mbështetën pas murit, pranë dritares së mbuluar me kompensatë.

- Po dollapin kur do ta riparoni? - pyeti përgjegjësja tullacin.

- Po e sjellim tani, - u përgjigj ai duke bërë me shenjë drejt derës.

Klara u kapërdi dhe ndoqi vështrimin e tullacit. Një punëtor tjetër u mbështet te kasa e derës me njërin fund të dollapit në duar. Shpatullat i kishte të gjera, vështrimin energjik dhe flokët të zinj, të lëpirë pas kokës. Ajo gulçoi. Lëshoi nga dora këmishën e natës dhe u ngrit në këmbë. Iu duk se do të kalonte një jetë e tërë para se cepi tjetër i dollapit të dukej nga dera. Pa burrin që ishte në anën tjetër. Ai kishte flokë gri dhe mbante syze. Sytë i ranë sërish mbi burrin me flokë të errët. Më në fund, dollapin e kishin futur të gjithin në dhomë. Burri me flokë të errët e lëshoi përdhe dhe u kthye me një lëvizje të ngadaltë. Hoqi dorezat dhe hodhi një vështrim përqark dhomës, sikur të kërkonte dikë. Flokët i kishte më të gjatë nga sa i mbante mend Klara dhe mbi sy kishte një vrajë të freskët, por ajo e njohu menjëherë atë fytyrë.

Ishte Brunoja.

Ajo lëshoi një britmë gëzimi.

- Bruno! - thirri dhe iu mek zëri.

Mori për nga ai.

Brunos iu zgurdulluan sytë dhe goja i mbeti hapur. Lëshoi dorezat dhe eci drejt saj.

- Mos bëj asnjë hap më tutje! - ulëriti përgjegjësja. - Roje!

- Bëj si të thonë, - i tha Brunoja.

Rojat u futën me vrap në dhomë dhe Klara u ndal në vend duke u munduar ta mposhtte dëshirën për të vrapuar drejt krahëve të Brunos. Por ai kishte të drejtë. Situata nuk do të ishte në favor të asnjërit prej tyre, po të futej në telashe. Brunoja bëri prapa, me duart e ngritura lart si të ishte dorëzuar. Përgjegjësja ia nguli sytë Klarës.

- Ç'të thotë mendja se po bën? - e pyeti ajo e vrenjtur. Eci çalë-çalë nëpër dhomë dhe e mbërtheu Klarën nga mjekra me gishtat

e fortë. - Bëre diçka të ndaluar. Prit sa ta marrë vesh doktor Roaçi këtë prapësi! Ka një pavijon të veçantë për femrat si ti, e dashur.

- Ajo është gruaja ime, - tha Brunoja me zërin e tij të fuqishëm.

Përgjegjësja ia nguli sytë. E lëshoi mjekrën e Klarës dhe e studioi atë nga koka te këmbët me buzët e mbledhura. Pastaj, ngriti bastunin dhe e drejtoi fundin e tij nga tullaci. - E ke idenë se çfarë po ndodh këtu?

Ai mohoi me kokë.

Përgjegjësja ktheu kokën drejt derës.

- Shoqërojini të dy te doktor Roaçi! - i urdhëroi rojat.

Klara dhe Brunoja ishin ulur në qoshet e kundërta të zyrës së doktor Roaçit, me nga një rojë në të dyja anët e karrigeve të tyre. Doktor Roaçi u ul në tryezën e tij, ndërsa infermiere Trençi qëndronte pas tij dhe shihte e shqetësuar një herë nga Klara dhe një herë nga Brunoja. Shtrëngonte një kartelë pacienti në kraharorin e saj të gjerë dhe, në krahë, si të ishte peshqir, kishte hedhur një këmishë force. Infermiere Mei hyri në zyrë, i dorëzoi doktor Roaçit një dosje, pastaj, si një punonjëse e bindur, zuri vend në një cep të tryezës. Doktor Roaçi hapi dosjen, e vuri mbi kartonin mbajtës dhe u hodhi një sy letrave duke shtrembëruar fytyrën. Klara mezi mbushej me frymë, priste që ai të thoshte diçka. Më në fund, ai ngriti sytë dhe tha:

- Nuk jam i sigurt nëse e kuptoj si duhet atë që po ndodh këtu. Mund të më sqarosh pak, Klara?

- Ky është Brunoja, - i tha Klara. - Burri që ju thoshit se nuk ekziston! Ju kam thënë që s'jam e çmendur! Ai është... - ajo u mundua të kapërdinte lëmshin që i ishte mbledhur në fyt dhe e vështroi ngultas Brunon me sy të përlotur. Nuk kishte mënyrë tjetër për t'ia thënë atij. - Ai është babai i vajzës sime. Vogëlushes që ju ma morët me forcë.

Brunoja ngriu i tëri dhe u përflak në fytyrë. Mbylli sytë dhe uli kryet. Gishtat e tij rrëmonin në krahët e karriges dhe tëmthat i punonin pa pushim.

- Ndoshta ai mund të na shpjegojë se pse në dosjen e punonjësit emri i tij është Xhozef Ruso dhe jo Bruno Moreti, - tha doktor Roaçi.

Brunoja ngriti sytë e tij të pajetë dhe qëroi zërin.

- Xhozef është emri i parë i tim eti, - iu përgjigj ai, me fjalë të ashpra dhe të nxjerra si me forcë, sikur me zor po e mbante mllefin. - Ruso është mbiemri i vajzërisë së nënës sime.

- Pse nuk dhe emrin tënd të vërtetë kur aplikove për vendin e punës së marangozit? - e pyeti doktor Roaçi.

- Sepse Klara më kishte paralajmëruar në një letër se mjekët në qendrën "Long Ajlënd" e dinin emrin tim, - tha Brunoja. - Babai i saj u kishte dhënë urdhër që të më mbanin sa më larg saj, madje kishte shkuar deri aty sa kishte ndaluar të postoheshin letrat e saj të mëparshme, që unë të mos e merrja vesh ku ishte. Përdora një emër tjetër sepse mendova se të njëjtat udhëzime do të kishit marrë edhe ju.

- Pra, ti fillove punë në Uillard vetëm për të gjetur të dashurën? - e pyeti doktor Roaçi.

- Po, - ia ktheu Brunoja. - E dija që s'do të më lejonit të vija dhe t'ju kërkoja ta linit të lirë. Henri Kartrajt është njeri i pushtetshëm. E di që ajo mbahet e mbyllur këtu me urdhër të tij. Për të qenë të qartë, ajo s'është e dashura ime. Është ime shoqe.

- Henri Kartrajti do vetëm të mirën e vajzës së tij, - tha doktor Roaçi. - Ai e solli në Uillard, ngaqë ajo s'është mirë.

- Gjepura! - tha Brunoja dhe i kërcyen damarët në ballë. - E solli këtu që ta largonte prej meje! Ajo nuk ka asnjë problem!

- Druaj se ti nuk je i specializuar për të vlerësuar gjendjen e saj mendore, - tha doktor Roaçi. - Ndërsa unë, nga ana tjetër, jam i kualifikuar. - Aty ai hodhi sytë nga Klara dhe shtoi: - Mund të më shpjegosh pse nuk ma ke përmendur kurrë që ke qenë e martuar?

Klara hodhi sytë nga Brunoja, pa qenë e sigurt se çfarë të thoshte, por ai ia kishte ngulur sytë doktor Roaçit duke mposhtur ngasjen për t'u lëshuar përmes tavolinës dhe për ta kapur për fyti. Kur ndjeu ngurrimin e Klarës, e pa me ballin e rrudhur, sikur të donte t'i thoshte që duhej t'i vinte pas fijes lojës së tij. Futi dorën në xhepin e pasmë të pantallonave dhe nxori nga kuleta një copë letër të palosur.

- Ja ku e keni certifikatën tonë të martesës, - tha Brunoja, duke ia zgjatur doktor Roaçit.

Infermiere Mei i erdhi rrotull tryezës, mori letrën dhe e la të hapur mbi dosje. Doktor Roaçi i hodhi një sy të shpejtë certifikatës.

- Si u takuat ju të dy? - pyeti ai.

- U njohëm në klubin "Koton", - tha Klara. - Babai im s'e dinte që unë shkoja atje me shoqet. Një mbrëmje, Brunoja ishte...

Doktor Roaçi tundi njërën dorë në ajër.

- Jo, jo, - tha ai. - S'dua të dëgjoj histori të tjera. Dua të di si u takuat këtu, në Uillard. Me siguri, sistemi ynë që parandalon punonjësit e jashtëm të përzihen me pacientët, paska të meta mjaft serioze.

- Nuk është histori, - tha Klara. - Ne...

- Klara punonte në rrobaqepësi, - ndërhyri Brunoja, me zërin e tensionuar dhe lëvizi në cep të karriges, si të donte të ngrihej. Roja e rroku nga shpatullat dhe e detyroi të ulej. Brunoja i hodhi një shikim plot neveri para se të fillonte atje ku e kishte lënë. - Po ndihmoja në dorëzimin e një dollapi që kishim riparuar në punishte. Ishte hera e parë që e pashë këtu, edhe pse kam muaj të tërë që e kërkoj.

- Nuk ke pasur marrëdhënie me Klarën ndërkohë që ajo ka qenë paciente këtu? - pyeti doktor Roaçi.

- Jo, - tha Brunoja, duke mos ia ndarë sytë. - Ne jemi njohur para dy vjetësh, në klubin "Koton", siç e tha edhe vetë ajo.

- Pse nuk besoni asgjë nga ato që ju themi? - e pyeti Klara. - Gjatë gjithë kësaj kohe ju kam thënë se im atë më mbylli këtu për të më mbajtur larg njeriut që doja. Tani, ai ndodhet këtu, para jush, dhe ju ende nuk ma vini veshin!

- Ti ke pasur vegime që nga çasti kur mbërrite këtu - tha doktor Roaçi. - Ky njeri po mundohet të përfitojë nga sëmundja jote duke u hequr si dikush që nuk është.

- Nuk është e vërtetë! - tha Klara dhe i ra dyshemesë me këmbë. - Po emrat në certifikatën e martesës si i shpjegoni?

Doktor Roaçi ndezi llullën, e thithi një herë gjatë, pastaj pa edhe një herë certifikatën me tymin që i dilte nga buzët.

- Kjo nuk vërteton asgjë, - tha ai. - Mund të jetë e falsifikuar.

- Po Beatrisa? - tha Klara dhe iu mblodh një lëmsh në kraharor. Nëse Brunoja s'është babai i saj, kush tjetër mund të jetë?

Doktor Roaçi tundi kokën.

- Këtë unë nuk kam nga ta di, - tha ai, - por babai yt më vuri në dijeni se ti kishte qenë tepër... si të ta them... tepër e lëvizur para se të përfundoje në qendrën "Long Ajlënd". Ai tha se kjo ishte diçka e pazakontë për natyrën tënde dhe kësisoj i lindën dyshimet se duhej të kishe patjetër një problem.

Me këto fjalë, doktor Roaçi ia bëri me shenjë infermiere Meit dhe ajo u largua nga zyra, duke dalë përmes derës së dhomës së kontrollit.

- Kjo është gënjeshtër! - thirri Klara. - Unë u lidha me Brunon, ndaj prindërit më mbyllën këtu! Nuk e kuptoni? Gjithçka është ashiqare!

- Ku është vajza jonë? - pyeti Brunoja, duke i nxjerrë me zor fjalët nga dhëmbët e shtrënguar fort. - Të kërkoj të na e kthesh sërish, - tha, mori frymë thellë dhe e mbajti përbrenda, me siguri duke u munduar të ruante gjakftohtësinë.

- Më vjen keq, - i tha doktor Roaçi Brunos, prerë. - E di që mendon se po e ndihmon Klarën, por ajo nuk është e denjë për të qenë nënë. Më beso kur të them se vajza e saj është dërguar në një familje që e do dhe ku kujdesen shumë për të.

Në atë çast, infermiere Mei erdhi sërish me një gjilpërë hipodermike mbi një tabaka. Klarës nisi t'i rrihte zemra si çekan në kraharor. Brunoja e pa tabakanë vetullngrysur. Pastaj u ngrit me duart e mbledhura grusht. Rojat e mbërthyen nga krahët.

- Kjo s'është e ligjshme, - tha ai, me zërin që ushtoi nga tërbimi. - Ju s'mund t'i mbyllni njerëzit si pa të keq dhe të bëni çfarë t'ju dojë qejfi me fëmijët e tyre!

- Babai i Klarës më ka besuar mua që të kujdesem për të, - tha doktor Roaçi. - Thjesht po bëj atë që është më e mira për të gjithë.

- Do t'ju denoncoj në polici! - bërtiti Brunoja. - Do t'u them se na keni rrëmbyer fëmijën! Do t'i sjell këtu, do t'ju kërkoj të na e ktheni vajzën dhe ta lini të lirë Klarën!

Doktor Roaçi e studioi Brunon për një moment të gjatë, sikur po mundohej të kuptonte nëse po bënte blof apo jo. Brunoja ia nguli sytë me kraharorin që i ulej e i ngrihej pa pushim.

- Ku është vajza ime? - e pyeti sërish me sy të skuqur nga

mllefi. - Nëse s'ma tregoni, do të gjej dikë që të ma thotë. Pastaj, do t'ju arrestoj!

Doktor Roaçi mbështeti llullën në tavllën e duhanit, lëvizi në karrige dhe shkroi diçka në dosjen e Brunos, me ballin të mbuluar nga djersë të ftohta.

Klara u ngrit në këmbë.

- Pse jeni kaq nervoz? - e pyeti ajo. - Mos ndoshta im atë ju ka paguar që të më mbani këtu? Ai ju detyroi që të ma merrnit fëmijën?

Rojat e shtynë atë sërish në karrige.

Doktor Roaçi nuk ia vuri veshin dhe u kthye nga infermiere Trençi, duke i zgjatur dorën. Ajo kafshoi buzën e poshtme dhe i dorëzoi kartelën që mbante në duar. Doktor Roaçi e hapi, e çoi në faqen e fundit dhe shkroi diçka. Pastaj mbylli dosjet dhe tundi dorën sikur po trembte ndonjë mizë. Rojat e rrasën Brunon sërish në karrige. Ai luftoi dhe u mundua të ngrihej, por ishte e kotë.

- Ç'dreqin mendoni se po bëni?! - bërtiti Bruno. - Ju nuk keni asnjë kompetencë mbi mua! Nuk jam një nga pacientët tuaj!

Doktor Roaçi u ngrit, zgjati duart për të marrë pallton në mbështetësen e karriges dhe i futi krahët. Pastaj e drejtoi vëmendjen tek infermiere Trençi.

- Nisni terapinë e insulinës për Klarën, - tha ai duke mbërthyer pallton. Infermiere Trençi pohoi me kokë, me sytë të mbushur me lot. Pastaj, doktor Roaçi pa Brunon gjithë shpërfillje dhe shtoi: - Ndërsa ty do të të shtroj për të vlerësuar gjendjen tënde, Xhozef, Bruno apo kushdo qofsh.

Brunoja u mundua të ngrihej me duart e mbledhura grusht dhe buzët e mbledhura me përbuzje.

- Kjo ishte e gjitha?! - ulëriti ai. - Thjesht do të marrësh një vendim se ne po gënjejmë, jemi të çmendur, apo çfarëdo emri që do t'i vësh kësaj? Do të na mbyllësh në çmendinë?

- Unë bëj detyrën, - tha doktor Roaçi. - Po mundohem të ndihmoj Klarën. Tani do të mundohem të të ndihmoj edhe ty.

- Në djall vafshi ti dhe ndihma jote! - ulëriti Brunoja. - Nga se ke frikë? Çfarë po mundohesh të fshehësh?

Klara u rrëzua nga karrigia, e sigurt që do të villte. Një nga rojat e kapi nga krahu dhe e ngriti në këmbë. Brunoja shpëtoi më

në fund nga mbërthimi i rojave. Vrapoi përmes dhomës, rrëmbeu Klarën dhe e tërhoqi drejt derës.

- Ndalini! - bërtiti doktor Roaçi.

Një nga rojat e mbërtheu Klarën nga beli dhe e tërhoqi pas, ndërkohë që ajo vërtiste këmbët në ajër. Ajo e çori rojën te krahu dhe ia çau lëkurën, por pa sukses. Roja nuk e lëshonte. Klara e shikonte, gjysmë e ngritur në ajër, teksa rojat e tjera e shtrinë Brunon në dysheme dhe e mbanin ashtu, pa lëvizur. Doktor Roaçi u vërsul drejt tij me këmishën e forcës dhe pastaj, rojat e ngritën në këmbë. Brunoja hidhte shqelma dhe sulej me kokë, duke u munduar të shpëtonte, por rojat ia rrotulluan krahët nga pas, duke ia tërhequr me forcë pas shpatullave. Brunoja u përkul nga dhembja, me sytë e mbufatur dhe ngriti kokën për të parë Klarën.

- Mos u shqetëso, - i tha i tensionuar. - Do ta gjej një mënyrë për t'u larguar prej këtej!

Doktor Roaçi i injektoi një shiringë në pjesën e sipërme të krahut e mandej bëri mbrapa, teksa shikonte rojat që e detyronin të vishte këmishën e forcës. Klara shtrëngoi sytë dhe i mbylli. Nuk mund ta shikonte atë skenë.

KAPITULLI 19



Izi

Burgu Shtetëror i Bedfordit

Era e tetorit i fshikullonte flokët në fytyrë teksa Izi ia kishte ngulur sytë portës së madhe metalike jashtë burgut të Bedfordit. I ktheu shpinën shkulmit të erës së ftohtë dhe e mblodhi pallton poshtë mjekrës duke u dridhur dhe duke pritur që roja ta fuste brenda. Pas portës, grumbulli i godinave me tulla, i dritareve me hekura dhe oxhaqet i sillnin ndër mend spitalin "Uillard". Ndryshimet e vetme mes tij dhe burgut ishin kullat e vrojtimit dhe telat e përdredhur me gjemba mbi gardhet metalike.

Hodhi sytë matanë rrugës, drejt parkingut, ku Pegi ishte ulur në makinën e saj, në ndenjësen e shoferit, dhe shihte nga xhami i përparmë. Pegi kishte telefonuar më parë për të organizuar këtë vizitë dhe i kishte thënë ta shoqëronte, por Izi kishte këmbëngulur se donte të ishte vetëm kur të përshëndetej për herë të fundit me nënën e saj. Tani, stomaku nisi t'i bënte numra dhe ajo pyeste veten nëse ishte tepër vonë për të ndërruar mendje. Kur iu mbush mendja se do të kishte dashur që Pegi ta shoqëronte, një roje po i afrohej me hap të qetë për ta futur brenda. Ai tërhiqte këmbët zvarrë nëpër trotuar dhe shikonte përqark gjithë mospërfillje, si të ishte i mërzitur.

- Lejen e vizitores? - i tha ai kur iu afrua.

- Jo, - i tha Izi. - Unë... nuk kam qenë ndonjëherë këtu. Nëna ime është shtruar në infermieri. Gruaja që kujdeset për mua, telefonoi dhe foli me drejtorin. Ai i tha se mund të vija për vizitë.

- Si e ke emrin?

- Izabela Stoun, - iu përgjigj ajo.

- Prit, - i tha ai. Hapi një kuti të zezë mbi një shtyllë pranë portës, formoi një numër dhe i shpjegoi situatën dikujt që ishte në anën tjetër të telefonit. - Po, - tha ai. - Iza... ma thuaj edhe një herë si e kishe emrin?

- Izabela Stoun, - iu përgjigj ajo.

- Izabela Stoun, - përsëriti roja. - Po. Mirë, - tha, mbylli telefonin dhe e pyeti duke e parë në sy: - Ke ndonjë dokument identifikimi?

Ajo rrëmoi në çantë, nxori certifikatën e lindjes dhe kartën e shkollës. Ai i kontrolloi, ngriti sytë për ta krahasuar atë me fotot, pastaj hapi portën.

- Duhet të shkosh te salla e vizitorëve dhe të pajisesh me një leje, - i tha.

Ajo i futi sërish dokumentet e identifikimit në çantë, ktheu kokën mbrapa dhe ia bëri me dorë Pegit. Pastaj u fut në mjediset e burgut. Roja i tregoi me gisht godinat me tulla në të djathtën e tij.

- E shikon atë tabelën blu atje tej? Ajo në të cilën është shkruar "Të gjithë vizitorët"?

- Po, - ia ktheu ajo.

- Ndiq trotuarin drejt hyrjes për te holli, pastaj shtyp citofonin dhe përsërit edhe një herë gjithçka që më the mua.

- Mirë, - iu përgjigj ajo.

Uli kokën dhe nisi të ecte nëpër erë duke mbajtur fustanin me duar që të mos i ngrihej dhe duke sharë veten që e kishte veshur. Kur ishte e vogël, nëna këmbëngulte që ajo të vishte fustane, ia bënte flokët me onde dhe ia lidhte pas me fjongo rozë. Në moshën gjashtëvjeçare, Izi kishte nisur të rebelohej ndaj veshjeve me fruda dhe i ishte lutur së ëmës që ta linte të vishte bluza sportive dhe xhinse si shoqet e saj, sikur kjo të kishte qenë gjëja më e rëndësishme në botë. Nëna ishte dorëzuar, por Izi nuk do ta harronte kurrë vështrimin e trishtë në sytë e saj kur kuptoi

se vogëlushja e saj po rritej. Sot, më e pakta që Izi mund të bënte, ishte të vishte një fustan. Tani, me erën që i rrihte mes këmbëve të zhveshura, kuptoi se kishte bërë një budallallëk.

Me zemrën që i ishte çuar peshë, shtypi zilen në derën e jashtme të hollit të vizitorëve dhe u fut brenda. E ulur pranë një dritareje që hapej me rrëshqitje dhe duke mos i hequr sytë nga puna e saj, një recepsioniste i dorëzoi tre formularë duke e udhëzuar që t'i plotësonte. Izi mori skaletën dhe u ul në një karrige, duke u përpjekur të mos i hidhte sytë nga fëmijët që luanin dhe lexonin në tavolinat e vogla në mes të sallës. Ishin fëmijë shkolle, kopshti dhe foshnja, vajza e djem nga dhjetë deri në dymbëdhjetë vjeç, që qeshnin dhe gajaseshin, sikur të luaje në hollin e burgut të ishte gjëja më e natyrshme në botë.

Në fillim, Izi u hutua dhe pyeti veten se ç'kërkonin ata fëmijë në burg, por mandej, e kuptoi se kishin ardhur për të takuar nënat e tyre të burgosura. Kafshoi buzën. *Po fëmijët më të mëdhenj mos ndoshta nuk kishin pranuar të vinin? Apo ata i vizitonin nënat e tyre gjithmonë, pavarësisht nga gjithçka?* Plotësoi dokumentet teksa në stomak iu mblodh një lëmsh i hidhur faji.

Më në fund, erdhi një infermiere, e cila do ta shoqëronte në infermieri. Izi ndoqi rojën përmes një dere metalike drejt një korridori të shkurtër të shtruar me çimento, që vinte erë gur i lagësht, hekur, urinë dhe diçka tjetër që asaj i kujtonte mishin me erëza. Një anë e murit ishte plot me dritare të gjata të mbyllura me hekura, ndërsa në anën tjetër ishin tri dyer të hapura. Roja ndaloi dhe i bëri shenjë drejt derës së parë. Ajo u bind. Një rojë tjetër priste pranë një tavoline të bardhë brenda një dhome të vogël.

- Më duhet të të kontrolloj çantën, - i tha ai.

Izi e uli çantën nga supet dhe e zgjati përpara. Roja i zbrazi të gjitha sendet mbi tavolinë.

- Ngriji krahët lart dhe hapi këmbët anash, - i tha roja i parë.

Ajo u mundua të kapërdinte lëmshin që i ishte formuar në fyt dhe ngriti duart lart. Roja e kontrolloi nga koka te këmbët, duke e prekur mes këmbëve dhe poshtë gjoksit. Më në fund, kontrolli mbaroi dhe roja i parë e shoqëroi sërish në korridor. Në fund të tij iu afruan një dere me hekura. Izi qëndronte pas rojës

duke pritur që ai ta hapte, me gjunjët që i dridheshin. Zhurma e vetme që i ushtonte në vesh ishte ajo e zemrës së saj që mend po i buçiste në kraharor. Të qenët për herë të parë në një burg ishte një ndjesi shumë e keqe, por sa më shumë i afrohej çastit kur do të shihte nënën, aq më të vështirë e kishte t'i hidhte hapat njëri pas tjetrit.

Ndoqi rojën, kaluan mes hekurave dhe dolën në një korridor të shtruar me çimento, me drita të futura brenda disa kutive në tavan, pastaj, kaluan një derë tjetër të kyçur metalike për të përfunduar sërish në një holl të vogël. Roja i tha të zinte një vend dhe të priste derisa të vinte ta merrte dikush. Ajo bëri si i thanë dhe u ul duke u munduar të merrte frymë thellë dhe qetë. Roja u largua përmes një dere tjetër.

Një infermiere ishte ulur në anën tjetër të ndarjes së xhamit: një derë e hapur pas saj të çonte në një dhomë tjetër. *Ndoshta bëra gabim,* mendoi Izi me lot në sy. Imazhi i nënës që dergjej në shtratin e pavijonit për të sëmurët mendorë, ia pushtoi kokën dhe mend ulëriti me të madhe. Pyeste veten jo vetëm se si do të dukej nëna e saj tani, pasi kishte qëndruar në burg për plot dhjetë vjet, por kur mendonte se do ta shikonte të ëmën në koma, stomaku i pështjellohej dhe i përzihej. Imazhi i fundit që kishte për të ëmën, e kishte përndjekur në ëndrra për vite të tëra. Çfarë imazhi i tmerrshëm do të pikturohej sot në mendjen e saj?

Iu kujtua një libër nga Stefan King, i titulluar "Zona e vdekjes", ku një burrë i plagosur në një aksident me makinë kishte qëndruar në koma për pesë vjet. Ajo imagjinoi personazhin kryesor teksa zgjohej dhe i shtrëngonte dorën dikujt, pa mundur t'ia lëshonte derisa të parashikonte të ardhmen e tij. Pasi e kishte lexuar romanin, Izi nuk kishte mundur të vinte gjumë në sy për javë të tëra. Koma dukej si gjëja më e keqe që mund t'i ndodhte një njeriu. Tani ajo do të shikonte nënën në të njëjtën gjendje. I vinte t'ia jepte ulërimës teksa përjetonte fajin që nuk kishte pranuar ta vizitonte gjatë gjithë këtyre viteve, hidhërimin e të mbeturit jetime dhe frikën që do ta shikonte nënën të lidhur pas pajisjes që të mban në jetë. Por ajo duhej t'i kërkonte falje dhe t'i thoshte lamtumirë. Duhej t'i thoshte nënës se nuk kishte reshtur kurrë së e dashuri. I detyrohej të paktën kaq.

Gati kërceu përpjetë kur u hap një nga dyert e hollit. Një gardiane thirri emrin e saj, duke e mbajtur derën hapur. Izi kaloi përmes saj dhe qëndroi në holl me thonjtë e ngulur në pëllëmbët e duarve. Një infermiere me flokë të errët dhe me uniformë u shfaq dhe e shoqëroi nëpër një korridor të gjatë në ngjyrë të gjelbër, me këpucët që i kërcisnin në dyshemenë e shtruar me pllaka. Ajo u ndal jashtë dy dyerve shumë pranë njëra-tjetrës dhe, për habinë e Izit, i buzëqeshi.

- Je mirë? - e pyeti.

Izi bëri një pohim me kokë, që iu duk më tepër si një spazmë.

- Që ta dish, - i tha infermierja, - rrallë i lejojmë të afërmit të vijnë në infermieri. Zakonisht, dikush që është në gjendjen e nënës sate, dërgohet në spitalin shtetëror. E kam zët t'i them gjërat troç, por mendojmë se ajo nuk do ta përballonte dot udhëtimin. Kujdestarja jote na u përgjërua që ta mbanim këtu derisa ti të vije dhe ta shikoje. Ke vetëm disa minuta kohë.

Izi ia bëri me kokë dhe u orvat ta falënderonte, por goja i ishte kyçur.

- Mos u shqetëso, - i tha infermierja duke e rrokur nga supet. - Ajo duket sikur po fle.

Infermierja hapi derën dhe e shoqëroi brenda. Përgjatë mureve të bardha të dhomës së madhe, ishin rreshtuar me dhjetëra shtretër metalikë, në të cilët ishin shtrirë të burgosurat. Disa flinin, disa flisnin me të burgosurën që kishin pranë, dhe disa të tjera lexonin. Në një tryezë pranë derës, ishte ulur një rojë. Të burgosurat ndaluan gjithçka, ngritën vështrimin me sytë e zgurdulluar nga habia dhe vetullat të rrudhura nga çoroditja. Infermierja e shoqëroi Izin te pacientja e parë, hapi një perde mes shtretërve, afroi një karrige metalike dhe pastaj qëndroi e mbështetur te koka e krevatit. Pranë shtratit, ekranet e pajisjeve bënin "bip", ventilatorët kërcisnin dhe frynin e shfrynin oksigjenin.

- Xhoisi, ka ardhur të të vizitojë jot bijë, - i tha infermierja gruas që dergjej në shtrat.

Izi ngriu në vend, stomaku iu mblodh. Iu duk sikur mushkëritë po ngurronin të punonin brenda kraharorit, sikur nga një sekondë në tjetrën organet e saj do të kontraktoheshin

dhe do të reshtnin së funksionuari njëherë e përgjithmonë, duke e plandosur përdhe. Iu afrua anës së shtratit me gishtat mbi buzët që i dridheshin, dhe ia nguli sytë gruas që dergjej në të.

Kur pa tiparet e njohura të nënës, mollëzat dhe hundën e ngritur, vrajën e vogël mbi vetullën e djathtë që kur rrëshqiti në akull te rrugica pranë shtëpisë, nuk po ngopej dot më me frymë. Lëkura rreth syve të saj ishte mbushur me rrudha dhe në flokët e zinj vërehej tek-tuk ndonjë fije argjendi, por, përveç tubit që i kishin vendosur në gojë, dukej se nuk kishte ndryshuar fare. Kur ishte e vogël, Izi mendonte se nëna e saj ishte gruaja më e bukur në botë. Me kalimin e viteve, ajo pyeste veten nëse të gjitha vajzat e vogla mendonin se nëna e tyre ishte e bukur apo nëse imazhi që ajo ruante në mendjen e saj, ishte përmirësuar me kalimin e kohës. Tani, kuptoi se kishte të drejtë. Nëna e saj ishte e mahnitshme. La çantën te karrigia dhe iu afrua më pranë.

- A ka ndonjë gjasë që të zgjohet? - pyeti infermieren.

Infermierja mohoi me kokë.

- Jo, e dashur, - iu përgjigj. - Kur e gjetën, dëmi ishte bërë. - Ajo i erdhi shtratit rrotull dhe e rroku Izin te krahu. - Më vjen shumë keq. Mund të bëj ndonjë gjë për ty? Do një gotë ujë apo ndonjë pije freskuese?

- Jo, - i tha Izi, prerë. - Faleminderit! Do të doja të rrija disa minuta vetëm me...

- Je mirë? Dukesh pak e zbehtë.

Izi pohoi me kokë dhe infermierja e rroku nga supet.

- Në rregull, - i tha. - Po ju lë një minutë vetëm, - dhe ia bëri me shenjë rojës. - Sillu mirë, hë?

Izi u mundua t'i falte një buzëqeshje të vakët dhe infermierja më në fund u largua. Duke u orvatur të gjente nga t'ia niste, u mbajt tek anët e krevatit që të mos rrëzohej. I kapur pas fundit metalik të shtratit, një zinxhir i rëndë shtrihej poshtë batanijes deri te këmbët e nënës. Izi mendoi se ishte vërtet absurde të lidhje me zinxhir një paciente në koma që dergjej në shtrat. Ajo nuk kishte ku të shkonte, veç po të ndodhte ndonjë mrekulli. Ajo dergjej e shtrirë, si e gurtë, me krahët e zbehtë të hapur anash, pëllëmbët e duarve që i vareshin, dhe gishtat e gjatë, hollakë, që dukeshin si fildish mbi batanijen në ngjyrë blu. Duar pianisteje,

thoshte gjithmonë gjyshja. Mendoi të zgjatej dhe t'ia shtrëngonte dorën së ëmës, por nuk i bënte zemra ta prekte. Përveç faktit që nuk e dinte nëse i lejohej të prekte një të burgosur, ajo kishte frikë ta prekte lëkurën e nënës së saj. E urrente veten për këtë ndjenjë që përjetonte, por kjo ishte e vërteta. Mendimi i prekjes së një njeriu në koma e bënte t'i dridheshin këmbët, njëlloj si të prekte objektet që ndodheshin brenda valixheve në spitalin "Uillard". Madje, edhe kur bëhej fjalë për të ëmën.

Fshiu lotët që i binin teposhtë mollëzave, dhe mori frymë thellë.

- Më fal, - pëshpëriti. - Kam bërë një gabim. Letrat e tua nisa t'i lexoja kur ishte tepër vonë.

Kapërdiu dënesat dhe u orvat të fliste sërish. Për një sekondë i dukej sikur do t'ia plaste së qarës në mënyrë histerike, ndërsa sekondën tjetër, donte thjesht të godiste diçka, e inatosur me jetën që kishte marrë këtë rrjedhë. Për një fraksion sekonde, pyeti veten nëse të burgosurat e tjera mund ta dëgjonin. Pastaj, mendoi se s'i bëhej shumë vonë.

- Të lutem, më fal që nuk kam ardhur të të takoj, mami. Jam treguar budallaqe, kokëfortë, dhe kisha frikë. Mendoja se ti kishe ndonjë problem. E kisha harruar se çfarë kishte bërë babi. Tani e di të gjithë të vërtetën. E di që sakrifikove jetën tënde për të më shpëtuar mua, - tha dhe uli kokën duke fshirë hundët me mëngët e bluzës. - Dua ta dish që s'kam reshtur kurrë së të dashuri.

E kishte të pamundur ta përballonte këtë. U struk në karrige me supet që i dridheshin. Ah, sikur t'i kishte lexuar më parë letrat e nënës! Sikur të kishte ardhur ta takonte! Ndoshta do të kishte kuptuar që ajo nuk ishte e çmendur. Gjithë këto vite do të kishte pasur dikë me të cilën të fliste, dikë që e donte, edhe pse ishte pas hekurave. Një herë të vetme që Izi kishte pyetur gjyshen se çfarë kishte ndodhur, ajo kishte nisur të qante. Izi, asokohe shtatë vjeçe, duke mos dashur ta mërziste njeriun e vetëm të dashur që kishte, nuk e kishte hapur më atë temë. Pas tre vjetësh, gjyshja e saj kishte ndërruar jetë.

Pastaj iu kujtua vajza e Klarës. Nëse do të kishte mbijetuar, ajo ndoshta do ta kishte vazhduar jetën e saj duke menduar të njëjtën gjë - që nënën e saj e mbanin të mbyllur ngaqë ishte e

çmendur. Izi u ngrit në këmbë. Nëse do të ishte gjallë, vajza e Klarës meritonte ta dinte të vërtetën; ajo duhej të lexonte patjetër ditarin e Klarës. Tani, më shumë se kurrë, Izi ishte e vendosur të zbulonte se ç'kishte ndodhur me të ëmën dhe, nëse do të kishte mundësi, do t'i thoshte që nuk ishte e çmendur.

Tani s'i mbetej veçse t'i thoshte lamtumirë. Më shumë se gjithçka tjetër, donte të ndiente krahët e saj përreth vetes, ta pushtonte fort, t'i thoshte se e donte pavarësisht gjithçkaje. Por kjo s'kishte për të ndodhur kurrë. Hodhi sytë nga roja për të parë nëse po e shikonte. Ajo ishte mbështetur në karrigen e saj dhe lexonte një revistë. Izi mori frymë thellë, puthi gishtat e saj dhe pastaj i vuri me kujdes në faqen e nënës.

- Dua që ta dish se do të jem shumë mirë, - tha ajo. - Jam e fortë dhe kam njerëz që kujdesen për mua. Të dua, mami. Të kam dashur dhe do të të dua gjithmonë. Më fal që nuk t'i kam thënë më parë këto fjalë...

U rrek t'i thoshte diçka tjetër, por befas, iu duk sikur nuk po ndihej mirë. Në atë çast, infermierja u fut në dhomë dhe i tundi gishtin për t'i bërë me dije se koha kishte mbaruar. Por asaj i kishte mbetur edhe diçka tjetër për t'i thënë.

- Lamtumirë, nënë!

KAPITULLI 20



KLARA

Uillard
Dita e Shën Valentinit, 1932

Nga tavanet e *Hadley Hall*-it, vareshin shirita gjarpërues dhe zemra me letër të kuqe që përziheshin me njëra-tjetrën teksa pacientët kërcenin duke tërhequr këmbët zvarrë poshtë tyre. Atmosfera gëlonte nga melodia e këngës "All Along". Infermiere Mei qëndronte pranë gramafonit, duke u tundur dhe duke kënduar me vete pa ua ndarë sytë çifteve që kërcenin. Dhjetëra pacientë shikonin si spektatorë, disa të lidhur me rripa në karriget e drurit të ngjitura me tavolinat, disa në karriget me rrota dhe disa të tjerë të mbështetur mbi paterica e bastunë. Infermiere Trençi çau rrugën mes atyre që kërcenin në pistën e vallëzimit për t'u siguruar që të ruanin largësinë e kërkuar nga njëri-tjetri. Rojat ishin ulur përreth perimetrit të sallës në karrige portative, pranë dritareve dhe dyerve, gati për të ndërhyrë nëse ndokush dilte nga rreshti. Pacientët, rojat dhe infermieret kishin veshur jelekë dhe kishin vënë trëndafila me letër të kuqe, të bërë nga pacientët gjatë orëve të vizatimit dhe të zejtarisë.

Klara ishte ulur në një stol në fund të skenës dhe ia kishte ngulur sytë hyrjes kryesore, me shpresën dhe me lutjen se do të vinin pacientë të tjerë meshkuj dhe Brunoja do të ishte mes tyre. Nuk kishte kaluar as një muaj që kur i kishin dhënë privilegje

të veçanta: tani, ajo mund të merrte pjesë në orën e vizatimit dhe të zejtarisë e mund të shikonte koncerte dhe filma në *Hadley Hall,* por kjo ishte hera e parë që merrte pjesë në një ngjarje që organizohej si për pacientët meshkuj, ashtu edhe për femrat. Tani, guxonte të shpresonte se do ta shikonte sërish Brunon. I mbushte mendjen vetes se ai kishte bërë maksimumin për të bashkëpunuar, për të fituar dhe pasur atë pak liri që u lejohej pacientëve të Uillardit. Në të kundërt, mundësitë për të gjetur njëri-tjetrin dhe për t'ia mbathur, do të ishin thuajse zero.

E vetmja gjë që i kishte dhënë zemër gjatë atyre dhjetë muajve, arsyeja e vetme që nuk e kishte lejuar të çmendej vërtet, ishte mendimi se Brunoja ishte diku aty, në Uillard. I dukej më se e arsyeshme të besonte se, deri më tani atë duhej ta kishin futur në punë në depon e stacionit hekurudhor, në punishten e farkëtarit, në kopshte, ara, stalla ose baxho, ose në një nga dyqanet ku prodhoheshin këpucë, fshesa apo sapunë. Fatmirësisht, falë zanatit të tij, ai ishte i detyruar të punonte jashtë. Nëse ajo do të arrinte ta fitonte sërish punën në kuzhinë, mund të takoheshin te mbeturinat. Ai do të hapte portën dhe mund t'ia mbathnin përmes pyllit.

Gjatë çdo shëtitjeje, rrugës për në tualet, mensë apo në rrobaqepësi, në çdo mundësi që i jepej për të parë nga dritarja, sytë e saj kërkonin gjithmonë atë. Kur shihte ndonjë grup pacientësh meshkuj duke ecur përgjatë bregut të liqenit për të punuar pranë dokut, apo duke shkarkuar ngarkesat nga treni, ajo i këqyrte me vëmendje të gjithë trupat e tyre, me shpresën se do ta njihte atë nga mënyra e të ecurit ose se do të shikonte një kokë të njohur me flokë të errët. Deri më tani, nuk e kishte parë ende, por nuk duhej ta humbte besimin se ajo ditë do të vinte shumë shpejt. Në të kundërt, ç'kuptim do të kishte?

Kishte hequr dorë me kohë nga shpresa se i ati do ta lironte. Para shtatë muajsh, doktor Roaçi i kishte thënë se ai dhe Henri ishin të të njëjtit mendim: ajo nuk do të ishte kurrë gati për t'u bërë pjesë e shoqërisë. Pas kësaj, doktori nuk organizoi më seanca terapie me të. Gjithsesi, ajo nuk pranonte të besonte se do ta kalonte gjithë jetën e mbyllur brenda mureve të Uillardit, mes të çmendurve: mes një turme grash, nënash, motrash dhe vajzash të mbyllura aty pa dëshirën e tyre. Brunoja i kishte premtuar

se do të gjenin një mënyrë për t'u larguar prej andej dhe nuk duhej ta humbte besimin. Në asnjë mënyrë! Nuk kishte rrugë tjetër. Gjithsesi, kishte raste kur i vinte të dorëzohej. Donte të mos mendonte më në mënyrë të arsyeshme, ta linte veten të kridhej në një dëshpërim të thellë, që të mos ishte më në gjendje të ndiente asgjë, por i duhej ta ruante logjikën dhe arsyen, sepse i detyrohej kaq Beatrisës dhe Brunos.

Ajo rrëqethej e tëra kur mendonte se çfarë mund të kishte ndodhur nëse Brunoja nuk do ta kishte marrë letrën e saj, nëse nuk do të ishte përpjekur ta shpëtonte. Me siguri do të kishte luajtur mendsh deri tani. Nga njëra anë, i ishte më shumë sesa mirënjohëse, por, nga ana tjetër, ndjenja e fajit se ai u mbyll në një institucion për shkak të saj, shpesh, zor se përballohej. Sa herë që mendonte se atij mund t'i kishte ndodhur diçka e keqe, që ndoshta kishte vdekur nga tuberkulozi ose e kishin lidhur me zinxhir pas një krevati në qendrën "Ruki Pest", ndiente një gropë të zbrazët dhe të ftohtë në kraharor, zemra dukej sikur i ndalej dhe se mund të vdiste nga çasti në çast.

Nuk arrinte ta imagjinonte se çfarë mund t'i kishte ndodhur atij pas asaj dite të tmerrshme në zyrën e doktor Roaçit, por lutej që të mos përjetonte asgjë më të tmerrshme nga ajo që kish përjetuar ajo. Atë e çuan në një pavijon të veçantë, ku çdo ditë, për dy muaj rresht, i bënin injeksione me insulinë derisa ra në koma. Mbante mend se kishte nisur të djersinte pa pushim, të dridhej, të rënkonte dhe të nxirrte jargë derisa kishte humbur ndjenjat. Me kalimin e kohës, infermieret e kishin sjellë në vete me glukozë intravenoze, pastaj e kishin angazhuar në lojëra të ndryshme dhe në leximin e hartës me qëllim që të parandalonin ndonjë shok hipoglicemik. Në fund të dy muajve, e dërguan në infermieri që të merrte veten.

Tri javë më pas, e rikthyen në punën e saj në rrobaqepësi. Ndonjëherë, shikimin e kishte ende të paqartë dhe mendimet të turbullta. Kishte probleme me përqendrimin. Për të shmangur efektet anësore të insulinës, infermierja e kishte këshilluar që ta vinte trurin në punë sa më shumë të mundej. Duke ndjekur udhëzimet e saj, Klara këndonte me vete këngët e fëmijërisë derisa mendja iu kthjellua plotësisht.

Atë çast, shihte Esterin teksa vallëzonte me një burrë truplidhur, të veshur me pantallona me shtrat të lartë dhe tiranda. Të dy kishin ulur kokat dhe shikonin këmbët. Esteri kishte veshur fustanin me lule dhe dukej sikur vallëzimin e udhëhiqte ajo. Para tetë muajsh, doktor Roaçi kishte vendosur se Esteri nuk kishte më prirje "armiqësore" dhe i kishte dhënë privilegje të tjera. Meqenëse Esteri i kishte thënë Klarës se gjatë koncerteve dhe shfaqjes së filmave meshkujt uleshin në anën tjetër të *Hadley Hall*-it, Klara mbeti e tronditur kur pa se meshkujt dhe femrat lejoheshin të kërcenin bashkë për raste të veçanta.

Në anën tjetër të dhomës, Madalena qëndronte pranë tavolinës së koktejit. Një infermiere e godiste në kyç duke i thënë që të mos pinte më. Sipas Esterit, xhaxhai i madh i Madalenës kishte shprehur dëshirën ta merrte atë në shtëpinë e tij dhe e kishin nxjerrë nga Uillardi kur Klara ishte ende nën trajtimin me insulinë. Por, pas disa javësh, ajo ishte kthyer sërish në Uillard. Këtë herë nuk e mbante mend se si quhej dhe nga vinte. Nuk fliste më, vetëm qante për fëmijët që kishte humbur. Klara pa një pacient çalaman ta tërhiqte Madalenën për në pistën e vallëzimit. Ajo i hodhi krahët rreth shpatullave dhe e tërhoqi pranë vetes, duke strukur fytyrën në qafën e tij. Infermiere Trençi nxitoi drejt tyre për t'i ndarë.

Klara shtrëngoi cepin e stolit duke ngacmuar me thonj drurin teksa Xhin Ostin këndonte "My blue heaven". *Kjo nuk është parajsa*, mendoi Klara. *Ky është ferri.* Në fakt, pasi e kishin nxjerrë nga izolimi në pavijon, asaj i kishin dhënë edhe disa privilegje. Kjo ishte festa e parë ku merrte pjesë dhe me zor po e përballonte. Kur shikonte pacientët e Uillardit të kërcenin dhe të festonin si të bënin jetë të zakonshme, si të kishin një mundësi për të gjetur dashurinë apo lumturinë e vërtetë, diçka shumë e vogël e frenonte nga ngasja për t'ia dhënë vrapit jashtë me ulërima.

Për çdo pacient të qeshur në pistën e vallëzimit, kishte shumë pacientë të tjerë që vështronin me fytyra të turbullta. Disa të tjerë ecnin çalë-çalë dhe lëviznin me hope, të paaftë për të ndjekur ritmin e muzikës. Pacientët në karrige me rrota i tejkalonin në numër ata që ishin në këmbë, në raport tre me një. Shumica prej tyre shikonin përqark dhomës gojëhapur, tërë jargë, me kyçet e përkulura drejt kraharorit dhe me duart që u vareshin pa jetë dhe

të padobishme. Në njëfarë mënyre, kështu ishte shndërruar edhe jeta e tyre. Kështu ishte jeta e saj. Kaq mjaftonte që ajo të luante mendsh.

U bë gati të ngrihej dhe të shkonte te tavolina ku ishin pijet dhe mezet, kur befas dikush e rroku nga supet. Ngriu në vend. Do të ishte kërkesa e tretë për të kërcyer, pasi dy i kishin ardhur nga njerëz të shëndoshë mendërisht. Buzëqeshi dhe u kthye, duke u përgatitur për refuzimin e radhës, por, sakaq, iu bllokua frymëmarrja.

Burri që qëndronte përballë saj, ishte me mustaqe të trasha, mjekër të zezë dhe flokët mbi veshë i hijeshoheshin nga disa fije gri. Hundën e kishte paksa me kurriz, si ta kishte thyer disa herë. Dukej si malësor, i egër dhe me pamje të çrregullt. Klarës i fërgëlloi zemra nga frika. Ai u zgjat për t'i marrë dorën, por ajo u ngrit dhe nisi të largohej. Më pas, ai foli.

- Ç'kemi, *bella* Klara? - tha me zërin e trashë e me theks.

Ajo u kthye vrik duke kafshuar buzën për të mbytur britmën që mund të lëshonte. Pastaj, zgjati duart dhe nxitoi turravrap drejt Brunos.

- Mos! - ia priti ai. - Ndryshe do të dyshojnë se ka diçka dhe do të vijnë menjëherë.

Ajo nderi krahët dhe u orvat të rregullonte frymëmarrjen teksa shihte përreth se mos i kishte rënë në sy ndokujt. Infermiere Trençi, me fytyrën e përflakur dhe të shfytyruar, po mundohej të ndante dy gra që donin të kërcenin bashkë. Infermiere Mei po shikonte disqet e gramafonit dhe po mendonte se cilin të vinte më pas. Nxori një disk të zi nga një kapak letre, e vendosi mbi gramafon dhe vendosi gjilpërën te buza e tij. Zëri i Etel Uotersit mbushi dhomën me këngën "Am I blue?". Zemra e Klarës rrihte aq shpejt, saqë me zor i vinin fjalët.

- Po sikur të të njohin? - arriti të thoshte ajo.

- S'kanë për të më njohur, - iu përgjigj ai. - Kam ndenjur i ulur në anën tjetër të dhomës gjatë gjithë kohës.

- Je i sigurt? - e pyeti ajo.

- Po, - ia ktheu ai duke i kapur dorën. - Prita shumë kohë derisa të të afrohesha, që të mos dyshonin. Si të gjithë pacientët e tjerë, edhe unë jam i padukshëm, nëse nuk hap telashe.

Ai e shoqëroi nëpër pistën e vallëzimit dhe, duke ruajtur distancën e kërkuar mes tyre, i vendosi njërën dorë në bel. Pëllëmba e tij si hekur i nxehtë, sikur rëndonte mbi fustanin e pambuktë. Vetëm ideja që ishte pranë tij, e bëri të ndihej ngrohtë pas aq muajsh të ftohti dhe vetmie, aq ngrohtë sa edhe sikleti sikur nisi t'i venitej. Ngriti sytë për të takuar të tijtë, duke i sforcuar buzët që i dridheshin, të buzëqeshnin.

- Të kam kërkuar gjithandej, - tha ajo me sytë të mbushur me lot hidhërimi. - Çdo ditë, - shtoi, duke shijuar çdo grimë të fytyrës së tij, duke u dehur në gështenjën e syve të tij dhe në qerpikët e gjatë e të zinj si terri. Ai shikonte prapa supeve të saj, duke vrojtuar infermieret dhe rojat.

- Mos më shiko, - i tha qetësisht. - Ti nuk më njeh, harrove?

Ajo i hoqi sytë nga ai dhe nisi të shikonte muret, pacientët e tjerë dhe rojat. S'e kishte mendjen asgjëkund.

- Më fal, - i tha. - Vetëm se...

- E di, - ia ktheu ai dhe i shtrëngoi dorën. - Edhe unë jam i lumtur që të shikoj.

- Çfarë të bënë pasi të morën nga zyra e doktor Roaçit?

- Më mbajtën tre muaj në izolim.

- O Zot! - psherëtiu ajo, mblodhi buzët dhe vari kokën. - Më vjen shumë keq.

- S'ka rëndësi. Rëndësi kanë ky vend dhe ky çast. Unë, ti dhe çfarë do të bëjmë për t'u larguar prej këtej.

- Kur? - e pyeti ajo, duke ngritur sytë drejt tij pa e mbajtur dot veten. Duhej ta shikonte në sy. Befas, ndjeu t'i merreshin mendtë.

- Shumë shpejt, - tha ai dhe e shtrëngoi fort, si ta ndiente tensionin e saj. - Tani qetësohu dhe më dëgjo me kujdes. Unë po punoj me varrmihësin, ndërtoj qivure dhe bëj gurët e varreve. Na kanë lejuar të futemi në tunelet që ndodhen poshtë *Chapin Hall*-it. Atje mbajnë qivuret, në një magazinë pranë morgut. Kur të vendosim se kur do të largohemi, ti gjej një mënyrë për të shkuar deri tek ato tunele. Ka një tabelë...

- Po si të shkoj unë atje? - e pyeti ajo dhe paniku sa vinte dhe e shtrëngonte në fyt.

- Nuk e di, - tha ai. - Tani për tani, vetëm më dëgjo. Më lër të të them gjithçka që kam për të thënë. Më pas, do të dëgjojmë

edhe versionin e planit tënd. Kur të mbërrish te tunelet, ndiq tabelat drejt morgut. Magazina është në anën tjetër të korridorit. Fshihu brenda njërit prej qivureve. Unë dhe Lorenci do të të nxjerrim jashtë.

- Varrmihësi?

- Po.

Ata lëviznin nëpër pistën e vallëzimit me rrotullime të ngadalta. Fytyrat e turbullta pas kokës së Brunos bënin që asaj t'i merreshin mendtë.

- Je i sigurt që ai s'do të na spiunojë? - e pyeti duke e kapur më fort nga shpatullat.

- Po, - vijoi ai.

Pastaj, infermiere Trençi nisi të ecte pranë tyre me buzët e kuqe të mbledhura me vendosmëri. Klara uli mjekrën, e sigurt që infermiere Trençi do të arrinte ta lexonte të vërtetën në sytë e saj. Balli iu mbulua me bulëza djerse dhe gjunjët nisën t'i dridheshin. Infermiere Trençi kontrolloi largësinë mes tyre, u vendosi dorën e trashë mbi supe dhe i largoi edhe më nga njëri-tjetri.

- Jeni shumë afër, - u tha ajo.

Kur infermiere Trençi u kthye për të shkuar te çifti tjetër, Klara mendoi se kaq e pat. Pastaj, infermierja ndaloi dhe qëndroi në vend pa lëvizur, një çast që u duk se zgjati sa një përjetësi. I picërroi sytë lart e poshtë mes fytyrave të pacientëve. Klara ndjeu se u mbulua nga djersë të ftohta. Infermiere Trençi e njohu Brunon. Për një të qindtën e sekondës, gjithçka iu errësua. U kapërdi duke e sforcuar veten ta shikonte infermiere Trençin në sy.

- Gëzuar Shën Valentinin! - i tha me buzët e mbledhura teksa mundohej të buzëqeshte. - Faleminderit që na organizove këtë festë kaq të bukur!

Duke u ngrysur e tëra, infermiere Trençi ia nguli sytë Brunos dhe po analizonte fytyrën e tij. Brunoja mori shprehjen e një njeriu të ekzaltuar, që tundej dhe vështronte zemrën prej letre të varur mbi kokën e Klarës.

- Hëm, - bëri infermiere Trençi duke kërveshur buzët e kuqe. Mandej, pa vëngër Klarën, tundi një herë kokën dhe lëvizi më tutje. - Bëni kujdes! - tha teksa largohej.

Klara lëshoi një psherëtimë drithëruese. Këmbët mend po e linin.

- Je mirë? - e pyeti Brunoja.

Klara u mundua të gjente zërin që i kishte humbur.

- Ajo të njohu! - pëshpëriti.

Ai mohoi me kokë.

- Jo, ndryshe do të kishte njoftuar rojat.

Klara u mundua të merrte frymë normalisht kur pa që infermiere Trençi ndaloi te çifti tjetër.

- Nuk e di, - tha ajo. - M'u duk sikur... Sikur po na paralajmëronte të tregoheshim të kujdesshëm apo diçka tjetër.

- Na paralajmëroi që të mos afrohemi shumë kur kërcejmë, - tha Brunoja. - Kjo është e gjitha. Tani më dëgjo me kujdes. Duhet të mbaroj së treguari planin tim.

Klara mori frymë thellë dhe e nxori jashtë ngadalë. Ndoshta ai kishte të drejtë. Infermiere Trençi do të kishte lajmëruar rojat ose do t'i shoqëronte atë dhe Brunon te doktor Roaçi, por jo, ajo vijoi të kontrollonte çiftet e tjera që kërcenin, si të mos kishte ndodhur asgjë e keqe.

- Mirë, - tha duke u munduar ta mbante veten nga të dridhurat. - Po të dëgjoj.

- Lorenci jeton në një kasolle të vjetër në krahun tjetër të korijes me kedra.

Ajo pohoi me kokë.

- E kam parë, - ia ktheu.

- Do të fshihemi atje derisa të bjerë muzgu, pastaj do të përvidhemi poshtë liqenit ku na pret një varkë.

- Një varkë?

- Po. Para disa vjetësh, Lorenci kishte gjetur një varkë me rrema në korijen me kedra. Ishte gjysmë e prishur dhe e mbuluar me një shtresë halash e gjethesh pishe. Por unë e kam riparuar trupin e saj dhe kam sajuar disa rrema me drurin që përdorim për të bërë qivuret.

- Është e sigurt?

- Këtë do ta zbulojmë shumë shpejt, apo jo?

Klara tundi kokën. Pastaj u kujtua se ishte shkurt dhe diçka iu mblodh në stomak. Liqeni kishte ngrirë. Duhej të prisnin derisa të vinte pranvera, por, tani që mundësia e shpëtimit kishte hedhur rrënjë në mendjen e saj, nuk mund të priste dot aq gjatë. Nuk

duronte as edhe një ditë tjetër e mbyllur në Uillard, lëre pastaj edhe dy muaj. Po të kishte mundësi, ajo do të orvatej t'ia mbathte që atë çast. Nëse ajo dhe Brunoja duhej të prisnin deri në pranverë, nëse do t'u duhej të prisnin derisa të shkrinte liqeni, do të çmendej nga frika. Përveç këtyre, po sikur deri atëherë të ndodhte diçka? Po sikur njëri prej tyre të sëmurej ose të futej në izolim? Ç'do të bënin atëherë?

- Kur? - e pyeti ajo, duke mbajtur frymën.

- Shumë shpejt, - iu përgjigj ai.

- Por liqeni është i ngrirë!

- Akulli është i hollë në këtë periudhë, - tha Brunoja. - Dy javët e fundit kanë qenë në përgjithësi të ngrohta. Do të jemi në gjendje ta çajmë akullin dhe të kalojmë matanë.

Klarës iu mblodh sërish diçka në stomak. Mori frymë thellë, ngriti kokën dhe e drejtoi pak më shumë trupin. Kjo ishte mundësia e tyre! Më në fund! Mundësia për të qenë të lirë, për të qenë bashkë dhe për të gjetur Beatrisën. Por si fillim, duhej të gjente një mënyrë për të zbritur te tunelet poshtë infermierisë. Kjo dukej thuajse e pamundur, duke marrë parasysh edhe se në kalendarin e saj ditor nuk kishte asnjë punë që mund ta shpinte pranë *Chapin Hall*-it. Befas, i lindi një ide.

- Nesër, - tha ajo. - Duhet t'ia mbathim që nesër!

Brunoja rrudhi vetullat.

- Pse? - e pyeti.

- Thjesht ki besim tek unë, mirë?

- Çfarë do të bësh?

- Do të mundohem të bëj diçka që të më çojnë në infermieri, - vijoi ajo. - Pastaj do të gjej një mënyrë për të zbritur te tunelet pa rënë muzgu. Po ti, mund të shkosh te tunelet të dielave?

- Po, - tha ai. - Lorenci varros pacientë edhe të dielave. Në fakt, nesër kemi për të varrosur një.

- Shumë mirë, - tha ajo. - Do ta lëmë për nesër.

Në atë çast, kënga "Am I blue?" mbaroi dhe infermiere Mei ndryshoi diskun. Gertrud Lorenci nisi të këndonte "Someone to watch over me" dhe Klara ndjeu një shtrëngim në fyt. Iu kujtua hera e parë kur ajo dhe Brunoja kishin kërcyer në klubin "Koton". Tani, po kërcenin nën tingujt e së njëjtës këngë, por të mbyllur brenda një çmendine. Mend iu prenë gjunjët nga ky mendim.

Të dielën pasdite, pasi kishte bërë shportat me Esterin dhe Madalenën në dhomën e argëtimit, Klara pyeti një nga infermieret nëse mund të kthehej në pavijon më herët se zakonisht. U ankua se i dhembte stomaku dhe kishte nevojë të rrinte shtrirë. Një infermiere, me një shikim krejtësisht indiferent, urdhëroi një nga rojat ta shoqëronte në pavijon. Klara hodhi vështrimin pas për të parë Esterin dhe Madalenën, me zemrën që e shtrëngonte fort në kraharor. Ato ishin ulur në një stol dhe punonin kokulur. Klara kishte vendosur të mos ua tregonte planin e arratisjes, me shpresën që ato të mos lëndoheshin. Krahas kësaj, ishte një rrezik shumë i madh. Ku i dihej se çfarë mund të thoshin nëse i kërcënonin se do t'i mbyllnin në izolim, u bënin injeksione derisa të binin në koma apo i mbyllnin në qendrën "Ruki Pest". Në vend që të ndahej me to, u dërgoi një lutje në heshtje, me shpresën se edhe Esteri e Madalena do të dilnin një ditë nga Uillardi.

Gjysmë ore më vonë, para kohës kur infermieret kthenin pacientët e tjerë në pavijon, Klara mori pecetën mes këmbëve dhe ndoti çarçafët dhe kofshët me gjakun e ciklit menstrual. Nuk e kishte ndërruar pecetën gjithë ditën dhe meqenëse ishte dita e dytë e ciklit, gjakderdhja ishte më e madhe dhe gjaku më i bollshëm e më i errët në ngjyrë. Me zemër të ngrirë u struk në krevat dhe priti. Kur dëgjoi çelësat në derë, nisi të rënkonte dhe të qante, me duart rreth mesit. Pacientet u futën brenda, u grumbulluan rreth shtratit të saj dhe ia ngulën sytë të tmerruara! Ajo rënkonte dhe përpëlitej në shtrat. Një nga gratë nisi ta përkëdhelte Klarën te balli, duke ia hequr me kujdes flokët që i kishin rënë mbi sy. Një infermiere i urdhëroi pacientet që t'i hapnin rrugën.

- Si e ke hallin? - e pyeti ajo.

Klara shtrembëroi fytyrën dhe hapi këmbët.

- Nuk e di, - ia ktheu, me zërin e sforcuar.

- Kthehu nga ana tjetër dhe më lër të të kontrolloj, - i tha infermierja.

Klara rënkoi dhe u kthye me kurriz, me gjunjët të përkulur dhe sytë të mbyllur fort. Infermierja ia largoi dorën Klarës dhe i preku barkun. Klara ulëriti me sa kishte në kokë dhe u rrotullua sërish, duke mbajtur frymën që të skuqej në fytyrë.

- Sill shpejt një karrige me rrota, - i tha infermierja një kolegeje. - Çoje në infermieri.

Pas njëzet minutash, Klara e pa veten të shtrirë në tryezën e vizitave në zyrën e doktor Slejdit, i cili rrudhte ballin teksa i prekte stomakun. Një infermiere e kishte ndihmuar të pastrohej, i kishte dhënë një pecetë të pastër higjienike dhe një këmishë nate të pastër. Atë çast, infermierja po shikonte me interes skenën.

- Nuk shikoj asgjë jonormale, - tha doktor Slejdi. - Mund të më tregosh më qartë se ku të dhemb? Më trego nga të vjen dhembja.

Klara vendosi gishtat mbi këllk.

- Ja, këtu, - tha ajo.

- Ke ndier dhembje më të forta se ato të ciklit mujor?

- Po, - iu përgjigj Klara. - Por më duket se po filloj të ndihem pak më mirë tani.

- Lajmëroni doktor Kingun, - i tha ai infermieres. - Pacientja ka nevojë për një kontroll gjinekologjik.

Klara mohoi me kokë dhe u ngrit.

- Jam më mirë tani, - tha ajo. - Mendoj se kam nevojë të eci pak. - Rrëshqiti nga tavolina e vizitave, u ngrit duke e mbajtur trupin të përkulur dhe duart në pjesën e poshtme të barkut.

- Çfarë po bën? - e pyeti doktor Slejdi. - Nuk të thashë që të ngriheshe.

- Kam nevojë të eci, - ia ktheu ajo. - Po më lehtësohet dhembja.

Doktor Slejdi i hodhi një sy përmes syzeve.

- Po më thua se bëre gjithë këtë potere për asgjë?

Klara mblodhi supet.

- Nuk e di. Ti je mjeku, jo unë, - tha dhe vuri sërish duart poshtë barkut e u drodh e tëra. - Ja, më nisi prapë dhembja.

- Shtrihu edhe një herë që të shohim se çfarë ke, - tha ai dhe, i ngrysur, hodhi sytë nga infermierja. - Nuk do të jap analiza apo radiografi tjetër, nëse ajo thjesht është helmuar apo ka dhembje të ciklit.

- Të lutem! - i tha Klara. - Kam nevojë të eci. Nëse kjo nuk më lehtëson, do të bëj gjithçka që do të më thoni ju.

Doktor Slejdi u mendua një hop, pastaj tundi kokën duke ia bërë me shenjë drejt derës me një shikim plot neveri.

- Shoqëroje deri në fund të korridorit dhe sille prapë këtu, - i tha infermieres.

Klara ndoqi infermieren jashtë dhomës së vizitave, me zemrën që i rrihte fort në kraharor. Kontrolloi të dy krahët e korridorit për të parë nëse kishte ndonjë shkallë që të çonte poshtë në bodrum, duke e ditur mirë se s'kishte për të qenë aq e lehtë. Gjithsesi, shpresonte që, për një herë të vetme, gjërat të ishin në favor të saj. Nga të dy krahët, korridori lidhej me korridore të tjera që të çonin majtas apo djathtas. Nisi t'i tërhiqte këmbët zvarrë duke u mbështetur te muri, pas infermieres, me njërën dorë te barku dhe tjetrën duke u mbajtur te parmaku i murit. Vriste mendjen nëse do ta gjente menjëherë shkallën apo nëse, në njëfarë mënyre, do të ishte e detyruar ta kalonte natën në infermieri. Nëse nuk gjente në ato çaste një rrugë që të çonte te tunelet, do t'i duhej të dilte më vonë vjedhurazi nga dhoma dhe kjo ishte thuajse e pamundur.

Kur arritën në fund të korridorit, infermierja mori një kthesë në formë "U"-je dhe nisi të kthehej te dhoma e vizitave të doktor Slejdit. Klara ndaloi, e shtrëngoi më fort parmakun dhe hodhi vështrimin poshtë korridorit, në të majtën e saj. Korridori i gjerë ishte mbushur me pacientë të lidhur pas karrigeve me rrip lëkure te mesi, disa duke qarë dhe rënkuar, të tjerë hidhnin vështrimin e zbrazët, kot, në hapësirë. Korridori në të djathtën e saj ishte thuajse i zbrazët, përveç një karrigeje bosh me rrota dhe një karroce metalike plot me shishe barnash. Dyert e dhomave të pacientëve në të dy krahët e korridorit ishin të mbyllura. Në fund të korridorit, qëndronte i hapur një ashensor shërbimi, pranë një porte të madhe me dy dyer, poshtë së cilës ishte varur një tabelë në të cilën shkruhej "Bodrumi". Djersët i binin palë-palë mbi ballë. Klara u kthye djathtas, drejt shkallëve.

- Ku po shkon? - e pyeti infermierja. - Kthehu menjëherë këtu!

Klara vazhdonte të ecte, duke u munduar ta mposhte ngasjen për t'ia dhënë vrapit.

- Kam nevojë të eci pak më shumë, - ia ktheu. - Më duket se po më lehtëson.

- Bëj si të them! - i bërtiti infermierja. - Doktor Slejdi po na pret!

Klara nuk ia vuri veshin dhe vazhdoi të ecte. Infermierja psherëtiu, këpucët i kërcisnin teksa nxitonte pas saj. Klara hodhi një vështrim prapa.

- Deri në fund të këtij korridori, - i tha ajo. - Pastaj do të kthehemi mbrapsht.

Infermierja shpejtoi hapat e mblodhi buzët. Klara ngadalësoi ritmin duke e lënë infermieren të kalonte përpara dhe duke u munduar të mos bënte frymëmarrje të shpejtuar. Kjo duhej të funksiononte patjetër. Me çdo kusht! Kur u kthyen përpara portës së madhe, u shemb përdhe dhe nisi t'i lëvizte gjymtyrët sikur t'i kishin dalë nga kontrolli. Zgurdulloi sytë, nxori gjuhën jashtë dhe hidhej përpjetë duke goditur pllakat e ftohta të dyshemesë. Infermierja u kthye mbrapa dhe gulçoi me sy të zgurdulluar. U ul në gjunjë dhe e kapi Klarën nga shpatullat. Pastaj u ngrit në këmbë dhe vrapoi për të kërkuar ndihmë. Kur infermierja u largua, Klara u ngjit pas murit dhe u ngrit në këmbë, vrapoi drejt portës së madhe e pastaj poshtë shkallëve, drejt bodrumit poshtë *Chapin Hall*-it.

Në fund të shkallëve, ndaloi dhe po mendonte nga cila anë të shkonte. Tunele të gjata çimentoje të çonin në të gjitha drejtimet: majtas, djathtas dhe drejt. Në ajër mbizotëronte era e mykut dhe e gurëve të lagësht. Tuba të madhësive të ndryshme që pikonin, ishin instaluar në të gjithë gjatësinë e tavaneve dhe dritat me mbrojtëse hekuri lëshonin një shkëlqim të dobët dhe të bezdisshëm. Llambat e tyre të zverdhura kishin zënë kore nga pisllëku dhe rrjetat e thara të merimangave. Çdo tre metra, të gjitha korridoret karakterizoheshin nga një hark kaba, si hajatet me shtylla poshtë një kalaje mesjetare. Mbi harkun në të majtë ishte varur një tabelë ku shkruhej "Morgu".

Pas Klarës, zërat e lartë vinin deri poshtë shkallëve, motori i ashensorit gjëmonte dhe kërcitja e rrotëzave me dhëmbëza jehonte nëpër boshtin e ndryshkur. Ajo mori me nxitim majtas, drejt morgut, e gëzuar që bodrumi i ngjante një labirinti gjigant. Kushdo që do të vinte ta kërkonte, s'do ta gjente kurrë se cilin drejtim mund të kishte marrë ajo. Meqenëse ishte e diel, u lut që aty poshtë të mos kishte njeri tjetër.

Hapat e saj jehonin në tunelin e zbrazët dhe këpucët me taban të fortë kërcisnin mbi dyshemenë e gurtë. Ndaloi dhe i hoqi, por ngriu në vend, sepse dëgjoi disa zëra përpara. Zëri i një mashkulli përçohej nëpër korridor, i ndjekur nga diçka që dukej si një rënkim apo e qarë. Vazhdoi ngadalë përpara duke u tërhequr zvarrë pas murit, gati për t'u kthyer dhe për t'ia dhënë vrapit. Por sa më shumë mbante vesh, aq më shumë i dukej sikur zëri përsëriste të njëjtën shprehje pa pushim. Dëgjohej zhurma e metalit dhe zinxhirët që tërhiqeshin zvarrë përmes gurëve. Përpara, në murin përballë, ishte një derë me rrjetë të trashë hekuri, me dorezë të lidhur me zinxhirë dhe e mbyllur me dry. Kaloi tunelin dhe u afrua akoma më shumë me këpucët shtrënguar pas kraharorit.

Sa më shumë i afrohej derës, aq më kundërmuese bëhej era e urinës dhe e jashtëqitjeve. Mbuloi gojën me dorë dhe pa vjedhurazi përmes cepit të derës me rrjetë hekuri, me zemrën që mend po i dilte nga kraharori. Në dhomën e gurtë kishte kafaze hekuri të mbushur me pacientë; disa lakuriq, disa me këmishët e pista të spitalit, por shumica të lidhur me zinxhir pas murit, të ulur mbi shtretër portativë ose të shtrirë përtokë. Klara gulçoi, sytë po i digjnin. Pse mbaheshin këta pacientë nëpër kafaze në bodrum? Nuk kishte më keq se të mbylleshe në Uillard, por kjo... Kjo ishte barbare! Si ia hidhnin paq mjekët me gjithë këto që bënin? U betua me vete se, pasi të dilte nga Uillardi, do të shkonte tek autoritetet për të denoncuar zhdukjen e Beatrisës, si dhe do të kallëzonte në polici keqtrajtimet çnjerëzore që bëheshin në atë vend. Duke fshirë faqet dhe duke u lutur në heshtje, nxitoi poshtë tunelit, e vendosur që të gjente dikë, i cili do t'i jepte fund kësaj mizorie.

Më në fund, mbi dy dyer që tundeshin, pa një tabelë ku shkruhej "Morgu". Më tej, në thellësi të korridorit, disa dyer prej druri shënonin fundin e tunelit, ku një dritë e dobët dielli depërtonte përmes dritareve të mbuluara nga pisllëku në gjysmën e pjesës së sipërme të çdo paneli. Për një të qindtën e sekondës, mendoi të shkonte deri në fund të tunelit dhe të provonte dorezat e dyerve. Ndoshta mund të dilte jashtë. Pastaj, u kujtua se infermieret dhe rojat ishin vënë në kërkim të saj.

Edhe nëse dyert do të ishin të hapura, ajo nuk dinte se në cilin drejtim të shkonte. Po sikur të ishin duke e kërkuar jashtë? Ishte më mirë të zbatonte planin e Brunos.

Shtyu derën e magazinës matanë morgut. Menteshat kërcitën si një mace që angullinte. Ndaloi së shtyri derën për të mos shkaktuar më tepër zhurmë, mandej, u fut përmes hapësirës së ngushtë, duke ecur sa në njërën anë në tjetrën, në dhomën e errët. Era e ujthit të pemëve dhe e tallashit mbushte të gjithë atmosferën përreth dhe muret ishin me forma të gjata drejtkëndore. Veshi këpucët dhe eci përpara ngadalë, duke u munduar të gjente rrugën përmes gjithë atij terri. Kur goditi kërcirin pas diçkaje të fortë, zgjati duart poshtë dhe gishtat i cekën një dru dhe diçka që dukej si anët e trasha të një qivuri. E shtyu kapakun anash, hyri brenda qivurit, u shtri dhe, më pas, tërhoqi kapakun për ta mbyllur, me zemrën që i buçiste në vesh si një tren zhurmues. Me të hyrë brenda, e ngriti pak kapakun me gishtërinj, pastaj e uli sërish poshtë dhe nisi të kontrollonte me dorë anët, duke u siguruar që të mos kishte asnjë të çarë.

E gëzuar që askush nuk kishte për ta parë kur të futeshin në atë dhomë, ajo mbylli sytë dhe nisi të merrte frymë fort dhe shpejt. Pas disa sekondash, ishte thuajse e pamundur t'i rezistonte dëshirës për ta hapur kapakun, për t'u ngritur, për t'ia mbathur me vrap nga dhoma nëpër tunelin e errët dhe për të dalë në dritën e diellit. Bëri të pamundurën që të mos i mblidhte gjunjët dhe bërrylat e të ngrihej. Herë pas here, nëpër korridoret e bodrumit dëgjohej jehona e britmave të largëta dhe e dyerve që përplaseshin. Kush do ta gjente i pari, Brunoja apo ndonjë nga rojat?

Tingulli i lëvizjeve që sa vinin dhe dëgjoheshin më pranë tunelit, bëri që të ngrinte në vend. Një derë e rëndë u dëgjua të hapej e të mbyllej, mandej, disa kërcitje të mbytura dhe një *goditje e fortë* jashtë magazinës. U hap një dry. Pastaj kërciti dera e magazinës. Klara mbajti frymën. Çfarë dënimi do t'i jepnin që u mundua t'ia mbathte? Do ta fusnin në izolim? Apo do t'i injektonin insulinë derisa të binte në koma? Apo mos vallë do ta mbyllnin në qendrën "Ruki Pest"? Dera u mbyll me forcë. U dëgjua zhurma e një çelësi elektrik. Disa rreze drite depërtuan

përmes anëve të kapakut të qivurit. Hapa të rëndë ecnin nëpër dhomë. Ajo mbylli sytë fort.

- Do të presim këtu derisa të vijë? - pyeti një zë burri.

- Ky është plani apo harrove? - u përgjigj një burrë tjetër. Klarës iu ngritën qimet përpjetë. Duhej të ishte Brunoja. Por më parë duhej të sigurohej. Priti, duke u munduar të mos merrte frymë, e sigurt që do t'i binte të fikët para se ai burri të fliste sërish. Mandej, pas një çasti që iu duk si përjetësi, i njëjti zë tha:

- E mbylle morgun?

- Ëhë, - u përgjigj zëri i parë. - E mbylla, posi.

Dukej si zëri i një të moshuari. Ishte i trashë dhe i ngjirur, fliste me shumë kujdes dhe ngadalë.

- Po sikur të vijë ndonjë? - pyeti zëri i parë.

- Sot do të varrosim zonjushën Ani Blumberg, - ia ktheu zëri i dytë.

Klara mori frymë shpejt. Ishin Brunoja dhe varrmihësi. Nisi të shtynte kapakun e qivurit, por dëgjoi hapa të rëndë të vraponin nëpër tunel. Ngriu në çast. U dëgjua një kërcitje dhe dera e magazinës u hap.

- Keni parë ndonjë tjetër këtu poshtë? - pyeti një burrë, duke gulçuar.

- Sot do të varrosim zonjushën Ani Blumberg, - tha varrmihësi. - Ajo do të shkojë në parajsë për të qenë pranë Jezusit.

- S'të pyeta se çfarë po bëni, Lorenc, - ia ktheu burri, i xhindosur. - Të pyeta nëse ke parë ndonjë këtu poshtë, nëpër tunele. Na ka humbur një paciente femër.

- S'kemi parë asnjë, - tha Brunoja. Fliste me zë më të lartë se pak më parë, si të ishte duke qëndruar mbi qivur.

- S'të pyeta ty, - i tha burri. - Po pyes Lorencin. Ke parë ndonjë, Lorenc?

U duk sikur zgjati një përjetësi, para se Lorenci të përgjigjej. Klara mendoi se do t'ia jepte ulërimës para se ai të thoshte diçka.

- Jo, - tha Lorenci. - Nuk kam parë asnjë paciente femër këtu poshtë te tunelet. Ne do të varrosim zonjushën Ani Blumberg sot. Ajo do të shkojë në parajsë për të qenë pranë Jezusit.

- Mirë, - tha burri. - Nëse shikon ndonjë, na lajmëro menjëherë. Më kuptove, Lorenc?

- Po, - pohoi Lorenci. - Do të të lajmëroj nëse shikoj një grua që nuk është zonjusha Ani Blumberg.

Dera kërciti dhe u mbyll. Klara nxori frymën, me gjymtyrët që i fërgëllonin nga lehtësimi. Instinkti i thoshte ta hapte kapakun e qivurit dhe të dilte, por duhej të priste. Duhej të sigurohej që roja ishte larguar njëherë e mirë. Nguli thonjtë në pëllëmbët e duarve.

- Këtu je, Klara? - pëshpëriti Brunoja. Dukej sikur ishte shumë larg.

Klara u kapërdi dhe u mundua të fliste pavarësisht nga lëmshi që i ishte mbledhur në fyt, por nuk i doli asnjë fije zëri.

- Klara? - thirri Brunoja sërish.

- Jam këtu, - arriti të thoshte më në fund ajo dhe i ra drurit me nyjet e dorës. - Jam këtu brenda.

Një goditje e fortë mbi qivur bëri që ajo të hidhej përpjetë dhe qivuri të dridhej. Pastaj, kapaku rrëshqiti në njërën anë. Në fillim, pa disa gishta, më pas, një pjesë të fytyrës së Brunos. Ai hoqi kapakun dhe ia nguli sytë asaj, i shqetësuar. Ajo nisi të ngrihej.

- Mos lëviz, - pëshpëriti ai. - Mos fol fare.

Ajo u shtri sërish.

- Je mirë?

Klara pohoi me kokë, duke u sforcuar të buzëqeshte.

- Do të të nxjerrim prej këtu, - i tha Brunoja duke pëshpëritur. - Do të arratisemi sonte. Lorenci do të na ndihmojë.

Fytyra e gjatë dhe me qime e varrmihësit u shfaq sipër kokës së saj. Ai hoqi kapelën, shtriu me dorë flokët e thinjur e të shpupuritur dhe e përshëndeti me kokë. Lëkura rreth syve i ishte holluar me moshën, duke u dhënë qepallave një nuancë rozë, ndërkohë që në rrudhat e qafës dukeshin vija pisllëku.

- Ndaj teje është bërë një padrejtësi, - tha Lorenci, duke tundur kokën. - S'është e drejtë që ta morën fëmijën.

Klarës iu mbushën sytë me lot. Mori frymë thellë dhe tundi kokën duke i buzëqeshur lehtë Lorencit. Por, në atë çast, Brunoja u nxi në fytyrë dhe ajo nisi të dridhej sërish. Kishte diçka që nuk shkonte.

- Duhet të të nxjerrim nga tuneli, - pëshpëriti ai. - Duhet ta mbajmë qivurin në krahë dhe të ngjisim shkallët. Do ta ngarkojmë

në një karro dhe do ta çojmë te varrezat. Trupin e Anit e nxorëm sot në mëngjes herët dhe e fshehëm në korijen me kedra pranë kasolles së Lorencit. Ndërrimin do ta bëjmë te pylli, por duhet të nxitojmë. Duhen ende edhe disa orë derisa të errësohet dhe, kur mos të të gjejnë në infermieri, do të nisin të kërkojnë në mjediset përreth, - tha Brunoja dhe drejtoi trupin e nisi të kruante qafën nga prapa, duke u munduar të shmangte shikimin e saj. Më pas, psherëtiu dhe e drejtoi sërish vështrimin tek ajo. - Duhet ta mbyllim qivurin, Klara. S'do t'i ngulim të gjitha gozhdët, por duhet ta mbyllim në rast se dikush na ndalon gjatë rrugës për në varreza.

Ajo pohoi me kokë dhe u orvat të buzëqeshte. E përshkoi një ndjesi e ftohtë dhe e zbrazët, që e bëri të dridhej e tëra. Brunoja u ul në gjunjë dhe zgjati duart brenda qivurit, duke pushtuar kokën e saj me duart e tij të ngrohta. U përkul dhe e puthi në buzë me sa fuqi kishte.

- Të premtova se nuk do të lejoja kurrsesi që të të ndodhte gjë, - pëshpëriti ai, me sytë që i shkëlqenin si qelq. - S'do të na gjejë gjë.

Pas atyre fjalëve e lëshoi dhe kapi kapakun e qivurit, i zbardhur në fytyrë si një fantazmë. E vuri kapakun në vend duke mos ia ndarë sytë asaj deri në sekondën e fundit, derisa qivuri u mbyll plotësisht. Klara u krodh sërish në errësirë. Mbylli sytë dhe mblodhi grushtet duke u munduar të merrte frymë normalisht. Pastaj dëgjoi dikë të rrëmonte brenda një qeseje me gozhdë. Në kapakun e qivurit u dëgjua *një goditje e fortë.*

- U ngul gozhda e parë, - tha Brunoja.

Pavarësisht se e kishin lajmëruar, Klara u hodh përpjetë nga zhurma. Pastaj pasoi një pauzë, sikur Brunoja donte që ajo të mësohej me zhurmën, pastaj *bam, bam, bam, bam*. Ajo dridhej në çdo goditje, lotët i rrëshqisnin poshtë tëmthave, pastaj çoi duart sipër kraharorit dhe futi gishtat në vesh. Tani, goditjet e forta të metalit përçoheshin deri në tru. Kafshoi buzën, stomaku iu pështjellua dhe u mundua të mos mendonte se ç'do të ndodhte nëse, në njëfarë mënyre, Brunoja nuk do të mund ta nxirrte nga qivuri. Më në fund, Brunoja foli sërish.

- Kjo ishte gozhda e fundit, - tha prerë. - Tani do të të nxjerrim jashtë. Mundohu të mos lëvizësh.

Qivuri u lëkund lehtë, pastaj u ngrit në ajër me një lëvizje të

shpejtë. Për një sekondë, Klara nuk po e ndiente peshën e trupit të saj. Koka nisi t'i vinte vërdallë dhe mbështeti duart në anët e drunjta. Në lëkurë iu ngulën ashkla të vogla. Brunoja dhe Lorenci e transportuan përmes tunelit, nëpër shkallë dhe më pas drejt karros që i priste jashtë. Trupi i saj lëvizte brenda qivurit si një tapet i mbledhur rrotull, pavarësisht se ajo mundohej në maksimum që të mos lëvizte. Bëri të pamundurën që të mos bërtiste.

Në afërsi të pjesës së pasme të varrezave, Brunoja dhe Lorenci e shkarkuan qivurin nga karroja, e çuan në korijen me kedra dhe e fshehën brenda një vargu të dendur me pemë. Brunoja mori një levë për të hapur kapakun dhe e përdori me kujdes që të mos thyente drurin, në mënyrë që ta përdornin sërish si qivur për Ani Blumbergun. Në pritje për t'u liruar, Klara merrte frymë ngadalë duke u munduar ta mposhtte dëshirën për ta shtyrë kapakun e për të dalë jashtë. Më në fund, Brunoja e hapi dhe ajo brofi në këmbë e doli jashtë qivurit, duke thithur thellë ajrin e pastër, si një grua që sapo e kishin shpëtuar nga mbytja. Ai e përqafoi fort dhe struku fytyrën në qafën e saj. Ajo u krodh në ngrohtësinë e tij, duke u përpjekur të mos dridhej më. Iu duk sikur kishte kaluar një jetë e tërë derisa ndjeu ngrohtësinë e krahëve të tij. Nuk donte që ai ta lëshonte. Brunoja ia pushtoi fytyrën me duar dhe e puthi në buzë, duke hapur gojën si një i uritur i pashpresë. Pastaj, u spraps dhe i nguli sytë e pajetë.

- Më ka marrë shumë malli për ty, - i tha.

- Edhe mua, shumë, - ia ktheu ajo, me dhëmbët që i kërcisnin. - Nuk e di se ç'do të kishte ndodhur me mua, nëse ti nuk do të...

Ai vuri gishtin e tij mbi buzët e saj.

- Shshsh... - i tha. - Tani gjithçka po shkon mirë. Do të largohemi prej këtej dhe do të gjejmë vajzën tonë. - E puthi sërish në buzë. - Por tani duhet t'ia japësh vrapit. Fshihu poshtë krevatit të Lorencit derisa të vij të të marr.

Ajo pohoi me kokë dhe e pushtoi edhe një herë të tërin duke e strukur kokën në kraharorin e tij.

- Të dua! - i tha.

- Edhe unë të dua, - ia ktheu ai. - Shko tani!

Klara nisi të vraponte. Fryma i dilte si avull në ajrin e ftohtë.

Dikur, hodhi një vështrim prapa dhe ngadalësoi ecjen. U ndal për të parë Brunon dhe Lorencin teksa hiqnin shtresat e degëve të gjelbra nga trupi i Ani Blumbergut, të cilin e kishin mbështjellë me çarçafë. E ngritën trupin dhe e vendosën brenda qivurit, mandej zëvendësuan kapakun. Klara tha një lutje falënderimi në heshtje për gruan që i dha mundësinë të arratisej. Pastaj u krodh mes pemëve dhe vrapoi pa e kthyer më kokën pas.

Kur mbërriti në kasollen e Lorencit, nxitoi përmes verandës së përparme dhe hapi derën e shtrembër, me zemrën që mend po i dilte nga kraharori. Kur hyri brenda, zuri hundën dhe gojën me dorë për të mos ndier erën e neveritshme të jashtëqitjes dhe të brejtësve të dekompozuar. I digjnin sytë nga era kundërmuese dhe zor se merrte frymë pa u shtrënguar për të vjellë. Druhej se do t'i duhej të fshihej jashtë, të shtrihej mbi çati ose të mblidhej kruspull brenda një qosheje të fshehtë prapa shtëpisë. Jo, s'mund të rrezikonte që ta shikonin. Duhej të zbatonte pikë për pikë planin. Duke hedhur një sy rreth e rrotull, u mundua të gjente koordinatat e saj.

Ndërtesa në shkatërrim e sipër përbëhej nga dy dhoma të vogla: kuzhina/dhomë ndenjjeje dhe dhoma e gjumit. Dyshemeja e dhomës së ndenjjes ishte e shtruar me argjilë shisti dhe një oxhak i rrënuar me tulla zinte thuajse të gjithë murin e veshur me dru. Poshtë një dritareje të pistë, ishte vendosur një dollap i pikturuar, pjesa e sipërme e të cilit ishte e pajisur me një pompë uji dhe një lavaman të ndryshkur. Në mes të dhomës, qëndronte mbi tri këmbë një karrige me mbështetëse me kallama. Këmba e katërt ishte zëvendësuar me një grumbull tullash të thyera. Sipërfaqja e karriges ishte mbuluar me kanoçe bosh dhe gazeta të vjetra. Tavolina e ngrënies ishte përshtatur duke përdorur një derë të vjetër. Edhe sipërfaqja e saj ishte mbuluar me kanoçe bosh dhe gazeta të vjetra. Në një qoshe ishte vendosur një sobë. Flakët portokalli të zjarrit kërcisnin pas skarës së hekurt.

Duke mposhtur dëshirën për t'u ulur pranë sobës së druve dhe të ngrohej, Klara nxitoi përmes dhomës së ndenjjes duke kaluar në dhomën e gjumit me dysheme të pistë. Në njërin cep të saj, ishte një krevat druri me dyshek me flokë kali, ndërsa poshtë një dritareje të mbuluar me kompensata qëndronte një komo

e shtrembër, e ulët, si një xhuxh i deformuar. Drita e dobët e diellit depërtonte përmes xhamave të sipërm të dritares dhe binte mbi një qilim të vjetruar përpara komosë. Ishte një qilim i endur persian, figurat gjeometrike të të cilit i kujtonin tapetin jashtë studios së babait.

Pasi fshiu nga mendja imazhin e të atit, u zvarrit poshtë krevatit. Gjunjët dhe bërrylat iu gërvishtën në dysheme. U fut sa më thellë që mundi derisa shpina i preku murin prej druri. Pastaj, nisi të shikonte vjedhurazi nga poshtë kokës së ulët të krevatit duke u munduar të merrte frymë lehtë. Kundërmimi i jashtëqitjes nuk durohej. Në qoshen pranë komosë ishte një kovë metalike, në anët e së cilës ishin ngurtësuar cikla dhe njolla kafe. Kapi cepin e batanijes së leshtë të Lorencit dhe e tërhoqi deri poshtë krevatit për të bllokuar pamjen e tualetit të improvizuar. Rrjetat e merimangës iu ngjitën pas kyçeve të duarve dhe të këmbëve. I hoqi dhe pastaj, priti, duke u munduar të mos e mbante mendjen tek i ftohti që përhapej nga dyshemeja e pistë.

Duke vrarë mendjen se sa kohë do të duhej të kalonte para se Brunoja të vinte dhe ta merrte, ajo u mundua të kujtonte sa kohë i duhej Lorencit për të varrosur dikë, kur e shikonte nga dritarja e qendrës "Ruki Pest". Por, asokohe, ajo kishte qenë e topitur nga hidhërimi dhe tretësira e opiumit, ndaj nuk arrinte ta kujtonte mirë. Shpresonte që ai dhe Brunoja të mbaronin punë shpejt dhe, meqë ishin dy veta, ndoshta puna do të zgjaste sa gjysma e kohës së zakonshme. Jashtë po errësohej dhe drita në kasolle sa vinte e dobësohej.

Kaloi një kohë e gjatë, por dikur, dera kryesore e kasolles u hap. Klara lëvizi nga poshtë krevatit, por e kishte shumë të vështirë të shikonte në dhomën e errët. Sakaq, u zmbraps nga frika se mund të mos ishin Brunoja me Lorencin. Edhe po të ishin ata, ndoshta nuk kishin ardhur vetëm. Ngriu e tëra dhe mbajti vesh duke mbajtur frymën. Dikush ndezi një shkrepëse në dhomën e ndenjjes. Diçka fishkëlleu dhe mori flakë. Një palë çizme me baltë u dukën te hapësira e derës dhe një dritë e verdhë ndriçoi dhomën e gjumit. Çizmet e llastikut tërhiqeshin zvarrë nëpër pisllëkun e dhomës dhe ndaluan në murin përballë. Një fener i ndryshkur me vajguri u lëshua përdhe. I zoti i çizmeve i

hoqi ato duke nxjerrë në pah këmbët e zbathura e të pista. Pastaj, një xhaketë u lëshua në pirgun e pisllëkut. Dukej sikur ishte xhaketa e Lorencit.

Pse Lorenci ishte kthyer pa Brunon, pyeste veten ajo. *Mos ndoshta e kishte spiunuar? Mos ndoshta po priste që të vinin rojat dhe ta merrnin atë? Po sikur Brunon ta kishin kthyer në pavijon, ngaqë një paciente ishte zhdukur? Mos ndoshta Lorenci kishte harruar që ajo ishte fshehur nën krevat? Gjithsesi, kishte gjasa që burri në kasolle të mos ishte Lorenci.*

Këmbët e pista u zgjatën drejt kovës. Tirandat u tërhoqën dhe u hapën me zhurmë, ndërkohë që pantallonat ranë rreth kyçeve të këmbëve të burrit. Një rrëke urine goditi anët e kovës. Burri rënkoi dhe priti pak para se t'i ngrinte sërish pantallonat, pastaj u kthye dhe eci në drejtim të saj. Në cep të krevatit, u ul në gjunjë. Gishtërinjtë e bardhë dhe me gunga rrëmonin nëpër pisllëkun e dyshemesë. Klara mbajti frymën dhe u ngjesh pas murit, me zemrën që gati sa s'po i buçiste. Pastaj pa fytyrën me rrudha të Lorencit, i cili po picërronte sytë. Mori frymë e lehtësuar.

- Po të kërkojnë, - i tha Lorenci.

- E di, - iu përgjigj e tmerruar. - Ku është Brunoja?

- Ai po varros zonjushën Ani Blumberg, - vijoi ai. - Më tha që të thosha se isha sëmurë, nëse vinin të kërkonin në shtëpinë time.

Klara u kapërdi.

- Kur do të vijë të më marrë?

- Kur të jetë i sigurt, - ia ktheu ai. - Pasi të qetësohen ujërat ti dhe Brunoja do të keni mundësi të gjeni foshnjën tuaj, por duhet të të fsheh në një vend më të sigurt.

Klara ndjeu t'i përflakeshin faqet.

- Ku? - e pyeti ajo.

Lorenci u ngërdhesh, me dhëmbët e shtrembër si kokrra misri në mes të buzëve të çara. Ia bëri me shenjë të dilte prej atje ku ishte, mandej, u ngrit sërish në këmbë. Ajo u tërhoq zvarrë nëpër dyshemenë prej çimentoje, doli këmbadoras nga poshtë krevatit dhe u ngrit në këmbë duke pastruar bërrylat dhe gjunjët nga pisllëku dhe rrjetat e merimangës. Lorenci nxitoi drejt komosë, u përkul dhe palosi njërën anë të qilimit duke zbuluar një kapanxhë të vogël. Mbërtheu dorezën e hekurt dhe tërhoqi derën për ta

hapur. Në atë që dukej si një pus pa fund zbrisnin një palë shkallë rrangullina. Lorenci ia bëri me dorë që të zbriste poshtë tyre.

- Ke ndonjë qiri apo fener tjetër? - e pyeti Klara, duke u munduar të merrte frymë normalisht. - Që të jetë pak dritë aty poshtë. Do ta fik sapo të dëgjoj që po vjen ndonjë.

Lorenci shtrembëroi buzët dhe pa poshtë këmbëve të tij, duke kruar veshin, pastaj nxitoi drejt kuzhinës. Ajo i shkoi pas dhe qëndroi te dera, duke mos ia ndarë sytë dritares së madhe, në rast se shikonte ndonjë të hynte nga veranda. Jashtë, pothuajse kishte rënë terri dhe siluetat e turbullta të pemëve po bëheshin gjithnjë e më të errëta e më të dendura. Lorenci shkoi te tavolina e improvizuar dhe ngriti kanoçe pas kanoçeje duke i kontrolluar të gjitha para se t'i hidhte me potere në dyshemenë e gurtë. Në fundet e kanoçeve lëviznin insekte dhe krimba që përpëliteshin në një masë të zezë në gri. Klara mbuloi gojën me dorë. Lorenci e gjeti më në fund atë që po kërkonte, u drejtua për te pirgu i druve pranë sobës së zjarrit, theu disa shkarpa, i futi shkopinjtë e thyer brenda kanoçes dhe nxori një kuti shkrepësesh nga parvazi i dritares mbi lavaman.

Në dhomën e gjumit, ai e mbajti Klarën për dore teksa zbriti në qilarin e vjetër, pastaj i zgjati kanoçen me shkarpa dhe shkrepëset. Ajo u ul në gjunjë, lëshoi kanoçen përdhe dhe ndezi shkarpat. Flaka mori shpejt dhe nisi të digjej, duke regëtirë përgjatë murit të gurtë dhe duke ndriçuar shtresat e pilivesave të thara dhe mantidet e lidhura me spango, të varura në gozhdët e ngulura mes çarjeve të thella si një koleksion insektesh gjigante. Në fillim, Klara u zmbraps, por pastaj kuptoi se ato që mendonte se ishin insekte, ishin në fakt kryqe të vogla të bëra me dru dhe spango. Ishin me mijëra dhe mbulonin çdo centimetër katror të mureve të qilarit.

Hodhi sytë nga Lorenci dhe e pyeti:

- Çfarë janë këto?

Ai u ngërdhesh, duke u munduar të përmbante emocionet.

- Njerëz, - tha ai. - Nuk është mirë që në varret e tyre të shkruhen vetëm numrat.

Klara e afroi dritën pranë mureve të gurta, duke parë tinëz përmes kryqeve të vogla. Në secilin prej tyre, ishin gdhendur tre iniciale dhe një numër. Shkrimi ishte aq i vogël, sa mezi lexohej.

Sytë iu mjegulluan. Si ishte e mundur që një njeri aq i mirë dhe i kujdesshëm si Lorenci të mbyllej gjithë jetën në Uillard? Nuk ishte e drejtë. Ajo vuri dorën mbi zemër dhe ia nguli sytë atij.

- Ti je njeri shumë i mirë, Lorenc, - i tha.

Lorenci buzëqeshi me sytë e tij të pajetë dhe ia bëri me kokë, me gjakun që i vërshoi në faqet e rrudhura.

- Tani më duhet ta mbyll derën, - tha ai.

- Mirë, - ia ktheu Klara. - Faleminderit, Lorenc!

Në përpjekje për të shpërfillur panikun e klaustrofobisë, Klara u ul në dyshemenë e ftohtë e të ndotur, me këmbët mbledhur poshtë fustanit. Lorenci mbylli kapanxhën dhe ajo u gllabërua sërish nga terri. Flaka brenda kanoçes përhapte hije drithëruese mbi kryqet, duke krijuar iluzionin se shkopinjtë kishin nxjerrë papritmas krahë dhe përpëliteshin teksa mundoheshin të çliroheshin.

Ajo dëgjoi qilimin të shtrohej sërish mbi kapanxhë dhe skeleti i krevatit kërciti. Brenda disa minutash, dëgjoi gërhitjen e Lorencit. Kafshoi buzën dhe mbylli sytë fort, duke u munduar të mos qante. *Shumë shpejt do të pllakosë errësira*, mendoi ajo. *Pastaj, Brunoja do të vijë të më marrë. Duhet të pres edhe pak.* Mandej, mendoi diçka tjetër, diçka që ia bëri gjakun ujë. Si do të kthehej Brunoja në kasolle pasi të errej?

Zakonisht, pacientët ktheheshin nëpër pavijone sapo fillonte të errej. Ndoshta Brunoja kishte një pozitë tjetër, por a nuk do të pyeste kush se ku kishte përfunduar ai? Kush ishte përgjegjës që ta kthente atë në kohë në pavijon? Apo mos ndoshta atij, ashtu si dhe Lorencit, i kishin dhënë më shumë liri se të tjerëve? Zemra nisi t'i rrihte fort. Pastaj, dera e përparme e kasolles u hap. Ajo shoi flakën e kanoçes dhe mbajti frymën.

- Lorenc! - thirri një burrë.

Klara ngriu në vend.

Nuk ishte Brunoja.

- Lorenc! - thirri sërish burri.

Hapa të rëndë u dëgjuan në dyshemenë e gurtë dhe u zvarritën përmes dhomës së pistë të gjumit. Krevati nisi të kërciste, sikur dikush po e shkundte nga skeleti.

- Zgjohu! - bërtiti një zë i tretë. - Ngrihu nga krevati, dreqin!

Lorenci gërhiste dhe krevati vazhdonte të kërciste sikur

personi të ishte duke u rrokullisur apo ulur mbi të.

- Çfarë po bën? - e pyeti burri i dytë. - I paske mbaruar punët për sot?

- Jam i sëmurë, - u përgjigj Lorenci. - Brunoja varrosi zonjushën Ani Blumberg.

- Nuk më dukesh i sëmurë, - i tha burri i dytë. - Je thjesht përtac.

- Jam i sëmurë. Brunoja varrosi zonjushën Ani Blumberg.

Klara u mblodh kruspull, nga frika se mos burrat do të dyshonin nëse Lorenci vazhdonte të përsëriste të njëjtat fjalë.

- Sa kohë ke që ia ke këputur gjumit? - e pyeti burri i dytë.

- Nuk e di, - ia ktheu Lorenci.

- Ikim prej këtej, - i tha burri i parë. - Po e harxhojmë kot kohën këtu. S'kemi për të ndritur gjë me këtë të metë.

- Ke parë ndonjë të endet këtej rrotull, Lorenc? - e pyeti burri i dytë. - Ke parë ndonjë paciente femër këtej rrotull? Ka trokitur ndokush në derën tënde apo ka përgjuar nëpër dritaret e tua?

- Jam i sëmurë, - tha Lorenci. - Unë isha duke fjetur, ndërsa Brunoja varroste zonjushën Ani Blumberg.

- Shkojmë, - tha burri i dytë.

- Prit! - ia behu burri i parë. - Çfarë është ajo?

- Ç'dreqin të jetë vallë? - tha burri i dytë.

- Poshtë atij qilimi po del tym!

Klarës i ngriu gjaku! Vuri njërën dorë mbi kanoçe dhe kafshoi buzën teksa teneqeja e nxehtë po i digjte pëllëmbën e dorës. Ishte tepër vonë. Qilimi u hap duke nxjerrë në shesh derën e fshehtë. Ajo u zvarrit në një qoshe, me zemrën që i rrihte aq shpejt, saqë mezi mbushej me frymë. Dikush po luante me unazën e hekurt dhe filloi të ngrinte derën e fshehtë. Një rreze drite përshkoi bodrumin e errët. Pastaj dera u mbyll. Diçka e rëndë u dëgjua të përplasej në të. Dukej si zhurma e një trupi që binte përdhe.

Një burrë bërtiti dhe dhoma e gjumit u mbush me zhurma njerëzish që përlesheshin, që mezi merrnin frymë, grushte që godisnin muskuj dhe kocka, gulçime, thyerje drush dhe kërcitje, orendi që përplaseshin përdhe. Pastaj, u dëgjuan zëra të mbytur dhe nga dera e fshehtë dukej sikur po tërhiqej diçka e rëndë. Dikush mbërtheu unazën e hekurt dhe e hapi derën me gjithë

fuqinë që kishte. Klara gulçonte.

Ishte Brunoja.

Ajo u çlirua, me një dorë mbi zemrën që po i buçiste.

- Je mirë? - e pyeti ai.

Ajo pohoi me kokë, u kacavor derisa u ngrit më këmbë dhe i ngjiti shkallët me leqet e këmbëve që i dridheshin. Lorenci ishte ulur mbi shtrat. Me njërën dorë që i dridhej, kishte mbuluar buzën e gjakosur. Dy roja ishin shtrirë sa gjatë gjerë përdhe, njëri me bark, ndërsa tjetri me shpinë. Sytë i kishin të mbyllur.

- Kanë vdekur? - pyeti Klara me një frymë.

- Jo, - iu përgjigj Brunoja. - Eja! Duhet të largohemi prej këtej!

Ajo iu afrua Lorencit.

- Je mirë? - e pyeti.

Ai tundi kokën dhe u ngrit, pastaj mori xhaketën e tij dhe ia zgjati Klarës.

- Në liqen bën shumë ftohtë, - i tha.

Në fillim ajo ngurroi, por pastaj, futi krahët, u kthye dhe përqafoi Lorencin.

- Faleminderit që na ndihmove, - i tha ajo.

Lorenci u ngërdhesh, duke mos e hequr dorën nga buza.

- Shpresoj ta gjeni sa më shpejt vajzën, - tha ai me sytë që i shkëlqenin.

- Shkojmë, - vijoi Brunoja, me ton të prerë. - Duhet të ikim!

Të tre dolën me vrap nga kasollja dhe u zhdukën në pyllin e errët. Lorenci u tregonte rrugën. Hëna që sapo kishte dalë, i jepte mbrëmjes një shkëlqim kaltërosh, duke bërë dritë të mjaftueshme që ata të mund të shikonin se ku po ecnin. Klara nuk ia lëshonte dorën Brunos teksa vraponte duke dredhuar poshtë degëve e duke vrapuar përreth pemëve dhe shkurreve. Në largësi, fenerët lëviznin lart e poshtë përreth bllokut të errët të gurit në *Chapin Hall* dhe llambat e vajgurit regëtinin përgjatë pavijoneve të pacientëve, duke krijuar hije të gjata në formën e njeriut mbi muret me tulla dhe dritaret me kangjella. Rrezet e elektrikëve të dorës lëkundeshin matanë lëndinës, teksa figurat e turbullta po afroheshin gjithnjë e më shumë pranë hangarit të varkave dhe dokut. Kishte nisur të binte dëborë me flokë të trashë dhe të ngadaltë. As vetë nuk

e kuptoi pse, por kjo skenë e bëri Klarën të mendonte sikur po këndonte me familjen e saj dhe ishte gati të qeshte me të madhe me çmendinë e kësaj skene. E çorientuar, u pengua në një shkop.

- Kujdes! - pëshpëriti Brunoja, duke e mbajtur.

Ajo ndaloi që të rregullonte frymëmarrjen.

- Si do të futemi në ujë pa na parë? - pyeti.

- Varka me rrema është fshehur në breg, - tha Brunoja, - në krahun tjetër të një rruge, në fund të këtij pylli. Asnjë nuk do të na shikojë, por duhet të nxitojmë.

Ajo ia bëri me kokë dhe nisën të vraponin sërish.

Kur mbërritën në fund të pyllit, ndaluan për të kontrolluar rrugën. Ajo ishte e boshatisur. Lorenci u nis në drejtim të kundërt me ta. U ngjit mbi një breg lumi dhe u zhduk, pastaj koka e tij u shfaq sërish lart dhe ua bëri me shenjë që ta ndiqnin. Ata panë nga të dyja anët, u nisën si shigjetë përmes rrugës, mandej, u kacavorën te bregu i lumit dhe zbritën poshtë bregut shkëmbor.

Lorenci dhe Brunoja nxorën varkën me rrema nga vendi ku e kishin fshehur, poshtë një grumbulli me shkurre lulemustakë, dhe e tërhoqën drejt bregut. Kiçi i drunjtë u gërvisht mes gurëve. Paskëtaj, burrat e shtynë kiçin në ujë, shpinëkërrusur mbi pupë. Klara hodhi sytë nga liqeni. Nën dritën e argjendtë të hënës pasqyroheshin valët e buta, teksa dëbora binte ngadalë dhe pa u ndier në ajrin e ftohtë të mbrëmjes. Akulli ishte thyer para disa ditësh dhe tani, copa të vogla pluskonin në ujë sa andej-këtej duke u përplasur me njëra-tjetrën. Shtresa të holla akulli kërcisnin dhe tringëllonin si zilka të largëta e të qelqta. Ajo mori frymë thellë dhe pastaj e mbajti, e sigurt se mund të shijonte frymëmarrjen e pastër dhe të freskët të lirisë.

- Nxito! - i tha Brunoja. - Hip në varkë!

Dallgët përplaseshin lehtë pas varkës duke e përkundur atë lart e poshtë, si të ishte djep. Lorenci u mbajt te pupa, teksa Brunoja ndihmonte Klarën të zbriste nga shkëmbi dhe të hipte në varkë. Ajo zuri një vend pranë kiçit dhe priti në ankth. Burrat u futën në liqen, me shpatullat kërrusur nga të ftohtët. Uji u vinte deri te kofshët. Brunoja u kap pas pjesës së pasme të varkës dhe bëri që të kërcente brenda. Pikërisht në atë çast, Klara pa drita në majë të bregut të lumit. Doktor Roaçi dhe dy roja u shfaqën në majë të tij me fenerët që i mbanin lart. Një nga rojat i ra bilbilit dhe që

të dy u kacavorën poshtë bregut. Brunoja u ul sërish në ujë dhe u mundua të ndihmonte Lorencin, i cili ishte ende duke u mbajtur pas pupës, që të hipte në varkë. Lorenci tundte kokën në shenjë mohimi, duke rezistuar.

- Duhet të vish me ne, - i tha Brunoja. - Ata do të të fusin në izolim!

- Jo, - ia ktheu Lorenci duke tundur kokën gjithë ashpërsi. - Unë nuk do të vij.

- Të lutem! - iu drejtua Klara. - Hip! Duhet të ikim!

- Jo, - tha Lorenci prerë. - Unë do të qëndroj këtu.

- Mos lëvizni! - bërtiti doktor Roaçi.

Ai zbriti poshtë bregut me shkëmbinj, u pengua dhe mend ra.

Rojat u sulën përmes shkëmbinjve dhe u vërsulën me vrap drejt ujit duke shkuar kundër dallgëve sa më shpejt që mundeshin, me krahët të ngritur lart. Njëri e mbërtheu Lorencin nga koka dhe e zhyti nën ujë. Brunoja e lëshoi varkën dhe e goditi rojën në fytyrë në përpjekje për ta detyruar të lëshonte Lorencin. Klara u ngrit në këmbë, u zvarrit në mes të varkës dhe hodhi rremat në ujë. I tërhoqi dorezat e tyre drejt vetes, duke e larguar varkën nga bregu. I zhyti rremat sërish në ujë dhe nisi të voziste. Këtë herë varka lëvizi drejt burrave.

Një rojë i tretë që mbiu nga hiçi, zbriti bregun me vrap dhe u hodh menjëherë në ujë. Ai e goditi Brunon në kokë me një shkop, me fytyrën e shfytyruar nga sforcimi. Roja i dytë e lëshoi dhe Brunoja u zhduk poshtë sipërfaqes së ujit. Roja u zgjat, supet e tij thuajse u fundosën nën ujë, dhe e ngriti Brunon lart. Ai i kishte sytë të mbyllur, fytyrën të gjakosur dhe flokët të ngjitur pas ballit si leshterikë. Roja e tërhoqi zvarrë deri në breg dhe e lëshoi mbi disa shkëmbinj. Pjesa e poshtme e trupit të Brunos ishte ende e zhytur në ujë. Pastaj, roja vrapoi sërish drejt liqenit. Një nga rojat mbërtheu varkën dhe u mundua të hipte mbi traun tërthor. Klara u ngrit, hoqi rremën nga guzhma dhe e goditi rojën në kokë. Ai ra sërish në ujë dhe koka iu zhyt poshtë. Më pas, e mori veten dhe zgjaste duart kuturu për t'u kapur te varka. Rrëketë e gjakut i zbrisnin në fytyrë. Ajo e ngriti sërish rremën, gati për ta lëshuar me gjithë fuqinë që kishte.

Një e shtënë arme u dëgjua në ajër. Ajo ngriu në vend dhe

ngriti sytë lart, me rremën që vërtitej mbi kokën e saj. Doktor Roaçi qëndronte në breg me një pistoletë në dorë, me krahun të zgjatur drejt qiellit.

- Ndaloni në vend! - ulëriti ai.

Klara e lëshoi rremën dhe druri rrapëlloi nëpër stolat e varkës. Në majë të bregut u shfaqën edhe tri roja të tjera, me këmisha force dhe zinxhirë nëpër duar. Roja që mbante Lorencin nën ujë, e ngriti atë në sipërfaqe. Lorenci i kishte sytë të mbyllur, goja i varej e hapur. Roja e tërhoqi zvarrë drejt bregut dhe e lëshoi pranë Brunos. Klara u hodh nga varka dhe nisi të ecte me hapa të rëndë mes ujit të akullt, drejt bregut, me këmbët e bëra si kërcu. Ajri i ftohtë e godiste në mushkëri si thikë e sapomprehur. Ajo ra në gjunjë mbi shkëmbinj, mes Lorencit dhe Brunos, me frikën që ia shtrëngonte fytin si çengel. I shkundi të dy burrat nga supet, duke u munduar t'i zgjonte, por ishte e kotë.

Lorenci ishte shtrirë me shpinë, me kokën të kthyer në njërën anë. Lëkura e tij dukej pa ngjyrë, buzët të mavijosura. Nuk po merrte frymë. Klara shkundi Brunon, ia largoi flokët e lagur nga sytë dhe ia mori fytyrën e gjakosur mes duarve që i dridheshin, duke thirrur pa pushim emrin e tij. Lëkurën e kishte akull të ftohtë, ndërsa duart të bardha e të squllura. I vendosi veshin në kraharor dhe mbajti frymën, që t'i dëgjonte rrahjet e zemrës, por dëgjoi vetëm rrahjet e zemrës së saj. Ia dha ulërimës dhe u plandos mbi trupin e tij. Gjymtyrët dhe shpatullat i dridheshin në mënyrë të pakontrolluar. Para se të bënte frymëmarrjen e radhës, e mbytën dënesat. Para syve iu shfaqën një palë galloshe. Me atë pak fuqi që i kishte mbetur, ngriti sytë lart.

- Shiko se çfarë bëre tani! - i tha doktor Roaçi, duke ia ngulur sytë me përçmim.

KAPITULLI 21



Izi

Duke u dridhur e tëra, pavarësisht se kishte veshur pallto të trashë, Izi u ul në buzë të pishinës së Pegit dhe Herrit. Në kokë, kishte hedhur kapuçin e bluzës dhe duart i kishte futur në xhepa. Nga qielli binte dëborë dhe një erë e hidhur ia përloti sytë, por nuk e vriste shumë mendjen. Donte të dilte jashtë. Pak më parë, ajo dhe Pegi kishin shkuar në kompaninë e funeraleve "Xheneva" për t'u marrë me detajet e fundit të varrimit të nënës së saj. Llambadarët e zymtë, perdet e rënda të damaskut dhe era e acidit formaldehid i kujtonin të atin. Teksa qëndronte e ulur në zyrën e drejtorit të kompanisë, u ndje sërish shtatë vjeçe. Ashtu, e përhumbur në një det xhaketash dhe fustanesh të zeza, ajo kërkonte gjyshen dhe lutej që të ktheheshin në shtëpi. Iu desh të mblidhte gjithë fuqinë që i kishte mbetur, për të zgjedhur arkivolin e së ëmës, për të vendosur për qemerin dhe, më pas, për t'u dhënë të gjithëve shpjegime se pse nuk do të mbante meshë. Pati ngasjen të brofte në këmbë nga ajo karrige e stilit të mbretëreshës Ana, të hapte dritaren dhe të pyeste se pse ky vend duhej të ishte dhe të dukej aq i dëshpëruar.

Atë çast, nuk po mbushej dot me frymë. Imagjinoi nënën të shtrirë mbi një pllakë metalike brenda sirtarit të ftohtë të morgut

në kompaninë e funeraleve, me muskujt të ngrirë dhe sytë të mbyllur, përgjithmonë. Befas, ndjeu se duhej të merrte ajër. U ngrit dhe eci me mundim përmes lëndinës, duke u orvatur të mbushte mushkëritë me ajër, ndërkohë që bari i ngrirë i kërciste poshtë këmbëve. *Pra, kështu ndihesh kur je jetime,* mendoi ajo dhe ndjeu fytin e sytë t'i përvëlonin. *Tani e tutje, nuk do të ketë më asnjë person që të mendojë për mua çdo ditë, që të më dojë pa kushte. Tani jam përnjëmend fillikat në këtë botë.*

Për vite të tëra kishte menduar se, meqë pjesën më të madhe të kohës kishte jetuar vetëm, vdekja e së ëmës nuk do ta prekte aq shumë sa po ta kishte parë çdo ditë. Por e kishte pasur gabim. Kur Pegi i kishte dhënë lajmin, Izi ishte rrëzuar përtokë dhe e kishin mbytur dënesat, të cilat dukej sikur ia vidhnin të gjithë ajrin nga mushkëritë. Me sytë e përlotur, Pegi ishte ulur në gjunjë mbi tapet, e kishte shtrënguar fort, e kishte lënë të shfryhej dhe i kishte ledhatuar kokën me dashuri. U desh të kalonte më tepër se një orë, para se Izi të mendonte se mund të mbahej sërish në këmbë. Atë çast, mes vdekjes të së ëmës, shqetësimit që së shpejti do të mbushte tetëmbëdhjetë vjeç dhe incidentit në Uillard, dëshira e saj për të prerë veten me brisk sa vinte dhe shtohej. Nuk ishte dorëzuar deri më tani, por nuk reshtte së imagjinuari sikur thyente pasqyrën e kutisë së pudrës që e mbante në çantë, dhe e përdorte për të prerë lëkurën e hollë të krahëve. Mundohej ta bindte veten se ndjenja e lehtësimit do të zgjaste vetëm një minutë dhe se dhembja fizike nuk do t'ia kthente të ëmën. Duhej të mësonte të sillej si e rritur dhe të gjente rrugën e saj në jetë, pa rënë pre e keqardhjes për veten dhe e trishtimit. Nëna kishte sakrifikuar jetën për të. Më e pakta që mund të bënte Izi, ishte të jetonte.

Për fat të mirë, pas incidentit në Spitalin e Sëmundjeve Mendore "Uillard", Shenoni dhe shoqet e saj e kishin lënë të qetë. Kur shkëmbeheshin nëpër korridoret e shkollës, Shenoni ulte sytë. Izi pyeste veten nëse ajo kishte frikë se mos e padiste. Shenoni nuk ishte më e lidhur me Etanin, por Izi i shpërfillte orvatjet e tij për t'i folur. Ai i kishte dërguar një letër me Aleksën, ku i kërkonte falje për gjithçka dhe i lutej që të ndërronte mendim për të. Izi e kishte hedhur letrën në koshin e mbeturinave dhe

kishte porositur Pegin dhe Herrin që, kur Etani të telefononte në shtëpi, t'i thoshin se ajo ishte duke bërë dush ose kishte dalë me shoqet. I duhej kohë për të vënë rregull në jetën e saj dhe për të vendosur se ç'do të bënte më pas. Me gjithë ato që kishin ndodhur, nuk donte të vuante më. Pastaj, kush do të lidhej me një vajzë pa të afërm dhe me të ardhme të pasigurt?

- Izi! - thirri Pegi nga dera e kuzhinës. - Pse nuk hyn brenda? Pas pak, darka do të jetë gati.

Izi psherëtiu, fshiu sytë dhe mori drejt shtëpisë, me stomakun të pështjelluar. Nuk e dinte nëse do mund të fuste gjë në gojë, por Pegi dhe Herri i kishin qëndruar pranë gjatë asaj kohe të vështirë. Më e pakta që mund të bënte, ishte të tregohej e sjellshme me ta. Herri kishte zënë një qoshe në banakun e kuzhinës dhe po priste marule.

- Po bëj takos, - tha ai duke vënë buzën në gaz. - Ti i ke qejf, apo jo?

Izi pohoi me kokë teksa lotët i rrodhën nëpër faqe. Nuk e mbante mend se kur kishte qenë hera e fundit që dikush i kishte thënë se e dinte cili ishte ushqimi i saj i parapëlqyer, jo më të gjente kohë dhe t'ia përgatiste. Por Pegi dhe Herri e kishin lënë pa fjalë duke i gatuar për darkë atë ushqim. Ata kishin paguar për arkivolin dhe funeralin e nënës së saj, duke e shpëtuar njëherë e përgjithmonë nga prehja në varrezat e burgut. Ajo do të varrosej pranë prindërve të saj në Gjenevë. Izi nuk kishte njohur njerëz më bujarë se ata. Po mendonte të gjente një mënyrë për t'i falënderuar, por, sa herë që i bënte gati fjalët në mendje, bllokohej dhe nuk arrinte të nxirrte zë.

Vari pallton dhe qëndroi te këndi i banakut, ende duke u dridhur. Pegi nxori qumështin nga frigoriferi, hodhi pak në një tigan dhe e vendosi mbi sobë.

- Do të të bëj pak çokollatë të nxehtë, - i tha Izit, - dhe ti do ta pish. Nuk ke futur gjë në gojë që në mëngjes.

- Faleminderit! - iu përgjigj Izi dhe buzëqeshi lehtë.

Në atë çast, ra zilja e derës. Herri la thikën dhe nxitoi që ta hapte, duke fshirë duart me një pecetë. Pas një minute, ai u kthye sërish në kuzhinë, i shoqëruar nga Aleksa dhe Etani. Pavarësisht se Izi kishte vendosur t'i qëndronte larg Etanit, zemra nisi t'i

rrihte fort sapo e pa. Ai kishte veshur çizmet e punës, një xhaketë dhe xhinse të zeza. Faqet i kuqëlonin nga të ftohtët. Izi kafshoi buzën e poshtme duke u munduar ta mposhtte ngasjen për të vrapuar drejt tij. Aleksa vrapoi drejt Izit, me sytë e përlotur.

- Je mirë? - e pyeti ajo.

Izi pohoi me kokë dhe e lejoi Aleksën që ta përqafonte duke u përpjekur të mbante lotët. Sapo u shkëput nga përqafimi i saj, Etani e pushtoi të tërën. Kur ai ngjeshi faqen pas së sajës, ajo ndjeu aromën e një parfumi dimëror dhe me zor u përmbajt për ta zhytur fytyrën në të tijën.

- Më vjen shumë keq për nënën tënde, - tha ai.

- Faleminderit! - ia ktheu Izi dhe e përqafoi sa për sy e faqe e pastaj u tërhoq pa mundur ta shikonte në sy. Megjithatë, ai nuk e lëshoi. E tërhoqi sërish drejt vetes me krahët e fuqishëm.

- Të pëlqen ty apo jo, unë erdha vetëm për ty, - i pëshpëriti në vesh.

Izi shtrëngoi sytë fort që të mos qante, por ishte e kotë. Lot të nxehtë nisën t'i rridhnin faqeve.

- Qëndroni për darkë - u tha Pegi. - Herri po përgatit takos. Ai gatuan gjithmonë sa për një ushtri, kështu që kemi ushqim me shumicë.

Etani u përkul dhe, duke i fshirë faqen Izit me gishtin e madh të dorës, tha:

- Unë vdes për takos.

- Edhe unë, - tha Aleksa, duke e fërkuar Izin nga supet.

Izi qeshi, me zemrën të çuar peshë. Mbase nuk ishte krejtësisht fillikate në këtë botë.

KAPITULLI 22



KLARA

Mars 1946

Gjatë shtatë ditëve të fundit kishte rënë shi me gjyma dhe uji gjithë baltë rridhte nëpër kanalet e kullimit përgjatë mureve të tunelit poshtë *Chapin Hall*-it, duke bërë që në dyshemetë prej guri të pllakoste lagështira. Klara qëndronte në rresht pas Esterit, në fund të shkallëve të bodrumit, duke vrarë mendjen nëse do ta vinte re ndokush po të dilte nga rreshti dhe t'ia mbathte poshtë tunelit, drejt morgut, përmes dyerve të mëdha që të çonin jashtë për në lëndinën e gjelbër. Po të thyente xhamin e dritares, të dilte përmes kanatës e pastaj të vraponte me sa i hanin këmbët drejt liqenit, mund të futej në ujë para se ndokush ta kapte. Mund t'i jepte fund këtij tmerri.

Nuk do të flinte më në një krevat të fortë, në një pavijon të ftohtë dhe të ndyrë, s'do të dëgjonte më femrat që mërmërisnin dhe qanin. Do t'i jepte fund mëngjeseve kur i duhej të mblidhte të gjithë fuqinë për t'u ngritur nga krevati dhe të përballej sërish me një ditë tjetër, me të sëmurat që sodisnin jashtë dritareve, që përplasnin kokat pas mureve e ulërinin mes dënesave, se donin të ktheheshin në shtëpi. Mund t'i jepte fund jetës duke qepur rroba, duke luajtur shah dhe duke ngrënë ushqime të shpëlara. Mund t'i jepte fund dëshmisë rrëqethëse të njerëzve që keqtrajtoheshin dhe

dendeshin me barna. Mund t'i jepte fund dhembjes së tmerrshme në kraharor, ku çdo rrahje e zemrës së saj të copëtuar ishte si një thikë që i ngulej mes brinjëve.

Uli sytë dhe pa duart. Në majat e shumicës së gishtërinjve, ishin krijuar të çara nga tërheqja e perit për vite të tëra, ndërsa në majën e gishtit të mesit kishte dhëmbëzime të krijuara nga gishtëzat e qepjes. Thonjtë i ishin ngrënë deri në rrëzë, lëkurën e kishte të thatë dhe me kallo, si duart e një të moshuare. Iu kujtuan duart e nënës: të buta dhe me manikyr, me thonj të lëmuar dhe lëkurë me aromë livande. U mundua të imagjinonte se si do të ishte nëna e saj tani: e thinjur, e rrudhosur, duke rrufitur çaj me takëmet e porcelanit të importuara, e ulur në një divan të kadifenjtë. Pyeste veten nëse i ati ishte ende gjallë, nëse ata po i jetonin të lumtur vitet që u kishin mbetur, të sigurt dhe të ngrohtë në shtëpinë e tyre të madhe. A mendonin ndonjëherë për të? A e pyesnin ndonjëherë veten nëse ajo ishte mirë, nëse ishte ende gjallë? A kishin menduar ndonjëherë të vinin në Uillard dhe t'i përgjëroheshin që ajo t'i falte ose t'u thoshin mjekëve që ta linin të lirë? Apo ndoshta ishin aq të pashpirt, sa nuk mendonin kurrë për të? A ishin penduar ndonjëherë për vendimin për ta hequr qafe vajzën e vetme, si të ishte leckë?

Atë çast, në tunel, era e ftohtë e çimentos së njomë i sillte ndër mend mbrëmjen kur ajo dhe Brunoja u munduan t'ia mbathnin. Edhe pse kishin kaluar aq vite, ajo e imagjinonte ende Brunon me vështrimin e ngulur tek ajo, mbi arkivol, teksa tërhiqte kapakun e arkivolit për ta mbyllur me gozhdë. Po të kishte ditur asokohe ato që dinte tani, do t'u kishte kërkuar Brunos dhe Lorencit që në vend të zonjushës Ani Blumberg, të kishin varrosur atë.

Sytë nisën t'i digjnin dhe, ashtu siç kishte bërë me mijëra herë gjatë këtyre viteve, u mundua t'i fshinte kujtimet e dhimbshme dhe të mendonte për diçka tjetër. Ngriti kokën, u kujtua se atë ditë ishte mbrëmja e kinemasë në *Hadley Hall* dhe pikniku me rastin e 4 Korrikut ishte shumë pranë. Ishin argëtime të vogla, por diçka ndryshe dhe ajo i priste me padurim. Ato e ndihmonin të mos luante mendsh. I kujtonte vetes çdo ditë se nuk ishte kurrë vonë për ndonjë mrekulli. Ndoshta do të vinte një ditë kur ajo të ishte e lirë. Po t'i dorëzohej keqardhjes për veten, me siguri do

të çmendej. Nuk mund të lejonte kurrsesi që të ndodhte diçka e tillë. Nëse donte të mbijetonte, nëse donte ta gjente një ditë Beatrisën, duhej të ruante me çdo kusht logjikën dhe arsyen.

Rreshti ecte përpara dhe ajo arriti të shikonte më në fund tunelin përpara saj.

- Si e quajnë trajtimin e ri? - pyeti Esterin.

- Terapi me elektroshok, - iu përgjigj Esteri. - Por kam dëgjuar rojat që e quajnë edhe "Rrufeja".

- E çfarë do të thotë kjo? - pyeti Klara.

Esteri mblodhi supet. Klara bëri pak anash për të parë rreshtin e grave. Në atë çast, dy roja nxorën nga dhoma e trajtimit një grua pa ndjenja, me barelë, me një çarçaf të hedhur sipër trupit. Çarçafi rrëshqiti dhe ra në dyshemenë e çimentos, duke zbuluar se gruaja ishte krejtësisht e zhveshur. Rojat e çuan në një dhomë në anën tjetër të korridorit. Një infermiere ngriti çarçafin nga toka dhe u shkoi pas duke rrudhur buzët. Rojat u kthyen sërish në dhomën e trajtimit. Pas një minute, nxorën një grua tjetër, të cilën e mbanin në këmbë teksa ecte me mundim drejt një prej karrigeve të vendosura përgjatë murit të tunelit. Gruaja pas Klarës nisi të qante. Klara nuk po e duronte dot. Rreshti vazhdonte të bënte përpara.

Doktor Roaçi u fut në tunel dhe nisi të bënte një xhiro përgjatë rreshtit, duke shkruar emrat e pacienteve mbi një kartelë. Para se të arrinte tek Esteri, dy roja dolën me nxitim nga dhoma e trajtimit, duke mbajtur me barelë një grua tjetër. Ajo përpëlitej e tëra dhe ulërinte me sa kishte në kokë, me duart që i vërviste lart në ajër. Prapa rojave, infermiere Trençi vrapoi drejt doktor Roaçit, e përflakur dhe e shfytyruar.

- Doktor Roaç! - thirri ajo. - Më duket se pacientes i është thyer shtylla kurrizore!

Doktor Roaçi vendosi kartelën nën sqetull dhe nxitoi drejt pacientes. Rojat ndaluan që ta kontrollonte. Ai fërkoi shpinën e gruas me dorën e mbuluar me dorashkë, mori kartelën nga sqetulla dhe ia bëri me shenjë rojave që ta çonin drejt ashensorit të shërbimit.

- Çojeni në infermieri, - i urdhëroi.

Rojat e shtynë barelën drejt ashensorit të shërbimit, duke u

munduar të ruanin ekuilibrin, teksa gruaja godiste me këmbë dhe përdridhej e tëra. Infermiere Trençi ia nguli sytë doktor Roaçit me pamjen e saj të përhershme.

- Ju thashë se ishte graduar shumë, - i tha.

Doktor Roaçi e mbërtheu prej krahu dhe e çoi drejt dhomës së trajtimit, duke i thënë diçka në vesh me inat. Klara shtrëngoi nofullën dhe ndjeu t'i shpejtohej frymëmarrja. Çfarë bënin vallë në atë dhomë? Hodhi vështrimin pas vetes, poshtë tunelit, duke vrarë mendjen nëse mund t'ia mbathte nga e gjitha kjo. Ndoshta mund të arrinte te porta e madhe që të çonte jashtë para se ndokush ta kuptonte që kishte ikur. Pastaj i kujtoi vetes se çfarë kishte ndodhur herën e fundit kur ishte orvatur t'ia mbathte. U drodh e tëra kur kujtoi dhjetë muajt e pambarimtë që kishte kaluar në izolim. Nuk mund ta bënte sërish. Nuk mundej. Ajo eksperiencë thuajse e kishte varrosur për së gjalli.

Rreshti lëvizte përpara. Klara ia nguli sytë gruas që ishte ulur në karrige. Ajo ishte mbështetur me kokën pas murit të tunelit, symbyllur, si të ishte duke fjetur. Nga dhoma, nxorën edhe dy gra të tjera që i ulën pranë saj. Ndoshta ai lloj trajtimi nuk ishte edhe aq i tmerrshëm. Ndoshta u bënte keq vetëm disa njerëzve, atyre me probleme. Pastaj, si pa e kuptuar, një rojë kapi atë dhe Esterin për krahu dhe i çoi drejt dhomës së trajtimit.

Infermiere Mei dhe shtatë infermiere të tjera prisnin brenda dhomës. Në mes të saj, ishin vendosur katër shtretër të shtruar me çarçafë të rinj. Pranë secilit, qëndronte një kuti e drunjtë mbi karrocat metalike. Kutitë kishin brenda një lloj makinerie, disqe, instrumente matëse dhe tela që dilnin nga të gjitha drejtimet. Makineritë përngjanin me një bateri gjigante të futur në prizat e murit me tela të trashë e të zinj. Ato lidheshin përmes dy telave të tjerë me pllaka të lëvizshme. Rojat shoqëruan Esterin dhe Klarën te shtretërit dhe infermieret u thanë të shtriheshin.

Klara ndoqi udhëzimet me duart dhe këmbët që i dridheshin, teksa një rrëke djerse i shkëlqente mbi ballë dhe në buzën e sipërme. Infermiere Trençi e kapi nga mjekra dhe ia tërhoqi atë poshtë duke e detyruar të hapte buzët. Druri i trashë dhe i njomë vinte era dhëmb i kalbur dhe të vjelle. Infermiere Mei qëndronte te koka e krevatit me drurin në dorë dhe i tha Klarës

që ta kafshonte. Ajo nisi të merrte frymë me hundë që të mos i përzihej, me zemrën që i fërgëllonte. Infermiere Trençi ia lidhi me rrip pas shtratit kyçet e duarve dhe të këmbëve. Doktor Roaçi mbante në dorë pllakat e lidhura me makinerinë.

- Tani do t'i nënshtrohesh terapisë me elektroshok, - i tha ai. - Do t'i vendos këto pllaka anash kokës dhe ti do të ndiesh një tronditje të vogël. Nuk ka asgjë për të pasur frikë. Kolegët e mi më kanë siguruar se kanë pasur rezultate shumë pozitive me pacientët që vuajnë nga skizofrenia dhe vegimet. Kjo do të të ndihmojë shumë, Klara.

Dy infermiere e mbanin Klarën nga supet. Papritmas, e pushtoi një vetësiguri e pashoqe, një ndjesi se duhej të ngrihej menjëherë nga ai shtrat. Nuk duhej t'i lejonte kurrsesi t'ia bënin këtë, s'mund t'i lejonte t'ia godisnin trurin me elektroshok. Ajo godiste me këmbë dhe përdridhej, duke u munduar të çlirohej. Luftonte me të gjitha forcat që ta nxirrte atë copë druri nga goja. Infermiere Mei mëshonte mbi copën e drurit me gjithë fuqinë e saj, duke ia mbyllur gojën. Në atë çast, në korridor u dëgjuan trazira. Diçka gjëmoi, si një bubullimë e largët, pastaj u dëgjua një zhurmë tjetër, si një valë uji.

Gratë u turrën në dhomë me ulërima dhe duke u përplasur me njëra-tjetrën në nxitim e sipër. Ato që ishin rrëzuar përdhe i morën nëpër këmbë. Disa u munduan të mbyllnin derën duke u grumbulluar te hyrja, disa të tjera u munduan të futeshin brenda. Dikush ulëriti:

- Përmbytje!

Dera u hap duke i përplasur gratë pas murit dhe duke i hedhur përtokë. Një rrymë uji me lartësi deri te gjuri vërshoi në dhomë dhe rrëzoi edhe infermieret, edhe rojat. Klara shikonte me habi doktor Roaçin dhe infermiere Mein, duke iu përgjëruar në heshtje që ta zgjidhnin. Infermiere Mei ia kishte ngulur sytë derës, e ngrirë, pa e lëshuar ende copën e drurit. Klara lëvizte kokën sa para-mbrapa. Më në fund, infermiere Mei e lëshoi. Klara pështyu me neveri drurin e njomë dhe u ngrit.

- Më zgjidhni! - ulëriti.

Infermiere Mei u zhduk duke iu marrë këmbët nga rryma që vërshonte. Doktor Roaçi e pa teksa u rrëzua e shfytyruar nga

frika, por, në vend që ta ndihmonte, ai shkoi në drejtimin tjetër, duke ecur me mundim mes ujit, drejt fundit të dhomës, duke shtyrë sa andej-këtej infermieret dhe rojat. Hipi mbi një raft, hoqi këpucën dhe u zgjat drejt një dritareje të lartë të bodrumit. Uji e përmbyti dhomën dhe niveli sa vinte dhe ngrihej. Koka e infermiere Meit u shfaq sërish në fund të shtratit të Klarës. Këtë herë, flokët e lagur i ishin ngjitur pas fytyrës, kapela e infermieres ishte bërë shuk, ishte lagur dhe i mbahej pas kokës vetëm nga një karficë e zezë. Ajo u ngrit dhe shtrëngoi me njërën dorë dyshekun, ndërsa tjetrën e zgjati drejt doktor Roaçit.

- Viktor, - tha ajo, duke u kollitur, - më ndihmo! Më ka ngecur këmba!

Doktor Roaçi i hodhi një shikim të shpejtë, pastaj u kthye nga ana tjetër dhe theu dritaren me këpucën e tij. Pa hedhur sytë mbrapa, u ngjit dhe u zvarrit jashtë. Klara mbajti frymën, ndërsa infermiere Mei u zhyt sërish nën ujë me duart e zbehta të mbërthyera fort pas dyshekut, por uji vërshonte aq me furi, saqë krijonte rryma të fuqishme. Ai vërshoi nëpër anët e shtratit duke ia mbuluar këmbët Klarës. Gishtërinjtë iu bënë akull dhe ngriu e tëra. Tërhoqi me gjithë fuqinë rripat me të cilët i kishin lidhur kyçet. Venat e ballit gati sa s'i shpërthyen nga sforcimi. Niveli i ujit i erdhi deri te mesi.

Infermiere Trençi doli në sipërfaqe në krahun e djathtë të Klarës, si një balenë e tërbuar. Gulçonte nga mungesa e ajrit, pështynte dhe hiqte flokët e njomë nga sytë, duke u munduar të gjente një pikëmbështetje. Hodhi një vështrim përqark dhomës, pastaj u zgjat përpara dhe eci me mundim drejt Klarës, me krahët që i tundeshin poshtë e lart, duke hungërirë me sforcim. Më në fund, arriti te shtrati. Niveli i ujit i vinte deri te gjoksi. I zgjidhi rripat rreth kyçeve të Klarës, duke e gjetur me dorë drejtimin nga duhej të shkonte nën ujë. Klara mbajti frymën. Uji i vinte deri te buza e sipërme teksa priste të zgjidhej edhe rripi i fundit. Pastaj, infermiere Trençi u zhduk. E mori përpara rryma e fuqishme. Dritat shkreptinë dhe u fikën, ndërkohë që Klara, më në fund, u lirua e gjitha, në kohë. Koka i preku tavanin. Niveli i ujit sa vinte dhe rritej.

Ajo mbajti frymën dhe notoi nën sipërfaqen e ujit drejt

dritares së thyer, duke gjetur instinktivisht rrugën përmes trupave, çarçafëve dhe jastëkëve. Papritmas, e humbi orientimin, nuk ishte më në gjendje të dallonte nëse po shkonte në drejtimin e duhur. Hapi sytë dhe pa një rreze të dobët drite që valëvitej poshtë sipërfaqes së ujit si një mirazh. Pastaj diçka e errët lëvizi drejt mirazhit, duke e zënë pamjen si një eklips i papritur. Ajo u mundua ta kalonte pengesën, por dikush e mbërtheu prej krahu dhe po e tërhiqte në drejtimin e kundërt. Duke u orvatur të çlirohej, mori gabimisht frymë dhe gëlltiti një gllënjkë ujë. Dikush e mbërtheu prej supesh, si të përpiqej të hipte sipër saj për të dalë në sipërfaqe. Ajo mblodhi forcat dhe bëri përpara, me dhimbjen që po i zhdukej.

KAPITULLI 23



Izi

Dy ditë pas varrimit të nënës, Izi qëndronte pranë Pegit në verandën e një shtëpie të gjelbër të stilit viktorian, me zemrën që i gjëmonte në kraharor. Pasi hezitoi për njëfarë kohe, ajo mori frymë thellë, i ra ziles dhe bëri disa hapa mbrapa. Në anën tjetër të derës, u dëgjuan hapa që nxitonin përgjatë një dyshemeje të fortë. Nga brenda, dikush hapi perden me dantella të dritares, pastaj e çoi sërish në vend. Dikush tjetër po mundohej të ulte dorezën e derës. Dera u hap dhe një grua e re, me syze dhe flokë të shkurtër ngjyrë kafe, u buzëqeshi të dyjave. Izi pyeti veten nëse kishin ardhur në shtëpinë e duhur.

- Si mund t'ju ndihmoj? - i pyeti gruaja.

- Kjo është shtëpia e zonjushës Rita Trenç? - e pyeti Pegi duke buzëqeshur.

- Po, - iu përgjigj gruaja. - Kush jeni ju?

- Kjo është vajza që kam në kujdestari, Izabela, - tha Pegi. - Ndërsa unë jam Pegi Barous, kuratore në muzeun shtetëror. Telefonova pak më parë dhe pyeta nëse zonjushë Trençi mund të na tregonte diçka për kohën kur ka punuar në spitalin "Uillard".

- Ah, po, - tha gruaja, buzëqeshi dhe i zgjati dorën. - Unë jam Reneja, infermierja e Ritës. Hyni brenda, ju lutem!

Reneja i futi brenda, mbylli derën dhe u kërkoi t'i jepnin palltot. Një tufë macesh shumëngjyrëshe mjaullinin dhe shtriqeshin rreth këmbëve të saj, duke trazuar me putra një rrugicë të thurur. Shkallët ishin mbushur me mace që shtriqeshin, ndërsa disa të tjera flinin në divanin e sallonit.

- Uroj të mos jeni alergjike nga macet, - tha Reneja.

Pegi dhe Izi buzëqeshën, tundën kokën në shenjë mohimi, pastaj ndoqën Renenë deri në fund të një korridori të ngushtë, drejt pjesës së pasme të shtëpisë. Në të dyja anët e korridorit, dyert e hapura të çonin në dhomën e ngrënies dhe atë të ndenjjes, të dyja të mbushura me orendi antike. Raftet dhe komotë ishin mbushur me vazo qeramike, statuja të qelqta, ora me xhingla, filxhanë çaji prej porcelani dhe libra pa fund. Izi nuk kishte parë kurrë aq shumë në një shtëpi. Në të gjitha muret, shikoje të varura piktura vaji, portrete bardhë e zi dhe pasqyra të praruara. Nuk kishte vend që të mos ishte mbuluar, gjithçka mbante diçka brenda. Madje, edhe llambat ishin zbukuruar me fjongo e shalle.

- Vetëm jeton zonjusha Trenç? - pyeti Pegi.

Reneja ndaloi dhe u kthye drejt tyre.

- Po, - tha qetësisht. - Ajo ka jetuar gjithmonë vetëm. Nuk ka të afërm. Është shumë e trishtë, por mos u mashtroni nga mosha e saj. Edhe pse është 95 vjeçe, të jep ujë me bishtin e lugës!

- Po kohën kur ka punuar në Uillard, e mban mend? - pyeti Izi.

- Posi jo, - tha Reneja dhe vazhdoi të ecte në korridor. - Këtu kanë ardhur shumë njerëz dhe e kanë pyetur për të afërmit e tyre që kanë qenë të mbyllur në Uillard. I mban mend thuajse të gjithë për të cilët e pyesin.

Pegi i buzëqeshi Izit, së cilës nisi t'i rrihte zemra shpejt. Hynë në një dhomë të madhe në pjesën e pasme të shtëpisë, me një kuzhinë në njërin krah dhe me dhomën e ndenjjes nga krahu tjetër. Drita e diellit depërtonte përmes dyerve tipike spanjolle, duke u pasqyruar në muret e bardha dhe duke e mbushur dhomën me dritë e ajër. Një grua e thinjur ishte shtrirë në një shezlong. Në prehër, kishte hedhur një batanije mbi të cilën qëndronte një mace. Këmbët i vareshin deri në fund të shezlongut, ndërsa shpinën e kishte mbështetur në të gjithë gjatësinë e tij. Fytyra nofullgjerë përngjante me atë të një futbollisti ose mundësi tashmë

të moshuar. Izi nuk kishte parë kurrë një grua të moshuar kaq trupmadhe. Me sa duket, teoria e tkurrjes së trupit me moshën nuk vlente për zonjushë Trençin.

Ajo buzëqeshi dhe u ngrit në këmbë, duke i ftuar të uleshin.

- Mirë se erdhët! - i përshëndeti. - Dëshironi kafe apo çaj?

Pegi dhe Izi u ulën në një divan në ngjyrë kremi, përballë shezlongut.

- Jo, faleminderit! - iu përgjigj Pegi. - Nuk duam gjë.

- Mos kini turp, - vijoi zonjushë Trençi. - Nuk më vijnë shumë vizitorë në shtëpi. Bëjani qejfin një të moshuare dhe pini nga një filxhan çaj. Rene, ka mbetur ndonjë copë nga ai keku me çokollatë?

- Kam frikë se jo, - tha Reneja buzagaz. - Copën e fundit e hëngre sot në mëngjes.

- Sa keq! - tha zonjushë Trençi, buzëqeshi dhe ngriti këmbët në anën e shezlongut, duke e ulur macen pranë saj. - Mund të pimë nga një filxhan çaj, apo jo? Si mund t'i ndihmoj këto zonjusha?

- Shpresojmë që ti të mbash mend një paciente që ka qenë në Uillard, - tha Pegi.

- Ka mundësi ta mbaj mend, - tha zonjushë Trençi. - Si quhet?

Pegi i ra Izit me bërryl. Izi u kapërdi dhe bëri pak përpara.

- Klara Elizabet Kartrajti, - tha Izi.

Zonjushë Trençi u mbështet mirë dhe ngrysi vetullat.

- Jeni të afërm të saj? - pyeti duke e drejtuar shikimin nga Izi.

Izi mohoi me kokë.

- Jo, - tha ajo dhe ndjeu t'i vërshonte gjaku në fytyrë. Po sikur zonjushë Trençi të mos i ndihmonte? Ç'do të bënin më pas? - Kemi gjetur valixhen me sendet personale të Klarës, ato që kishte me vete kur e sollën në Uillard.

- Është pjesë e një projekti të muzeut, - shpjegoi Pegi. - Po mundohemi të rikrijojmë jetët e disa pacientëve që kanë qenë në Uillard. Shteti dha leje që të hapeshin vetëm disa nga kartelat e pacientëve, pasi ato janë të ndaluara edhe për të afërmit e tyre më të ngushtë. Klara është një nga pacientet për të cilën do të donim të hetonim pak më shumë. Në dosjen e saj mungojnë disa gjëra. Për shembull, nuk e kemi gjetur dot certifikatën e saj të vdekjes.

Zonjushë Trençi turfulloi dhe mbylli sytë, duke tundur kokën.

- Me siguri mungojnë shumë gjëra në dosjen e saj, - pohoi ajo dhe mori sërish macen në prehër, duke e ledhatuar me dorën e madhe dhe me gunga. Uli kokën dhe dorën nisi ta lëvizte gjithnjë e më ngadalë, derisa e ndaloi në qafen e maces. Për një sekondë, Izit iu duk se gruan e moshuar e zuri gjumi, por, në atë çast, ajo ngriti sytë dhe tha.

- E mbaj mend Klarën. Ishte shumë e re asokohe.

Izi mori frymë thellë dhe e mbajti përbrenda. Erdhi Reneja, e cila vendosi një tabaka argjendi mbi tavolinë. Zbrazi çajin, i dha secilës prej tyre një filxhan porcelani, mandej, u ul në një kolltuk pranë zonjushë Trençit.

- Mund të merrni limon dhe sheqer, - tha ajo.

Pegi hodhi dy kubikë sheqer në çajin e saj, pastaj bëri të njëjtën gjë edhe për Izin, së cilës i dridhej dora teksa mori filxhanin dhe pjatën e rafinuar. Ajo piu një gllënjkë sa për t'u treguar e sjellshme, pastaj e vendosi sërish filxhanin në tabaka dhe vuri duart e mbledhura grusht në prehër.

- Në dosjen e Klarës shkruhej se ajo kishte lindur një vajzë kur ishte në Uillard, - tha Izi. - Di gjë për këtë?

Zonjushë Trençi pohoi me kokë.

- Po, - tha ajo me zë të ulët. - Mbaj mend që Klara ishte shumë e shqetësuar pasi i morën vajzën.

Izi ngriu në vend, diçka e ftohtë dhe e fortë po i shtrëngonte kraharorin. E gjora Klarë! Humbi jo vetëm lirinë dhe dashurinë e jetës së saj, por edhe të bijën. Si mundet një njeri t'i mbijetojë një dhembjeje kaq të madhe?

- Pra, vajzën e Klarës e dhanë për birësim? - pyeti Pegi.

Një mijë mendime i shkonin nëpër mend Izit. Nëse vajzën e Klarës e kishin birësuar, a ishte rritur ajo në një familje të lumtur apo ia kishin ndërruar vazhdimisht familjet birësuese? Ishte rritur ajo me mendimin se ishte jetime apo se nëna nuk e kishte dashur? A e dinte se cila ishte nëna e saj e vërtetë? Nëse e kishte marrë vesh, a i ishte damkosur jeta ngaqë e ëma ishte mbyllur në një spital mendor? A kishte menduar ndonjëherë të shkonte ta vizitonte? Apo mos ndoshta i kishte fshirë të gjitha mendimet për të ëmën dhe kishte vendosur ta shpërfillte plotësisht ekzistencën e saj? A kishte jetuar me të njëjtën frikë si Izi, që do të pëtfundonte

si e ëma, apo mos ndoshta gjenet e çmendurisë do të lëshoheshin si të harbuara në trurin e saj dhe ajo s'do të mund të bënte dot asgjë për t'i frenuar?

Zonjushë Trençi mohoi me kokë.

- Shumica e foshnjave që lindnin në Uillard, u dorëzoheshin pjesëtarëve të familjes, nëse ata pranonin t'i merrnin, - tha ajo. - Ose jepeshin për birësim. Por nuk është ky rasti i Klarës.

Izi u kapërdi dhe një lëmsh i zjarrtë nisi t'i zmadhohej në fyt.

- Pse jo? - pyeti Pegi, duke u ngrysur. - Çfarë ndodhi me të?

Zonjushë Trençi psherëtiu, duke përdredhur mes gishtave të saj kockëgjerë një tufë qimesh të maces.

- Pse po më pyesni për foshnjën e Klarës? - i pyeti ajo. - Kujtova se donit të mësonit diçka më shumë për Klarën.

Me duart që i dridheshin, Izi nxori ditarin e Klarës nga çanta. - Gjetëm ditarin e Klarës në valixhen e saj, - tha ajo, duke e zgjatur, që zonjushë Trençi ta shikonte. - Këtu tregon për jetën para se të përfundonte në Uillard. Dua ta gjej vajzën e Klarës që të mund t'i jap këtë ditar. Nëse është ende gjallë, dua që ajo ta marrë vesh të vërtetën për nënën e saj.

Zonjushë Trençi ia nguli sytë Renesë. Fytyra e saj tani ishte shumë më e zbehtë nga ç'kishte qenë para disa sekondash.

- Më duhet diçka më e fortë se çaji për këtë rast, e dashur, - tha ajo. - Më sjell pak konjak?

- Është shumë herët, - ia ktheu Reneja. - Nuk ke ngrënë ende drekë.

- S'dua t'ia di fare sa është ora! - tha zonjushë Trençi, duke goditur këmbën me dorën ku i dukeshin venat në ngjyrë blu. - Kam nevojë të rrufis vetëm një gllënjkë të vogël, kaq. Bëj punën për të cilën të paguaj!

Reneja tundi kokën.

- Në rregull, - iu përgjigj, u ngrit në këmbë dhe shkoi drejt kuzhinës. - Por mjekut tënd s'ka për t'i pëlqyer aspak kur ta marrë vesh.

- Ai s'ka për të marrë vesh asgjë, nëse nuk i tregon ti, - i bërtiti zonjusha Trenç, me zërin e ngjirur. Kur Reneja u zhduk në dhomën tjetër, ajo i buzëqeshi vakët Pegit dhe Izit.

- Vajza e Klarës nuk u dha për birësim, sepse ajo ishte e

veçantë, - tha.

- Si "ishte e veçantë"? - e pyeti Pegi.

- Nëna e saj ishte e shëndetshme, - vijoi zonjushë Trençi. - Mjeku përgjegjës e dinte që edhe fëmija do të ishte i shëndetshëm. Ishim thuajse të sigurt që dhe fëmija nuk do të shfaqte asnjë simptomë të ndonjë sëmundjeje mendore.

- Pra, po thua që Klara nuk ishte e sëmurë, - tha Pegi me sy të picërruar. - Që ajo s'e kishte vendin në atë institucion mendor?

- Është e vërtetë, - tha zonjushë Trençi.

- Mjeku përgjegjës e dinte që ajo nuk e kishte vendin atje, - e përforcoi Pegi.

Zonjushë Trençi pohoi me kokë.

- Atëherë, pse e mbajtën të mbyllur? - pyeti Izi. - Pse nuk e lanë të lirë mjekët?

- Asokohe gjërat ishin krejt ndryshe, - tha infermiere Trençi. - Kishte shumë njerëz që s'e meritonin të ishin të mbyllur në një institucion të tillë, veçanërisht gra, por ne nuk ishim në dijeni të rasteve.

- Por ti sapo the që mjeku përgjegjës e dinte që Klara nuk ishte e sëmurë, - përsëriti Pegi.

- Në fillim ai mendonte se ishte e sëmurë, - tha zonjushë Trençi. - Të gjithë ashtu mendonim. Por në këtë rast përfshiheshin gjëra dhe njerëz të tjerë. Kur doktor Roaçi e kuptoi se Klara ishte një vajzë e re, e trazuar dhe me një jetë të vështirë familjare, ishte tepër vonë. Fati i saj ishte vulosur tashmë.

- Pse? - pyeti Izi, e habitur edhe vetë me mllefin e saj.

- Gruaja e doktor Roaçit nuk mund të bënte fëmijë, - tha zonjushë Trençi. - Ata përpiqeshin, por ajo e gjora mbetej shtatzënë dhe më pas bënte abort spontan.

Izi vuri dorën në stomak. Iu duk se po i përzihej keqas.

- Po thua se foshnjën e Klarës e mori doktori? - e pyeti Pegi. Në atë çast, Reneja u kthye me një shishe konjak. Zbrazi pak në çajin e zonjushë Trençit, pastaj e la shishen në tavolinën e vogël të kafesë. Zonjushë Trençi rrufiti një gllënjkë me zhurmë.

- Po, ashtu ndodhi, - tha ajo. - Doktor Roaçi e mori në familjen e tij dhe e rriti si të ishte e bija.

- Di gjë se ku është ai doktor tani? - e pyeti Pegi.

- Po, është varrosur në varrezat e Itakës, pranë bashkëshortes, - tha dhe ia nguli sytë tryezës së kafesë. - S'e kuptova kurrë pse ajo grua qëndroi e martuar me atë njeri.

- Po vajza e Klarës? - pyeti Izi. - Ku është ajo?

- Herën e fundit që mësova diçka, ajo jetonte në Itaka, - tha zonjushë Trençi. - Punonte edukatore në kopsht, më duket.

Izit iu mblodh stomaku.

- Punonte? - tha ajo.

- Ma do mendja se do të ketë dalë në pension, - vijoi zonjushë Trençi. - Duhet të jetë te të gjashtëdhjetat tani.

Izi nxori një psherëtimë e lehtësuar.

- E di si quhet? - e pyeti ajo.

Zonjushë Trençi pohoi me kokë.

- Suzana, - tha. - E shoqja e doktor Roaçit e solli një herë vajzën në Uillard për të takuar të atin. Mendoj se asokohe Suzana duhej të ishte rreth katër vjeçe. Doktor Roaçi u tërbua. I tha së shoqes që të mos e përsëriste më atë veprim. Mua gati sa nuk m'u prenë gjunjët kur mora vesh kush ishte Suzana.

- Po ti, tregove gjë? - e pyeti Izi. - I the doktor Roaçit se e dije të vërtetën?

Zonjushë Trençi mohoi me kokë, duke u ngrysur.

- Nuk do të ndryshonte asgjë, gjithsesi.

- I the Suzanës se ajo ishte e birësuar? - e pyeti Pegi dhe mbështeti dorën mbi gjurin e Izit, pastaj e pa ëmbël në sy. - E di që do të bësh gjënë e duhur duke ia dhënë Suzanës ditarin, - i tha, - por nëse ajo nuk e di që është e birësuar... do të ishte më mirë që gjërat të qëndrojnë kështu siç janë.

- Oh, ajo e di, - tha zonjushë Trençi. - E shoqja e doktor Roaçit ishte një grua e mrekullueshme. Kur ma prezantoi Suzanën, më tha se nuk do të donte kurrë që ajo ta merrte vesh gabimisht se ishte e adoptuar, siç e kishte mësuar vetë ajo. Donte që Suzana të rritej dhe të kuptonte se Zoti kishte vendosur që ajo të mund ta zgjidhte vajzën e saj dhe se ajo kishte zgjedhur atë.

- Sa shpesh e shikoje Suzanën, pasi ia morën Klarës? - e pyeti Pegi.

- Vetëm atë herë e kam parë, - u përgjigj zonjushë Trençi. - Ishte një vajzë shumë e bukur, si e ëma, por me flokë të zinj dhe

sy kafe.

Infermierja e moshuar fshiu faqet.

- Si i ati, Brunoja, - tha Izi.

- Pikërisht, - u përgjigj zonjushë Trençi.

Izi drejtoi trupin.

- Prit një minutë. Po ju nga e dini për Brunon? - tha ajo, mblodhi buzët, pastaj ktheu një gllënjkë tjetër çaji dhe konjaku. Kur u përkul përpara për të vendosur në tavolinë filxhanin me pjatën, duart iu drodhën aq shumë, saqë enët mend i ranë përdhe. Reneja ia mori filxhanin dhe e vendosi mbi tabaka.

- Ndoshta duhet të bëjmë pak pushim, - ndërhyri Reneja. - Më duket se kjo bisedë po e mërzit zonjën.

Zonjushë Trençi ngriti dorën dhe e tundi në ajër, duke mohuar me kokë.

- Jo, jo, - tha ajo. - E kam mbajtur të fshehtë për një kohë shumë të gjatë. Duhet të nxjerr gjithçka që kam përbrenda para se të shkoj në botën tjetër. - Mori frymë thellë, e nxori ngadalë dhe shtoi: - Brunoja erdhi në Uillard për të shpëtuar Klarën.

Izi mori frymë me vështirësi dhe u përflak në fytyrë.

- Arriti ta shpëtonte? - e pyeti.

- Jo, - tha zonjushë Trençi dhe sytë iu zgurdulluan sërish. - Doktor Roaçi e mbylli edhe Brunon në çmendinë.

Një drithërimë i përshkoi Izit shpinën, e më pas edhe qafën. Trupi iu ftoh. U orvat të kapërdinte lëmshin që i ishte mbledhur në fyt, pa mundur të besonte atë që sapo i dëgjuan veshët.

- Je e sigurt? - e pyeti Pegi, me sytë e zgurdulluar.

- Sigurisht që po, - iu përgjigj zonjushë Trençi. - Isha e pranishme ditën kur e shtruan edhe atë.

- E mbyllën para apo pas lindjes së Suzanës? - pyeti Pegi.

- Pas, - ia ktheu zonjushë Trençi.

- Pra, doktor Roaçi e kishte marrë me kohë foshnjën, - vijoi Izi dhe ndjeu diçka të ftohtë e të fortë t'i mblidhej në stomak.

Zonjushë Trençi pohoi me kokë, me buzët e mbledhura.

- Në atë kohë, unë nuk e dija se ku kishte përfunduar foshnja. Mendoja se ia kishin dorëzuar Shoqatës në Ndihmë të Fëmijëve dhe se e kishin dhënë për adoptim.

- Po pas shtrimit të Brunos, a mundi ai ta takonte Klarën? -

pyeti Izi.

Zonjushë Trençi tundi kokën.

- U panë gati një vit më vonë. S'kam për t'i harruar kurrë ata të dy që kërcenin në ditën e Shën Valentinit. Mund të them se ishin bërë për njëri-tjetrin. Ata kujtonin se askush nuk e kishte kuptuar që e kishin gjetur njëri-tjetrin, por unë e dija.

- Pse nuk the gjë? - e pyeti Izi. - Pse nuk u mundove t'i ndihmoje?

- S'do të kisha nxjerrë gjë në dritë, - tha zonjushë Trençi. - Unë nuk kisha asnjë fuqi brenda Uillardit. Përveç kësaj, as Klara dhe as Brunoja nuk kishin të afërm që të kujdeseshin për ta. Kë duhej të vija në dijeni? Po ta merrte vesh doktor Roaçi, do të bënte të pamundurën që ata të mos takoheshin më. E dija që do të takoheshin në ditët e festave dhe gjatë ngjarjeve të veçanta për pacientët, kur pacientët meshkuj dhe femra lejoheshin të qëndronin bashkë, në një vend. Mendoja se kështu, po u jepja mundësinë që të krijonin një jetë të re në Uillard, sado e trishtë që mund të ishte ajo.

- I ka treguar kush Suzanës për prindërit e saj? - e pyeti Izi. - E di ajo që ata kanë qenë të shtruar të dy në Uillard?

Zonjushë Trençi uli sytë.

- Ajo e dinte që e ëma kishte qenë e shtruar në Uillard, - u përgjigj ajo, - por doktor Roaçi i kishte thënë së shoqes se Klara kishte vdekur gjatë lindjes. Me siguri edhe Suzanës i kanë treguar të njëjtën histori.

- Pra, Suzana mendonte se i kishte vdekur nëna, - përforcoi Izi, prerë. - Dhe që ka qenë e çmendur.

Zonjushë Trençi mblodhi supet.

- Besoj se po, - tha.

- Nuk mendon se ajo ka të drejtë ta dijë që nëna e saj nuk ishte e çmendur? - pyeti Izi, pa mundur të fshihte zemërimin.

Zonjushë Trençi mohoi me kokë. Tërhoqi një fill gjithë rrudha nga mënga e bluzës, me gishtërinjtë që i dridheshin.

- Të thashë që e kam parë Suzanën vetëm atë herë. E kam vëzhguar me kujdes me kalimin e kohës, por nuk mendoja se ishte me vend që të ngatërrohesha në këtë histori.

- Di gjë se çfarë mbiemri përdor tani? - e pyeti Izi. - A është

martuar?

- Nuk e di, - tha zonjushë Trençi duke tundur kokën. - Më vjen shumë keq!

- Po emrin e saj të dytë e di? - pyeti sërish Izi.

Zonjushë Trençi pohoi me kokë.

- E ka Klara, - tha ajo. - Bashkëshortja e doktor Roaçit këmbënguli që ajo të kishte një lidhje me nënën biologjike.

- Çfarë ndodhi pasi Brunoja dhe Klara gjetën njëri-tjetrin ditën e Shën Valentinit? - pyeti Izi. - E kaluan gjithë jetën më pas në Uillard? A gjetën ndonjë mënyrë për të qëndruar bashkë, siç the edhe ti?

Zonjushë Trençi fshiu hundët me shami.

- E po, - tha ajo, - për këtë do të ishte më mirë të pyesni Klarën. Certifikata e vdekjes nuk gjendet në dosjen e saj, pasi ajo është ende gjallë.

KAPITULLI 24



Izi

Një javë pas takimit me zonjushë Trençin, Izi ishte ulur përballë Pegit në vagonin-restorant "Itaka", që vetëtinte nga dritat fluoreshente, duke tundur gjurin poshtë tavolinës. Ishte mesditë dhe restoranti ishte mbushur plot e përplot me studentë, çifte të moshuarish dhe familje me fëmijë të vegjël. Kamerieret jepnin porositë me zë të lartë, duke nxituar lart e poshtë me tabakatë e mbushura me byreçka me mish, kek me mollë, birrë me akull dhe kafe. Zilja mbi derën kryesore tringëlloi sërish, për të njëqindtën herë, dhe Izi zgjati kokën përtej tavolinës së tyre, duke u munduar të shikonte se kush po hynte. Ishin një i moshuar trupvogël, me një kapelë veterani në ngjyrë blu dhe një grua me pallto të verdhë, të cilët ecnin duke u tundur sa andej-këtej në vagonin-restorant. Izi psherëtiu dhe mori kutinë e kripës, duke e rrotulluar nëpër gishta.

- E ke dëgjuar ndonjëherë shprehjen "kur e do shpejt, nuk bëhet"? - e pyeti Pegi duke qeshur.

- Ndoshta ka ndërruar mendje, - ia ktheu Izi.

- S'e besoj, - tha Pegi dhe pa orën. - I thashë të takoheshim mes paradites dhe orës 12:30. Ora tani është 12:10.

Në atë çast, u afrua kamerierja, e skuqur e tëra dhe mezi

merrte frymë. Ishte e re, thuajse nja dy vjet më e madhe se Izi. Flokët biondë i kishte kapur bisht. Futi pas veshit një cullufe ballukesh, nxori nga përparësja bllokun e shënimeve dhe buzëqeshi.

- Çfarë dëshironi të porosisni? - i pyeti.

- Po presim dikë, - iu përgjigj Pegi. - Tani për tani, do të porosisim vetëm pijet, nëse nuk ka ndonjë problem.

Kamerierja hodhi sytë pas saj.

- Në rregull, por do të vonohet shumë i njohuri juaj? Shefit tim nuk i pëlqen kur njerëzit e zënë tavolinën për një kohë të gjatë.

Pegi buzëqeshi.

- E presim nga çasti në çast, - theksoi ajo, - por herën tjetër kur të kalosh këtu, edhe nëse ajo nuk ka ardhur, ne do të porosisim gjithsesi.

- Dakord, - tha kamerierja. - Çfarë dëshironi për të pirë?

Pegi dhe Izi porositën kafe e një *Coca-Cola* dhe pritën në heshtje teksa kamerierja e mbajti shënim porosinë e tyre të thjeshtë. Më në fund ajo u largua, me bishtin që i tundej sa nga njëra anë në tjetrën. Izi hapi gojën për të thënë se pronari duhej të ishte i paedukatë, që kërkonte që klientët të mbaronin punë shpejt e shpejt, kur një grua e moshuar iu afrua tavolinës së tyre. Palltoja e gjatë, e zezë dhe çizmet e lëkurës i jepnin një hije fisnikërie dhe shalli në ngjyrë të purpurt, i lidhur pas qafe, kombinohej me tonin e lehtë të syve. Izi mbeti pa frymë. Gruaja ishte imazhi i Klarës, por sytë i kishte më të errët dhe lëkurën në ngjyrë karameli të lehtë.

- Pegi? - tha gruaja me vetullat në formë harku të përsosur.

Pegi rrëshqiti nga vendi i saj dhe i shtrëngoi dorën gruas së moshuar.

- Po, - ia ktheu duke buzëqeshur. - Ju duhet të jeni Suzana. Faleminderit që erdhët, - tha dhe ia bëri me shenjë për nga karrigia e lirë. - Ju lutem, uluni. Unë do të ulem këtu, bashkë me Izin.

Suzana u ul në tavolinën e tyre dhe hoqi shallin.

- Pra, ti qenke Izabela? - iu drejtua ajo, buzagaz.

Izi pohoi me kokë dhe i shtrëngoi dorën Suzanës.

- Gëzohem që ju njoh, - pëshpëriti ajo, me zërin që i dridhej nga nervozizmi. Shtrëngoi çantën që ndodhej në shiltenë pranë saj, duke imagjinuar që ditari i Klarës ishte i sigurt aty brenda. Rrahjet e zemrës nisën t'i shpeshtoheshin.

- Përse dëshiroje të më takoje me kaq ngulm, Izabelë? - e pyeti Suzana. - Nëna jote më tha se doje të më tregoje diçka, diçka që ka lidhje me vendin e punës së babait tim, me spitalin "Uillard".

Izi u kapërdi dhe u ngrit në këmbë.

- Po, unë...

Në atë çast, kamerierja energjike u shfaq sërish me pijet e Izit dhe të Pegit. I vendosi mbi tavolinë dhe i hodhi një sy Suzanës.

- T'ju sjell diçka për të pirë, sa t'i hidhni një sy menysë? - tha ajo.

- Patjetër, - tha Suzana. - Dua një filxhan çaji të nxehtë, të lutem. Me limon.

- Menjëherë, - tha kamerierja dhe u largua.

- E keni problem nëse them disa gjëra para se të fillojmë? - pyeti Pegi Suzanën. - Ndoshta mund t'ju bëj disa pyetje, që të mos kemi asnjë keqkuptim më pas.

Suzana buzëqeshi.

- Sigurisht, - tha ajo.

Pegi qëroi fytin.

- Unë jam nëna kujdestare e Izabelës, - vijoi ajo. - Jua kisha thënë më parë këtë?

Suzana mblodhi vetullat dhe një hije pështjellimi e pushtoi të tërën. Por pastaj, fytyra i ndriti sërish dhe tha:

- Po, ma thatë në telefon.

- Për fat të keq, Izi nuk ka shumë kohë që ka humbur nënën e vërtetë.

- Oh, sa keq! - tha Suzana duke rrudhur vetullat. - Më vjen shumë keq. Edhe unë e kam humbur nënën, menjëherë pasi kam lindur.

- E di - iu përgjigj Izi, - dhe më pas të birësuan.

Pegi u mblodh e tëra dhe e pa Izin me sy të zgurdulluar. Ishte shumë shpejt, por Izi nuk mund të përmbahej. Dëshira për t'i treguar Suzanës të vërtetën për Klarën dhe Brunon e bënte të

ndihej sikur po e mbante gishtin në një prizë elektrike. Fshiu duart te prehri dhe u ul mbi to.

- Nga e di ti këtë? - e pyeti Suzana dhe ia nguli sytë Pegit, sikur ta pyeste për diçka. - Çfarë po ndodh këtu?

- Ju kërkoj ndjesë, - u shfajësua Pegi. - Izi është pak e nervozuar. Por ashtu siç shpresoja edhe unë, ju e konfirmuat humbjen e nënës kur fola për mamanë e Izit.

- Pse nuk më pyetët? - tha Suzana. - Mendova se donit të dinit diçka më shumë për Uillardin dhe për babanë tim, doktor Roaçin.

- Do t'ju shpjegojmë gjithçka, - vijoi Pegi. - Ju jap fjalën, por më parë, duhet të dimë disa gjëra.

Suzana psherëtiu.

- Në rregull, - tha. - Çfarë dëshironi të dini?

- Keni shumë informacione për nënën biologjike?

- Vetëm ato që më ka treguar nëna birësuese, që ajo ka qenë paciente në Uillard.

- Vetëm kaq? - e pyeti Pegi.

- Im atë nuk donte të flisnim për këtë temë, - shpjegoi Suzana. - Nëna ime biologjike kishte qenë një nga pacientet e tij dhe vdiq kur po më lindte mua. Vetëm kaq di. Para rreth pesëmbëdhjetë vjetësh, pas vdekjes së nënës birësuese, u mundova të gjeja të dhënat e nënës sime të vërtetë, edhe pse nuk ia di emrin e plotë. Nuk më lejuan të kontrolloja nëpër arkiva, edhe pse jam pasardhëse e një ish-pacienteje. Për mendimin tim, kjo nuk ka asnjë kuptim. Madje, nuk më thonë as se ku e kanë varrosur time më, që të mund t'i shkoj te varri.

Izi bëri pak përpara, me zemrën që i fërgëllonte.

- Kishit marrëdhënie të mira me babanë birësues? - e pyeti ajo.

- Ç'lidhje ka kjo? - pyeti Suzana, duke ngritur kokën.

Pegi ceku pjesën e tavolinës përpara Izit, si për t'i thënë që ta merrte shtruar.

- Mendoj se e di se çfarë do të thotë Izi. Le ta marrim pak më shtruar, - tha ajo, i hodhi Izit një tjetër shikim që të tregohej e duruar, pastaj vazhdoi më tej. - Pra, ju keni dashur gjithmonë të dinit për nënën tuaj të vërtetë?

Suzana mblodhi supet.

- Sigurisht. Besoj se të gjithë duan të dinë se nga e kanë prejardhjen, apo jo? - tha ajo, shtrëngoi duart me gishtat me manikyr në cepin e tavolinës dhe psherëtiu. - Duhet ta pranoj se, kur kam qenë më e re, nuk doja të dija asgjë për nënën e vërtetë. Mendimi se ajo ishte e sëmurë mendore, më kallte datën. Por, teksa rritesha, kuptova se kjo frikë pati një ndikim shumë të madh në vendimet që unë kam marrë në jetë. Nëna birësuese nuk e kuptoi kurrë pse nuk doja të martohesha dhe të lindja fëmijë. Nuk dija si t'ia shpjegoja se këtë vendim e kisha marrë ngaqë kisha frikë...

- Se keni trashëguar gjenet e nënës suaj, - tha Izi.

- Më se e drejtë, - tha Suzana me zë dyshues. - S'e kam idenë se çfarë ADN-je përmban gjaku im. Kisha frikë të pyesja tim atë. Pjesën më të madhe të kohës, ai ishte shumë i dashur dhe i kujdesshëm, por ndonjëherë kishte edhe shpërthime të vogla. Kur kisha arritur moshën që mund të bëja pyetje, ai u inatos keq dhe më paralajmëroi që të mos e pyesja më kurrë për nënën e vërtetë. Nuk mund ta pyesja as nënën birësuese, sepse ajo i bindej urdhrave të tij. Krahas kësaj, nuk doja ta mërzisja apo ta lëndoja. Ajo ishte shumë e brishtë, si nga ana fizike, ashtu edhe emocionale.

- Keni ende dëshirë të mësoni diçka më shumë për nënën e vërtetë? - e pyeti Pegi. - Edhe pse ndoshta këto që do të themi, nuk përputhen fare me ato që ju ka thënë babai juaj?

Suzana u zbeh dhe ia nguli sytë Pegit. Në atë çast, kamerierja solli çajin e Suzanës. Vendosi mbi tavolinë një filxhan të bardhë, një ibrik të argjendtë në miniaturë dhe një pjatë të mbushur me feta limoni. Pastaj, nisi të rrëmonte sërish në xhepin e përparëses për të nxjerrë bllokun dhe stilolapsin. Diçka e gërryente përbrenda Izin.

- Mund të na lësh edhe disa minuta kohë, të lutem? - i tha Pegi.

Kamerierja kapsalliti sytë dhe u largua.

- Nuk po kuptoj asgjë, - tha Suzana. - Si mund të keni informacione për nënën time?

Pegi vijoi duke i shpjeguar pozitën e saj në muze, i përshkroi me pak fjalë projektin "Uillard" dhe se puna e Izit konsistonte

në regjistrimin e sendeve që ndodheshin brenda valixheve dhe sëndukëve të pacientëve. Kur Pegi pohoi se u kishin dhënë të drejtë për të përdorur dosjet e pacientëve, Suzana zgurdulloi sytë, bëri pak përpara dhe dëgjonte gjithë sy e veshë çdo fjalë që thuhej.

- Izi di shumë gjëra për nënën tuaj, - tha Pegi. - Madje, më shumë se unë. Ajo e ndiente si detyrim t'ju takonte dhe t'ju tregonte të vërtetën për prindërit tuaj.

Suzana afroi kokën.

- Prindërit e mi? - pyeti ajo e shastisur. - Im atë nuk e dinte se kush ishte babai im biologjik.

Izi mori frymë thellë.

- Më vjen keq! - i tha ajo. - Kjo nuk është e vërtetë. Doktor Roaçi dinte gjithçka.

- Si "gjithçka"? - e pyeti Suzana. - Të lutem, më trego gjithçka që di.

- Së pari, - tha Pegi, - dua që ta dini se babai juaj birësues nuk kishte për qëllim t'ju lëndonte ju apo nënën tuaj biologjike. Asokohe, trajtimi i personave me probleme mendore ishte shumë ndryshe, ashtu siç ishte edhe përkufizimi për ta. Ai thjesht po bënte detyrën. Megjithatë, nuk jemi të sigurta për arsyet pse ai e shtroi në çmendinë babanë tuaj të vërtetë.

- Po më thua se edhe babai im i vërtetë ka qenë i shtruar në Uillard? - pyeti Suzana me mjekrën që i dridhej. Mblodhi buzët dhe lotët i shkuan çurg. - Falënderoj Zotin që dëgjova instinktet e mia dhe nuk linda kurrë fëmijë!

- Jo, - tha Izi, duke tundur kokën. - Nuk është ashtu si mendoni! - Ajo u zgjat përmes tavolinës dhe vuri dorën e saj mbi atë të Suzanës, e habitur nga instinkti për të ngushëlluar dikë që thuajse nuk e njihte. Me dorën tjetër, nxori një foto nga çanta e saj. - Dua t'ju tregoj diçka, - i tha dhe vuri mbi tavolinë fotot bardhë e zi. - Kjo është Klara Elizabet Kartrajti dhe ky është Bruno Moreti, - tha ajo me zë të mekur. - Prindërit tuaj. Ata nuk ishin të çmendur.

Suzana u përkul përpara dhe e kapi foton me gishtat që i dridheshin.

- Sa të bukur qenkan! - belbëzoi si e trembur dhe vuri mbi buzë dorën që i dridhej.

- Ju jeni kopja e tyre, - tha Pegi.

- Brunoja u mundua ta nxirrte Klarën nga Uillardi, - tha Izi, - por pikërisht atëherë, e mbyllën edhe atë në çmendinë.

- Pse duhej ta bënin diçka të tillë? - pyeti Suzana.

Pegi ia nguli sytë Izit.

Ato kishin vendosur që të mos ia tregonin Suzanës teorinë e tyre, që doktor Roaçi e kishte mbyllur Brunon në çmendinë me qëllim që të mos e merrte vesh se ai e kishte marrë Suzanën si bijën e tij. Kjo ishte e tepërt. Përveç kësaj, ishte shumë herët. Mandej, kjo ishte thjesht një teori.

- Nuk jemi të sigurta, - iu përgjigj Pegi.

- E lanë të lirë më pas?

- Nuk jemi të sigurta se çfarë ka ndodhur, sepse as nuk e kishim kuptuar që ai ishte pacient, - vijoi Izi. - Përndryshe, do të kishim kërkuar edhe dosjen e tij kur na u dha mundësia të kontrollonim.

- Ndoshta na lejojnë t'i përdorim dosjet edhe disa orë më shumë, - konfirmoi Pegi. - Por dyshoj për këtë.

- Kartrajt, - përsëriti Suzana, duke fërkuar mjekrën. - Mbaj mend që e kam dëgjuar këtë mbiemër. Henri Kartrajti dhe gruaja e tij u vranë gjatë shkëmbimit të zjarrit në tunelin "Holland". Asokohe isha njëzet vjeçe, por nuk mbeti media pa e bërë publik këtë lajm, ngaqë ai ishte bankier shumë i famshëm.

- Ata ishin gjyshërit tuaj nga mamaja, - i tha Izi.

Vetullat e Suzanës u ngrysën.

- Po ju nga e dini këtë? - pyeti.

Izi mori frymë thellë, nxori ditarin nga çanta dhe e vendosi me ngadalë mbi tavolinë.

- Sepse gjithçka është e shkruar këtu, - i shpjegoi ajo. - Ky ka qenë ditari i nënës suaj.

Suzana gulçoi dhe preku lëkurën e gjelbër me gishtat e saj delikatë. Hapi ditarin në faqen e parë dhe u hodhi një sy të shpejtë rreshtave të parë.

- Duam që ditarin ta mbani ju, - tha Pegi.

Pas një çasti të gjatë, Suzana rroku ditarin dhe e shtrëngoi në kraharor.

- Faleminderit shumë! - tha ajo duke buzëqeshur mes lotëve. - Nuk e di si mund t'jua shpërblej.

Mori sërish ndër duar foton, me buzët që i dridheshin.

Izi qëroi fytin.

- Ka edhe diçka tjetër, - tha ajo me zemrën që gati sa s'po i buçiste brenda kraharorit. - Nëna juaj nuk vdiq gjatë lindjes. Kur Uillardi u mbyll, vitin e shkuar, ajo u transferua në një azil pleqsh këtu në Itaka.

Suzanës i ra fotografia nga dora, mbuloi gojën me dorë dhe sytë gati sa nuk i dolën vendit.

- Pasi të lexosh ditarin, - tha Izi, - vendos vetë nëse do ta takosh apo jo.

KAPITULLI 25



Izi dhe Klara

Gjela deti të pjekur me feta portokalli dhe pelegrinë me kapela të zeza zbukuronin dritaret dhe muret e azilit të Itakës, edhe pse Dita e Falënderimeve kishte më tepër se tri javë që kishte kaluar. Izi ndiqte Pegin dhe Suzanën përmes korridoreve të ngrohta pas një infermiereje me uniformë në ngjyrë rozë. Balli iu mbush me bulëza djerse. Hoqi pallton dhe e hodhi mbi njërin krah me mendimin se do të kishte bërë mirë të kishte veshur një bluzë më të hollë. Ajri ishte i rëndë. Ndihej era e supës me mish pule, e patateve të ziera, e dezinfektantëve dhe e urinës. Një burrë i moshuar hiqte këmbët zvarrë drejt tyre. Me duart e tij me gunga ishte kapur fort pas dy bastunëve me katër këmbë dhe koka i tundej mbi qafën me lëkurë të hollë. Izi shikonte drejt, duke u munduar të mos ua hidhte sytë shtretërve të azilit dhe mbështetëseve metalike brenda dhomave. Gratë e thinjura, të ulura në karriget me rrota, ua kishin ngulur sytë ekraneve të televizorëve.

Ajo mërmëriti diçka nëpër dhëmbë, e acaruar që azili i pleqve i kujtonte të ëmën, duke u dergjur në shtratin e spitalit të burgut. Lëpiu buzët që kishin marrë një shije të kripur nga djersa. Bota përreth mizëronte nga njerëzit e pashpresë dhe pavarësisht nga numri

i madh i spitaleve, institucioneve dhe burgjeve, asgjë nuk mund t'i ndreqte zemrat e tyre të thyera, mendjet e trazuara dhe shpirtrat e shtypur. Izi mori frymë thellë, u mundua ta hiqte atë mendim nga koka dhe vendosi të përqendrohej te Klara dhe Suzana. Më e pakta, ajo duhej të ishte e lumtur dhe krenare për veten që po orvatej ta ndreqte këtë gabim trashanik, që po orvatej të shëronte një zemër të thyer.

Gjithnjë nëse gruaja që do të takonin tani, ishte vërtet Klara Elizabet Kartrajti.

Deri pak më parë, në parkingun e azilit, kur Suzana i kishte thënë se nuk ishte plotësisht e bindur se kjo grua mund të ishte e ëma, Izi ishte më se e sigurt që zonjushë Trençi e dinte shumë mirë se për çfarë i kishte folur. Por tani filloi ta brente dyshimi. Ashtu siç kishte thënë Suzana, me kalimin e viteve mund të bëheshin edhe gabime. Si në institucionet e tjera të mëdha, dosjet e Uillardit mund të ishin ngatërruar, emrat mund të ishin shkruar gabim. S'ishte e thënë që ajo të ishte Klara Elizabet Kartrajti vetëm sepse një grua thoshte kështu. Gjatë gjashtëdhjetë viteve të fundit, në Uillard kishin hyrë dhe dalë me mijëra gra dhe ekzistonte gjithmonë mundësia që njëra prej tyre të kishte të njëjtin mbiemër me një tjetër. Mundësia për ngatërrimin e identitetit ishte e madhe. Nuk mund të ishin të sigurta se kishin gjetur nënën e vërtetë të Suzanës, e cila po luftonte me veten, duke u munduar që të mos ngjallte shpresa të kota. Ajo donte të ishte e sigurt para se t'i tregonin njeriu, madje edhe personelit të azilit.

Infermierja e re ndaloi më në fund jashtë një dere dhe u kthye drejt tyre. Uniforma rozë shkëlqente si neon nën dritat fluoreshente. Izit i dukej sikur po mbytej, ndaj nisi të kapte fort jakën e bluzës.

- Klara është shpirt njeriu, - tha infermierja. - Me siguri që do të gëzohet dhe do të habitet që kanë ardhur ta vizitojnë. Duhet t'ju paralajmëroj që më përpara: ndonjëherë, kujtesa i bën numra dhe ndryshon humor sa herë që është e turbulluar. Mjekët mendojnë se është në fazat e para të alzhajmerit. E di që keni ardhur për ta pyetur për kohën kur ka qenë e shtruar në Uillard, por nëse ajo nuk e përballon dot, do të jem e detyruar t'ju kërkoj të largoheni. Nëse ju thotë se ka pasur një vajzë, mos e kundërshtoni, bëjani

qejfin. Mërzitet shumë kur dikush mundohet t'ia mbushë mendjen për të kundërtën.

Suzana mezi merrte frymë dhe me njërën dorë shtrëngonte kraharorin. Infermierja e re buzëqeshi dhe i shoqëroi përmes derës së hapur.

Brenda dhomës së vogël dhe pa ajër, dy shtretër ishin vendosur përballë televizorëve të instaluar në mur. Televizorët ishin të fikur, ekranet të zeza. Në shtratin e parë flinte një grua e moshuar, gojëhapur, dhe fijet e flokëve të thinjur i binin mbi fytyrën e rrudhur. Infermierja kaloi pranë shtratit të parë dhe ndaloi në fund të shtratit të dytë, duke e përqendruar të gjithë vëmendjen te një grua e rrëgjuar, e ulur në një karrige, duke soditur nga dritarja.

Gruaja i kishte mbyllur sytë, kishte mbështetur kokën pas karriges dhe flokët i dukeshin si mjegull nën rrezen e diellit që depërtonte përmes xhamit. Gishtërinjtë e shtrembër i ishin mbledhur rreth anëve të mbështetëses së krahut dhe kockat e holla në duart e plakura dukeshin si të ishin brinjë. Këmbët i kishte mbuluar me një batanije të kuqe, pavarësisht se dhoma ishte e nxehtë.

- E ka zënë gjumi? - pëshpëriti Pegi.

Infermierja mohoi me kokë.

- Jo, - tha ajo, - por mezi dëgjon. Klara, shiko! Ke vizitorë, - iu drejtua asaj me zë pak më të lartë.

Klara kapsalliti sytë dhe më pas i hapi. U përkul pak përpara dhe u kthye për të parë, duke u mbajtur me të dyja duart te krahu i karriges për të ruajtur ekuilibrin. Buzët iu zhdukën nën formën e gojës. Lëkura i ishte fishkur nga vitet e gjata të dhembjes dhe dëshpërimit. I vrojtoi fytyrat e tyre një nga një, me kokën e vogël që lëkundej ndonjëherë lehtë.

Infermierja nxitoi drejt saj.

- Po ta kthej karrigen nga ana tjetër që të mund të flasësh me këto zonja të sjellshme, - i tha me zë të lartë, mori një protezë dhëmbësh dhe ia dha Klarës, që e futi në gojë. - Duan të të pyesin për spitalin "Uillard". A s'është diçka e bukur? Të kujtohet Uillardi, apo jo?

Klara mblodhi batanijen në krahët e saj të hollë dhe u ngrit

në këmbë. Kishte veshur një robdëshambër, pantofla të kuqe dhe çorape që i vinin deri te gjuri. Hoqi këmbët zvarrë për t'i liruar rrugën infermieres, duke pritur sa t'ia kthente karrigen. U ul sërish, e hodhi batanijen mbi këmbë, pastaj ia nguli sytë Izit, Suzanës dhe Pegit. Sytë e bardhë i mbetën në fytyrën e Suzanës, e cila uli shikimin dhe nisi të merrej me shallin, duke u orvatur ta hiqte, ndërkohë që faqet iu skuqën. Infermierja mbylli perden mes dy shtretërve.

- Po ju lë vetëm, tani për tani, - tha ajo me zë gazmor. - Por do të vij t'ju shoh shumë shpejt. Mund të bëj ndonjë gjë tjetër për ju?

- Jo, - ia ktheu Pegi, - s'kemi nevojë për gjë. Faleminderit!

Me të ikur infermierja, Suzana u plandos në një karrige që ishte vendosur në qoshen e dhomës. Izi uli çantën e shpinës përdhe dhe rroku nga supet Suzanën.

- Je mirë? - i pëshpëriti.

Suzana fërkoi ballin. Tëmthat i rrihnin pa pushim.

- Jam shumë mirë, - u përgjigj me një zë të dobët.

- Je e sigurt që do t'i shkosh deri në fund kësaj? - i pëshpëriti Pegi. - Ndoshta është shumë herët.

Suzana tundi kokën.

- Jam mirë. E kam seriozisht.

Pegi bëri përpara dhe u ul në gjunjë përpara Klarës, e cila po i shikonte gjithë kërshëri.

- Ç'kemi, Klara? - e përshëndeti ajo me zë të lartë. - Si je?

Klara i fali një buzëqeshje të zbehtë.

- Jam aq mirë sa mund të pritet, besoj, - ia ktheu.

Për habinë e Izit, Klara e kishte zërin të ulët dhe të ngjirur. Për disa arsye, ajo kishte pritur që ta kishte të lartë, si ai i një vajze të re.

Pegi u ngrit në këmbë.

- Unë jam Pegi, - u prezantua ajo. - Kjo është vajza që kam në kujdestari, Izabela, dhe kjo është mikja jonë, Suzana. Duam të flasim me ty për kohën që ke kaluar në Uillard, nëse nuk e ke problem.

Klara pohoi me kokë.

- S'ka asnjë problem, - tha ajo.

- Ne shkuam në Uillard për një projekt të muzeut dhe teksa ishim atje, gjetëm disa valixhe të vjetra, - tha Pegi dhe i bëri shenjë Izit që të hapte çantën e shpinës. - Mes bagazheve, ishte edhe një sënduk i madh. Besojmë se ai është yti.

Klara ia nguli sytë Pegit, me fytyrën të ngrirë si gur.

- Më kupton se çfarë po të them? - vazhdoi Pegi.

Klara pohoi me kokë.

- Do të të tregojmë disa nga sendet që gjetëm brenda sëndukut, për të parë nëse njeh ndonjë, - tha Pegi. - E ke problem?

Klara pohoi sërish me kokë dhe shtrëngoi duart në prehër, ndërsa me gishtin e madh me gunga të njërës dorë fërkonte gungat e tjetrit.

Izi zgjati dorën brenda çantës së shpinës, nxori një partiturë të zverdhur dhe ia zgjati Klarës. Titulli ishte rrethuar me zemra të vizatuara me dorë, "Someone to watch over me", por boja e kuqe ishte zbehur. Klara ngriti kokën për ta parë dhe më pas, gulçoi. Zgjati duart që i dridheshin për të marrë letrën, mandej, e vendosi në prehër. U përkul dhe nisi ta studionte me kokën ulur.

- Kjo është imja, - tha duke ngritur sytë e përlotur. - Ma ka dhuruar një njeri shumë i veçantë për mua. Kam pasur gjithmonë dëshirë të mësoja t'i bija pianos, por im atë nuk më lejonte.

Nga qoshja ku ishte ulur, Suzana shikonte syzgurdulluar, me dorën mbi buzë.

- Po kjo të kujtohet? - e pyeti Izi, duke i zgjatur një kartolinë nga Parisi.

Klara buzëqeshi dhe e mori ndër duar.

- Këtë e kam marrë gjatë një udhëtimi në Paris, kur isha gjashtëmbëdhjetë vjeçe, - shpjegoi ajo duke qeshur mbyturazi. - Doja t'ia dërgoja një shoqes sime, por më pas vendosa ta mbaja si suvenir.

Izi mori frymë thellë dhe nxori foton e Klarës dhe të Brunos. Klara ia nguli sytë. Faqet e zbehta i morën një ngjyrë rozë.

- Oh, po, - tha ajo. - Kemi qenë të bukur, apo jo?

Zgjati dorën për të marrë foton, pastaj vuri duart te mjekra që i dridhej, si të kishte frikë ta prekte. Kafshoi buzën, me sytë që iu mbushën me lot.

- E mban mend kush është ky? - e pyeti Pegi.

Klara rrufiti hundët dhe i fshiu.

- Sigurisht që e mbaj mend, - konfirmoi ajo me zë të mekur. - Ka kaluar shumë kohë që kur e kam parë për herë të fundit atë foto, - tha dhe e mori fotografinë dhe e shtrëngoi fort në gjoks. Pastaj, mori frymë thellë dhe e pa sërish. - Shumë faleminderit që ma sollët.

Me zemrën të çuar peshë, Izi mori ditarin nga çanta e shpinës, u ul në gjunjë para Klarës dhe ia vendosi në prehër.

- Më fal, - i tha ajo, - por e lexova. S'e dija që ishe ende gjallë apo që do të të takoja ndonjëherë... - aty u ndal dhe u kapërdi, para se të vazhdonte, - ndaj kemi ardhur këtu. Falë tij, arritëm të të gjenim.

Klara e ledhatonte lëkurën e gjelbër të ditarit me gishtat që i dridheshin. Për disa çaste, nuk foli. Pastaj, dora e saj reshti së lëvizuri, u mbështet pas karriges dhe psherëtiu.

- Pra, ti di gjithçka? - e pyeti ajo. - E di që im atë më dëboi dhe më mbylli në çmendinë.

- Po, - ia ktheu Izi. - E di. Më vjen shumë keq për gjithçka që të ka bërë.

Në atë që dukej si lëvizje e ngadaltë, Klara i përkëdheli lehtë dorën Izit, mori foton dhe e vendosi brenda ditarit, të cilin e vuri mbi tavolinën pranë karriges. Hoqi batanijen nga këmbët, vendosi duart mbi mbështetësen e karriges dhe bëri të çohej. Izi drejtoi trupin dhe bëri mbrapa me zemrën që i buçiste në kraharor. Kishte frikë se mos Klara i përzinte, se mos i nxirrte jashtë, duke u thënë ta linin të qetë. Klara arriti të ngrihej nga karrigia, me trupin e brishtë që i tundej lehtë. Fshiu pjesën e përparme të robdëshambërit, kaloi gishtat mes flokëve të rrallë dhe mori frymë thellë. Pastaj, ia nguli sytë Suzanës.

- Dhe ti je vajza ime, - tha, - apo jo?

Suzana u ngrit dhe lotët i shkuan rrëke nëpër faqe.

- Besoj se po, - ia ktheu ajo. Klara mbuloi gojën me duart që i dridheshin dhe fytyrën që i kishte ikur fare. Lëvizi ngadalë dhe zgjati duart drejt Suzanës, e cila iu afrua. Ato pushtuan plot emocione njëra-tjetrën, duke qeshur dhe qarë në të njëjtën kohë.

- E kuptova kush ishe që në çastin e parë që të pashë, - tha Klara. - Njoha sytë e Brunos dhe hundën time.

Suzana qeshi.

- Je e sigurt? - e pyeti ajo.

- Në mendjen time nuk isha e sigurt, - tha Klara, - por thellë në zemër e dija që ishe ti.

Pas një minute që zgjati sa një përjetësi, Klara e lëshoi Suzanën dhe fshiu fytyrën. U kthye sërish te karrigia e saj, me pantoflat që i tërhiqte zvarrë nëpër dysheme.

- Eja dhe ulu pranë meje, - e ftoi Suzanën.

Suzana tërhoqi një karrige pranë Klarës, duke e kapur atë për dore.

- Jam munduar të zbuloj më shumë për ty, - tha ajo duke rrufitur hundët. - Por ishte thuajse e pamundur. S'e mendoja kurrë se mund të ishe ende gjallë apo se unë...

Klara e përkëdheli Suzanën në faqe duke ia fshirë lotët me gishtat e hollë.

- Mjaft më, - tha ajo. - Tani jemi bashkë dhe kjo ka rëndësi. E dija që do të vinte kjo ditë. Është e vetmja gjë që më ka mbajtur gjallë gjithë këto vite.

- Po babai im? - e pyeti Suzana. - Është ende gjallë?

Klara mohoi me kokë, me sy të përlotur.

- Brunoja u mundua të më shpëtonte, - vijoi ajo. - Kishim planifikuar t'ia mbathnim dhe të të kërkonim ty. Thuajse ia dolëm mbanë, por na kapën para se të largoheshim. Brunoja u kthye për të shpëtuar burrin që na ndihmoi dhe një rojë e goditi në kokë. Ai... nuk shpëtoi.

- Më vjen shumë keq, - tha Suzana, me zë të mekur.

- Jo, - tha Klara, duke i përmbajtur dënesat. - Duhet të të kërkoj unë të falur. Po të kisha bërë ashtu siç kishin dashur prindërit e mi, Brunon nuk do ta kishin vrarë dhe ne të dyja do të ishim bashkë për gjithë këto vite.

Suzana i shtrëngoi dorën Klarës.

- S'ka gjë, - tha ajo. - Ti s'mund ta dije se ç'rrjedhë do të kishin marrë gjërat.

- Dua që ta dish se, nëse do të ishte në dorën time, - vijoi Klara, - nuk do të të kisha larguar kurrë nga vetja. Por ata... - Aty iu mora goja, mjekra i fërgëllonte dhe buzët e holla i dridheshin nga hidhërimi. - Uillardi nuk ishte vendi i duhur për një foshnjë,

por mendjen e kam pasur gjithë kohës te ti. Mendoja se një ditë do të dilja prej andej. Në njëfarë mënyre, do të të gjeja. Nuk do të reshtja kurrë së kërkuari. S'do të lija gur pa lëvizur... - tha dhe uli kokën, me lotët që i pikonin nga maja e hundës.

Suzana e përqafoi Klarën fort.

- E di që nuk ishte faji yt, - tha duke i fërkuar së ëmës shpinën. - Tani që jemi bashkë, mund ta kompensojmë kohën e humbur.

Klara rrufiti dhe fshiu hundët.

- Po, - ia ktheu me zërin e mekur. - Ke të drejtë. - Pastaj, Klara u tërhoq, duke kërkuar sytë e së bijës. - Por dua të di diçka. Të adoptoi ndonjë familje? Ke bërë jetë të lumtur?

Suzana pohoi me kokë, duke u munduar të buzëqeshte mes lotëve.

- Po, - u përgjigj. - Kam qenë e adoptuar dhe pjesën më të madhe të kohës kam qenë e lumtur.

Ajo ia nguli sytë Pegit. Përpara se të vinin këtu, i kishte thënë Pegit dhe Izit se, nëse gruaja e azilit ishte vërtet nëna e saj, nuk donte t'i tregonte për doktor Roaçin. Nuk kishte asnjë kuptim që të gërmonin sërish në të shkuarën. Do të ishte shumë e dhimbshme dhe Klara kishte vuajtur mjaftueshëm.

- Dhe të quajtën Suzana, - i tha Klara.

- Suzana Klara, - ia ktheu Suzana.

- Unë të kisha quajtur Beatris, - tha Klara duke buzëqeshur. - Beatris Elizabet Moreti.

- Më pëlqyeka shumë ky emër, - tha Suzana.

Klara hodhi vështrimin nga Izi.

- Si mund të të falënderoj që ma ktheve time bijë?

Izi buzëqeshi dhe mblodhi supet.

- Ishte diçka që e kisha për detyrë ta bëja, - iu përgjigj ajo.

- Duhet të jesh shumë krenare për të, - i tha Klara Pegit.

Pegi i hodhi krahun Izit.

- Jam, shumë, - ia ktheu ajo.

Në atë çast, infermierja u kthye në dhomë dhe ia nguli sytë Klarës, me ballin e rrudhur nga shqetësimi.

- Çfarë po ndodh këtu? - pyeti ajo. - Je mirë, Klara?

- Jam shumë mirë, - iu përgjigj Klara. - Më mirë se ç'kam qenë prej shumë kohësh. Infermiere Xheni, dua të njihesh me

vajzën time, Suzanën.

Infermierja hapi gojën e shushatur, me sytë e zgurdulluar.

Suzana u ngrit në këmbë dhe i shtrëngoi dorën.

- Gëzohem që njihemi.

- Jua kisha thënë që kam një vajzë, - iu drejtua Klara. - Por asnjë nuk ma vuri veshin, kurrë. Fundja, mua askush nuk ma ka vënë ndonjëherë veshin, - tha ajo dhe qeshi mbyturazi, me sytë që i shndrisnin nga gëzimi.

Ndërkohë që Izi po i jepte Klarës pjesën tjetër të fotografive dhe të letrave që i kishte shkruar Brunos, Suzana e pyeti infermieren për shëndetin e Klarës. Pas disa minutash, ajo u ul në gjunjë pranë Klarës.

- Infermiere Xheni më tha se ti gëzon shëndet të plotë, - tha ajo.

- Besoj se po, - tha Klara. - Vetëm se jam paksa e moshuar, si e ngrirë dhe herë pas here më bën numra kujtesa.

- E po, - ia ktheu Suzana, - do të vish të jetosh me mua? Kam një shtëpi të madhe dhe të vjetër, jo larg prej këtej, me një kopsht të madh dhe dy qen. S'është luksoze, por është shtëpi e ngrohtë.

Klarës nisi t'i dridhej buza.

- U bënë gjashtëdhjetë e gjashtë vjet që s'kam pasur shtëpi, - pëshpëriti me zë të ulët.

- E po, atëherë, - tha Suzana, - shtëpia ime do të jetë edhe jotja, nëse dëshiron. S'kam shumë që kam dalë në pension, do të më kesh ngaherë pranë, që të kujdesem për ty.

Klara vuri buzën në gaz, me sytë që i shkëlqenin.

- Nuk kërkoj asgjë më shumë nga jeta, - tha ajo.

KAPITULLI 26



Izi

Të enjten pas shkolle, duke nxituar për në kuzhinë, Izit po i lëshonte goja lëng teksa imagjinonte biskotat e famshme me çokollatë të Herrit, të vendosura në një pjatë të mbuluar me kapak qelqi në banakun e kuzhinës. Mezi po priste të mbushte një gotë qumësht dhe të kollofiste nja tre a katër syresh. Herri kishte filluar t'i bënte biskotat çdo dy javë dhe këto ishin gjëja më e shijshme që mund të kishte provuar ndonjëherë. I lëshoi librat në stolin që ndodhej pas derës kryesore, vari pallton dhe ngriu në vend. Në njëfarë mënyre, pas gjithë atyre që kishin ndodhur gjatë dy javëve të fundit: varrimi i nënës së saj, biseda me zonjushë Trençin, takimi i parë me Etanin, gjetja e Klarës dhe e vajzës së saj, ajo kishte harruar se çfarë dite ishte.

Pegi dhe Herri qëndronin në kuzhinë dhe fytyrat u shndrisnin nga kënaqësia. Në vend të biskotave, në banakun e kuzhinës kishte një tortë çokollate me trëndafila rozë e të bardhë, me tetëmbëdhjetë qirinj flakërues që pasqyroheshin në sytë e Pegit dhe të Herrit. Në tavan, qëndronin pezull disa tullumbace rozë dhe lejla. Filli i tyre përdredhës ngjante si një shi shumëngjyrësh. Pegi dhe Herri nisën të këndonin këngën e ditëlindjes "Shumë urime për ty". Sa ironike! Kjo ishte ditëlindja, së cilës ajo i ishte druajtur prej kohësh.

- Mendo një dëshirë, - tha Pegi.

- Mirë, - u përgjigj Izi, me fytyrën flakë të kuqe. Mblodhi pas flokët dhe u fryu qirinjve.

- I thashë Pegit se do të ishte më mirë që këngën të ta këndonim pas darkës, - vijoi Herri, - por asaj nuk i pritej. Donte të të bënte një surprizë.

- Faleminderit! - tha Izi. - S'ishte nevoja të më blinit tortë.

- Si jo? - i tha Pegi, doli nga pas banakut dhe e pushtoi Izin fort. - Por kjo nuk është surpriza e vetme. Ka edhe të tjera. Ajo shkoi te tavolina dhe tërhoqi njërën nga karriget.

- Megjithatë, në fillim ulu pak se duam të bisedojmë për diçka.

Izi u ul, rrahjet e zemrës sa vinin dhe i shpeshtoheshin. Pegi mbështeti duart te tavolina e kuzhinës, mori frymë thellë dhe e nxori ngadalë. Qëroi fytin dhe u kapërdi, si të mos dinte nga t'ia niste. Një ngërç i madh trishtimi e mbërtheu në kraharor. *Kaq e pati,* mendoi. *Tani do të më thotë se ka ardhur koha që unë të largohem, pasi ata nuk mund të më mbajnë më në shtëpinë e tyre. Do të mundohet të shfajësohet dhe do të më thotë se donin të më organizonin një festë për ditëlindje, me qëllim që të largohem prej këtej me një kujtim të bukur.*

- Ndoshta është shumë herët, pasi s'ka kaluar shumë kohë nga vdekja e nënës sate, - tha Pegi, - por unë dhe Herri kemi kohë që e diskutojmë. Kemi bërë të gjitha dokumentet dhe... dua të them që tani gjithçka është në dorën tënde, por... - aty ajo vështroi Herrin si t'i kërkonte mbështetje.

Herri u afrua duke fshirë duart pas pantallonave.

- Ne e dimë që, duke filluar që sot, ti je në moshë madhore, - tha ai. - Ndoshta nuk do të të duket ide e mirë, por ne... - shtoi dhe i shtrëngoi dorën Pegit, - kemi dëshirë të të birësojmë, Izi. E dimë që ndoshta mendon se s'është e nevojshme... por ne duam të jemi vërtet prindërit e tu.

Izi mbeti gojëhapur. Nuk kishte fjalë. Pegi ia mori dorën dhe e shtrëngoi mes duarve.

- Të duam të mirën dhe duam të të qëndrojmë gjithmonë pranë, - iu drejtua Pegi me zërin që i dridhej. - Në jetë ke ende shumë vendime për të marrë, vendime që janë të vështira për

t'u marrë vetëm. Duam të të ndihmojmë, të kujdesemi që të ndjekësh universitetin për të gjetur potencialin tënd të vërtetë, cilido qoftë ai. Dhe kur të martohesh... - Pegit iu mbushën sytë me lot e i shtrëngoi dorën Izit edhe më fort, - Herri do ta kishte për nder të të shoqëronte drejt altarit. Dëshirojmë shumë që një ditë të bëhemi gjyshër.

Izi mblodhi buzët me mjekrën që i dridhej. Hapi gojën për të thënë "po", për t'u thënë se dëshironte më shumë se gjithçka tjetër në botë të ishte vajza e tyre, por fjalët i ngecën në fyt.

- Si thua, vogëlushe? - e pyeti Herri.

Izi pohoi me kokë, duke vënë buzën në gaz. Pegi lëshoi një pasthirrmë dhe mbuloi gojën me duar. U ngritën të tre në këmbë dhe u përqafuan. Izi mbylli sytë me lotët që i shkonin rrëke, duke pyetur veten si ishte e mundur që zemra mend po i shpërthente nga ky gëzim i madh, pasi ishte mbushur për aq shumë kohë me hidhërime e dhembje. I shtrëngoi fort Pegin dhe Herrin, duke lejuar që krahët e tyre të fortë t'ia largonin të gjitha shqetësimet dhe frikën.

- Na e bëre zemrën mal! - tha Pegi, duke ndjellë hundët.

Në atë çast, në derën e kuzhinës u dëgjua një e trokitur.

- Hyr! - tha Herri.

Aleksa dhe Etani hynë në dhomë, me krahët të mbushur plot e përplot me dhurata.

- Gëzuar ditëlindjen! - thanë njëzëri.

Pas tyre, hynë Klara dhe Suzana, të kapura për krahu, të dyja të përlotura dhe të mallëngjyera.

Shënime të Autores

Gjatë kohës që kam shkruar romanin "Misteret e Klarës", u jam referuar këtyre librave: "Jetët që lanë pas: Valixhet e një papafingoje spitali", të autorëve *Darby Penney* dhe *Peter Stastny*; "Dhjetë ditë në një çmendinë" të autores *Nellie Bly* dhe "Gratë e azilit: Zëra pas mureve 1840 - 1945" të shkrimtarëve *Jeffery L. Geller* dhe *Maxine Harris*. Megjithëse librat e lartpërmendur më kanë ndihmuar shumë të imagjinoj kushtet brenda një spitali të sëmundjeve mendore, romani im nuk është një vepër historike dhe qëllimi i tij s'është aspak i tillë. Unë kam bërë një interpretim timin të ndjenjave që mund të përjetojë dikush që izolohet dhe dëbohet kundër dëshirës. Personazhet e këtij romani janë të gjithë imagjinarë, por disa nga vendet e përshkruara, si qendra "Long Ajlënd" dhe spitali shtetëror "Uillard" janë të vërtetë. *Chapin Hall*, pavijonet e tij dhe godinat e jashtme kanë ekzistuar vërtet. Në Uillard, ka pasur edhe pavijone të veçanta për pacientët, secili i pajisur me sallën e tij të ngrënies, kuzhinën, zyrën e mbikëqyrësit, apartamente dhe kaldajë. Është gjithashtu e rëndësishme të theksoj se, për qëllime të subjektit të këtij romani, mjekimet dhe terapitë e pacientëve janë portretizuar sikur janë përdorur qoftë më parë, ashtu edhe më pas nga ç'kanë ndodhur në të vërtetë ngjarjet. Grazhdi Utika, një kafaz i drunjtë me kyç, u nxor jashtë përdorimit në vitin 1887. Terapia e insulinës nisi të përdorej në vitin 1935. Terapia me elektroshok u fut në përdorim në vitin 1938. Së fundi, në pjesën dërrmuese të spitaleve të sëmundjeve mendore, roli i psikologut u fut vetëm në vitin 1960.

Ju lutem, shfletoni këto faqe
për një intervistë shumë të veçantë
me *Ellen Marie Wiseman*!

Çfarë ju frymëzoi për të shkruar romanin "Misteret e Klarës"?

Kam qenë gjithmonë kureshtare për spitalet e sëmundjeve mendore, veçanërisht për mënyrën se si trajtoheshin pacientët në të shkuarën dhe si kanë ndryshuar dhe evoluar me kalimin e viteve kuptimi dhe trajtimi i tyre. Kam pyetur shpesh veten si do të ndihesha po të më kishin mbyllur dhe mbajtur në një institucion, kundër dëshirës. U intrigova kur lexova për "Ekspozitën e valixheve të Uillardit", një koleksion me valixhet e pacientëve, të gjetura në papafingon e spitalit pasi ai ishte mbyllur. Atëherë, mësova për librin "Jetët që lanë pas: Valixhet e një papafingoje spitali", të autorëve *Darby Penney* dhe *Peter Stastny*. Misioni i shkrimtarëve ishte të hetonin sendet brenda valixheve, në përpjekje për të rikrijuar jetët e pacientëve që ishin futur në atë institucion, por që nuk kishin dalë kurrë prej andej. Libri është magjepsës, të mban të ngërthyer, pasi fotot dhe historitë janë të lehta për t'u identifikuar. Pasi e lexova atë libër, më lindi dëshira për të shkruar diçka për gjetjen e valixheve dhe ndjenjat që mund të përjetonte një pacient në atë institucion.

Si u ndjetë gjatë kërkimeve nëpër spitale të tilla?

E kisha shumë të vështirë të lexoja për njerëzit që në të shkuarën ishin mbyllur në institucione të ndryshme, në të shumtën e rasteve për gjithë jetën, për shkak të një gjendjeje të dëshpëruar emocionale apo ekonomike. Disa pacientë ishin vërtet të sëmurë, ndërsa shumë të tjerë u mbyllën nëpër këto spitale në rrethana që sot i shikojmë me tjetër sy, si: vobekësia, depresioni, homoseksualiteti, alkoolizmi dhe çrregullime emocionale për shkak të divorcit, mosmarrëveshjeve familjare, marrëdhënieve të këqija dhe humbjes së fëmijëve. Një person mund të mbyllej atje për arsye shumë të thjeshta: kur nuk ishte i aftë të gjente një punë ose për shkak të ndonjë shpërthimi zemërimi në publik. Në fund të viteve 1800, dr. *Judson B. Andrews* shkroi një artikull

të titulluar "Treguesit e hershëm të sëmundjeve mendore" duke sugjeruar se familjet u kushtonin vëmendje "ëndrrave të frikshme, çrregullimeve të gjumit, dhembjeve të përhershme të kokës, teprimeve emocionale, skrupujve të tepruar fetarë dhe ndryshimeve në zakonet e veshjes dhe të pastërtisë".

Femrat ishin më të dobëta. Burrat mund t'i mbyllnin gratë e tyre "që shkaktonin probleme", ndërsa mjekët meshkuj ishin më se të gatshëm t'u bindeshin. Shumë gra punonin si shërbëtore dhe ishin në kontakt të ngushtë me punëdhënësit e tyre. Çdo sjellje e padenjë apo mosmarrëveshje mund të konsiderohej si sëmundje mendore. Deri në fund të vitit të parë të funksionimit të tij, në spitalin "Uillard" ishin mbyllur një numër thuajse i barabartë meshkujsh dhe femrash. Në një rast, një grua që ishte mbyllur atje për shkak të despresionit, i kaloi 75 vitet e jetës atje, derisa ndërroi jetë në moshën njëqindenjëvjeçare. Emigrantët që kishin shumë pak lidhje me komunitetin, ndonjëherë dërgoheshin në spital, ndërsa të afërmit e tyre në mëmëdhe nuk e dinin se ku mund të kishin përfunduar. Shumë pacientë "të çmendur" u mbyllën në spitalet shtetërore. Mund të ishin njëqind apo më shumë persona të ngjeshur si sardele nëpër trena apo autobusë, të cilët nuk kishin asnjë ide se ku po i çonin. Thuajse 54 000 persona që u mbyllen në Uillard, vdiqën atje.

Çfarë ju bëri më tepër përshtypje gjatë kërkimit tuaj?

Ajo që më bëri më tepër përshtypje ishte se sterilizimi i detyruar ishte një praktikë më se e zakonshme në spitalet mendore nga viti 1910 deri në fund të Luftës së Dytë Botërore, kur u ndalua në masë të gjerë, për shkak të krahasimit të tij me politikat naziste. Në disa shtete jugore, kjo praktikë vazhdoi deri në vitet 1960. Duke u nisur nga kjo, zbulova se Shtetet e Bashkuara të Amerikës ishin vendi i parë që mori përsipër programet e sterilizimit të detyruar për qëllime të eugjenikës, ku objektivi janë të sëmurët mendorë. Mes viteve 1907 dhe 1963, mbi 64 000 individë (përfshirë edhe të tjerë që nuk ishin të sëmurë mendorë) u detyruan t'i nënshtroheshin procedurës së sterilizimit, në

përputhje me legjislacionin në fuqi mbi eugjenikën në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Sipas *Edwin Black*, shkrimtar fitues i disa çmimeve për librin "Lufta kundër të dobëtëve: Eugjenika dhe fushata e Amerikës për të krijuar një racë të përsosur", metoda më e zakonshme që sugjerohej në masë për të hequr qafe popullatat "inferiore" ishte eutanazia. Në një raport të kryer në vitin 1911 nga instituti "Carnegie", shkruhej se eutanazia ishte një nga "zgjidhjet" e rekomanduara për spastrimin e shoqërisë nga vetitë e papërshtatshme gjenetike. Metoda më e sugjeruar ishte krijimi i dhomave të gazit. Megjithatë, shumë persona të përfshirë në lëvizjen për eugjenikën nuk besonin se amerikanët ishin gati për zbatimin e programit të eutanazisë në një shkallë të gjerë. Për pasojë, shumë mjekë duhej të gjenin mënyra të tjera që ta përdornin eutanazinë eugjenike në institucione të ndryshme mjekësore. Për shembull, në një institucion mendor, pacientëve u jepej qumësht i infektuar me tuberkuloz (duke gjykuar se personat e shëndoshë gjenetikisht do të ishin rezistentë). Për pasojë, përqindja e vdekjeve në vit u rrit me 30 deri në 40 për qind. Mjekë të tjerë përdornin eugjenicide përmes formave të ndryshme vdekjeprurëse.

Çfarë mësuat lidhur me trajtimin që u ofrohej pacientëve nëpër spitalet e të sëmurëve mendorë?

Barnat psikotropike u zbuluan nga mesi i viteve 1950 dhe barnat me të cilat mund të mjekoheshin pacientët ishin qetësuesit e ndryshëm. Pacientët që shfaqnin simptoma psikiatrike si pasojë e sifilizit, trajtoheshin me arsenik dhe infektoheshin me malarie. Në spitalin "Uillard", roli i psikologëve nuk ekzistonte deri në vitet 1960 dhe pacientët takoheshin rrallë me mjekun. Sipas *Darby Penney*-it, bashkautor i librit "Jetët që lanë pas", disa pacientë nuk u vizituan nga një mjek për dekada të tëra. Në vitet 1930, periudhë kur zhvillohet historia e Klarës, në trajtimin e pacientëve përfshiheshin banjat me akull, punët artistike, punët e dorës dhe stërvitjet. Disa vite më vonë, në trajtimin e tyre u përfshinë terapia me insulinë dhe ajo me elektroshok. Gjatë kërkimeve të mia, nuk gjeta asnjë provë për kryerjen e lobotomisë

në Uillard. Pacientët e fuqishëm, të cilët nuk ishin të rrezikshëm apo që nuk shfaqnin iluzione të shpeshta, ngarkoheshin me punë të ndryshme. Kjo konsiderohej si një trajtim terapeutik.

Mund të na thoni ndonjë informacion tjetër për spitalin "Uillard?

Ashtu si pjesa dërrmuese e institucioneve mendore, funksionimi i Uillardit varej nga puna e pacientëve të tij, të cilët nuk paguheshin për atë që bënin. Ai spital zotëronte mbi gjashtëqind akra tokë fermere, serra, një baxho, stalla, pulari, stalla derrash dhe hangarë, ku kultivoheshin dhe përpunoheshin thuajse të gjitha ushqimet. Në punishtet industriale prodhoheshin veshje, këpucë, fshesa, shporta, sapunë dhe arkivole. Kishte edhe lavanteri, furra buke, kuzhina, thertore, zdrukthëtari, punishte për prodhimin e tullave, kovaçhanë dhe një central elektrik që vihej në punë me qymyr, kaldajat e të cilit furnizoheshin me qymyrin që pacientët transportonin me karrocat e dorës nga hekurudha pranë spitalit. Këto impiante mbikëqyreshin nga punëtorë me pagesë, por pjesën më të madhe të punës e kryenin pacientët, të cilët formonin skuadrat e terrenit, bënin gërmime për ndërtimet e reja, pastronin pavijonet dhe zyrat, shërbenin ushqimin dhe kujdeseshin për qendrën luksoze të drejtuesve të institucioneve.

Romani juaj i parë, "Pema e kumbullës", bazohet kryesisht në përvojat që nëna juaj kaloi gjatë fëmijërisë së saj në Gjermani dhe përqendrohet te historia e një gruaje të re dhe kaosi i shkaktuar nga Lufta e Dytë Botërore. Ajo mundohet të shpëtojë të dashurin, i cili ishte hebre. Cili ishte ndryshimi mes atij libri dhe romanit "Misteret e Klarës"?

Ndryshimi më i madh ishte kronologjia e dyfishtë e ngjarjeve. Në parim, duhej të shkruaja dy histori dhe t'i ndërthurja në mënyrë që të përshtateshin me njëra-tjetrën. Ishte shumë më e vështirë nga sa e kisha menduar.

Mund të na thoni nëse ka ndonjë temë të përbashkët të trajtuar në romanin "Pema e kumbullës" dhe te "Misteret e Klarës"?

Po. Kristina (në romanin "Pema e kumbullës") dhe Klara ishin të dyja vajza të reja, të cilave u ishte mohuar e drejta për të bërë një jetë normale gjatë kohës së ndryshimeve të mëdha sociale. Kristina ishte viktimë e periudhës së vështirë ekonomike, luftës dhe intolerancës së qeverisë ndaj individëve të veçantë. Klara ishte viktimë e krizës në tregun e bursës, e pritshmërive që i ati dhe shoqëria kishte për femrat e shpallura të sëmura mendore dhe e intolerancës së qeverisë ndaj individëve të caktuar. Ka shumë të ngjarë që para se Klarën ta dëbonin nga shtëpia, ajo, ashtu si Kristina, kishte parë me siguri afishe përmes së cilave kërkohej "spastrimi" i shoqërisë nga personat që konsideroheshin të papërshtatshëm. Në një afishe për eugjenikën në vitin 1926, në Amerikë, ishte shkruar: "Disa njerëz kanë lindur për të qenë barrë për të tjerët". Kjo i kujtonte njerëzit se një person lindte në çdo gjashtëmbëdhjetë sekonda dhe njëqind dollarë nga paratë e tyre shpenzoheshin për përkujdesjen e personave me probleme, si: personat e çmendur, personat me të meta mendore, kriminelët dhe njerëzit e tjerë me probleme. Të dyja këtyre vajzave iu ndalua të martoheshin me njeriun që donin, Kristina me Isakun, ngaqë ai ishte hebre, dhe Klara me Brunon, ngaqë ishte emigrant i varfër. Të dyja ato u rebeluan dhe nuk donin t'u bindeshin urdhrave të të tjerëve. Kristina u rebelua ndaj Gestapos, ndërsa Klara ndaj të atit dhe mjekëve të spitalit "Uillard". Që të dyja u rezistuan vuajtjeve të shkaktuara nga drejtuesit e institucioneve, të cilët nuk tregonin as respektin më të vogël për dinjitetin njerëzor; Kristina në Dakau dhe Klara në Uillard. Ato nuk pranuan të hiqnin dorë nga shpresa dhe bënë të pamundurën për ta përmirësuar jetën e tyre.

UDHËZUES PËR GRUPIN E LEXIMIT

Misteret e Klarës

Ellen Marie Wiseman

HYRJE PËR UDHËZUESIN

Pyetjet e mëposhtme janë përfshirë për ta bërë sa më të frytshëm leximin në grup të romanit "Misteret e Klarës", të shkrimtares Ellen Marie Wiseman.

Pyetje për diskutim

1. Kur vizitoi për herë të parë spitalin "Uillard", Izi kishte frikë të hynte brenda godinave të vjetra, sepse ato i kujtonin vizitat në pavijonin e psikiatrisë ku ishte mbyllur nëna e saj. Gjithashtu, e pati shumë të vështirë të merrej me historinë e sendeve të valixheve të tjera, pasi ato i sillnin ndër mend personat që kishin vdekur dhe që ishin në prag të vdekjes. Spitali i braktisur mund t'u duket magjepsës disa njerëzve, por disa të tjerë do të donin t'i qëndronin sa më larg. Po ju, a do të donit të hynit brenda godinave të braktisura? Do të donit t'u bënit një kontroll valixheve të vjetra?

2. Para se të shpërngulej në shtëpinë e Pegit dhe të Herrit, Izi priste veten me brisk, që të mposhtte emocionet e saj. Vetëlëndimi haset më shpesh gjatë periudhës së adoleshencës dhe moshës së hershme madhore, zakonisht nis të shfaqet në moshën dymbëdhjetë dhe njëzet e katër vjeç. A keni dëgjuar ndonjëherë që vetëlëndimi është një mënyrë për të mposhtur dhembjen emocionale, mllefin dhe zhgënjimin? Mendoni se njerëzit e lëndojnë veten për t'u përballur më mirë me vështirësitë e jetës? Çfarë mendoni se mund t'i kishte ndodhur Izit po të kishte jetuar në kohën e Klarës?

3. E ëma e Izit vrau të shoqin për të mbrojtur të bijën, ndërsa nëna e Shenonit dhe ajo e Klarës nuk bënë asgjë për të mbrojtur bijat e tyre. Diskutoni instinktin mëmësor. Mendoni se ai është më i fortë te disa femra dhe më i dobët te disa të tjera? Mendoni se ndryshimi vjen si pasojë e rrethanave, mënyrës se si janë rritur femrat apo mendoni se ndryshimi është diçka gjenetike?

4. Klara duket se nuk lë gjë pa provuar për t'u arratisur nga Uillardi. Mendoni se duhej të kishte provuar diçka tjetër?

5. Qeveria e Nju Jorkut i ka arkivuar të dhënat mjekësore të ish-pacientëve mendorë, madje nuk ka lejuar as pasardhësit e tyre të kenë askses në to. Pse mendoni se këto të dhëna duhet të mbahen të fshehta? Mendoni se ky ligj duhet ndryshuar?

6. Çfarë ndryshimi keni vërejtur tek Izi gjatë zhvillimit të ngjarjeve të këtij romani? Po te Klara, çfarë ndryshimi ju ka rënë në sy? Cilat ishin ngjarjet më të rëndësishme që ndihmuan në lehtësimin e këtyre ndryshimeve?

7. Në fillim, doktor Roaçi mendon se Klara ka vërtet nevojë për ndihmë, pjesërisht duke u nisur nga historia që i ka treguar i ati i saj dhe pjesërisht për shkak të asaj kohe kur shpërthimet emocionale konsideroheshin shpesh si shenja të sëmundjeve mendore. Pse mendoni se doktor Roaçi nuk pranoi ta linte të lirë Klarën, edhe pse Brunoja i konfirmoi të vërtetën për mbylljen e saj në atë çmendinë? Pse mendoni se ai e mbylli edhe Brunon në azil? Mendoni se doktor Roaçi shqetësohej më tepër për emrin dhe punën e tij apo ndoshta donte të fshihte faktin që i kishte marrë fëmijën Klarës?

8. Izi nuk pranonte ta vizitonte të ëmën në burg, ngaqë kishte frikë. Mendoni se ishte e zemëruar me të ëmën apo thjesht ishte e trishtuar dhe kishte frikë?

9. Klara nuk pranoi të martohej me mblesëri me Xhejmsin, sepse ishte e dashuruar me Brunon. Ajo nuk mund ta imagjinonte kurrë se i ati do ta mbyllte në një çmendinë. Në kohën e Klarës, femrat duhej t'i nënshtroheshin tekave të burrave dhe baballarëve të tyre, por si do të kishit vepruar ju në një situatë të tillë? A do t'i ishit bindur urdhrave të prindërve dhe a do të ishit martuar me Xhejmsin? Do të kishit vazhduar të takoheshit me Brunon?

10. Brunoja nuk e dinte që Klara ishte mbyllur në qendrën "Long Ajlënd", pasi ai nuk i kishte marrë kurrë letrat e saj. Izi nuk e kuptoi kurrë arsyen pse e ëma i kishte vrarë babanë, deri në çastin kur lexoi letrat e saj. Nëse do të kishit pasur më tepër informacione, mendoni se do të kishit menduar dhe vepruar ndryshe në një çast të caktuar në jetën tuaj? Mendoni se pjesa dërrmuese e njerëzve dalin menjëherë në përfundime apo mundohen të mësojnë të gjitha alternativat e një historie?

11. Nga pamja e jashtme, infermiere Trençi dukej si një grua e ashpër, por thellë brenda saj, ajo fshihte një natyrë të butë. Cila ishte përshtypja që ju krijoi, kur u njohët me të për herë të parë? Çfarë menduat për të kur ishte e moshuar? Mendoni se infermiere Trençi duhej të kishte bërë më shumë për ta ndihmuar Klarën gjatë kohës që ishte e mbyllur në Uillard? Çfarë mund të kishte bërë ajo?

12. Izi mendon se asgjë nuk do të ndryshojë për sa i përket bullizmit nëpër shkolla. Po ju, si mendoni? Si mund të bëhen realitet këto ndryshime? Mendoni se kemi bërë përparime për sa i përket bullizmit nëpër shkolla apo mendoni se gjërat janë përkeqësuar?

13. Pas lindjes, Klara sterilizohet, ngaqë doktor Roaçi mendonte se detyra e tij ishte të mos lejonte trashëgiminë e gjeneve "inferiore". Mendoni se mjekët kishin të drejtë të merrnin kësisoj vendimesh për pacientët që konsideroheshin të sëmurë mendorë? Mendoni se është qeveria ajo që duhet të vendosë se kush mundet dhe kush nuk mundet të ketë aftësi riprodhuese? Mendoni se e kemi tepruar për sa i përket të drejtave të riprodhimit të femrave dhe të drejtës së tyre për të vendosur?

14. Brunoja u detyrua ta mbyllte Klarën brenda një arkivoli, me qëllim që të arratiseshin. Po ju a do të ishit në gjendje të mbylleshit brenda një arkivoli, nëse kjo do të ishte mundësia e vetme për të fituar sërish lirinë?

15. Gjatë përmbytjes së dhomës së terapisë me elektroshok, dikush e mbërtheu Klarën për krahu. Kush mendoni se ka qenë?

16. Mendoni se bashkimi i Klarës me të bijën e ndihmoi Izin të shërohej? Në çfarë mënyre? Si u ndje Klara kur pa të bijën?

17. Libri "Misteret e Klarës" përbëhet nga dy histori të ndërthurura - historia e Klarës në të shkuarën dhe kërkimi i Izit në të tashmen. Diskutoni strukturën e secilit subjekt. Ju pëlqyen historitë e ndërthurura dhe kronologjia e ngjarjeve? Cilat janë pikat e forta dhe të dobëta të këtij formati?

18. Cili "zë" ju pëlqeu më shumë, ai i Izit apo i Klarës? Cili është më pak apo më shumë autentik se tjetri? Nëse do t'ju jepej mundësia të takonit një prej këtyre dy personazheve, cilin prej tyre do të zgjidhnit?

19. Cilat janë pikat e përbashkëta të Klarës dhe të Izit? Ku qëndron ndryshimi mes tyre?

20. Si mendoni se do të jetë e ardhmja e Izit? Po e ardhmja e Klarës dhe e vajzës së saj?

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Wiseman, Ellen Marie
Misteret e Klarës / Ellen Marie Wiseman;
Përkth. Manjola Çëraga; Red. Pranvera Palushi, Edvina Sojati.
- Tiranë: Living, 2016
358 f.; 14,8 x 21.0 cm.
Tit. origj.: What she left behind
ISBN 978-9928-216-01-4

1.Letërsia amerikane 2.Romane

821.111(73) -31